

VADEMEKUM PËR AVOKATËT

Këshilla dhe akte për procesin civil

VADEMEKUM PËR AVOKATËT

Këshilla dhe akte për procesin civil

Botuar nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

© Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, 2014

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Materiali që përmban ky publikim mund të citohet ose rishtypet me kusht që të njihet autorësia e tij dhe një kopje e publikimit që përmban materialin e rishtypur t'i dërgohet OSBE-së. Çdo përdorim tjetër i këtij materiali, që përfshin, por që nuk kufizohet në përdorimin komercial apo në krijimin e punimeve që rrjedhin nga ky publikim, kërkon lejen me shkrim të OSBE-së.

Autorët: Artan Hajdari
Mariana Semini-Tutulani
Envi Hicka
Julian Haxhiu
Florian Ballhysa
Ardian Dvorani
Julian Hodaj
Besmir Beja
Holger Hembach

Redaktor shkencor: Ervin Pupe

ISBN: 978-92-9235-258-5

Arti grafik: Eva Kukaleshi

Përmbajtja e botimit është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe jo domosdoshmërisht pasqyron pozicionin e Prezencës së OSBE-së.

Në vend të parathënies

I nderuar lexues,

Libri që kenë në duar nuk është një botim klasik mbi procesin civil dhe veçoritë e tij. Ekzistojnë shumë libra dhe tekste universitare, të cilët kanë trajtuar më së miri gati të gjitha aspektet teorike të instituteve të procedurës civile.

Ky libër ka një qasje ndryshe ndaj procesit civil dhe punës së avokatit në përgjithësi. Ai synon të jetë një mjet lehtësues në punën e përditshme të avokatit, sidomos atij të ri. Libri jep këshilla praktike dhe fokusohet në tre aspekte kryesore: në marrëdhënien e avokatit me organet që “qeverisin” këtë profesion; në marrëdhënien e avokatit me klientin dhe përgatitjet paraprake për një çështje; dhe në sjelljen e mënyrën e përfaqësimit të klientit gjatë procesit gjyqësor civil.

Më pëlqen shumë një thënie e avokatit të njohur italian, Piero Calamandrei, për cilësitë dhe punën e avokatit. Kur u pyet se cili ishte një “avokat i madh,” Calamandrei u përgjigj: “të jesh avokat i madh do të thotë të jesh avokat i dobishëm për gjykatësit, në mënyrë që t’i ndihmosh ata të vendosin sipas parimeve të drejtësisë, të jesh i dobishëm për klientin për ta ndihmuar në mbrojtjen e të drejtave dhe paraqitjen sa më mirë të argumenteve të tij, të flasësh aq pak sa është e nevojshme, të shkruash qartë, shkurt dhe saktë, të mos shkaktosh rrëmujë në seancën gjyqësore duke e pushtuar atë me personalitetin tënd, të mos bezdisësh gjykatësit me fjalë të shumta dhe të mos i shtysh ata të kenë dyshime të kota duke iu ofruar hollësira të tepërta e të panevojshme: pikërisht pra, duhet të jetë e kundërta e atij që shumë njerëz kujtojnë se është një “avokat të madh”.” Për mendimin tim kjo përgjigje pasqyron cilësitë që duhet të ketë një avokat i mirë dhe ky libër ofron rrugën për përfitim të këtyre cilësive.

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, ka qenë dhe është e përkushtuar për të asistuar në përmirësimin e cilësisë dhe efektivitetit të sistemit të drejtësisë në vend. Ne jemi gjithashtu të vetëdijshëm se lipset të vlerësohet siç duhet roli dhe rëndësia e secilit prej aktorëve të sistemit. Ne jemi të bindur për rolin e rëndësishëm të avokatëve, veçanërisht në procesin civil. Mund të thuhet fare mirë se avokatët janë “motori” apo “zemra” e këtij procesi dhe për këtë arsye besojmë se përmirësimi i performancës profesionale të avokatëve do të sjellë një cilësi më të mirë të procesit.

Duke përfunduar, dua të falënderoj qeverinë norvegjeze që, me shumë dashamirësi dhe largpamësi, financoi publikimin e këtij libri. Gjithashtu dëshiroj t’u bëj thirrje avokatëve, sidomos atyre të rinj: Përdoreni këtë libër, mundohuni të mësoni dhe të rriteni profesionalisht por mbi të gjitha mos harroni kurrë parimet bazë të ushtrimit të profesionit, atë të ndershmërisë, pavarësisë, besnikërisë ndaj klientit, dinjitetit dhe përkushtimit! Shpresoj që ky libër t’ju ndihmojë të jeni në gjendje të nxirrni më të mirën nga vetvetja dhe të influenconi pozitivisht jo vetëm sistemin e drejtësisë, por edhe gjithë shoqërinë.

Florian Raunig

Ambasador

Kryetar i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri

Tabela e Lëndës

SHKURTIME

11

KREU 1 - TË BËHESH AVOKAT

1.1. Roli i avokatit në shoqëri dhe në fushën e së drejtës civile	13
1.1.1. Profesionin e avokatit dhe roli i tij në shoqëri, në një këndvështrim historik	13
1.1.2. Kush mund ta ushtrorë profesionin e avokatit në RSH	14
1.1.3. E drejta për t'u mbrojtur me avokat si një e drejtë kushtetuese dhe ligjore	19
1.1.4. E drejta e mbrojtjes në procesin civil	20
1.2. Kushtet për t'u bërë avokat në Republikën e Shqipërisë	24
1.2.1. Kushtet ligjore për ushtrimin e profesionit të avokatit	24
1.2.2. Hapat konkretë që duhen ndjekur për të ushtruar avokatinë	25
1.2.3. Ndjekja e studimeve në Shkollën Kombëtare të Avokatisë	27
1.2.4. Provimi për marrjen e licencës së "Avokatit"	28
1.2.5. Përjashtimi nga provimi	30
1.3. Organizimi i avokatisë dhe i avokatëve	31
1.3.1. Statusi i Dhomës Kombëtare të Avokatisë	31
1.3.2. Statusi i avokatit dhe kategorizimet e tyre	33
1.3.3. Organizimi i Studive avokatore	35
1.4. Kodi i sjelljes së Avokatit	37
1.4.1. Të drejtat dhe detyrat e avokatit sipas kodit të sjelljes	37
1.5. Procedimi disiplinor	43
1.5.1. Thelbi i procedimit disiplinor	43
1.5.2. Subjektet që mund të bëjnë ankesë ndaj avokatit	46
1.5.3. Afati i ushtrimit të së drejtës së ankimit	47
1.5.4. Komisioneri i Ankimeve	48
1.5.5. Komiteti Disiplinor	49
1.6. Trajnimet e vazhdueshme	52
1.6.1. Roli dhe rëndësia e trajnimeve vazhduese	52
1.6.2. Mënyra e zhvillimit të trajnimit vazhdues	53

KREU 2 - MARRËDHËNIA ME KLIENTIN

2.1. Marrëdhënia juridike e porosisë, ndërmjet avokatit dhe klientit	55
2.1.1. Parimet që udhëheqin marrëdhënien e avokatit me klientin	56
2.1.2. Kontrata e porosisë dhe kushtet e saj	59
2.1.3. Dallimi i kontratës së porosisë nga prokura për përfaqësimin gjyqësor apo juridik	65
2.2. Tarifimi	67
2.2.1. Liria dhe kufizimi në përcaktimin e tarifës së shërbimit	68
2.2.2. Tarifa orare	70
2.2.3. Tarifa e sheshtë	71
2.2.4. Parapagimi (the retainer fee)	72
2.2.5. Tarifa sipas rastit	73
2.2.6. Aspekte normative të tarifimit	74
2.2.7. Financimi i padive	76
2.2.8. Success fee si pjesë e marrëveshjes së porosisë	77

2.2.9. Dy dispozita për t'u marrë në konsideratë në vend për përfundimit	78
2.3. Përfaqësimi me prokurë	79
2.3.1. Prokura noteriale	80
2.3.2. Prokura noteriale e përpiluar në juridiksionin e huaj	81
2.3.3. Prokura e lëshuar nga personat juridikë (autorizimi i përfaqësimit)	84
2.4. Aspekte etike	85
2.4.1. Përgjegjësia profesionale. Aspekte teorike të përgjegjësisë profesionale	85
2.4.2. Përgjegjësi profesionale e avokati sipas legjislacionit tonë	86
2.5. Privatësia. Mbrojtja e të dhënave personale	87

KREU 3 - PËRGATITJA PARAPRAKE E ÇËSHTJES

3.1. Krijimi, administrimi dhe ruajtja e dokumenteve të çështjes. Llojet e provave dhe menaxhimi i tyre	89
3.1.1. Fazat që duhet të kalojë marrëdhënia avokat - klient para krijimit, administrimit dhe ruajtjes së dokumenteve të çështjes	89
3.1.2. Llojet e dokumenteve që krijon avokati	91
3.1.3. Llojet e provave të njohura nga ligji procedural	94
3.2. Kërkimi shkencor	102
3.2.1. Analizimi i rrethanave, menaxhimi i situatës/rastit juridik dhe përcaktimi i strategjisë së mbrojtjes	103
3.2.2. Përcaktimi i kompetencës lëndore dhe përcaktimi i ndërgjyqësisë dhe analizimi i legjitimitetit të palëve	108
3.2.3. Rastet e konkurrimit të padive dhe mënyra e përzgjedhjes së padisë së duhur dhe më efikase	110
3.2.4. Gjetja e ligjit dhe normës së zbatueshme (objekti dhe shkaku ligjor i padisë)	117
3.2.5. Gjetja e vendimeve unifikuese të Gjykatës së Lartë dhe e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese që mbulojnë rastin konkret	119
3.2.6. Doktrina ku mbështetet arsyetimi i rastit si e vendit ashtu edhe e huaj	119
3.3. Teknikat e arsyetimit ligjor	120
3.3.1. Disa këshilla praktike për përgatitjen e çështjes për gjyq	120
3.3.2. Ankimi i administrativ	122
3.3.3. Kërkesa për sigurimin e padisë	123
3.3.4. Konkluzionet përfundimtare	129

KREU 4 - ORIENTIMI NË GJYKATË

4.1. Funksionet drejtuese në gjykatë	131
4.1.1. Kryetari i gjykatës	131
4.1.2. Kancelari i gjykatës	132
4.2. Menaxhimi i çështjeve civile në gjykatë	133
4.2.1. Regjistrat gjyqësorë	133
4.2.2. Pranimi i çështjeve civile	134
4.2.3. Ndarja e çështjeve civile	134
4.3. Marrëdhëniet me publikun dhe median	134
4.4. Taksat gjyqësore	135
4.5. Aktet e procesit civil	136
4.5.1. Aktet e gjykimit në shkallë të parë	137

4.5.1.1. Padia	137
4.5.1.2. Kërkesa për sigurimin e padisë	137
4.5.1.3. Prapësimet	137
4.5.1.4. Kundërpadia	137
4.5.1.5. Vendimet e ndërmjetme	138
4.5.1.6. Vendimi përfundimtar	138

KREU 5 - GJYKIMI NË SHKALLË TË PARË

5.1. Gjykimet civile në përgjithësi	139
5.1.1. Parimet e gjyimit civil	139
5.1.2. Palët në gjykimin civil	140
5.1.3. Listë kontrolli për avokatin e paditësit në gjykimin civil	141
5.1.4. Listë kontrolli për avokatin e të paditurit në gjykimin civil	142
5.1.5. Teknika të hartimit të dokumenteve që i paraqiten gjykatës	143
5.1.5.1. Të përgatitsh për të shkruar	143
5.1.5.2. Këshilla për shkrimin e dokumenteve që i paraqiten gjykatës	144
5.1.6. Teknika të prezantimit të çështjes para gjykatës	145
5.1.6.1. Besueshmëria e dërguesit	145
5.1.6.2. Aftësitë e marrësit	146
5.1.6.3. Dhënia e mesazhit në mënyrë efektive	146
5.1.6.4. Planifikimi i gjyqit	147
5.1.6.5. Këshilla praktike për prezantimin e rastit	147
5.1.6.6. Teknikat e komunikimit të mesazhit	148
5.1.6.7. Etika dhe argumentet e palejueshme	149
5.1.7. Skema e gjyimit civil	149
5.2. Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative	152
5.2.1. Aktet administrative që i nënshtrohen kontrollit gjyqësor	153
5.2.2. Llojet e padive administrative	154
5.2.3. Kufijtë e shqyrtimit gjyqësor dhe afatet e gjyimit administrativ	155
5.2.4. Barra e provës në gjykimin administrativ	157
5.2.5. Pezullimi i aktit administrativ, si një lloj i veçantë i masës për sigurimin e padisë	157
5.2.6. Vendimi i gjykatës në përfundim të gjyimit administrativ	158
5.3. Mosmarrëveshjet që lidhen me familjen	159
5.3.1. Zgjidhja dhe pavlefshmëria e martesës	160
5.3.2. Vënia dhe heqja e kujdestarisë mbi të miturit, mbajtja për rritje dhe edukim e fëmijëve të mitur	164
5.3.3. Miratimi i birësimit	165
5.3.4. Mosmarrëveshjet lidhur me detyrimin për ushqim	166
5.3.5. Heqja dhe kthimi i të drejtës prindërore	166
5.3.6. Këshilla praktike për marrëdhënien me klientin dhe palën tjetër gjatë gjyimit të mosmarrëveshjeve familjare	167

KREU 6 - GJYKIMI I ÇËSHTJEVE NË GJYKATËN E APELIT

6.1. E drejta e ankimit	169
6.2. Mjetet për të ushtruar të drejtën e ankimit në gjykatën e apelit të	

kompetencës lëndore civile të zakonshme	169
6.3. Gjykimi i çështjeve administrative në gjykatën e apelit	192

KREU 7 - REKURSI, ANKIMI I VEÇANTË DHE KËRKESA PËR RISHIKIM NË GJYKATËN E LARTË

7.1. Funksioni rishikues i Gjykatës së Lartë	197
7.2. E drejta e ankimit kundër një vendimi gjyqësor në Gjykatën e Lartë	198
7.3. E drejta kushtetuese e ankimit kundër vendimit gjyqësor të një gjykate më të ulët në një gjykatë më të lartë. Kufizimet e saj	199
7.4. Mjetet e ankimit	200
7.4.1. Rekursi si mjet ankimi	201
7.4.2. Kundërrekursi	202
7.5. Shkaqet e rekursit	203
7.5.1. Rregullat bazë për pranueshmërinë dhe për shqyrtimin e shkaqeve të rekursit	204
7.5.1.1. Thelbi dhe rastet e zbatimit të shkakut ligjor “Nuk është respektuar ose është zbatuar keq ligji” - parashikuar nga neni 472, shkronja “a”	205
7.5.1.2. Qëllimi dhe thelbi i zbatimit të shkakut ligjor “Ka shkelje të rënda të normave procedurale (neni 467 i këtij Kodi)” – parashikuar nga neni 472, shkronja “b”	206
7.5.1.3. Rastet e zbatimit të shkakut ligjor “Ka shkelje të rënda të normave procedurale (neni 467 i këtij Kodi)” – parashikuar nga neni 472, shkronja “b”	208
7.5.1.3.1. Gjykata e shkallës së parë ka shkelur dispozitat mbi juridiksionin dhe kompetencën (neni 467, shkronja “a”)	208
7.5.1.3.2. Përbërja e trupit gjykues nuk ka qenë e rregullt apo vendimi nuk është nënshkruar nga anëtarët e tij, ose është cënuar parimi i paanësisë (neni 467, shkronja “b”)	209
7.5.1.3.3. Gjykata ka vendosur pushimin e çështjes në kundërshtim me rregullat e përcaktuara nga ky Kod (neni 467, shkronja “c”)	212
7.5.1.3.4. Çështja është gjykuar në mungesë të pjesëmarrësve në proces, pa pasur dijeni për ditën e gjykimit (neni 467 shkronja “ç”)	213
7.5.1.3.5. Nuk është formuar drejtë ndërgjyqësia (neni 467, shkronja “d”)	213
7.5.1.3.6. Kur mungojnë ose janë të pavlefshme padia, procesverbali gjyqësor, ankimi, si dhe çdo dokument tjetër, që ka ndikuar në dhënien e vendimit (neni 467, shkronja “e”)	214
7.5.1.3.7. Gjykata nuk është shprehur për të gjitha kërkesat e parashtruara nga palët në padi dhe që përbëjnë objektin e mosmarrëveshjes midis palëve ndërgjyqëse (neni 467, shkronja “ë”)	215
7.5.1.3.8. Kur lind nevoja për marrjen e një prove vendimtare, marrja e së cilës është e vështirë në shkallë të dytë (neni 467, shkronja “ë”)	215
7.5.1.3.9. Shkelje të tjera të rënda procedurale, që sjellin cenimin e vendimit të gjykatës	216
7.6. Procedura e paraqitjes së rekursit dhe kundër rekursit, në Gjykatën e Lartë	218
7.6.1. Interesi dhe legjitimiteti i palës për të ushtruar të drejtën e rekursit	218
7.6.2. Afati për ushtrimin e rekursit	219
7.6.3. Rivendosja në afat e rekursit	220
7.6.4. Njoftimi i rekursit dhe kundërrekursit	221
7.6.5. Struktura, elementët formalë dhe dokumentet që i bashkëlidhen rekursit	221
7.6.6. Verifikimi i plotësisimit të elementëve formal-procedural	224

7.7. Kërkesa për pezullimin e vendimit që kundërshtohet me recurs	224
7.8. Heqja dorë nga recursi	225
7.9. Mënyra e shqyrtimi të recursit dhe kundërrecursit nga Gjykata e Lartë	226
7.9.1. Kufijtë dhe procedura e shqyrtimit në dhomën e këshillimit	228
7.9.2. Kufijtë dhe procedura e shqyrtimit në seancë gjyqësore	230
7.10. Ankimet e veçanta mbi juridiksionin dhe kompetencën	233
7.10.1. Gjykimi mbi juridiksionin	234
7.10.2. Gjykimi mbi kompetencën	235

KAPITULLI 8 - EKZEKUTIMI I DETYRUESHËM

8.1. Hyrje	237
8.2. Roli i avokatit në fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm	237
8.3. Vënia në ekzekutim	244
8.4. Roli i avokatit gjatë procesit të ekzekutimit	246
8.5. Mjetet e mbrojtjes ndaj ekzekutimit të detyrueshëm	249
8.5.1. Pavlefshmëria e titullit ekzekutiv (neni 609)	249
8.5.2. Kundërshtimi i veprimeve të përmbarusit gjyqësor (neni 611)	252
8.5.3. Padia e personit të tretë (neni 612)	254

KREU 9 - PARAQITJA DHE SHQYRTIMI I KËRKESËS PËRPARA GJYKATËS EVROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT

9.1. Hyrje	257
9.2 Faza e pranueshmërisë së kërkesës	259
9.2.1. Pajtueshmëria	259
9.2.1.1. Juridiksioni racione temporis	259
9.2.1.1.1. Përcaktimi i momentit të veprimit të Konventës	261
9.2.1.1.2. Detyrimet e ndashme	263
9.2.1.1.3. Shkelja e vazhdueshme	265
9.2.1.1.4. Marrja në konsideratë e rrethanave që kanë ekzistuar përpara datës së hyrjes në fuqi të Konventës	267
9.2.1.2. Juridiksioni racione loci	268
9.2.1.3. Juridiksioni racione personae	269
9.2.1.3.1. Shkeljet që i atribuohen një shteti anëtar	270
9.2.1.3.2. Përgjegjësia e sjelljes në lidhje me organizatat ndërkombëtare	272
9.2.1.3.3. Kërkesa nga persona që gëzojnë të drejtën t'i drejtohen Gjykatës	275
9.2.1.4. Juridiksioni racione materiae	275
9.2.2. Pranueshmëria strictu sensu	277
9.2.2.1. Viktima	277
9.2.2.1.1. Cenimi i kërkuesit nga sjellja e një shteti	277
9.2.2.1.1.1. Kërkesat e paraqitura nga personat e cenuar nga një veprim apo mosveprim	277
9.2.2.1.1.1.1. Viktima e drejtpërdrejtë	278
9.2.2.1.1.1.2. Viktimë e tërthortë	278
9.2.2.1.1.1.3. Viktima e mundshme	282
9.2.2.1.1.2. Kërkesa nga palë të treta në emër të personit të prekur	284
9.2.2.1.1.2.1. Kërkuesi vdes pas paraqitjes së kërkesës	285

9.2.2.1.1.2.2. Personi i cenuar drejtpërsëdrejti vdes para paraqitjes së kërkesës në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut	286
9.2.2.1.1.2. Jo “actio popularis”	289
9.2.2.1.3. Zgjidhje e pamjaftueshme në nivel kombëtar	290
9.2.2.1.3.1. Njohja e shkeljes	290
9.2.2.1.3.2. Zgjidhje e mjaftueshme	291
9.2.2.3. Subjektet potencialë që mund të paraqesin kërkesë përpara Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut	292
9.2.2.3.1. Individët	292
9.2.2.3.2. Organizatat jo-qeveritare	293
9.2.2.3.2.1. Organizatat	293
9.2.2.3.2.2. Organizmat jo shtetërorë / entet jo publikë	294
9.2.2.3.2.3. Grupe individësh	296
9.2.3. Shterimi i mjeteve ligjore në nivel kombëtar	296
9.2.3.1. Tablo e përgjithshme	296
9.2.3.2. Mjetet ligjore efikase	297
9.2.3.2.1. Mjetet ligjore të realizueshme që sigurojnë rigjykim të mjaftueshme	298
9.2.3.2.2. Ngritja para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut e të njëjtës çështje, si ajo e ngritur në nivel kombëtar	302
9.2.3.3. Koha e disponueshmërisë së mjeteve	304
9.2.3.3.1. Përrjashtim: Mjetet në nivel kombëtar dhe lidhja e tyre me kohëzgjatjen e procedimeve	304
9.2.3.3.2. Përrjashtim: Mjetet në nivel kombëtar lidhur me shkeljen e të drejtave mbi pronën	306
9.2.3.4. Barra e provës	306
9.2.3.5. Përrjashtimet nga parakushti për të shteruar zgjidhjet ligjore në nivel kombëtar	307
9.2.4. Periudha kohore	307
9.2.4.1. Tablo e përgjithshme	307
9.2.4.2. Fillimi i afatit kohor	309
9.2.4.3. Përrllogaritja e afatit kohor	313
9.2.4.4. Informacionet që duhet të jepen brenda afatit	313
9.2.5. Disavantazhe të konsiderueshme	314
9.2.5.1. Përrmbledhje/Tablo e përgjithshme	314
9.2.5.2. Kuptimi i disavantazhit	315
9.2.5.2.1. Dëmi financiar	315
9.2.5.2.2. Dëmet jo financiare	316
9.2.5.3. Të drejtat e njeriut kërkojnë gjykim në themel	316
9.2.5.4. Mos vlerësimi siç duhet në nivelin vendas	317
9.2.6. Mos abuzimi me të drejtën e paraqitjes së një kërkesë	317
9.2.7. Mospranimi i kërkesave anonime	320
9.3. Çështje procedurale	320
9.3.1. Komente të përgjithshme	320
9.3.2. Rezultatet	321
9.3.2.1. Konstatimi i një shkeljeje	321
9.3.2.2. Shpërrblimi i drejtë	321
9.3.2.3. Masat e ndërrmjetme	322
9.3.2.4. Procedura e gjykimit pilot	322
9.3.2.5. Zgjidhja me pajtim	322

Shkurtime

Av.	Avokat
DHKA	Dhoma Kombëtare e Avokatisë
K.C.	Kodi civil
KE	Këshilli i Evropës
KEDNJ	Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut
K.Pr.C.	Kodi i procedurës civile
K.Pr.P.	Kodi i procedurës penale
K.Pr.A.	Kodi i procedurës administrative
K.Sh.C.	Komisioni i shërbimit civil
GJEDNJ	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
ZRPP	Zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme

KREU 1

TË BËHESH AVOKAT

Av. Artan HAJDARI, Prof. Dr. Mariana SEMINI-TUTULANI
dhe Av. Envi HICKA

1.1. Roli i avokatit në shoqëri dhe në fushën e së drejtës civile

1.1.1. Profesioni i avokatit dhe roli i tij në shoqëri, në një këndvështrim historik

Kur flasim për rolin e avokatit në shoqëri, kemi parasysh se ai si profesion zë fill qysh nga lashtësia, fillimisht në Athinë dhe më pas në Romën e Lashtë. Në Athinë avokatë konsideroheshin oratorët (*orators*), të cilët mund t'i jepnin këshilla ligjore një miku të tyre pa pasur të drejtë që t'i kërkonin atij paraprakisht apo në fund të punës një shpërblim në të holla, ashtu siç veprohet sot në profesionin e lirë të avokatit.

Ndërsa në Romën e Lashtë, rreth vitit 204 Përpara Krishtit, ashtu si dhe në Athinë, avokatë quheshin ata të cilët ishin trajnuar në retorikë (*retoric*). Oratorët mund të jepnin edhe këshilla ligjore. Me kalimin e kohës prej tyre lindën edhe të ashtuquajturit “këshilltarë ligjorë” (*iuris consulti*), të cilët e ushtronin profesionin jo si një mënyrë jetese, por si një hobi. Në Romën Perandorake profesioni i avokatit filloi të merrte zhvillim të madh, duke hyrë si një pjesë e rëndësishme e jetës tregtare (qarkullimit juridik) që zhvillohej në këtë periudhë.

Me zhvillimin e marrëdhënieve tregtare njohu zhvillim edhe profesioni i avokatit. Në Perandorinë Bizantine profesionin e avokatit e gjejmë jo vetëm më të zhvilluar, por edhe më të organizuar. Duke cituar juristin e njohur Fritz Schulz¹ konstatojmë se, në shekullin e katërt gjërat kishin ndryshuar në Perandorinë lindore ku “avokatët tani ishin me të vërtetë profesionistë”.

¹ Fritz Schulz (16 Qershor 1879 – 12 Nëntor 1957), jurist gjerman dhe një historian i së drejtës, një prej doktrinave më të rëndësishme në të drejtën civile (*Roman Law*) në shekullin e 20-të. Emigroi në Angli për shkak të origjinës së tij hebraike dhe të përndjekjes nga nazistët gjermanë.

Me rënien e Perandorisë së Perëndimit dhe ardhjen e periudhës së mesjetës së errët, në kontinentin evropian edhe profesioni i avokatit, ashtu si dhe shumë aktivitete të tjera të jetës, humbi përkohësisht rolin e tij. “Dinjteti” i avokatit u arrit të fitohej sërish rreth viteve 1231, falë përpjekjeve të kishës dhe të shtetit për ta ringritur atë me rregulla më të qarta. Me kalimin e viteve, profesioni i avokatit filloi të merrte formë më të qartë dhe të bazohej në rregulla më të plota për organizimin dhe funksionimin e tij. Avokatët u ndanë në dy grupe të mëdha, në ata që e ushtronin profesionin sipas sistemit të *civil law* dhe ata që e ushtronin profesionin sipas sistemit të *common law*. Por, pavarësisht kësaj ndarjeje në dy sisteme të së drejtës, avokatët kishin të njëjtën natyrë pune, atë të ndihmës juridike që u jepnin individëve apo tregtarëve për çështje të ndryshme. Kështu, sipas ndarjes në këto dy sisteme të mëdha, vërehet se për avokatët në sistemin *civil law* është pothuajse e pamundur të ndryshojnë karrierën dhe të emërohen si gjyqtarë, me përjashtime në disa vende të këtij sistemi, përfshi këtu edhe sistemin e së drejtës në vendin tonë². Ndërsa, në sistemin *common law* nuk është e pazakontë që për t’u emëruar gjyqtar kërkohet që të kesh punuar disa vite në praktikë si avokat. E theksuam këtë fakt për të nxjerrë në pah rëndësinë e profesionit të avokatit në të dyja sistemet, por edhe vlerën e “shtuar” që ai merr sidomos në sistemin *common law*.

Profesioni i avokatit është kthyer sot në kohët moderne në një nga profesionet më të kërkuara, pasi nuk ka hapësirë të jetës ku avokati nuk lë gjurmët e tij. Për t’u bërë avokat kërkohet që të plotësohen disa kritere, të cilat në vende të ndryshme janë të ndryshme.

1.1.2. Kush mund ta ushtrojë profesionin e avokatit në RSH

Avokatia në Republikën e Shqipërisë është organizuar si një profesion i lirë, i pavarur, i vetë-rregulluar dhe i vetë-drejtuar. Kjo do të thotë që, pavarësisht se kemi një ligj që rregullon veprimtarinë ligjore të avokatisë, ai nuk e bën atë të varur nga ndonjë degë e pushtetit. Ligji sanksionon në vetvete pavarësinë substanciale të profesionit të avokatit. Kjo pavarësi është zgjeruar më tej në statutin e Dhomës Kombëtare të Avokatisë (DHKA) si dhe në aktet që nxjerrin organet drejtuese të DHKA me qëllim mirëfunksionimin e aktivitetit profesional të avokatit.

Avokatinë do ta konsideronim jo thjesht si një shërbim ku secili individ, grup individësh apo entitete ligjore të krijuara me ligj mund të marrin këshilla të

² Sipas kushtetutës së RSH, neni 125, kriteri për t’u bërë gjyqtar i Gjykatës së Lartë dhe asaj kushtetuese nuk përjashton avokatët që të jenë kandidatë të mundshëm, ndërsa për t’u emëruar gjyqtarë në Gjykatën e Shkallës së Parë dhe asaj të Apelit kërkohen kritere të cilat përjashtojnë kategorinë e avokatëve.

ndryshme juridike, por gjatë veprimtarisë së tij avokati padyshim kryen veprime dhe shërbime në të mirë të publikut, duke i dhënë kështu profesionit të avokatit edhe një karakter publik.

Avokati gjatë ushtrimit të profesionit, jep ndihmë juridike nëpërmjet këshillave që ai i jep klientit për çështje të ndryshme ligjore, kujdeset për përgatitjen e akteve gjyqësore, siç janë kërkesë paditë apo kërkesat e ndryshme gjatë procedimit penal si dhe kërkesave të ndryshme ankimore drejtuar organeve të administratës publike në kuadër të mbrojtjes dhe interesave të klientit. Në mënyrë të veçantë, ndihma juridike konsiston në dhënien e këshillave në çdo fushë të së drejtës dhe sa herë që ajo kërkohet nga klienti.³

Ushtrimi i profesionit të avokatit në Republikën e Shqipërisë, bëhet i mundur kur plotësohen dy kërkesa kryesore: së pari, pajisja me leje për ushtrimin e profesionit të avokatit dhe së dyti, regjistrimi pranë organit tatimor. Pajisja me lejen e ushtrimit të profesionit të avokatit është një nga kushtet themelore që një avokat duhet të plotësojë që të mund të ushtrojë profesionin e tij. Marrja e kësaj lejeje kërkon përmbushjen e disa kushteve thelbësore, realizimi i të cilave mbikëqyret nga ana e organeve drejtuese të Dhomës Kombëtare të Avokatisë. Kushtet thelbësore për marrjen e lejes së ushtrimit të profesionit të avokatit janë:

1. Pasja e një diplome universitare, sipas ligjit për arsimin e lartë në RSH, në të cilën të jetë përcaktuar marrja e titullit “Jurist”;
2. Regjistrimi pranë DHKA si asistent avokat, dhe kryerja e stazhit të asistentit avokatit për një periudhë një vjeçare, pranë një zyre avokatie;
3. Përfundimi i Shkollës Kombëtare të Avokatisë dhe pajisja me vërtetimin përkatës, sipas kriterëve të vendosura nga ana e organeve drejtuese të DHKA;
4. Kalimi me sukses i provimit që organizohet nga ana e DHKA, pas përfundimit të periudhës së stazhit dhe asaj të programit të formimit fillestar pranë Shkollës Kombëtare të Avokatisë⁴.

Avokati mund ta ushtrojë profesionin e tij në të gjithë territorin e vendit, pa pasur nevojë për ndonjë leje të posaçme për këtë. Titulli i avokatit fitohet vetëm një herë dhe mund të hiqet vetëm në kushtet e përcaktuara nga ligji dhe statuti. Ky titull i jep

³ Neni 2 i ligjit nr. 9109, datë 17. 07. 2003, parashikon në mënyrë jo shteruese disa nga punët që mund të kryejë avokati gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij, duke dhënë ndihmë juridike. Themi jo shteruese, pasi dispozita në fjalë liston punët që duhet të kryejë avokati gjatë dhënies së ndihmës juridike dhe lë të hapur mundësinë e zgjerimit të kësaj ndihme në raste të parashikuara më ligj.

⁴ Më ndryshmet që janë bërë ligjit bazë nr. 9109, datë 17.07.2003 “Për Profesionin e Avokatit në RSH”, më ligjin nr. 91/2012, datë , datë 27. 09. 2012, është themeluar Shkolla Kombëtare të Avokatisë më qëllim trainimin për formimin e asistentëve avokatë më njohuritë bazë praktiko- teorike të ushtrimit të profesionit si dhe trainimi vazhdues me njohuri të thelluara i avokatëve në detyrë.

avokatit mundësinë që të paraqitet përpara çdo gjykate, prokurorie apo organi të administratës publike në nivel qendror apo vendor, me qëllim mbrojtjen e interesave të klientëve. Avokati gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij duhet të identifikohet me numrin e lejes së ushtrimit të profesionit si dhe me kodin fiskal të tij apo të zyrës ku ai bën pjesë. Një nga problemet më të mëdha që haset në praktikën e përditshme është se avokatëve jo në pak raste u mungon plotësimi i njërit apo tjetrit kriter. Kjo për faktin se, identifikimi i avokatit nuk kërkon vetëm pasjen e numrit të lejes së ushtrimit të profesionit, e cila është një dhe unike për secilin avokat dhe caktohet vetëm në momentin e lëshimit të saj, por avokati duhet që gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij, të paraqesë kartën e identitetit të avokatit e cila sipas rregullave të vendosura në statutin e DHKA, i jepet avokatit çdo vit nga DHKA pasi ai ka paguar rregullisht detyrimet e anëtarësisë. Pagimi i detyrimeve për anëtarësinë në DHKA dhe pagimi i detyrimeve ndaj organeve tatimore, që lindin gjatë ushtrimit të aktivitetit të avokatit, është një nga kushtet bazë për ushtrimin e profesionit të tij.

Avokati mund ta ushtrojë profesionin e tij edhe jashtë territorit të RSH, por gjithnjë në përputhje me ligjet e shtetit ku mendohet se mund të jepet ndihma juridike. Kjo ndodh në rastet kur avokati kërkon të përfaqësojë klientin e tij para organeve kompetente të drejtësisë apo të administratës publike të një shteti tjetër. Përjashtim bëhet në ato raste kur ndihma juridike jepet në negocime kontratash apo në këshilla juridike midis privatëve. Avokati ka të drejtë, pa pasur asnjë pengesë, të përfaqësojë klientin e tij para trupave të arbitrazhit të vendosura në juridiksione të huaja, pavarësisht ligjit të aplikueshëm nga ana e tyre.

Avokati gjatë ushtrimit të profesionit të tij ka një sërë të drejtash që rrjedhin si nga kuadri ligjor organik që rregullon profesionin e avokatit, ashtu edhe nga ligjet procedurale, të fushës civile ose të fushës penale. Një nga të drejtat themelore të avokatit për të ushtruar sa më mirë profesionin e tij dhe në interesin më të lartë të klientit, është e drejta që ai ka për të kërkuar nga institucionet shtetërore akte, dokumente apo të dhëna dhe shpjegime të cilat kanë lidhje me çështjet që ai përfaqëson apo mbron. Në çdo rast, kur avokati u drejtohet këtyre institucioneve duhet të paraqesë edhe aktin e përfaqësimit, prokurën, e cila i jep atij legjitimitetin për t'iu drejtuar atyre në emër dhe për llogari të klientit të tij.

Nuk janë të pakta rastet kur avokati në ushtrim të detyrave të tij t'i drejtohet organeve të administratës shtetërore pa e pasur aktin e përfaqësimit nga klienti i vet dhe anasjelltas, vërehet që edhe organet e administratës shtetërore gjatë komunikimit me avokatin, i cili në këtë rast vepron në emër e për llogari të klientit të tij, shpesh herë nuk e kërkojnë një akt të tillë. Në një praktikë të tillë jo ligjore detyrimi parësor rëndon mbi avokatin, i cili, në çdo rast, nuk duhet të

veprojë për llogari të klientit të tij pa pasur aktin e përfaqësimit.

E drejta e avokatit, që në përmbushje të misionit të tij ligjor dhe në interesin më të lartë të klientit, të kërkojë nga institucionet e administratës shtetërore të dhëna dhe dokumente të cilat do t'i nevojiten atij për të mbrojtur apo përfaqësuar klientin në gjykatë ose për t'i dhënë atij një opinion ligjor të bazuar, të drejtë dhe të plotë, gjen bazë ligjore në nenin 6 i ligjit nr. 9109, datë 17.07.2003, "Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar). Institucionet e administratës shtetërore janë të detyruara t'i përgjigjen pozitivisht kërkesës së avokatit, pasi në të kundërt, ky i fundit ka të drejtë që brenda një afati prej 5 ditësh, të bëjë kërkesë në gjykatë për të realizuar këtë të drejtë. Që të kemi një vendim gjyqësor në favor të kërkesës së avokatit, duhet që kërkesa e tij të jetë e motivuar dhe refuzimi i bërë nga ana e institucionit shtetëror përkatës të jetë i pabazuar në ligj dhe në prova.

Në praktikë, përmbajtja e nenit 6 e ligjit të sipërpërmendur, ka nxjerrë probleme të ndryshme, pasi ajo nuk është vetëm një dispozitë materiale, pra një rregull ku përcaktohet si e drejta e avokatit për të kërkuar informacion nga institucionet shtetërore, ashtu edhe detyrimi i këtyre të fundit për ta përmbushur atë. Neni 6 në vetvete, është edhe një dispozitë me përmbajtje procedurale, pasi në të kërkohet edhe respektimi i disa kërkesave, mospërmbushja e të cilave mund të çojë në rrëzimin e kërkesës pa hyrë në shqyrtimin e përmbajtjes së themelit të saj.

Në këtë marrëdhënie të krijuar ndërmjet avokatit dhe institucioneve shtetërore për shkak të kërimit të informacionit, një moment procedural me rëndësi është edhe ai i respektimit të afatit brenda të cilit avokati duhet të kundërshtojë vendimin e institucionit shtetëror për refuzimin e kërkesës për marrje informacioni. Ligji nuk bën fjalë se kur fillon ky afat, por duke iu referuar parimeve të përgjithshme të së drejtës procedurale civile, afati ankimor prej 5 ditësh në këtë rast, është një afat prekluziv dhe fillon të ecë nga momenti i marrjes dijeni për refuzimin e kërkesës së bërë për marrjen e të dhënave apo dokumenteve të ndryshme. Humbja e këtij afatit pa asnjë shkak ligjor, nuk do të merret parasysh nga ana e gjykatës dhe do të konsiderohet si një kërkesë e bërë jashtë afatit. Në këtë aspekt duhet të kemi parasysh disa probleme që ka nxjerrë zbatimi praktik i nenit 6 të ligjit në fjalë. Konkretisht përmbajtja e kësaj dispozite lë pa sqaruar disa momente që po i rendisim më poshtë:

- a) Cili është afati brenda të cilit, institucioni shtetëror duhet të përgjigjet për kërkesën e bërë nga ana avokatit.
- b) Cili është riti i gjykimit që duhet të bëjë gjykata kur vihet në lëvizje mbi bazën e një kërkesë të tillë.

Në lidhje me çështjen e parë jemi të mendimit se avokati duhet të këtë

parasysh disa parime të së Drejtës Administrative dhe që janë fiksuar në Kodin e Procedurës Administrative. Kështu, në rast se pas depozitimit të kërkesës së bërë nga ana e avokatit, në bazë të nenit 6 të ligjit nr. 9109, datë 17. 07. 2003 “Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), në organin përkatës të administratës publike, qendrore ose vendore, dhe nga ana e kësaj të fundit nuk kthehet një përgjigje brenda një afati 1 mujor nga dita e depozitimit të saj, kjo nënkupton se organi administrativ nuk e ka shqyrtuar kërkesën në afatin e përcaktuar në ligj. Në këto kushte, bazuar në nenin 6/2 të ligjit të posaçëm, brenda afatit 5 ditor,⁵ avokati i drejtohet me kërkesë gjykatës kompetente. Që kërkesa e tij të merret në konsideratë, ajo duhet të përmbushë disa kritere formale, si dhe të justifikojë faktin që vetë kërkuesi ka një interes të ligjshëm e që lidhet drejtpërdrejtë me çështjen ose personin që përfaqësohet apo mbrohet prej tij. Kështu, kërkesa duhet të përmbajë:

- a) emrin e kërkuesit (të dhënat e sakta të tij) si edhe emrin e avokatit që e përfaqëson atë;
- b) prokurën në rastin kur klienti i tij është person fizik dhe autorizimin në rast se është person juridik;
- c) objektin e kërkesës dhe bazën ligjore të saj;
- d) argumentet mbi kërkesën dhe arsyen pse i drejtohesh organit të administratës publike.

Duke e analizuar si përmbajtjen e kërkesës, ashtu edhe anën formale të paraqitjes së saj, duhet të kemi parasysh që në çdo rast kërkesës duhet t’i jetë bashkangjitur Prokura (e posaçme apo e përgjithshme sipas rastit) ose autorizimi në emër të personit juridik. Në përmbajtjen e këtyre akteve, duhet të jetë përcaktuar qartë tagri që i jepet avokatit për të ndjekur çështjen konkrete si dhe e drejta e tij për t’iu drejtuar organit administrativ me qëllim marrjen e të dhënave apo dokumenteve të ndryshëm, në funksion të zgjidhjes së çështjes që ai përfaqëson.

Në objektin e kërkesës duhet të jetë e përcaktuar qartë se çfarë kërkohet p.sh. një shpjegim për një situatë të caktuar; një e dhënë konkrete e cila sipas rastit, mund të jetë e një karakteri të përgjithshëm apo të posaçëm; një dokument konkret, duke specifikuar qartë formën dhe përmbajtjen e tij, etj. Është e rëndësishme të kihet parasysh se realizimi i gjithë këtyre kërkimeve, duhet patjetër të ketë

⁵ Kërkesa e bërë nga avokati në kuadrin e nenit 6 të ligjit, nuk duhet të dalë jashtë parimeve të procedimit por edhe të ankimit ndaj një akti administrativ sanksionuar në K. Pr. Administrative. Duke e konsideruar përgjigjen negative apo pozitive, apo refuzimin për t’u mos përgjigjur të organit administrativ, kërkesës së bërë nga avokati, për marrjen e provës apo për të dhënave që kanë lidhje me çështjen që ai ndjek, si një veprimtari administrative dhe aktin që organi do të nxjerrë si një akt i organit administrativ që krijon pasoja juridike në rastin individual, mendojmë se ankimi duhet bërë mbi bazën e parimeve të ankimit administrativ të parashikuar në K. Pr. Administrative, neni 141.

lidhje me çështjen konkrete ose personin që përfaqësohet ose mbrohet prej avokatit. Nuk është rasti që të zgjatemi për bazën ligjore, pasi ajo është e qartë dhe gjithmonë e bazuar në nenin 6 të ligjit nr. 9109, datë 17. 07. 2003 i ndryshuar “Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë”.

Një element i rëndësishëm i kërkesës është edhe pjesa e arsytimit të saj, në të cilën duhet të dalin në dukje sa më qartë si shkaku i bërjes së saj, ashtu edhe argumentet ligjore e ato faktike ku ajo mbështetet. Duhet të jetë gjithashtu pjesë e arsytimit të kërkesës edhe argumentimi logjik e juridik i lidhjes midis interesit të ligjshëm që ka personi që e ka bërë kërkesën me atë të çështjes konkrete që ai ka për të zgjidhur.

1.1.3. E drejta për t’u mbrojtur me avokat si një e drejtë kushtetuese dhe ligjore

“E drejta e mbrojtjes” është një çështje e cila trajtohet sot në shumë disiplina të së drejtës, si në atë të së drejtës publike, ashtu edhe në atë private. Kushtetuta jonë sanksionon disa parime themelore për të drejtën e mbrojtjes, mbi bazën e të cilave janë orientuar ligjet materiale dhe ato procedurale, të cilat rregullojnë veprimtarinë e avokatit në raport me institucionet shtetërore apo me entet private. Kështu, sipas nenit 28 të Kushtetutës, personi të cilit i hiqet liria, ka të drejtën e komunikimit menjëherë me një avokat. Kjo garanci bën pjesë në kategorinë e të drejtave dhe lirive vetjake kushtetuese, e si e tillë është një garanci themelore për individin. Në rast se kjo garanci kushtetuese nuk do të shfrytëzohej me dinjitet profesional dhe përgjegjshmëri qytetare nga ana e avokatit ajo nuk do të kishte ndikimin e duhur si në planin personal, ndaj individit të cilit i është hequr liria, ashtu edhe më gjerë, në atë shoqëror.

Neni 42 i Kushtetutës garanton mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave si kushtetuese ashtu edhe ligjore të individit, gjatë shqyrtimit dhe gjykimit të tyre nga një gjykatë e paanshme dhe e pavarur, brenda kufijve të një afati të arsyeshëm. Natyrisht që pa një mbrojtje profesionale të këtyre të drejtave nga avokatë profesionistë, garanci të tilla kushtetuese do të ishin të dobëta, ndoshta edhe në rrezik. Në praktike, nuk janë të pakta rastet ku si pasojë e një mbrojtjeje jo profesionale e jo cilësore, proceset civile por edhe ato penale, kanë përfunduar përpara Gjykatës Kushtetuese dhe janë konsideruar jo në standardet e kërkuara nga kushtetuta dhe konventa.

E drejta për t’u mbrojtur me avokat përveçse është një e drejtë kushtetuese, është edhe një e drejtë ligjore dhe trajtohet dhe garantohet në mënyrë të hollësishme në ligjet procedurale penale dhe ato civile.

Gjatë procesit penal avokati ka një rol shumë të rëndësishëm, pasi i jep klientit të vet këshilla ligjore dhe i garanton një mbrojtje profesionale që konsiston në respektimin e të drejtave të tij, të cilat lindin për shkak të kufizimit të lirive si pasojë e ngritjes së një akuze penale. Ndërsa në procesin civil, palët mund të mbrohen edhe vetë, përveç rasteve kur përfaqësimi është i detyrueshëm⁶. Pra në dallim nga procesi penal, ku mbrojtja bëhet më e domosdoshme për të garantuar një proces të rregullt ligjor, në procesin civil, palët janë të lira që të ndërtojnë mbrojtjen e interesave të tyre vetë ose nëpërmjet përfaqësimit me avokat.

Ashtu si në ligjet procedurale edhe në ligjet materiale, duke filluar nga Kodi Civil apo Kodi Penal apo ligje të tjera që dispijlojnë fusha të ndryshme të së drejtës, e drejta e mbrojtjes konceptohet si pjesë e rëndësishme e zbatimit të tyre në mënyrë sa më efikase. Një mbrojtje cilësore do t'i jepte mundësi gjyqtarit si në fushën penale ashtu edhe në atë civile të jepte një vendim të drejtë dhe të paanshëm, përkundrazi një mbrojtje jo cilësore mund të ndikonte në mënyrë negative në dhënien e drejtësisë.

Ligji për profesionin e avokatit në RSH, përcakton një sërë të drejtash që ka avokati gjatë ushtrimit të profesionit në interes të personit të asistuar ose mbrojtur prej tij. Në këtë kuadër avokati ka të drejtë që gjatë procesit penal të takojë pa kufizim kohor dhe në çdo gjendje të kufizimit të lirisë personale personin e mbrojtur prej tij. Nga ana tjetër organet kompetente, kanë të drejtë që të mbikëqyrin takimin e avokatit me klientin e tij, por me kusht që të mos dëgjojnë bashkëbisedimin midis tyre. Gjatë procesit penal e drejta e mbrojtjes merr një përparësi të veçantë, pasi kemi të bëjmë me kufizimin e lirive personale të individit ose me dhënien e një vendimi penal ndaj tij. Ndaj, është shumë i rëndësishëm ushtrimi sa më me efikasitet dhe me një nivel të lartë profesional i kësaj të drejtë, përndryshe do të cenohet vetë procesi. Ushtrimi i së drejtës së mbrojtjes me një profesionalizëm të lartë vlen edhe për procesin civil dhe jo vetëm për atë penal, pasi edhe këtu të drejta të individit siç është e drejta e pronës, do të cenoheshin rëndë në rast se mbrojtja nuk do të ishte në drejtimin dhe nivelin e duhur.

1.1.4. E drejta e mbrojtjes në procesin civil

Procesi civil nuk nënkupton thjesht faktin e paraqitjes së një kërkesë padie me qëllim vënien në lëvizje të gjykatës, por mbi të gjitha ai ka në themel të tij cilësinë e argumenteve që parashtrihen në të dhe mbrojtjen profesionale përballë gjykatës.

⁶ Gjatë gjyqimit në Gjykatën e Lartë, përfaqësimi me avokat është i detyrueshëm dhe kjo del nga përmbajtja e nenit 483/2 sipas së cilës "pas relatimit kryetarit fton avokatët e palëve të paraqesin mbrojtjen e tyre". Përmbajtja e dispozitës nuk lë hapësirë tjetër që mbrojtja mund të bëhet vetë, pra pa avokat.

Natyrisht që mbrojtja në procesin civil ka karakteristika të ndryshme nga ajo e procesit penal, pasi në këtë të fundit mbrojtja konsiderohet e detyrueshme, ndërsa në procesin civil, palët mund të mbrohen edhe vetë, përveç rasteve kur përfaqësimi është i detyrueshëm. Në procesin civil nuk flitet si në procesin penal, për “mbrojtës” dhe me këtë të nënkuptohet vetëm avokati i pajisur me licencë nga Dhoma e Avokatisë, por flitet për “përfaqësues të palës” apo për “palë të asistuar prej përfaqësuesit të vetë”, ku kjo e fundit jo detyrimisht mund të jetë “avokat”. Megjithatë mund të themi se praktika gjithnjë edhe më shumë, përfaqësuesin e palës në procesin civil, po e identifikon me termin “mbrojtës”.

Kur ligji procedural flet për mbrojtjen e interesave të palëve, i vë ato përballë dy alternativa; përfaqësim personal e i drejtpërdrejtë në gjyq si dhe përfaqësim nëpërmjet avokatit ose personave të tjerë që nuk janë avokatë por të cilët ligji i lejon kur përmbushen kriteret e caktuara. Përfaqësimi në gjyq i një pale, dallohet në përfaqësim vullnetar dhe në përfaqësim të detyrueshëm. Kjo e fundit del nga përmbajtja e nenit 22 të K.Pr.C. sipas të cilit, palët mund të mbrohen vetë ose kur ato e shikojnë të arsyeshme, me përfaqësues. Në rrethana kur ligji kërkon përfaqësimin e detyrueshëm, ai duhet të ndodhë, pasi në të kundërt cenohet një normë detyruese e procesit civil e për pasojë ky i fundit do të konsiderohet i parregullt dhe objekt kundërshtimi në shkallët e larta të gjykimit, deri në Gjykatën Kushtetuese⁷.

Ashtu siç nënvizuam edhe më sipër, përfaqësimi nga pikëpamja doktrinale ndahet në përfaqësim vullnetar dhe në përfaqësim ligjor ose të detyrueshëm.

a) *Përfaqësimi vullnetar ose me prokurë*, ndodh atëherë kur palët shprehin vullnetin e tyre para Noterit dhe emërojnë si përfaqësues të tyre një avokat, bashkëshortin, të paralindurit ose të paslindurit, vëllezërit ose motrat. Përfaqësues me prokurë mund të jenë edhe juristët apo punonjësit e institucioneve shtetërore apo të personave juridikë, të autorizuar prej titullarëve të tyre. Përfaqësues me prokurë mund të jenë edhe persona të tjerë që nuk hyjnë në kategorinë e mësipërme, por që me ligj u njihet kjo e drejtë.⁸

Ligji procedural ka parashikuar edhe një sërë rregullash që ndalojnë

⁷Neni 22 i K.Pr. Civile, parashikon se: “palët mund të mbrohen vetë, përveç rasteve kur përfaqësimi është i detyrueshëm”. Detyrueshmëria e zbatimit të përfaqësimit të detyrueshëm në kushtet e përcaktuara nga ligji pas sjell edhe ankesa të individëve për shkelje të të drejtave të tyre kushtetuese dhe ligjore për një proces të rregullt ligjor, në kuadër të nenit 131/f të kushtetutës.

⁸Rregulli i mësipërm është përcaktuar nga përmbajtja e nenit 96/d. Në fakt ky është një rregull që të referon në ligje të tjera apo përgjithësisht në rregullime normative që kanë fuqinë e ligjit. Kështu p.sh. administratori i një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe një shoqërie anonime, janë përfaqësues të shoqërive të tyre në marrëdhënie me të tretët përfshi këtu edhe gjykatat, dhe ky përcaktim rrjedh nga fryma detyruese e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

përfaqësimin e disa kategorive të veçanta subjektsh. Kështu ndalohet që të jenë përfaqësues personat që nuk kanë mbushur moshën 18 vjeç, personat te cilëve u është hequr zotësia për të vepruar apo avokatët të cilët, me vendim të formës së prerë të Komisionit të Disiplinës të DHKA-së, u është pezulluar e drejta e ushtrimit të profesionit.

Paraqitja në gjykatë e përfaqësuesit të palës në çdo rast kërkon pasjen e aktit që e legjitimon atë si të tillë, d.m.th. prokurën, ose aktin që në bazë të ligjit i jepet titullarit një e drejtë e tillë siç është për shembull rasti i administratorit të një shoqërie tregtare.⁹ Si rregull i përgjithshëm prokura për përfaqësim përpara gjykatës bëhet me akt noterial, ndërsa në rastet të caktuara ligji mund të lejojë që prokura mund të bëhet me shkresë të thjeshtë. Raste të tilla mund të jenë ato kur vërtetimi i saj kërkohej të bëhet nga ana e institucionit ku i përfaqësuari, për shkak të veprimtarisë së tij, krijon si lidhjen e domosdoshme me këtë institucion, ashtu edhe pasojën që duhet të sjellë veprimi i kryer prej tij.

Përfaqësimi vullnetar i avokatëve në gjykatë mund të mos ketë nevojë për një akt përfaqësimi, siç është prokura noteriale apo autorizimi i lëshuar nga personi juridik, por mund të bëhet edhe me gojë para gjykatës. Në këtë rast, veprimi i përfaqësimit dhe përmbajtja e tij, duhet të fiksohen në procesverbalin e seancës gjyqësore apo në atë të veprimeve paraprake të kryera nga ana e gjyqtarit në seancë përgatitore. Këtu duhet pasur kujdes që tagrat e përfaqësimit duhen përcaktuar sipas vullnetit të të përfaqësuarit, më qëllim që përfaqësimi të jetë i vlefshëm dhe të mos sjellë pasoja për cenimin e procesit nga një gjykatë më e lartë. Për sa shprehëm më sipër për përfaqësimin vullnetar ose me prokurë në procesin civil, është detyrë e avokatit që të marrë të gjitha masat që tagrat e përfaqësimit të tij në gjykim, jo vetëm të jenë në përputhje me vullnetin e shprehur nga klienti i tij sipas marrëveshjes që ata kanë rënë dakord, por të jenë në përputhje edhe me të gjitha parimet e gjykimit për një proces civil të rregullt. Avokati si përfaqësues i palës në procesin gjyqësor dhe në bazë të tagrave të shprehura në aktin e përfaqësimit, ka të gjitha të drejtat që i takojnë vetë palës, përfshi edhe disponimin e së drejtës, në rast se kjo është shprehur në mënyrë të posaçme dhe të qartë në aktin e përfaqësimit.

⁹Neni 72 i Kodit Civil përcakton formën se si duhet të bëhet përfaqësimi me prokurë apo me shkresë. Përballë gjykatës apo institucioneve të tjera shtetërore, përfaqësimi me prokurë duhet të bëhet gjithmonë me akt noterial, ndërsa kur palë në gjyq është personi juridik, përfaqësimi nga avokati mund të bëhet edhe me autorizim të nënshkruar nga titullari i personit juridik, përveç rasteve kur ligji kërkon që veprimi juridik të bëhet me akt noterial. P.sh. në rastin e shitjes së pasurisë së paluajtshme, veprimi juridik i shitjes, duhet të bëhet me akt noterial përndryshe është i pavlefshëm. Po kështu edhe akti përfaqësimit që kërkohet për të lidhur këtë kontratë, duhet të jetë ma akt noterial. Të gjitha këto kërkesa të ligjit avokatët duhet t'i mbajnë parasysh detyrimisht gjatë punës së tyre.

b) *Përfaqësimi ligjor ose i detyrueshëm.* Ky lloj përfaqësimi buron në mënyre të shprehur nga vetë përmbajtja e normave juridike, të cilat u japin mundësinë disa subjekteve të caktuara që të përfaqësohen në qarkullimin juridik civil, por edhe para gjykatës, në mënyrë të detyrueshme nga persona të përcaktuar me ligj. Në procesin civil është detyrë e gjykatës që të kujdeset për plotësimin e kërkesave të ligjit që vijnë nga një përfaqësim i tillë, por edhe avokati ka detyrimin e tij që të verifikojë ose të kërkojë përmbushjen e një detyrimi të tillë ligjor. Përpara se çështja të përgatitet për gjyq, avokati në këshillat paraprake që i jep klientit të tij, duhet të bëjë kujdes që kërkesat që vijnë nga përfaqësimi i detyrueshëm të jenë përmbushur sipas kriterëve të ligjit. Kështu, në një gjykim civil personat që nuk kanë zotësi për të vepruar, jo vetëm që nuk mund të përfaqësohen vetë në gjykim, por edhe nga ana e një avokati apo një personi tjetër, për shkak se për këtë kategori personash duhet të plotësohen fillimisht kriteret e përfaqësimit të detyrueshëm që rregullohen nga dispozitat e Kodit Civil. Të miturit që nuk kanë mbushur moshën 14 vjeç janë të detyruar që në veprimet juridike që ata mund të kryejnë, përveç atyre që u përshtaten moshës së tyre, duhet të jenë të përfaqësuar nga përfaqësuesi i tyre ligjor, që është prindi ose kujdestari në rast se është vendosur një i tillë. Kjo ka vlerë edhe kur ata mund të jenë palë në gjyq si paditës apo të paditur dhe kërkojnë që të përfaqësohen me avokat. Në këtë rast përfaqësimi tyre jo vetëm që është i detyrueshëm nga përfaqësuesi ligjor, por edhe mbrojtja me avokat duhet të realizohet duke respektuar së pari, rregullat mbi përfaqësimin e detyrueshëm dhe pastaj ato mbi përfaqësimin vullnetar.¹⁰

Gjatë procesit civil mbrojtja me avokat e palëve në proces, mund të kalojë në disa faza dhe në disa mënyra. Përgjithësisht praktika tregon se në çështje të rëndësishme palët i drejtohen një avokati për këshillë dhe më tej për t'u përfaqësuar e mbrojtur prej tij përballë institucioneve shtetërore apo gjykatës. Mënyra se si avokati e administron këtë proces është shumë e rëndësishme dhe duhet kuptuar drejt. Kjo pasi në këtë proces pleksen, jo vetëm çështje të karakterit administrativ e që kanë të bëjnë me respektimin e rregullave të vendosura nga ligji "Për profesionin e avokatit" apo rregullave të vendosura në Kodin e Etikës së avokatit, por mbi të gjitha ky proces ka si parësore norma të ligjit procedural dhe materiale që ndikojnë drejtpërdrejt në interesin e klientit dhe në cilësinë e mbrojtjes.

¹⁰ Kodi Civil (nenet 6-10), parashikon rregulla të qarta që duhen respektuar në përfaqësimin e detyrueshëm, dhe kjo lidhet me konceptin e zotësisë për të vepruar. Kështu personat me zotësi të kufizuara për të vepruar apo zotësi juridike, apo personat që për shkak të kufizimit të zotësisë juridike apo heqjes së saj me vendim gjyqësor të formës së prerë, duhet të përfaqësohen në qarkullimin juridik nga përfaqësuesit ligjor të tyre që janë prindërit apo kujdestari.

Faza e parë që avokati duhet t'i kushtojë rëndësi, është ajo e krijimit dhe administrimit të raporteve me klientin nga pikëpamja administrative, përpara se ai të vendosë së bashku me klientin për fatin e rastit të këtij të fundit. Kjo fazë konsiston kryesisht në çështje p.sh. si e kupton avokati problemin juridik që ka klienti i tij; si i jep ai përgjigje për problemin që ka klienti dhe si vendos në lidhje me pagesën që klienti duhet t'i bëjë atij për çështjen konkrete. Do të ishte më e drejtë në funksion të krijimit të raporteve sa më korrekte me klientin, që avokati pasi të vendosë se e merr përsipër apo jo një çështje, të fiksojë këto marrëdhënie në një akt juridik, që në gjuhën e përditshme njihet si kontratë për shërbime juridike apo kontratë porosie e rregulluar nga neni 913 e vijues i Kodit Civil. Pas kësaj faze vjen ajo që quhet puna profesionale e avokatit, e cila fillon që nga studimi më i thellë i rastit, mbledhja e provave, përgatitja e opinionit për klientin apo padisë në rastin kur është vendosur së bashku me klientin që çështja duhet zgjidhur në gjykatë. Në të gjitha këto marrëdhënie paraprake administrative apo profesionale midis avokatit dhe klientit, duhen mbajtur parasysht rregullat etike dhe sociale të cilat duhet të vënë në balancë jo vetëm parime të rëndësishme juridike të procesit civil, por edhe parime që lidhen me rolin e profesionit të avokatit në shoqëri.

1.2. Kushtet për t'u bërë avokat në Republikën e Shqipërisë

1.2.1. Kushtet ligjore për ushtrimin e profesionit të avokatit

Profesioni i avokatit mbetet një nga risitë e zhvillimeve demokratike pas viteve '90, pasi solli jo vetëm mbrojtjen më mirë të interesave juridike të shtetasve shqiptarë, por njëkohësisht rriti shkallën e profesionalizmit për kryerjen e veprimeve juridike materiale dhe procedurale.

E drejta e anëtarësisë në Dhomën Kombëtare të Avokatisë i takon çdo avokati. Legjislacioni shqiptar¹¹ parashikon edhe kushtet ligjore për ushtrimin e avokatisë. Sipas ligjit, profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë mund ta ushtrojë çdo shtetas shqiptar që plotëson kushtet e mëposhtme:

- të këtë kryer arsimin e lartë juridik brenda vendit ose jashtë vendit, por të njësuar me të nga Ministria e Arsimit;
- të jetë regjistruar në një dhomë avokatie dhe në Ministrinë e Drejtësisë si asistent pranë një avokati;
- të ketë përfunduar periudhën njëvjeçare të stazhit dhe të këtë marrë mendimin pozitiv të avokatit;

¹¹ Për hollësi, shihni nenin 25 të ligjit nr. 9190, datë 17.07.2003 "Për avokatinë në Republikën e Shqipërisë".

- të ketë marrë më shumë se 50 për qind të pikëve në provimin e kualifikimit për ushtrimin e profesionit të avokatisë;
- të gëzojë integritet moral dhe qytetar, për të mbrojtur të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, si dhe të plotësojë kërkesat e etikës për ushtrimin e profesionit të avokatit;
- të mos jetë dënuar për vepra penale të kryera me dashje, sipas parashikimeve të “Kodit të etikës së avokatit”;
- të mos jetë pjesëmarrës në marrëdhënie apo veprimtari publike ose private, të cilat, sipas ligjit, Statutit të Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe “Kodit të etikës së avokatit”, janë të papajtueshme ose të papërshtatshme me figurën dhe ushtrimin e profesionit të avokatit;
- të jetë anëtar i Dhomës së Avokatisë në juridiksionin e së cilës ndodhet zyra e tij e punës.

Mbështetur në kriteret e mësipërme ligjore Dhoma Kombëtare e Avokatisë në statutin e saj ka bërë specifikimet e nevojshme lidhur përcaktimet dhe kufijtë e interpretimit për secilin nga kushtet e sipërpërmendura.

1.2.2. Hapat konkretë që duhen ndjekur për të ushtruar avokatinë

Realizimi praktik i të drejtës së mbrojtjes, në procesin gjyqësor apo në veprimtaritë e ndryshme me natyrë juridike me anë të avokatit, bëhet në përputhje me zbatimin e K.Pr.P., K.Pr.C. dhe ligjit nr.9109, datë 17.7.2003 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”¹², të ndryshuar.

Përgatitja e avokatëve të diplomuar e të shkolluar me qëllim ofrimin e shërbimit klientëve të interesuar, është detyrë e edukimit ligjor e profesional të realizuar në Fakultetet e Drejtësisë, publike e private, brenda e jashtë shtetit, si dhe detyrë e Dhomës Kombëtare të Avokatisë, e cila kujdeset si për trajnimin e mëtejshëm të asistentëve në Shkollën Kombëtare të Avokatisë, ashtu edhe për dhënien e lejes për ushtrimin e profesionit të avokatit. Praktikisht që të bëhesh avokat duhet të ndiqen hapat e mëposhtëm:

Hapi i parë është diplomimi si “Jurist” në sistemin 3+2, Bachelor + Master Shkencor ose 3+1 Bachelor + Master Profesional në fakultetet e drejtësisë,

¹² Në procesin e konsolidimit të të drejtës së mbrojtjes me avokat një sërë ndryshimesh e përmirësimesh ka pësuar ajo pjesë e legjislacionit që ka pasqyruar më nga afër profesionin e avokatisë në R.Sh. Kështu, si të tilla përmendim: ligjin nr.7541, datë 18.12.1991 “Për avokatinë në R.Sh” të shfuqizuar me ligjin nr.7827, datë 31.5.1994 me të njëjtin emër “Për avokatinë në R.Sh”, Ligjin nr.8428, datë 4.12.1998 “Për një shtese në ligjin nr.7827, date 31.5.1994 “Për avokatinë në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 9109, datë 17.7.2003 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë” i cili është amenduar me ligjin Nr.10 047/2008, me ligjin 9795/2007 dhe me ligjin 91/2012.

publikë ose privatë, në Shqipëri ose jashtë saj. Për studentët e diplomuar jashtë shtetit, duhet të bëhet njohja e e diplomës, mbështetur në ligjin për arsimin e lartë dhe në procedurat e përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës.

Hapi i dytë është regjistrimi si asistent avokat pranë Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe Dhomave Lokale/Vendore të Avokatisë, me qëllim fillimin e periudhës së stazhit një vjeçar profesional pranë një avokati në karrierë (mbikëqyrës), apo pranë një studioje avokatore¹³. Avokati mbikëqyrës ka të drejtë të ketë një ose më shumë asistentë. Asistentët zgjidhen nga vetë avokati ndërmjet personave të diplomuar si juristë, të cilët nuk kanë marrë ende lejen për ushtrimin e profesionit të avokatit.

Avokati ka për detyrë që, brenda 15 ditëve nga ajo e lidhjes së marrëdhënies të punës me asistentin, të depozitojë dokumentacionin e tij për regjistrim në dhomën e avokatisë ku është anëtar, në Dhomën Kombëtare të Avokatisë, si dhe në Ministrinë e Drejtësisë. Me autorizimin me shkrim të avokatit dhe kurdoherë me pëlqimin me shkrim të klientit, asistenti përfaqëson ose mbron të interesuarit në fazën hetimore, në gjykimin e kundërvajtjeve penale si dhe në seancat përgatitore të çështjeve civile.

Hapi i tretë është konkurrimi për të ndjekur studimet në Shkollën Kombëtare të Avokatisë dhe regjistrimi pranë saj. Ndjekja e studimeve pranë shkollës së avokatisë është bërë një kusht i detyrueshëm për ushtrimin e profesionit të avokatit, me ndryshimet e ligjit për avokatinë në vitin 2012.¹⁴

Hapi i katërt është pajisja me vërtetimin përkatës që provon mbarimin e studimeve në Shkollën Kombëtare të Avokatisë. Asistenti i cili ka përfunduar studimet pranë Shkollës Kombëtare të Avokatisë dhe ka kryer stazhin pranë avokatit, ka të drejtë të hyjë në provimin final për marrjen e lejes së ushtrimit të profesionit. Nëse del fitues, ai ka të drejtë të marrë lejen e ushtrimit të profesionit.

Hapi i pestë është regjistrimi pranë QKR-së si person fizik me cilësinë e tregtarit që ushtron veprimtari me natyrë financiare e fitimprurëse dhe marrja e NIPT-it me qëllim shlyerjen e detyrimeve fiskale pranë zyrës së Tatim-Taksave. Me ndryshimet ligjore të bëra në vitin 2007,¹⁵ veprimet që duhet të kryejë avokati lidhen edhe me identitetin e tij financiar dhe fillojnë me detyrimin për t'u pajisur

¹³ Më 27.09.2006, Dhoma Kombëtare e Avokatisë ka aprovuar Rregulloren mbi Procedurat e organizimit të Provimit të Avokatisë, mbështetur në të cilën që të kesh mundësi të regjistrohesh si pjesëmarrës në këtë provim duhet të kesh punuar paraprakisht si asistent avokat. Në provimin e avokatisë do të marrin pjesë kandidatët e regjistruar, të pajisur me pasaportë ose me kartonin e identitetit të asistentit.

¹⁴ Për hollësi, shihni nenin 7-13 të ligjit 91/2012.

¹⁵ Shih nenet 1-4 të Ligjit nr. 9795, datë 23.7.2007, për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9109, datë 17.7.2003 "Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë".

paraprakisht me lejen e ushtrimit të profesionit dhe për t'u regjistruar në organet tatimore. Këtu përfshihen edhe avokatët që mund të organizohen në zyra avokatie, të cilat po ashtu, regjistrohen në organet tatimore.

Në çdo rast, avokati, në ushtrimin e profesionit, identifikohet me numrin e lejes së ushtrimit të profesionit (numri i licencës), si dhe kodin fiskal (numri i NIPT-it) të tij apo të zyrës së avokatisë ku bën pjesë.

Hapi i gjashtë mund të jetë grupimi i avokatëve në zyra ose studio avokatore dhe regjistrimi si të tilla pranë DHKA-së dhe QKR-së në formën e shoqërive tregtare me përgjegjësi të kufizuar apo të shoqërive të thjeshta. Ligji për avokatinë dhe Statuti i DHKA-së¹⁶ parashikon se avokatët mund të ushtrojnë veprimtarinë e tyre jo vetëm si persona fizikë, por mund të grupohen edhe si zyra apo studio avokatore. Këshilli Drejtues i Dhomës Kombëtare të Avokatisë miraton hapjen e zyrës së avokatisë, pas regjistrimit të saj në organet e regjistrimit të biznesit, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

1.2.3. Ndjekja e studimeve në Shkollën Kombëtare të Avokatisë

Në ndryshimet e fundit të ligjit për profesionin e avokatit të bëra në vitin 2012¹⁷, është parashikuar edhe ngritja e mëtejshme e edukimit profesional të kandidatëve për avokatë, në një nivel më të lartë përpara se këta të marrin lejen e ushtrimit të profesionit. Kjo do të kryhet me fitimin e mundësisë për t'u regjistruar në Shkollë përmes konkurrimit dhe ndjekjen e studimit. Ligji parashikon se kandidati për avokat, para se të licencohet si avokat duhet të ketë përfunduar me sukses programin e trajnimit për kandidatët për avokatë, në përputhje me rregullat e përcaktuara në Statutin e Dhomës Kombëtare të Avokatisë si dhe rregulloren përkatëse të trajnimit të cilat miratohen me vendim të Këshillit të Përgjithshëm të Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

Shkolla Kombëtare e Avokatisë është organ i Dhomës Kombëtare të Avokatisë¹⁸, e cila merret me përgatitjen e programeve të trajnimit, organizimin dhe administrimin e trajnimit fillestar të kandidatëve për avokat dhe trajnimin e vazhduar të avokatëve¹⁹. Këshilli i Përgjithshëm i DHKA miraton Statutin e

¹⁶ Për hollësi, shihni nenin 26 të Statutit të DHKA-së.

¹⁷ Shihni nenet 7-13 të ligjit nr. 91/2012 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9109, datë 17.7.2003 "Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

¹⁸ *Koment:* Dhoma Kombëtare e Avokatisë ka bërë ndryshimet në Statutin e saj të miratuara nga Këshilli i Përgjithshëm i DHKA më 2 shkurt 2013, kryesisht në ngritjen dhe organizimin e Shkollës Kombëtare të Avokatisë, (shihni nenin e ri të shtuar në këtë Statut) dhe për të përcjellë edhe ndryshimet e bëra në ligjin për avokatinë në vitin 2012.

¹⁹ Për hollësi, shihni nenin 25/1, pika 4 të ligjit 9109, datë 17. 07. 2003 "Për profesionin e avokatit në RSH", i ndryshuar.

themelimit të Shkollës Kombëtare të Avokatisë dhe rregulloret e trajnimit të propozuara nga Shkolla Kombëtare e Avokatisë.

Shkolla Kombëtare e Avokatisë në përputhje me qëllimet e DHKA, krahas organizimit dhe ndjekjes së trajnimit fillestar për asistent-avokatët, kryen edhe aktivitetet e mëposhtme:

1. promovon studime dhe kërkime në fushën e trajnimit dhe zhvillimit profesional të avokatëve;
2. nxit trajnime për përditësimin e avokatëve dhe specializimin profesional, organizon kurse, master të akredituar edhe nga shteti, nga shtete të tjera të BE-së dhe organizatat ndërkombëtare, duke siguruar trajnimin e trajnuesve dhe lektorëve;
3. përcakton, në bashkëpunim me DHKA, drejtimin e organizimeve, funksionalitetit dhe didaktikën, e kurseve dhe të aktiviteteve të përditësimit profesional;
4. këshillon DHKA-së në fushat e kompetencave të saj;
5. përkujdeset dhe publikon Revistën “Avokatia” organ i DHKA.

Programi i trajnimit synon përgatitjen e kandidatëve për avokat me njohuri specifike profesionale, teorike dhe praktike. Shkolla Kombëtare e Avokatisë është organi i Dhomës Kombëtare të Avokatisë që merret me përgatitjen e programeve të trajnimit, organizimin dhe administrimin e trajnimit fillestar të kandidatëve për avokat dhe trajnimin e vazhduar të avokatëve. Kandidati për avokat ndjek programin e trajnimit, të organizuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe pasi vlerësohet kalues, pajiset prej saj me vërtetimin përkatës për ndjekjen e këtij programi.

1.2.4. Provimi për marrjen e licencës së “Avokatit”

Me mbarimin e studimeve në Shkollën Kombëtare të Avokatisë dhe plotësimin e periudhës së stazhit pranë një avokati, jepet provimi përfundimtar për marrjen e licencës së avokatit, si dokumenti që akordon mundësinë e ushtrimit të profesionit të avokatit. Provimi është hallka kryesore dhe bazë në zinxhirin e procedurave për ushtrimin e profesionit të avokatit. Provimi i avokatisë është një proces të cilit i nënshtrohen pjesa kryesore e juristëve që aplikojnë për avokat²⁰.

²⁰ *Koment:* Them i pjesa kryesore, sepse me ligjin për avokatinë dhe me Statutin e DHKA-së ka edhe raste përjashtimore për përjashtimin nga detyrimi i dhënies së provimit. Jo vetëm ligji i parashikon si raste përjashtimore, por edhe praktikisht rastet e përjashtimit nga provimi me Vendim të Ministrit të Drejtësisë kanë qenë tepër të rralla. Më konkretisht, duke filluar nga data e aprovimit të ligjit për avokatinë më 17.7.2003, është bërë përjashtim nga detyrimi për të dhënë provim vetëm në pesë raste. Nëse do të krahasojmë këtë shifër, me numrin e personave që i janë nënshtuar procedurave të dhënies së provimit, do të konstatojmë se numri i të përjashtuarve nga provimi zë vetëm 0.036 % të numrit të përgjithshëm të juristëve që kanë ndjekur rregullin e përgjithshëm për marrjen e licencës së avokatit.

Provimi i kualifikimit për ushtrimin e profesionit të avokatit zhvillohet përpara një komisioni që përbëhet nga tre anëtarë të caktuar nga Këshilli Drejtues i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, një anëtar i caktuar nga Ministri i Drejtësisë dhe një anëtar i caktuar ndërmjet punonjësve akademikë të Shkollës së Magjistraturës.

Kërkesa për ushtrimin e profesionit të avokatit i drejtohet, si rregull, dhomës së avokatisë ku kërkuesi ka vendbanimin e tij. Dhoma e avokatisë, brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës për ushtrimin e profesionit të avokatit, duhet të marrë në shqyrtim kërkesën dhe, së bashku me mendimin e saj, e përcjell për shqyrtim në Këshillin Drejtues të Dhomës Kombëtare të Avokatisë. Këshilli Drejtues i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës, duhet të njoftojë kërkuesin, nëse ai i plotëson kushtet për të marrë pjesë në provimin e kualifikimit, si dhe për ditën e caktuar për zhvillimin e tij.

Këshilli Drejtues i Dhomës Kombëtare të Avokatisë shpall datat e zhvillimit të provimeve të kualifikimit, për ushtrimin e profesionit të avokatit, për atë vit kalendarik. Këshilli Drejtues i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, brenda muajit janar të çdo viti, miraton edhe përfaqësuesit e tij në komisionin e provimit të kualifikimit për ushtrimin e profesionit të avokatit.

Në bazë të ligjit për avokatinë, provimi jepet dy herë në vit. Teza e provimit ka një kompleksitet në përmbajtjen e saj duke synuar të evidentojë njohuritë e pjesëmarrësve si në nivelin teorik, ashtu edhe në drejtim të shprehive praktike. Më konkretisht, teza e cila vlerësohet me 150 pikë maksimale, përbëhet nga:

- pyetje teorike nga fushat kryesore të së drejtës të tilla si: e drejta kushtetuese, e drejta civile, e drejta e procedurës civile, e drejta penale, e drejta e procedurës penale, e drejta administrative, e drejta tregtare, e drejta familjare dhe njohuritë mbi ligjin “Për avokatinë”, si dhe
- nga pjesa praktike që përbëhet nga dy raste të praktikës gjyqësore: kazusi i të drejtës civile dhe procedurës civile si dhe kazusi i të drejtës penale dhe procedurës penale. Raportet teori-praktikë në pyetjet që kompozojnë tezën janë përafërsisht 2/3 për teorinë dhe 1/3 për praktikën.

Kualifikohen fitues të gjithë asistentët që arrijnë të vlerësohen me të paktën 76 pikë.

Zgjedhja e tezës bëhet me short nga ana e pjesëmarrësve në provim, nga pyetjet e vendosura në zarfet përkatës sipas disiplinave dhe të gjitha fletët e provimit dorëzohen dhe depozitohen në një kuti të mbyllur dhe të vulosur nga komisioni i provimit. Provimi sekretohet në mënyrë që procesi i vlerësimit të jetë sa më objektiv dhe të shmangen ndërhyrjet nga ana e personave të interesuar.

Për këtë arsye, pjesëmarrësve nuk u lejohej të shënojnë emrin apo të vendosin shenja të tjera dalluese në fletët e provimit. Çdo fletë korrigjohet nga anëtarët e Komisionit dhe nënshkruhet nga çdo anëtar. Pasi bëhet rakordimi i emrave me pikët, zbardhet procesverbali përfundimtar i nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Komisionit. Fletët e provimit vendosen në një kuti të vulosur, që mbahet në Zyren e Dhomës Kombëtare të Avokatëve.

Në qoftë se kandidati për avokat nuk arrin të grumbullojë minimumin e pikëve të nevojshme kualifikuese për ushtrimin e profesionit të avokatit, ai mund të marrë pjesë përsëri në provimin kualifikues, me kusht që të kryeje edhe gjashtë muaj të tjerë periudhë stazhi si asistent pranë një avokati.

1.2.5. Përrjashtimi nga provimi

Këshilli Drejtues i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, kryesisht ose mbi kërkesën e personit që kërkon të ushtrojë profesionin e avokatit, ka të drejtë që të përjashtojë kërkuesin nga detyrimi i pjesëmarrjes në provimin e kualifikimit, nëse për këtë vendoset me shumicën e votave të fshehta të të gjithë anëtarëve të saj. Përrjashtimi nga detyrimi i pjesëmarrjes në provimin e kualifikimit për ushtrimin e profesionit të avokatit mbështetet në eksperiencën e tyre në ushtrimin e profesionit të juristit, aftësitë profesionale të treguara dhe edukimin e posaçëm profesional e akademik. Rregulla të hollësishme për kushtet dhe kriteret e përjashtimit nga provimi i kualifikimit caktohen nga Statuti i Dhomës Kombëtare të Avokatisë. Vendimi për përjashtimin nga detyrimi për dhënien e provimit të kualifikimit për ushtrimin e profesionit të avokatit, miratohet nga Ministri i Drejtësisë.

Personat që kanë punuar jo më pak se 2 vjet si gjyqtarë, prokurorë, noterë, si dhe jo më pak se 3 vjet në pozicionin e drejtuesit, këshilltarit apo specialistit të strukturave juridiko-profesionale të Presidencës, Kuvendit, Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë, aparatit të Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Drejtësisë, avokatët e strukturave të Avokaturës së Shtetit, si dhe ata që kanë punuar si punonjës akademik të brendshëm të lëndëve juridike në shkollat e larta, përjashtohen nga përmbushja e detyrimit të parashikuar.

1.3. Organizimi i avokatisë dhe i avokatëve

1.3.1. Statusi i Dhomës Kombëtare të Avokatisë

Dhoma Kombëtare e Avokatisë përfaqëson një person juridik me qendër në Tiranë, i cili është krijuar dhe organizuar si një bashkim i anëtarëve aktivë dhe joaktivë të dhomave të avokatisë. Ajo është një organ që ushtron veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, të pavarur nga shteti²¹. Dhoma Kombëtare e Avokatisë përgjigjet për rregullimin dhe kontrollin e ushtrimit të profesionit të avokatit në Republikën e Shqipërisë dhe është përgjegjëse për themelimin e dhomave të avokatisë. Çdo avokat mund të jetë anëtar vetëm i një dhome avokatie. Çdo dhomë është e përbërë nga avokatë, të cilët janë anëtarë të saj dhe që praktikojnë ose kanë praktikuar për herë të fundit profesionin e avokatit në juridiksionin e saj. Çdo dhomë avokatie ushtron veprimtarinë e saj në mënyrë të pavarur, duke respektuar rregullat e parashikuara në ligj dhe në statut.


Në krye të Dhomës Kombëtare të Avokatisë (DHKA) qëndron organi më i lartë përfaqësues dhe vendimmarrës i DHKA-së, që është Këshilli i Përgjithshëm. Ndërsa organi më i lartë Ekzekutiv i DHKA është Këshilli i saj Drejtues, anëtarët e të cilit zgjidhen nga Këshilli i Përgjithshëm. Organigrama dhe struktura e organeve drejtuese të Dhomës Kombëtare të Avokatisë janë përcaktuar në ligjin Nr. 9109, datë 17.07.2003 “Për shërbimin e avokatisë në Republikën e Shqipërisë”²². Dhoma Kombëtare e Avokatisë ka bërë ndryshimet në Statutin e saj të miratuara nga Këshilli i Përgjithshëm i DHKA më 2 shkurt 2013, sipas të cilave në nenin 38 të Statutit është vendosur se në përbërjen e Këshillit Drejtues së Dhomës Kombëtare të Avokatisë, duhet mbajtur parasysh, përfaqësimi i Dhomave të Avokatisë në këtë organ si dhe funksionimi normal i punës së këtij organi ekzekutiv.

Këshilli Drejtues i Dhomës Kombëtare të Avokatisë duhet të mbledhet jo më pak se një herë në dy muaj dhe përbëhet nga 15 anëtarë. Kryetari i DHKA dhe Kryetari i Dhomës së Tiranës, i cili është njëkohësisht edhe zv/Kryetar i DHKA janë anëtarë *ex officio* të Këshillit Drejtues, për shkak të mënyrës së zgjedhjes së tyre. Jo më pak se tre nga anëtarët e Këshillit Drejtues do të zgjidhen nga radhët e përfaqësuesve të dhomave të avokatisë në rrethe dhe, jo më pak se tre anëtarë të Këshillit Drejtues duhet të jenë femra. Më poshtë është paraqitur kjo strukturë dhe varësitë institucionale të organeve nga njëri-tjetri.

²¹ Për hollësi, shihni nenin 17 të ligjit 9109, datë 17.07.2003, i ndryshuar, “Për avokatinë në Republikën e Shqipërisë”

²² Për hollësi shihni nenet 19, 21, të ligjit dhe nenet 20 deri në nenin 48 të Statutit të DhKA-së.

Organigrama e Dhomës Kombëtare të Avokatisë



Mbështetur në analizat e të dhënave që janë të depozituara pranë Dhomës Kombëtare të Avokatisë, rezulton se në Republikën e Shqipërisë janë licencuar gjithsej si avokatë 6693²³ persona, pjesa kryesore e të cilëve e ushtrojnë aktivitetin në 12 Dhoma Avokatie nëpër rrethet: Tiranë, Durrës, Vlorë, Shkodër, Korçë, Berat, Lushnje, Elbasan, Fier, Lezhë, Gjirokastër dhe Sarandë.

Në Dhomën e Avokatisë së Tiranës janë anëtarësuar më shumë se gjysma e avokatëve që veprojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Krahas Dhomës së Avokatisë së Tiranës, dhomat më të mëdha në rrethe janë: Dhoma e Avokatisë e Durrësit, e Shkodrës, e Vlorës dhe e Fierit. Në skemën e mëposhtme mund të shihni më të detajuara dhomat e avokatisë në rrethe dhe numrin e anëtarëve të secilës prej tyre. Në rrethet e vendit ku nuk ka dhoma mund të vijnë avokatë të

²³ *Shpjegim.* Kjo shifër vjen nga statistikat e Dhomës Kombëtare të Avokatisë të tetorit 2013.

rrethve të tjera, për shkak të numrit të pakët ose të mungesës së avokatëve në to.

Një pjesë e konsiderueshme e avokatëve të licencuar e ushtrojnë në mënyrë aktive aktivitetin e tyre, por krahas tyre ka edhe një kategori të dytë, e cila ndonëse është pajisur me licencë avokatie nuk e ushtron profesionin për shkak të angazhimit në sektorë të tjerë të administratës publike, të biznesit, të politikës, të arsimit juridik e të tjera.

Tirana mbetet qendra e realizimit të shërbimeve më masive të avokatisë, nisur edhe nga numri dërrmues i avokatëve të përqendruar në këtë rreth. Në Tiranë janë të grumbulluar 66 % e avokatëve të të gjithë Republikës së Shqipërisë. Kjo gjë lidhet me disa faktorë, por më të rëndësishmit lidhen me faktin se në Tiranë:

- ushtron aktivitetin Gjykata e Lartë dhe Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë;
- ushtron aktivitetin Gjykata më e madhe e Apelit e Republikës së Shqipërisë;
- Gjykata e Shkallës së Parë ka ekskluzivitetin e shqyrtimit të disa çështjeve, të tilla si ato që lidhen me pronësinë industriale, etj.;
- është përqendruar biznesi dhe subjektet më të rëndësishme tregtare që veprojnë në vendin tonë;
- janë përqendruar organet qendrore të administratës publike;
- veprojnë pjesa më e madhe e organizatave jofitimprurëse;
- jeton gati gjysma e popullsisë të gjithë vendit.

Dhoma Kombëtare e Avokatisë ka luajtur një rol aktiv. Mbështetur edhe në ligjin për avokatinë ajo ka përgatitur një paketë të plotë nënligjore me aktet më të rëndësishme të funksionimit të brendshëm të strukturave të saj, si dhe i ka aprovuar ato sipas rregullave të paracaktuara ligjore. Aktet më të rëndësishme që janë të aprovuara nga DHKA-ja janë:

- (a) Statuti i Dhomës Kombëtare të Avokatisë;
- (b) Kodi i Etikës i Avokatit;
- (c) Rregullorja e provimit të pranimit si avokat.

1.3.2. Statusi i avokatit dhe kategorizimet e tyre

Po t'i referohemi Statutit të DH.K.A-së, dispozitat e tij përcaktojnë disa kategorizime të anëtarët e saj në varësi të kushteve që lidhen me karakteristikat individuale dhe kolektive të çdo avokati konkret. Avokatët në Republikën e Shqipërisë ndahen në disa kategori, si më poshtë:

- **Anëtarë aktivë**, janë avokatët që plotësojnë kushtet e regjistrimit në DHKA, në QKR e që e ushtrojnë profesionin në mënyrë të përditshme, të

vazhdueshme dhe aktive, duke realizuar të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga anëtarësia në DHKA.

- **Anëtarë joaktivë**, janë personat që e kanë fituar titullin ‘Avokat’ sipas kushteve të parashikuara nga ligji, por që nuk e ushtrojnë praktikisht profesionin për shkak të pamjaftueshmërisë me profesionin e avokatit, si dhe për shkak të ushtrimit të një detyre tjetër, si dhe juristët që kanë fituar grada dhe tituj shkencorë dhe që ushtrojnë aktivitetin e tyre në sektorin publik e shtetëror me paga të përhershme.
- **Anëtarët e nderit** do të konsiderohen avokatët e shteteve të huaja, të cilët shpallen si të tillë me Vendim të Këshillit Drejtues të DHKA-së.
- **Asistentë avokatë** janë shtetasit shqiptarë të cilat janë të diplomuar si juristë në sistemin Bachelor + Master Profesional/Shkencor dhe janë regjistruar si të tillë pranë DHKA-së për të kryer një praktikë si asistentë pranë një dhome avokatie.

Sistemi i karrierës së avokatëve njeh vetëm një përshkallëzim të lidhur me përfaqësimin në Gjykatën e Lartë dhe atë Kushtetuese. Me ndryshimet e fundit të bëra në Statutin e DHKA-së²⁴, parashikohet se në kriteret e përfaqësimit të avokatëve në Gjykatën e Lartë dhe Kushtetuese, shtohet kriteri që avokati të ketë ushtruar profesionin e juristit jo më pak se 20 vite. Kjo kategori shënon edhe nivelin më të lartë të karrierës së avokatëve.

Ndarja për efekt karriere është në dy nivele:

- **Avokatë të nivelit të parë**, janë të gjithë ata që mund të përfaqësojnë dhe mbrojnë çështjet në gjykatat e shkallës së parë dhe në gjykatat e apelit dhe faktikisht ushtrojnë profesionin rreth 960 avokatë të tillë;
- **Avokatët e nivelit të dytë**, ku përfshihen të gjithë avokatët që mund të përfaqësojnë dhe mbrojnë çështjet në Gjykatën e Lartë dhe në Gjykatën Kushtetuese. Aktualisht veprojnë 472 avokatë të tillë.

Në Republikën e Shqipërisë aktiviteti i avokatisë realizohet nëpërmjet avokatëve të organizuar në disa mënyra, që përcaktohen në Statutin e Dhomës së Avokatisë:

Një nga mënyrat është me anë të zyrave të avokatisë, të cilat janë krijime të ardhura si rezultat i bashkimit të partnerëve themelues që shprehin vullnetin dhe vendimin e tyre në një akt themelimit, si dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të tyre në statut. Këto dy akte së bashku me një kërkesë, i dërgohen për shqyrtim Këshillit Drejtues së DHKA-së. Në këto dokumente duhet të jepet

²⁴ *Koment:* Dhoma Kombëtare e Avokatisë ka bërë ndryshimet në Statutin e saj të miratuara nga Këshilli i Përgjithshëm i DHKA më 2 shkurt 2013, midis të cilave edhe ky element i shtuar në radhën e kriterëve të përfaqësimit të shkallët e larta të gjyqësorit.

informacion lidhur me disa të dhëna të përcaktuara në nenin 76, të Statutit të Dhomës Kombëtare të Avokatisë:

Emrin e Zyrës Avokatore,
Adresën e selisë së saj,
Kopje të noterizuara të
të titullit të avokatit,
Datën e nënshkrimit.

Gjeneralitetet e avokatëve themelues,
Kohëzgjatja e aktivitetit,
Numrat e licencave
të avokatëve,

Forma e dokumenteve të nevojshëm për regjistrimin e zyrave avokatore do të jetë për analogji ajo e përdorur nga praktika e regjistrimit tregtar. Emri i zyrës ka zakonisht mbiemrin e njërit ose të gjithë avokatëve themelues dhe pas tyre vihet emërtimi “Zyrë Avokatie”²⁵. Në praktikë ndodh që termi “zyrë avokatie” ndeshet edhe në formën e emërtimit “Studio ligjore”, aq sa mund të themi se, termi i dytë ndeshet më shpesh dhe ka zënë vendin e një norme praktike. Gjithsesi, kur flasim për zyra avokatie në kuptimin e statutit të Dhomës Kombëtare të Avokatisë, do të kemi parasysh edhe Studiot Ligjore, sepse këto dy terma në praktikë si rregull, janë përdorur si sinonime të njëri-tjetrit. Themë si rregull, sepse ka raste që në praktikë termi “Zyrë Avokatie” ka edhe një kuptim të dytë, që lidhet me kuptimin e ambientit të punës së avokatit dhe jo me ndonjë formë të veçantë organizimi.

1.3.3. Organizimi i Studiove avokatore

Dhoma Kombëtare e Avokatisë është kujdesur në hartimin e procedurave sa më të thjeshta dhe sa më të shpejta për t’i dhënë një shtysë ngritjes së zyrave, të studiove apo firmave ligjore, sepse këto të fundit, nga njëra anë, rrisin shkallën e specializimit dhe të profilizimit të tyre, por në të njëjtën kohë nga ana tjetër, me anë të përqendrimit të avokatëve në grupe rrisin cilësinë e përfaqësimit ligjor. Në këtë këndvështrim, puna e grupit në raport me atë të një individi, sado të aftë nga pikëpamja profesionale gëzon një prioritet të dukshëm. E ardhmja në avokati u përket pikërisht studiove ligjore.

Mënyra e organizimit të tyre është e ndryshme rast pas rasti. Kështu, disa prej tyre funksionojnë me një strukturë të brendshme të mbështetur mbi parimet dhe rregullat e një ortakërie dhe në raste të tjera, ato janë thjesht bashkime mekanike që minimizojnë dhe ndajnë shpenzimet për mbajtjen dhe funksionimin e zyrës, por secili nga avokatët i shlyen detyrimet individualisht.

²⁵ Neni 78 i Statutit të DHKA-së e ndalon që emri i avokatit ose i personave të tjerë të përdoret si emër i zyrës avokatore.


Kur dy ose më shumë avokatë dëshirojnë të themelojnë një zyrë avokatie, ata, fillimisht, duhet të dërgojnë aktin e themelimit dhe statutin e saj për shqyrtim dhe miratim në Këshillin Drejtues të Dhomës Kombëtare të Avokatisë. Këshilli Drejtues i Dhomës Kombëtare të Avokatisë duhet të miratojë statutin e zyrës së avokatisë brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës. Nëse ai nuk është dakord me statutin e paraqitur, ajo duhet t'ia kthejë të interesuarit modelin e paraqitur, së bashku me kërkesën e saj për ndryshimet që dhoma mendon se i duhen bërë statutit. Aplikanti duhet të kthejë projektin e ndryshuar brenda 15 ditëve.

Zyra e avokatisë, nëse e sheh të arsyeshme dhe brenda interesit të vet, pasi është miratuar si e tillë nga dhoma, mund t'u drejtohet procedurave ligjore pranë QKR-së për t'u njohur si person juridik, sipas ligjit për shoqëritë tregtare.

Zyrat avokatore, që shpesh paraqiten në formën e studiove ligjore, janë të përqendruara vetëm në Tiranë dhe jo në rrethe. Aktualisht janë të regjistruara 27 studio ligjore në QKR²⁶ si subjekte tregtare dhe 45 zyra/studio pranë DHKA-së, krahasuar me 1545 avokatë të regjistruar në QKR si persona fizikë. Funksionimi i zyrave të Avokatisë bëhet mbështetur në disa modele të cilat kanë si kriter dallues llojin e personalitetit juridik që i akordojnë Zyrës.

Siç e shohim, nga skema e mëposhtme, ka zyra që funksionojnë si shoqëri e thjeshtë, pavarësisht nëse akti i themelimit apo kontratat që ato nënshkruajnë e përdorin këtë emërtim apo jo. Statuti i DHKA-së e njeh edhe mundësinë që Zyra Avokatore të organizohet në formën e shoqërisë tregtare, në varësi të fitimeve që realizon dhe në varësi të faktit nëse aktiviteti i saj me karakter ekonomik, përthithet nga përcaktimet e legjislacionit tregtar për veprimtaritë tregtare²⁷.

Personaliteti juridik i Zyrave Avokatore



²⁶ *Sqarim.* Të dhënat janë siguruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, (QKR) në muajin tetor 2013.

²⁷ Për hollësi, shihni nenin 80 të Statutit të DHKA-së.

Referuar skemës së mësipërme, kryesisht avokatët zhvillojnë aktivitetin e tyre individualisht, me anë të përfaqësimit të çështjeve ligjore në mënyrë individuale, duke qenë të regjistruar në DHKA-së, si të tillë. Për këtë arsye, avokatët pas marrjes së provimit dhe licencimit nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, mund të regjistrohen si persona fizikë apo juridikë në QKR, regjistrohen në DHKA-së dhe pas kësaj regjistrohen në zyrat e tatim-taksave si subjekte fiskale që shlyejnë detyrimet ndaj shtetit, mbështetur në të ardhurat e akumuluarra prej tyre si rezultat i përfaqësimeve ligjore që kryejnë dhe i mbrojtjes së klientëve që kanë, si edhe si rezultat i shërbimeve që ata kryejnë në procesin e lidhjes së kontratave e kryerjes së veprimeve të tjera me karakter juridik.

Shpesh avokatët krijojnë zyra që kanë vetëm konceptin mekanik të ambientit të përbashkët dhe jo atë juridik të përkufizuar nga neni 26 i Statutit të DHKA-së. Avokatët në këto zyra ruajnë një pavarësi pasurore dhe një përgjegjësi të pavarur pasurore nga njëri-tjetri dhe forma e organizimit të tyre është në nivele dhe raporte tepër të thjeshtësuara, që i referohen vetëm marrjes përsipër bashkërisht vetëm të shpenzimeve të përditshme me karakter teknik dhe ndajnë shpenzimet për mirëmbajtjen dhe funksionimin e zyrës. Në këto zyra ndodh që avokatët të jenë totalisht të shkëputur në ushtrimin e shërbimit të avokatisë. Vlen të theksohet, se shumica e avokatëve janë me zyra avokatie dhe ushtrojnë shërbim në ambiente të përshtatshme dhe komode. Gjithsesi, mbetet edhe një numër i konsiderueshëm që ushtrojnë profesionin në mënyrë “ambulante” duke i seleksionuar klientët rast pas rasti.

1.4. Kodi i sjelljes së Avokati

1.4.1. Të drejtat dhe detyrat e avokatit sipas kodit të sjelljes

Avokatia dhe profesioni i avokatit janë shtylla të rëndësishme për zhvillimin e sistemit të së drejtës së një vendi dhe padyshim mbështetëse kryesore të dhënies së drejtësisë, si asaj penale ashtu edhe civile. Profesionin e avokatit nuk lidhet vetëm me përgatitjen e tij profesionale në fushat e së drejtës ku ai ushtron profesionin e tij, si penale, civile, tregtare, familjare etj., por mbi të gjitha profesionin e avokatit duhet të udhëhiqet nga disa parime morale dhe etike, të cilat janë të mishëruar në Kodin e Sjelljes së tij.²⁸

²⁸ Kur flasim për Kod Sjelle, kemi parasysh ato rregulla të etikës që avokati duhet të mbajë parasysh dhe duhet të udhëhiqet gjatë profesionit të tij. Këto rregulla janë të vendosura në Kodin Etik të Avokatit, i cili është miratuar me vendimin nr. 31, datë 12. 11. 2005, të Këshillit të Përgjithshëm të Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

Qëllimi i rregullave të vendosura në Kodin Etik të Avokatit, është respektimi dhe zbatimi i tyre në funksion të mbrojtjes së drejtave dhe interesave legjitime të klientit dhe në shërbim të interesave të drejtësisë. Pra, qëllimi që përcaktojnë këto rregulla mund të adresohet në dy drejtime kryesore:

- a) Rregulla profesionale në shërbim të interesave të klientit
- b) Rregulla profesionale në shërbim të interesave të drejtësisë.

Të dyja këto kategori rregullash të vendosura në Kodin Etik të Avokatit, mund të zbatohen dhe të sjellin rezultatin e duhur vetëm në rast se avokati do të udhëhiqej së pari, nga disa parime të rëndësishme sjellje që e shoqërojnë veprimtarinë praktike të tij, të cilat janë:

a) *Pavarësia e avokatit në ushtrimin e profesionit.* Kjo nënkupton që avokat gjatë ushtrimit të profesionit të tij duhet të jetë i lirë nga ç'do ndikim që mund të lindë si nga interesat e tij të ngushta personale, ashtu edhe nga persona të tretë. Gjatë ushtrimit të profesionit të tij, avokati vepron në përputhje me rregullat e vendosura në ligj, në statut dhe në Kodin e Etikës. Ai gjatë ushtrimit të profesionit duhet të udhëhiqet nga mbrojtja e interesit më të lartë të klientit dhe duhet të jetë i pandikuar nga interesa të ngushta, përfshi këtu edhe interesa politike. Ai duhet të jetë i shkapëputur nga këto interesa në mënyrë që klienti të besojë në profesionin e tij dhe njëkohësisht ky i fundit (profesioni) të jetë në shërbim të gjithë komunitetit dhe atë të interesave të dhënies së drejtësisë.

b) *Dinjteti i avokatit gjatë ushtrimit të profesionit.* Kjo nënkupton që, avokati në çdo hap të aktivitetit të tij duhet të sillet me dinjtet jo vetëm profesional, por edhe të kryeje e demonstroje veprime që përputhen me moralin e përgjithshëm dhe me rregullat e vendosura nga Dhoma e Avokatisë për ushtrimin e profesionit të tij. Në këtë kuptim, ai duhet të shfaqë më të mirën e formimit të vetë, jo vetëm gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij dhe në raport me klientin dhe institucionet shtetërore e ato gjyqësore, por njëkohësisht ai duhet të tregojë në çdo hap të jetës së tij, një kulturë të përgjithshme korrekte jo vetëm në kuptimin formal, por edhe në përmbajtje të saj.

Avokati gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij por edhe më gjerë, nuk duhet të bëjë deklarata fyese ose përbuzëse për aktivitetin e tij apo ndaj vendimeve gjyqësore apo autoriteteve të tjera shtetërore. Në funksion të dinjtetit të tij profesional, ai mund të shfaqë mendimin e tij të kundërt me sa është përcaktuar në këto vendime, në çdo kohë, por vetëm duke respektuar rregullat ligjore dhe ato të kulturës së debatit profesional. Mendime të tilla avokati mund t'i shfaqë në revista të ndryshme profesionale, në konferenca apo në auditorët e studentëve ku ai mund të jetë i përfshirë në mësimdhënie, por në asnjë mënyrë nuk duhet të

debatojë më fjalë fyese për to dhe për më tepër, të nxisë klientin në një veprimtari të tillë. Përkundrazi, avokati duhet ta shtyjë klientin që ky të sillet me respekt ndaj gjykatës apo autoriteteve të tjera. Kjo mënyrë sjellje duhet të jetë motivi i punës së tij, pasi vetëm në një mënyrë të tillë ai mund të fitojë respekt personal si një profesionist i zoti dhe me kulturë të gjerë dhe të ndihmojë në jetën sociale të juridiksionit ku ai ushtron profesionin e tij.

c) *Përkushtimi dhe aftësitë e avokatit gjatë ushtrimit të profesionit.* Praktika dhe eksperiencia e profesionit të avokatit ka treguar se avokati duhet të zotërojë dy cilësi, që të jetë në lartësinë e profesionit dhe ti shërbejë interesit më të lartë të klientit dhe të dhënies së drejtësisë. Së pari, njohuritë e tij në fushën e ligjit duhet të jenë shumë të mira dhe së dyti, duhet të zotërojnë aftësi profesionale të mira. Njohuritë që duhet të ketë avokati në fushën e ligjit janë relative. Me zhvillimet që ka marrë “tregu ligjor”, gjithnjë e më shumë po dalin në pah specializime të avokatëve në fusha të ndryshme të së drejtës. Dy shtylla vihen re në këto specializime, avokatët që janë të specializuar dhe ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën penale dhe pjesa e avokatëve të specializuar në fushën civile. Vihen re gjithnjë edhe më shumë tendenca për specializime më të ngushta brenda këtyre fushave, sidomos në fushën e së drejtë tregtare, fiskale, bankare etj. Kjo e fundit është më efektive, sidomos në qytetet e mëdha ku është përqendruar edhe më shumë aktiviteti i biznesit dhe ai bankar.

Avokati, përveçse njohurive shumë të mira në fushën e ligjit që duhet të ketë gjatë ushtrimit të profesionit të tij, duhet të ketë dhe aftësi profesionale që edhe këto të fundit janë relative dhe varen nga thellimi i njohurive në profesionin e avokatit dhe nga dëshira dhe vullneti i gjithsecilit avokat për të ushtruar profesionin në mënyrë sa më cilësore.

Tendenca dhe eksperiencia e kohëve të fundit ka treguar që avokatët që janë të specializuar në fusha të ndryshme të së drejtës janë më efikas dhe me rezultate pozitive. Kjo ka rritur cilësinë e shërbimit dhe ushtrimin e profesionit me një nivel profesional shumë të mirë. E kundërta konstatohet tek avokatët të cilët shërbejnë pothuajse në të gjitha fushat e së drejtës, kanë një rendiment më të ulët në punë dhe një cilësi jo në nivelin e duhur. Gjithsesi të dyja këto konstatime janë relative dhe ngelen në vlerësimin dhe zgjedhjen personale të gjithë secilit, që ndërmer rrugën e ushtrimit të profesionit të nderuar të avokatit, por edhe në vlerësimin e klientit para se të zgjedhë se te kush avokat do të “trokasë”.

Është e rëndësishme të kuptohet që, profesioni i avokatit nuk fillon dhe nuk mbaron me marrjen e lejes së ushtrimit të aktivitetit. Por ai është një profesion që kërkon në vazhdimësi thellimin në njohuritë ligjore dhe ngritje të vazhdueshme

aftësive profesionale. Avokati, duhet të jetë gjithmonë në kërkim jo vetëm të ndryshimeve ligjore dhe atyre të praktikës gjyqësore, por duhet të jetë i lidhur gjithmonë me të rejat në fushën e doktrinës juridike jo vetëm brenda por edhe të asaj jashtë vendit.

Është detyrë e organeve drejtuese të DHKA që në drejtim të rritjes së aftësive profesionale të avokatit dhe të thellimit të dijeve të tij në fushën e së drejtës, të organizohen trajnime vazhduese për avokatët në detyrë dhe ato fillestare për brezin e ri që përgatitet për të ushtruar profesionin e avokatit në praktikë.

Ndryshimet e fundit ligjore që i janë bërë ligjit “Për profesionin e avokatit”, tregojnë sipërmarrjen e madhe të organeve drejtuese të dhomës së avokatisë, për ngritjen e Shkollës Kombëtare të Avokatisë, e cila do të ketë si detyrë parësore formimin praktik të kandidatëve për avokatë (asistentëve) para se ata t’i nënshtrohen provimit të kualifikimit për marrjen e lejes së ushtrimit të profesionit dhe si sfidë të dytë, trajnimin vazhdues të avokatëve në detyrë me njohuri të thelluara në fushat ku ata ushtrajnë profesionin, si dhe pajisjen me njohuri në fusha të reja të së drejtës që zhvillohen si një logjikë e hapjes së Shqipërisë me ekonominë e tregut dhe rrugës së saj për t’u anëtarësuar ne Bashkimin Evropian.

d) *Veprimtaria dhe Punësime të papajtueshme.* Kodi Etikës ndër të tjera përmban edhe rregulla të cilat orientojnë avokatin gjatë ushtrimit të profesionit të tij. Duke pasur si qëllim kryesor atë të ushtrimit të profesionit të avokatit në interes të klientit dhe të dhënies së drejtësisë, avokati duhet të jetë i kujdesshëm që veprimtaritë që ai ushtron gjatë ushtrimit të profesionit dhe jashtë tij duhet të mos jenë së pari të ndalura nga ligji që rregullon profesionin e tij dhe së dyti, të jenë në maksimum në përputhje me ushtrimin e profesionit të avokatit dhe të mos pengojnë ushtrimin e këtij profesioni në interes të klientit.

Kur themi që avokati duhet ta ushtrojë profesionin e tij në përputhje me rregullat e vendosura në ligjin nr. 9109 datë 17. 07. 2003 “Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë”, Statutin e DHKA dhe Kodin Etik, kemi parasysh faktin që veprimet e tij nuk duhet të bien në kundërshtim, me rregullimet urdhëruese apo ato detyruese të këtyre akteve.

Ligji që rregullon profesionin e avokatit e ndalon avokatit që, pasi është pajisur me lejen për ushtrimin e profesionit, të jetë anëtar i më shumë se një zyre avokatie. Kjo do të thotë që avokati mund të ushtrojë profesionin si i vetëm në një zyrë avokatie apo në bashkëpunim me avokat të tjerë, por e ndalon që të jetë njëkohësisht anëtar i një zyre tjetër.

Po kështu rregullat e vendosura në këtë ligj e detyrojnë avokatin që të jetë

i regjistruar në organin tatimor dhe të jetë i pajisur me kodin fiskal përkatës (NIPT) sipas rregullave të vendosura në ligjet përkatëse në fushën e tatimore. Po kështu edhe kur vepron në një zyrë avokacie së bashku me avokat të tjerë ai është i detyruar të regjistrohet si një entitet juridik i vetëm në organin tatimor dhe të pajiset me kodin fiskal përkatës.

Avokati gjatë kohës që ushtron veprimtarinë e tij duhet të ketë të vendosur në një vend të dukshëm jo vetëm lejen e ushtrimit të profesionit të tij por edhe certifikatën tatimore ku është përcaktuar kodi i fiskal personal apo i zyrës ku ai ushtron në ortakëri profesionin e avokatit.

Avokati është i detyruar që gjatë ushtrimit të profesionit të tij të identifikohet me numrin e lejes së ushtrimit të profesionit (në praktikë konsiderohet si numri licencës) të tij dhe me numrin e kodit fiskal të tij apo të zyrës ku ai ushtron këtë veprimtari. Po kështu është i detyruar që gjatë mbrojtjes së klientit të tij në gjykatë, këto dy identifikime duhet t'ia tregojë gjykatës, në momentin që ai legjitimohet si i tillë për llogari të të asistuarit prej tij. Për këtë ai duhet që t'i tregojë gjyqtarit apo trupit gjykues, kartën e identitetit të avokatit ku është fiksuar numri i lejes së ushtrimit të profesionit të tij dhe certifikatën tatimore, ku është fiksuar kodi fiskal i tij apo i zyrës ku ai ushtron aktivitetin vetëm apo në ortakëri.

e) Detyrimi i avokatit për t'u sjellë në interesin më të lartë të klientit. Gjatë aktivitetit të tij si avokat ai duhet të kujdesit që ta ushtrojë profesionin e tij duke u udhëhequr jo vetëm nga interesi më i lartë i klientit të tij duke treguar besnikëri dhe profesionalizëm në mbrojtjen e interesave të tij, por gjithashtu ai duhet të tregojë ndershmëri dhe dinjitet moral dhe profesional. Marrëdhëniet me klientin janë shumë të rëndësishme pasi aty fillon dhe përfundon ushtrimi i profesionit të avokatit. Pa kuptuar qartë dhe saktë këto marrëdhënie, nuk mund të ketë sukses ky profesion dhe kjo jo vetëm në aspektin material, por në atë të suksesit profesional.

Avokati, përveçse duhet të kujdeset për përgatitjen e tij profesionale në çështjen konkrete që ka marrë përsipër, duhet të ketë parasysh që të mos ekzistojë asnjë konflikt interesi ndërmjet tij dhe personit që ai mbron dhe përfaqëson.

Gjatë ushtrimit të profesionit, avokatit i ndalohet që të bëjë kallëzim në organin e ndjekjes penale dhe njëkohësisht të jetë si dëshmitar për personin, të cilit i ka shërbyer dhe për rrethana që ai ka mësuar gjatë ushtrimit të profesionit të avokatit. Ky ndalim ligjor nxit një parim shumë të lartë jo vetëm profesional, por edhe moral. Këto parime jo vetëm udhëhiqen nga fryma e besnikërisë ndaj profesionit dhe interesave të klientit, por nxisin dhe risin prestigjin e profesionit të avokatit në raport me publikun dhe e bëjnë atë një profesion të nderuar dhe të kërkuar.

Në kuptim të ligjit për profesionin e avokatit dhe të Kodit Etik, avokati duhet të kujdeset për të shmangur konfliktin e interesit. Kështu, atij nuk i lejohet që të jetë avokat i një personi, kur ka këshilluar një person tjetër për të njëjtën çështje ose kur ai ka lidhje gjaku apo ka interes më palën kundërshtare të asistuarit prej tij. Avokatit i ndalohet që të marrë përsipër një çështje, kur më parë e ka trajtuar atë profesionalisht në pozicionin dhe funksionin e gjyqtarit, prokurorit, oficerit të policisë gjyqësore apo si dëshmitar.

Ligji dhe Kodi Etikës në shumë dispozita, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, sanksionojnë parimin e mosveprimit të avokatit gjatë ushtrimit të profesionit në rastet e konfliktit të interesit. Natyrisht që një rregull i tillë nuk është shterues dhe çështja e mosveprimit në konflikt interesi me interesat e klientit që përfaqëson, duhet trajtuar rast pas rasti. Kështu në praktikë është vërejtur shkelja e këtij parimi në një rast konkret dhe për avokatin që e ka bërë këtë shkelje do të përbënte një rast të procedimit disiplinor ndaj tij. Rasti është i tillë:

``...Avokati gjatë gjykimit në shkallë të parë ka përfaqësuar palën paditëse dhe pasi ka përfunduar ky gjykim dhe çështja ka shkuar mbi bazën e ankimit të palës së paditur në gjykatën e apelit, ai ka marrë përsipër që të mbrojë para kësaj gjykate, palën e paditur....``

Natyrisht që rasti është në shkelje të parimit të ``konfliktit të interesit``, i cili rregullohet nga ligji dhe nga Kodi Etik. Secili nga lexuesit e këtij materiali qoftë edhe jo profesionistë të fushës, mund të jenë në gjendje që ta zgjidhin një rast të tillë, duke e trajtuar atë si një rast të pastër të shkeljes së konfliktit të interesit.²⁹

Kodi i Etikës përcakton se, marrëdhënia me klientin është një marrëdhënie besimi reciprok dhe detyrimi profesional dhe se ky besim arrihet kur avokati karakterizohet nga ndershmëria dhe nga integriteti. Pikërisht, nga ky rregull burojnë një sërë detyrash për avokatin në marrëdhënie e tij me klientin që ai merr përsipër ta asistojë apo ta mbrojë në një çështje përballë gjykatës, apo edhe institucioneve shtetërore. Në zbërthim të këtij parimi mund të përmendim disa nga këto detyrime të cilat janë rregulluar në Ligj, Statut dhe në Kodin Etik.

Së pari, avokati, pasi ka rënë dakord me klientin që do e asistojë në problemin që ka marrë përsipër për të zgjidhur, gjithashtu ka rënë dakord edhe për shpërblimin që ai do marrë për punën që do të kryejë dhe pasi t'i këtë fiksuar këto dhe probleme të tjera në kontratën e porosisë, ai duhet t'i shpjegojë klientit, ligjin dhe linjën e veprimit që do të ndjekë. Avokati duhet t'i përgjigjet profesionalisht dhe me thjeshtësi komunikimi, kërkesave që klienti do të ketë sipas rastit.

²⁹ Rregulla më të hollësishme që rregullojnë parimin e interesit më të lartë të klientit duke mos vepruar në konflikt interesi gjatë ushtrimit të profesionit të avokatit, janë të përcaktuara në nenin 9 të ligjit dhe kapitullin II të Kodit të Etikës.

Një nga detyrimet e avokatit në marrëdhënie me klientin, detyrim ky që buron nga dispozitat e akteve që rregullojnë profesionin e avokatit, është edhe informimi i vazhdueshëm që ai duhet t'i bëjë klientit në lidhje me ecurinë e çështjes. Kjo është shumë e rëndësishme të kuptohet drejtë, pasi jo rrallë në praktikë janë vërejtur raste se, mungesa e komunikimit apo edhe keqkuptimet në komunikim kanë çuar në prishjen e raporteve të shërbimit midis avokatit dhe klientit. Mendojmë se, do të ishte mirë sikur mënyra dhe mjeti i komunikimit të fiksohej në kontratën e porosisë që avokati nënshkruan me klientin në momentin që bien dakord për të filluar bashkëpunimin midis tyre.

1.5. Procedimi disiplinor

Çështjet e procedimit disiplinor janë një nga problemet më të rëndësishme dhe më delikatet në organizimin dhe funksionin e organeve të Dhomës së Avokatisë, por edhe të vetë jetës profesionale të avokatit gjatë ushtrimit të profesionit të tij. E themi këtë pasi nga njëra anë është detyrë e organeve të Dhomës që të ndjekin problemet e shkeljeve disiplinore dhe njëkohësisht sipas rastit, të marrin masa e të ndëshkojnë avokatët që shkelin rregullat për funksionimin e aktivitetit të tyre të vendosura në ligj, statut dhe kodin e etikës. Nga ana tjetër marrja e masës disiplinore ndaj një avokati gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij, mund të sjellë pasoja të padëshiruara jo vetëm për vetë avokatin, por edhe për klientin e asistuar prej tij.

Çështjet e procedimit disiplinor sipas praktikës së Dhomës së Avokatisë, deri më tani kanë paraqitur problematika të shumanshme, të cilat kanë pasjellë një proces jo korrekt, dhe kjo si pasojë e problemeve që ka pasur vetë ligji në mos konstituimin e drejtë të procesit disiplinor. Reforma e fundit ligjore, ka sjellë një përbërje të re të organeve që merren me procedimin disiplinor dhe me vetë mënyrën e të kuptuarit e të funksionimit të thelbit të procesit disiplinor.³⁰

1.5.1. Thelbi i procedimit disiplinor

Vetë procedimi disiplinor ka në thelb raportin e krijuar midis avokatit, gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij dhe qëndrimin të organeve të Dhomës së Avokatisë, në rast se konstatohen veprimet apo mosveprimet e mëposhtme:

- a) sjellje jo profesionale të avokatit, ku përfshihen veprime në kundërshtim me dispozitat e ligjit, statutit dhe kodit të etikës si dhe

³⁰ Me ligjin nr. 91/2012, datë 27. 09. 2012, janë bërë ndryshimet në ligjin aktual për Profesionin e Avokatit në RSH në lidhje me procedimin disiplinor.

- b) shërbime të papërshtatshme profesionale, ku përfshihen veprime apo mosveprime ndaj të përfaqësuarit, të cilat janë dukshëm nën nivelin e pritshmërisë për një avokat.

Me sjellje jo profesionale të avokatit, nuk duhet të kuptojmë vetëm faktin që ai gjatë ushtrimit të veprimtarisë profesionale të veprojë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit, Statutit apo Kodit Etik, por edhe kur veprimet apo mosveprimet e tij vijnë në kundërshtim me rregullat e vendosura nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, ku këtu përfshihen rregullat detyruese të nxjerra nga organet më të larta drejtuese të Dhomës së Avokatisë, si Këshilli Përgjithshëm dhe Këshilli Drejtues. Rregulla të tilla mund të ishin, vendimet e Këshillit të Përgjithshëm për pagimin e tarifës vjetore të anëtarësisë nga ana e avokatit që ushtron aktivisht detyrën, apo tarifës nga ana e avokatit që është anëtar jo aktiv për shkak të mos ushtrimit aktivisht të profesionit të avokatit.

Mospagimi i tarifës së anëtarësisë është konsideruar si një shkelje e rëndë e një rregulli të vendosur nga Këshilli Drejtues dhe futet në sferën e sjelljeve jo profesionale të avokatit e sjell detyrimisht marrjen e një mase disiplinore ndaj tij. Po kështu sjellje jo profesionale do të konsiderohet edhe një veprim i avokatit, në kundërshtim më një rregull të vendosur nga Dhoma e Avokatisë (vendore) në zonën ku ai ushtron si rregull profesionin e tij. Aktet e nxjerra nga këto të fundit nuk kanë karakterin detyrues të akteve që nxjerrin organet e Dhomës Kombëtare, dhe si të tilla, jo në çdo rast shkelja e tyre nga ana e avokatit mund të përbëjë një rast që të kualifikohet si sjellje jo profesionale e të sillte si pasojë marrjen e një mase disiplinore ndaj tij.

Sjellje jo profesionale mund të kualifikohet edhe rasti kur avokati vepron në kundërshtim me legjislacionin tatimor në fuqi. Avokati, pasi është pajisur me lejen e ushtrimit të profesionit, detyrohet që të regjistrohen në QKR dhe për rrjedhojë të pajiset me Kodin Fiskal (NIPIT), identifikim që e shoqëron atë në raport me të tretët, përfshi këtu marrëdhëniet me gjykatën apo vetë organin tatimor. Një tjetër veprim që mund të konsiderohet në kundërshtim me legjislacionin tatimor dhe që sjell ndër të tjera, nisjen e procedimit disiplinor, është edhe mospagimi i taksave nga ana e avokatit. Pra, avokati gjatë ushtrimit të profesionit të tij, jo vetëm që duhet të regjistrohet në organin tatimor për t'u pajisur me numrin e identifikimit fiskal, por duhet që të paguajë rregullisht edhe detyrimet tatimore. Për të përmbushur këtë detyrim, këshillohet që ndihma dhe asistenca e një eksperti fiskal (financier apo kontabël i miratuar) mund të krijojë padyshim kushtet dhe komoditetin që avokati jo vetëm të ketë një veprimtari të rregullt fiskale, por edhe të kontabilizojë sipas standardeve të kontabilitetit të

ardhurat dhe shpenzimet e aktivitetit të tij.³¹

Avokati gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij nuk duhet të kryejë akte apo sjellje të cilat diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e avokatit. Këto veprime apo sjelle të tij duhet të jenë të një karakteri të rëndë dhe duhet të vlerësohen rast pas rasti, nëse përbëjnë ose jo shkak për fillimin e një procedimi disiplinor. Në këtë kuptim avokati, jo vetëm gjatë ushtrimit të profesionit të tij duhet të veprojë me një sjellje etike, por edhe jashtë këtij profesioni duhet të silltet si një qytetar i denjë dhe në çdo kohë duhet të priret nga virtytet e larta të qytetarisë si edhe ato të etikës profesionale.

Një tjetër sferë e veprimit të avokatit gjatë ushtrimit të profesionit të tij është edhe ajo ngushtësisht profesionale. Avokati gjatë ushtrimit të profesionit duhet të tregojë profesionalizëm dhe të kujdeset që veprimet e tij profesionale të jenë në përputhje me ligjin procedural, atë material dhe me jurisprudencën e krijuar, me qëllim që mos prekë cilësinë e mbrojtjes dhe të mos cenojë parimet e një procesi të rregullt ligjor. Në këto rrethana, do të përbënin shkelje disiplinore veprimet e kryera në mënyrë të përsëritur nga ana e avokatit në kundërshtim me rregullat e procedurës civile gjatë një procesi civil, veprime këto të cilat mund të sillnin pasoja të padëshiruara për klientin e tij, p.sh. humbja e afatit të ankimit në mënyrë të përsëritur nga ana e avokatit do të përbënte një shkak për të filluar një procedim disiplinor ndaj tij.³²

Mund të ndodhë që gjatë ushtrimit të profesionit, avokati të jetë nën një procedim penal, i cili ka lindur nga të njëjtat shkaqe apo rrethana që ka lindur edhe procedimi disiplinor ndaj tij. Në këtë rast procedimi disiplinor pezullohet dhe pritet përfundimi i procedimit penal dhe çdo vendim penal pranohet në procedimin disiplinor. Këtu jemi përballë parimit që vendimi penal i formës së prerë për rrethanat të njëjta me atë të një procesi civil, përbën në këtë të fundit një provë të padiskutueshme që duhet marrë në konsideratë për faktin civil të ndodhur.

³¹ Ushtrimi i profesionit të avokatit pa u pajisur me lejen numrin e identifikimit fiskal apo me tej pa paguar në rregull detyrimet tatimore, jo vetëm që përbën një sjellje jo profesionale të tij dhe mund ta çojë atë në një procedim disiplinor dhe me pasoja për profesionin e tij, por përbën edhe veprë penale në bazë të neneve 180 -181 të Kodit Penal.

³² Ekziston tashmë një praktikë e konsoliduar e GJEDNJ dhe Gjykatës Kushtetuese, për atë që konsiderohet si “cilësia e mbrojtjes”, pasi mbrojta apo përfaqësimi i avokatit në një nivel të ulët profesional do të përbënte shkak për ta cilësuar ushtrimin e profesionit të tij në cenim të procesit të rregullt ligjor, i cili mbrohet nga kriteret e vendosura në nenin 6 të Konventës Evropiane dhe nenit 42 të Kushtetutës së R.SH.

1.5.2. Subjektet që mund të bëjnë ankesë ndaj avokatit

Këto subjekte janë përcaktuar në nenin 39 të ligjit Për Profesionin e Avokatit dhe konkretisht janë:

a) Çdo person që përfaqësohet, mbrohet apo asistohet prej tij. Këtu hyjnë palët në një proces civil, paditësi, i padituri, apo personat e interesuar, si dhe çdo person që këshillohet apo asistohet prej avokatit jashtë këtij procesi.

b) Çdo person i interesuar që pretendon se është dëmtuar nga sjellja apo veprimet e avokatit gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij. Këtu, rrethi i subjekteve duket që është shumë i gjerë, por jo çdo person mund të jetë një ankues ndaj veprimeve të avokatit. Te tille mund të jene vetëm ata persona të cilët kanë një interes të ligjshëm që lidhet me cenimin e interesave të tyre nga veprimet e avokatit.

c) Organet drejtuese të Dhomave të Avokatisë. Këto organe kanë një rol të madh në mbikëqyrjen e veprimtarisë së avokatëve gjatë ushtrimit të profesionit të tyre dhe për pasojë mund dhe duhet të veprojnë kur shohin veprime që përbëjnë sjellje jo profesionale të avokatit, apo kanë dijeni për shërbime të papërshtatshme të dhëna nga ana e tij gjatë ushtrimit të aktivitetit profesional.

d) Një avokat tjetër. Çdo avokat që në ushtrim të detyrës së tij ka përballë një kolego apo i duhet të komunikojë me të, për shkak të profesionit dhe në interes të klientit të tij, është subjekt që mund të vërë në lëvizje organet disiplinore për veprime që vijnë në kundërshtim me përmbushjen e detyrimeve të profesionit të kolegut të tij. Natyrisht që këtu duhet patur kujdes pozita ankuese e një avokati në një rast të caktuar kundër kolegut, pasi ajo mund të kthehet në një pozitë jo në favor të tij në një rast tjetër. Për këtë arsye marrëdhëniet midis kolegëve duhet të prirën nga respekti reciprok dhe nga zgjidhja e problemeve në frymën e mirëkuptimit dhe gjithnjë në interes të klientit e të respektit ndaj profesionit që ushtrojnë.

e) Ministri Drejtësisë. Raporti që krijon me avokatinë dhe roli që luan në sistemin e drejtësisë, i jep Ministrin të Drejtësisë një rol të veçantë dhe mbikëqyrës të ligjshmërisë së zbatimit të akteve normative që veprojnë në fushën e ushtrimit të profesionit të avokatit. Kjo e bën atë që të jetë në kontakt të vazhdueshëm me subjekte që kanë raporte me avokatët siç janë gjykatat, prokuroritë apo institucione të ndryshme shtetërore si dhe të marrë prej tyre, por edhe më gjerë, informacione në lidhje me shkeljet apo sjelljet jo profesionale të avokatëve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre. Kjo i jep mundësinë Ministrin të Drejtësisë që

të ushtrojë të drejtën e ankimit në një mënyrë të argumentuar dhe në ndihmë të organeve të dhomës së avokatisë që merren me procedimin disiplinor.

f) Gjyqtarët dhe prokurorët. Përfshirja e kësaj kategorie është një risi e vendosur në ndryshimet e fundit ligjore në reformën e organizimit dhe funksionimit të avokatisë. Këto subjekte ndeshen drejtpërdrejtë gjatë punës së tyre me sjelljet dhe veprimet e avokatëve, përfshi këtu edhe përgatitjen e tyre profesionale. Kështu që ata mund të jenë personat që mund ta shfrytëzojnë më me efikasitet të drejtën e ankimit ndaj avokatit.

g) Organet tatimore, mund të jenë subjektet që lidhen me faktin e ushtrimit ose jo në përputhje me legjislacionin fiskal të veprimtarisë së avokatit.

h) Çdo organ tjetër shtetëror, i parashikuar me ligj. Ky rregull vjen si pasojë e forcimit të transparencës edhe në fushën e ushtrimit të profesionit të avokatit, dhe i jep mundësi ligjvënësit që të parashikojë në ligje të tjera të posaçme të drejtën e institucioneve shtetërore që të ushtrojnë mjetin e ankimit ndaj sjelljeve të avokatit.³³

1.5.3. Afati i ushtrimit të së drejtës së ankimit

Në çdo ankim, në fushën e së drejtës civile apo asaj administrative, duhet marrë në konsideratë koha që ankuesi ka në dispozicion për të ushtruar të drejtën e këtij ankimi, pasi ushtrimi i saj jashtë këtyre afateve do të sillte shuarjen e kësaj të drejte. Po kështu edhe ushtrimi i të drejtës së ankimit jashtë afateve të përcaktuara në ligjin “Për Profesionin e Avokatit”, pas sjell shuarjen e kësaj të drejte për t’iu drejtuar organit kompetent që merret me shqyrtimin e procedurave disiplinore. Në ndryshim nga e drejta civile, afati i parashkrimit në procedimin disiplinor duhet të merret parasysh nga vetë organet e këtij procedimi në rastin kur ai konstatohet. Ankesa ndaj një avokati, nga rrethi i subjekteve të përmendura më sipër, mund të bëhet brenda një afati 6 mujor, duke filluar të ecë ky afat nga data e sjelljes ose veprimit të avokatit apo nga data e konstatimit të sjelljes apo veprimit të tij. Ankesa e mësipërme sipas këtij rregulli, mund të bëhet në çdo rast, por jo më vonë së një vit nga momenti i kryerjes së shkeljes. Pra, edhe këtu vepron parimi i së drejtës në përgjithësi dhe në çdo fushë të saj, se një shkelje nuk mund të cenoje pafundësisht sigurinë e ushtrimit të profesionit.

³³ Nuk gjejmë ndonjë dispozitë të një ligji të posaçëm që rregullon veprimtari shtetërore të ndryshme që parashikon një rregull që lidhet me drejtën e ankimit ndaj avokatit. Rregulli i mësipërm e lejon që në të ardhmen organe shtetërore që janë të interesuar për mbarëvajtjen e profesionit të avokatit apo kanë raport ligjor me të, mund të parashikohet në ligjet që rregullojnë veprimtarinë e tyre një e drejtë e tillë.

Instituti i rivendosjes në afat, pranohet edhe në procesin disiplinor ndaj avokatit. Kjo do të thotë që ankuesi, i cili ka humbur afatin e ankimit ndaj veprimeve apo sjelljeve të avokatit, mund të kërkojë nga ana e organeve kompetente (Komisioneri) që për shkaqe të arsyeshme, të rivendoset në afat. Rivendosja në afat bëhet në përputhje me rregullat e parashikuara në Kodin e Procedurës Civile.³⁴

Ligji parashikon afatin prej 3 muajsh, brenda të cilit duhet të përfundojë procesi disiplinor ndaj avokatit. Ky afat fillon nga data e depozitimit të kërkesës. Por afati mund të zgjatet deri në 6 muaj, duke marrë pëlqimin me shkrimin të ankuesit dhe avokatit që procedohet ose nga vetë Komisioneri, kur ekzistojnë shkaqe të arsyeshme dhe që mund të justifikojnë këtë zgjatje. Kryetari i Dhomës Kombëtare të avokatëve ka një rol të rëndësishëm në procesin disiplinor, pasi ai është filtri i parë i marrjes në shqyrtimin të ankesave ndaj një avokati dhe pasi i shqyrton ato vetëm nga pikëpamja formale, ai brenda 5 ditëve ia përcjell ankesat Komisionerit të ankimeve duke njoftuar për këtë veprim edhe vetë ankuesin. Natyrisht që kjo është një procedure formaliste, por gjithnjë ka një moment dalje i cili lidhet me refuzimin e kryetarit apo me mosveprimin e tij tej afatit 5 ditor për të përcjellë ankesën Komisionerit. Në këtë rast ligji i jep të drejtë ankuesit që ta përcjellë ankesën drejtpërdrejtë Komisionerit të Ankimeve.

1.5.4. Komisioneri i Ankimeve

Komisioneri i ankimeve është një figurë e re e futur në ligj pas reformës së vitit 2012. Ai ka një rol shumë të rëndësishëm në mbarëvajtjen e procedurës disiplinore. Ai është përgjegjës për të filluar procedimin disiplinor, si dhe për të shqyrtuar dhe hetuar ankimin brenda një afati prej 20 ditësh nga momenti i regjistrimit të tij. Në përfundim të këtij shqyrtimi paraprak, ai përgatit një relacion të hollësishëm mbi shkaqet dhe përmbajtjen e ankimit dhe ia paraqet atë komitetit disiplinor. Me paraqitjen e relacionit komitetit disiplinor, ai duhet të njoftojë menjëherë për këtë si ankuesin, ashtu edhe avokatin i cili është edhe subjekti i ankimit.

Komisioneri i ankimeve ka disa kompetenca të karakterit formal, si edhe ato që lidhen me vetë afatet e ankimit. Kështu ai mund të ndihmojë ankuesin në përgatitjen e procesit të ankimit, ta informojë atë për çdo hap që ndërmerret si dhe të regjistrojë ankimin. Ai ka gjithashtu të drejtën e kontrollit të ankimit para regjistrimit dhe në rast se ai nuk përmbush kriteret e vendosura në nenin 39 pika 1 dhe 2 të ligjit,

³⁴ Neni 151 dhe 152 i K. Pr. Civile, parashikojnë rregullat që zbatohen në rastin e shqyrtimit të kërkesës për rivendosjen në afat.

mund ta refuzojë atë. Komisioneri ankimeve në përmbushje të detyrave të tij për të respektuar procesin e rregullt të procedimit disiplinor dhe me qëllim që ankimi të jetë sa më i plotë, mund të kërkojë shpjegime në lidhje me të edhe nga vete avokati. Ai ka detyrimin që ta paraqesë ankimin së bashku me relacionin e Komitetit disiplinor, por njëkohësisht, ai ka detyrimin që të raportojë para tij sa herë i kërkohet. Siç e përmendëm më sipër, Komisioneri i ankimeve ka të drejtë edhe të refuzimit të ankimit në rast se ai nuk përmbush kërkesat e nenit 39 të ligjit. Në këtë rast, ankuesi mund të paraqesë ankim ndaj refuzimit, para komitetit disiplinor.

Një nga detyrat e rëndësishme që ka Komisioneri i Ankimeve, është edhe raportimi i tij para Komitetit Disiplinor. Këtë detyrim ai e ka sa herë i kërkohet prej Komitetit. Raporti i ndërvarësisë midis tij dhe Komitetit është i tillë aq sa veprimtaria e tij konsiderohet si e varur nga ajo e Komitetit. Në fakt, Komisioneri i Ankimeve ka një pavarësi që buron nga kompetencat që jep ligji dhe statuti, por raportimi para Komitetit të Disiplinës i jep natyrës së punës së tij karakterin e varësisë dhe të kontrollit nga ana e komitetit.

Ndërkohë, Komisioneri ka një raport të caktuar edhe me subjekte të posaçme të ngritjes së ankimit ndaj avokatit. Konkretisht, në rastet kur ankues është Ministri i Drejtësisë apo një gjyqtar, këta të fundit kanë të drejtën që të ankojnë vendimet e Komisionerit përpara komitetit të disiplinës, brenda një afati 15 ditor nga data e njoftimit të vendimit. Siç shihet natyra e punës së Komisionerit të Ankimeve, është e një rëndësie të madhe në mbarëvajtjen e procesit disiplinor.

1.5.5 Komiteti Disiplinor

Reforma e fundit ligjore në aspektin e procedurave disiplinore i dha mundësinë organeve të disiplinës, konkretisht Komitetit Disiplinor, të jetë më funksional dhe me rezultativ në krahasim me ato organe procedimi që ishin krijuar para ndryshimeve ligjore. Aktualisht ka vetëm një shkallë procedimi disiplinor dhe vetëm një shkallë ankimi brenda organeve të dhomës, e cila është e përqendruar në kompetencat funksionale të Komitetit Disiplinor. Ai është një organ kolegjal dhe përbëhet nga 6 avokatë, të cilët zgjidhen me votim të fshehtë nga anëtarësia e Këshillit të Përgjithshëm të Dhomës Kombëtare të Avokatisë. Kësaj përbërje avokatësh i shtohen edhe përfaqësues profesionistë të fushës, të zgjedhur nga ana e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Ministrisë së Drejtësisë apo të Botës Akademike ose të Shoqërisë Civile.

Kompetencat funksionale të Komitetit të Disiplinës, janë përcaktuar në ligj dhe konsistojnë së pari në shqyrtimin e vendimeve të Komisionerit të Ankimeve.

Ai vendos në pranimin e kërkesës dhe më tej, në marrjen e masës disiplinore ndaj avokatit. Afati kohor i shqyrtimit të ankesës ndaj avokatit nga ana e Komitetit të Disiplinës, është 30 ditor dhe kjo për shkak të karakterit urgjent dhe shumë serioz të çështjes, pasi një avokat nuk mund të ushtrojë profesionin, si nga pikëpamja ligjore, ashtu edhe nga ajo etike, i “kërcënuar” nga një procedurë e stërzgatur disiplinore. Për më tepër, mosrespektimi i afatit të shqyrtimit të ankesës ndaj avokatit nga ana e Komitetit të Disiplinës, i jep të drejtë ankuesit që të çojë çështjen para gjykatës kompetente e cila në përfundim, mund të vendosë për marrjen e masave dhe rivendosjen e gjendjes për shqyrtimin e kërkesës. I interesuar për një shqyrtim të shpejtë të ankimit mund të jetë edhe avokati, dhe në këtë pikë ligji nuk i jep të drejtë atij që të paraqesë ankim në gjykatën kompetente ndaj mosveprimit të komitetit. Kjo është një mangësi e dispozitës, por mendojmë se me një interpretim të zgjeruar dhe sistematik të nenit 44 pika 6 dhe 7, mund të argumentojmë edhe legjitimitimin e avokatit për të ankuar mosmarrjen në shqyrtimin, nga ana e Komitetit të Disiplinës, të ankesës së bërë ndaj tij. Kundër vendimit përfundimtar të Komitetit të Disiplinës, mund të bëhet ankim në gjykatën kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative, brenda një 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit, nga të dyja subjektet si nga ankuesi, ashtu edhe nga ana e Avokatit.

Nga shqyrtimi me kujdes i kompetencave që i jep ligji Komitetit të Disiplinës, mund të arrijmë në konkluzionin se ai është një organ i tipit “*quasi* gjykatë” dhe si i tillë ka në diskrecion që, para së të japë një vendim përfundimtar, të bëjë të gjitha veprimet e nevojshme apo edhe të marrë prova që i mendon të domosdoshme për zgjidhjen e çështjes. Nisur nga ky arsytim mendojmë se parimi i respektimit të një procesi të rregullt ligjor gjatë procedurës disiplinore, nuk mendojmë se është vetëm një fikSION i ndryshimeve të fundit ligjore, por edhe një substancë materiale për t’u respektuar nga ana e Komitetit Disiplinor. Në këtë kuadër, gjatë kohës që Komiteti merr në shqyrtim kërkesën e ankuesit, është i detyruar që të bëjë një seance dëgjimore ku të thërrasë palët në procedim, të cilat kanë të drejtë që të paraqiten vetë ose me avokat. Gjatë gjithë procesit dhe seancës së procedimit disiplinor, komiteti ruan të gjitha të drejtat jo vetëm që të dëgjojë palët personalisht apo mbrojtësit e tyre, por edhe ta bëjë gjykimin në mungesë, kur njëra palë apo asnjëra prej tyre nuk është paraqitur pa shkaqe të arsyeshme.

Pretendimet e palëve në seancë, ashtu si në një gjykim civil, mund të paraqiten me shkrim ose me gojë. Avokati ndaj të cilit është paraqitur ankimi duhet që, brenda një afati 15 ditor nga momenti i komunikimit të tij, të paraqesë argumentet e tij me shkrim. Komiteti disiplinor pranon provat e paraqitura nga palët, shkresore apo me dëshmitare, por edhe mund t’i marrë vetë ato në rast se e shikon të domosdoshme për zgjidhjen e çështjes.

Në fund të shqyrtimit, komiteti disiplinor mund të vendose në pranimin apo rrëzimin e kërkesës. Vendimi duhet të jetë i arsyetuar dhe rastin e marrjes së masës ndaj avokatit të proceduar, ajo (masa) duhet të jetë në proporcion me natyrën dhe rëndësinë e shkeljes. Vendimmarrja e komitetit për dhënien e masës disiplinore, në rast se arrin në konkluzionin e pranimit të kërkesës, mund të ndahet në dy grupe në raport me shkelje që ai ka kryer:

a) *Shkelje që klasifikohen si sjellje jo profesionale.*

Në këtë rast masat disiplinore mund të jenë të ndryshme dhe fillojnë që nga heqja e së drejtës së ushtrimit të profesionit të avokatit, pezullimi i lejes së ushtrimit të profesionit të avokatit nga 3 muaj deri në 2 vjet, dhënia e një gjobe që shkon nga 5 000 deri në 50 000 lekë, urdhërimin e avokatit për të kryer veprime shtesë që lidhen me etikën profesionale dhe të tjera masa disiplinore që janë parashikuar në nenin 45 të ligjit.

b) *Shkelje që klasifikohen si shërbim i papërshtatshëm profesional.*

Për këto lloj shkeljesh komiteti disiplinor jep masa të ndryshme të cilat fillojnë nga urdhërimi për t' i kërkuar ndjesë ankuesit, kompensimin e tij deri në një vlerë prej 100 000 lekë dhe deri në urdhërimin e avokatit për të bërë trajnim shtesë.

Vendimet e dhëna nga Komiteti i Disiplinës përbëjnë titull ekzekutiv. Mendoj se kur vendimi merr formë të prerë, ai duhet të ekzekutohet nga ana e organeve drejtuese të Dhomës sipas rregullave të vendosura në statut. Ligji nuk përcakton se kur vendimi merr formë të prerë, në momentin kur ai shpallet nga ana komitetit apo pasi kanë përfunduar afatet apo procedurat e ankimit në gjykatë. Rregulli këtu është ai i përgjithshëm dhe i përcaktuar në të drejtën procedurale civile dhe atë administrativ, që do të thotë se vendimi i komitetit si një organ e një shkalle gjykimi, nuk merr formë të prerë në rast se ai apelohehet nga ana e avokatit në gjykatën kompetente ose në rast se ai nuk apelohehet brenda afatit 30 ditor nga njoftimi i tij. Kjo do të thotë se vendimi do të marrë formë të prerë dhe do të përbëjë titull ekzekutiv vetëm kur ai është shqyrtuar nga gjykata dhe vendimi i dhënë prej saj ka marrë formë të prerë sipas rregullave të përgjithshme të një gjykimi administrativ.

Nga rregulli i mësipërm ekziston një përjashtim, i përcaktuar në nenin 46/3 të ligjit dhe ka të bëjë me ato vendime të Komitetit të Disiplinës kur merren në kushtet e nenit 45 dhe 46 me pasojë heqjen apo pezullimin e së drejtës për të ushtruar profesionin e avokatit. Në këtë rast, ankimi ndaj vendimit të komitetit nga ana e avokatit nuk e pezullon zbatimin e tij, pra vendimi për pezullimin e ushtrimit të aktivitetit apo heqjen e së drejtës për ta ushtruar atë hynë në fuqi, përveçse kur gjykata urdhëron shprehimisht pezullimin e tij.

1.6. Trajnimet e vazhdueshme

1.6.1. Roli dhe rëndësia e trajnimeve vazhduese

Duke u bashkuar edhe me profesionet e tjera të ngjashme, ndryshimet e vitit të kaluar në ligjin “Për profesionin e avokatit”, kanë parashikuar në mënyrë të hollësishme nevojën dhe mënyrën e zhvillimit të trajnimeve vazhduese për avokatët. Nevoja e avokatëve të cilët e ushtrojnë profesionin për trajnim vazhdues, është një nevojë konstante e cila ka diktuar më pas këto ndryshime ligjore. Përtej një nevoje natyrale për të zgjeruar njohuritë, e cila është karakteristike tek çdo qenieje njerëzore, nevoja për trajnim vazhdues e avokatëve vjen edhe si një nevojë profesionale.

Në një kohë ndryshimesh të mëdha në sferën shoqërore e ekonomike, të reflektuara këto detyrimisht me ndryshime juridike, e të shoqëruara nga një proces përshtatje e përafrimi të legjislacionit tonë me atë ndërkombëtar si dhe në kuadër të përfshirjes së rendit tonë juridik në konventa dypalëshe dhe shumëpalëshe, nevoja për trajnim vazhdues është bërë jetike.

Cilido nga avokatët, edhe ata me profesionistë, edhe ata me më shumë eksperiencë apo që merren me një shumëllojshmëri çështjesh, kombëtare dhe ndërkombëtare, kuptojnë çdo ditë që mund të marrin dhe shkëmbejnë informacione të vlefshme në takimet me kolegë apo studiues të së drejtës, qofshin këta vendas apo të huaj.

Qëllimi dhe roli kryesor i trajnimit vazhdues është që të ndihmojë avokatët gjatë punës së tyre të përditshme, e kuptuar kjo ndihmë në shumë forma si:

Ndarja e informacionit mbi legjislacionet dhe praktikën e reja, sidomos ato ndërkombëtare është një temë gjithmonë e dobishme dhe gjithmonë e re, me hapësira të shumta për të trajtuar. Avokatët mund të marrin informacion p.sh. për një ankim sipas Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, për rregullat ndërkombëtare të shitjes, transportit etj.

Krijimi i lidhjeve midis avokatëve në dhomat e ndryshme të avokatisë, është një ndihmesë tjetër që mund të japin trajnimet vazhduese, për shkak se mbledhin bashkë avokatë të cilët ushtrojnë veprimtari në gjykata të ndryshme. Avokatët mund të krijojnë lidhje me njeri-tjetrin, gjë që rezulton gjithmonë e dobishme gjatë praktikës.

Lehtësira të tjera të nevojshme mund të përfitohen gjatë trajnimeve vazhduese, siç mund të jenë informacione mbi teknologjinë e re, duke përfshirë

funksionimin e programeve informatike të cilat përdoren nga sistemi gjyqësor apo organet e tjera, në mënyrë që të përftohet prej tyre informacion, pa qenë nevoja t'i drejtohem personalisht apo me shkresë.

Gjithashtu, trajnimet mund të shërbejnë edhe për nevoja më bazike, siç mund të jenë rregulla të shkrimit dhe arsyetimit ligjor apo qoftë edhe teknika të relaksimit (p.sh. në një seminar mbi jogën) që ndoshta nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me profesionin e avokatit, por që sigurisht ndihmojnë jetën e tyre të përditshme dhe për rrjedhojë edhe atë profesionale. Sigurisht që të gjithë bien dakord që bashkëbisedimi dhe ndarja e eksperiencave praktike në këtë fushë krijon eksperiencë pozitive dhe është e dobishme për të dyja palët.

1.6.2. Mënyra e zhvillimit të trajnimit vazhdues

Trajnimi vazhdues për avokatët, në të kaluarën nuk ka ekzistuar dhe vetëm vitet e fundit është menduar për fillimin e një eksperience të tillë, pas rezultateve pozitive që dha aplikimit i këtij lloj trajnimi tek gjyqtarët dhe prokurorët. Dhoma Kombëtare e Avokatisë (DHKASH), së bashku me partnerët ndërkombëtarë, në vitin 2012 ka krijuar Programin Kombëtar për Trajnimin Profesional të Avokatëve dhe Asistentëve, i cili kishte për qëllim të niste këtë eksperiencë si edhe të shihte problematikat që do të sillte në praktikë aplikimi i saj. Pas mbylljes me sukses të vitit të parë të programit të Arsimit Vazhdues Ligjor, ku mbi 320 avokatë dhe asistentë në dhomat rajonale Durrës dhe Vlorë morën pjesë në trajnimet e dhëna nga pedagogët më të njohur në 12 fusha të së drejtës, po punohet për zhvillim e mëtejshëm të programit duke e bërë gjithëpërfshirës. Nisur nga suksesi i kësaj nisme dhe si rrjedhojë e zbatimit të saj, DHKASH-ja paraqiti propozime për ndërhyrje në ligjin “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, të cilat synojnë kthimin e programit të trajnimit vazhdues në një program të detyrueshëm dhe të vetë-qëndrueshëm financiarisht, nën administrimin e Dhomës.

Në këtë frymë, Dhoma Kombëtare e Avokatisë përmes ndryshimeve ligjore realizoi themelimin e Shkollës Kombëtare të Avokatisë, me qëllim organizimin dhe zhvillimin e trajnimeve për avokatët si trajnimi fillestar, ashtu edhe ai vazhdues. Ne do të ndalemi në trajnimin vazhdues për ata avokatë të cilët ushtrojnë aktualisht profesionin.

Ndryshimet e ligjit “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”³⁵,

³⁵ Ligji Nr. 9109, datë 17.7.2003 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.9795, datë 23.7.2007, ligjin nr. 10 047, datë 24.12.2008 dhe ligjin nr. 91/2012 datë 27.09.2012

e kanë bërë të detyrueshëm ndjekjen e programit të trajnimit vazhdues, me pasojë marrjen e masave disiplinore për ata avokatë të cilët nuk i nënshtrohen trajnimit vazhdues. Rregullat për zhvillimin e trajnimit vazhdues janë të parashikuar në nenin 16/1 të ligjit, në të cilën parashikohet detyrimi i avokati për ndjekjen e trajtimit vazhdues dhe pajisjen me vërtetimin përkatës për ndjekjen e këtij programi. Në rast të mospërmbushjes së detyrimit për ndjekjen e programit të trajnimit vazhdues nga avokati, zbatohet neni 46 i ligjit i cili parashikon marrjen e masave disiplinore ndaj tij.

Për më tepër, në ndryshimet e reja ligjore, një nga llojet e masave disiplinore që mund të jepet për shkelje disiplinore të kryera nga avokatët gjatë ushtrimit të profesionit është edhe urdhërimin e avokatit për të bërë trajnim vazhdues shtesë, përfshirë këtu edhe trajnim në një fushë të veçantë të ligjit.

Rregullat e hollësishme për pjesëmarrjen në trajnim, organizimin, kohëzgjatjen dhe mënyrën e zhvillimit të tij do të përcaktohen në statutin e Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe rregulloren e programit të trajnimit, të cilat miratohet me vendim të Këshillit të Përgjithshëm të Dhomës Kombëtare të Avokatisë.” Me miratimin e ndryshimeve ligjore Shkolla Kombëtare e Avokatisë është organi i Dhomës Kombëtare të Avokatisë që merret me përgatitjen e programeve të trajnimit, organizimin dhe administrimin e trajnimit vazhdues të avokatëve.

KREU 2

MARRËDHËNIA ME KLIENTIN

Av. Artan HAJDARI, Prof. Dr. Mariana SEMINI-TUTULANI
dhe Av. Envi HICKA

2.1. Marrëdhënia juridike e porosisë, ndërmjet avokatit dhe klientit

Pavarësisht nga forma e ndihmës juridike dhe e asistencës që përfshihet në rrethin e shërbimeve të avokatisë, e rëndësishme është që cilësia në kryerjen e shërbimit të jetë në nivele të tilla që të plotësojë të gjithë parametrat bashkëkohore me qëllim që avokati të paraqitet para publikut që ka nevojë për të, si një figurë e karakterizuar nga profesionalizmi dhe ndershmëria. Këto elementë të rëndësishëm do të bëjnë që komuniteti të ketë besim tek shërbimi juridik i ofruar nga avokatët.

Ndryshimet e bëra me Ligjin Nr. 91/2012, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9109, datë 17.7.2003 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë” (të ndryshuar), kanë synuar të forcojnë shkallën e përgjegjësisë dhe të përgjegjshmërisë së avokatit përkundrejt klientit të tij në mbrojtje të interesave të këtij të fundit. Avokati duhet të veprojë si një “profesionist i arsyeshëm”³⁶ dhe të respektojë të gjitha rregullat etike profesionale. Në punën e një juristi, avokati apo konsulenti ligjor, është shumë e rëndësishme të dihet paraprakisht rregullt se: sa më shumë njohuri dhe dije të kemi për një marrëdhënie juridike që lidhet me një përfaqësim gjyqësor, aq më të lehtë do ta kemi në ndërtimin e raportit midis avokatit dhe klientit dhe në negocimin e kushteve në kontratën e porosisë, që do të lidhet midis tyre. Sa më shumë njohuri të kemi për çështjen gjyqësore që do të përfaqësojmë, sa më shumë njohuri të kemi për një klient a palë kontraktore me të cilën do të lidhim kontratën, aq më mirë do të jetë për të dyja palët si për avokatin, ashtu edhe për klientin, për fatin e realizimit të detyrimeve që rrjedhin prej saj.

³⁶ Për hollësi shihni nenin 9 të Ligjit Nr. 91/2012 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9109, datë 17.7.2003 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”,

2.1.1. Parimet që udhëheqin marrëdhënien e avokatit me klientin

Marrëdhënia juridike avokat-klient në vetvete është një kontratë. Pra, avokati është i lidhur me konceptin e kontratës, në dy plane: së pari, se hartimi i kontratave është një nga llojet e shërbimit që ai mund t'i ofrojë klientëve dhe, së dyti se çdo lloj shërbimi që ai i ofron klientëve është një marrëdhënie kontraktore. Përpilimi i kontratave është një punë, sa juridike, aq edhe “letrare” dhe “artistike”. Të përgatitësh një kontratë është një art më vete dhe që të jesh sa më i suksesshëm në këtë lloj “arti”, duhet që të njohësh disa parime mjaft të rëndësishme të cilat, duhet të jenë në themel të ndërtimit të marrëdhënies midis avokatit dhe klientit.

a. Kontrata është e shenjtë. Parimi i parë është ai që marrëdhënia juridike e lidhur me kontratën e porosisë midis avokatit dhe klientit është e shenjtë. Legjislacioni shqiptar³⁷ parashikon se çdo kontratë është ligj për palët. Lidhur me këtë parim ka ekzistuar një drejtim filozofik³⁸ i cili propagandonte tezën se liria brenda kufijve të ligjit, ndikon domosdoshmërisht mbi faktin, që kufijtë e lirisë së njëres palë kontraktore synojnë gjithmonë të “zvogëlojnë” kufijtë e lirisë së palës tjetër. Kjo buron nga fakti se realizimi i së drejtës së njëres palë në një kontratë porosie, (por edhe më gjerë), është i lidhur pazgjidhshmërisht me përmbushjen e detyrimit të palës tjetër kontraktore. Ky rregull është shumë i rëndësishëm, sepse ai duhet të merret parasysh kur përcaktohet risku normal për suksesin e një marrëdhënie kontraktore. “Mbajtja në këmbë” e një kontrate deri në përmbushjen e plotë të objektit të saj, do të varet nga mënyra si respektohet ligji dhe vullneti i palëve, por edhe nga mënyra se si parashikohet çdo situatë juridike që mund të shkaktojë konflikt juridik midis palëve. Për këtë arsye, kontrata është një dokument juridik që kërkon aftësitë më të larta hartuese, të cilat duhet të kombinojnë gjuhën e ligjit me kërkesat dhe interesat e biznesit.

Qenia “e shenjtë” e një marrëdhënie kontraktore lidhet edhe me parashikimin apo promovimin nëpërmjet saj të mekanizmave vet shërbyes. Në këtë kontekst, kushte të tilla që lidhen me afatet kontraktore, kushtet penale dhe garancitë kontraktore, parashikimi për tërheqje nga kontrata, e të tjera, ndonëse mbeten përherë kushte që duket sikur tronditin “paqen” dhe “qetësinë” e kontratës, për shkak të efekteve psikologjike që mbartin në vetvete, përsëri ato sigurojnë të ashtuquajturën “qetësi” në përmbushjen me korrektesë të detyrimeve kontraktore. Gjithsesi, ndryshimet në ligjin për avokatinë parashikojnë që avokati e garanton

³⁷ Kodi Civil, neni 690 në Kreun III Efektet e kontratave sanksionon: “Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të priset ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve ose për shkaqe të arsyeshme të parashikuara në ligj”.

³⁸ Commercial Law, Iwan R. DAVIES, Blackstone Press Limited, Great Britain 1992, Faqe 4-5

klientin e tij, duke lidhur kontratë sigurimi për të garantuar përgjegjësinë e tij ndaj palëve të treta, për shkak të ushtrimit të veprimtarisë së tij.

b. Mirëbesimi. Parimi i dytë që duhet të udhëheqë marrëdhënien Avokat-Klient është parimi i mirëbesimit. Edhe legjislacioni shqiptar parashikon mirëbesimin si një nga rregullat e interpretimit të kontratave³⁹, si edhe një nga kushtet në procesin e lidhjes së kontratave⁴⁰. Mirëbesimi është një koncept që nuk ka një definicion apo përkufizim në Kodin Civil apo në ndonjë ligj tjetër. *Mirëbesimi është një gjendje mendore dhe shpirtërore me cilësi abstrakte të pamatshme teknike apo të papërcaktuara ligjrisht, që lidhet me ndershmërinë në qëllime dhe në sjellje, me qenien besnik dhe i drejtë, me mungesën e keqdashjes, të mashtrimit apo të kërkimit të një avantazhi të vetëdijshëm apo të pavetëdijshëm ndaj një personi tjetër.*

Mirëbesimi në marrëdhëniet avokat-klient nënkupton ndershmërinë në sjellje dhe në veprimet juridike, që në fakt manifestohet në plotësimin me korrektesë⁴¹ dhe me besnikëri të standardeve të arsyeshme profesionale e etike. Ndonjëherë për ta pasur më të lehtë analizën e një termi, nisemi nga e kundërta e tij. Keqbesimi mund të shprehet në forma të tilla si: fshehja e informacionit të plotë lidhur me një çështje, fshehja e të dhënave teknike, mashtrimi lidhur me cilësinë e shërbimit, lidhur me provat, ngjallja e besimit për fakte jo të vërteta, prezenca e konfliktit të interesit dhe marrëdhëniet me avokatin e palës kundërshtare, e të tjera.

Kodi ynë Civil parashikon edhe si zgjidhen situata të ndryshme kur palët kanë shkelur rregullin e mirëbesimit, edhe pasojat që lidhen me shkaqet dhe pasojat e pavlefshmërisë së kontratës së lidhur, duke parashikuar që pala që është në keqbesim të detyrohet të shpërblejë dëmin që ka pësuar pala në mirëbesim.

Në kontratat me detyrime të ndërsjella, çdo palë mund të refuzojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se pala tjetër nuk e ka përmbushur atë, ose nuk kërkon të përmbushë njëkohësisht detyrimin, me përjashtim të rasteve kur nga palët është caktuar kështu, ose kur del nga natyra e kontratës, nga e cila rezultojnë afate të ndryshme për përmbushjen e detyrimeve të palëve. Megjithatë përmbushja nuk mund të refuzohet në qoftë se, duke pasur parasysh rrethanat, refuzimi bie në kundërshtim me mirëbesimin. Ky rregull i përgjithshëm kontraktor vlen edhe për marrëdhëniet midis avokatit dhe klientit.

³⁹ Shih Kodin Civil shqiptar Neni 682/2, që parashikon se: “Kontrata duhet të interpretohet në mirëbesim nga palët”.

⁴⁰ Shih Kodin Civil Shqiptar, neni 675, që parashikon se: “Në rast se një palë kontraktuese disponon njohuri profesionale dhe pala tjetër i ngjall asaj besim të plotë, e para ka detyrim t’i japë asaj me mirëbesim, informata dhe udhëzime”.

⁴¹ Neni 422 i Kodit Civil parashikon: “Kreditori dhe debitori duhet të sillen ndaj njëri-tjetrit me korrektesë, me paanësi dhe sipas kërkesave të arsyes.”

Marrëdhënia juridike midis avokatit dhe klientit mund të vishet në formën e kontratës së porosisë ose prokurës së posaçme.

Në vijim do të trajtojmë karakteristikat dhe elementët e këtyre dy modeleve me të cilat mund të vishen marrëdhëniet juridike për përfitimin e shërbimeve avokatore.

c. Siguria juridike. Ndërtimi i binomit Avokat-Klient mbështetet tek besimi reciprok dhe korrektesa. Këto janë elementë të rëndësishëm që duhet të veprojnë në mënyrë të dyanshme dhe reciproke. Nëse klienti do të ndihet i sigurt për mbrojtjen e interesave të tij, për ruajtjen e konfidencialitetit në lidhje me rrethanat e çështjes, për suksesin në arritjen e pritshmërive, për rivendosjen në vend të së drejtës së shkelur, atëherë marrëdhënia juridike e avokatit me klientin do të jetë në nivelin e duhur. Nga ana tjetër, dhënia e shërbimit me nivelin e duhur profesional dhe me ndershmëri profesionale mbetet thelbi i kësaj marrëdhënie juridike. Në vijim, do të trajtohen në pikën 2.6 të këtij kreu edhe garancitë ligjore dhe kontraktore që forcojnë sigurinë e raportit avokat-klient.

d. Formaliteti i kontratës së shërbimit të avokatit duhet të priret nga korrektesa e ndershmëria në kryerjen e shërbimit, por edhe nga dokumentimi i të gjitha aspekteve të saj në formën e shkresës së thjeshtë. Kontrata e porosisë është, si rregull, një kontratë joformale. Kjo do të thotë, se ajo mund të bëhet si me gojë, ashtu edhe me shkresë të thjeshtë apo me akt noterial. Forma e saj do të mbetet në zgjedhjen e palëve apo në varësi të natyrës juridike dhe fizike të objektit të shërbimeve të parashikuara nga palët, apo nga pasojat që pritet të vijnë nga kryerja e këtyre shërbimeve avokatore.

Nuk duhet të harrojmë se nga vetë përmbajtja e porosisë do të varet edhe forma e saj. Më konkretisht, nëse objekti apo ndonjë kusht tjetër kontraktor është i tillë që parashikon:

- kufijtë e veprimit që lidhen me sende të paluajtshme;
- përfaqësimin e të drejtave reale;
- veprime me sende të luajtshme, por që i nënshtrohen ndonjë sistemi regjistrimi, si dhe me të drejta që lidhen me to;
- dhënien e autorizimit për lidhje kontratash, për të cilat ligji kërkon formë shkresore apo akt noterial për efekt vlefshmërie apo provueshmërie;
- shpërblime apo detyrime në të holla që i kalojnë limitet e përcaktuara nga Kodi i Procedurës Civile⁴² dhe,
- sigurimin e pasurisë lidhur me shërbimin e ofruar nga avokati dhe dëmshpërblimin e rreziqeve të kryerjes me sukses të shërbimit avokator.

⁴²Shihni nenin 232 të Kodit të Procedurës Civile.

e. Probabiliteti apo dilema e marrëdhënies avokat-klient lidhet me pritshmërinë për zgjidhjen me sukses të çështjes gjyqësore, të realizimit të lidhjes dhe të zbatimit të kontratës së hartuar nga avokati, ardhjes së pasojave të dëshiruara për klientin si rezultat i kryerjes së shërbimit nga avokati, e të tjera. Pavarësisht nga shërbimi i kryer me profesionalizëm dhe përkushtim nga ana e avokatit, jo gjithmonë suksesi i shërbimit të tij varet vetëm prej tij. Kjo, për faktin se shpesh shërbimet e avokatisë ndërthuren edhe me persona fizikë të tjerë, persona juridike privat e publik, institucione, të tilla si gjykatat, organet tatimore, organet doganore, komisaritet e policisë, zyrat e përmbarimit, shërbimin e provës, administratën e burgjeve, ministrinë, etj.

E rëndësishme është të theksohet se avokati nuk duhet të japë asnjëherë garanci që gjyqi do të fitohet, që e drejta do të realizohet, që shkelja do të eliminohet, që kontrata do të lidhet, që marrëveshja do të mbyllet, e të tjera të ngjashme me to. Avokati duhet të bëjë të qartë për klientin se çfarë strategjie do të ndiqet, çfarë alternativash ka për mbrojtjen, çfarë pritet ligjërisht nga kjo çështje, me qëllim që klienti të mos zhgënjehet dhe të mos e shikoj avokatin si shkak të humbjes së tij apo të mos realizimit të asaj që priste nga ky shërbim.

Avokati duhet të jetë ndershmërisht i hapur për të dhënë përgjigjen që në fillim për një veprim që nuk ka sukses, nëse mbrojtja është haptazi e panevojshme nga pikëpamja ligjore. Për shembull, nëse klienti kërkon të hapë një proces gjyqësor për shpërblimin e dëmit, kur ka mbi 6 vjet nga kryerja e tij dhe kur ka pasur dijeni, si për dëmin, ashtu dhe për personat që kanë shkaktuar atë, duhet t'i jepet përgjigja që kjo çështje nuk mund të fitohet, sepse afati i parashkrimit të kësaj padie ka skaduar prej tre vjetësh⁴³.

Strategjia paraprake e mbrojtjes e ndihmon edhe palën të jetë më e qartë për atë që pritet, por edhe avokatin që të jetë më i qartë për atë për të cilën do të luftojë dhe mënyrën e realizimit të kësaj “fitore” profesionale.

2.1.2. Kontrata e porosisë dhe kushtet e saj

(A) Objekti i kontratës së porosisë

Shërbimi i Avokatisë në Republikën e Shqipërisë konsiston në kryerjen e të gjitha veprimeve juridike, të interesit të publikut, që ka nevojë për asistencë ligjore. Ky shërbim i cili do të jetë objekti i kontratës së porosisë mund të ofrohet në një nga format apo mënyrat e parashtruara në drejtimet e mëposhtme:

(a) Këshillimi me karakter juridik të përkohshme dhe spontane apo me klientelë

⁴³ Shihni nenin 115, shkronja dh) të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

- të rregullt, në mënyrë periodike apo të vazhdueshme;
- (b) Përpilim aktesh, kontratash dhe dokumentacioni tjetër që lidhet me fazën para-kontraktore, si dhe korrespondencën e palëve gjatë ekzekutimit të kontratës;
 - (c) Studim i dosjeve dhe dokumentacionit që lidhet me një çështje juridike;
 - (d) Mbrojtje dhe përfaqësim juridik në fazën e hetimit nga prokuroria;
 - (e) Përfaqësim gjyqësor në shkallën e parë të gjykimit;
 - (f) Përfaqësim gjyqësor në Gjykatën e Apelit;
 - (g) Përfaqësim gjyqësor në Gjykatën e Lartë, i cili mund të bëhet vetëm nga avokatët që kanë mbi 20 vjet punë si jurist;
 - (h) Përfaqësim gjyqësor në Gjykatën Kushtetuese;

Edhe ligji për avokatinë, në nenin 2 të tij, parashikon se avokati i jep klientëve të tij ndihme juridike. Listimi i veprimeve që mund ose duhet të kryejë avokati, brenda kryerjes së shërbimit të tij, janë:

- i. këshillimi ligjor për çështje të ndryshme;
- ii. përgatitja e kërkesëpadive ose të kërkesave gjatë procedimit penal, si dhe të kërkesave ankimore, rekurseve kundër vendimeve gjyqësore, atyre të organit të prokurorisë, arbitrazhit ose të organeve të administratës publike;
- iii. përgatitja e kërkesave drejtuar Gjykatës së Apelit, Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese, gjykatave ndërkombëtare dhe çdo organizmi në të cilin aderon Republika e Shqipërisë;
- iv. përgatitja e ankesave dhe kërkesave të personave fizike ose juridike;
- v. përpilimit të akteve që i nënshtrohen veprimeve noteriale;
- vi. hartimi i kontratave e të marrëveshjeve, si dhe të çdo dokumenti tjetër që sjell ose synon të sjellë pasoja juridike;
- vii. prania si mbrojtës në kohën e shoqërimit, ndalimit, arrestimit, gjatë procesit të hetimit, shqyrtimit gjyqësor të personave në çështjet penale;
- viii. përfaqësimi i personave fizike ose juridike në çështjet civile dhe administrative, në gjykatë, në arbitrazh dhe në organe të tjera të administratës publike;
- ix. veprime të tjera të ndihmës juridike që parashikohen në ligj.

Kuptohet që kontrata e porosisë avokat-klientë mund të ketë një ose disa nga veprimet e mësipërme në objektin e saj, por pavarësisht nga kjo veprimi duhet të specifikohet me kujdes dhe të artikulohet në mënyrë të qartë kufijtë e kryerjes së porosisë dhe pritshmëritë e saj.

(B) Të drejtat dhe detyrimet e avokatit

Avokati ka të drejtë që, në përputhje me procedurat hetimore, të marrë pjesë

në proces, të pyesë personin e mbrojtur prej tij, dëshmitarët dhe ekspertët, të lexojë dhe të njohë në përfundim të hetimit të gjitha aktet e dokumentet që janë të lidhura me çështjen dhe t' i nënshkruajë ato. Avokatit i ndalohet të bëjë publike të dhënat, që i ka mësuar nëpërmjet personit të mbrojtur ose të përfaqësuar prej tij ose nga dokumentet që ky i fundit i ka vënë në dispozicion, në funksion të mbrojtjes së kërkuar, me përjashtim të rastit kur ai ka dhënë miratimin e tij me shkrim. Avokatët, që ushtrojnë profesionin e tyre pranë së njëjtës zyre avokatie, prezumohet se janë në dijeni dhe zotërojnë dokumentet për këdo që është mbrojtur apo përfaqësuar nga zyra e tyre.

Avokati ka për detyrë ta ushtrojë profesionin e vet me ndershmëri dhe dinjitet, të respektojë rregullat e etikës profesionale dhe të përdorë të gjitha mjetet e ligjshme për mbrojtjen me besnikëri të të drejtave dhe të interesave të personave që mbrohen ose përfaqësohen prej tij.

Avokati duhet të sigurojë që asnjë konflikt interesash nuk ekziston ndërmjet tij dhe personit që mbron ose përfaqëson. Avokatit i ndalohet të marrë pjesë në një çështje, kur ai ka qenë i ngarkuar më parë në të si gjykatës, prokuror, oficer i Policisë Gjyqësore ose si dëshmitar. Avokati nuk lejohet të japë ndihmë ligjore ose të përfaqësojë një person, kur ka këshilluar ose ka përfaqësuar me parë palën kundërshtare në të njëjtën çështje, ose kur avokati ka lidhje gjaku apo ka interes të njëjtë me palën kundërshtare.

Në ndryshimet e bëra me ligjin 91/2012 parashikohet se avokati nuk duhet të japë mbrojtje ligjore edhe kur ka këshilluar, përfaqësuar ose ka pasur të bëjë në mënyrë tjetër profesionale me një palë tjetër në të njëjtën çështje. Avokatët, që shërbejnë në të njëjtën zyre avokatie, nuk lejohen të përfaqësojnë palët kundërshtare në të njëjtën çështje. Përveç rasteve të parashikuara në ligj, avokati është i detyruar të sigurohet se nuk vepron në konflikt me interesat e personit që mbrohet ose përfaqësohet prej tij. Kur avokati dyshon se është duke vepruar në konflikt interesash, ai duhet të marrë miratimin me shkrim nga palët të cilat mendohet se preken nga ky konflikt interesash.

Po në këto ndryshime ligjore parashikohet se avokati, në rastin e pengesës së shkaktuar nga konflikti i interesit i shfaqur në një nga format e parashikuara ligjore, për aq kohë sa zgjat ajo, me pëlqimin e personave që mbrohen ose përfaqësohen prej tij, mund të caktojë një zëvendësues, i cili ushtron të drejtat dhe merr përsipër detyrimet e avokatit. Klienti duhet të japë pëlqimin për caktimin e një zëvendësuesi, pëlqim ky që mund të jepet në aktin e përfaqësimit.

Avokatit i ndalohet të bëjë kallëzim në organin e ndjekjes penale dhe nuk mund të pyetet si dëshmitar për personin, të cilit i ka kryer shërbime dhe ndihmë

juridike, si dhe për rrethanat që ai i ka mësuar gjatë ushtrimit të profesionit të avokatit.

Avokatët, në përputhje me dokumentacionin standard, të miratuar nga Këshilli Drejtues i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, duhet të mbajnë një libër shënimesh ku shënohen të gjitha shërbimet ligjore të dhëna, kontratat, me shkrim, duke përdorur sistemin numerik, emrin e tij, si dhe emrin e zyrës së avokatisë.

Në nenin 46/1 të ligjit 91/2012, parashikohet se në rast se avokati shkel detyrimet ligjore dhe dënohet me ndonjë masë disiplinore, atëherë Komiteti disiplinor mund të urdhërojë avokatin që të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për zgjidhjen e problemit në fjalë dhe t'i kompensojë dëmin e shkaktuar ankuesit ose palëve të tjera të dëmtuara nga veprimet ose mosveprimet e tij, në masën që çmohet e drejtë nga komiteti disiplinor.

(C) Shpërblimi i avokatit

Shpërblimi, si rregull caktohet sipas marrëveshjes së arritur prej tij me klientin dhe është pjesë e kontratës së porosisë. Megjithatë ligji parashikon se shpërblimi i avokatit për punën e kryer mund të caktohet në një nga mënyrat e mëposhtme:

- me marrëveshje ndërmjet tij dhe palës së mbrojtur ose të përfaqësuar prej tij;
- nga gjykata ose prokuroria, kur ai është caktuar kryesisht ose kur personi i mbrojtur ose i përfaqësuar nuk ka mundësi financiare dhe ndihma ligjore për të është falas.
- Masa e shpërblimit për këto raste përcaktohet me vendim të përbashkët të Ministrisë të Drejtësisë dhe Këshillit Drejtues të Dhomës Kombëtare të Avokatisë⁴⁴;
- me ligj.

Në të gjitha rastet, avokatit nuk i lejohet të marrë shpërblim tjetër. Si rregull, avokati nuk mund të kërkojë nga personi që mbron ose përfaqëson, që të shpërblehet prej tij me përqindje gjatë procesit të gjyqimit. Si rast përjashtimor, shpërblimi me përqindje, i parallogaritur ose jo, mund të paguhet vetëm kur është parashikuar në marrëveshjen ndërmjet avokatit dhe personit që ai mbron ose përfaqëson, për rastin mbrojtjes apo përfaqësimit të suksesshëm të çështjes, ajo që në gjuhën ndërkombëtare quhet *“success fee”*.

⁴⁴ Sipas nenit 3 të ligjit 91/2012 për ndryshimet në ligjin mbi avokatinë, parashikohet se Ministri i Drejtësisë dhe Kryetari i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, pasi marrin mendimin e Ministrisë së Financave, caktojnë tarifën e shpërblimit të avokatëve për dhënien e ndihmës juridike, të cilat zbatohen kur nuk ka marrëveshje të ndryshme me shkrim mes avokatit dhe personit të mbrojtur ose të përfaqësuar prej tij dhe kur ndihma juridike nuk është dhënë sipas dispozitave për ndihmën juridike.

Avokatit i lejohet të paguhet me komision në rastet kur siguron kthimin e huas për personin që mbrohet ose përfaqësohet prej tij jogjyqësisht.

(Ç) Afati i kontratës

Marrëveshja avokat-klient e veshur në formën e saj kontraktore apo e veshur në formë prokure, mund të jetë **me afat** ose **pa afat**. Afati është një kusht tipik, atëherë kur lidhet me kryerjen e një veprimi juridik që është i ndryshëm nga përfaqësimi gjyqësor i çështjeve gjyqësore civile penale apo administrative, Kjo për faktin se kohëzgjatja e gjykimit të një çështje gjyqësore në shkallë të ndryshme të gjyqësorit është e papërcaktuar. Përfundim bën fakti që një çështje në Apel dhe një çështje në Gjykatën e Lartë e në atë Kushtetuese ka si rregull vetëm një seancë përfaqësimi. Megjithatë edhe në këto raste kohëzgjatja e pritjes së çështjes në radhë për t'u gjykuar është e papërcaktuar. Kjo bën që kontratat apo prokurat e posaçme që lidhen me përfaqësimin dhe mbrojtjen në proceset gjyqësore të jenë kryesisht pa afat.

Me afat janë si rregull përfaqësimet për kryerjen e veprime të ndryshme juridike që lidhen me negociatat parakontraktore dhe kontraktore, dorëzime dokumentacionesh pranë organeve të administratës publike, aplikime pranë zyrave të ZRPP, përmbarimit, tatim taksave, etj. Shpesh herë këto marrëdhënie avokat-klient parashikojnë edhe afate zgjidhës, me skadimin e të cilave humbet fuqitë juridike vetë përfaqësimi kontraktor ose ai me prokurë/autorizim.

(D) Revokimi apo zgjidhja e kontratës

Nëse personi, që përfiton ndihmën juridike nga avokati, vendos të zgjidhë kontratën përpara përfundimit të çështjes ose shërbimit, avokati ka të drejtën të kërkojë shpërblimin për punën e kryer.

(DH) Garancitë për cilësinë e mbrojtjes juridike me anë të avokatit

Marrëdhënia avokat-klient duhet të karakterizohet nga siguria juridike, e cila shprehet në dy drejtime: (1) siguria në dhënien e shërbimit në zbatim të plotë të ligjit dhe me nivelin e duhur të njohurive juridike, por nga ana tjetër, (2) edhe siguria në dhënien e shërbimit për të cilin jepen garancitë profesionale. Kjo siguri garantohej edhe nga ligji, por mund të garantohej edhe nga vetë kontrata. Në kontratë mund të gjejnë vend si dispozitat që rregullojnë e vendosin garancitë që janë të parashikuara me ligj, ashtu edhe garancitë e shtuara nga palët me kontratën e porosisë. Të parat paraqiten në formën e kushteve të zakonshme, që edhe po nuk u vunë shprehimisht në kontrata, prezumohen të mirëqena, sepse i

parashikon ligji, ndërsa të dytat paraqiten në formën e kushteve të rastit që palët i vendosin vetë. Edhe këto të dytat kanë forcën e ligjit për palët.

Garancitë ligjore: Lidhja e kontratës së sigurimit. Ndryshimet e reja të ligjit për avokatinë kanë parashikuar se avokati duhet të lidhë kontratë sigurimi me një shoqëri sigurimi për të mbuluar në çdo rast humbjet që mund t'i vijnë klientit nga veprime apo rrethana që lidhen me dhënien e shërbimit nga ana e tij. Më konkretisht, me ndryshimet e bëra në ligjin për avokatinë në vitin 2012 parashikohet edhe detyrimi që “Avokati duhet të lidhë kontratë sigurimi për të garantuar përgjegjësinë e tij ndaj palëve të treta, për shkak të ushtrimit të veprimtarisë së tij”⁴⁵.

DHKA ka parashikuar dy mundësi praktike për sigurimin e marrëdhënies dhe të objektit të kontratës për dhënien e shërbimit të avokatisë:

- Sigurimi në mënyrë individuale nga çdo avokat apo zyrë avokatie dhe,
- Sigurimi kolektiv nga ana e DHKA për avokatët në përgjithësi.

Ndër garancitë ligjore mund të përmendim edhe procedimet disiplinore dhe penale në rast se avokati me veprimet dhe mosveprimet e tij shkel ligjin dhe cenon interesat e klientit të tij

Procedimi disiplinor. Në ndryshimet e bëra me ligjin 91/2012 parashikohet se nëse avokati ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore procedurale që rregullojnë veprimtarinë e avokatit, duke cenuar rëndë ose në mënyrë të përsëritur procesin e rregullt ligjor, si dhe kur ka kryer akte dhe sjellje të rënda që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e avokatit, avokati i nënshtrohet procedimit disiplinor dhe do të nisin procedurat disiplinore.

Procedimi penal. Kur veprimet e avokatit plotësojnë kushtet e kryerjes së një vepre penale, atëherë fillon ndjekja penal. Në rast të procedimeve penale, që lindin nga të njëjtat rrethana si rrethanat që çojnë në procedim disiplinor, procedimi disiplinor pezullohet dhe afati kohor shtyhet deri në përfundim të procedimit penal dhe çdo dënim penal pranohet në procedimin disiplinor. Ankesat kundër avokatit mund të paraqiten nga çdo person që mbrohet, përfaqësohet ose ndihmohet juridikisht prej tij apo person i interesuar, ashtu sikundër edhe nga përfaqësuesit e institucioneve të parashikuara me ligjin për avokatinë. Ankesat mund të bëhen brenda gjashtë muajve nga data e sjelljes ose veprimit të avokatit apo nga data e konstatimit të sjelljes ose veprimit të avokatit, por, në çdo rast, jo më vonë se një vit nga momenti i kryerjes së shkeljes.

Dëmshpërblimi. Në rast se nga veprimet e avokatit shkaktohet një dëm,

⁴⁵ Për hollësiara, shihni pikën 11, (të shtuar) në ligjin nr. 91 /2012.

atëherë klienti ka të drejtë të pretendojë shpërblimin e tij, jo vetëm përmes procedimit civil, por edhe vetë Komiteti disiplinor që ka nisur procedurat disiplinore mund të urdhërojë avokatin që të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për zgjidhjen e problemit në fjalë dhe t'i kompensojë dëmin e shkaktuar ankuesit ose palëve të tjera të dëmtuara nga veprimet ose mosveprimet e tij, në masën që çmohet e drejtë nga Komiteti disiplinor⁴⁶.

Garancitë kontraktore. Palët në kontratën e porosisë mund të parashikojnë garanci kontraktore, të tilla si:

- kushte penale, në rast tërheqje, në rast të mosparaqitjes në seancat gjyqësore pa shkaqe të arsyeshme, në rast të shkeljes së elementëve proceduralë dhe të kodit etik, etj.
- kthimi i pagesës apo i një pjese të saj në mënyrë proporcionale me moskryerjen e shërbimit apo kryerjen e pjesëshme të tij.
- penalitete në formën e gjobave për rastet e tërheqjes nga mbrojtja pa shkaqe të arsyeshme.
- dëmshpërblime të paracaktuar për moskryerjen e detyrimeve të specifikuar në kontratën e porosisë etj.

2.1.3. Dallimi i kontratës së porosisë nga prokura për përfaqësimin gjyqësor apo juridik

Marrëdhënia Avokat-Klient mund të rregullohet krahas kontekstit të saj kontraktor edhe përmes institutit të përfaqësimit si rregull, me anë të një **prokure të posaçme**. Kufijtë e përfaqësimit me anë të një prokure të posaçme mund të lidhen me përfaqësimin e interesave të palëve në:

- një çështje gjyqësore në një, disa ose të gjitha shkallët e gjykimit, duke filluar me gjykatën e shkallës së parë, atë të Apelit, Gjykatën e Lartë, atë Kushtetuese dhe duke vijuar deri në përfaqësimet para GJEDNJ-së në Strasburg;
- procedurat administrative përpara organeve të administratës publike;
- procedurat e ndërmjetësimit apo të arbitrazhit kombëtar ose ndërkombëtar;
- procedurat me natyrë tregtare përpara subjekteve private vendas dhe të huaj;
- ndjekjen e procedurave përmbarimore për ekzekutimin e detyrueshëm që mund të burojë nga një titull ekzekutiv apo vendim gjykate a arbitrazhi, etj.;
- fazën parakontraktore lidhur me negociatat për lidhjen e një kontrate;
- lidhjen dhe ekzekutimin e kontratave, në emër e për llogari të klientit;
- çështjet me natyrë trashëgimore që kanë të bëjnë me çeljen e dëshmimeve

⁴⁶ Për hollësi, shihni nenin 46/1 të ligjit 91/2012, i cili parashikon se në rast se avokati shkel detyrimet ligjore dhe dënohet me ndonjë masë disiplinore, atëherë komiteti disiplinor mund të urdhërojë dëmshpërblimin e klientit për dëmet e shkaktuara nga veprimet apo mosveprimet e avokatit.

ligjore e testamentare, çeljen e testamenteve, inventarizimin e pasurisë trashëgimore, etj.;

- rastet e bashkëpronësisë për pjesëtimet e pronave/sendeve;
- e të tjera të ngjashme me to.

Në raste më të rralla praktikohet **prokura e përgjithshme** dhe kjo ndodh atëherë kur klienti është në pamundësi fizike për të operuar në vendin ku ndodhen pasuritë e tij, sepse p.sh jeton jashtë shtetit. Në rastin e një prokure të përgjithshme klienti e ngarkon avokatin të kujdeset për çdo përfaqësim të mundshëm në të mirë të interesave të tij pasurore e jopasurore. Prokura e përgjithshme është më e rrallë në praktikën juridike, sepse ajo mbart në vetvete riskun e tejkalimit të kufijve të përfaqësimit, si dhe matjen e elementi subjektiv kur ndërmerren veprime juridike “në të mirë të klientit”. Në momenti që klienti konstaton se veprimet e kryera nuk janë në të mirë të tij, ai ka të drejtë të kërkojë pavlefshmërinë e tyre dhe shfuqizimin e prokurës. Pavarësisht nga lloji i prokurës, në të gjitha këto raste do të zbatohen rregullat e përfaqësimit dhe pasojat e parashikuara në Kodin Civil. Prokura do të bëhet gjithmonë me akt noterial.

Në raste përjashtimore pranohet edhe përfaqësimi i interesave të personave juridik, duke u bërë **autorizim zyrtar** nga titullari i institucionit, publik ose privat, fitimprurës ose jofitimprurës, ku ngarkohet një punonjës apo avokat që të përfaqësojë interesat në një proces gjyqësor apo në kryerjen e një veprimi juridik. Në rastin e autorizimit ai është konkret dhe i specifikuar për një veprim të caktuar. Rastet e një autorizimi të përgjithshëm dhe pa kufij të përfaqësimit ligjor janë pothuajse të pamundura.

Heqja dorë nga përfaqësimi. Nëse avokati vendos të heqë dore nga përfaqësimi ose mbrojtja e mëtejshme e një personi, është i detyruar ta njoftojë atë 15 dite përpara mbarimit të shërbimit nga ana e tij. Avokati është i detyruar t'i shërbejë klientit të tij gjatë periudhës 15-ditore para mbarimit të shërbimit dhe t'i njoftojë atij çdo të dhënë për çdo shumë parash, prona apo kompensim që avokati mban për klientin. Brenda 15 ditëve nga dhënia e njoftimit, avokati duhet t'i kthejë klientit të gjitha dokumentet e lidhura me çështjen ose t'i dërgojë ato në adresën e treguar nga avokati i ngarkuar rishtas. Gjithashtu, avokati është i detyruar t'i kthejë klientit parapagimin që ka marrë prej tij, përveç kur, bashkërisht, merren vesh ndryshe.

Deklarimi në seancën gjyqësore për mbrojtje gjyqësore. Ka raste kur klienti deklaron publikisht se dëshiron që interesat e tij do të mbrohen nga një avokat konkret. Kjo deklaratë gjen zbatim vetëm në përfaqësimet në seancat gjyqësore dhe gjen pasqyrim në procesverbalin e seancës gjyqësore. Deklarimi

ka pasoja të njëjta juridike, me prokurën apo autorizimin. Deklarimi në seancë gjyqësore është karakteristikë për gjykimet në shkallë të parë dhe në apel. Ndërsa në Gjykatën e Lartë dhe në Gjykatën Kushtetuese duhet të operohet me përfaqësimin me anë të prokurës apo autorizimit. Po ashtu, edhe në Gjykatën e të Drejtave të Njeriut në Strasburg.

Caktimi i avokatit kryesisht. Për sa i takon *aksesit në drejtësi*, legjislacioni shqiptar garanton *mbrojtje ligjore falas* për të pandehurit që nuk kanë mundësi për avokat privat, por ky shërbim jo gjithmonë ofron asistencë ligjore të përshtatshme dhe në kohë⁴⁷. Në disa raste të mirë përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, ndihma nga një mbrojtës është e detyrueshme. Kjo e rrit më shumë përgjegjësinë e shtetit dhe të institucioneve të avokatisë për ta realizuar këtë mision në mënyrë sa më profesionale. E themi këtë jo sepse kjo nuk është e rëndësishme kur avokati zgjidhet nga palët, por kur ai caktohet kryesisht ka një përgjegjësi edhe më të gjerë⁴⁸.

2.2. Tarifimi

Meqenëse ky manual nuk është komentari i zakonshëm i rregullave të procedurës civile, por një udhëzues i praktikave më të mira të profesionit të avokatit, në të do të gjendet edhe ky kapitull i pazakontë për komentarët e mëparshëm, por i domosdoshëm për të njohur një aspekt veçanërisht të rëndësishëm të profesionit të avokatisë. Të gjitha vlerësimet, sugjerimet apo refleksionet që keni lexuar këtu dhe që do të vijoni të lexoni më poshtë në lidhje me detyrimet e natyrës etike në profesionin e avokatit, në të vërtetë do të ishin thjesht ushtrime teorike po qe se avokatia nuk do të ishte, ne fakt, një aktivitet profesional që në shumicën dërrmuese të rasteve ka për qëllim “fitimin” që avokati profesionist synon të krijojë për shkak të shërbimit që ofron.

Nisur nga kjo premisë, kushdo që ushtron profesionin e avokatit duhet të kujdeset në mënyrë të veçantë edhe për tarifat e punës së tij. Në marrëveshjen që avokati bën me klientin e tij, ndër të tjera, edhe çështja e tarifave ka një vend kryesor. Pavarësisht se avokatia në Shqipëri, për shkak të fazës së veçantë të zhvillimit kulturor dhe institucional, nuk është vlerësuar tërësisht si një shërbim që duhet të gjëjë një rregullim të plotë edhe në kuptimin ekonomik. Klienti, ndër të tjera, do t'i drejtojë avokatit pyetje të shumëllojshme në lidhje me atë që ai duhet të paguajë për shërbimet e që do t'i ofrohen, ndërsa ky i fundit do të

⁴⁷ Progres report i Komisionit Evropian 2005/561.

⁴⁸ Neni 35 i Kodit të Procedurës Penale parashikon ndihmën ligjore që i jepet një të pandehuri të mitur. Neni 49/2 i po këtij Kodi parashikon se kur i pandehuri është nën 18 vjeç atëherë mbrojtja e tij është e detyrueshme.

duhet t'i përgjigjet këtyre pyetjeve. Me qellim informimin e avokatit në dhënien e përgjigjeve sa më të kënaqshme si për të ashtu edhe për klientin, mendojmë që në këtë pjesë të sjellim një sërë mendimesh që lidhen me pikëpamjet më bashkëkohore në lidhje me tarifimin e shërbimeve avokatore, me mbrojtjen që duhet të gëzojnë konsumatorët në marrjen e këtyre shërbimeve, si dhe mbi modelet kryesore të ndërtimit të tarifave.

Ky udhëzues është i orientuar për të përshkruar kryesisht çështje që lidhen me shërbimet e përfaqësimit gjyqësor e atij paragjyqësor në fushën civile. Por, në rastin e trajtimit të çështjes së tarifave të shërbimeve, na duket shumë kufizuese të flasim vetëm për tarifën e këtyre lloj shërbimeve e për pasoje, do të tentojmë të trajtojmë çështjen e tarifave në një këndvështrim më të gjere, pasi mendojmë se kështu japim një udhëzim më të plotë për ata që nisin rishtazi praktiken juridike private.

Gjithkush tashmë e kupton se për të patur shërbime të mira në fushën e drejtësisë duhet të këshillohet me një profesionist të kësaj fushe. Në të vërtetë, kostot për të aksesuar drejtësinë shkojnë përtej kostove të shërbimeve avokatore duke u shtuar me kosto të tjera. Për këtë arsye, avokati duhet që të ndërgjegjësojë klientin e tij, jo vetëm për kostot e shërbimeve avokatore, por mundësisht edhe për kostot e tjera që ai do të duhet të përballë në procedurat ligjore. Nëse nuk do të bëhet kujdesi i duhur për sqarimin e këtyre ndarjeve, do të ndodhë rëndom që klientët të mos kuptojnë drejt se çfarë mbulon apo nuk mbulon tarifa e propozuar, dhe eventualisht e pranuar prej tyre që në fillim.

2.2.1. Liria dhe kufizimi në përcaktimin e tarifës së shërbimit

Shërbimet e avokatëve janë të ngritura mbi disa parime shumë të rëndësishme për të cilat është folur në kapitujt e mëparshëm. Autonomia profesionale, intelektuale, përgatitja profesionale, vetë rregullimi i këtij komuniteti (brenda normave të rendit publik të Republikës së Shqipërisë), ndershmëria, dinjiteti, besnikëria, etj., janë të gjitha këto aspekte që gjejnë pasqyrimin e tyre në çështjen e tarifave të shërbimeve avokatore. Në radhë të parë, një profesionist tek i cili janë të mishëruara të gjitha këto cilësi, është e pritshme që të paguhet për punën e tij. Nga ana tjetër raporti i pagesës me punën, duhet të jetë edhe ky i ndërtuar në zbatim të këtyre parimeve. Kur themi këtë, nuk duhet të fshehim faktin se shërbimet avokatore, edhe vetë brenda sferës së shërbimeve, janë të njohura botërisht si shërbime, kostoja e të cilave është veçanërisht e vështirë për t'u vlerësuar. Po që se do t'ju duhet të drejtoni një biznes avokatie, individual apo kolektiv, do të kuptoni se sa e vështirë është të vini çmimin e punës tuaj.

Sa orë në ditë mund të punoni? A jeni në gjendje të paguani stafin tuaj për orët jashtë orarit? Sa kushtojnë mjetet tuaja të punës? Sa duhet të udhëtoni këtë muaj me qëllim që të ndiqni të gjitha çështjet tuaja? Sa do shpenzoni për të kryer këto udhëtime?

Po të isha këshilltari financiar i një avokati do t'ju bëja edhe pyetje të tjera për të përcaktuar koston e shërbimeve tuaja, por nuk është ky qëllimi. Këto pyetje, por edhe të tjera si këto, shtrohen apo duhet të shtrohen sa herë që do të diskutoni çështjen e tarifës së punës tuaj me klientin tuaj. Kur thamë se kostoja e shërbimeve të avokatisë është veçanërisht e vështirë për t'u përcaktuar kemi parasysh faktin se duhet të jesh profesionist i kësaj fushe, për të njohur në radhë të parë punën që parashikohet të kryhet dhe rrjedhimisht edhe volumin e angazhimit tuaj profesional. Duke u nisur nga kjo premisë, çështja e parë që ngrihet, e lidhur ngushtë me aspektin etik të profesionit, është detyrimi për t'i bërë të ditur klientit tuaj kostot reale të shërbimeve tuaja, pa mbajtur kosto të fshehura në ofertën tuaj financiare. Ky detyrim i etikës profesionale është edhe një aspekt themelor i konkurrencës së ndershme.

Nëse kostot e shërbimeve avokatore janë deformuar për të mundësuar përfundimin e një marrëveshje me klientin, kjo pa diskutim ka deformuar edhe rregullat e konkurrencës së ndershme. Ashtu siç u përmend me sipër, këto diskutime duken ende të parakohshme për mjedisin juridik shqiptar, por fakti është se janë çështje që kanë qenë në themel të reformave rregullatore të profesioneve të lira në të gjithë hapësirën Evropiane në 5 vitet e fundit. Ato janë bërë tashmë, njëherazi, edhe pjesë thelbësore e rregullave etike të profesioneve të lira.

Nisur nga njohja dhe ballafaqimi i këtyre praktikave, një sugjerim që mendojmë se është shumë i shëndetshëm për raportin më të mirë klient-avokat është ajo që, marrëveshja për shërbimet juridike e cila përmban edhe detajet e tarifës së shërbimeve avokatore, këshillohet të përfundohet me shkrim. Nëse kjo marrëveshje është negociuar ndershmërisht dhe në mënyrë transparente, përfundimi i saj me shkrim është garanci për praktikën e ndershme ligjore. Ndërkohë në legjislacionin në fuqi, ky nuk është një detyrim, pasi nenet 11 – 12 të ligjit Nr.9109, datë 17.7.2003 Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë,⁴⁹ i ndryshuar, parashikojnë lirinë për të përcaktuar tarifën por jo formë të detyrueshme për marrëveshje.

⁴⁹ 1. Shpërblimi i avokatit për punën e kryer caktohet në një nga mënyrat e mëposhtme:

a) me marrëveshje ndërmjet tij dhe palës së mbrojtur ose të përfaqësuar prej tij;

b) nga gjykata ose prokuroria, kur ai është caktuar kryesisht ose kur personi i mbrojtur ose i përfaqësuar nuk ka mundësi financiare dhe ndihma ligjore për të është falas.

Masa e shpërblimit për këto raste përcaktohet me vendim të përbashkët të Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit Drejtues të Dhomës Kombëtare të Avokatisë;

c) me ligj.

Këto konsiderata na ndihmojnë pa dyshim të kuptojmë më shumë se cilat janë mundësitë për të strukturuar tarifën e duhur për shërbimin avokator të ofruar. Në të vërtetë, referuar kulturës së vendeve që janë dalluar për zbatimin parimeve më liberale në fushën ekonomike, do të gjejmë tashmë praktika të përcaktuara për modelet e tarifave, por që gjithsesi, lejojnë mundësinë e kombinimit të tyre në raport me çdo rast konkret. Megjithatë edhe në praktikën avokatore vlen rregulli se tarifa më e mirë është ajo që klienti është i gatshëm ta paguajë.

Për këtë arsye po prezantojmë fillimisht disa modele të cilat janë të mirënjohura për aplikimin e tyre. Këto janë tarifa për t'u aplikuar kryesisht kur avokati merr përsipër kryerjen e një shërbimi rastësor dhe jo afatgjatë për klientin, ndërkohë që për tarifat në rastet e bashkëpunimeve afatgjata do të flasim më poshtë. Për t'u orientuar po i rendisim më poshtë:

- a. tarifa orare;
- b. tarifa e sheshtë;
- c. parapagimi;
- d. tarifa sipas rastit;

2.2.2. Tarifa orare

Tarifa orare është në fakt tarifa më e përdorshme në nivel global. Ajo parashikon pagesën e një ore punë të avokatit. Pavarësisht faktit që kjo lloj tarife në tërësi ka zhvillimin më të gjerë, në kushtet aktuale të zhvillimit të tregut të shërbimeve avokatore në Shqipëri, ajo has vështirësi të veçanta në aplikimin e saj. Në çdo rast që do të propozoni aplikimin e kësaj tarife pa dyshim do t'ju kërkojnë të parashikoni edhe sa orë pune parashikoni të shpenzohen për të kryer shërbimet e nevojshme. Për këtë shkak duhet të merrni masat për përgatitjen një preventiv ku të jetë parashikuar në terma të përgjithshme, angazhimi i pritshëm për kryerjen e shërbimit.

Që të përcaktosh një tarifë, qoftë edhe atë orare, në radhë është e domosdoshme që të njihet në detaje strategjia dhe hollësitë e shërbimeve që janë të nevojshme për të dhënë asistencën në rastin konkret. Praktikisht, ajo që klienti do t'ju kërkojë është që t'i përcaktoni edhe numrin e orëve që parashikoni të shpenzoni për shërbimet që i duhen atij, duke kërkuar që kjo të kthehet pak a shumë në një tarifë të sheshtë. Megjithatë, tarifa orare është e këshillueshme të propozohet dhe të aplikohet kur volumi i punës është vështirë të llogaritet përtej një niveli të arsyeshëm. P.sh. nëse do të duhet të bëni hetimin e aktivitetit tregtar të një shoqërie, përpara shitjes së disa pjesëve të kapitalit (*due diligence report*) të një shoqërie tregtare, do ta keni pothuajse të pamundur të shpreheni paraprakisht për volumin e punës që do t'ju duhet të bëni, pasi në shumë raste do t'ju duhet

të konsultoni dokumente që më lehtë është të maten me kilogramë.

Përgatitja e kësaj tarife për klientin, është e lidhur pa diskutim me kriteret e ndershmërisë dhe transparencës, pasi në këtë marrëdhënie është e qartë se avokati është në një pozitë negociuese të posaçme. Kjo pasi ai duhet jo vetëm të sugjerojë veprimet e dobishme për interesat e klientit, por duhet gjithashtu të kujdeset që këto veprime të jenë sa më ekonomike për klientin e tij. Në këtë negociim klienti duhet të ndihet i qetë në lidhje me faktin se atij po i sugjerohet një rrugë veprimi sa më pak e kushtueshme. Ky negociim është delikat pasi përballë avokatit si klient nuk është një organizatë që ka burimet e nevojshme njerëzore për të kontrolluar dhe vlerësuar ofertën e tij të tarifimit, por është thjesht një individ që ka nevojë urgjente për shërbime juridike dhe aq me tepër, me një buxhet që përbëhet vetëm nga kursimet e tij.

2.2.3. Tarifa e sheshtë

Tarifa e sheshtë është tarifa që, në negociatat për marrëveshjen mes avokatit dhe klientit do të kërkohet më shpesh nga klientët. Ajo që klientët në përfundim duan të dinë është sa i kushton në tërësi ndihma e avokatit. Në rastin e aplikimit të tarifës së sheshtë është më i hasur keqkuptimi se shumica e propozuar nga avokati përfshin brenda edhe tarifën që duhen paguar si taksa gjyqësore, shpenzime për përkthime, njehsime të dokumenteve nga noterët publik, kosto transporti, taksa apo tarifa shtetërore për shërbimet në drejtësi etj. Kjo ndodh sepse klienti mesatar nuk i percepton këto çështje. Ky lloj klienti, në shumicën e rasteve nuk ka informacionin e duhur se çfarë kostosh kanë shërbimet publike në ofrimin e drejtësisë, prandaj nuk është në keqbesim kur pandeh se shumica që i propozon avokati, i përfshin të gjitha këto shpenzime.

Për këtë arsye, transparenca e tarifës është një aspekt thelbësor i sjelljes etike të avokatit. Në eksperiencën ndërkombëtare, ku publiciteti për shërbimet avokatore është më i liberalizuar dhe ku avokatëve u lejohej të publikojnë prezantime të cilat konkurrojnë edhe me çmimet e propozuara për shërbime konkrete, është vënë re se këto prezantime janë shpesh devijuese. Institucionet që mbrojnë interesat e konsumatorëve kanë vënë re se, publikimi i tarifave fikse ka qenë zhgënjyes për ata klientët të cilët kanë besuar se do të merrnin të gjithë ndihmën dhe aksesin e nevojshëm në drejtësi me pagesën e tarifës së publikuar dhe gjatë zhvillimit të procedurave ligjore, ato kanë zbuluar se duhet të ndërmerrnin kosto shtesë të cilat ishin vështirë të përballoheshin prej tyre. Ndaj avokati që i ka publikuar çmimet e shërbimeve të veta si në menynë e një restoranti nuk është avokati ku një klient duhet të drejtohet.

Duke marrë në konsideratë natyrën e kësaj tarife, ajo këshillohet të përdoret kryesisht në rastet kur shërbimet që do të ofrohen janë të një natyre jo shumë komplekse ose janë nga ato shërbime të cilat mund të vlerësohen me një saktësi relativisht të lartë në lidhje me angazhimin kërkues. Kjo varet edhe nga fusha e ekspertizës së një avokati. Megjithatë profilizimi për avokatët në këtë fazë specifike të zhvillimit historik dhe institucional është ende i kufizuar, mund të thuhet se një ekspert i një fushe të caktuar është më i aftë të vlerësojë angazhimin e tij në një çështje të cilën, për nga natyra e saj, e ka trajtuar shpesh në punën e tij. Po qe se duhet të japim një shembull se kur është rasti të përdorni tarifën e sheshtë, mund të themi se ajo mund të përdoret në rastet e një çështje për zgjidhjen e martesës, në rastin e hartimit dhe regjistrimit të akteve për themelimin e një shoqërie tregtare (të formave dhe përbërjeve të thjeshta), në rastin e hartimit të një marrëveshje për pjesëtimin vullnetar të pasurisë në bashkëpronësi, etj.

2.2.4. Parapagimi (*the retainer fee*)

Kjo nuk është një tarifë e mirëfillte, por është më shumë një mënyrë pagese. Ajo parashikon se në çdo rast, para nisjes së marrëdhënieve klient – avokat, klienti duhet të parapaguajë një shumë fikse. Shërbimet e avokatit, që më pas do të jepen me një tarifë orare, do të mbulohen nga ky fond i parapaguar derisa ky fond të konsumohet. Një mënyrë e tillë përdoret nga avokatëve më të rëndësishëm në SHBA dhe Mbretërinë e Bashkuar, pasi këta avokatë kanë një kërkesë shumë të madhe dhe e vetmja mënyrë për t'i pajtuar është që të parapagohen. Është e qartë se me konsumimin e shumës së të gjithë tarifës së parapaguar, për shkak se shërbimet e faturuara e kanë mbërritur këtë shumë, klienti duhet të kryejë sërish një parapagesë tjetër.

Po të marrim në konsideratë çfarë sqaruam për tarifën e sheshtë, duhet të themi edhe një herë në mënyrë specifike se parapagimi është një model tarife shumë i rrezikshëm për t'u përdorur në rastet kur avokatët nuk ofrojnë garancitë profesionale dhe një etikë të lartë. Zakonisht në vendet ku kjo tarifë është më e përdorshme, janë shumë të njohura edhe ato të quhen “*trust account*”⁵⁰ të cilat nënkuptojnë që shuma e parapaguar të depozitohet nga klienti diku, tek një i trete kryesisht banke dhe të tërhiqet prej avokatit duke paraqitur faturat e shërbimeve të kryera. Por, lehtësia e avokatëve për të vënë dorë në këto shuma, duhet të shoqërohet pa diskutim nga një transparencë e plotë për mënyrën se si janë faturuar shërbimet dhe si janë llogaritur faturat.

⁵⁰ “*Trust account*” të cilat quhen ndryshe edhe “*escrow*”, janë llogari në banke ku një person depoziton të holla në emrin e tij dhe i bllokon ato për llogari të një tjetri, me kusht që ky i fundit ka të drejtë t’i tërheqë (t’i zhblokojë) vetëm kur plotëson disa kushte. Kjo llogari është e ndryshme nga llogaria rrjedhëse.

2.2.5. Tarifa sipas rastit

Sërish përcaktimin e kësaj tarife e kemi përfutuar duke kryer përkthimin e asaj që quhet “*contingency fee*”. Kjo në të vërtetë është tarifa që i “pëlqen” më shumë klientëve. Ajo parashikon që avokati duhet të paguhet sipas rastit, në raport me atë që klienti ka pasur mundësi të fitojë për shkak të shërbimeve të avokatit. Kjo tarifë nuk parashikon pagesë për avokatin, nëse nga çështja për të cilën janë dhënë shërbimet e avokatit, klienti nuk ka fituar asgjë.

Siç mund të kuptohet kjo tarifë nuk është e përdorshme në çdo lloj shërbimi. Nuk do të kishte kuptim të vendosni një “*tarifë sipas rastit*” në një çështje për zgjidhje martese apo për rishikimin e një akti administrativ. Ajo zakonisht zbatohet në përfaqësimin e atyre çështjeve gjyqësore në të cilat klientët kërkojnë kthimin apo përfitimin e një shume të hollash (pra ato çështje gjyqësore të cilat do t’i sjellin një përfitim të dukshëm dhe të konsiderueshëm). Në fakt kjo tarife ka lindur në rastet e shkakimit të dëmit, apo të mbledhjes së borxheve, në të cilat klientët janë të gatshëm që të “saktifikojnë” një pjesë të të ardhurave (fitimit) të tyre, duke e ndarë atë me avokatin, me qëllim që të vjelin pjesën tjetër. Është e qartë që në një çështje të tillë roli i avokatit është kyç në zgjidhjen e saj si dhe përfitimit nga gjykimi. Prandaj, klientët të vetëdijshëm për pamundësinë e përfitimit në një mënyrë tjetër, zgjedhin këtë lloj “ortakërie” duke e lidhur fatin e përfitimit të tyre me atë të avokatit, me qëllim që t’i japin një shtysë më të madhe këtij të fundit për t’iu përkushtuar çështjes.

Kur thamë se kjo tarifë u pëlqen më shumë klientëve, kjo në të vërtetë është shumë e diskutueshme. “*Tarifimi sipas rastit*” ka aspektet e veta negative të cilat duhen konsideruar në rastit kur mendohet të propozohet një marrëveshje e tillë. Në radhë të parë, kush aplikon një tarifë sipas rastit, zakonisht vendos një përqindje shumë të lartë për shërbimin e tij. Kjo është e lidhur ngushtë me arsyetimin se, një tarifim i tillë jo në çdo rast i jep garanci avokatit për pagesë, por vetëm në rastin e fitimit të çështjes. Normalisht këto tarifa variojnë nga 20 – 50% të asaj që përfitohet, por mund të shkojnë edhe në 60 – 70%, në rastet kur avokatët marrin përsipër edhe shpenzimet për çështjen përkatëse. Këto nivele kaq të larta të kësaj tarife fillojnë të dekurajojnë klientët për t’u marrë vesh për një tarifë të tillë. Por ajo që më shumë mund të dëmtojë klientët është diçka tjetër. Kuptohet se avokati nuk përfaqëson vetëm çështjen për të cilën është rënë dakord për një “*contingency fee*”, kurse klienti ka vetëm një çështje. Kjo do të thotë se nëse avokati nuk është tërësisht i përkushtuar në rast të një tarife të tillë, ka shumë mundësi që ai të neglizhojë shërbimet në lidhje me këtë çështje në raport me një çështje tjetër që i jep të ardhura të vazhdueshme. Për këtë shkak,

pavarësisht faktit se kjo tarifë është shumë e kërkuar nga Klientët ajo duhet përdorur me një kujdes të veçantë.

2.2.6. Aspekte normative të tarifimit

Ashtu siç është shpjeguar më lart, në lidhje me tarifimin ka dy skenarë në vija të përgjithshme. Skenari i parë konsiston në rastin për të cilën u fol në këtë kapitull dhe që disiplinohet nga marrëveshja mes klientit dhe avokatit. Sigurisht ky është skenari normal që mundëson marrëdhënien e shëndetshme mes tyre si dhe raportin e përgjegjësive profesionale dhe kontraktuale që lehtëson kryerjen e shërbimeve avokatore.

Këshillat që përsëritëm më lart janë të rëndësishme që të mos gjendeni përpara skenarit të rastit tjetër që gjithashtu, nuk ndeshet rrallë në praktikën juridike private. Keni nisur të jepni shërbime për një klient pa u marrë më parë vesh në lidhje me marrëveshjen ekonomike, për shkaqe nga më të ndryshmet, për urgjencën e çështjes, për mungesën e organizimit, për shkak të marrëdhënies së vendosur të besimit me një klient të hershëm, etj. Çfarë duhet bërë në këto raste, nëse klienti është dakord të paguajë shërbimet e avokatit në atë nivel që ato janë llogaritur nga vetë ai?

Në fakt në Kodin Etik të Avokatëve janë caktuar disa kritere të përgjithshme për përcaktimin e tarifave, kjo sipas nenit 28/2 të këtij Kodi i cili thotë shprehimisht:

2) Tarifa e një avokati duhet të jetë e arsyeshme dhe e drejtë. Faktorët që duhet të konsiderohen për të përcaktuar se sa e arsyeshme është një tarifë përfshijnë:

- 1. koha dhe puna e kërkuar, risia dhe vështirësia e çështjeve të përfshira dhe aftësitë e kërkuara për të kryer shërbimet ligjore;*
- 2. kufizimet kohore të imponuara nga rrethanat;*
- 3. natyra dhe kohëzgjatja e marrëdhënieve profesionale me klientin;*
- 4. përvoja, reputacioni dhe aftësia e avokatit ose avokatëve, në kryerjen e shërbimeve;*
- 5. si dhe faktorë të tjerë të çmuar nga ai;*

I vetmi referim që jep një përgjigje, aspak shteruese, por që vendos disa shifra konkrete për një rast të tillë, është Urdhri nr. 1284/3, datë 16.02.2005 i Ministrisë të Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Avokatëve i cili ka përcaktuar një numër të caktuar tarifash për t'u zbatuar në rastet kur nuk ka marrëveshje mes avokatit dhe klientit për përfaqësimin e çështjeve gjyqësore.

Ky akt është kaq i vjetër⁵¹ dhe kaq elementar sa që është thujtë i papërdorshëm

⁵¹ Është miratuar para 3 ndryshimeve të fundit që i janë bërë ligjit 9109, datë 17.07.2003, me ligjet, nr.9795 datë 23.7.2007, nr. 10 047 datë 24.12.2008 dhe nr. 91/2012 datë 27.09.2012.

në kushtet aktuale, megjithëse ju do të gjeni në shumë raste se gjykatat e kanë aplikuar për të llogaritur shpenzimet gjyqësore në mungesë të paraqitjes së dokumenteve që tregojnë marrëveshjen e klientit dhe avokatit.

Tabelën që i bashkëngjitet këtij akti po e tregojmë këtu për të bërë disa komente të nevojshme mbi të.

Përfaqësimi në çështjet penale	Lekë
Dhënie e mbrojtjes për ndalimet e arrestimet, deri në seancën e caktimit të masës së sigurimit	15 000
Ndihmë juridike për hetimet paraprake, deri në dërgimin e çështjes në gjykim	
a) Për kundërvajtje	20000
b) Për gjykimet në shkallë të parë	50 000
Ndihmë juridike në Gjykatën e Shkallës së Parë	
a) Për krimet që parashikohet dënim deri në 5 vjet	30 000
b) Për krimet që parashikohet dënim mbi 5 vjet	80 000
Shërbime juridike (përfaqësimi) në Gjykatën e Apelit	40 000
Shërbime juridike (përfaqësimi) në Gjykatën e Lartë dhe Kushtetuese	50 000
Përgatitje kërkesa ankimore dhe të tjera	10 000
Këshillime juridike për çdo orë	500-1500
Shërbimi për të miturit do të jetë sa gjysma e tarifave të sipërme.	
Përfaqësimi për çështjet civile	Lekë
Përfaqësimi në Gjykatën e Shkallës së Parë, pa palë	15 000
Përfaqësimi në Gjykatën e Shkallës së Parë, me palë	40 000
Përfaqësimi në Gjykatën e Apelit	45 000
Përfaqësim në Gjykatën e Lartë dhe Kushtetuese	60 000
Përgatitje e kërkesave ankimore	15 000
Rekurseve dhe kërkesave në Gjykatën e Lartë dhe Kushtetuese	25 000
Këshillime juridike	1 000

Siç mund të kuptoni, qëllimi i këtij akti ka qenë të vendosë një tarifë për një kategorizim shumë elementar çështjesh që e bën pothuajse të papërdorshëm këtë akt. Mund t'ju themi gjithashtu se fakti që ky akt nuk është rinovuar prej kaq shumë vitesh e ka bërë atë krejt të pa përshtatur me kushtet aktuale të tregut.

Fakti është se referuar në traditat e vendeve të tjera, akte të ngjashme jo vetëm që rinovohen në mënyrë periodike në vlerësim të ndryshimit të tendencave

të tregut të shërbimeve juridike, por synojnë të krijojnë kategorizime sa më përfshirëse në lidhje me rastet e ndryshme për të cilat është e nevojshme llogaritja e arsyeshme e shpërblimit të avokatit. Duhet thënë gjithashtu se këto llogaritje bëhen kryesisht për shkak të përcaktimit të shpërblimit në kuadrin e përfaqësimit përpara organeve gjyqësore. Kjo për dy arsye:

- Në radhë të parë është e pakuptueshme që në përfundimin e një gjykimi, pjesë të të drejtave që duhet të zgjidhen mes palëve të mos jenë edhe detyrimet për të paguar edhe shpenzimet gjyqësore, përfshirë këtu edhe shpërblimin për avokatët, ashtu siç tregohet në nenin 106 të K.Pr.C. Kjo është jo vetëm një nevojë për të rregulluar përfundimisht marrëdhëniet mes palëve ndërgjyqëse, por edhe një masë e domosdoshme për të parandaluar nisjen e proceseve gjyqësore në mënyrë të nxituar dhe të pamenduar.
- Nga ana tjetër përllogaritja e shërbimeve avokatore në raste të tjera, siç është për shembull këshillimi juridik, ku është vështirë të vlerësohet *apriori* angazhimi i avokatit për çdo rast këshillimi, pasi nevoja për këshilla juridike është një fushë shumë më e gjerë sesa përfaqësimi gjyqësor, e për çdo rast ekzistojnë praktika më të konsoliduara dhe të njohura për shumicën e profesionistëve.

2.2.7. Financimi i padive

Kur folëm për transparencën e tarifave, vumë në dukje se është e domosdoshme që për një marrëdhënie besimi mes avokatit dhe klientit, të bëhet një dallim i qartë mes shpërblimit për shërbimet e avokatit dhe shpenzimeve të tjera që mund të jenë të nevojshme për të mundësuar zhvillimin e procesit gjyqësor, si shpenzime udhëtimi, taksa gjyqësore⁵², pagesa për ekspertët, pagesa për marrjen e dokumenteve, shërbime përkthimi, noteriale, etj.

Por, zërat e shpenzimeve mund të jenë nga më të ndryshmet dhe normalisht mund të rriten deri në atë masë sa të bëhen të papërballueshme për klientin e për pasojë të bëjnë të pamundur ndërmarrjen e veprimeve ligjore, të nevojshme për rivendosjen e të drejtave të tija. Ky probabilitet rritet veçanërisht për shkak se në rastet e kërkimeve të shpërblimit të dëmit apo përmbushjes së kontratave, Udhëzimi Nr.991/3, Datë 2.3.2010 parashikon pagesën e tarife fikse, në përqindje mbi vlerën e kërkimit, dhe kjo mund të jetë e papërballueshme. Paradoksalisht

⁵² Aktualisht këto rregullohen me Udhëzim Nr.991/3, Datë 2.3.2010 “Për një ndryshim në udhëzimin nr.13, datë 12.2.2009 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime dhe shërbime të administratës gjyqësore, ministrisë së drejtësisë, prokurorisë, noterisë dhe zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”

sa më i madh është niveli i shkeljes së të drejtës së subjektit aq më penguese bëhet nga ana ekonomike, mundësia e ushtrimit të mjeteve ligjore për ta vënë në vend të drejtën. Pavarësisht se së fundmi ka pasur një zhvillim jurisprudencial të rëndësishëm Kushtetues⁵³ në lidhje me këtë çështje, problemi mbetet.

Në këtë drejtim mendojmë se është rasti të prezantojmë një praktikë shumë të njohur botërore, Financimin e Padive (*claim financing*). Në shoqërinë e ngritur mbi parimet e tregut të lirë duket se ka pasur një kërkesë specifike jo të vogël për të gjetur financime për të mundësuar kryerjen e shpenzimeve të nevojshme për të çuar para Gjykatës një çështje gjyqësore. Shoqëri të caktuar financiare marrin përsipër të parapagujnë shpenzimet gjyqësore në tërësi, duke kërkuar që në përfundim të procedurave të marrin një pjesë të konsiderueshme të fitimeve të përfitohen për tyre.

Si realizohet kjo? Zakonisht këto shoqëri marrin opinionin e profesionistëve të tjerë, në fushën ligjore dhe bëjnë një parashikim të pavarur të shpenzimeve të pritshme, në lidhje me shanset e përfundimit të çështjes dhe nëse binden për mundësinë e realizimit të një fitimi ekonomik lidhin një marrëveshje me subjektin që kërkon financimin. Kjo praktikë nuk është e përdorur sot, por është një mundësi reale për të realizuar rivendosjen e të drejtave, në rastet kur ka pengesa të tilla financiare.

2.2.8. *Success fee* si pjesë e marrëveshjes së porosisë

Nga të gjitha modelet e tarifave të treguara më lart, jo pa qëllim nuk iu referuam tarifës së suksesit (*the success fee*). Kjo është tarifa më e pëlqyer nga avokatët. Ajo është një tarifë e përcaktuar në mënyrë të veçante e cila përfitohet kur çështja përfundon me sukses. Megjithatë është e rëndësishme që ajo të dallohet nga tarifa sipas rastit (*contingency fee*), sepse në vështrimin e parë duket sikur mes tyre nuk ka asnjë ndryshim.

Për t'u aplikuar drejt një tarifë suksesi, normalisht ajo duhet të jetë e shoqëruar nga një tarifë tjetër që nuk lidhet me suksesin, një *retainer* apo një tarifë e sheshtë. Kjo për arsye se siç ju shpjeguam edhe më lart është disi e papranueshme që një avokat të paguhet vetëm në rast suksesi, pasi ai duhet të jetë përgjegjës edhe për rastin e mosuksesit, apo suksesit të pjesshëm, duke qenë se përgjegjësia e tij rrjedh nga profesioni i tij. Por është e vështirë t'i kërkojë përgjegjësi dikujt që pranon të punojë pa u paguar fare.

Tarifa e suksesit është një stimul i përgjegjshëm për avokatin, ndërkohë që ai

⁵³Vendimi i Gjykatës Kushtetuese.

nuk duhet të shqetësohet për kohën e shpenzuar për çështjen në rast mossuksesi, duke qenë se do të paguhet gjithsesi për të. Ndaj në formulimin e këtyre tarifave duhet vendosur një raport logjik mes tarifës së shërbimit që nuk lidhet me suksesin dhe asaj që lidhet me suksesin. Zakonisht tarifa e shërbimit në këto raste ulet drejt minimumit ose edhe përtej minimumit dhe vendoset një tarife suksesi që normalisht nuk duhet të kalojë 10%.

2.2.9. Dy dispozita për t'u marrë në konsideratë në vend për përfundimit

Siç thamë edhe më lart të gjitha këto modele tarifash kanë avantazhet dhe disavantazhet e tyre, por ajo që duhet të kemi më shumë kujdes kur ua sugjerojmë klientëve, është ajo që aplikimi i tyre të mos krijojë probleme në aspektin etik.

Për këtë shkak duam që në përfundim t'ju vëmë në dukje dy dispozita të ligjit Nr.9109, datë 17.7.2003 Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë (i ndryshuar) dhe Kodit Etik të Avokatëve, të cilat për mendimin tonë duhen rishikuar pasi krijojnë paqartësi për shkak të formulimit. Këto dispozita janë si më poshtë:

Neni 12

1. *Avokati nuk mund të kërkojë nga personi që mbron ose përfaqëson, që të shpërblehet prej tij me përqindje gjatë procesit të gjyqimit.*
2. *Shpërblimi me përqindje, i paralogaritur ose jo, mund të paguhet vetëm kur është parashikuar në marrëveshjen ndërmjet avokatit dhe personit që ai mbron ose përfaqëson, për rastin mbrojtjes apo përfaqësimit të suksesshëm të çështjes.*
3. *Avokatit i lejohet të paguhet me komision në rastet kur siguron kthimin e huasë për personin që mbrohet ose përfaqësohet prej tij jo-gjyqësisht.*

Neni 28/3/4 i Kodit Etik

- 3) *Avokati nuk duhet të ketë të drejtë të bëjë një pactum de quota litis. Me "pactum de quota litis" kuptohet një marrëveshje e arritur përpara përfundimit të çështjes, e cila përcakton tarifën që duhet t'i paguhet avokatit vetëm për rezultatet e arritura dhe në të cilën klienti merr përsipër t'i paguajë avokatit një pjesë të rezultatit të arritur.*
- 4) *Avokati lejohet të përcaktojë "tarifat e rezultateve" me përjashtim të çështjeve të së drejtës familjare ose penale. Me "tarifa të rezultateve" kuptohen:*
 - a) *Marrëveshjet me shkrim ndërmjet avokatit dhe klientit, sipas të cilit avokati merr përsipër të fillojë një çështje ose rast sipas tarifave minimale të përcaktuara dhe klienti bie dakord të paguajë një shumë të arsyeshme fikse në varësi të rezultateve pozitive të tij. Sasia mund të përkufizohet si shumë totale ose si një përqindje e parave të përcaktuara nga vendimi i gjyqit.*
 - b) *Marrëveshja me shkrim ndërmjet avokatit dhe klientit sipas të cilës avokati merr*

përsipër të fillojë një çështje ose rast me tarifën minimale të përcaktuar dhe klienti bie dakord të paguajë tarifa të tjera shtesë për rezultatin pozitiv.

Nga përmbajtja e tyre, vihet re një mungesë koherencë në këto formulime, por që mendojmë se nëse i shihni nën dritën e shpjegimeve të dhëna më lart mund të bëhen më te qarta. Dhe mos harroni këshillën më të rëndësishme: **tarifa më e mirë është ajo që janë gati t’ju paguajnë.**

2.3. Përfaqësimi me prokurë

Ligji procedural dhe material i mundëson palëve ndërgjyqëse që të veprojnë në gjykim me anë të përfaqësimit, e cila është një marrëdhënie juridike që konkretizohet në atë akt që i mundëson avokatit të paraqitet në gjykim në emër dhe për llogari të klientit të tij. Në këtë pjesë do të trajtojmë nga një pikëpamje praktike përfaqësimin vullnetar i cili materializohet në një akt procedural që quhet prokurë, pavarësisht se në gjykim ekziston edhe përfaqësimi ligjor ne rastet p.sh. kur prindi përfaqëson fëmijën apo kujdestari personat e paaftë për të vepruar.

Dispozitat procedurale dhe konkretisht, kodi i procedurës civile flasin për përfaqësimin në gjykim duke kërkuar dhe lejuar që ai të bëhet në dy mënyra, me në të një prokurë noteriale ose në procesverbalin e seancës gjyqësore. Duhet pasur kujdes i veçantë, që kur vlerësohet mundësia e përfaqësimit gjyqësor me prokurë, të mos lihen jashtë vëmendjes detyrimet dhe rregullimet tipike të përfaqësimit, të parashikuara këto në Titullin II, Kreun I të Kodit Civil.

Nëse në prokurë është parashikuar se përfaqësimi do të kryhet nga më shumë se një avokat, shpesh nga Gjykatat do t’ju kërkohet që përfaqësimi të kryhet njëherazi në praninë e të gjithë avokatëve të emëruar me prokurë. Kjo ka ndodhur me një frekuencë shqetësuese në gjykatat tona dhe për këtë shkak në shembujt e prokurave që do të gjeni më poshtë është specifikuar se, megjithëse janë caktuar disa përfaqësues, përfaqësimi mund të kryhet së bashku dhe veçmas prej tyre. Por kjo barrierë me të cilën mund të haseni rëndom, është në kundërshtim të hapur me nenin 68 të Kodit Civil:

“Kur për kryerjen e një veprimi juridik janë caktuar dy ose më shumë përfaqësues, secili prej tyre mund ta kryejë atë pa pjesëmarrjen e përfaqësuesve të tjerë, përveç kur në prokurë është parashikuar ndryshe.”

Në praktikën e përditshme përdoren të dyja mënyrat në varësi të çështjes si edhe të mundësive ekonomike të palës që ne përfaqësojmë. Në rekomandimin që do t’i bëjmë palës për zgjedhjen e rrugës, apo mënyrës së hartimit të prokurës duhet të konsiderojmë disa faktorë. Një prokurë e hartuar përpara noterit na

jep ne si avokat, mundësinë që të punojmë në mënyrë më të pavarur nga pala dhe kështu të kursejmë kohë, ndërsa hartimi i prokurës duke e mbajtur atë në procesverbalin e gjykatës na kushtëzon në veprimet paraprake dhe në seancë përgatitore ku prania jonë varet nga prania e palës (p.sh. duhet që pala të kërkojë vetë marrjen e provave nga institucionet, të paraqitet në seancë përgatitore, të njoftohet nga gjykata për gjykimin etj. Të gjitha këto veprime që duhet të kryhen personalisht nga ajo, për shkak se avokati nuk është legjitimuar në këtë procedurë).

Për rrjedhojë nëse ndodhemi përpara një çështje të komplikuar, voluminoze apo me një tërësi veprimesh në fazën përgatitore, marrje dhe gjetje provash, kërkesa paraprakë etj., është e nevojshme që të pajisemi sa më parë me prokurë nga pala, në mënyrë që të fillojmë menjëherë nga puna, ndërsa në rast të një gjykimi të thjeshtë, kur çështja nuk ka nevojë për një përgatitje të gjatë dhe ka pak veprime paraprake, për të mos shtuar kostot e palëve mund të rekomandojmë hartimin e prokurës në procesverbalin gjyqësor (p.sh. në një kërkesë për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit, zgjidhje e një martesë me kërkesë të përbashkët të bashkëshortëve etj.)

2.3.1. Prokura noteriale

Meqenëse ligji kërkon që për përfaqësimin në gjykim të hartohet një prokurë noteriale, ju sigurisht që mund t'i drejtoheni një noterit i cili do të jetë i gatshëm që ta hartojë atë dhe ta noterizojë. Megjithatë në praktikën e përditshme, aplikohet më së shumti mundësia që vetë avokatët të hartojnë përmbajtjen e prokurës së nevojshme për gjykimin e çështjes. Edhe në këtë rast vlen rregulli i rëndësishëm së çështjes. Në një çështje komplekse dhe me shumë të drejta të ndërthurura, është e rekomandueshme që ju të bëni hartimin e prokurës, ndërsa në një çështje të thjeshtë ajo mund të hartohet edhe nga noterit, pasi në rastin e pare hartimi i prokurës nga noterit do të ishte një harxhim kohe. Duke patur parasysh faktin se padia duhet të hartohet fillimisht nga ju, rekomandohet që edhe hartimi i përmbajtjes së prokurës të bëhet po nga ju, pasi në këtë mënyrë do t'i shërbeni noterit për të identifikuar volumin dhe llojet e të drejtave që ju duhet të përfshini në prokurë.

Gjithashtu, ju mund të ndërtoni edhe një marrëdhënie besimi me një noter me të cilin të bashkëpunoni gjithmonë duke hartuar paraprakisht disa lloje prokurash të cilat mund të përdoren sipas rastit.

Zakonisht në përfaqësimin në gjykim hartohet një prokurë e posaçme e cila legjitimon avokatin që të ndjekë hapat e kërkuara procedurale në emër dhe për llogari të palës. Është e rëndësishme që prokura të përmbajë tërësinë e të drejtave

(tagrave) që klienti na delegon me anë të saj. Në hartimin e prokurës duhet pasur kujdes që të identifikohet qartë dhe saktë (duke përfshirë objektin dhe palët në gjykim) çështja të cilën do të përfaqësojmë. Gjithashtu është e nevojshme që të verifikojmë që prokura po lëshohet nga subjektet mbajtës i së drejtës, pra që personi që nënshkruan ka të drejtë ta lëshojë prokurën. Nëse bëhet fjalë për vetë palën në gjykim, kjo është një çështje e thjeshtë, por nëse prokurën e lëshon një përfaqësues i palës, p.sh., kujdestar, prindi, organi kompetent i caktuar nga ligji ose statuti, si edhe përfaqësuesi me prokurë i palës, atëherë duhet bërë kujdes. Në rastet kur bëhet fjalë për kujdestarin, prindin dhe organin kompetent i caktuar nga ligji ose statuti, duhet të verifikojmë identitetin e tyre dhe aktet që i legjitimojnë në këtë cilësi, p.sh. vendimin e gjykatës, certifikatën e gjendjes civile apo dokumente identifikues të fëmijës si edhe parashikimet ligjore, nënligjore dhe statutores për organin kompetent të cilat përcaktojnë të drejtat dhe detyrat e tij.

Në rastin e një përfaqësuesi me prokurë duhet që prokura të autorizojë shprehimisht të drejtën e tij për të zgjedhur një avokat.

Këta hapa do të ndjekë edhe gjykata në veprimet e veta për legjitimim, prandaj është e rëndësishme të kontrollohen fillimisht nga avokati për të garantuar tagrat e veta të përfaqësimit.

2.3.2. Prokura noteriale e përpiluar në juridiksionin e huaj

Në praktikën e përditshme do të gjendemi përpara rasteve kur pala që përfaqësojmë jeton, banon apo ka qendrën në një shtet tjetër dhe në hartimin e akteve të veta ajo i nënshtrohet një juridiksioni të huaj. Në këto raste është e nevojshme që të lëshohet një prokurë në juridiksionin e një shteti të huaj dhe që kjo prokurë të përdorë përpara organeve kompetentë shtetërore apo gjyqësore në vendin tonë, duhet t'i nënshtrohet disa rregulla të posaçme.

Prokura e hartuar në përfaqësitë diplomatike shqiptare. Fillimisht duhet të dallojmë prokurën e cila mund të hartohet nga shtetasit shqiptarë përpara ambasadave dhe konsullatave shqiptare në shtetet e huaja. Në këtë rast konsulli vepron në cilësinë e noterit duke lëshuar prokurën. Një prokurë e tillë për shkak se lëshohet në përfaqësitë tona diplomatike quhet si e lëshuar përpara autoriteteve shqiptare dhe për rrjedhojë, pranohet ashtu siç është nga organet tona shtetërore.

Një veprimtari e tillë rregullohet me Ligjin nr. 8372, datë 9.7.1998 “Për ushtrimin e funksioneve konsullore nga përfaqësitë diplomatike dhe konsullore” dhe me Ligjin nr. 7829, datë 01.06.1994 “Për noterinë”. Duke pasur parasysh funksionin e konsullit dhe duke marrë në konsideratë nevojat e qytetarëve

shqiptarë me banim jashtë vendit, Ligji u jep punonjësve konsullorë disa kompetenca të cilat mundësojnë kryerjen prej tyre të disa shërbimeve që në vendin tonë kryhen normalisht nga noterët.

Sipas nenit 12 të këtij ligji, funksionari konsullor, me kërkesën e shtetasve, ndër të tjera, përpilon:

- procesverbale për të dokumentuar fakte të ndryshme;
- deklarata, autorizime, testamente, kontrata, garanci dhe prokura të thjeshta;
- vërteton nënshkrime;
- vërteton kopje ose ekstrakte dokumentesh;

Këto dokumente janë të barasvlershme me ato të një noteri të licencuar në Republikën e Shqipërisë dhe nuk bien ndesh me kërkesat specifike që parashikon legjislacioni shqiptar lidhur me formën dhe subjektin i cili ka autoritet për t'i përpiluar. Kjo do të thotë se konsujt nuk mund të kryejnë të njëjtat veprime si noterët, por vetëm ato për të cilat ligji nuk parashikon se duhen kryer domosdoshmërisht me akt noterial, të parashikuara në nenin 83 të Kodit Civil.

Të tilla veprime noteriale që nuk mund të kryhen janë:

- a) përpilimi i kontratave që kanë të bëjnë me kalimin e pronësisë së sendeve të luajtshme, për të cilat regjistrimi i tyre kërkohet shprehimisht nga ligji;
- b) kontratat për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme;
- c) të drejta uzufukti, përdorimi e bujtjeje, enfitoze e servituti e të drejta të tjera reale;
- d) përpilimi i garancive mbi përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata me veprime juridike, për të cilat ligji kërkon që të kryhen me akt noterial.

Për të evidentuar kufizimet që i vë ligji veprimtarisë së konsujve për të mos kryer veprime që mund të kryhen vetëm me akt noterial, është e nevojshme që të shqyrtohen të gjitha ligjet specifike. Përveç sa më sipër, Kodi Civil në nenin 72 parashikon se, prokurat që autorizojnë një person të lidhë veprime juridike që sipas ligjit mund të kryhen me akt noterial, duhet të përpilohen po me akt noterial. Pra, edhe në këtë rast konsulli nuk mund të përpilojë autorizime apo prokura të posaçme apo të përgjithshme, nëse këto parashikojnë lidhjen e veprimeve juridike, që sipas ligjit, duhet të lidhen me akt noterial.

Ligji ka lejuar, përgatitjen nga konsujt vetëm të prokurave të thjeshta, që nënkupton redaktimin e prokurave që japin tagra për veprime përfaqësimi për veprime të thjeshta të cilat nuk synojnë lindjen, ndryshimin ose shuarjen e të drejtave dhe detyrimeve të të përfaqësuarit. Në këto raste, shtetasi shqiptar me banim jashtë vendit, duhet t'i drejtohet një noteri në vendin ku jeton, për

përgatitjen e prokurës që i nevojitet. Më tej, konsulli mund të procedojë me legalizimin e këtij dokumenti (në ato raste kur nuk është e zbatueshme përdorimi i vulës Apostile) përpara se të dërgohet për përdorim në Shqipëri.

Prokurat përpilohen në dy kopje origjinale, njëra prej të cilave mbahet në dosjen e prokurave të postit konsullor.

Prokura e lëshuar nga një noter në një shtet tjetër. Në rastet kur klientët lëshojnë një prokurë përpara një noteri në një shtet tjetër veprojnë rregullat e Konventës së Hagës të 5 tetorit 1961 “Për heqjen e kërkesës për legalizim të dokumenteve zyrtare të huaja” e quajtur ndryshe Konventa e Apostilit.

Vula Apostile, apo më saktë *Apostille* (fr. certifikatë) e lindur nga një marrëveshje ndërkombëtare të quajtur Konventa e Hagës, nuk është tjetër veçse një vulë e standardizuar në përmasa e përmbajtje nga vetë konventa. Është një lloj legalizimi që autoriteti kompetent i një shteti i bën dokumentit publik duke e kthyer dokumentin në të vlefshëm edhe për shtetet e tjera që kanë nënshkruar konventën. Pra, *Apostille* është një legalizim i mundshëm i parashikuar vetëm për shtetas që vijnë nga vendet që kanë nënshkruar Konventën e Hagës së 5 tetorit 1961 lidhur me heqjen e legalizimit të akteve publike të huaja.

Përmbajtja e Apostilës është gjithnjë e njëjtë sipas formatit të rënë dakord sipas konventës:

Apostille (Convention de La Haye du 5 octobre 1961)	
1. Country:	
This public document	
2. has been signed by.....	
3. acting in the capacity of	
4.bears the seal/stamp of.....	Certified
5.at.....	
6. the.....	
7. by.....	
8. No.....	
9. Seal/Stamp:	
10. Signature	

Po të lexohet me një sy kritik kjo përmbajtje, që në fakt është shumë e ngjashme me atë të përdoruar në formulat e legalizimit, mund të kuptohet edhe qëllimi i këtij formaliteti. Këto procedura janë krijuar me qëllim që autoritetet e një shteti

të jenë të sigurt për cilësinë e nëpunësve të shtetit nga vjen dokumenti. Në rastin konkret gjyqtari ose autoriteti shtetëror, të cilit ju i paraqisni prokurën e redaktuar jashtë Shqipërisë do të mësojë se personi që ka redaktuar këtë prokurë është zyrtar publik (noter) në vendin ku është përgatitur prokura. Është për këtë shkak që dokumentet me natyrë private nuk kërkohet të kenë Apostile kur paraqiten në Gjykatë. Konkretisht prokura e bërë nga përfaqësuesi i personit juridik (me lart, por edhe në përditshmëri e quajmë autorizim) nuk ka nevojë dhe nuk mund të mbajë Apostile, pasi organi kompetent i vendit nga vjen prokura nuk mund të certifikojë veçse cilësinë e personave që ushtrojnë një detyrë publike dhe përfaqësimi i personave juridike të së drejtës private nuk është i tillë.

Në vendin tonë Apostili vendoset në zyrën përkatëse në Ministrinë e Punëve të Jashtme, ndërsa çdo shtet i cili ka nënshkruar konventën cakton një autoritet ku mund të vendoset vula apostile. Në një prokurë të lëshuar jashtë shtetit është e nevojshme që të jenë të vendosura të dyja vulat në mënyrë që ajo të mund të përdoret përpara organeve kompetente shqiptare.

Në rast se prokura është hartuar në vende që nuk e kanë nënshkruar këtë konventë, apo që kanë paraqitur rezerva të veçanta në lidhje me njohjen e kësaj konvente për vende të caktuara (zakonisht vepron parimi i reciprocitetit), duhet të bëhet formaliteti i legalizimit të dokumenteve që gjithashtu kryhet në rrugë diplomatike.

2.3.3. Prokura e lëshuar nga personat juridikë (Autorizimi i përfaqësimit)

Në praktikën e përditshme, në rastet kur pala që ju përfaqësoni është një person juridik, për përcaktimin e të drejtës së përfaqësimit në gjykim përdoret një akt i quajtura rëndon “Autorizim”. Ky akt nuk është asgjë tjetër veçse një prokurë e posaçme, e cila dallon nga ajo e lëshuar nga personi fizik për shkak të lehtësive që i jep ligji personave juridik. Personat juridike hyjnë në marrëdhënie me njëri-tjetrin dhe të tretët, prandaj legjislatori për t’i sjellë atyre lehtësi, si edhe për t’i ulur kostot, i ka lejuar të përfaqësohen në gjykim me anë të një autorizimi të firmosur nga përfaqësuesi i tij ligjor dhe të vulosur me vulën e institucionit.

Në secilën nga llojet e akteve ajo që është e rëndësishme është përcaktimi saktë i volumi të të drejtave, të nevojshëm në gjykim; në aktet bashkëlidhur këtij manuali janë paraqitur modeli i një prokurë dhe një autorizimi.

2.4. Aspekte Etike

2.4.1. Përgjegjësia profesionale. Aspekte teorike të përgjegjësisë profesionale

Ashtu siç është treguar me lart, marrëdhënia avokat-klient është edhe një marrëveshje kontraktore dhe si e tillë ajo i nënshtrohet të gjitha kriterëve për vlerësimin e përgjegjësisë së palëve në mbarëvajtjen dhe përmbushjen e detyrimeve të tyre reciproke. Për më tepër, duke qenë se ajo lidhet ndërmjet dy palëve që nuk kanë aftësi të njëjta negociuese dhe duke u konsideruar avokati si një subjekt me përgjegjësi të veçanta profesionale, edhe përgjegjësitë e tij për mbarëvajtjen e kësaj marrëveshje janë të posaçme. Në kapitujt e mëparshëm është folur gjerësisht për rolin e posaçëm profesional të avokatit. Madje ka një tendencë gjithnjë në rritje për ta konsideruar këtë profesion të pajisur me një rol të veçantë në shoqëri, më të gjerë se një marrëdhënie e thjeshtë avokat-klient.

Në përgjithësi, në të gjitha marrëdhëniet e përgjegjësive të profesioneve të lira, roli i profesionistit shihet me një sy të veçantë. Në fakt është e kuptueshme se profesionisti ka një pozitë më të fortë në një marrëdhënie të tillë, për shkak se ai njihet dhe mund të parashikojë me saktësi më të lartë, detajet e shërbimeve që i janë kërkuar, ashtu siç edhe mund e duhet të vlerësojë edhe nevojën që ka klientit të tij për ato shërbime që nuk i janë kërkuar, por që sipas ligjit apo situatës konkrete janë të nevojshme për t'u ndërmarrë në mënyrë që interesat e klientit të marrin një mbrojtje sa më të përshtatshme.

Është e kuptueshme se ka raste të qarta kur përgjegjësia e avokatit është e dukshme, p.sh. avokati nuk paraqet ankimin brenda afatit të treguar në ligj, nuk informon klientin për plotësimin e formaliteteve gjatë një procedure të ankimit administrativ, harton një marrëveshje dhe nuk sugjeron asnjë mjet për sigurimin e përmbushjes së detyrimeve, etj. Por, po të marrim në konsideratë dimensionin e pamatshëm të marrëdhënies juridike që mund të krijohen, rrjedhimisht edhe rastet kur vlerësimi i gabuar i avokatit krijon pasoja të dëmshme për klientin, bëhen të vështira për t'u vlerësuar.

Mund të marrim disa shembuj praktik që japin një pikëpamje më të qartë për situata të tilla.

a. Dikush kërkon shërbimet e avokatit se fqinji i tij kryen punime të paautorizuara në kufirin mes dy pronave. Avokati pranon të marrë përsipër përfaqësimin, merr të gjithë informacionin e duhur, ngre padinë e duhur përpara Gjykatës dhe madje eventualisht mundëson edhe zgjidhjen e konfliktit me

sukses. Por gjatë zhvillimit të gjykimit punimet kanë vijuar për shumë kohë dhe në momentin kur Gjykata e ka rivendosur të drejtën, kthimi i pasojave në realitet është shumë i vështirë dhe i kushtueshëm. A është përgjegjës avokati për faktin që në nisjen e procesit nuk ka rekomanduar apo nuk ka paraqitur një kërkesë për të siguruar objektin e padisë duke kërkuar që punimet të pezulloheshin paraprakisht (pavarësisht fatit që do kishte kjo kërkesë në gjykim), gjatë zhvillimit të procesit?

b. Dikush i drejtohet avokatit për të mundësuar kthimin e një huaje që është e garantuar nga një dorëzanës. Avokati përgatit çështjen me saktësi, paraqet një padi kundër debitorit dhe çështja ka sukses por debitori rezulton se nuk është mjaftueshëm likuid për të mundësuar kthimin efektiv të borxhit. Ndërkohë dorëzanësi është një subjekt shumë më solvabel se debitori, por padia nuk është drejtuar ndaj tij dhe afati 6 mujor, i parashikuar nga neni 600 i Kodit Civil, tashmë është përmbushur dhe rrjedhimisht dorëzania është shuar. A aplikoi avokati zgjedhjen e duhur në këtë rast?

Mund të vijonim të tregojmë raste të tilla, qoftë teorike apo qoftë të ndodhur efektivisht në praktikë, por çështja është cilat do të ishin kriteret për të vlerësuar në mënyrë objektive nëse jemi në rastet kur kemi të bëjmë me një praktikë neglizhente nga ana e avokatit apo me faktin që nuk ishin rrethanat për të mundësuar një parashikim të arsyeshëm të zhvillimeve të një çështje konkrete për shkak të faktorëve që nuk varen nga vlerësimi i avokatit. Siç ju kemi treguar më lart marrëdhënia Avokat – Klient ka një dimension pasigurie për shkak se klienti nuk e njeh fushën e veprimit të Avokatit, por mbi të gjitha sepse është e paarsyeshme të besohet se avokati do të parashikojë plotësisht përfundimin e çështjes, gjë që varet nga shumë faktorë. Megjithatë, aspekti profesional i avokatit duhet të vlerësohet detyrimisht për të kuptuar se çfarë rëndësie kishte qëndrimi i tij në raport me përfundimin e çështjes. Për këtë, në fakt, do të ndihmonte shumë jo vetëm një përditësim i vazhdueshëm i rregullave etike, por mbi të gjithë edhe një stabilitet në zhvillimet jurisprudenciale, gjë që do të mundësonte kontrollin e punës së avokatëve në raport me praktikat gjyqësore.

2.4.2. Përgjegjësi profesionale e avokati sipas legjislacionit tonë

Në krerët e mëparshëm është folur rreth procesit disiplinor ndaj avokatëve në lidhje me ato raste kur ata duhet të mbajnë përgjegjësi sipas akteve në fuqi që rregullojnë profesionin në raport me ato sjellje të ndaluara ose të ndëshkueshme sipas ligjit. Ky le të themi se është aspekti “penal” i përgjegjësisë profesionale të avokatit, i cili ndëshkohet në mënyrat e parashikuara në ligj.

Megjithëse në ligj apo në aktet e tjera nuk është e shprehur drejtpërdrejtë, është e padiskutueshme se kjo përgjegjësi ka edhe një dimension civil, pra dimensionin që duhet të marrë parasysh nevojën për të rivendosur, në kuadrin pasuror, ato dëme që i kanë ardhur interesave të klientit nga shërbimet jo profesionale të klientit. Duke qenë kontrata e shërbimeve avokatore është një kontratë në kuptimin e plotë të saj, ajo presupozon detyrimin për t'u përmbushur me korrektësi, ashtu siç është trajtuar më lart. Duke shtuar këtu edhe faktin që avokati duhet të ketë të shenjta edhe rregullat e profesionit, atëherë mund të themi pa hezitim se ai duhet të përgjigjet edhe për dëmet që shkakton në sajë të veprimeve të tij të pakujdesshme.

Kjo është arsyeja pse praktikant më të mira botërore parashikojnë sigurimin profesional të avokatit, deri edhe si një detyrim i pa derogueshem i lidhur drejtpërdrejtë me mundësinë e ushtrimit të profesionit. Sigurimi i dëmeve që vijnë nga ushtrimi i profesionit do të ishte një garanci më shumë për zgjedhjen e një avokati, pasi klienti do të ishte më i qetë se avokati do të ishte i aftë jo vetëm të mbante përgjegjësi disiplinore, por edhe të rivendoste dëmet eventuale. Mund t'ju themi se megjithëse në kushtet aktuale ky nuk është një detyrim disa prej Zyrave Avokatore në Shqipëri e zbatojnë tashmë këtë standard dhe në tregun e sigurimeve mund të gjenden produkte që plotësojnë nevojat për sigurimin e avokatëve.

2.5. Privatësia. Mbrojtja e të dhënave personale

Privatësia apo konfidencialiteti që duhet të ketë parasysh avokati gjatë ushtrimit të profesionit të tij, buron nga ligji dhe nga normat e etikës profesionale. Ajo ka të bëjë me parimin e rëndësishëm të fiksuar nga këto norma, mbrojtjen e të dhënave personale. Po kështu konfidencialiteti është një garanci për klientin që ai mbron apo asiston dhe gjithashtu edhe një detyrim për avokatin gjatë ushtrimit të profesionit. Në këtë aspekt avokatit i ndalohet që të bëjë publike të dhënat që ai ka mësuar nëpërmjet personit të mbrojtur ose përfaqësuar prej tij apo nëpërmjet akteve apo dokumenteve që ai ka pasur në dispozicion gjatë trajtimit të rastit konkret. Përrjashtim behët vetëm kur klienti i ka dhënë leje apo miratim me shkrim që një e dhënë që i përket rastit të tij të bëhet publike, por edhe kjo duhet trajtuar si e tillë vetëm duke u udhëhequr nga parime të larta etike dhe gjithnjë në interes të klientit.

Në praktikë, jo në pak raste ndodh që konfidencialiteti apo mbrojtja e të dhënave personale të mos kuptohet drejtë duke sjelle edhe keqkuptime e dëmtime të interesave të klientit apo të të tretëve. Prandaj këshillohet që avokati

gjatë veprimtarisë profesionale , në kontratën e porosisë që lidh me të asistuarin prej tij, të fiksojë në mënyrë të qartë dhe të saktë jo vetëm ekzistencën e këtij parimi themelor të rregulluar nga Ligji dhe Kodi Etik, por edhe mënyrën dhe kushtet se si të dhënat që janë marrë nga çështja apo dokumente të saj, mund të bëhen publike.

Detyrimi i ruajtjes së konfidencialitetit duhet të jetë i lidhur jo vetëm midis avokatit dhe klientit apo dokumenteve që ai ka në dispozicion për çështjen konkrete, por ky detyrim duhet të ekzistojë edhe në marrëdhëniet midis avokatëve të së njëjtës zyrë apo të stafit të tij, qoftë ky edhe staf administrativ. Avokati në procesin civil, shpesh herë nuk vepron si i vetëm, por edhe si përfaqësues i profesionalizimit dhe interesave të zyrës ku ai punon dhe në këto kushte detyrimin e konfidencialitetit nuk e ka vetëm avokati që merr në dorë trajtimin dhe ndjekjen e çështjes së një klienti konkret, si individ, por i gjithë personeli profesional dhe ai administrativ ku ai punon dhe ushtron veprimtarinë e tij.

Avokatët që punojnë në partneritet, ortakëri, apo të punësuar brenda një zyre apo shoqëri avokatie, prezumohet se janë në dijeni të çështjes apo të dhënave që ajo përmban, edhe në rastin kur çështja ndiqet vetëm nga njëri prej anëtarëve të zyrës.

Vërehet në praktikë se në rastet kur avokati, për arsye të ndryshme, heq dorë nga një çështje dhe prish si pasojë raportet me klientin e vet, të mos kujdeset me tej për konfidencialitetin. Kjo është e gabuar, ndërsa nga pikëpamja disiplinore kjo do të përbënte një shkelje shumë të rëndë për rregullat e Ligjit dhe Kodit Etikës. Kështu, avokati edhe pas prishjes së raporteve të punës me të asistuarin prej tij, duhet të kujdeset pa kufizim në kohë, që të ruajë dhe të mos bëjë publike të dhënat që ka ditur për klientin gjatë kohës që trajtonte rastin. Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit duke qenë një parim shumë i rëndësishëm që rrjedh nga dispozitat e ligjit dhe Kodi Etik, nuk është i kufizuar në kohë.⁵⁴

⁵⁴ As ligji që rregullon profesionin e avokatit që rregullon detyrimin e avokatit për të ruajtur të dhënat personale të klientit dhe për të mos i bërë ato publike (neni 9), por edhe as vetë Kodi Etik nuk përcaktojnë një kohë se deri kur mund të skadonte një afat i tillë, pas të cilit avokati mund të mos ishte më i kujdesshëm për të ruajtur konfidencialitetin e të dhënave (neni 14 Kodi Etik).

KREU 3

PËRGATITJA PARAPRAKE E ÇËSHTJES

Av. Artan HAJDARI, Prof. Dr. Mariana SEMINI-TUTULANI
dhe Av. Envi HICKA

3.1. Krijimi, administrimi dhe ruajtja e dokumenteve të çështjes. Llojet e provave dhe menaxhimi i tyre

3.1.1. Fazat që duhet të kalojë marrëdhënia avokat - klient para krijimit, administrimit dhe ruajtjes së dokumenteve të çështjes

Çështja e krijimit, administrimit dhe ruajtjes së dokumenteve është një çështje me rëndësi të madhe praktike në raportet që krijohen midis avokatit dhe klientit. Shpesh në praktikë krijohet një problem i madh në lidhje me këtë çështje dhe hera herës ndikon në ecurinë e ndjekjes së problemit juridik dhe të vetë rezultatit të çështjes. Prandaj, është e rëndësishme që të kuptohet drejtë kjo çështje, pasi nuk është çështje e trajtimit të ndonjë rregulli procedural apo me tej, të rregullave të vendosura nga Dhoma e Avokatisë, por është thjesht një raport që krijohet nga vetë avokati në marrëdhënie me klientin, në funksion të një mbrojtje cilësore. Krijimi dhe menaxhimi i provave ne raportet klient avokat është një çështje që kalon në disa faza.

Së pari, pasi avokati ka dëgjuar me kujdes klientin e tij për problemin që ka dhe pasi ka kuptuar dhe sqaruar çështjet që ai mendon se janë me interes nga ana profesionale, i kërkon klientit që të përgatisë një dosje me dokumentet që ai mendon se janë të nevojshme për t'u studiuar nga ana e avokatit. Ky moment nuk mendoj se ka ndonjë recetë të shkruar që klienti duhet të sjellë këtë apo atë dokument, pasi kjo varet nga çështja konkrete dhe nga mënyra se si e trajton profesionalisht rastin avokati. Në momentin që është rënë dakord për dokumentet që do të sjellë klienti, duhet bërë kujdes që ato të jenë fotokopjo dhe asnjëherë nuk duhen kërkuar dokumentet origjinale. Kjo për faktin se në praktikë shpesh herë kanë ndodhur keqkuptime për shkak të humbjes apo të dëmtimit të tyre.

Mirë do të ishte që, edhe kur një dokument duhej parë në origjinal për shkak të natyrës së çështjes, ai (dokumenti) ose të studiohej në prani të klientit ose mund të merrej në dorëzim me një akt formal për të mos krijuar keqkuptime për çdo situatë jo pozitive që mund të ndodhë në të ardhmen⁵⁵. Bashkëpunimi avokat-klient në këtë fazë është shumë i rëndësishëm, në mënyrë që të krijohet një ide më e qartë mbi çështjen dhe dokumentet që do të jenë bazë për zgjidhjen e saj.

Së dyti, nga takimi që ka bërë me klientin, avokati pasi ka krijuar një ide për çështjen dhe ka mbajtur shënimet përkatëse për rastin që do të trajtojë, si dhe pasi ka marrë edhe dokumentet që ka vlerësuar se janë të rëndësishme për çështjen, ai krijon një dosje ku shënon emrin e çështjes për ta identifikuar atë sa më lehtë, dhe më pas kalon në fazën e studimit të hollësishëm të rastit në fjalë. Në studim, atë e ndihmojnë jo vetëm dokumentet që ai ka në dosje, por edhe shënimet që ka mbajtur gjatë takimit të parë me klientin e tij. Gjatë studimit do të këshillohej, që përsëri të mbaheshin shënime pika të rëndësishme për çështjen si dhe të nxirreshin konkluzione të sakta, që rasti në fjalë ka argumente të bazuar në ligj dhe në prova.

Së treti, pasi është arritur në konkluzionin e mësipërm do të ishte me interes që të bëhej një takim tjetër me klientin për të vendosur strategjinë në lidhje me ecurinë e çështjes. Pra, sipas rastit do të ishte një çështje që mund të zgjidhej në rrugë jo gjyqësore, duke hyrë në kontakt me palën tjetër kundërshtarë apo avokatin e saj, para se të vendosej së çështja të shkonte në gjykatë.

Mund të ndodhë që gjatë takimit të dytë me klientin të vendosej bashkërisht që çështja në fjalë nuk do të kishte nevojë që të trajtohej gjyqësisht, apo për më tepër, nuk do të kishte sukses edhe në rast se do të vendosej që të ngrihej një padi. Kjo e fundit është shumë e rëndësishme që t'i shpjegohet klientit, pasi jo rrallë në praktikë hasim raste ku avokatë të ndryshëm, edhe pse e kuptojnë se çështja nuk do të kishte sukses, këshillojnë të kundërtën, duke orientuar klientin që të shkohet në gjyq. Në këtë pikë avokatin duhet që ta udhëheqë jo vetëm interesi më i lartë i klientit, por edhe fakti që ai (klienti) nuk duhet të shpenzojë të holla për një çështje që nuk fitohet apo që nuk ka argumente të mjaftueshëm për

⁵⁵ Në praktikë ndodh shpesh herë që avokati t'i kërkojë klientit një dokument origjinal për shkak të natyrës së çështjes. Duke qenë që ai është i vetëm dhe si i tillë është shumë i rëndësishëm për t'u paraqitur edhe në gjykatë në të ardhmen duhet bërë kujdes që edhe në qoftë se merret nga avokati të mos dëmtohet apo për më tepër të humbë. Kjo ndodh p.sh në çështjet me natyrë juridike që lindin nga marrëdhëniet juridike të trashëgimit, kur avokati i duhet që të studiojë aktin origjinal testamentar i përpiluar më dorën e trashëgimlënësit për të krijuar një ide më të qartë për përmbajtjen e vullnetit testamentar apo të shkrimit të tij, gjë që nuk mund të dallohej nga një akt fotokopjo. Në këtë rast mirë do të ishte që testamenti olograf të shihej dhe studiohej në prani të klientit dhe t'i kthehej përsëri atij, pasi është i vetmi akt që do të duhej për të zgjidhur sa më drejtë çështjen në rast të kontestimeve në gjykatë nga palët që ai i kundërhohet, për shkak të marrëdhënies juridike të trashëgimisë.

të luftuar në debatin gjyqësor. Avokati gjithashtu duhet të ngrihet mbi interesin e vogël të momentit, dhe duhet të nxjerrë në pah vlerat më të larta të përgatitjes profesionale dhe asaj etike.

Së fundi, duhet të themi se nga momenti i kontaktit që avokati është vënë me klientin e tij, menaxhimi i kohës ka rëndësi të madhe, dhe hera herës merr një dimension të rëndësishëm, edhe për vetë fatet e ecurisë së çështjes. Koha ka rëndësi jo vetëm në kuptimin e dyanshëm si të avokatit, ashtu edhe të klientit, pasi është e rëndësishme që të përmendim këtu shprehjen popullore se “koha është flori” dhe të dyja palët nuk kanë kohë për të humbur, por koha ka rëndësi edhe në kuptimin procedural dhe atë material. Në këtë të fundit mund të themi se studimi i thelluar i çështjes nga ana e avokatit ka rëndësi për vetë afatet e parashkrimit të së drejtës subjektive për t’iu drejtuar organit kompetent, pra për marrjen në konsideratë së pari, të institutit të parashkrimit. Po kështu menaxhimi i kohës ka rëndësi edhe për ngritjen e kërkimeve të ngutshme në kuptimin procedural, të cilat lidhen me garantimin e vetë të drejtave që pretendohet të fitohen në fund të gjykimit.

Një moment i rëndësishëm që duhet të trajtohet para se të vendoset për mënyrën e mëtejshme se si do të ndiqet çështja, është edhe marrëveshja monetare që avokati duhet të firmosë me klientin. Në këtë pikë gjithsecili që ushtron profesionin e avokatit, duhet të ketë parasysh dy parime të rëndësishme që rrjedhin nga ligji 9109, datë 17. 07. 2003 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, që lidhet me ndalesën e një marrëveshje për një shpërblim në natyrë të avokatit nga ana e klientit të tij, dhe së dyti duhet të merren në konsideratë çmimet dysHEME të vendosura për kategori çështjes apo këshillimesh juridike me akt nënligjor të përbashkët midis Dhomës së Avokatisë, Ministrisë së Drejtësisë dhe asaj të Financave.⁵⁶

3.1.2. Llojet e dokumenteve që krijon avokati

Në dritën e argumenteve të mësipërm dhe pasi marrëdhënia avokat-klient ka konsumuar fazat e mësipërme, si dhe është rënë dakord që çështja të shkojë në gjyq, avokati i del si detyrë që argumentet e studimit të çështjes t’i kthejë në argumente ligjore dhe t’ia paraqesë gjykatës në kërkesë-padinë që do ngrejë apo

⁵⁶ Neni 11 - 12 i ligjit parashikon mënyrën e shpërblimit të avokatit e cila kalon në këto momente. Së pari me marrëveshje midis klientit dhe avokatit. Së dyti kur nuk ka marrëveshje me shkrim referimi është akti nënligjor i nxjerrë me marrëveshje të titullarëve të tre institucioneve, Kryetarit të Dhomës Kombëtare të Avokatisë, Ministrit të Drejtësisë, dhe pasi është marrë mendimi i Ministrit të Financave. Së treti, avokati nuk i lejohet që të shpërblehet me përqindje nga ana klientit të vetë, por kjo e fundit lejohet vetëm si sukses i punës së tij në zgjidhjen e çështjes dhe kur është fiksuar me marrëveshje midis tyre (shih për këtë nenin 12 pika 2).

sipas rastit, në prapësimet apo kundërpadinë. Po kështu, edhe dokumentet që ai ka në dosje duhet t'í kthejë në prova në kuptimin e vlerës burimore të tyre. Qysh në fillim, duhet të themi se në kuptim të nenit 12 të K.Pr.C., pala që pretendon një të drejtë, ka detyrimin që në përputhje me ligjin të provojë faktet mbi të cilat ajo bazon pretendimin e saj. Është gjykata ajo që vendos, se cila provë e paraqitur nga avokati në interes të palës që ai përfaqëson, duhet lejuar për të provuar faktet mbi të cilat bazon pretendimet e tij. Prova e paraqitur duhet të jetë një provë e domosdoshme për procesin dhe që ka lidhje me çështjen në gjykim. Në këtë pikë si avokati, ashtu edhe gjykata luajnë një rol të rëndësishëm në seleksionimin e tyre. Si provat e paraqitura nga palët, ashtu edhe veprimet e tjera të kryera nga to gjatë gjykimit, synojnë në zbulimin e së vërtetës dhe kontribuojnë para së gjithash në dhënien e drejtësisë. Ashtu si provat shkresore që hyjnë në kategorinë e provave të formuara më parë, pra ato prova që paraqiten nga palët në gjykim në formën e dokumenteve, ashtu edhe pohimi gjyqësor, ekspertimi apo dëgjimi i dëshmitarëve hyjnë në kategorinë e provave që njihen nga ligji, por që konsiderohen prova që formohen gjatë gjykimit. Në kuptimin e mësipërm vetëm dokumentet që krijohen paraprakisht nga avokati dhe jashtë gjykimit, janë një nga llojet e provave më të rëndësishme që përdoren nga avokatët për të provuar pretendimet e tyre.

Është e rëndësishme që të njohim se nga pikëpamja doktrinës juridike, kemi edhe një ndarje të tjera të provave që lidhen me lëndën apo me anën materiale të saj. Këtu futen kategoria e sendeve të cilat shërbejnë gjatë procesit, që të merren informacione apo të saktësohen fakte të ndryshme, p.sh. këqyrja e ndërtimit të një muri. Burimi i informacionit për avokatin apo gjyqtarin për këtë lloj provash është i drejtpërdrejtë dhe merret nga këqyrja e drejtpërdrejtë fizike e sendit. E kundërta e provave materiale janë provat personale. Këtu hyjnë ato prova që mbështeten në thëniet e personave të tjerë. Këto të fundit, ndahen në prova verbale kur dijenia merret gojarisht nga personat, dhe në prova shkresore kur dijenia e tyre merret nga përmbajtja e shkresës.

Një kategori tjetër ndarje të provave është ndarja në prova direkte dhe në prova indirekte. Provat direkte shërbejnë për të provuar një fakt drejtpërsëdrejti dhe ato indirekte shërbejnë për të provuar një fakt jo drejtpërsëdrejti, por tërthorazi. Në praktikën e përditshme provimi i fakteve gjatë gjykimit nga burime të drejtpërdrejta apo të tërthorta, shpesh herë luan një rol të rëndësishëm në vetë fatet e gjykimit të një çështje, prandaj njohja e tyre si në aspektin teorik, ashtu edhe praktik nga ana e avokatëve ka rëndësi të madhe.

Natyrshëm lind pyetja se çfarë duhet të provojë avokati në favor të klientit

të tij, nëpërmjet provave që përgatit dhe që do t'i duhet që t'i paraqesë përpara gjykatës. Kjo lidhet me objektin e të provuarit dhe në këtë kuptim, objekt prove janë faktet juridike që përbëjnë themelin e padisë, të prapësimeve ose të kundërpadisë. Ndërkohë që fakte botërisht të njohura nuk kanë nevojë që të provohen, ato mund të përdoren nga avokati gjatë gjykimit si një element i thjeshtë i të provuarit, pa qenë nevoja që të provohen me prova të tjera. Të njëjtën gjë mund të themi edhe për faktet zyrtarisht të njohura nga gjykata për të cilat merret njoftim nga burime zyrtare dhe avokati duhet të mjaftohet vetëm më përmendjen e tyre përpara gjykatë. Po kështu nuk kanë nevojë të provohen nga avokati faktet e pakontestuar, të cilat nuk mund të kundërshtohen nga pala tjetër, pasi pasqyrojnë një burim objektiv. Po kështu është e rëndësishme që të theksojmë se gjatë gjykimit, avokati mund të mbështet në provimin e pretendimeve të tij edhe në prezumime të ligjit apo prezumime të faktit, të cilat ashtu si faktet e njohura botërisht, nuk kanë nevojë që të provohen.

Por, në rast se objekti i të provuarit janë faktet juridike që përbëjnë themelin e padisë, të prapësimeve apo të kundërpadisë, instituti i barrës së të provuarit, përbën një gurë themeli në njohuritë profesionale të avokatit. Neni 12 i K.Pr.C. përcakton detyrimin e palëve që në përputhje me ligjin të provojnë faktet mbi të cilat bazojnë pretendimet e tyre. Si rregull provat paraqiten nga palët, por në raste të caktuara ato mund të merren edhe nga vetë gjykata, kur vërehet se palët kanë mangësi në paraqitjen e tyre apo nuk i kanë paraqitur ato. Nisur nga roli i arbitrit që ka gjykata dhe në përputhje me parimin procedural se gjykata shprehet vetëm për aq sa kërkohet dhe për atë që kërkohet nga palët, roli i saj aktiv në marrjen e provave është shumë i kufizuar dhe si i tillë, i takon avokatëve të palëve të kujdesen për paraqitjen e provave në çështjen që ata përfaqësojnë.

Avokati duhet të ketë kujdes që provat duhet t'i paraqesë në përputhje me kriteret e vendosura në procedurë. Kjo në teori përputhet me kohën e paraqitjes së provës. Si rregull së bashku me paraqitjen e kërkesë-padisë në gjykatë duhet të paraqiten edhe aktet provuese, në numër aq sa janë të paditurit, neni 156/b K.Pr.C. Ky urdhërim i ligjit shpesh herë në praktikë nuk respektohet dhe neglizhohet si nga avokatët, ashtu edhe nga gjykata duke lënë një moment tjetër pas depozitimit të padisë, atë të paraqitjes së provave që përputhet me seancën përgatitore të çështjes. Në fakt është e rëndësishme që aktet provuese jo vetëm të listohen, por të tregohen edhe me përmbajte dhe numër kuptimi i tyre, si dhe së bashku me to, të paraqitet edhe lista e personave që kërkohet të thirret në gjykim.

Sa më mirë avokati të njohë, llojet e provave të njohura nga ligji dhe ndarjen e tyre sipas vështrimit doktrinal, mënyrën dhe kohën e paraqitjes së tyre në

gjykatë, çështjet teorike dhe praktike të barrës së të provuarit, për të drejtën që ai pretendon në interes të klientit të vetë, mund të themi se jo vetëm arrin objektivat e tij në raport me klientin e tij, por gjithashtu ndihmon në realizimin e drejtësisë dhe në zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor.

Çmuarja e provave është një aspekt tjetër i rëndësishëm i procesit civil. Duke qenë se provat janë mjetë të ndryshme të parashikuara nga ligji (më poshtë do shikojmë llojet e tyre), dhe që shërbejnë për të konstatuar faktet dhe për të zbuluar të vërtetën në një konflikt që zhvillohet në gjykatë midis dy palëve, mund të themi se njohja e tyre merr një rëndësi të madhe në punën praktike të avokatit. Procesi i çmuarjes së provës si një aspekt rëndësishëm i procesit civil, është një e drejtë e gjykatës gjatë shqyrtimit të një rasti konkret. Por që ai proces të shkojë në drejtimin e duhur, avokati duhet domosdoshmërisht të njohë jo vetëm llojet e provave të evidentuara dhe pranuar nga ligji, por edhe të dijë t'i vlerësojë ato nga pikëpamja e të çmuarit për faktin që ai pretendon të provojë nëpërmjet tyre.

3.1.3. Llojet e provave të njohura nga ligji procedural

a) *Pohimi gjyqësor.* Megjithëse pohimi gjyqësor apo shpjegimet e palëve nuk tregohen si një lloj i veçantë i provës në K.Pr.C. (neni 281), ato marrin një rëndësi të madhe në praktikën e procesit civil dhe si të tilla mund të trajtohen dhe kategorizohen si një lloj i veçantë i provës në këtë proces. Shpjegimet e palëve zakonisht në procesin civil, përgatiten nga avokati dhe i parashtrihen gjykatës në një mënyrë të tillë që t'i paraprijnë paraqitjes së fakteve të tjera provuese. Paraqitja e tyre duhet të jetë e kujdesshme dhe në funksion jo vetëm të shkakut ligjor dhe të objektit të ndërtuar të padisë, por edhe sipas një strategjie të tillë e cila të mos e vërë gjykatën në pozicion të tillë, që të mund të shfrytëzojë detyrime të tjera procedurale të cilat çojnë në thirrjen e vetë palës në proces për t'u dëgjuar personalisht (Neni 284 i K.Pr.C.).

Pohimi gjyqësor, mund të jetë i rastit ose i nxitur, nëpërmjet pyetjeve të bëra në mënyrë zyrtare për një qëllim të tillë. Nga përmbajtja e neneve 281 dhe 282 të K.Pr.C., avokati duhet të ketë kujdes që të ndajë pohimin gjyqësor nga pohimi jo gjyqësor. Pohimi gjyqësor është ai që vetë pala apo avokati i saj bëjnë përpara gjykatës, ndërsa pohimi jo gjyqësor bëhet jashtë procesit gjyqësor dhe mund t'i bëhet palës kundërshtarë apo avokatit të saj apo edhe një personi të tretë.

Avokati duhet të ketë kujdes, por edhe të këshillojë palën në rastin e një konflikti të mundshëm, që një pohim që lidhet me një fakt që do i nënshtrohet procesit të provuarit, mund të përbëjë në rrethana të caktuara, një provë të

pakundërshtueshme për rastin konkret dhe mund të përdoret kundër tij. Prandaj pohimi gjyqësor apo ai jashtë gjyqësor duhet parë në harmoni me strategjinë e gjykimit që ai do të ndjekë në interes të klientit të vetë, por për më tepër, në harmoni me gjithë provat që ai do të paraqesë në gjykim. Parimi i rëndësishëm procedural (neni 214 i K.Pr.C.), se pohimet e bëra në gjykatë prej palëve apo prej përfaqësuesve të tyre, çmohen nga gjykata pa nënvleftësuar provat e tjera dhe rrethanat e çështjes, është një parim shumë i rëndësishëm për t'u mbajtur parasysh gjatë punës praktike të avokatit.

b) Përcaktimi i listës së dëshmitarëve. Prova me dëshmitarë si në procesin penal, ashtu edhe atë civil merr një rëndësi të madhe praktike dhe avokatët duhet që jo vetëm të njohin kriteret procedurale të marrjes dhe paraqitjes para gjykatës të kësaj prove, por edhe të përcaktimit të listës së dëshmitarëve dhe të kohës së paraqitjes së saj. Sipas nenit 231 K.Pr.C., jo çdo thënie dëshmitari mund të përbëjë prove dhe të lejohet të merret si e tillë. Kjo pasi ligji procedural e kufizon marrjen e kësaj prove kur për vlefshmërinë apo provimin e një veprimi juridik kërkohet shkresë.⁵⁷ Dispozitat procedurale civile nga neni 231 deri në nenin 245, parashikojnë jo vetëm kufijtë e lëvizimit të marrjes së provës me dëshmitarë, por edhe rastet e lëvizimit të saj, rregullat e dëgjimit të dëshmitarëve, betimin e tyre, si dhe radhën e pyetjes dhe ballafaqimin e tyre. Njohja e thellë e këtyre dispozitave nga ana e avokatit ka rëndësi për vendimmarrjen e tij, se cilin apo cilën prej dëshmitarëve që mendon ai do ta përfshijë në listën e provave që do ja paraqesë gjykatës.

Është mirë që lista e dëshmitarëve për faktet që ai mendon të provojë gjatë gjykimit, të paraqitet së bashku me kërkesë padinë dhe së bashku me llojet e tjera të provave. Por, kjo nuk është taksative pasi gjatë gjykimit mund të lindë nevoja e paraqitjes së dëshmitarëve të tjerë shtesë që janë jashtë listës që ai ka paraqitur, ashtu siç mund të lindë nevoja të hiqet dorë nga pyetja e dëshmitarëve të paraqitur në listë. Thëniet e dëshmitarëve, ashtu si dhe pohimi i palëve para gjykatës apo jashtë gjykatës, duhen kuptuar jo të shkëputura nga provat e tjera, sidomos ato shkresore, por duhen marrë në harmoni të plotë me to dhe duhen vlerësuar gjithnjë në funksion të faktit që mendohet të provohet në gjykimin civil konkret.

c) Eksperti dhe Ekspertimi. Nevoja për realizimin e një akti i cili vlerëson në mënyrë shkencore një fakt të ndodhur, është një nevojë jo vetëm për gjykatën gjatë gjykimit të një çështje civile, por edhe për avokatin, para se ky të marrë

⁵⁷ Kështu është e rëndësishme të kuptohet se me dëshmitarë nuk mund të provohet kryerja e një veprimi juridik shitje, dhe në këtë rast bërja e tij me shkresë kërkohet jo vetëm për vlefshmërinë e veprimit juridik, siç është rasti i shitjes së pasurisë së paluajtshme, që forma shkresore kërkohet jo vetëm për provueshmërinë por edhe për vlefshmërinë e veprimit juridik, por edhe në rastet e shitjeve të tjera të sendeve të luajtshme, ku prova me dëshmitarë nuk mund të shërbejë për të provuar kryerjen e veprimit juridik, por në këtë rast nevojitet shkresa vetëm për provueshmërinë e tij.

një vendim për ta çuar zgjidhjen e konfliktit para gjykatës. Duke qenë se, akti i ekspertimit është një argument shkencor që avokati apo gjyqtari nuk mund ta realizojnë dot vetë me njohuritë që kanë, si dhe vetë eksperti është një gjyqtar apo avokat shkencor, mund të themi se njohja e procedurës së realizimit të tij, e për më tepër vlera që ai mbart në vetvete për sqarimin e një ngjarje natyrore apo juridike, merr një rëndësi të madhe si për punën praktike të avokatit, ashtu edhe për vetë zgjidhjen e çështjes që ai përfaqëson.

Në punën e përditshme të avokatit si një mbrojtës i interesave të klientit që ai përfaqëson, shpesh herë nuk kuptohet drejtë roli i ekspertit dhe i aktit të ekspertimit, duke e kuptuar dhe kufizuar atë vetëm në një rol që drejtohet dhe udhëhiqet ekskluzivisht nga gjykata dhe se ka vlerë vetëm gjatë procesit gjyqësor. Është e vërtetë që, në kuptimin e ligjit procedural civil, për sqarimin e situatave juridike që tejkalojnë interpretimin gjyqësor dhe kërkohen njohuri shkencore, gjyqtari me kërkesë të palëve apo edhe vetë kryesisht dhe pasi merr edhe mendimin e tyre (palëve), cakton një ekspert të fushës kompetente për përgatitjen e aktit të ekspertimit (neni 225 K.Pr.C.). Por, gjithashtu në praktikë sqarimi i një situatë që kërkon një mendim të kualifikuar shkencor nga një ekspert i fushës kompetente, mund të bëhet edhe jashtë-gjyqësisht dhe para se të merret një vendim për të çuar një çështje në gjyq.

Në këtë aspekt, natyrshëm lind pyetja që, çfarë vlere ka një akt i tillë i marrë jashtë procesit gjyqësor dhe kuptimit të nenit 225 të K.Pr.C. Përgjigjen e ka dhënë praktika e përditshme e punës së avokatit dhe marrëdhëniet e tij me klientin, për të sqaruar, jo vetëm bazueshmërinë në ligj të rastit që ai trajton, por edhe për të marrë një vendim sa më të drejtë për zgjidhjen e konfliktit. Kjo bën që të menaxhohet më mirë profesionalisht rasti konkret dhe gjithashtu aspekti monetar dhe ai kohor. Çfarë do të ndodhte, në rast se avokati vendosë që të shkojë në gjyq për të zgjidhur një konflikt që rrjedh nga një marrëdhënie trashëgimie testamentare, me shkak pavlefshmërinë e saj si pasojë e falsitetit të firmës së testatorit dhe kjo situatë që kërkon një mendim të kualifikuar shkencor, bëhet gjatë gjykimit?! Nuk do të shihej më vend që kjo situatë të zgjidhje nga avokati para se të vendosej që të shkohej në gjyq, duke e sqaruar këtë problem thelbësor për zgjidhjen e çështjes përmes mendimit profesional të një eksperti të fushës kompetente? Natyrisht që përgjigja është logjiksht pozitive.

Kjo do të kursente kohë e vlera monetare që do të binin në kurriz të klientit, por edhe do të tregonte profesionalizëm. Çështje të karakterit të mësipërm që kërkojnë njohuri shkencore dhe që fiksohen në një akt shkencor ekspertimi, para se avokati të vendosë së bashku me klientin që t'i drejtohet gjykatës, ka

shumë në praktikë dhe sigurisht janë të ndryshme e duhet të trajtohen me kujdes dhe rast pas rasti.

Duhet pasur kujdes që një akt ekspertimi i përgatitur me kërkesë të avokatit, nuk ka vlerën e një prove paraprake pavarësisht rezultatit të tij, ashtu si dhe gjithë dokumentet e tjerë shkresorë apo provat e tjera që sqaruar më sipër dhe do sqarojmë më poshtë në këtë punim, por ai pa asnjë hezitim mund të jetë pjesë e listës së tërësisë së dokumenteve që avokati i bashkëngjijt padisë apo kundërpadisë. Si të gjithë provat e tjera edhe ky akt nuk ka vlerë paraprake dhe si i tillë do i nënshtrohet vlerësimit nga ana e gjykatës gjatë procesit civil.

Në praktikë ka ndodhur që një akt i realizuar në një fazë të tillë dhe që sqaron një situatë juridike, gjykata e ka parë të panevojshme që të mos ja nënshtrojë kontrollin e tij, një akti tjetër ekspertimi, pavarësisht kërkesës së palës tjetër dhe përmbajtjes së dispozitave procedurale që flasin për vlerën dhe natyrën e aktit të ekspertimit. Natyrisht që ky është përjashtim dhe jo rregull dhe vlera dhe synimi i aktit që përgatitet para se një çështje të vendoset për t'u çuar në gjyq nga avokati nuk është kjo, por ajo e sqarimit të çështjes paraprakisht dhe e marrjes së një vendimi të drejtë. Kjo tregon drejtimin që ka ecur praktika gjyqësore në raste të caktuara, në vlerësimin që i bën një akti ekspertimi i marrë në një rrugë paraprake nga ana e avokatit të palës, por që i jep procesit civil drejtimin dhe zgjidhjen e duhur.

Si përfundim, ne lidhje me ekspertimin dhe aktin e ekspertimit në punën e avokatit në një konflikt të mundshëm civil, mund të themi se:

1. Akti i ekspertimit i realizuar në një fazë paraprake nga ana e avokatit shërben për të sqaruar çështjen dhe i jep mundësi atij dhe klientit të tij, që të menaxhojë faktorë të rëndësishëm të procesit, siç është zgjidhja profesionale dhe e drejtë e çështjes, si dhe të kursejë kohë në punën e tij dhe vlera monetare në favor të klientit të tij.

2. Akti i ekspertimit i realizuar nga avokati para se të ketë vendosur të çojë çështjen në gjyq, përjashtimisht mund të marrë vlerën e provës gjatë gjykimit në raport edhe me provat e tjera, pa ju nënshtroar një kontrolli nëpërmjet një akti tjetër. Synimi siç thamë më sipër nuk është ky, por ai i konkluzionit të arritur në pikën e mësipërme.

d) Provat shkresore. Ashtu siç thamë edhe më sipër, prova shkresore është ajo që del nga përmbajtja e një dokumenti apo një shkrese. Në kuptim të ligjit procedural, shkresat kanë fuqi provuese kur janë hartuar në formën e caktuar, kanë elementët e nevojshëm për vlerën e tyre, nuk janë të copëtuara, të grisura ose të shuara, nuk kanë gërvishtje, ose shtesa midis rreshtave, ose çrregullime të tjera me shuarje dhe nuk mund të lexohen (neni 246 i K.Pr.C.).

Përmbajtja e përkufizimit të mësipërm i jep avokatit kuptimin e një akti të shkruar i cili mund të përbëjë provë dhe të jetë i vlefshëm si e tillë, për të provuar pretendimet që ai do të ngrejë gjatë gjykimit, në lidhje me faktet që do të parashtrijë. Natyrisht që duhet bërë kujdes që, provat në kuptimin e shkresës të jenë të tilla që të tregojnë sa më qartë dhe saktë atë fakt që kërkohet të provohet. Si të tilla, ato duhen kuptuar si përmbajtje e një mendimi që mund të perceptohet lehtësisht nga ana e gjyqtarit të çështjes.

Avokati duhet të dijë dhe të njohë mirë argumentin teorik dhe atë praktik, se për çfarë nevojitet një akt i shkruar apo shkresë. Në kuptimin që i jep doktrina e së drejtës procedurale civile këtij argumenti, mund të themi se akti i shkruar apo shkresa janë të vlefshëm për:

(1) provimin e një veprimi apo një marrëdhënie juridike (*ad probationem*), dhe në këtë rast kufizohet përdorimi i provës me dëshmitarë për të provuar ekzistencën e këtij veprimi apo të kësaj marrëdhënie juridike;

(2) si një kriter apo element përbërës i vetë veprimit juridik apo marrëdhënies juridike, dhe në këtë rast nuk është një mjet provimi, por një kusht thelbësor i vetë vlefshmërisë dhe ekzistencës së vetë veprimit apo marrëdhënies juridike (*ad substantiam ose ad solemnitatem*).⁵⁸

Në dritën e argumenteve të mësipërme, avokati duhet të ketë kujdes që, gjatë punës së tij praktike të dijë të kuptojë dhe të ndajë qartë faktin se, në cilat raste shkresat përbëjnë dhe konsiderohen element të vetë veprimit juridik (*ad substantium*) dhe në cilat raste ato kërkohen vetëm për provimin e veprimit juridik (*ad probationem*). Natyrisht kjo kërkohet të shihet rast pas rasti dhe është çështje e rregullimeve ligjore të posaçme të vetë Kodit Civil. Duke qenë një çështje ligjore, avokati në praktikë duhet të konsiderojë kriterin ndarës të ekzistencës së shkresës si provë shkresore, që në disa raste kërkohet që veprimet juridike, si kategori juridike e të drejtës civile, të kryhen me akt noterial dhe si të tilla mungesa e aktit do t'i bënte ato të pavlefshëm, si dhe të shkresës së thjeshtë që kërkohet vetëm për të provuar ekzistencën e vetë veprimit juridik, që do të thotë se mungesa e shkresës nuk e bën atë të pavlefshme, por ekzistenca e vetë veprimit juridik nuk mund të provohet me dëshmitarë.

Disa nga veprimet juridike që duhet të bëhen me shkresë, i gjejmë në pjesën e posaçme të së drejtës civile dhe kanë të bëjnë me kontrata të ndryshme. P.sh. duhet

⁵⁸ Neni 83 i Kodit Civil parashikon se, kontratat e shitjes së sendeve të paluajtshme duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohen, përndryshe veprimi juridik do të ishte i pavlefshëm. Në këtë rast kuptohet qartë që shkresa (për më tepër e veshur me solemnitet, akt noterial), kërkohet për ekzistencën e vetë marrëdhënies juridike, pra të veprimit të shitjes. Vendimi Unifikues nr. 1, datë 06.01.2009, nuk ka ndryshuar asgjë në këtë drejtim, përveç faktit që nuk e quan aktin noterial (shkresa) pjesë përbërëse të veprimit juridik. Por e konsideron atë, të realizuar në momentin e shfaqjes së vullnetit të palëve para noterit.

të bëhen me shkresë, ndryshe nuk mund të provohen me dëshmitarë, kontrata e dorëzarisë, kontrata e furnizimit, kontrata e qirasë, e nën qirasë, kontrata e huapërdorjes etj. Ndërsa disa nga veprimet juridike që kërkojnë veshjen me një formë të caktuar të vullnetit të palëve, me akt noterial ndryshe nuk janë të vlefshme janë, kontrata për shitjen e sendeve të paluajtshme, kontrata paraprake që lidhet me synim shitjen në të ardhmen të pasurive të paluajtshme, heqja dorë nga pronësia në dobi të një të treti, kontrata e shkëmbimit të sendeve të paluajtshme, kontrata për vënien në hipotekë të një sendi të paluajtshëm, prokura për të lidhur një kontratë e cila sipas ligjit duhet të bëhet me akt noterial etj.

Natyrisht njohja jo vetëm e kriterëve të vendosur nga doktrina se për çfarë kërkohet shkresa gjatë realizimit të një veprimi juridik, por edhe njohja praktike e kërkesave të ligjit të posaçëm civil se kur kërkohet materializmi i këtij kriteri, për t'i dhënë vlerën e provueshmërisë apo vlefshmërisë së vetë veprimit juridik, merr një rëndësi të madhe praktike në punën e një avokati që, ndan profesionin e tij me çështje të natyrës të së drejtës civile.

Është e rëndësishme për avokatin e praktikës që jo vetëm të njohë kriteret e ligjit procedural të aktit si shkresë provuese në një proces civil, por edhe ndarjen që i bënë ligji dhe teoria, duke u nisur nga vlera burimore të ndryshme. Në doktrinën e së drejtës procedurale civile përdoren këto kriteret për ndarjen e shkresës.

1. *Kriteri i vendit apo personit nga të cilat rrjedh një shkresë.* Në këtë pikëpamje shkresat i ndajmë, në *shkresa zyrtare* dhe në *shkresa private*. Të parat (*shkresa zyrtare*), janë në një kuptim të gjerë aktet zyrtare që nxirren gjatë veprimtarisë së organeve të pushtetit qendror dhe vendor, brenda kufijve të kompetencës së personave që janë ngarkuar me detyrë për nxjerrjen e tyre dhe të dytat (*shkresa private*) janë ato që në një kuptim të thjeshtë dhe praktik përpilohen nga persona privatë, gjatë një veprimtarie të thjeshtë të përditshme të jetës së tyre, por që mund të ndikojë në një marrëdhënie juridike civile të caktuara.

2. *Kriteri i formës.* Sipas këtij kriteri shkresat ndahen në *shkresa të cilësuar* dhe në *shkresa të thjeshta*. Janë të cilësuar ato që përpilohen nga persona zyrtarë gjatë kryerjes së veprimtarisë së tyre shtetërore, dhe në shkresa të thjeshta ato që përpilohen nga persona privatë.

Është e natyrshme që për avokatin, nuk do të mjaftonte vetëm njohja me çështjet e mësipërme në lidhje me kuptimin e shkresës, fuqinë provuese të tyre apo kriteret e ndarjes së saj, por interes praktik kanë edhe disa çështje që lidhen jo vetëm me mënyrën e paraqitjes së dokumenteve apo shkresave në gjykatë, por

edhe të kërkimit të tyre nga ana e avokatit nga institucionet e ndryshme, si dhe mënyrat dhe taktikat që përdoren për kundërshtimin e tyre dhe goditjen për falsitet.

Mënyra e paraqitjes dhe kërkimit të shkresave. Si rregull dokumentet, përfshirë ato zyrtare apo ato private, paraqiten nga ana e avokatëve të palëve në gjykatë në kuadër të fakteve që ato do të provojnë në një çështje konkrete. Por, mund të ndodhë që ato të merren edhe nga vetë gjykata kur shikohen se janë të nevojshme për zgjidhjen e çështjes, ose nga vetë avokati duke ushtruar të drejtat që rrjedhin nga neni 6 i ligjit nr. 9109, datë 17. 07. 2003 “Për profesionin e avokatit në RSH” si dhe neni 264 dhe 265 i K.Pr.C., të cilat kanë të bëjnë me detyrimin për paraqitjen e provës shkresore. Ushtrimi i të drejtave të njohura nga rregullat e dispozitave ligjore të përmendura më sipër, është mirë që të përdoren në rastin më të parë dhe të duhur nga avokati, pasi përmbajtja e tyre është e qartë që, institucionet dhe personat e tjerë që nuk marrin pjesë në gjykim, janë të detyruara që t’i dorëzojnë gjykatës një dokument apo shkresë që u kërkohet nga avokati dhe që ndodhet pranë tyre por që ka vlerë për gjykimin që po zhvillohet dhe ndihmon në rezultatin final në dhënien e drejtësisë.

Mënyra dhe kriteret ligjore të kundërshtimit të dokumenteve. Kjo është një procedure e nevojshme për t’u njohur në praktikën e punës së një avokati që merret me çështje civile. Kriteri doktrinal i kundërshtimit të shkresës që është paraqitur në gjykatë nga avokati i palës tjetër është ky :

1. Duke thënë që shkrimi apo nënshkrimi i vendosur në shkresë nuk është i palës apo personit që e ka përpiluar apo firmosur atë.
2. Duke pohuar pretendimin se shkrimi ose nënshkrimi i vendosur në një shkresë të thjeshtë të jetë i trashëgimlënësit apo një personi tjetër që mendohet se tërheq të drejta nga ky gjykim.
3. Duke ngritur pretendimin për shkresën zyrtare se është e falsifikuar (neni 273 i K.Pr.P.). Në këtë rast ai që pretendon falsitetin e një shkresë është i detyruar që të provojë falsitetin dhe të tregojë shkresat që provojnë këtë, dëshmitarët apo mjetet e tjera provuese.

Dokumentet për krahasim, dhe procedura e krahasimit është ajo e përcaktuar në nenin 269 të K.Pr.C. Në praktikë dokumentet që mund të përdoren për tu krahasuar me ato shkresa apo akte që kundërshtohet origjinaliteti i tyre janë:

1. Aktet noteriale, ose akte zyrtare që përmbajnë nënshkrimin e palës që ka kundërshtuar origjinalitetin ose vërtetësinë e dokumentit.
2. Shkresa të karakterit zyrtar në përmbajtje, që ka shkruar vetë personi zyrtar, të cilit do i nënshtrohet verifikimi i nënshkrimit.
3. Shkresa të ndryshme të karakterit të thjeshtë në përmbajtje, të cilat mund

të jenë përpiluar apo nënshkruar nga vetë personi, të cilët do i verifikohet shkrimi apo nënshkrimi.

4. Pjesë të përmbajtjes së dokumentit zyrtare apo të thjeshtë, të cilat janë pranuar nga personi që pretendon jo origjinalitetin e tyre.

E rëndësishme për avokatin është që, të njohë jo vetëm kriteret dhe procedurat e krahasimit të dokumenteve, por edhe të këtë njohuri të mjaftueshme për teknikat e krahasimit të tyre. Këto të fundit, mund të përdoren nga vetë avokati kur janë të thjeshta dhe provojnë në mënyrë të qartë mungesën e origjinalitetit të dokumentit me anë të metodës së thjeshtë më sy të krahasimit dhe në raste me të komplikuar por dhe kur kërkohet nga palët ndërgjyqëse, mund të nevojitet detyrimisht një ekspert për të provuar atë që kërkohet. Kjo e fundit është metoda që përdoret zakonisht në praktikë.

Goditja e dokumenteve për falsitet. Kriteret dhe përmbajtja e goditjes së një shkresë për falsitet, parashikohet në nenet 270 e vijues të K.Pr.C. Është e rëndësishme për një avokat të praktikës që të dijë se kur dhe në çfarë kushtesh mund të bëhet një kërkim i tillë. Si rregull goditja për falsitet bëhet si për shkresat zyrtare, ashtu edhe ato private (neni 270 K.Pr.C.). Ligji procedural civil parashikon se, kur rezulton një shkresë e falsifikuar dhe kjo i atribuohet një personi konkret, zakonisht këshillohet pezullimi i çështjes civile, pritja e përfundimit të çështjes penale dhe përdorimi i vendimit penal të formës së prerë për sa i përket faktit të ekzistencës së falsitetit të provës së marrë në procesin civil (neni 272 K.Pr.C.).

Avokati në praktikë duhet të jetë i orientuar drejtë për sa përket mënyrës së si mund të bëhet goditja për falsitet e një akti gjatë procesit civil. Në kuptimin praktik një shkresë mund të goditet për falsitet në mënyrë incidentale gjatë një gjykimi të padisë të themelit (neni 270 i K.Pr.C.), por ka edhe mendime që goditja për falsitet mund të bëhet si një kërkim më vete. Kjo nuk na rezulton nga përmbajtja e ligjit për me tepër jurisprudenca ka treguar që duhet të ekzistojë një interes i ligjshëm, pra të kemi një padi të ngritur, në mënyrë që të kërkohet edhe falsiteti i një shkrese. Duhet pasur parasysh se falsiteti i një shkrese për sa i përket objektit, mund të kërkohet si një falsitet material ose si një falsitet intelektual. Falsiteti është material kur është ndërhyrë në shkresën origjinale dhe intelektual kur shkresa e dalë nga personi zyrtar nuk shpreh përmbajtje të vërtetë, apo kur një akt është privat përmbajtja e tij bie ndesh me deklaratimet që janë bërë nga vetë palët apo avokatët e tyre gjatë procesit civil.

3.2. Kërkimi shkencor

Përgatitja për dhënien e shërbimit të avokatisë është një nga momentet e rëndësishme për të arritur një mbrojtje të efektshme dhe profesionale. Puna e çdo avokati në dhënien e shërbimit të tij duhet të konceptohet si një punë studimore dhe shkencore. Kjo për faktin se çdo çështje gjyqësore përfaqëson në vetvete një gërshetim të elementit unik me elementin ngjashmëri në precedentë të ngjashëm.

Puna studimore e avokatit për çdo rast konkret duhet të ndjekë disa etapa në mënyrë që të konkludojë me një paraqitje dinjitoze dhe profesionale të mbrojtjes nga ana e avokatit. Radha e ecurisë së këtyre etapave mund të ndryshojë nga njëri rast në tjetrin, në varësi të specifikave dhe veçantive që paraqet çdo situatë juridike, por mbetet e rëndësishme të kuptohet që ato duhet të jenë të gjitha në mënyrë kumulative pjesë e punës kërkimore e shkencore të avokatit në çdo çështje juridike.

Më konkretisht, hapat që duhet të ndiqen në fushën kërkimore për përgatitjen e çështjes janë, si më poshtë:

- Analiza e rrethanave dhe të fakteve që paraqet klienti lidhur me situatën juridike për të cilën ka nevojë për mbrojtje ligjore dhe ndërtimi i strategjisë së mbrojtjes;
- Listimi i provave të nevojshme, përcaktimi i mënyrës së sigurimit të tyre dhe të depozitimit të tyre në gjykatë, si dhe analiza e provave;
- Përcaktimi i kërkesëpadisë që siguron në mënyrë më të plotë, më të thjeshtë dhe më të sigurt vendosjen në vend të së drejtës së shkelur të klientit apo realizimin e fitimit të një të drejte të tij të mohuar;
- Përcaktimi i bazës ligjore të nevojshme për mbrojtjen e çështjes;
- Seleksionimi dhe analiza e vendimeve unifikuese të Gjykatës së Lartë apo të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese që kanë ngjashmëri me fabulën e çështjes konkrete që përgatit të mbrojtje avokati;
- Seleksionimi dhe analiza e vendimeve të GJEDNJ në Strasburg apo të Gjykatës së Drejtësisë në Luksemburg, që kanë ngjashmëri me fabulën e çështjes konkrete që përgatit të mbrojtje avokati;
- Seleksionimi i doktrinës së nevojshme juridike për dhënien e përgjigjeve ndaj pyetjeve të shtruara për diskutim.

Të gjitha këto etapa duhet të jenë pjesë e një planifikimi me natyrë strategjike të ndërtuar e të ndjekur me kujdes nga avokati dhe të njohur dhe të miratuar edhe nga klienti.

3.2.1. Analizimi i rrethanave, menaxhimi i situatës/rastit juridik dhe përcaktimi i strategjisë së mbrojtjes

Intervistimi i klientit. Për të analizuar të gjitha rrethanat e çështjes konkrete, duhet të hetojmë palën e cila paraqitet për të qenë klienti i avokatit. Duhet të njihemi me shkaqet për të cilat kërkohet shërbimi, nëse duhet dhënë një këshillë juridike, nëse do të hartohet një kontratë apo akt i një natyre ligjore, nëse do të përgatitet mbrojtja në një proces gjyqësor, etj. Në këtë fazë fillon ngritja apo shtrimi i problematikës ligjore, ndërtimi i hipotezave dhe shndërrimi i tyre në teza. Intervistimi realizohet përmes pyetjeve të hapura, ku klienti orientohet që të flasë lirshëm dhe me detaje, ndërsa avokati mban me kujdes shënimet e tij. Pas një shpjegimi me natyrë përshkruese të situatës për të cilën klienti kërkon mbrojtje ligjore, atëherë avokati vijon me pyetje që lidhen me detajet e çështjes.

Ndërtimi i skemës së planifikimit strategjik. Më konkretisht, pas sqarimit të rrethanave paraprake të çështjes, ndërtohet strategjia e mbrojtjes dhe përcaktohen argumentet në favor të secilit hap apo veprim, por edhe argumentet kundër secilit hap apo veprim. Ndërtimi i skemës së strategjisë së mbrojtjes gjyqësore lidhet me elementë të tillë si: përcaktimi i problemeve juridike të nevojshme për diskutim; radha e paraqitjes së provave; mënyra e realizimit të pyetjeve në proces, pretendimet dhe argumentet që do të përdoren, analizat e nevojshme me karakter logjik, etj. Kështu, nëse avokati konstaton, se pas intervistës apo bisedës paraprake që ka bërë me klientin e tij, e ka evidentuar se cila e drejtë i është shkelur klientit të tij, duhet të sqarojë si e provon klienti që është mbajtës i së drejtës që pretendohet se është shkelur, cilat janë kufijtë e kësaj të drejte, si mund të provohet kjo shkelje, cili është personi fizik apo juridik që ka cenuar apo shkelur të drejtën e klientit, çfarë pasojash kanë ardhur nga kjo shkelje. Lidhur me sa më sipër avokati duhet të listojë edhe provat, dokumentet, apo dëshmitarët që e vërtetojnë të drejtën dhe kufijtë e saj apo shkeljen dhe kufijtë e saj.

Hapi i parë strategjik është që avokati dhe klienti të bien dakord për një proces të planifikimit strategjik, sepse është shumë e rëndësishme që ata të kenë një vizion të përbashkët dhe të përqendrohen njëlloj në qëllimet. Planifikimi i mbrojtjes apo dhënies së shërbimit nga ana e avokatit është momenti më i rëndësishëm, sepse e ndihmon që të jetë i organizuar dhe t'i përgjigjet nevojave të klientit duke kontribuar në stabilitetin e mbrojtjes dhe duke lehtësuar zhvillimin e saj. Planifikimi është i rëndësishëm sepse i përgjigjet një mjedisi të ndryshueshëm, që përfshin në vetvete persona, organe, institucione, si për shembull gjyqtarë, ekspertë, palë ndërgjyqësore, media, etj. Çdo planifikim parashikon të ardhmen dhe realitetin duke tentuar të jetë më i fokusuar në objektivat specifike dhe afate kohore të planifikimit strategjik.

Planifikimi strategjik është procesi që zhvillon një vizion për të ardhmen e mbrojtjes ligjore të çështjes konkrete, që përcakton prioritetet e nevojshme, procedurat dhe veprimet për të arritur këtë vizion. Këtu përfshihen si: qëllimet e matshme, të cilat janë realiste dhe të arritshme, ashtu edhe qëllimet sfiduese dhe objektivat të cilat janë të shoqëruara me dilema apo me rreziqe të papritura. Planifikimi strategjik është procesi i vetë-ekzaminimit, i konfrontimit të zgjedhjeve të vështira dhe i vendosjes së prioriteteve. Planifikimi strategjik përfshin përcaktimin e një rrugëtimi apo të një grafiku ku avokati do të ecë në të ardhmen dhe të cilën ai beson se është më e mundshme për të arritur objektivin që kanë së bashku me klientin si destinacion final.

Hetimi i mjedisit ku ka lindur nevoja për mbrojtje ligjore. Hapi i dytë strategjik është që avokati të kryejë një hetim të mjedisit ku ka lindur konflikti apo nevoja për mbrojtjen e të drejtave të klientit. Kjo ndihmon për të siguruar një përgjigje për pyetjen: Si lidhet çështja gjyqësore me mjedisin dhe faktorët e jashtëm? Përgjigja do të fokusohet në identifikimin dhe vlerësimin e mundësive, rreziqeve dhe kërcënimeve, me vlerësimin e pikave të forta të mbrojtjes dhe me evidentimin e dobësive që nuk është gjë tjetër veçse ajo që në praktikën ndërkombëtare quhet shpesh “SWOT”⁵⁹: pikat e forta, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet. Pjesë e këtij hetimi është vlerësimi i bashkëpunëtorëve aktualë dhe potencialë, si dhe vlerësimi i konkurrentëve.

Një element i rëndësishëm në ndërtimin e strategjisë është përcaktimi i nevojës për ekspert të një fushe specifike që lidhet me gjykimin, apo kryerja e eksperimentimit gjyqësor, kryerja e ballafaqimit të dëshmitarëve, apo personave të tjerë pjesëmarrës në gjykim, etj.

Radha e kryerjes së veprimeve dhe kohëzgjatja e tyre. Kur flasim për strategji, do të kemi parasysh jo vetëm radhën e veprimeve që do të kryhen, por edhe kohëzgjatjen e secilit prej tyre dhe faktorët që ndihmojnë e pengesat që vështirësojnë dhënien e shërbimit të avokatit. Lidhur me radhën e veprimeve dhe kohën e kryerjes së secilit, avokati mund të ndërtojë strategji të ndryshme.

Për shembull, nëse vëren se e drejta e shkelur ka afat parashkrimi dhe koha nuk pret, ai procedon me ngritjen e padisë dhe pastaj vijon me sigurimin e provave dhe plotësimin e elementëve të tjerë të strategjisë. Në rastin kur problemi i parashkrimit nuk ekziston, atëherë avokati mund të ndjekë një strategji ku liston provat dhe siguron secilën prej tyre dhe vetëm pasi i plotëson ato harton kërkesëpadinë dhe e paraqet në gjykatë. Në rastin e mëposhtëm mund të shohim

⁵⁹ *Shënim i autorit:* SWOT në gjuhën angleze do të thotë: *strength, weaknesses, opportunities, threats* - fuqitë, dobësitë, mundësitë, kërcënimet.

se çfarë situatë krijohet nga parashkrimi i një të drejte që lidhet me kushtin penal dhe çfarë fati pësojnë padia dhe kundërpadia si rezultat i saj:

Rasti: “Padiës i kundërpaditur Ins i sig. kundër i padituri kundërpaditës Shoq. “Lura” sh.p.k. dhe person i tretë Dega Bankës së Kursimeve Tiranë”⁶⁰
*me objekt padie: pagim i kamatëvonesave dhe objekt i kundërpadisë: detyrimin e palës së kundërpaditur të paguajë vlerën e dëmit. Nga hetimi gjyqësor i çështjes rezultoi se Padiësi kundërpaditur kanë nënshkruar midis tyre kontratën nr.1 dt. 12.02.1998 objekt i së cilës ka qenë edhe ndërtimi i godinës rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë. Sipas nimit 6, të kësaj kontrate, palët kanë rënë dakord që ky ndërtimi të përfundonte brenda 160 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës. Pretendimi i palës paditëse të kundërpaditur është se dorëzimi i objektit të ndërtuar nga i padituri kundërpaditës është bërë tej afateve të parashikuara në kontratë. Gjykata duke iu referuar neneve 115-118 të Kodit Civil arrin në përfundimin se kërkesë padia duhet të rrëzohet për shkak të plotësimit të afatit të parashkrimit të padisë. Në dispozitat e sipërcituara parashikohet se paditë **për kërkimin e kushtit penal** sipas kontratave të lidhura parashkruhen brenda 6 muajve. Në rastin tonë objekti i konfliktit është një detyrim kontraktor **i lidhur** me afat ekzekutimi dhe parashkrimi i padisë fillon nga dita kur është plotësuar ky afat sipas kontratës. I padituri kundërpaditës në kundërpadinë e paraqitur pretendoi se pala paditëse e kundërpaditur nuk ka qenë korrekte në përmbushjen e detyrimeve në likuidimin e pagesave, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në kontratë. Këto pretendime të të paditurit u kundërshtuan gjatë shqyrtimit gjyqësor nga pala paditëse e kundërpaditur. Duke qenë se i padituri kundërpaditës ka pasur **barrën e provës për të provuar pretendimin e tij**, Gjykata arrin në përfundimin se edhe kundërpadia nuk mund të pranohet. Gjatë shqyrtimit të çështjes, rezultoi se nga ana e të paditurit kundërpaditës, volumet e reja janë më të vogla se ato të parashikuara në projekt.*

Kur objekti i gjykimit rrezikon që të shitet nga pala kundërshtare apo të transferohet në emër të një të treti, apo kur shuma në të holla rrezikon që të tërhiqet nga debitori para se të përfundojë gjykimi, atëherë avokati procedon paralelisht me ngritjen e padisë edhe me kërkesën për sigurimin e objektit të saj. Madje, kur çështja është aq emergjente sa koha nuk pret, paraqet paraprakisht kërkesën për sigurimin e padisë dhe pastaj kujdeset që të depozitojë edhe padinë sa më shpejt, brenda afateve procedurale ligjore.

Në rastin kur klienti nuk është padiës, por është i paditur, atëherë avokati, duhet të shikojë se çfarë padie është ngritur kundër klientit të tij dhe cilat janë provat që ka paraqitur padiësi. Kjo i jep mundësi që të shohë se çfarë hapësire ka për mbrojtjen. Një moment i rëndësishëm është të gjejë pikat e dobëta në

⁶⁰ Me vendimin nr. 480, dt. 08.02.2002 Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë vendosi rrëzimin e kërkesë padisë, rrëzimin e kundërpadisë. Gjykata e Apelit Tiranë e cila me vendimin nr. 961 dt, 01.10.2002 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 480. dt.08.02.2002 të Gjykatës së Rrethit Tiranë.

strategjinë e sulmit të paditësit për të ndërtuar vijën e mbrojtjes së të paditurit që ka klient. Kështu, avokati studion me kujdes nëse objekti apo lloji i padisë është zgjedhur drejt, apo nëse legjitimiteti është ndërtuar si duhet apo ka të meta, apo nëse baza ligjore e padisë është zgjedhur siç duhet. Kjo e ndihmon avokatin që mbrojtjen ta organizojë në formën e një sulmi për ta çoroditur palën kundërshtare dhe për të fituar avantazh në kohë dhe në njohuri profesionale.

Prapësimet, kundër-prapësimet dhe kundërpadia. Pastaj avokati vijon studimin për të përgatitur prapësimet lidhur me pretendimet e paditësit. Sa më shumë prapësime të ketë avokati në vijën mbrojtëse të tij, aq më i madh është probabiliteti që rrit shkallën e sigurisë për sukses në platformën e ndërtuar si strategji. Për çdo prapësim avokati duhet të përgatisë veten edhe për kundërpërgjigjen e avokatit të paditësit, i cili vjen si një kundër-prapësim. Për këtë avokati duhet ta vendosë veten në mënyrë imagjinare në rolin e kolegut të tij “kundërshtar”. Kjo i lehtëson punën dhe i parandalon rastet që të mos gjendet në situata të papritura gjatë procesit gjyqësor apo të gjendet i papërgatitur. Listimi i prapësimeve dhe i kundër-prapësimeve kërkon një njohje shumë të mirë të legjislacionit dhe kjo bën që të dallohet avokati si një profesionist i zoti.

Në rast se ndonjëri nga prapësimet ngrihet deri në nivelin e një kundërpadie, atëherë avokati e këshillon klientin, (të paditurin), që të paraqesë një kundërpadi. Në gjykimet me një duel procedural padi-kundërpadi apo paditës i kundërpaditur dhe i paditur-kundërpaditës, ka një strategji më të fortë mbrojtje, sepse nga njëra anë, mjetet që përdorin palët janë ekuivalente dhe simetrike dhe, nga ana tjetër, gjykata është e detyruar që nga pikëpamja procedurale dhe materiale të japë një përgjigje për të dyja mjetet në vendimin e saj. Kundërpadia gjithmonë e zbut forcën goditëse të padisë, madje në mjaft raste jo vetëm e neutralizon, por edhe e tejkalon atë. Rastet tipike, por jo vetëm, kur mund të pretendohet një kundërpadi janë:

- padia me objekt përmbushje detyrimi – kundërpadia me objekt pavlefshmëri kontrate ose,
- padia me objekt zgjidhje kontrate – kundërpadia me objekt pavlefshmëri kontrate ose
- padia me objekt zgjidhje kontrate – kundërpadia me objekt përmbushje të detyrimeve kontraktore.

Në praktikën gjyqësore ka mjaft situata e vendime gjyqësore ku konkurrojnë si padia, ashtu edhe kundërpadia.

*Kështu, në çështjen gjyqësore **A.Z kundër A.D**⁶¹ rezulton se më datën 4.7.1996 midis A.Z-së dhe A.D-së është lidhur një kontratë shitje me akt noterial, me objekt shitjen e 50%*

⁶¹ Vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë Nr. 1290, datë 12.04.2001.

të kapitalit themeltar e barabartë kjo me 50% të kuotave, me 6.932.234 lekë, ku A.D-ja del si palë shitëse dhe A.Z-ja si palë blerëse. Çmimi i shitjes është likuiduar jashtë zyrës së noterisë. Pas nënshkrimit të kësaj kontrate palët janë bërë ortakë të shoqërisë "Poligrafia S", me kapitale të barabarta prej 50% me njëri-tjetrin. Pra, pasoja kryesore e kësaj kontrate shitje ishte bashkë ortakëria e palëve në shoqëri. Më 10.12.1999, A.Z-ja ngre **padi me objekt: Zgjidhjen e kontratës** dhe shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin prej saj. A.Z-ja pretendon se A.D-ja nuk ka shlyer detyrimin e tij për kryerjen e veprimeve përkatëse pranë regjistratit tregtar. Pas nënshkrimit të kontratës pala shitëse, i padituri, i cili është edhe administrator i shoqërisë nuk e ka bërë regjistrimin e ndryshimeve si rezultat i shitjes së kuotave. Pala e paditur ngre **kundërpadi me objekt: Pavlefshmërinë absolute të veprimit juridik për shitjen e kuotave** të shoqërisë. Ai pretendon se kontrata ka qenë **fiktive** nuk ka pasur si qëllim ardhjen e pasojave të ortakërisë midis palëve. Për pagimin e çmimit nuk ka asnjë provë shkresore ndonëse vlera është e konsiderueshme. Gjatë shqyrtimit gjyqësor rezultoi se i padituri kundërpaditës A.D kishte një detyrim për të përmbushur në emër të K.Z-së, që është babai i paditësit A.Z, objekti (kapitali i shoqërisë "Poligrafi S", i kalon personit të tretë me një procesverbal që mban datën 2.6.1999. Personi i tretë që ishte K.Z-ja përfaqësohej në këtë procesverbal nga i biri A.Z-ja.

Barra e provës. Siç dihet, si rregull barra e provës në procesin civil i takon të paditurit. Kështu kur kemi një padi që lidhet me mbrojtjen e pronësisë (për shembull rivendikimi), atëherë i padituri do të provojë që nuk e ka sendin në përdorim apo posedim, apo nuk e ka zhveshur ai pronarin nga e drejta e sundimit të sendit. Por nuk duhet harruar që edhe paditësi ka barrën e vetë të provës, sepse ai do të provojë që është pronar i sendit dhe mbajtës i të drejtës që pretendon që i është shkelur.

Vetëm në raste përjashtimore, siç është padia e shpërblimit të dëmit barra e provës fillon me të dëmtuarin/paditës, i cili duhet të provojë ekzistencën e dëmit dhe masën e tij, si dhe ekzistencën e veprimit të kundërligjshëm dhe të lidhjes shkakësore. Në rastin e padive për shpërblimin e dëmit i padituri ka barrën e provës për të provuar që dëmi nuk ka ardhur për fajin e tij dhe, për rrjedhojë, ai nuk ka përgjegjësi. Por, kjo barrë prove rëndon si detyrim, vetëm pasi është ushtruar paraprakisht barra e provës e të dëmtuarit/paditës.

Listimi i provave dhe i mjeteve të mbrojtjes. Provat janë shumë të rëndësishme për suksesin e një procesi gjyqësor. Disa prej tyre avokatit i vihen në dispozicion që në bisedat e para me klientin e tij. Kështu, nëse do të kemi një konflikt që ka si shkak një marrëdhënie kontraktore, gjëja e parë kërkohet nga avokati është kontrata që kanë lidhur palët. Nëse kemi një konflikt pronësie, do të kërkohet certifikata apo titulli i pronësisë. Nëse kemi një konflikt me natyrë

administrative ku kërkohet kundërshtimi apo shfuqizimi i një akti administrativ, prova e parë që do të kërkohet nga avokati është vetë akti administrativ. Nëse mbrojtja e avokatit fillon në fazën e gjyqimit në apel, avokati do të kërkojë një kopje të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, e kështu me radhë.

Krahas provave fillestare, pa të cilat nuk mund të fillojë procesi, do të listohen edhe provat e tjera që ndihmojnë për të ezauruar barrën e provës. Të tilla mund të jenë, për shembull në një proces që lidhet me një konflikt kontraktor, krahas kontratës, të duhen procesverbalet e marrjes në dorëzim të sendit/ve, mandatpagesat apo faturat e pagimit të çmimit, korrespondenca që palët i kanë dërguar njëra-tjetrës për reklamimin e të metave të mallit, apo për shtyrjen e afatit kontraktor, apo për vonesën në dorëzim, apo për pranimin me vonesë të përmbushjes së detyrimit, apo për pezullimin e detyrimit nga njëra palë, derisa të shlyhet detyrimi pararendës i palës tjetër, apo për tërheqjen nga kontrata apo zgjidhjen e saj, apo raporti i ekspertit për vlerësimin e dëmit, e të tjera.

Në hierarkinë e provave, avokati duhet ta fillojë nga provat shkresore të të gjitha llojeve dhe pastaj të kalojë tek dëshmitarët, tek nevoja e ekspertit, tek personat e tretë e të tjera. Veç tyre, avokati duhet të shohë edhe nëse ka nevojë për ballafaqime, për eksperimente gjyqësore, këqyrje në vend, e të tjera.

Sigurimi i provës është një element strategjik i nevojshëm në rastet kur dëshmitari është nën një presion psikologjik apo të ndonjë lloji tjetër dhe ekziston rreziku që të ndryshojë thëniet e tij në procesin gjyqësor. Sigurimi i provës është një veprim me natyrë strategjike që ndeshet më shpesh në proceset penale, por jo vetëm.

3.2.2. Përcaktimi i kompetencës lëndore dhe përcaktimi i ndërgjyqësisë dhe analizimi i legjitimitetit të palëve

Kompetenca lëndore. Një moment i rëndësishëm për avokatin është përcaktimi i drejtë i kompetencës lëndore, që lidhet me përcaktimin e gjykatës kompetente ku do të paraqitet padia, apo të organit administrativ kompetent ku do të paraqitet ankimi apo kërkesa, apo të arbitrazhit kompetent ku do të zhvillohet gjyqi i arbitrazhit, apo të zyrës kompetente të ndërmjetësimit, në varësi të alternativës që mund të kenë zgjedhur palët për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis tyre.

Në disa raste specifike, çështja mund të jetë në kompetencë të gjykatave të specializuara, si për shembull, të gjykatës së krimeve të rënda, të gjykatës administrative, të gjykatës së apelit apo të Gjykatës së Lartë, kur kjo e fundit ka juridiksion fillestar, etj. Në disa raste të tjera, kompetenca mund të lidhet me Gjykatën e Rrethit Tiranë, për shembull në rastin e padive që lidhen me markat tregtare dhe patentat.

Në disa raste ligji mund të ketë parashikuar fillimisht ndjekjen e juridiksionit administrativ para atij gjyqësor, dhe avokati duhet të ketë informacion të plotë për këtë gjë, me qëllim që çështja të mos bllokohet në procesin gjyqësor, për shkak se nuk është ezauruar procedimi në juridiksionin administrativ.

Përcaktimi i ndërgjyqësisë kur klienti është paditës dhe, **analizimi i legjitimitetit të palëve** kur klienti është i paditur, mbetet një nga detyrat më delikate të avokatit. Kjo për faktin se një gabim në ndërgjyqësi rrezikon krejtësisht fatin e çështjes.

Në proceset gjyqësore që kanë në themel një çështje kontraktore dhe që lidhen me padi të tilla si: përmbushja në natyrë e detyrimeve që burojnë nga kontratat, zgjidhja e kontratës dhe shpërblimi i dëmit kontraktor, duhet të bëhet kujdes nga avokati që ndërgjyqësia ndërtohet **vetëm me subjektin që është palë kontraktore dhe jo me një person fizik apo juridik që nuk është palë në kontratë**. Kur çështja gjyqësore lidhet me pavlefshmërinë e një kontrate apo të një veprimi juridik i paditur do të jetë pa diskutim pala kontraktore, por në gjykim duhet të thirret edhe si person i tretë, i interesuar edhe çdo person që ka përfituar nga një kontratë e mëpasshme në kohë, pronësinë mbi një send apo pasuri të kontratës që shqyrtohet për pavlefshmëri.

Në proceset gjyqësore që lidhen me marrëdhëniet e pronësisë, padia duhet të ngrihet ndaj atij që ka zhveshur pronarin nga pronësia, ndaj atij që e mban sendin në mënyrë të paligjshme, ndaj atij që ka cenuar ushtrimin e së drejtës së pronësisë.

Në proceset gjyqësore që lidhen me shkaktimin e dëmit jashtëkontraktor çështja bëhet pak më komplekse, për shkak se rast pas rasti konkurron solidariteti për dëmin e shkaktuar nga më shumë se dy persona. Kështu, në disa raste konkurron faji i punëmarrësit, ndërkohë kur përgjegjësia për shpërblimin e dëmit është e punëdhënësit, në disa raste konkurron faji i nën-sipërmarrësit, kur përgjegjësinë përballë porositësit e mban sipërmarrësi, në disa raste konkurron faji i prodhuesit të mallit apo produktit, kur përgjegjësinë e mban furnizuesi, e kështu me radhë.

Paditë për shpërblimin e dëmit janë më të vështira se të tjerat për të ndërtuar ndërgjyqësinë. Avokati duhet të bëjë kujdes më tepër në rastet kur dikush mban përgjegjësi për dëmet e shkaktuar nga një person i tretë. Kështu, nëse një punonjës i forcave speciale policore dëmton shëndetin e një kalimtari gjatë një aksioni policie, padia do të ngrihet ndaj Ministrisë së Brendshme, nëse një pacient dëmtohet për shkak të mjekimit të pakujdesshëm në një spital publik, padia

do të ngrihet ndaj Ministrisë së Shëndetësisë, nëse një konsumator dëmtohet nga shërbimi i pakujdesshëm i një kamerieri, atëherë përgjegjësi do të mbajë punëdhënësi i tij, pronari i lokalit. Këta subjekte mbajnë përgjegjësi edhe kur veprimet i kanë kryer persona të tjerë. Madje, përgjegjësia e tyre konsiderohet nga ligji si përgjegjësi me faj. Por, gjithsesi kjo përgjegjësi është e kushtëzuar. Kjo do të thotë, se nëse subjektet e paditur të përmendur më sipër, provojnë se i kanë marrë të gjitha masat dhe, përsëri dëmi ka ardhur për faj të punëmarrësve, atëherë ata kanë të drejtë të ngrenë padinë e regresit ndaj të punësuarve të tyre.

3.2.3. Rastet e konkurrimit të padive dhe mënyra e përzgjedhjes së padisë së duhur dhe më efikase

Pika më delikate e gjithë grafikut të planifikimit strategjik të mbrojtjes së avokatit është përzgjedhja e padisë së duhur. *Dubet të bëhet e qartë për të gjithë që: për të ngritur një padi do t'i drejtohem listës me termat dhe emrat tradicionalë të padisë.* Avokatët nuk mund të krijojnë padi të reja dhe nuk mund të emërtojnë padi të reja. Ky proces nuk njeh origjinalitet dhe të drejtë autori. Përkundrazi, duhet të mbetemi tradicionalë, atëherë kur duhet dhe, ky është pikërisht një nga rastet kur *dubet të mbetemi tradicionalë*, përse i përket tipave apo llojeve të padive që vijnë në praktikën dhe legjislacionin tonë që nga e drejta romake. E nënvizojmë këtë, sepse shpesh në praktikë shikojmë emra padish që nuk e kupton se çfarë të drejte kërkon të mbrojë paditësi apo avokati i tij.

Për shembull, gjejmë shpesh në praktikën gjyqësore padinë e emërtuar: “Kthim shume”. Nga titulli apo emri i saj nuk të thotë asgjë, ose të thotë çdo gjë. Kjo pikërisht, se emri është shumë i përgjithshëm. Nëse hyn në përmbajtjen e padisë do të kuptosh që mund të jetë një padi që rrjedh nga kontrata, padi që rrjedh nga shkaktimi i dëmit, padi që rrjedh nga marrëdhëniet e pronësisë, padi që rrjedh nga pavlefshmëria e veprimeve juridike, pra mund të jetë çdo lloj padie.

Atëherë lind pyetja: *A ka rëndësi zgjedhja e padisë? A ka rëndësi emërtimi i padisë?*

Pa diskutim që emërtimi i padisë lidhet me përmbajtjen e saj. Nëse do të radhitnim paditë tradicionale dhe ato më të shpeshta në praktikën gjyqësore do të na dilte lista e mëposhtme me grupet dhe nëngrupet e veta:

- (a) **Paditë e mbrojtjes së pronësisë:** padia e rivendikimit, padia mohuese, padia posedimore, padia e kallëzimit të punimit të ri, padia e njohjes së pronësisë apo e njohjes së bashkëpronësisë, padia për njohjen e një të drejte reale, padia për pjesëtimin e sendit të përbashkët;
- (b) **Paditë për pavlefshmërinë e veprimeve juridike** (absolute dhe relative):

padia e pavlefshmërisë së testamentit, padia e pavlefshmërisë së kontratës, padia e pavlefshmërisë së prokurës, si dhe padia për shpërblimin e dëmit që ka ardhur nga pasojat e pavlefshmërisë, që e shoqëron atë, etj.;

- (c) **Paditë që burojnë nga kontratat:** padia e përmbushjes në natyrë të detyrimeve kontraktore, padia e zgjidhjes së kontratës, së bashku me padinë e shpërblimit të dëmit kontraktor, (që mund të ngrihet në të dyja rastet);
- (d) **Paditë e shpërblimit të dëmit jashtëkontraktor:** padia për shpërblimin e dëmit ndaj emrit, dinjitetit dhe personalitetit të personit; padia e shpërblimit të dëmit ndaj jetës apo shëndetit të personit; padia për prishjen e cilësisë së jetës; padia për shpërblimin e dëmit nga produktet; padia për shpërblimin e dëmit nga kafshët; padia për shpërblimin e dëmit nga të miturit; padia për shpërblimin e dëmit nga punëmarrësi; padia për shpërblimin e dëmit nga përfaqësuesi, e të tjera. Në radhën e këtyre padive, në disa prej tyre, në mënyrë të prejardhur prej tyre mund të ngrihet edhe padia e regresit;
- (e) **Padia e begatimit pa shkak,** e cila mbyll listën e padive dhe ngrihet vetëm atëherë kur nuk ka më mjete të tjera mbrojtje dhe kur nuk mund të ngrihet asnjë padi tjetër.

Në praktikën juridike mund të ndodhë që për të njëjtën situatë juridike të mund të ngrihen më shumë se sa një padi. Kjo mund t'i shkaktojë avokatit pak konfuzion. Megjithatë nuk duhet harruar se padia e duhur në fund të dilemave do të mbetet vetëm njëra dhe, do të jetë pikërisht ajo padi që ofron për klientin dhe situatën konkrete më tepër efektivitet mbrojtje.

Po marrim disa situata praktike për ilustrim me qëllim që të evidentojmë se si analizohet situata dhe si zgjidhet padia e duhur.

Rasti i parë:

A-ja ka lidhur një kontratë me B-në për shitblerjen e një makine në janar të vitit 2011. Palët kanë parashikuar që çmimi është 9000 mijë Euro dhe do të shlyhet me dy këste: i pari prej 6000 Eurosh në çastin e lidhjes së kontratës dhe të dorëzimit të sendit dhe kësti i dytë prej 3000 Eurosh, pas një muaji nga lidhja e kontratës. B-ja nuk e paguan këstin e dytë, prandaj në prill të 2011-ës, A-ja kërkon kthimin e makinës. Meqenëse B-ja nuk pranon t'ia kthejë, A-ja i drejtohet gjykatës me padinë e rivendikimit.

Lind pyetja: *A është zgjedhur padia e duhur apo jo?*

Pavarësisht se jemi para një rasti ku kërkohet kthimi i sendit në duart e A-së, jo çdo kthim sendi është rivendikim. Ngritja e padisë së rivendikimit në këtë rast nuk është një zgjedhje e goditur, sepse nuk mjafton të kesh kthim sendi në duart e një personi, duhet edhe të provosh qenien pronar, zhveshjen e pronarit nga

një person që e mban sendin pa të drejtë, etj... etj., (të gjitha kushtet që duhet të plotësohen për ngritjen e padisë së rivendikimit). Kjo rrugë është e gjatë dhe e vështirë, sepse A-ja në momentin e ngritjes së padisë, nuk është ende pronar, (ndonëse mund të diskutohet në frymën e rezervës së pronësisë, meqë çmimi ka qenë me këste dhe veprimi juridik i shitjes nuk është një zhveshje e paligjshme, sepse kontrata e shitjes është lidhur me vullnet të lirë të të dyja palëve, si të A-së, ashtu edhe të B-së).

Padia që duhet të ngrihet nga A-ja në rastin e parë do të ishte një padi që rrjedh nga kontrata: ajo që do t'i siguronte A-së edhe pagimin e kështit të dytë, ose padia për zgjidhjen e kontratës ku palët do të ktheheshin në gjendjen e mëparshme: A-ja merr makinën dhe B-ja merr kështin e parë të çmimit dhe paguan dëmin ndaj A-së, (që në rastin tonë minimalisht do të ishte shuma që do të duhej, nëse makina do të ishte marrë me qira për dy apo tre muaj), meqë është përdorur nga B-ja tej afatit të pagimit të kështit të dytë.

Konkluzioni nga analiza e rastit të parë është: **Sa herë që ka vend të ngrihet një padi që rrjedh nga kontrata në raport me një padi që rrjedh nga pronësia, do të preferohet padia që rrjedh nga kontrata**, sepse i vetmi element i rëndësishëm për analizë dhe provë në procesin civil do të ishte kontrata.

Rasti i dytë:

A-ja ka furnizuar me një sasi uji B-në sipas një kontrate ku është parashikuar se çmimi i mallit është 100 lekë për ton. Sasia e ujit do të matet në bazë të një pajisje matëse që është vendosur nga B-ja, e cila në mënyrë automatike dhe të kompjuterizuar përcakton, se sa është shpenzuar nga B-ja. Pas një viti nga ekzekutimi me korrektësi i kontratës nga të dyja palët, A-ja dhe B-ja konstatojnë se pajisja matëse nuk e ka treguar sasinë e ujit të furnizuar, aq sa ka qenë realisht, por më të madhe. Për këtë arsye, palët bëjnë llogaritjet e dubura, dhe korrigjojnë programimin e pajisjes në mënyrë që t'i përgjigjet kushteve të furnizimit real. Ndërkohë, B-ja pasi bën llogaritë, konstaton se ka paguar rreth 580 000 lekë më tepër sesa ka marrë furnizim dhe ia bën të qartë A-së. Ky i fundit nuk pranon të kthejë pagesat e marra tepër, me justifikimin se ato i përgjigjen faturave dhe dëmi ka ardhur nga pajisja e vetë B-së. Në këto rrethana, B-ja ngre padinë e begatimit pa shkak dhe kërkon t'i kthehen shumat që ka paguar për një sasi uji që nuk e ka marrë. Megjithatë B-ja është në dilemë që mund të ngrejë edhe padinë e shpërblimit të dëmit, meqenëse ai është dëmtuar ekonomikisht nga pagesa e bërë jo në proporcionalitet me sasinë e mallit që ka marrë.

Lind pyetja: *A është zgjedhur padia e dubur në rastin e dytë?*

Padia e begatimit ka shkak nuk është padia e duhur, ndonëse kemi një fitim pa të drejtë të krijuar në favor të A-së dhe një ulje të pasurisë të palës paditëse

dhe ndonëse në pamjen e parë duket se ky përfitim ka ndodhur pa faj. Nuk duhet të harrojmë asnjëherë rregullin se: **Padia e begatimit pa shkak ngrihet vetëm atëherë, kur kanë shteruar të gjitha mjetet mbrojtëse dhe nuk mund të ngrihet asnjë padi tjetër.** Në rastin tonë, palët kanë një marrëdhënie kontraktore furnizimi dhe diferenca e shkaktuar mbi vlerën e shpërblimit që duhet të paguhej është krijuar gjatë përmbushjes së detyrimeve të palëve. Prandaj në këtë rast ose palët do të bëjnë një vetë rregullim pa shkuar në gjykatë, (për të bërë kompensimin midis detyrimeve që do të lindin në të ardhmen, me detyrimet që janë përmbushur në të shkuarën, derisa peshorja mall-çmim të balancohet tërësisht), ose do të ngrihet një padi që rrjedh nga kontrata dhe që ka të bëjë me shpërblimin e dëmit që buron nga mospërmbushja e detyrimeve kontraktore sipas skemës së parashikuar nga palët. Ndërkohë, nuk duhet të harrohet edhe një fakt tjetër, nëse luhatja e çmimit të paguar tepër kundrejt sasive të ujit realisht të furnizuar është në atë shkallë sa për shitjen të konsiderohet e konsiderueshme, sepse në fund të fundit sasia e faturuar tepër ka qenë për faj të pajisjes që ka bërë matjen, e cila ka qenë në pronësi dhe administrim të B-së.

Rasti i tretë:

A-ja ka marrë me qira një dyqan nga B-ja për 5 vjet. Pas një viti A-ja ka bërë një kontratë për ta blerë dyqanin nga B-ja me çmimin 200 000 Euro për të cilin ka dhënë edhe kaparin 40 000 Euro. Marrëveshja është bërë me akt noterial dhe ka parashikuar se diferenca e çmimit duhet të shlyhet brenda 2 muajve nga pagimi i kaparit. A-ja aplikon për të marrë një kredi prej 160 000 Eurosh në bankë dhe kur kjo e fundit vjen të vlerësojë pronën shikon se dyqani është gati 20 metra katrorë më i vogël, prandaj e njofton se nuk mund të japë kredinë në shifrën e kërkuar, por në një shifër më të vogël. A-ja verifikon edhe një herë certifikatën e pronësisë dhe pasi bëjnë matjet së bashku me B-në vërejnë se vërtet ka një mospërputhje midis sipërfaqes së dyqanit të specifikuar në certifikatën e pronësisë dhe sipërfaqes reale. Ndryshimi është mbi 20% të madhësisë së sendit, prandaj A-ja i kërkon B-së që të bëjnë një ulje proporcionale të çmimit, gjë që B-ja nuk e pranon. Një javë pas kësaj bisede, tek A-ja paraqitet C-ja i cili pretendon se është pronar i sendit, që ia ka blerë B-së dhe kërkon dorëzimin e tij nga A-ja. A-ja nuk pranon dorëzimin e sendit dhe përballet me një padi të C-së për rivendikimin e dyqanit. A-ja bën një kundërpadi dhe kërkon pavlefshmërinë e kontratës së B-së dhe të C-së, sepse B-ja i ka kaluar C-së një të drejtë që nuk e ka as vetë.

Lind Pyetja: *A është ngritur padia dhe kundërpadia e duhur?*

Në rastin e mësipërm, padia e ngritur është e drejtë, sepse midis A-së dhe C-së nuk ka një marrëdhënie kontraktore paraprake. Fakti që B-ja është palë si në kontratën me A-në, ashtu edhe në kontratën me C-në nuk e bën këtë konflikt midis A-së dhe C-së një konflikt me natyrë kontraktore. Na rezulton se C-ja e ka

regjistruar dyqanin në ZRPP në emrin e tij, pra është pronar dhe ka të drejtë ta kërkojë sendin nga çdo posedues i paligjshëm. Por A-ja është qiramarrës i ligjshëm dhe Kodi Civil, në nenin 825 të tij, parashikon se qiraja është e detyrueshme edhe për pronarin e ri. Pra, padia e C-së mund të ngrihet teorikisht, por ajo rrezikon që të rrëzohet. A-ja do të vijojë të qëndrojë në dyqan si qiramarrës deri sa të përfundojë kontrata e qirasë që ai kishte me B-në. Kundërpadia e ngritur nga A-ja, është e saktë, por në gjykim duhet të thirret edhe B-ja, sepse ai i ka kaluar C-së një të drejtë që nuk e kishte më, se kontrata e shitjes ishte lidhur me A-në me akt noterial dhe ishte paguar si kapar $\frac{1}{4}$ e çmimit. A-ja duhet të ngrinte një padi B-së, ku A-ja të kërkonte përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga shitja, uljen e çmimit në mënyrë proporcionale në raport me uljen e sasisë së sendit, mbështetur në nenet 752-753 të Kodit Civil dhe likuidimin e çmimit në këtë shifër. Pas kësaj, A-ja mund të kërkonte pavlefshmërinë e shitjes.

Për të konkluduar lidhur me hierarkinë e përzgjedhjes së padive po vijojmë me një paraqitje skematike e cila strukturon një intervistim me 10 Pyetje për Klientin dhe me sugjerimet për paditë që duhet të ngrihen në varësi të përgjigjeve të Klientit:


- (1) A ka një raport juridik ekzistues midis Klientit dhe palës me të cilën ai është në konflikt?
- (2) Nëse ka një raport ekzistues juridik, në formën e një kontrate, a ka mospërmbushje të detyrimeve të saj?
- (3) Nëse Klienti ka ende interes apo jo për përmbushjen apo i ka humbur ky interes?
- (4) Nëse mospërmbushja në natyrë e detyrimit kontraktor është bërë e pamundur për faj të palës debitore apo për faj të personave të tretë?
- (5) Nëse ka shkaqe pavlefshmërie juridike kontrata apo një veprim tjetër juridik, si për shembull testamenti, prokura, etj.?
- (6) Nëse nuk ka një raport ekzistues juridik midis Klientit dhe palës tjetër, çfarë e drejte i është shkelur Klientit dhe në çfarë raporti qëndron Klienti me të drejtën e tij?
- (7) A është Klienti një pronar që është zhveshur nga e drejta e pronësisë së tij pa të drejtë apo në mënyrë të paligjshme?
- (8) A është Klienti një pronar që është cenuar në ushtrimin e së drejtës së tij të pronësisë pa të drejtë apo në mënyrë të paligjshme? Apo Klienti është një posedues i ligjshëm që është cenuar në mënyrë të padrejtë në ushtrimin e të drejtës së tij posedimore?
- (9) A është dëmtuar Klienti nga një veprim i paligjshëm i një apo disa personave të tjerë që i ka sjellë atij një dëmtim me natyrë pasurore apo jopasurore?

(10) A ka pësuar Klienti një dëmtim apo ulje të pasurisë së tij që i korrespondon një rritje të pasurisë së një personi tjetër, si rezultat i një veprimi të kryer pa faj nga ky i fundit?

Në varësi të të gjitha përgjigjeve që do të merren për pyetjet prej Klientit, Avokati do të zbresë shkallë-shkallë në skemën e mëposhtme, duke kaluar hap pas hapi nga njëra mundësi e ngritjes së një padie, drejt mundësive të tjera. Disa këshilla praktike parimore që duhet pasur parasysh pavarësisht skemës janë:

- Sa herë që ka një marrëdhënie kontraktore ekzistuese, (ku futet edhe rasti që ndonëse kontrata ka mbaruar, palët qëndrojnë të lidhura për shkak të afateve garancive ligjore), atëherë do të ngrihet padia që rrjedh nga kontrata, edhe sikur të ketë mundësi teorike për t'u ngritur një padi tjetër, p.sh. padi pronësie.
- Padia e shpërblimit të dëmit pasuror ose jopasuror do të ngrihet vetëm në rastet kur midis palëve nuk ka një marrëdhënie ekzistuese kontraktore;
- Padia e shpërblimit të dëmit që ngrihet në rastin e përmbushjes me vonesë të detyrimit, apo të zgjidhjes së kontratës, është një padi aksesore. Edhe në rastin shpërblimit të dëmit që rrjedh nga cenimi i së drejtës së pronësisë, shpërblimi i dëmit është kërkesë aksesore e një padie kryesore, që rrjedh nga pronësia.
- Padia e begatimit pa shkak, ngrihet vetëm atëherë kur nuk mund të ngrihet një padi tjetër.

10 PYETJET E AVOKATIT PËR KLIENTIN



3.2.4. Gjetja e ligjit dhe normës së zbatueshme (objekti dhe shkaku ligjor i padisë)

Përcaktimi i bazës ligjore të padisë apo të mbrojtjes në çështjen gjyqësore është një nga pikat kryesore që duhet të saktësohet nga ana e avokatit. Baza ligjore do të shihet e lidhur ngushtë me llojin dhe objektin e padisë dhe duhet t'i përmbahet këtij objekti. Tek baza ligjore e padisë do të përfshihen si dispozitat me natyrë materiale, ashtu edhe ato me natyrë procedurale.

Kështu, në rast se jemi para padisë për përmbushjen në natyrë të detyrimeve ligjore që rrjedhin nga kontrata e shitjes, përsa i përket dorëzimit të sendeve pa të meta, atëherë do të jenë si bazë ligjore nenet 722 dhe 723 të Kodit Civil. Po ashtu kësaj baze ligjore do t'i shtohen nenet 31 dhe neni 161 i Kodit të Procedurës Civile.

Në rast se do të kemi një padi që ngrihet për të kërkuar ndalimin e veprimeve që përbëjnë shkelje dhe cenim të të drejtave që burojnë nga pronësia industriale mbi markën tregtare dhe emërtimin e origjinës së paditësit nga produktet e tregtuara nga i padituri dhe mos përsëritjen në të ardhmen, si dhe heqjen nga qarkullimi civil dhe bllokimin e të gjithave produkteve të tregtuara nga të paditurit me etiketat që përbëjnë shkelje të të drejtave të emërtimit të origjinës me treguesit gjeografik dhe asgjësimin e etiketave të ngjashme me ato të paditësit, atëherë baza ligjore do të jetë: Nenet 608, 625, pika a) 635 pikat a), dh), g), 636-638, pika 1 dhe 2, 639, 640, 644 Kodit Civil dhe neni 31, 131 e vijues, neni 161 i Kodit të Procedurës Civile, neni 176 – 187 i Ligji 9947, datë 07.07.2008, “Për Pronësinë Industriale”, nenet 140,143, pika 1, 2, shkronja a, b dhe pika 3 shkronja a, b, si dhe nenet 177 e në vazhdim, si dhe Ligji nr. 9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorit”, nenet 13-17, 28, paragrafi 2.

Në rast se do të kemi një çështje që lidhet me Anulimin e Vendimit të Komisionit të Kthimit të Pronave, baza ligjore mund të ishte neni 13 i Ligjit Nr. 7698, datë 15.04.1993, “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve” dhe nenet 153, 154 dhe 161 të K.Pr.C.

Në rast se do të kishim një konflikt midis një sipërmarrësi dhe pronarëve të trullit për ndërtimin e një pallati, ndërkohë kur palët kanë lidhur një marrëveshje paraprake, ku detyrimet e sipërmarrësit dhe pronarëve janë përmbushur, por pronarët refuzojnë që të lidhin kontratën e sipërmarrjes të parashikuar si detyrim nga kontrata paraprake, atëherë do të ngrihet padia me objekt: detyrimin për lidhjen e kontratës së sipërmarrjes midis palëve, si dhe pagimin e sanksionit dhe të shpërblimit të dëmit të shkaktuar nga vonesa për lidhjen e kësaj kontrate, në bazë të neneve 676 e në vijim i K.C. dhe 51 të K.Pr.C. si dhe, sigurimin e padisë

bazuar në nenet 202-205 dhe 527 e në vijim të K.Pr.C. dhe vendosjen e masës së sekuestros mbi pronën e mësipërme, me qëllim bllokimin për moskryerjen e veprimeve të palës së paditur lidhur me pasurinë në ZRPP Tiranë.

Në rastin e një konflikti midis paditësit, që është një shoqëri tregtare dhe Degës Doganore Durrës, që ka vendosur ta dënojë Paditësin me detyrimin e pagimit të një detyrimi doganor dhe të pagimit të gjobës sa katërfishi i detyrimeve doganore, shumë të cilën paditësi e ka paguar tërësisht, me objekt: Shfuqizimin e Vendimeve të Degës Doganore Durrës dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, si dhe kthimin e shumës së paguar si sanksion që buron nga vendimet e mësipërme, për veprime të shkaktuara jo nga vetë paditësi, por nga ana e një personi tjetër të tretë, baza ligjore do të jetë: Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë nenet 245, 256, 276, 281, 287, 289, dhe Kodi Civil, nenet 496 deri në 498, si dhe neni 51, e 324-333 të Kodit të Procedurës Civile.

Në rastin e një konflikti që vjen nga cenimi i së drejtës së pronësisë për shkak të zhurmave akustike, atëherë baza ligjore do të jetë: neni 302 i Kodit Civil dhe nenet 31, 153-157 të K.Pr.C.

Në rastin e një konflikti që vjen nga kallëzimi i një punimi të ri, atëherë baza ligjore do të jetë: neni 303 i Kodit Civil dhe nenet 31, 153-157 të K.Pr.C.

Në rastin e një konflikti që vjen nga cenimi i së drejtës së posedimit për shkak të veprimeve të personave të tretë, atëherë baza ligjore do të jetë: nenet 304-306 dhe 310-315 të Kodit Civil dhe nenet 31, 153-157 të K.Pr.C.

Në rastin e një konflikti që vjen nga administrimi i sendit në bashkëpronësi, atëherë baza ligjore do të jetë: nenet 199-203 të Kodit Civil dhe nenet 31, 153-157 të K.Pr.C.

Në rastin e shpërblimit të dëmit të shkaktuar shëndetit apo jetës nga mjekimi i pakujdesshëm, atëherë baza ligjore do të jenë nenet 625, pika a), dhe 640-647 të Kodit Civil dhe nenet 31, 153-157 të K.Pr.C.

Në rastin e shpërblimit të dëmit të shkaktuar emrit, dinjitetit, apo personalitetit të një personi fizik apo juridik, atëherë baza ligjore do të jenë nenet do të jenë nenet 625, pika a) e ndryshuar, dhe 640-647 të Kodit Civil dhe nenet 31, 153-157 të K.Pr.C.

Në rastin e pavlefshmërisë së testamentit atëherë baza ligjore do të jenë nenet 403-411 të Kodit Civil dhe nenet 31, 153-157 të K.Pr.C.

Në rastin e pjesëtimit të sendit të përbashkët atëherë baza ligjore do të jenë nenet 206 dhe 207 të Kodit Civil, si dhe nenet 369-374 të K.Pr.C.

Në rastin e zgjidhjes së kontratës atëherë baza ligjore do të jenë nenet 698-704 të Kodit Civil dhe nenet 31, 153-157 të K.Pr.C.

Në rastin e pavlefshmërisë absolute të veprimit juridik atëherë baza ligjore do të jenë nenet 92-93 dhe 106 e 108 të Kodit Civil dhe nenet 31, 153-157 të K.Pr.C., ndërsa në rastin e pavlefshmërisë relative të veprimit juridik për shkak të mashtrimit, atëherë baza ligjore do të jenë nenet 94-95 dhe 107 të Kodit Civil dhe nenet të K.Pr.C.

Vlen të theksohet, se në të gjitha rastet e sipërpërmendura të bazës ligjore në padi të ndryshme, ka edhe vendosje të bazës ligjore me një diapazon më të gjerë se sa një ose dy nene. Në varësi të situatës konkrete që do të mbrojë avokati, ky diapazon duhet të jetë sa më i ngushtë, sepse do t'i specifikohet rastit konkret. Kështu, nëse nga neni 403-411 janë raste të ndryshme të pavlefshmërisë së testamenti, nëse shkak i kërimit të kësaj pavlefshmërie nga ana e paditësit është mungesa e formës ligjore baza ligjore do të jenë: neni 404 dhe 410-411 dhe jo 403-411, që rregullon të gjitha rastet e pavlefshmërive të testamentit.

3.2.5. Gjetja e vendimeve unifikuese të Gjykatës së Lartë dhe e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese që mbulojnë rastin konkret

Puna kërkimore që ka të bëjë me analizën e vendimeve unifikuese që lidhen me raste që janë shndërruar në precedentë të detyrueshëm për t'u zbatuar dhe që janë analoge me situatën që i ofrohet avokatit për zgjidhje, fillon me gjetjen dhe seleksionimin e tyre. Sot, teknologjia moderne ofron mundësi të panumërta kërkimi të praktikës gjyqësore. Vendimet e gjykatave që mund të mbulojnë rastin konkret mund të gjenden qoftë në faqet e internetit të gjykatave përkatëse ose në portale të tjera të specializuara. Një shembull se si mund të kryhet kërkimi gjendet në materialet bashkëlidhur këtij manuali.

3.2.6. Doktrina ku mbështetet arsyetimi i rastit si e vendit ashtu edhe e huaj

Njohja e doktrinës është pjesë e punës profesionale të avokatit që nuk lidhet thjesht me një çështje konkrete, por lidhet me formimin e përgjithshëm të tij. Doktrina i ndihmon avokatët që të jenë më të organizuar dhe më profesionistë në realizimin e kërimit shkencor. Përdorimi i burimeve doktrimore është mirë të jetë pjesë e një pune sistematike të avokatëve. Megjithatë pavarësisht nga njohuritë doktrimore të tyre, është e rëndësishme që herë pas here të ndjehet nevoja e shfrytëzimit të një literature të re, të cilën nuk e ke pasur në dispozicion më parë.

Tekstet dhe librat, revistat periodike apo artikujt e ndryshëm ofrojnë njohuri mbi legjislacionin dhe praktikën gjyqësore shqiptare ose atë ndërkombëtare, por ofrojnë edhe pikëpamje e komente personale të autorëve. Kur tekstet apo monografitë janë botuar dhe miratuar me Bordi editorial shkencor, atëherë ato japin një garanci për mendimet dhe komentet që bëhen në to.

Doktrina i rrit avokatit vizionin për çështjen dhe jo vetëm e ndihmon të shtrijë drejt pyetjet që i dalin për shqyrtim në një çështje konkrete, por e ndihmon të japë edhe përgjigjet e duhura. Në disa raste doktrina e ndihmon edhe në përgatitjen e akteve të tilla si: kërkesë padia apo prapësimet, kundërpaditë dhe sidomos përgatitjet për fjalën përfundimtare të mbrojtjes që bën avokati.

Doktrina shqiptare ka lista të kufizuara me tituj librash, manualesh, tekstesh e monografish apo revistash me natyrë juridike shkencore a profesionale, por që janë të mjaftueshme për t'u studiuar nga avokatët. Në vijim po paraqesim disa prej tyre, për të lehtësuar disi kufijtë e njohjes, veçse duke theksuar se lista e mëposhtme nuk është përfundimtare:

3.3. Teknikat e arsytimit ligjor

3.3.1. Disa këshilla praktike për përgatitjen e çështjes për gjyq

Gjatë punës së përditshme, një avokati i lind nevoja që përveç përgatitjes së çështjes nga ana juridike duke e mbështetur atë me prova dhe argumente ligjore, të llogarisë dhe një sërë faktorësh të cilët do të kenë njëlloj rëndësi për suksesin çështjes. Menaxhimi me efikasitet i çështjes duke bërë llogaritë jo vetëm me ligjin, por edhe me kohën dhe burimet në dispozicion, është diçka që secili nga avokatët do ta mësojë me eksperiencën e vet ndër vite, por edhe disa këshilla praktike në këtë drejtim mund të jenë të dobishme për avokatët e rinj.

Në përgatitjen e një çështjeje për gjykim, duhet të llogarisim dhe të planifikojmë disa faktorë mjaft të rëndësishëm me qëllim që të jemi të suksesshëm, siç janë: **koha** dhe **burimet në dispozicion**. Energjitë dhe kapacitetet nga njëra anë, dhe koha që kemi në dispozicion për përgatitjen e padisë, mbledhjen e provave dhe paraqitjen e tyre përpara gjykatës duhet të llogariten me saktësi, në mënyrë që puna e kryer të jetë sa më cilësore dhe brenda afateve të kërkuara procedurale.

Mungesa e koordinimit të saktë dhe e parashikimit të qartë të këtyre faktorëve mund të sjellë dëme të sigurta, ku më e pakta është humbja në cilësinë e akteve të paraqitura përpara gjykatës, apo humbja e kohës për paraqitjen e provave në gjykim (nëse ato nuk janë gati përpara fillimit të gjykimit), moment ky që mund

të sjellë pasoja edhe më serioze, duke humbur të drejta të pariparueshme të palës (klientëve) në gjykim.

Janë këto arsytet të cilat na bëjnë të ndalemi në këtë fazë dhe të sugjerojmë përllogaritjen e kohës dhe të burimeve në dispozicion me qëllim që të kemi një përgatitje sa më të mirë të çështjes dhe shqyrtimin e saj në një kohë sa më të shkurtër nga gjykata.

Fillimisht çdo avokat i cili ka përgjegjësinë për një çështje, duhet të flasë me klientin e tij për të dëgjuar më me hollësi detajet e saj, duke mbajtur me atë rast edhe shënime. Ajo që është më kryesorja, avokati duhet të kërkojë dhe të marrë sa më shpejt nga klienti, të gjitha provat që ai disponon. Më pas, është e nevojshme që sa më parë të planifikojë dhe të organizojë punën duke mbajtur në konsideratë disa faktorë si p.sh.:

-*Volumi i punës*: nëse ndodhemi përpara një pune voluminoze, duhet të përllogarim burimet që kemi në dispozicion duke konsideruar sipas rastit dhe mundësinë e përfshirjes së asistentëve apo avokatëve të tjerë në të.

-*Ndarjen e punëve*: për secilin person që do të punojë në grup apo secili në një pjesë të caktuar të çështjes është mjaft e rëndësishme. Këtu duhet të mbahen parasysh edhe aftësitë e secilit në fusha të ndryshme, p.sh. dikush që ka një teknike të mirë shkrimi mund të caktohet për të përgatitur argumentet me shkrim për gjykatën; dikush duhet të merret me mbledhjen e provave (në ato raste kur klienti preferon të lëshojë një prokurë duke kërkuar që provat të mbliidhen nga avokati apo kur klienti vet nuk arrin t'i sigurojë), të tjerë mund të me kërkime në jurisprudencë dhe në praktikë gjyqësore për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme, etj. Në këtë fazë ka mjaft rëndësi që avokati të bie dakord me klientin për rrugën që duhet ndjekur, duke pasur kujdes që:

- Të jemi të qartë në shpjegimet dhe komunikimet tona, për parashikimet ligjore dhe të drejtat që gëzon pala dhe sa nga këto të drejta mund t'i njihen realisht nga gjykata.

- Të jemi të qartë për kërkimet që ka pala (pra sa nga tërësia e të drejta që ajo gëzon, dëshiron të kërkojë me anë të padisë) dhe sipas rasti të çdo të drejte, të shpjegojmë me qartësi mundësinë për të qenë të suksesshëm në një gjykim me qëllim fitimin e kësaj të drejte. P.sh. le të supozojmë një rast kur pala mund të ketë të drejta që lindin nga një detyrim kryesor, por mund të ketë edhe kamatë-vonesa, ndërkohë që detyrimi kryesor mund të vilet duke lëshuar një urdhër ekzekutimi në një gjykim të shkurtër, i cili ka mundësi të larta ekzekutimi, ndërsa nëse kërkohen edhe kamatë-vonesat duhet të gjykohet një padi me palë

kundërshtare, e cila jo vetëm zgjat në kohë, por mund të ketë edhe kosto shtesë si p.sh. pagesa për akt ekspertimi etj. Në këtë rast, avokatit i takon t'i shpjegojë me hollësi palës avantazhet dhe disavantazhet e çdo mënyre kërkimi dhe i takon palës të bëjë zgjedhjen e saj, për rrugën që duhet ndjekur. Në këtë pikë duhet të jemi të qartë dhe të mos përfshihemi, duke konsideruar se çfarë do të bënim ne vetë, në një rast të ngjashëm. Ne nuk jemi titullarë të së drejtës, por vetëm ndihmës dhe këshillues të tyre, prandaj është e nevojshme që të krijojmë distancë duke i dhënë mundësi palës të zgjedhë.

- Të shikojmë, dhe kur është në interes të palës sonë, të sugjerojmë zgjidhjen e çështjes me pajtim, duke shmangur gjykimin. Në fillim një gjë e tillë mund të duket kontradiktore pasi mendohet se fitimi ekonomik i një avokati është më i madh, pikërisht kur shkon në gjyq por në praktikë nuk funksionon kështu. Të sugjerojmë një zgjidhje me pajtim të çështjes është jo vetëm një detyrë ligjore e avokatit, por në disa raste edhe një detyrë humane, p.sh. në çështjet familjare apo në ato situata kur në këtë mënyrë shmanget një konflikt shoqëror midis palëve. Të bësh gjyq nuk është e leverdishme për palën tonë jo vetëm nga pikëpamja ekonomike, por edhe ajo emocionale. Gjykimi në tërësi shoqërohet me një ngarkesë emocionale të fuqishme dhe është një eksperiencë stresuese për ata që janë të përfshirë kështu që ne do të këshillojmë me ndershmëri palën do t'i sugjeronim asaj të bënte ndonjë lëshim dhe të zgjidhte çështjen me pajtim. Në përfundim kjo mënyrë do të rezultojë fitimprurëse edhe për avokatin i cili jo vetëm është kujdesur për interesat e palës së vet, por ka fituar në këtë mënyrë edhe besim e saj duke krijuar një klient dhe një lidhje të vazhdueshme.

3.3.2. Ankimi i administrativ

Përpara se të përgatisim një çështje administrative për gjykim, është e nevojshme që të vlerësojmë nëse është ezauruar ankimin administrativ dhe nëse është e mundur që t'i paraqitet gjykatës pa ankim administrativ. Përgjithësisht është e nevojshme që për një vendim të organit administrativ të ketë një ankim në rrugë administrative të tij dhe vetëm në raste të posaçme, të parashikuara posaçërisht nga ligji, mund t'i drejtohem gjykatës pa ezauruar rrugën administrative.

Një kërkesë e tillë ligjore lidhet edhe me të drejtat dhe kompetencat e organit administrativ dhe sidomos mundësinë e këtyre organeve që te revokojnë, shfuqizojnë, ndryshojnë dhe zëvendësojnë aktet administrative. Në këtë mënyrë, meqenëse është e mundur që aktet të paligjshme, pavlefshme apo thjesht të paarsyeshme të riparohen apo shfuqizohen nga vetë organi administrativ është e drejtë që fillimisht t'i drejtohem atij, apo organit epror për të rregulluar situatën e krijuar.

Ankimi tek organi që ka nxjerrë aktin nuk përfshihet në rrugën e detyrueshme për t'u ndjekur, në konsiderimin e një ankimi administrativ, ndërsa ankimi tek organi epror përfshihet në këtë rrugë. Pavarësisht se nuk është hallkë e detyrueshme për t'u ndjekur, paraqitja e një ankimi tek organi që ka nxjerrë aktin mund të rezultojë mjaft efektiv, dhe mund të sjellë menjëherë rregullimin e situatës praktike, meqenëse vetë organi mund të ketë të drejtë të revokojë aktin, duke iu referuar parregullsisë së tij.

Megjithatë për të mos humbur afatet dhe kohën është e nevojshme që të bëjmë një ankim tek organi epror i cili ka kompetenca për ta shfuqizuar aktin. Mosparaqitja e këtij ankimi, sjell si pasojë që gjykatat ta deklarojnë të papranueshme për shqyrtim padinë, duke e nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit. Kjo është tashmë një praktikë e konsoliduar deri në gjykatat me të larta të vendit.

3.3.3. Kërkesa për sigurimin e padisë

Përpara paraqitjes në gjykim të padisë për rastet e ngutshme, ose njëkohësisht me padinë për rastet e tjera⁶², avokatët rekomandojnë që kur plotësohen kushtet ligjore të procedohet me një kërkesë për sigurimin e objektit të padisë e cila nënkupton marrje e një masë për të siguruar të drejtat e paditësit, deri në momentin e ekzekutimit të padisë, nëse është rasti kur ekzistojnë dyshime që ekzekutimi i vendimit mund të bëhet i vështirë apo i pamundur për interesat e paditësit. Ky është në të vërtetë një ndër institutet më të debatueshme procedurale në praktikën juridike të viteve të fundit, fakt ky që e reflektojnë edhe ndryshimet e herëpashershme ligjore që i janë bërë këtij instituti në Kodin e Procedurës Civile.

Në aspektin strukturor, duhet kuptuar se kërkesa për sigurimin e objektit të padisë është një kërkesë aksesore dhe vendimi për marrjen e sigurimit të padisë është një vendim i ndërmjetëm. Duhet thënë në fakt, se ky institut ka një rëndësi të veçantë për efektet e një procesi të rregullt ligjor. Një ndër kriteret themelor për cilësimin e një procesi të rregullt gjyqësor, është efektiviteti i zgjidhjes që mundëson procesi gjyqësor. Mirëpo po të mendoni se ndërsa zhvillohet procesi

⁶²Neni 203 “Sigurimi i padisë lejohet për të gjitha llojet e padive dhe në çdo fazë të gjyimit, derisa vendimi të marrë formë të prerë. Sigurimi i padisë lejohet edhe nga gjykata e apelit, kur padia është duke u shqyrtuar prej saj.”

Neni 204 “Sigurimi i padisë mund të kërkohet edhe përpara ngritjes së padisë në gjykatën e vendit ku ka banimin paditësi ose ku ndodhet pasuria me të cilën do të sigurohet padia. Në këtë rast gjykata cakton një afat jo më shumë se pesëmbëdhjetë ditë, brenda të cilit duhet të paraqitet padia në gjykatë.”

Neni 205 “Sigurimi i padisë mund të lejohet për të gjithë padinë, ose vetëm për ato pjesë të saj, që gjykata i gjen të bazuara, në përputhje me rregullat e parashikuara në nenin 202 të këtij Kodi. Kërkesa, si rregull, shqyrtohet në prani të palëve, por në raste të veçanta ose të ngutshme, mund të shqyrtohet edhe pa u thirrur pala tjetër.”

gjyqësor, efektet e shkeljes së të drejtës të paditësit bëhen të pakthyeshme apo të vështira për t'u rivendosur, procesi gjyqësor nuk është më një mjet për të rivendosur të drejtën, por një ushtrim iluziv/teorik jurisprudence.

Në fakt ky qëndrim është sanksionuar jo vetëm në shumë raste të trajtuara nga GJEDNJ, por edhe nga vendimi nr.32, datë 24.11.2003, i Gjykatës Kushtetuese⁶³, ku është sqaruar përfundimisht se nevoja për të marrë masa të përkohshme është në të vërtetë një garanci për efektivitetin e procesit gjyqësor.

Shumë i rëndësishëm për vlerësimin e drejtë të kritereve për marrjen e masave për sigurimin e objektit të padisë është edhe një zhvillim jurisprudencial i disa viteve më parë, VUGJL nr. 10, datë 24.03.2004, që futi disa parime shumë të rëndësishme që megjithëse të ngërthyera në vetë natyrën e sigurimit të objektit të padisë, ishin shtrembëruar nga praktika gjyqësore. Ndoshta më e rëndësishmja prej tyre është përcaktimi se marrja e masës për sigurimin e padisë, nuk duhet të jetë e njëjta me rezultatin e pritshëm të çështjes në rastin e pranimit të objektit të padisë⁶⁴. Për të dhënë një shembull; nëse në një padi është kërkuar ndalimi i disa punimeve, masa për sigurimin e objektit të padisë nuk mund të jetë ndalimi i punimeve.

Por, besojmë se sintezën më të qartë për kriteret e marrjes së masave për sigurimin e objektit të padisë, e ka bërë Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në vendimin Nr. 00-2011-47 (22), datë 19.01.2011: *“(iv) Gjykimi për marrjen e masës për sigurimin e padisë është një proces i shpejtë, ku gjykata nuk shqyrton dhe vlerëson të gjitha provat në mënyrë të hollësishme për të parë nëse qëndrojnë apo jo pretendimet e kërkuësit, nëse qëndron apo jo e drejta. Në gjykime të këtij lloji, gjykata vetëm beton nëse plotësohen këto kushte: (a) ekzistenca e mundshme e një të drejte për të cilën kërkohet mbrojtje në procesin e gjyqësor të padisë (fumus bonis juris⁶⁵), dhe (b) ekzistenca e frikës, që ekzekutimi i vendimit për të drejtën që kërkohet të mbrohet do të bëhet i pamundur ose i vështirë (periculum in mora⁶⁶). E kundërta ndodh në gjykimin e themelut të padisë gjatë të cilës gjykata duke respektuar të gjitha normat procedurale shqyrton në themel nëse ekziston apo jo e drejta e*

⁶³ “Së dyti: E drejta e pezullimit të aktit, objekt shqyrtimi gjyqësor, është një e drejtë që lidhet pazgjydhshmërisht me procesin e rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42/1 i Kushtetutës. Të mënjanoresh pezullimin si një prerogativë e natyrshme e organeve gjyqësore në ushtrimin e pushtetit të tyre, do të thotë të pengohet realizimi i një procesi të rregullt, në parametraj që kërkon dispozita e mësipërme kushtetuese ashtu dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

- Së treti: Mënjanimi në mënyrë arbitrare i kësaj kompetence të organeve gjyqësore në shqyrtimin e ankimeve ndaj ligjshmërisë së akteve të administratës publike, vështrëson ose bën të pamundur efektivitetin e ankimit, kërkesë thelbësore që buron nga neni 13 i Konventës dhe nga neni 8 i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut;

⁶⁴ “Në asnjë rast nuk mund të vendoset me anë të një mase të përkohshme të sigurimit të padisë urdhërimi për të kryer i padituri atë që kërkon paditësi nëpërmjet padisë dhe që prapësohet nga i padituri. E thënë ndryshe, masa e përkohshme e sigurimit të padisë, që vendoset nga gjykata, nuk ka kuptim të jetë e njëjtë me urdhërimin për përmbushjen e kërimit të palës paditëse të shprehur në objektin e padisë.”

⁶⁵ Shënim i autoreve.

⁶⁶ Shënim i autoreve.

pretenduar nga paditësi, nëse kërkimet e tij janë të mbështetura apo jo në prova dhe në ligj.”

Nga ky paragraf del qartë një kriter që duket se është i fshehur në nenet 202 e vijues të KPC. Nëse këto nene flasin qartë për *periculum in mora* (rrezikun nga vonesa) ato duket se nuk flasin aq qartë për *fumus bonis iuris*, përveç se në rastin e nenit 202/2/a të KP Civile, kur parashikohet se, masa për sigurimin e objektit të padisë lejohet kur padia mbështetet në prova më shkresë. Provat me shkresë janë të afta të krijojnë një bindje prima facie, se kërkuesi ka një të drejtë jo shumë të diskutueshme për të cilin i është drejtuar Gjykatës (fumus bonis iuris), pra mund të “nuhatet” se është një e drejtë që ka nevojë për t’u mbrojtur nga kjo masë.

Ky trajtim duket se është kundërshtues me qëndrimin e mbajtur nga VUGJL nr. 10, datë 24.03.2004: *“Gjykatat vendimin për marrjen e masës së përkohshme për sigurimin e padisë nuk duhet ta mbështesin në fakte apo veprime, si dhe në cilësimin juridik të tyre, që kanë të bëjnë me shqyrtimin dhe zgjidhjen e çështjes në themel. Gjithashtu shqyrtimi i kërkesës për marrjen e masës së sigurimit të padisë duhet të trajtohet në një mënyrë të tillë që të shmangë çdo lloj perceptimi sipas të cilit gjykata e ka paragjykuar zgjidhjen e çështjes në themel apo nuk është e paanshme në gjykim.”* Por, interpretimi i drejtë është një tjetër. Gjykata duhet të vërë re *fumus bonis iuris*, pa mbajtur një qëndrim për zgjidhjen përfundimtare të çështjes, sepse do të ishte e pafalshme të merrej një masë për sigurimin e objektit të padisë kur duket qartë se për çështjen në themel paditësi nuk ka të drejtë.

Një kërkesë për masë sigurimi mund të merret sipas rregullave të Kodit të Procedurës Civile ose edhe sipas dispozitave të tjera materiale dhe procedurale, siç mund të jenë ato në kuadrin e Kodit të Familjes si p.sh. për lënien përkohësisht për rritje dhe edukim, caktimin e pensionit ushqimor, të drejtës për takim, apo strehimin në banesë deri në përfundim të gjykimit të padisë së themelit nga gjykata, si edhe masa të tjera të përkohshme në kuadër të së drejtës administrative gjatë shqyrtimit të padisë në një gjykim të tillë.

Veçanërisht të rëndësishme janë ndryshimet që prezantohen në lidhje me pezullimin e efekteve të zbatimit të aktit administrativ nga ligji Nr. 49/2012, Për Organizimin dhe Funksonimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative. Në këto raste sigurimi i padisë apo marrja e masave të përkohshme janë jetike dhe në një moment të caktuar kohor bëhen tepër të rëndësishme edhe më shumë se padia.

Veçanërisht duhet të ndalemi në trajtimin e rastit kur kërkesa për sigurimin e objektit të padisë është paraqitur para ngritjes së padisë. Në fakt një rrymë shumë e rëndësishme mendimi, ka pasur një qëndrim të unifikuar se mundësia e paraqitjes së kësaj kërkesë përpara padisë, në sajë të formulimit aktual të nenit 204,

duhet të jetë e kufizuar, vetëm në rastet kur është nevoja për ta paraqitur padinë në Gjykatën jo kompetente, por për shkak urgjence, bëhet kompetente Gjykata ku banon paditësi apo ku ndodhet pasuria që duhet të sigurohet. Sipas kësaj rryme kuptimi dhe qëllimi i këtij parashikimi është që kërkesa për sigurimin e objektit të padisë duhet të lejohet dhe të merret në shqyrtim si kërkesë e veçantë, të bëhet vetëm në ato raste kur paditësi nuk ka kohën e nevojshme për të çuar në Gjykatën kompetente padinë, por nevoja e çastit që kërkesa të merret në shqyrtim sa më parë duhet t'i japë mundësi paditësit të paraqesë atë në vendin ku banon apo atje ku ndodhet pasuria që nevojitet të sigurohet sepse rreziku është eminent.

Në rastet kur kërkesa për sigurimin e padisë paraqitet përpara gjykimin të padisë dhe Gjykata e pranon kërkesën dhe urdhëron masën për sigurimin e padisë, gjykata do të caktojë edhe një afat në maksimum prej 15 ditësh për të paraqitur padinë, prandaj avokati duhet të llogarisë që nuk ka shumë kohë në dispozicion për të përgatitur padinë dhe provat për shqyrtim. Gjithashtu, duhet mbajtur parasysh që një kërkesë për sigurim padie duhet të shqyrtohet nga gjykata brenda 5 ditëve⁶⁷ prandaj është e nevojshme që së bashku me kërkesën, të paraqiten edhe provat që e shoqërojnë atë. Në rast se padia, objekti i së cilës, është siguruar nuk është paraqitur brenda afatit të caktuar nga Gjykata, masa konsiderohet se është shfuqizuar, *ipso lege*.

Duhet të merret në konsideratë edhe një rast tjetër, kur masa për sigurimin e objektit të padisë, shqyrtohet veçmas nga padia e themelit që është shumë specifik, por edhe shumë indikativ për këtë institut.

Ligji 10428, datë 02.06.2011 Për të drejtën ndërkombëtare private⁶⁸, parashikon se Gjykatat Shqiptare kanë juridiksion edhe për të shqyrtuar kërkesat për sigurimin e padisë edhe për ato padi, për të cilat ato nuk kanë juridiksion për sa i përket themelit, por që për nevoja sigurie duke qenë se do të ekzekutohen në Shqipëri, duhet të shqyrtohen nga Gjykatat e vendit. Po të vini re me kujdes, kjo është një analogji me rastin kur kërkesa paraqitet në Gjykatën e vendit ku ndodhet pasuria që do të sigurohet. Ky parim i rëndësishëm është përqafuar me të drejtë edhe nga praktika gjyqësore edhe para hyrjes në fuqi të këtij ligji në zbatimin e

⁶⁷ Me kërkesën e paditësit, gjykata Brenda 5 ditëve, lejon marrjen e masave për sigurimin e padisë, kur ka arsye të dyshohet se ekzekutimi i vendimit për të drejtat e paditësit do të bëhet i pamundur ose i vështirë. Sigurimi i padisë lejohet kur:

a) padia mbështetet në prova me shkresë;
b) paditësi jep garanci, në masën dhe në llojin e caktuar nga gjykata, për dëmin që mund t'i shkaktohet të paditurit nga sigurimi i padisë.

Garancia mund të kërkohet edhe për rastin e parashikuar nga shkronja "a" e këtij neni.

⁶⁸ Neni 81, "Juridiksioni për masat për sigurimin e padisë", Gjykatat shqiptare kanë juridiksion për masat për sigurimin e padisë, kur ato duhet të ekzekutohen në Republikën e Shqipërisë ose nëse gjykatat shqiptare kanë juridiksion ndërkombëtar për objektin e gjykimin.

kritereve të ligjit nr.3920, datë 21.11.1964 “Mbi gëzimin e të drejtave civile nga të huajt dhe zbatimin e ligjit të huaj”. Konkretisht Kolegji Civil i Gjykatës së Larë në vendimin Nr. 00-2011-47 (22), datë 19.01.2011 është shprehur me të drejtë se: *“Kolegji Civil i Gjykatës së Larë arrin në konkluzionin se personi fizik apo juridik i huaj mund t’i drejtohet gjykatës shqiptare me kërkimin për sigurimin e padisë, në rast se pasuria/asetet e të paditurit (debitorit) ndodhet në Republikën e Shqipërisë, edhe pse kompetente për të shqyrtuar çështjen e themelit mund të jetë një gjykatë tjetër e huaj apo arbitrazhi.”*

Analoge janë edhe rastet e parashikuara nga Konventa për Arrestimin e Anijeve, e vitit 1952 (neni 7/2) dhe për më shumë ajo e Gjenezës e vitit 1999 (7/3), ku parashikohet qartë rasti i paraqitjes së kërkesës për arrestin e Anijeve në një juridiksion që nuk është kompetente për themelin e gjykimi. Këto dispozita janë zbatuar edhe nga Gjykatat Shqiptare⁶⁹.

Vetëm në sajë të vlerësimit të objektit të padisë dhe shkakut të saj, pra të përcaktimit të qartë të së drejtës subjektive dhe objektive që është në diskutim, të gjendjes së faktit që vjen ndesh me këto të drejta dhe të kërimit që i është drejtuar Gjykatës me qëllimin për ta rivendosur të drejtën subjektive, mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm nëse është rasti, për të marrë një masë dhe çfarë mase duhet të merret. Më i rëndësishëm bëhet përcaktimi i objektit të padisë që duhet siguruar, në rastet kur kërkesa paraqitet përpara ngritjes së padisë. Kjo për shkak se edhe në këtë kërkesë duhet të përcaktohet saktë se cila është padia, objekti i së cilës duhet të sigurohet. Kjo për dy arsye:

1. në radhë të parë për të vlerësuar nevojën e marrjes së këtyre masave dhe përshtatshmërinë e masës që kërkohet të merret;
2. mbi të gjitha për të vlerësuar nëse padia që do të ngrihet brenda afatit 15 ditor të treguar më lart është pikërisht ajo për të cilën ishte nevoja urgjente e sigurimit të objektit të padisë.

Po të kthehemi edhe një herë në rastet kur Gjykatat Shqiptare bëhen kompetente për shkak të së drejtës ndërkombëtare, duhet kuptuar se masat e përkohshme shqyrtohen sipas të drejtës vendase, ndaj edhe është e pritshme se Gjykata do të lerë një afat për t’u paraqitur padia e themelit në Gjykatën kompetente. Sipas të drejtës tonë afati maksimal për këtë është 15 ditë. Por, brenda këtij afati mendojmë se jo vetëm duhet të paraqitet padia në juridiksionin përkatës, por edhe duhet t’i tregohet Gjykatës shqiptare se padia është paraqitur në juridiksionin përkatës. Kjo do të thotë se duhet koordinuar puna me kolegjet e vendit ku ngrihet padia, që brenda këtij afati ju të kenë në dorë një kopje të padisë

⁶⁹ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin nr. (11 – 2012 – 7292) 22, datë 04.10.2012, kur vendosi arrestimin e Anijes M/V Adriatica, vendosi gjithashtu edhe afatin 15 ditor për paraqitjen e padisë në Gjykatën e Gjenovës, për të zgjidhur çështjen e themelit.

së paraqitur jashtë Shqipërisë, të përkthyer dhe të legalizuar për t'ia paraqitur Gjykatës Shqiptare.

Çdo kërkesë për sigurimin e padisë duhet të argumentojë nevojën e marrjes së masave nga ana e gjykatës, nevojë e cila lidhet ngushtë me pamundësinë ose krijimin e vështirësive të tepërta për ekzekutimin e së drejtës së paditësit, në rast se fitohet gjykimi prej tij. Mund të quhen vështirësi të tepërta edhe ato raste të cilat do të kërkonin shpenzime të mëdha për vënien në ekzekutim, apo do të harxhonin shumë kohë. Në gjykimin për sigurimin e padisë ajo që në fakt bën gjykata është një balancim i interesave të paditësit për ekzekutim të të drejtave të tij që rrjedhim nga fitimi i gjykimit mbi padinë, me interesat e të paditurit për të gëzuar plotësisht sendin e vet dhe për të përfituar, fryte (civile apo natyrore) nga shfrytëzimi i ligjshëm i tij.

Për rrjedhojë, duhet të argumentohet përpara gjykatës, nevojën e marrjes së masës për sigurimin e padisë dhe sidomos arsyet se përse një e drejtë e tillë e paditësit, duhet të mbizotërojë ndaj të drejtave të të paditurit për përdorim apo gëzimin e lire të sendit. Kjo është një balancë të cilën gjykata në çdo rast do ta marrë në konsideratë, prandaj është e nevojshme që avokatët të paraqesin argumente në këtë drejtim.

Gjykata mund të kërkojë që paditësi të japë garanci për dëmin që mund t'i shkaktohet të paditurit nga vendosja e masës për sigurimin e padisë dhe në çdo rast është mirë që një situatë e tillë të diskutohet me klientët. Meqenëse një garanci e tillë mund të mendohet apo vendoset nga gjykata dhe dhënia e saj mund të favorizojë marrjen e masës së sigurimit të padisë, avokatët mund të mendojnë dhe vlerësojnë opsionet për garancitë që mund të japin. Nëse arrijnë një marrëveshje me klientët, është e këshillueshme t'i paraqesin gjykatës një ose disa opsione për garancitë që mund të japin duke parashtruar edhe argumentet që do të bënin të vlefshme garancitë. Duhet të kihet kujdes që garancitë të mos rëndojnë së tepërmi klientin dhe të mbahet në konsideratë që gjykata mund të vendosë edhe disa garanci, prandaj propozimet duhen shqyrtuar në të gjitha drejtëmet përpara se t'i paraqiten gjykatës, për të mbrojtur sa më mirë interesat e klientit.

Për shkak se vendimi për sigurimin e padisë është një vendim i ndërmjetëm dhe se merret vetëm në kushte shumë specifike, Gjykatës që e ka marrë vendimin, i është dhënë edhe kompetenca për të rishikuar ose për të abroguar masat që janë vendosur për sigurimin e objektit të padisë⁷⁰. Këto vendime merren në rastet kur Gjykatës i paraqiten provat, se kushtet që kanë diktuar marrjen e masave, kanë

⁷⁰ Neni 211 i K.Pr.C.

ndryshuar dhe se rreziku për të cilin ishte bërë e domosdoshme caktimi i këtyre masave, nuk është më i pranishëm.

Veçanërisht i rëndësishëm është ankimi kundër vendimit për sigurimin e objektit të padisë. Në radhë të parë ky është një ankim i veçantë, pasi siç shpjeguem më lart vendimi për sigurimin e padisë është një vendim i ndërmjetëm. Rrjedhimisht afati për këtë ankim është 5 ditë. Paraqitja e këtij ankimi nuk pezullon zbatimin e masës, dhe kjo është e kuptueshme pasi ndryshe masat për sigurimin e objektit të padisë nuk do të kishte dimensionin e saj efektiv. Përkundrazi ankimi i veçantë i parashikuar me ligj për vendimet që heqin ose ndryshojnë masat e sigurimit të objektit të padisë, pezullon zbatimin e këtyre vendimeve.

I ndryshëm është rasti kur kërkesa për sigurimin e objektit të padisë është rrëzuar. Sërish, duke qenë se ky është një vendim i ndërmjetëm që nuk sjell asnjë pasojë për gjykimin dhe raportet e të drejtave të palëve, teorikisht ankimi kundër tij duhet të bëhet bashkë me vendimin përfundimtar⁷¹, megjithëse duke mos pasur në fakt asnjë efekt për gjykimin, mund të vlerësohet edhe në kuadrin e urdhrave të dhëna gjatë gjykimin. Mungesa e ankimit të veçantë në këtë rast ka edhe një shkak tjetër logjik dhe praktik. Është e logjishme të mendohet se për shkak të kriterit të urgjencës dhe nevojës absolute, në rast se këto kritere nuk konstatohen nga Gjykata në Shkallë të parë, është e pakuptueshme që kjo gjendje të vijojë edhe shumë kohë më pas, kur ankimi eventual të shqyrtohej në Gjykatën e Apelit.

Një risi konceptuale, në këtë drejtim, është prezantuar me ligjin Nr. 49/2012, Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative. Në nenin 32, në kreun ku diskutohen çështjet e Gjykimit në shkallë të parë është vendosur se ankimi i veçantë mund të ushtrohet edhe kundër vendimit që rrëzon kërkesën për sigurimin e objektit të padisë. Kjo risi që diferencon shumë nga parimet e treguara më lart, është e mbështetur nga shpresa që faza e gjykimin në shkallë të parë dhe ajo e Gjykimit në apel do të jenë vendosur shumë pranë në kohë dhe nga ana tjetër do të jetë premisë për zhvillime të reja jurisprudenciale.

3.3.4. Konkluzionet përfundimtare

Konkluzionet përfundimtare përfaqësojnë parashtrimin e fundit që një avokat bën mbi çështjen përpara gjykatës. Duke e konsideruar si fjalën e fundit të avokatit, para marrjes së vendimit, duhet të kemi parasysh që konkluzionet përfundimtare

⁷¹ Edhe vendimet që rrëzojnë kërkesat për pushimin e gjykimin, pezullimin e tij, përjashtimin e gjyqtarit, ankojen së bashku me vendimin përfundimtar, por kundërligjshmëria e këtyre vendimeve të ndërmjetme është shkak për prishjen e vendimit përfundimtar (neni 467 i KPC)

janë njëkohësisht edhe një apel drejtuar gjykatës për pranimin e padisë. Në këtë kuptim, ndërsa padia ka për qëllim të krijojë një hyrje mbi problematikën që do të paraqitet në gjyq, konkluzionet përfundimtare kanë qëllime të tjera; së pari, ato duhet të përmbyllin të gjitha argumentet e paraqitura dhe të shqyrtuara gjatë gjykimit nga të dyja palët; së dyti, ato duhet të japin një përgjigje për pikëpyetjet dhe argumentet e palës tjetër, por edhe çdo dyshimi që mund të keni pikasur nëpërmjet pyetjeve të gjykatës; dhe së fundmi konkluzionet përfundimtare kanë për qëllim të paraqesin në mënyrë të përmbledhur të gjitha arsyet ligjore dhe faktike mbi të cilat mbështetet padia juaj.

Konkluzionet përfundimtare paraqiten kur është mbyllur hetimi gjyqësor dhe janë marrë të gjitha provat e nevojshme dhe të kërkuara gjatë gjykimit, prandaj në këtë fazë nuk mund të paraqiten prova të reja. Nëse keni një provë për të cilën nuk kishit dijeni më parë, mund ta paraqisni përpara se të jepni konkluzionet përfundimtare duke i kërkuar gjykatës të ri çelë hetimin gjyqësor. Vetëm në rast pranimi të kësaj kërkesë kur gjykata bindet për mungesën e dijenisë së ekzistencës më parë të provës dhe lejon marrjen e saj duke ri çelur hetimin gjyqësor, mund të pranohet për shqyrtim kjo provë e re.

Ligji përcakton të drejtën për bërjen e konkluzioneve me shkrim dhe lejon një afat deri në 5 ditë i cili caktohet nga gjykata për përgatitjen e tyre, nëse kërkohet nga avokati. Sigurisht që konkluzionet përfundimtare mund të paraqiten edhe me gojë por ne do të rekomandonim që ato të jene më shkrim. Duke pasur parasysh rëndësinë e tyre si edhe faktin që gjykata mund t'i referohet në marrjen e vendimit është më mirë dhe do të konsideroheshin më shumë nëse arrini të paraqisni me shkrim konkluzionet tuaja. Le ta mendojmë kështu, nëse gjykata po shqyrton një argument tuajin, nëse konkluzionet janë më shkrim i referohet lehtë ndërsa, kur janë me gojë duhet të lexojë në procesverbal. Një gjyqtar jo shumë këmbëngulës mund të heq dorë dhe ti referohet kujtesës së tij në lidhje me argumentin; kjo është gjithmonë në disfavor sepse na heq mundësinë për të parashtruar argumentin e plotë. Këtu nuk po përmendim ato raste kur procesverbali është me shkrim dore dhe mund të ketë pasaktësi, apo kur është i regjistruar që gjyqtari duhet ta dëgjojë, gjë që është gjithmonë më e vështirë se sa t'i lexosh të përmbledhura argumentet.

Prandaj, është gjithmonë e këshillueshme t'i paraqisni me shkrim konkluzionet përfundimtare duke i kërkuar gjykatës edhe kohën e nevojshme, për të pasur mundësi të bëni një studim të fundit të dosjes dhe të gjithë gjykimit dhe të përmbledhni çështjen tuaj.

KREU 4

ORIENTIMI NË GJYKATË

Julian HAXHIU

4.1. Funksionet drejtuese në gjykatë

Funksionet drejtuese në gjykatë ushtrohen nga kryetari i gjykatës dhe kancelari. Ekzistenca e këtyre dy figurave drejtuese në gjykatë është një shembull i *checks and balances* të vendosura mes pushteteve. Kryetari i gjykatës është gjyqtar, dhe si i tillë gëzon të gjitha privilegjet kushtetuese që i garantohen gjyqtarëve.. Kancelari është përfaqësues i ekzekutivit, i emëruar nga Ministri i Drejtësisë dhe i lëvizshëm nga detyra në çdo kohë, për shkaqe të caktuara. Të dy janë të detyruar të bashkëpunojnë me njëri- tjetrin dhe kompetencat e tyre janë të ndërlidhura ngushtë.

Njohja e funksioneve të tyre është e rëndësishme, pasi ata nuk kanë vetëm kompetenca administrative, por edhe procedurale⁷².

4.1.1. Kryetari i gjykatës

Funksioni kryesor drejtues në gjykatën e shkallës së parë është ai i kryetarit. Kryetari i gjykatës emërohet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, nëpërmjet një procesi konkurrimi mes gjyqtarëve të asaj gjykate, në bazë të aftësive profesionale dhe të etikës, të aftësive organizuese dhe drejtuese⁷³. Koha e qëndrimit në detyrën e kryetarit është 4 vjet, me të drejtë riemërimi. Ushtrimi i funksioneve të kryetarit përbën një element të rëndësishëm në karrierën e gjyqtarit.

Kompetencat kryesore të kryetarit të gjykatës janë shpërndarja e gjyqtarëve

⁷²Ligji Nr. 9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

⁷³Vendim Nr. 227/2, datë 28.03.2008 i Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Për funksionin drejtues në gjykata”.

në dhoma dhe seksione⁷⁴, ndarja e gjyqtarëve në trupa gjykues dhe planifikimi i gjyqtarëve që do të gjykojnë kërkesat e fazës së hetimit penal⁷⁵. Këto kompetenca procedurale, së bashku me përfaqësimin e gjykatës në marrëdhëniet me të tretët, përbëjnë thelbin e funksioneve të kryetarit.

Gjithashtu, kryetari i gjykatës luan një rol të rëndësishëm në vlerësimin profesional të gjyqtarëve, pasi ai është përgjegjës për fazën e parë të këtij vlerësimi⁷⁶. Për këtë qëllim, ai mbikëqyr respektimin e etikës gjyqësore dhe të solemnitetit, si dhe planifikimin e çështjeve gjyqësore nga gjyqtarët e gjykatës përkatëse.

Përveç këtyre, kryetari i gjykatës ushtron edhe një sërë kompetencash të natyrës administrative. Më të rëndësishmet prej tyre janë kompetenca për të marrë masa disiplinore ndaj administratës gjyqësore⁷⁷ dhe për t'i kërkuar Ministrin të Drejtësisë fillimin e procedimit disiplinor ndaj kancelarit⁷⁸.

Ligji nuk e parashikon funksionin e zëvendëskryetarit të gjykatës, por, në mungesë të tij, kryetari mund të autorizojë një gjyqtar për ushtrimin e një pjese të kompetencave të tij drejtuese. Gjyqtari i autorizuar nuk mund të ushtrrojë funksionet procedurale të kryetarit dhe as të përfaqësojë gjykatën tek të tretët. Nëse perioda e drejtimit nga gjyqtari i autorizuar do të jetë më shumë se 10 ditë, kryetari i gjykatës duhet të njoftojë Këshillin e Lartë të Drejtësisë.

4.1.2. Kancelari i gjykatës

Kancelari është nëpunësi më i lartë i administratës gjyqësore në gjykatën ku ushtron funksionin e tij. Në ushtrimin e këtij funksioni drejtues, ai merr udhëzime të përgjithshme nga Ministri i Drejtësisë, por veprimtarinë e përditshme e ushtron në bashkëpunim të ngushtë me kryetarin e gjykatës.

Kancelari i gjykatës emërohet dhe shkarkohet nga Ministri i Drejtësisë. Ai duhet të jetë jurist me përvojë pune jo më pak se pesë vjet në këtë profesion dhe përfiton pagë dhe leje të pagueshme vjetore të njëjtë me atë të gjyqtarit të gjykatës përkatëse ku ushtron funksionet.

Kancelari drejton dhe përgjigjet për shërbimet ndihmëse në gjykatë.

⁷⁴ Kjo shpërndarje bëhet çdo dy vjet, por kryetari i gjykatës mund të komandojë gjyqtarë për të gjykuar në një seksion tjetër në çdo kohë.

⁷⁵ Ky planifikim bëhet çdo muaj, sipas rendit alfabetik, me bazë mbiemrin.

⁷⁶ Vendimi Nr. 193/2, datë 11.05.2006 i Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Sistemi i Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve” dhe Vendim Nr. 261/2, datë 14.04.2010 i Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve”.

⁷⁷ Mbi bazën e propozimit të kancelarit.

⁷⁸ Në rast se kancelari nuk zbaton urdhrin e kryetarit për të marrë masa që veprimet dhe vendimet e marra nga gjyqtarët në kryerjen e veprimtarisë së tyre gjyqësore të zbatohen menjëherë nga administrata gjyqësore.

4.2. Menaxhimi i çështjeve civile në gjykatë

4.2.1. Regjistrat gjyqësorë

Në fushën civile, gjykata mban regjistrat e mëposhtëm:

- a) Regjistri Themeltar Civil, në të cilin regjistrohen të gjitha kërkesë-paditë civile të paraqitura për gjykim. Për secilën kërkesë-padi shënohen palët, objekti i padisë, baza ligjore dhe, pasi përfundon gjykimi, vendimmarrjen e gjykatës, ankimet dhe vendimmarrjen e gjykatave më të larta;
- b) Indeks in Alfabetik të Çështjeve Civile, në të cilin shënohen emrat dhe mbiemrat e çdo paditësi dhe të padituri, sipas rendit alfabetik;
- c) Regjistrin e Vendimeve Civile, në të cilin shënohen të gjithë vendimet civile, sipas numrit të tyre rendor. Për secilin vendim shënohen data e dhënies së tij, emri i gjyqtarit, emrat e palëve, objekti dhe numri i seancave;
- d) Regjistrin e Personave të cilëve u është Hequr, Kufizuar ose Kthyer Zotësia për të Vepruar.

Përveç këtyre regjistrave, të cilët mbahen në çdo gjykatë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë mban edhe:

- a) Regjistrin e Organizatave Jo-Qeveritare;
- b) Regjistrin e Partive Politike.

Deri në vitin 2007⁷⁹, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë mbante edhe Regjistrin e Shoqërive Tregtare, kurse të gjitha gjykatat mbanin Regjistrin e Personave Fizikë.

Aktualisht, të gjitha gjykatat e vendit përdorin sistemin ICMIS të menaxhimit të çështjeve. Ndërkohë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë vazhdon të përdorë edhe sistemin ARK IT, i cili është instaluar rreth 10 vjet më parë në disa gjykata të vendit. Të gjitha të dhënat për çështjet civile e penale të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përshtirë kalendarin e gjykimeve, informacionin për çdo seancë gjyqësore dhe vendimin përfundimtar të gjykatës, mund të gjenden në faqen e kësaj gjykate në internet www.gjykatatirana.gov.al (sistemi ARK IT).

Gjatë dy-tre viteve të fundit, Ministria e Drejtësisë ka punuar për të bërë kalimin e gjykatave që përdornin sistemin ARKIT në sistemin kombëtar ICMIS. Në vitin 2012, Ministria e Drejtësisë hapi portalin www.gjykata.gov.al, në të cilin mund të merret informacion për çdo çështje gjyqësore në çdo gjykatë të vendit (në të vërtetë, eksperiencat me këtë portal janë mikse dhe nuk është e qartë nëse kjo ndodh për shkak të vështirësive teknike apo sepse informacioni nuk ndodhet aty).

⁷⁹ Kohë kur u miratua Ligji Nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

4.2.2. Pranimi i çështjeve civile

Gjykimi civil fillon me paraqitjen e padisë civile. Kërkesë-padia paraqitet me shkrim dhe mund t'i dorëzohet gjykatës dorazi (nga vetë paditësi apo përfaqësuesi i tij me prokurë) apo nëpërmjet shërbimit postar. Aktualisht, nuk është e mundur që paditë të depozitohen me mjete të tjera, përfshirë dorëzimin elektronik.

Së bashku me padinë, duhet të paraqiten edhe prokura e përfaqësuesit, nëse ka; aktet provuese, si dhe kopje të padisë dhe akteve provuese për të gjithë palët e tjera..

Paditësi ose përfaqësuesi i tij duhet të mbajë gjithashtu edhe një kopje të kërkesë-padisë për vete, në të cilën të vendoset vula e sekretarisë gjyqësore dhe data e paraqitjes së padisë. Në këtë mënyrë, ai provon datën e depozitimit të padisë, në bazë të së cilës llogaritet nëse padia është paraqitur brenda afatit të parashikuar apo jo.

Kërkesë-padisë i vendoset vula me datën e paraqitjes, regjistrohet në Regjistrin Themeltar Civil dhe krijohet dosja përkatëse, në të cilën depozitohet edhe çdo dokument që është paraqitur me kërkesë-padinë, si edhe çdo dokument i paraqitur më vonë e çdo dokument procedural i krijuar nga gjykata, përfshirë procesverbalin e seancës dhe vendimet gjyqësore.

4.2.3. Ndarja e çështjeve civile

Në të gjitha gjykatat çështjet ndahen me short, pra në mënyrë rastësore, ndërmjet të gjithë gjyqtarëve. Aktualisht, të gjitha gjykatat përdorin programe të caktuara kompjuterike për ndarjen e çështjeve. Kryetari i gjykatës dhe kancelari nuk mund t'ia japin një çështje një gjyqtari të caktuar, por kryetari i gjykatës mund të përjashtojë një ose më shumë gjyqtarë nga shorti për një çështje të caktuar. Rastet kur kjo mund të ndodhë janë: çështja është kthyer për rigjykim nga një tjetër trup gjykues; gjyqtari ka ngarkesë shumë të madhe në krahasim me gjyqtarët e tjerë, etj.

4.3. Marrëdhëniet me publikun dhe median

Pranë çdo gjykate funksionon edhe Sektori për Marrëdhëniet me Publikun dhe Median. Kjo zyrë e ushtron veprimtarinë e saj nën kujdesin e kancelarit të Gjykatës dhe ka për objekt:

- a) informimin e publikut dhe medias për veprimtarinë e gjykatës;
- b) promovimin e imazhit të gjykatës dhe punonjësve të saj kundrejt publikut;
- c) administrimin e marrëdhënieve të gjykatës me publikun;

- d) informimi i brendshëm në gjykatë;
- e) marrja e ankesave për mosrespektim të kërkesave të publikut dhe medias nga personeli i gjykatës.

Ky sektor është përgjegjës edhe për hartimin dhe publikimin e:

- a) emrat e punonjësve të ngarkuar me informimin e publikut, marrjen e kërkesave dhe kthimin e përgjigjeve;
- b) procedurave të punës së gjykatës dhe gjyqtarëve;
- c) listave të gjyqeve;
- d) afateve dhe njoftimeve të ndryshme që kanë lidhje me punën e gjykatës.

4.4. Taksat gjyqësore

Taksat për veprimet dhe shërbimet që kryhen nga administrata gjyqësore⁸⁰ janë përcaktuar me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Drejtësisë⁸¹.

Tarifat aktuale pasqyrohen në tabelën më poshtë:

Lloji i veprimit/shërbimit	Tarifa në lekë
Për lëshimin e vërtetimit se personi nuk ka pengesë ligjore për pajisjen me pasaportë për jashtë shtetit	200
Për lëshimin e kopjes së vendimit ose të çdo dokumenti që kërkohet nga të interesuarit	200
Për lëshimin e vërtetimit se kërkuesi nuk është në proces gjyqësor	200
Kërkesë për pension ushqimor	0
Kërkesë për vërtetim fakti	200
Kërkesë-padi për zgjidhje martese	3000
Kërkesë-padi për pavlefshmëri të veprimeve juridike	3000

⁸⁰ Në të vërtetë, udhëzimi përdor termin “tarifa”, por sqaron se ky term ka të njëjtin kuptim me termin “taksë mbi aktet” i përdorur në nenin 156 të Kodit të Procedurës Civile.

⁸¹ Udhëzim Nr. 13, datë 12.2.2009 i Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të administratës gjyqësore e ministrisë së drejtësisë, prokurorisë, noterisë dhe zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”. Niveli aktual i tarifave është përcaktuar në vitin 2010, nga Udhëzimi Nr. 991/3, datë 2.3.2010, i cili ka bërë ndryshime në udhëzimin e sipërpërmendur.

Kërkesë-padi të rrjedhura nga marrëdhënie kontraktore dhe kërkesë-padi për shkaktim dëmi: - Nëse vlera e padisë është deri në 100.000 lekë; - Nëse vlera e padisë është mbi 100.000 lekë.	3000 1 % e vlerës së padisë
Kërkesë-padi për pjesëtim pasurie	3000
Kërkesë-padi për kthim në punë	0
Pranimi i ankimeve kundër vendimeve gjyqësore	200
Pranimi i ankimeve për paditë e pensionit ushqimor dhe kthimit në punë	0

Siç shihet, tabela nuk parashikon tarifa për çdo lloj padie që mund të ngrihet në gjykatë. Për këtë arsye, gjykata të ndryshme kanë praktika të ndryshme në lidhje me llogaritjen e tarifave për paditë që nuk parashikohen në udhëzim. Praktika mbizotëruese është ajo e përdorimit të tarifave të parashikuara për paditë kontraktore, pra 3000 lekë për paditë me vlerë deri në 100.000 lekë dhe 1% e vlerës së padisë për padi me vlerë më të madhe.

Tarifat e shërbimeve gjyqësore paguhen në momentin e kryerjes së veprimeve. Vërtetimi i kryerjes së pagesës bëhet nëpërmjet vendosjes së pullave, nëse tarifa është fikse, ose me mandatarëkëtim, nëse tarifa është e përcaktuar në përqindje.

Në rast se personi heq dorë nga gjykimi apo nga e drejta e padisë, tarifrat e paguara nuk i kthehen.

Në rast se paditësi ose kërkuesi nuk kanë paguar, plotësisht ose pjesërisht, taksën mbi aktet (tarifën gjyqësore), gjyqtari i çështjes do t'u japë atyre kohë për ta bërë këtë pagesë. Nëse pagesa përsëri nuk bëhet, gjyqtari do të urdhërojë kthimin e akteve paditësit ose kërkuesit. Kodi i Procedurës Civile i jep mundësinë gjyqtarit të vendosë nëse paditësi ose kërkuesi mund të përjashtohet nga pagimi i taksës mbi aktet.

4.5. Aktet e procesit civil

Aktet procedurale janë akte që i përkasin procesit civil, të cilat krijohen gjatë tij dhe sjellin pasoja të drejtpërdrejta mbi marrëdhënien procedurale civile. Aktet procedurale krijohen nga gjykata dhe nga palët.

4.5.1. Aktet e gjykimit në shkallë të parë

4.5.1.1. Padia

Sipas përkufizimit ligjor, padia është e drejta e personit që bën pretendimin për t'u dëgjuar për themelin e këtij pretendimi, në mënyrë që gjykata ta shpallë atë të bazuar ose jo. Padia duhet të përmbajë:

- a) të dhënat identifikuese të paditësit dhe adresën e tij;
- b) të dhënat identifikuese të të paditurit dhe adresën e tij;
- c) të dhënat identifikuese dhe adresën e përfaqësuesve;
- d) objektin e padisë, përfshirë vlerën e tij, nëse është i vlerësueshëm;
- e) faktet dhe provat, mbi të cilat mbështetet padia;
- f) atë çfarë kërkon paditësi nga gjykata.

4.5.1.2. Kërkesa për sigurimin e padisë

Kërkesa për sigurimin e padisë mund të paraqitet para ngritjes së padisë, së bashku me padinë apo pasi ka filluar gjykimi. Në këtë rast, kërkesa duhet të tregojë llojin e padisë që do të ngrihet.

Nëse kërkesa për sigurimin e padisë paraqitet para ngritjes së padisë, ajo përmban formalisht elementët e padisë (të renditur më sipër). Në rast se paraqitet bashkë me padinë, kjo kërkesë nuk është e nevojshme të pasqyrohet në një dokument më vete, por mund të përfshihet si një ndër pikat e objektit të padisë dhe një ndër kërkimet e paditësit.

Nëse kërkesa për sigurimin e padisë paraqitet gjatë gjykimit, ajo përmban formalisht elementët e padisë.

4.5.1.3. Prapësimet

Prapësimet nuk janë akt procedural. Ato janë kundërshtimet e palës së paditur. Prapësimet nuk është e nevojshme të pasqyrohen në një dokument, ato mund të bëhen me gojë para gjykatës. Prapësimet nuk u nënshtrohen afateve të parashkrimit dhe nuk ka nevojë të kenë një formë të caktuar.

4.5.1.4. Kundërpadia

Kundërpadia u nënshtrohet të gjitha rregullave si padia. I vetmi ndryshim mes tyre është se kundërpadia paraqitet në kuadër të një gjykimi të filluar dhe

nuk i jep rrugë regjistrimit të një çështjeje të re dhe krijimit të një fashikulli të ri, por, nëse hiqet dorë nga gjykimi i padisë, gjykimi vazhdon mbi bazën e kundërpadisë, e cila bëhet shkak për ekzistencën e çështjes civile.

4.5.1.5. Vendimet e ndërmjetme

Vendimet e ndërmjetme jepen nga gjykata gjatë seancës gjyqësore dhe kanë për qëllim të garantojnë disiplinimin e procesit dhe zhvillimin e tij brenda rregullave të parashikuara dhe nën autoritetin e gjykatës. Si rregull, vendimet e ndërmjetme kanë karakter procedural dhe nuk zgjidhin çështje të themelit të gjykimit. Për këtë arsye, ndaj vendimeve të ndërmjetme, si rregull, nuk mund të ushtrohet ankimi i veçantë, por vetëm së bashku me vendimin përfundimtar.

4.5.1.6. Vendimi përfundimtar

Vendimi përfundimtar i gjykatës e zgjidh çështjen në themel. Këta vendime duhet të dallohen nga vendimet jo përfundimtare, pra vendimet që i japin fund gjykimit, por nuk e zgjidhin çështjen në themel (vendimi i pushimit, nxjerrja jashtë juridiksionit gjyqësor, etj.). Vendimi përfundimtar i gjykatës së shkallës së parë nuk është i formës së prerë dhe nuk ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme.

KREU 5

GJYKIMI NË SHKALLË TË PARË

Julian HAXHIU

5.1. Gjykimet civile në përgjithësi

5.1.1. Parimet e gjykimit civil

Gjykimi civil zhvillohet në bazë të parimeve të mëposhtme:

- a) Parimi i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë. Ky parim do të thotë, nga njëra anë, që ligjet dhe aktet nënligjore duhet të jenë në pajtim me Kushtetutën dhe, nga ana tjetër, që gjykatat duhet të respektojnë Kushtetutën dhe ligjet e aktet nënligjore që janë në pajtim me të.
- b) Gjykimi nga një gjykatë e pavarur dhe paanshme, brenda një afati të arsyeshëm.
- c) Gjykimi me dyer të hapura dhe shpallja publike e vendimit. Nga parimi i gjykimit publik mund të bëhet përjashtim, në raste të caktuara në ligj, por vendimi gjyqësor shpallet gjithmonë publikisht.
- d) Parimi i kontradiktoritetit dhe barazisë së pjesëmarrësve në procesin gjyqësor. Ky parim nënkupton se gjykimi bazohet mbi debatin e palëve dhe se të dyja palëve duhet t'u jepen të njëjtat mundësi e të njëjtat mjete procedurale për të prezantuar rastin e tyre para gjykatës.
- e) Parimi i disponibilitetit, i cili do të thotë se gjykimi civil fillon vetëm me kërkesë të palëve të interesuara. Gjithashtu, ky parim nënkupton se paditësi ka të drejtë të heqë dorë nga gjykimi ose nga e drejta e padisë në çdo kohë apo të bjerë dakord për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me pajtim.
- f) Parimi i oralitetit të gjykimit, i cili do të thotë se gjykimi, si rregull, zhvillohet verbalisht, megjithëse palëve u lejohet të paraqesin pretendime e prapësime me shkrim.

Gjykimi civil duhet të bazohet edhe në dy parime të tjera, të cilat nuk gjejnë shprehje të qartë në Kodin e Procedurës Civile dhe në doktrinë. I pari është parimi, sipas të cilit secila nga palët është e detyruar të provojë pretendimet dhe prapësimet që bën. Në dallim nga procesi penal, në procesin civil barra e provës është e barabartë mes të dy palëve.

Parimi i dytë lidhet me standardin e të provuarit në gjykimet civile. Ashtu si edhe për akuzat penale⁸², legjislacioni ynë hesht në lidhje me standardin e të provuarit në çështjet civile. Në legjislacione të ndryshme gjejmë standarde të ndryshme. Në Gjermani, Francë dhe, në përgjithësi, në vendet e traditës së *të drejtës civile* zbatohet i njëjti parim si në çështjet penale, ashtu edhe në ato civile. Ky parim është ekuivalent i "*përtej çdo dyshimi të arsyeshëm*", por në vende të ndryshme shprehet në mënyrë të ndryshme. Në vendet e traditës *common law* zbatohen standarde me të ulëta në çështjet civile. Këto standarde i gjejmë me emrat: mbizotërim i provave (*preponderance of evidence*), prova të qarta e bindëse (*clear and convincing evidence*) apo balancë e mundësive (*balance of probabilities*), etj.

5.1.2. Palët në gjykimin civil

Palë ose ndërjyqës në një gjykim civil janë personat fizikë ose juridikë, në emër ose kundër të cilëve zhvillohet gjykimi. Në shumicën e proceseve civile, palët janë paditësi, pra personi që vë në lëvizje gjykatën dhe i kërkon asaj të marrë një vendim, dhe i padituri, pra personi kundër të cilit kërkohet të merret vendimi. Në një numër procesesh gjyqësore, si palë paraqitet edhe ndërhyrësi (personi i tretë). Personi i tretë mund të ndërhyjë duke bërë kërkime kundër të dy palëve (ndërhyrës kryesor) ose duke u bashkuar me njërin nga palët (ndërhyrës dytësor).

Përcaktimi i kuptimit të palës duhet të dallohet nga përcaktimi i legjitimitetit, pra nga identifikimi i personave, të cilëve u përket e drejta për të ngritur padi apo kundër të cilëve duhet të ngrihet padia. Palët ngelen të tilla për procesin gjyqësor edhe nëse ato nuk kanë legjitimitetin në lidhje me mosmarrëveshjen objekt gjykimi. Për të rregulluar situatat, në të cilat cilësia e palës nuk përputhet me legjitimitetin, gjykata mund të lejojë zëvendësimin e palës. Zëvendësimi kërkohet nga pala e interesuar, por për të kërkohet pëlqimi i të dy palëve i personit që zëvendëson paditësit apo të paditurin.

Palët në një gjykim civil, si rregull, duhet të kenë zotësi për të vepruar dhe, nëse nuk kanë ose kanë zotësi të kufizuar për të vepruar, përfaqësohen nga kujdestari

⁸² As Kodi i Procedurës Penale nuk e shpreh në mënyrë të qartë standardin e të provuarit, por pranohet gjërisht se, për çështjet penale, ai është "*përtej çdo dyshimi të arsyeshëm*".

ligjor. Personat juridike publikë përfaqësohen nga titullari i tyre, kurse shoqëritë tregtare nga administratori i tyre apo ortakët i caktuar në statut si përfaqësues.

Palët e gjykimit civil mund të zgjedhin të përfaqësohen nga një person tjetër apo nga avokati.

Palët në gjykimin civil kanë detyrimin për t'u sjellë në mënyrë korrekte, për të ndihmuar zhvillimin normal të hetimit gjyqësor dhe për të parapaguar shpenzimet gjyqësore.

5.1.3. Listë kontrolli për avokatin e paditësit në gjykimin civil

1. Gjatë takimit të parë me paditësin, zhvillo një intervistë paraprake mbi çështjen
2. Shqyrto dokumentet që disponon paditësi.
3. Nëse është e nevojshme, zhvillo një intervistë shtesë me paditësin, për të sqaruar elementë të tjerë të çështjes apo hetuar mbi prova të tjera që mund të ekzistojnë.
4. Konsultohu me paditësin dhe vendos për objektin e padisë.
5. Sigurohu që çështja bën pjesë në juridiksionin gjyqësor dhe që janë shteruar mjetet e ankimit administrativ. Nëse jo, diskuto me paditësin për veprimet që duhet të ndërmerren dhe mundësinë për ta përfaqësuar në procedimin administrativ.
6. Përcakto gjykatën që ka kompetencën lëndore: nëse çështja nuk është në kompetencë të gjykatave administrative, atëherë ajo është në kompetencë të gjykatave të rretheve gjyqësore.
7. Përcakto gjykatën që ka kompetencën tokësore:
 - a. Verifiko nëse ekziston ndonjë marrëveshje mes palëve për përcaktimin e gjykatës kompetente. Nëse ka marrëveshje të tillë, sigurohu që ajo nuk vjen në kundërshtim me ndalimet e parashikuara në nenin 52 KPC.
 - b. Nëse nuk ka marrëveshje mes palëve, përcakto gjykatën ose gjykatat kompetente sipas neneve 42- 53 KPC.
 - c. Nëse është kompetente më shumë se një gjykatë, konsultohu me paditësin për të zgjedhur gjykatën, pranë të cilës do të ngrihet padia. Faktorët që mund të merren parasysh në këtë vendim janë: vendndodhja e secilës gjykatë dhe largësia nga vendbanimi i paditësit dhe selia e avokatit; praktika e mëparshme e gjykatës në çështje të ngjashme, etj.
8. Përcakto vlerën e padisë dhe informo paditësin për taksat dhe tarifat gjyqësore.
9. Nëse vlera e padisë është me e madhe se 20 milionë lekë, konsultohu me

paditësin nëse do të kërkonti trup gjykues me tre gjyqtarë apo jo. Gjykimi me një gjyqtar mund të jetë më i shpejtë, por ai me trup gjykues mund të ofrojë më shumë garanci.

10. Konsultohu me paditësin dhe vendosni për të gjithë elementet e marrëdhënies së përfaqësimit.
11. Nënshkruani aktin e përfaqësimit.
12. Harto padinë, konsultojë me paditësin dhe merr nënshkrimin e tij.
13. Përgatit kopje të padisë dhe provave për të gjithë të paditurit.
14. Dorëzo padinë në gjykatë.
15. Ndiq shortin në gjykatë.
16. Paraqitu pranë gjyqtarit, të cilit i ka rënë çështja ne short, për të caktuar datën e seancës përgatitore.
17. Kërko kopje të provave të të paditurit.

5.1.4. Listë kontrolli për avokatin e të paditurit në gjykimin civil

1. Gjatë takimit të parë me paditësin, shqyrto padinë dhe provat e paraqitura bashkë me të.
2. Shqyrto dokumentet që disponon i padituri.
3. Nëse është e nevojshme, zhvillo një intervistë shtesë me të paditurin, për të sqaruar elementë të tjerë të çështjes apo hetuar mbi prova të tjera që mund të ekzistojnë.
4. Sigurohu që çështja bën pjesë në juridiksionin gjyqësor dhe që janë shteruar mjetet e ankimit administrativ. Nëse jo, diskuto me të paditurin nëse duhet të kërkohet nxjerrja jashtë juridiksionit gjyqësor dhe mundësinë për ta përfaqësuar në procedimin administrativ.
5. Sigurohu që çështja është paraqitur para gjykatës kompetente. Nëse jo, diskuto me të paditurin për kundërshtimin e kompetencës.
6. Nëse vlera e padisë është me e madhe se 20 milionë lekë, konsultohu me paditësin nëse do të kërkonti trup gjykues me tre gjyqtarë apo jo. Gjykimi me një gjyqtar mund të jetë më i shpejtë, por ai me trup gjykues mund të ofrojë më shumë garanci.
7. Konsultohu me paditësin dhe vendos për mënyrën e përgjigjes ndaj padisë. Nëse do të ngrihet kundërpadi, referoju listës paraardhëse të kontrollit.
8. Konsultohu me të paditurin dhe vendosni për të gjithë elementët e marrëdhënies së përfaqësimit.
9. Nënshkruani aktin e përfaqësimit.
10. Përgatit kopje të provave për të gjithë paditësit.

5.1.5. Teknika të hartimit të dokumenteve që i paraqiten gjykatës

Sipas frymës së legjislacionit procedural civil, gjykimi bazohet në parimin e oralitetit, që do të thotë se procesi zhvillohet verbalisht para gjykatës. Megjithatë, palët e, veçanërisht, avokatët e tyre, nxiten t'i paraqesin pretendimet e prapësimet e tyre me shkrim. Avantazhi i dokumenteve të shkruar është se ato lejojnë të bëhen analiza të detajuara ligjore, gjë që nuk është gjithmonë e mundur në prezantimin verbal. Nga ana tjetër, një prezantim verbal, sado i mirë qoftë, e humbet vlerën nëse marrësi i informacionit (gjyqtari) nuk është i vëmendshëm gjatë të gjithë prezantimit. Për më tepër, dokumenti i shkruar përbën një referencë më të shpejtë për gjyqtarin se sa procesverbali i seancës gjyqësore, prandaj mund të përbëjë edhe një bazë të mirë për vendimin e gjykatës. Nuk duhet harruar edhe se pretendimet e shkruara përbëjnë gjithashtu një referencë më të shpejtë për gjykatat më të larta, gjatë shqyrtimit të çështjes së ankimuar.

Përveç padisë, që është dokumenti më i rëndësishëm që palët hartojnë e që duhet të plotësojë kërkesat formale të parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile, ato mund t'i drejtohen gjykatës me dokumente të tjerë, që nuk ka nevojë të kenë ndonjë formë të caktuar apo të respektojnë ndonjë formalitet. Zakonisht, këto dokumente kanë formën e memorandumëve.

5.1.5.1. Të përgatitesh për të shkruar

Para se të shkruajë një dokument që i drejtohet gjykatës, avokati duhet:

1. Të njohë mirë çështjen, provat dhe dokumentet e tjera të paraqitura nga palët.
2. Të njohë mirë pretendimet e palës tjetër.
3. Të ketë diskutuar dhe vendosur me klientin se cila është strategjia e mbrojtjes.
4. Të ketë vendosur se çfarë është e rëndësishme të përfshihet në dokument.

Ky vendim shpesh duhet të merret pak diskutimesh e konsultimesh me klientin e pasi të jenë bërë vlerësimet e mëposhtme, por gjithmonë duke mbajtur parasysh se është e këshillueshme të përfshihen vetëm ato çështje, për të cilat i kërkohet gjykatës të marrë një vendim.

- a. Çfarë mendon klienti se është e rëndësishme të përfshihet?
- b. Çfarë pretendon pala tjetër që është e rëndësishme të përmendet dhe rrëzohet me argumente?
- c. Çfarë pret gjykata që të argumentohet nga pala?
- d. Cilat mendoj unë se janë problemet thelbësore në çështjen në fjalë?

5. Të ketë bërë punën e përshtatshme kërkimore mbi çështjet procedurale dhe ato thelbësore, duke përfshirë:
 - a. Ligjet dhe aktet nënligjore të zbatueshme.
 - b. Vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë.
 - c. Praktikën gjyqësore të gjykatës që shqyrton çështjen dhe gjykatave më të larta.
 - d. Doktrinën dhe artikuj te revistave ligjore.

5.1.5.2. Këshilla për shkrimin e dokumenteve që i paraqiten gjykatës

- a) Strukturat bazë të dokumenteve ligjorë janë:
 - a. IRAC: Çështja-Rregulli-Analiza-Përfundimi.
 - b. CRAC: Përfundimi-Rregulli-Analiza-Përfundimi.
- b) Çdo dokument ligjor duhet të fillojë me një paragraf hyrës. Ky paragraf përmban çështjen ose çështjet më të rëndësishme që ju doni të vini në vëmendje të gjykatës.
- c) Në dokument duhet të renditen të gjitha faktet që janë të nevojshme për të kuptuar çështjen tuaj. Faktet duhet të renditen në një vend, në mënyrë të ndarë nga analiza e ligjit apo e provave. Gjithashtu, duhet të bëni kujdes që datat, nëse janë të rëndësishme për t'u përfshirë, të renditen në një paragraf të vetëm dhe jo përgjatë të gjithë dokumentit, për të mos ngatërruar lexuesin.
- d) Çështjet procedurale dhe ato që kanë të bëjnë me juridiksionin/kompetencën duhet të trajtohen në fillim të dokumentit. Nëse këto çështje janë shumë të rëndësishme, ato duhet të trajtohen në dokumente të veçantë.
- e) Çdo dokument duhet të mbyllet me një paragraf përmbyllës, i cili është ana tjetër e paragrafit hyrës dhe tregon çfarë i kërkohet gjykatës.
- f) Nëse bëhen citime, këto duhet të tregojnë burimin dhe të vendosen në thonjëza.
- g) Shënimet në fund të faqes duhet të përdoren për të treguar burimin e informacionit ose për të vënë në dukje një çështje dytësore. Nëse një çështje është thelbësore, ajo nuk duhet të shpjegohet me shënim në fund të faqes.
- h) Në shkrimin e dokumenteve ligjorë, duhet të evitohet:
 - a. Përdorimi i formës pësore.
 - b. Përfshirja e detajeve që nuk janë të rëndësishme.
 - c. Përdorimi i termave të përgjithshëm, nëse sendet/njerëzit mund të individualizohen.

- d. Përdorimi i “mendoj”, ”besoj”, etj.
- e. Përdorimi i fjalive të gjata apo fjalëve të vështira, për të bërë përshtypje tek lexuesi.
- f. Ndajfoljet që nuk thonë asgjë: “qartësisht”, “jashtëzakonisht”, “shumë”, pa dyshim”, “në të vërtetë”, etj.
- g. Shprehjet emotive.
- h. Mungesa e strukturës.

5.1.6. Teknika të prezantimit të çështjes para gjykatës

Në vendet që kanë një sistem gjyqësor kontradiktor të fortë, prezantimi i çështjes në gjyq quhet edhe “art”, sepse aftësitë dhe talenti i avokatëve shpesh arrin të ndikojë edhe në rezultatin e çështjes. Kjo është e vërtetë, pasi ata që vendosin për faktet janë qenie njerëzore dhe mund të ndikohen nga personaliteti i avokatëve, aftësia e tyre bindëse, aftësia për të paraqitur versionin e tyre të fakteve në mënyrë logjike e të kuptueshme, si dhe forca e argumenteve.

Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, vendi me sistemin kundërshtar më të konsoliduar, studimi i jurive ka treguar se anëtarët e tyre i marrin vendimet mbi bazën e një sërë faktorësh, ndër të cilët janë: 1) besueshmëria e personit që jep informacionin (“dërguesi”); 2) aftësia e dëgjuesit (“marrësi”) dhe 3) teknikat efikase të dhënies së mesazhit.

5.1.6.1. Besueshmëria e dërguesit

Gjatë gjyqit, dërguesit e informacionit janë përfaqësuesit e palëve, dëshmitarët dhe ekspertët. Besueshmëria përcaktohet nga tre faktorë: 1) integriteti, 2) ekspertiza dhe 3) dinamizmi.

Integriteti përcaktohet nga perceptimi se dëshmitari ose mbrojtësi është i pandikuar, i qëndrueshëm dhe i sinqertë.

Ekspertiza u referohet njohurive që dërguesi zotëron në lidhje me faktet dhe problemet e çështjes. Në rastin e avokatit, ekspertiza tregohet duke qenë i përgatitur dhe në gjendje për të prezantuar çështjen dhe trajtuar problemet faktike e ligjore rrjedhshëm dhe me logjikë. Për dëshmitarët, ekspertiza vërtetohet duke treguar se dëshmitari ka qenë në gjendje të shohë, dëgjojë dhe kujtojë ngjarjet, për të cilat po dëshmon. Në rastin e ekspertit, ajo përcaktohet nga arsimi, trajnimi dhe përvoja e tij, si dhe plotësia e analizës së tij.

Dinamizmi i referohet aftësisë së dërguesit për të komunikuar. Dërguesit e

kendshëm dhe që përçojnë energji, vetëbesim dhe entuziazëm janë më të lehtë për t'u besuar sesa të tjerë që nuk i kanë këto cilësi. Të gjithë elementët e komunikimit efikas: përmbajtja verbale (fjalët që thuhet) dhe mënyra e përcjelljes (qëndrimi, lëvizjet e duarve, gjestet, kontakti me sy, shpejtësia e të folurit, theksimi i fjalëve, intonacioni, etj.) luajnë një rol të rëndësishëm në mënyrën se si merret dhe përpunohet mesazhi.

5.1.6.2. Aftësitë e marrësit

Marrësit (gjyqtarët) kanë aftësi të ndryshme për të përpunuar informacionin dhe për të mbajtur mend atë që shohin dhe dëgjojnë. Tek pjesa më e madhe e njerëzve, kohëzgjatja e përqendrimit është e shkurtër; mesatarisht, një person mund të qëndrojë i përqendruar vetëm rreth 15-20 minuta pa ndërprerje, përpara se përqendrimi të fillojë të bjerë. Pas kalimit të kësaj kohe, disa njerëz e zhvendosin plotësisht vëmendjen, kurse të tjerë dëgjojnë me intervale. Për më tepër, ka njerëz që mësojnë më lehtë nëpërmjet perceptimeve pamore sesa atyre dëgjimore, që do të thotë se ata e përthithin më mirë informacionin nga ato që lexojnë ose shikojnë sesa nga ato që dëgjojnë. Gjithashtu, njerëzit priren ta përpunojnë informacionin mbi bazën e mendimit personal mbi mënyrën se si funksionon bota, që do të thotë mbi bazën e përvojave të tyre jetësore, bindjeve personale dhe preferencave.

5.1.6.3. Dhënia e mesazhit në mënyrë efektive

Njohja e dëgjuesve dhe përshtatja ndaj tyre është përbërësi kyç i një prezantimi të suksesshëm të çështjes. Për avokatët, kjo nënkupton njohjen e gjyqtarëve dhe qëndrimeve të tyre, bazuar në përvojat e mëparshme personale ose të kolegëve me këta gjyqtarë. Gjithashtu, mesazhi duhet të formulohet në mënyrë të tillë që të mund të përthithet lehtë. Shumë njerëz fillojnë të harrojnë brenda pak orëve pjesën më të madhe të asaj që ju është thënë dhe ky përfundim vlen për ata që e kanë dëgjuar atë që u është thënë. Pas disa ditëve, në kujtesën e tyre mbetet shumë pak informacion. Duke qenë se një pjesë e çështjeve duan javë ose muaj që të përfundojnë dhe ka shumë ndërprerje ndërmjet prezantimeve të pjesëve të ndryshme të çështjes, harresa e marrësve mund të kthehet në një problem vërtet të madh. Megjithatë, avokati mund të përdorë strategji për të rritur aftësitë e gjyqtarëve për të mbajtur mend, nëpërmjet përdorimit të fjalëve dhe shprehjeve kyçe, temave, mjeteve pamore ndihmese dhe, sigurisht, nëpërmjet përsëritjes.

5.1.6.4. Planifikimi i gjyqit

Mendimi i parë është që të gjitha përgatitjet për gjyqin duhet të synojnë që prezantimi i çështjes të jetë i kuptueshëm për trupin gjykues. Në disa sisteme ligjore, avokatët besojnë se janë të detyruar t'i paraqesin gjithçka gjykatës, sepse vetë trupi gjykues vendos se çfarë është e rëndësishme dhe çfarë jo. Kjo është krejt e kundërta e prezantimit të çështjes në gjyq! Është përgjegjësia e avokatit të përcaktojë se cilat prej provave i shërbejnë çështjes dhe jo e trupit gjykues. Të bësh të kundërtën, pra t'i lësh gjykatës të përcaktojë se çfarë është e rëndësishme, i dërgon asaj mesazhin se avokati nuk e njih çështjen ose ajo nuk i intereson ose të dyja bashkë.

Prezantimi në gjyq përfshin shumë më tepër sesa tregimin e fakteve: këto fakte duhet të organizohen dhe të prezantohen si pjesë e një historie të paharrueshme. Aftësia për të treguar histori është baza e asaj që ndodh gjatë gjyqit, përfshirë shpjegimet e palëve dhe diskutimet përfundimtare. Avokatët më të mirë janë, pa dyshim, shumë të aftë për të treguar histori.

5.1.6.5. Këshilla praktike për prezantimin e rastit

a) Shpjegoni teorinë tuaj të rastit. Çdo çështje ka dy versione: atë të palës që ju përfaqësoni dhe atë të palës tjetër. Teoria juaj e rastit është versioni juaj i të vërtetës, i cili bazohet mbi faktet e pakundërshtuara dhe interpretimin tuaj për faktet e kundërshtuara. Teoria duhet të jetë logjike dhe e lehtë për t'u kuptuar. Teoria duhet të qëndrojë sipas logjikës normale të gjërave, por edhe duhet të përshtatet me mënyrën se si trupi gjykues e percepton botën reale.

b) Përcaktoni temën tuaj. Çdo çështje mund të përmblihet në një a më shumë (por jo më shumë se tre ose katër) tema, të cilat shprehin pozicionin tuaj në mënyrë të kuptueshme dhe të lehtë për t'u mbajtur mend. Herë-herë tema mund të jetë një fjalë, herë- herë një fjali e lehtë për t'u mbajtur mend. Tema është diçka që mund të deklarohet që në fillim të gjyqit dhe të përsëritet në fund të tij, në bisedimet përfundimtare.

c) Filloni fuqishëm. Tema dhe teoria e rastit duhet të prezantohen sa më shpejt të jetë e mundur. Ky është momenti kur trupi gjykues është edhe më i vëmendshëm, prandaj duhet të shfrytëzohet në maksimum.

d) Shprehni faktet në mënyrë të qartë. Gabimi më i zakonshëm që bëjnë përfaqësuesit e palëve është se harrojnë të përmendin faktet ose nuk arrijnë t'i deklarojnë ato në mënyrë të qartë dhe koherente. Përkundrazi, shpesh ata flasin për faktet sikur dëgjuesi ta njohë tashmë çështjen. Avokati nuk duhet ta marrë të mirëqenë se trupi gjykues e ka lexuar dosjen ose, nëse e ka lexuar, e ka kuptuar

atë krejtësisht

e) Bëjeni çështjen interesante.

f) Jini të qartë, bindes dhe pozitivë. Kjo do të thotë se struktura e fjalive duhet të jetë e thjeshtë dhe e drejtpërdrejtë dhe duhet të përzgjidhen fjalë të thjeshta.

g) Bëhuni efikasë. Siç është theksuar më sipër, pjesa më e madhe e njerëzve fillojnë të humbasin përqendrimin pas 15-20 minutash, por, edhe gjatë kësaj kohe, mendja shpërqendrohet herë pas here. Kërkimet, gjithashtu, tregojnë se kujtesa shuhet shpejt dhe, brenda një kohe të shkurtër, njerëzit harrojnë shumicën e atyre që kanë dëgjuar. Një faktor kyç në përmirësimin e kujtesës është përsëritja. Ajo ndihmohet, gjithashtu, nga stimulimi pamor.

h) Ndaluni tek pikat e forta të çështjes dhe tek provat që tregojnë qartë avantazhin tuaj. Nëse harxhoni kohën për t'u mbrojtur nga argumentet e palës tjetër, atëherë i keni dërguar një mesazh negativ gjyqtarëve.

i) Përmendni pikat e dobëta. Përbalja me pikat e dobëta dobëson argumentet që do të përdorë kundërshtari juaj, kur të vijë radha e tij, si dhe tregon se jeni i sigurtë kundrejt trupi gjykues. Përveç kësaj, shpesh mund t'u jepni një trajtë asnjane ose pozitive pikave tuaja të dobëta.

5.1.6.6. Teknikat e komunikimit të mesazhit

a) Mos lexoni apo mësoni përmendesh. Diskutimi më i mirë është ai që komunikohet duke pasur një skemë. Përdorimi i skemës ju lejon ta planifikoni diskutimin, ta komunikoni atë në mënyrë spontane dhe t'i përshtateni argumenteve të palës kundërshtare.

b) Lëvizjet. Një farë lëvizje e trupit dhe duarve do ta gjallërojë diskutimin tuaj përfundimtar dhe do të shtojë përqendrimin e trupit gjykues. Gjestet mund të përdoren për të theksuar pika të rëndësishme apo për të vënë në pah ndryshimin ndërmjet argumenteve tuaj dhe atyre të kundërshtarit. Lëvizjet trupore mund të përdoren gjithashtu për të theksuar apo kaluar në një temë tjetër. Megjithatë, duhet të shmangni ecejaket kuturu dhe gjestet pa qëllim. Lëvizjet e vazhdueshme jo vetëm që janë shpërqendruese, por edhe nuk ju lejojnë t'i përdorni ato për një qëllim të caktuar.

c) Ritmi verbal. Shpejtësia, toni, intonacioni dhe volumi i zërit tuaj mund të jenë mjete bindëse të rëndësishme. Ndryshimet e tyre mund të përdoren për të sinjalizuar kalimin nga njëra temë në tjetrën dhe për të mbajtur të mbërthyer vëmendjen e gjyqtarëve. Është e rëndësishme të mos flisni as shumë shpejt, as shumë ngadalë.

d) Emocioni. Ka disa shkolla mendimi për përdorimin e emocionit gjatë diskutimit. Shumë juristë besojnë se emocioni ka pak vend gjatë gjyqit, ndërsa të

tjerë besojnë se emocionit mund të komunikojë me po aq efikasitet sa dhe logjika apo arsyeja. Megjithatë, të gjithë bien dakord se emocionet e shtirura japin efektin e kundërt. Qasja më e mirë ndaj emocionit është ta ruash për momentin kur diskuton dimensionin moral të çështjes.

5.1.6.7. Etika dhe argumentet e palejueshme

a) Deklarata të bindjeve personale. Është e pavend dhe jo etike që një avokat të shprehë njohuri personale për faktet që diskutohen apo të deklarojë një mendim personal në lidhje me drejtësinë e çështjes.

b) Thirrja për paragjykim apo intolerancë. Është jo etike të përpiqeni të bindni gjykatën nëpërmjet thirrjeve për paragjykim mbi bazën e racës, fesë, etnisë, gjinisë apo faktorëve të tjerë.

c) Shtrembërimi i provave. Ndërkohë që lejohet të nxirrni deduksione apo konkluzione, është e pavend që, në mënyrë të qëllimshme, të shtrembëroni apo keqinterpretoni provat.

d) Citimi i keq i ligjit. Avokati mund të citojë dispozitat ligjore që zbatohen dhe mund t'i lidhë ato me faktet e çështjes. Megjithatë, në asnjë mënyrë nuk duhet të citoni keq ligjin apo të përdorni interpretime të tij që janë në kundërshtim me frymën e ligjit.

e) Keqpërdorimi i provave. Kur provat janë pranuar vetëm për një qëllim të caktuar, është e pavend të përpiqesh t'i përdorësh ato për ndonjë qëllim tjetër.

f) Thirrje ndaj interesit personal të gjykatësit. Avokati nuk duhet të përdorë kurrë një argument që bashkon interesat e ndonjërit prej gjyqtarëve me rezultatit e çështjes. Nëse një anëtar i trupit gjykues ka pasur një interes personal, avokati duhet të kishte kërkuar përjashtimin e tij.

5.1.7. Skema e gjykimit civil

Gjykimi civil kalon nëpër tre faza: fazën e krijimit, fazën e shqyrtimi apo hetimit gjyqësor dhe fazën e përfundimit të çështjes. Gjykimi civil fillon gjithmonë me paraqitjen e padisë, pra me kërkesën e paditësit që gjykata të shprehet mbi themelin e pretendimeve të tij.

Padia duhet të plotësojë kërkesat formale, të parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile. Nëse padia nuk plotëson këto kërkesa, atëherë gjyqtari i vetëm vendos kthimin e saj për plotësimin e të metave, duke caktuar edhe një afat, brenda të cilit duhet të bëhet kjo gjë. Nëse të metat nuk plotësohen brenda afatit, padia, së bashku me aktet, kthehet pa veprime të mëtejshme. Kthimi i


padisë pa veprime përbën një vendim procedural, pra jo themeli, dhe nuk përbën pengesë për ngritjen e padisë në një moment tjetër. Nëse të metat plotësohen brenda afatit të caktuar, atëherë gjykimi vazhdon.

Në shumicën e çështjeve civile, gjyqtari zhvillon një seancë përgatitore. Qëllimi i kësaj seance, në të cilën marrin pjesë palët, është të përcaktohet natyra e mosmarrëveshjes, të shpjegohen çështje që do të dalin gjatë gjykimit, si dhe të përcaktohen provat që do të sillen nga palët për vërtetimin e pretendimeve e të prapësimeve të tyre.

Gjatë seancës përgatitore, gjyqtari bën edhe përpjekje për zgjidhjen e çështjes me pajtim dhe, nëse arrihet pajtimi, merr vendimin përkatës dhe miraton marrëveshjen e palëve. Gjithashtu, nëse janë kushtet e parashikuara nga ligji, gjykata mund të pushojë gjykimin edhe gjatë seancës përgatitore, përveç se gjatë gjykimit. Pezullimi i gjykimit mund të vendoset, gjithashtu, në çdo kohë, si gjatë seancës përgatitore, ashtu edhe gjatë gjykimit. Pezullimi bie menjëherë nëse pushon së ekzistuari shkaku i pezullimit.

Shqyrtimi gjyqësor i çështjes fillon me shpjegimet e paditësit dhe prapësimet e të paditurit. Procesi civil, si rregull, zhvillohet verbalisht para gjykatës dhe ka një fleksibilitet të madh, që u lejon palëve të paraqesin çështjen e tyre dhe provat përkatëse.

Për një paraqitje skematike të gjykimit, shih skemën.



5.2. Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative⁸³

Gjykimet administrative lindin si pasojë e konflikteve mes personave fizikë e juridikë dhe administratës publike. Karakteristikat e këtyre gjykimeve janë:

- a) konfliktet e natyrës administrative lindin kryesisht si pasojë e veprimtarisë së administratës publike ose paaftësisë së saj për të marrë vendime. Megjithatë, jo çdo veprimtari e administratës publike bëhet shkak për konflikt administrativ. Vetëm veprimtaria e saj në ushtrim të kompetencave ekzekutive e urdhërdhënëse bëhet shkak për konflikte të tilla;
- b) pjesa më e madhe e konflikteve administrative duhet të kalojnë nëpër shkallët e ankimit administrativ para se të arrijnë në gjykatë;
- c) vetëm një kategori shumë e vogël aktesh administrative nuk bën pjesë në juridiksionin e zakonshëm gjyqësor;
- d) organi i administratës publike, si rregull, ka detyrimin të provojë bazueshmërinë në ligj dhe në fakt të veprimeve të kryera prej tij;
- e) gjykata administrative, sipas natyrës së çështjes, shqyrton çështjen gojarisht në seancë gjyqësore ose mbi bazë aktesh shkresore në dhomë këshillimi. Mosparaqitja e palëve nuk përbën shkak për pushimin e gjykimit.

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, u miratua nga Kuvendi më datë 3.5.2012, kurse gjykatat administrative filluan nga funksionimi më datë 4 nëntor 2013.

Në territorin e Republikës së Shqipërisë, gjykatat administrative organizohen në 6 gjykata të shkallës së parë dhe 1 gjykatë apeli. Gjykatat administrative të shkallës së parë kanë kompetencë tokësore dhe seli qendrore të ushtrimit të veprimtarisë së tyre, si më poshtë:

1. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka kompetencë tokësore në rrethet: Bulqizë, Dibër, Krujë, Laç, Mat dhe Tiranë, me seli qendrore në Tiranë.
2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës ka kompetencë tokësore në rrethet: Elbasan, Gramsh, Librazhd, Peqin, Durrës dhe Kavajë, me seli qendrore në Durrës.
3. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër ka kompetencë tokësore në rrethet: Lezhë, Mirditë, Kukës, Has, Pukë, Malësi e Madhe, Shkodër dhe Tropojë, me seli qendrore në Shkodër.
4. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë ka kompetencë tokësore

⁸³ **Shënim:** Ky nënkapitull bazohet në Ligjin 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

në rrethet: Berat, Skrapar, Kuçovë, Fier, Mallakastër, Lushnjë dhe Vlorë me seli qendrore në Vlorë.

5. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë ka kompetencë tokësore në rrethet: Devoll, Kolonjë, Bashkinë Leskovik, Korçë dhe Pogradec me seli qendrore në Korçë.
6. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë ka kompetencë tokësore në rrethet: Gjirokastrë, Tepelenë, Përmet, Delvinë dhe Sarandë, me seli qendrore në Gjirokastrë.

Gjykata Administrative e Apelit, me seli në Tiranë, ka kompetencë tokësore në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

5.2.1. Aktet administrative që i nënshtrohen kontrollit gjyqësor

Gjykatat administrative janë kompetente për:

- a) mosmarrëveshjet që lindin nga aktet administrative individuale, aktet nënligjore normative dhe kontratat administrative publike, të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative nga organi publik;
- b) mosmarrëveshjet që lindin për shkak të ndërhyrjes së paligjshme ose të mosveprimit të organit publik;
- c) mosmarrëveshjet e kompetencave ndërmjet organeve të ndryshme administrative në rastet e parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative;
- d) mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të punës, kur punëdhënësi është organi i administratës publike;
- e) kërkesat e paraqitura nga organet administrative për shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative, për të cilat ligji parashikon heqjen e lirisë deri në 30 ditë, si një lloj të dënimit administrativ për kundërvajtësin;
- f) kërkesat e paraqitura nga kundërvajtësit për zëvendësimin e dënimit administrativ me heqje lirie deri në 30 ditë me dënimin me gjobë.

Gjykata administrative nuk shqyrton mosmarrëveshjet:

- a) të cilat lidhen me aktet nënligjore normative që, sipas Kushtetutës, janë në kompetencën e Gjykatës Kushtetuese;
- b) shqyrtimi i të cilave, sipas legjislacionit në fuqi, është në kompetencën e një gjykate tjetër.

5.2.2. Llojet e padive administrative

Të drejtën e ngritjes së padisë e ka:

- a) çdo subjekt, që pretendon se i është cenuar një e drejtë apo një interes i ligjshëm nga një veprim apo mosveprim i organit publik;
- b) organi i administratës publike, që pretendon se është cenuar në ushtrimin e kompetencave nga një akt administrativ apo nga një akt nënligjor normativ i paligjshëm, i një organi publik, me të cilin nuk ka lidhje varësie hierarkike. Në këtë rast, organi shtetëror mund të kërkojë zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës dhe/ose shfuqizimin e aktit;
- c) punëmarrësi ose punëdhënësi për mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të punës, kur punëdhënësi është një organ i administratës publike;
- d) çdo subjekt që pretendon se është cenuar në të drejtat dhe interesat e tij të ligjshëm për shkak të ndërhyrjeve të paligjshme të organit publik, që nuk kanë formën e aktit administrativ;
- e) çdo shoqatë apo grup interesi që pretendon se është cenuar një interes i ligjshëm publik:
- f) nga një akt normativ;
- g) nga një akt administrativ, në rast se një e drejtë e tillë u njihet me ligj;
- h) çdo subjekt tjetër, të cilit kjo e drejtë i njihet shprehimisht me ligj.

Padia ngrihet:

- a) për shfuqizimin tërësisht apo pjesërisht të aktit administrativ;
- b) për ndryshimin, pjesërisht apo tërësisht, të aktit administrativ apo detyrimin e organit publik për të ndryshuar një akt administrativ;
- c) për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ;
- d) për të detyruar organin publik të kryejë një veprim administrativ, që është refuzuar, apo për të cilin organi publik ka heshtur, ndonëse ka pasur kërkesë;
- e) për konstatimin e paligjshmërisë së veprimit administrativ, që nuk prodhon pasoja juridike, nëse paditësi ka një interes të arsyeshëm për këtë;
- f) për saktësimin e të drejtave dhe të detyrimeve ndërmjet paditësit dhe organit publik;
- g) për detyrimin e organit publik për të kryer apo për të ndaluar kryerjen e një veprimi tjetër administrativ, të nevojshëm për mbrojtjen e të drejtave apo të interesave të paditësit;
- h) për përcaktimin e organit që ka në kompetencën e tij zgjidhjen e çështjes konkrete, duke urdhëruar kur është rasti dhe shfuqizimin e aktit të nxjerrë

nga organi jokompetent;

- i) për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor, sipas ligjit të posaçëm;
- j) për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të punës, kur punëdhënësi është një organ i administratës publike.

Pra, paditë administrative janë të dy llojeve. E para me përmbajtje pozitive, me të cilën kërkohet shfuqizimi ose ndryshimi i një akti administrativ dhe e dyta me përmbajtje negative, me të cilën kundërshtohet refuzimi i miratimit të një akti administrativ ose lënia pa shqyrtim e kundërshtimit të shtetasit në organin kompetent administrativ.

Paditë administrative mund t'i ngrejë vetëm personi, interesat e të cilit preken nga akti apo veprimi administrativ. I padituri është gjithmonë një organ administrativ. Paditësi duhet të argumentojë paligjshmërinë e aktit administrativ dhe faktin se, nga ky akt i paligjshëm, i cenohen interesat e të drejtat e tij, drejtpërdrejt ose tërthorazi, individualisht ose në mënyrë kolektive.

Së bashku me padinë, paditësi i paraqet gjykatës kopjen e aktit administrativ që kundërshtohet, por nuk ka detyrim të bashkëlidhë aktet të tjera provuese. Paditësi është i detyruar të identifikojë saktë veprimin ose mosveprimin administrative që kundërshton. Gjithashtu, paditësi duhet të tregojë adresën e tij ose të përfaqësuesit, në të cilën duhet t'i dërgohen nga gjykata njoftimet dhe aktet, si dhe një numër telefoni ose adresë elektronike.

Padia administrative mund të përmbajë edhe një kërkim dytësor, atë të shpërblimit të dëmit të shkaktuar. Në varësi të interesit të paditësit, ky kërkim mund të paraqitet edhe si padi më vete.

5.2.3. Kufijtë e shqyrtimit gjyqësor dhe afatet e gjykimit administrativ

Gjykata shqyrton ligjshmërinë e veprimit administrativ që kundërshtohet, në bazë të provave të paraqitura nga palët dhe të situatës ligjore dhe faktike që ekzistonte në kohën e kryerjes së veprimit konkret administrativ.

Në rastet kur paditësi ose kur ligji material kërkojnë nxjerrjen e një akti administrativ, gjykata e bazon vendimin e saj në situatën faktike dhe ligjore në kohën e marrjes së vendimit.

Në rastin kur ligji i jep organit publik të drejtën për zgjedhje alternative, në nxjerrjen e një akti administrativ apo në kryerjen e veprimit tjetër administrativ, gjykata shqyrton edhe nëse:

- a) zgjedhja nga organi publik është bërë në përputhje me objektivin dhe

qëllimin e ligjit;

- b) zgjedhja nga organi publik është bërë vetëm për të arritur qëllimin e ligjit;
- c) zgjedhja nga organi publik është në raport të drejtë me nevojën që e ka diktuar atë.

Për mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të punës, gjykata zbaton legjislacionin që rregullon marrëdhëniet e punës.

Gjykata administrative, gjatë shqyrtimit gjyqësor të një veprimi administrativ, kryesisht ose me kërkesë të palëve, vendos të mos zbatojë një akt nënligjor normativ, në bazë të të cilit është kryer veprimi administrativ që shqyrtohet, kur çmon se akti nënligjor është i paligjshëm. Gjykata vendos në këtë mënyrë edhe nëse gjykimi parësor i aktit normativ nuk është në kompetencën e saj.

Ligji parashikon afate për faza të ndryshme të gjykimit administrativ.

Padia kundër veprimit administrativ paraqitet në gjykatë brenda 45 ditëve nga marrja dijeni për veprimin administrativ, vendimin e organit epror administrativ, ndërhyrjen e paligjshme të organit administrativ, etj. Ky afat është prekluziv, gjë që do të thotë që ai nuk ndërpritet e nuk pezullohet dhe kalimi i tij sjell jo vetëm humbjen e mundësisë procedurale, por edhe humbjen e të drejtës subjektive. Ky afat merret në shqyrtim nga gjykata me iniciativën e saj, pa patur nevojë për kërkesë nga pala. Si përjashtim nga rregulli, padia për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ mund të ngrihet në çdo kohë.

Brenda 7 ditëve nga data e paraqitjes së padisë, gjyqtari kryesues kryen veprimet e nevojshme përgatitore. Nëse padia është paraqitur me të meta, ai cakton një afat deri në 10 ditë për rregullimin e tyre. Nëse të metat nuk plotësohen brenda këtij afati, gjyqtari jep vendim për kthimin e padis. Gjyqtari i njofton të paditurit padinë dhe aktet shoqëruese të saj, duke i caktuar atij një afat, deri në 10 ditë nga data e marrjes së njoftimit, për depozitimin në sekretari të prapësimeve me shkrim dhe të listës së dëshmitarëve e ekspertëve.

Pas përfundimit të veprimeve përgatitore, gjyqtari cakton seancën gjyqësore. Në dallim nga seanca e gjykimit civil, seanca e gjykimit administrativ nuk ndikohet nga mosparaqitja e palëve, pasi kjo nuk përbën shkak as për shtyrjen dhe as për pushimin e gjykimit.

Shqyrtimi i çështjeve administrative, në dallim nga ato civile, bëhet me shkrim dhe, vetëm si përjashtim, palët mund të bëjnë parashtrime gojarisht, me kusht që këto parashtrime të jenë të përmbledhura e të përmbajnë çështje që janë përmendur më parë në padi ose prapësimet me shkrim.

Si rregull, vendimi i gjykatës duhet të shpallet i arsyetuar. Vetëm në raste përjashtimore dhe vetëm për shkak të pamundësisë absolute, gjykata shtyn shpalljen e arsyetuar të vendimit deri në 5 ditë. Në çdo rast, dosja duhet të dorëzohet në sekretarinë gjyqësore brenda 7 ditëve nga shpallja e vendimit.

5.2.4. Barra e provës në gjykimin administrativ

Barra e provës në gjykimin administrativ është e përzier. Pavarësisht objektit të padisë, i padituri, pra organi administrativ, ka detyrimin të provojë ligjshmërinë e aktit administrativ apo veprimin tjetër administrativ dhe ligjshmërinë e veprimeve, nga të cilat ka lindur mosmarrëveshja në kuadër të marrëdhënieve të punës. Gjithashtu, i paditur ka detyrimin të provojë faktet që parashtron dhe pretendimet që bën vetë.

Paditësi ka detyrim të provojë faktet e tjera që parashtron. Në raste të caktuara, gjykata mund ta kalojë edhe këtë barrë prove tek i padituri.

Ashtu si edhe për gjykimin civil, ligji hesht në lidhje me standardin e të provuarit në gjykimin administrativ.

5.2.5. Pezullimi i aktit administrativ, si një lloj i veçantë i masës për sigurimin e padisë

Me paraqitjen e padisë, paditësi mund t'i kërkojë gjykatës marrjen e masave të sigurimit të padisë, në rastet kur ai tregon se gjatë kohës së nevojshme të procesit, derisa të arrihet në marrjen e vendimit të themelit, ekziston mundësia e ardhjes së një dëmi të rëndë e të pariparueshëm, që rrjedh nga ekzekutimi i veprimin administrativ.

Kërkesa për sigurimin e padisë, për shkak të rrethanave të çështjes, mund të paraqitet edhe para ngritjes së padisë. Në këto raste, gjykata, kur lejon sigurimin e padisë, cakton edhe një afat, jo më të gjatë se 10 ditë, brenda të cilit duhet të ngrihet padia.

Kërkesa për sigurimin e padisë duhet të shqyrtohet brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes në gjykatë. Si rregull kërkesa shqyrtohet në prani të palëve, por, në raste të ngutshme, mund të shqyrtohet edhe pa u thirrur palët.

Vendimi për sigurimin e padisë jepet në çdo fazë dhe shkallë të shqyrtimit gjyqësor, derisa vendimi nuk ka marrë formë të prerë. Në të gjitha rastet gjykata duhet të arsyetojë vendimin e saj. Vendimi jepet nga gjykata, pranë së cilës ndodhet padia.

Gjykata vendos sigurimin e padisë, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

- a) ekziston dyshimi i arsyeshëm, i bazuar në shkresa, për mundësinë e shkakimit të një dëmi të rëndë, të pakthyeshëm dhe të atëçastshëm për paditësin;
- b) nuk cenohet rëndë interesi publik;
- c) nëse shihet e nevojshme nga gjykata, paditësi jep garanci, në llojin dhe masën e caktuar për dëmin, që mund t'i shkaktohet të paditurit nga sigurimi i padisë.

Sigurimi i padisë bëhet nëpërmjet:

- a) pezullimit të zbatimit të aktit administrativ, kontratës administrative ose veprimit tjetër administrativ;
- b) marrjes edhe të masave të tjera të përshtatshme, nga gjykata, në rastet kur vetëm pezullimi nuk ofron mbrojtje të mjaftueshme.

5.2.6. Vendimi i gjykatës në përfundim të gjykimit administrativ

Gjykata vendos mospranimin e padisë, kur padia nuk plotëson kushtet formale të paraqitjes së saj. Ky vendim jepet derisa nuk është dhënë vendimi i ndërmjetëm për shqyrtimin e provave.

Gjykata vendos pushimin e gjykimit, kur paditësi heq dorë nga gjykimi i padisë.

Gjykata, në vendimin e saj përfundimtar të pranimit, tërësisht ose pjesërisht të padisë, vendos:

- a) shfuqizimin tërësisht apo pjesërisht të aktit administrativ;
- b) ndryshimin, pjesërisht apo tërësisht, të aktit administrativ ose detyrimin e organit publik për të ndryshuar një akt administrativ;
- c) konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ;
- d) detyrimin e organit publik për të kryer një veprim administrativ, që është refuzuar, apo për të cilin organi publik ka heshtur, ndonëse ka pasur kërkesë;
- e) konstatimin e paligjshmërisë së veprimit administrativ që nuk prodhon më pasoja juridike, nëse paditësi ka një interes të arsyeshëm për këtë;
- f) saktësimin e të drejtave dhe të detyrimeve ndërmjet paditësit dhe organit publik;
- g) detyrimin e organit publik për të kryer apo për të ndaluar kryerjen e një veprimi tjetër administrativ, të nevojshëm për mbrojtjen e të drejtave apo të interesave të paditësit;
- h) përcaktimin e organit që ka në kompetencën e tij zgjidhjen e çështjes konkrete, duke urdhëruar, kur është rasti, dhe shfuqizimin e aktit të nxjerrë nga organi jokompetent;

- i) shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor, sipas ligjit të posaçëm;
- j) zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të punës, kur punëdhënësi është një organ i administratës publike.

Gjykata vendos rrëzimin e padisë, kur vlerëson se veprimi administrativ apo akti nënligjor normativ është i ligjshëm dhe i themeltë. Gjykata vendos rrëzimin e padisë dhe kur vlerëson se, pavarësisht shkeljeve procedurale të konstatuara të veprimtarisë administrative, pasojat do të ishin të njëjta.

5.3. Mosmarrëveshjet që lidhen me familjen

Mosmarrëveshjet në gjirin e familjes kanë një natyrë të ndryshme nga gjykimet civile në përgjithësi dhe i përkasin të drejtës familjare. Gjykimi i tyre u nënshtrohet rregullave të përgjithshme të procedurës civile dhe rregullave të posaçme procedurale, të parashikuara nga Kodi i Familjes.

Mosmarrëveshjet familjare mund të lindin nga martesja, nga marrëdhëniet mes anëtarëve të familjes (detyrimi për ushqim, kujdestaria, përgjegjësia prindërore, amësia dhe atësia, birësimi, etj.).

Paditë familjare janë të veçanta në faktin që ato gjithmonë janë padi konstitutive, pasi ato krijojnë, ndryshojnë apo shuajnë marrëdhënie mes anëtarëve të familjes. P.sh. padia për njohjen e atësisë krijon marrëdhënie të reja familjare, padia për ndryshimin e detyrimit për ushqim ndryshon marrëdhënie familjare ekzistuese, kurse padia për zgjidhjen e martesës shuan marrëdhënien burrë-grua.

Përcaktimi i llojit të padisë është i rëndësishëm edhe në nivelin praktik, sepse tregon mënyrën se si palët do të formulojnë kërkimet e tyre për gjykatën dhe urdhërimet që gjykata do të japë në vendimin përfundimtar. Kështu, në radhë të parë, paditësi do t'i kërkojë gjykatës krijimin, ndryshimin apo shuarjen e marrëdhënies familjare përkatëse, kurse çdo kërkim tjetër do të jetë me natyrë dytësore, pasi do të kërkohej si pasojë e krijimit, ndryshimit apo shuarjes së marrëdhënies mes paditësit dhe të paditurit. P.sh: në rastin e zgjidhjes së martesës, lënia e fëmijëve për rritje dhe edukim, detyrimi ushqimor, ndryshimi i mbiemrit, etj., janë kërtime dytësore që vijnë si pasojë e zgjidhjes së martesës. Madje, disa prej këtyre çështjeve duhet të zgjidhen nga gjykata edhe nëse nuk ka kërkesë nga paditësi apo i padituri. Këto janë zakonisht çështje që kanë të bëjnë me mbrojtjen e interesave të fëmijëve. P.sh. kur vendos zgjidhjen e martesës, gjykata është e detyruar të përcaktojë lënien e fëmijëve për rritje dhe edukim dhe detyrimin ushqimor. Kurse disa çështje të tjera nuk mund të zgjidhen nga gjykata nëse nuk ka një kërkesë nga palët. P.sh. pjesëtimi i pasurisë bashkëshortore, etj.

Në këtë kuptim, vendimi i gjykatës nuk do të jetë vetëm konstituitiv, por do të ketë edhe urdhërime detyruese për çështje të veçanta. Këto urdhërime, nëse nuk ekzekutohen në mënyrë vullnetare, mund të ekzekutohen me forcën detyruese të shtetit. Ndërkohë, disponimet me natyrë konstitutive (zgjidhja e martesës, birësimi, etj.) ekzekutohen administrativisht, pa patur nevojë për ndërhyrjen e zyrës së përmbartimit.

Një karakteristikë tjetër e veçantë e gjykimeve me natyrë familjare është se vendimet gjyqësore që jepen në përfundim të këtyre gjykimeve nuk marrin asnjëherë formë të prerë nga pikëpamja substanciale. Kjo do thotë se palët mund të kërkojnë në çdo kohë krijimin, ndryshimin apo shuarjen e të njëjtës marrëdhënie juridike familjare. Këtë gjë ata mund ta bëjnë pa patur nevojë të bëjnë ankim gjyqësor ndaj vendimit të mëparshëm (ankimi gjyqësor është gjithashtu i mundur, por u nënshtrohet afateve të shkurtra). P.sh: martesa e zgjidhur mund të rilidhet në çdo kohë para Zyrës së Gjendjes Civile dhe të zgjidhet përsëri në çdo kohë; secili nga ish bashkëshortët mund të kërkojë me padi të re ndryshimin e prindit që ka për rritje dhe edukim fëmijët, ndryshimin e detyrimit ushqimor dhe të takimeve me fëmijët; përgjegjësia prindërore e hequr mund të kthehet prapë, etj.

Kjo karakteristikë e vendimeve që jepen në fushën e marrëdhënieve familjare është e rëndësishme, sepse ndihmon palët e interesuar dhe avokatin e saj për të ndërtuar strategjitë e mbrojtjes. P.sh: prindi që kërkon lënien e fëmijëve për rritje dhe edukim, por i rrëzohet kjo kërkesë nga gjykata, mund të zgjedhë të mos bëjë ankim, por të përpiqet për të ndryshuar kushtet dhe të bëjë një kërkesë të re disa kohë më vonë.

5.3.1. Zgjidhja dhe pavlefshmëria e martesës

Paditë për zgjidhjen e martesës (padija për divorc) dhe për shpalljen e pavlefshmërisë së martesës janë në kompetencën lëndore të seksioneve familjare në gjykatat e rretheve gjyqësore. Nëse zgjidhja e martesës kërkohet me pajtim apo nëse ka kontratë për pasurinë bashkëshortore, bashkëshortët mund të zgjedhin gjykatën që do të ketë kompetencë. Nëse kjo nuk është bërë, kompetenca tokësore për këto padi i takon si gjykatës së vendit ku bashkëshortët kanë patur vendbanimin e fundit të përbashkët, ashtu edhe gjykatës së vendit ku ka vendbanimin i padituri.

Të dyja këto padi kanë karakter konstituitiv shues, sepse synojnë të shuajnë marrëdhëniet bashkëshortore, të krijuara nga martesa.

Procedura e gjykimit të këtyre padive nuk parashikohet në Kodin e Procedurës Civile, por në Kodin e Familjes, i cili parashikon edhe dispozitat materiale për këto padi. Megjithatë, Kodi i Procedurës Civile vazhdon të zbatohet për çështje si: njoftimet, mënyrën e zhvillimit dhe drejtimit të seancës, etj.

Padia për zgjidhjen e martesës mund të ngrihet nga secili bashkëshort apo nga të dy bashkë (zgjidhje me pajtim), si edhe nga kujdestari i bashkëshortit pa zotësi për të vepruar apo me zotësi të kufizuar për të vepruar. Bashkëshortët mund ta ngrenë padinë nëpërmjet përfaqësuesve të tyre, por për këtë qëllim duhet t'u japin atyre prokurë të posaçme.

Padia për shpalljen e pavlefshmërisë së martesës mund të ngrihet nga bashkëshorti që është martuar pa shprehur vullnet të lirë (mund të jetë vetëm njëri ose të dy), nga prokurori apo nga çdo person që ka një interes të ligjshëm, në varësi të shkakut të pretenduar të pavlefshmërisë. Për këtë arsye, është e domosdoshme që, para ngritjes së një padie për pavlefshmërinë e martesës, paditësi dhe avokati i tij të saktësojnë shkakun e pavlefshmërisë dhe të sigurohen që paditësi ka legjitimitet aktiv për këtë lloj padie.

Përveç kërkesave të përgjithshme për përmbajtjen e padisë, padia për zgjidhjen e martesës duhet të përmbajë edhe disa të dhëna të posaçme:

- Gjendjen faktike të fëmijëve, pra ku dhe me cilin person jetojnë ata;
- Nëse fëmijët jetojnë me një person të tretë, të dhënat identifikuese të këtij personi;
- Të dhëna për të ardhurat e secilit bashkëshort dhe burimet e këtyre të ardhurave;
- Të dhëna për fëmijë të tjerë (nga martesë të mëparshme, jashtë martesë) të secilit bashkëshort apo persona të tjerë në ngarkim të tyre;
- Të dhëna për situatën e banimit të secilit bashkëshort;
- Të dhëna për pasurinë bashkëshortore; etj.

Padisë i bashkëngjiten detyrimisht certifikata e martesës dhe certifikatat e lindjes së fëmijëve. Nëse padia përmban të dhënat si më sipër, duhet të bashkëngjiten edhe dokumentet provues përkatës.

Një ndër të veçantat e gjykimit të padisë për zgjidhjen e martesës është detyrueshmëria e zhvillimit të seancës përgatitore, e cila, për këto gjykime, quhet seancë pajtimi. Në këtë seancë, gjyqtari dëgjon personalisht bashkëshortët (nëse ata paraqiten) dhe bindet për vullnetin e tyre të lirë në zgjidhjen e martesës. Seanca e pajtimit nuk është vendosur në ligj për arsye formale, por si një detyrim serioz i gjykatës për të hetuar shkakun e vërtetë të zgjidhjes së martesës dhe për t'u bindur se nuk ekziston asnjë mundësi që kjo martesë të vazhdojë. Në këtë

kuptim, është gjithashtu detyrim për avokatët që, gjatë seancës së pajtimit, të ndihmojnë gjykatën në përpjekjet e saj për të evituar zgjidhjen e një martese.

Përpjekjet për pajtim janë aq të rëndësishme në një çështje të tillë sa ligji i ka dhënë gjyqtarit mundësinë që të shtyjë shpalljen e vendimit përfundimtar deri në një vit, nëse çmon se ka mundësi për pajtim. Të njëjtin qëllim ndjek edhe detyrimi që ka gjykata për të pezulluar gjykimin me kërkesë të gruas shtatzënë. Ky pezullim zgjat derisa fëmija të mbushë një vjeç. Ky lloj pezullimi synon gjithashtu të mbrojë mirëqenien e gruas shtatzënë dhe ta ruajë atë nga pasojat psikologjike e sociale që mund të sjellë divorci dhe jetesa vetëm.

Një veçanti tjetër e padisë për zgjidhjen e martesës është se ajo duhet të ngrihet edhe kur mes palëve nuk ka konflikt. Siç është theksuar më lart, bashkëshortët mund të arrijnë marrëveshje dhe t'ia paraqesin gjykatës për miratim (mënyra gjyqësore është e vetmja mënyrë për të zgjidhur martesën). Por edhe nëse nuk kanë marrëveshje, palët nuk janë të detyruara të tregojnë para gjykatës shkakun e vërtetë të zgjidhjes së martesës dhe, nëse të dy bashkëshortët nuk e kundërshtojnë zgjidhjen e martesës dhe nuk kanë mosmarrëveshje në lidhje me fëmijët, gjykimi mund të zhvillohet pa debat.

Përsa i takon zgjidhjes së martesës me pajtim, duhet theksuar se formalisht kërkesa e të dy bashkëshortëve paraqitet si padi, megjithëse në të vërtetë ajo është një marrëveshje që kërkohet të miratohet. Përveç pëlqimit për zgjidhjen e martesës, kur është rasti, palët duhet të paraqesin edhe marrëveshjen lidhur me lënien e fëmijëve për rritje dhe edukim, me detyrimin ushqimor dhe takimet me fëmijët, me kontributin për bashkëshortin nevojtar, si edhe me ndarjen e pasurisë bashkëshortore, kur është e mundur. Të dyja palët mbeten paditësa të veçantë, gjë që do të thotë se, nëse njëri prej tyre apo të dy tërhiqen nga marrëveshja e arritur, gjykimi vazhdon si një gjykim i zakonshëm për zgjidhje martese.

Gjykata nuk është e detyruar të pranojë marrëveshjen e palëve. Nëse çmon se marrëveshja nuk siguron interesat më të lartë të fëmijëve dhe të bashkëshortit nevojtar, gjykata cakton një afat 3 mujor për arritjen e një marrëveshjeje tjetër dhe, nëse kjo nuk arrihet, gjykata rrëzon kërkesën për zgjidhjen e martesës me pëlqimin e të dy bashkëshortëve.

Dy të veçanta të tjera të gjykimit të padisë për zgjidhje martese janë:

- Në rast se nga martesa kanë lindur fëmijë, për të cilët gjykata duhet të marrë një vendim, është i detyrueshëm caktimi dhe marrja e mendimit të një psikologu apo punonjësi social. Ky fakt është i rëndësishëm të dihet veçanërisht nga paditësi, pasi ai do të paguajë tarifën e psikologut, pavarësisht se teknikisht

nuk është ai që ka kërkuar këtë ekspertizë.

- Gjykata mund të marrë edhe mendimin e fëmijëve në lidhje me lënien e tyre për rritje dhe edukim. Ligji nuk përcakton kufij moshe për të marrë mendimin e fëmijëve.

Bashkë me padinë për zgjidhjen e martesës mund të bëhen edhe kërkime të tjera:

- Marrja e masave të përkohshme;
- Lënia e fëmijëve për rritje dhe edukim;
- Detyrimi monetar për ushqimin, edukimin dhe jetesën e fëmijëve në ngarkim të bashkëshortit tjetër;
- Koha dhe mënyra e takimit të fëmijëve me prindin tjetër;
- Kontributi kompensues për bashkëshortin;
- Detyrimi monetar për jetesën e bashkëshortit nevojtar;
- Kërkimi i sendeve personale;
- Likuidimi i regjimit pasuror (pjesëtimi i pasurisë bashkëshortore);
- Marrja e mbiemrit të mbajtur para martesës;
- Lejimi i mbajtjes së mbiemrit të martesës.

Nga këto kërkime, vetëm likuidimi i regjimit pasuror (pjesëtimi i pasurisë bashkëshortore) mund të veçohet, nëse vështirëson shqyrtimin e padisë për zgjidhjen e martesës dhe kërkimeve të tjera.

Disa nga çështjet e mësipërme janë të detyrueshme të zgjidhen nga gjykata, edhe nëse nuk ka kërkesë nga palët apo pavarësisht kërkimeve të palës. Këto janë: lënia e fëmijëve për rritje dhe edukim, detyrimi për ushqim për fëmijët, takimi me fëmijët dhe marrja e mbiemrit të vajzërisë.

Masat e përkohshme që mund të merren gjatë gjykimit të padisë për zgjidhjen e martesës janë:

- Caktimi i një detyrimi të përkohshëm për ushqimin dhe edukimin e fëmijëve;
- Caktimi i një detyrimi të përkohshëm për ushqimin e bashkëshortit, kur plotësohen kushtet për një përfitim të tillë;
- Sigurimi i banesës bashkëshortore për mos tjetërsimin e saj;
- Masa që lidhen me administrimin dhe përdorimin e pasurisë bashkëshortore deri në dhënien e vendimit përfundimtar.

5.3.2. Vënia dhe heqja e kujdestarisë mbi të miturit, mbajtja për rritje dhe edukim e fëmijëve të mitur

Kujdestaria është një mënyrë e garantimit të interesave të të miturit në situatat kur këto interesa nuk mund të garantohen nga prindërit, për shkak se:

- Prindërit nuk kanë mundësi ta ushtrojnë përgjegjësinë prindërore (p.sh: prindi është i burgosur;
- Prindërit kanë vdekur ose nuk njihen ose janë shpallur të zhdukur;
- Prindërve u është hequr zotësia për të vepruar;
- Për çdo shkak tjetër të pranuar nga gjykata (prindi dhe fëmija kanë konflikt interesash pasurore).

Gjatë gjykimit për vendosjen e kujdestarisë duhet të vërtetohet se fëmija ka mbetur pa prindër [që të ushtrojnë të drejtën prindërore] për një nga shkaqet e mësipërme. Në të vërtetë, shkakun në vetvete nuk është fare i rëndësishëm.

Gjykatat që kanë kompetencë lëndore për këto çështje janë seksionet familjare të gjykatave të rretheve gjyqësore. Kompetenca tokësore përcaktohet nga vendbanimi i të miturit ose vendi ku ndodhet pasuria.

Kërkesat që lidhen me kujdestarinë mbi të miturit mund të bëhen nga një rreth i gjerë personash. Ata mund ta bëjnë kërkesën për shkak të interesit apo për shkak të rrethanave, që i vënë në dijeni të kushteve të fëmijës, por kjo nuk ka ndonjë rëndësi për legjitimitimin e tyre. Kur mbush moshën 16 vjeç, vetë i mituri mund të bëjë kërkesë për caktimin e kujdestarit.

Kur kanë mbetur pa prindër disa vëllezër e motra të mitur, për ta mund ta caktohet një ose disa kujdestarë. Preferohet të caktohet një kujdestar i vetëm, por, nëse ndërmjet tyre ka konflikt interesash, do të caktohen më shumë se një kujdestar.

Kujdestari preferohet të caktohet nga personat e afërm të fëmijës, duke filluar nga ata me lidhje me të afërt gjaku. Gjykata nuk është e detyruar të pranojë kujdestarin e caktuar në testament, nëse çmon se kjo nuk është në interesin më të lartë të fëmijës.

Para se të caktojë kujdestarin, gjykata duhet të marrë mendimin e sektorit të ndihmës dhe të përkrahjes sociale pranë bashkisë ose komunës përkatëse.

Kujdestaria mund të jetë e përkohshme (pra, e përcaktuar në kohë apo ngjarje) ose e përhershme. Por, edhe kur është e përhershme, kujdestaria mund të mbarojë në çdo kohë, nëse pushojnë së ekzistuari shkaqet që e kanë diktuar, dhe kujdestari mund të zëvendësohet në çdo kohë, nëse ka arsye të besohet se ka shpërdoruar të drejtat e kujdestarit.

5.3.3. Miratimi i birësimit

Birësimi duhet të përmbushë këto kritere bazë:

- Birësimi duhet të jetë në interesin e lartë të të miturit.
- Birësimi duhet të garantojë respektimin e të drejtave themelore të të miturit.
- Vetëm të miturit (nën 18 vjeç) mund të birësohen.
- Birësuesi duhet të ketë një diferencë moshe të paktën 18 vjet me të birësuarin. Në qoftë se birësohet fëmija i bashkëshortit, diferenca e moshës duhet të jetë jo më pak se 15 vjet.
- I mituri mund të birësohet nga më shumë se një person vetëm kur ata janë bashkëshortë.
- Nëse janë gjallë, të dy prindërit e të birësuarit duhet të japin pëlqimin për birësimin.
- I mituri mbi 10 vjeç duhet të pyetet për birësimin, kurse i mituri mbi 12 vjeç duhet të japë pëlqimin për birësimin.
- Bashkëshorti i birësuesit duhet të japë pëlqimin për birësimin.
- Mund të birësohen vetëm të miturit që figurojnë në listat e Komitetit Shqiptar të Birësimeve.

Gjykata kompetente për miratimin e birësimit është gjykata e vendbanimit të kërkuarit, nëse kërkuari është shtetas shqiptar me banim në Shqipëri. Nëse kërkuari është shtetas i huaj ose shqiptar që banon jashtë shtetit, kompetenca i takon gjykatës së vendbanimit të të miturit. Gjykata vlerëson, ndër të tjera, nëse kërkuari ofron garanci se do të kryejë në rregull detyrën e birësuesit në lidhje me mirërritjen, edukimin dhe arsimimin e atij që do të birësohet. Për këtë arsye, avokati i kërkuarit duhet të paraqesë prova që tregojnë se këto garanci ekzistojnë.

Birësimi duhet të kalojë nëpër një periudhë prove prej të paktën 3 muajsh, gjatë të cilës prindërit e fëmijës mund të tërheqin pëlqimin e tyre.

Birësimi u nënshtrohet ndalimeve të mëposhtme:

- Nuk mund të birësohet një person nga të paralindurit e tij, si edhe vëllai nga motra dhe anasjelltas.
- Nuk mund të birësojë personi, të cilit i është hequr nga gjykata përgjegjësia prindërore; personi që vuan nga një sëmundje psikike ose ka zhvillim mendor të metë; personi që vuan nga një sëmundje e rrezikshme për të tjerët.
- Kujdestari mund të birësojë personin nën kujdestari vetëm pasi të jetë vlerësuar nga gjykata mënyra e administrimit të pasurisë e të jetë dorëzuar kjo pasuri.
- Një i mitur mund të birësohet jashtë vetëm nëse ka ndenjur të paktën 6 muaj në listat e Komitetit Shqiptar të Birësimeve dhe nuk është bërë i mundur birësimi brenda vendit.

5.3.4. Mosmarrëveshjet lidhur me detyrimin për ushqim

Detyrim për ushqim kanë, sipas radhës:

- bashkëshorti ndaj bashkëshortit tjetër dhe fëmijët ndaj prindërve të tyre (përfshirë thjeshtit ndaj njerikut dhe njerkës, në kushte të caktuara);
- prindërit ndaj fëmijëve të tyre;
- të paslindurit ndaj të paralindurve të tyre, që nuk janë prindër, sipas radhës më të afërt;
- të paralindurit ndaj të paslindurve të tyre, që nuk janë fëmijë të tyre, sipas radhës më të afërt;
- vëllezërit dhe motrat ndaj vëllezërve dhe motrave të tyre;
- njerku e njerka ndaj thjeshtërve të tyre të mitur.

Si rregull, detyrimi për ushqim lind vetëm kur personi që kërkon këtë detyrim është i paafte për punë dhe nuk ka mjete të mjaftueshme për të jetuar.

Detyrimi për ushqim i prindërve ndaj fëmijëve ka këto të veçanta:

- Prindërit nuk shkarkohen nga detyrimi për ushqim ndaj fëmijëve të tyre, edhe sikur t'u jete hequr përgjegjësia prindërore.
- Një fëmijë i mitur mund t'u kërkojë prindërve të tij detyrimin për ushqim edhe kur ka pasuri, nëse të ardhurat nga pasuria dhe nga puna e tij nuk i përmbushin nevojat e tij.
- Detyrimi për ushqim vazhdon edhe për kohën që fëmijët madhorë ndjekin shkollën e mesme ose të lartë, deri në moshën 25 vjeç.

Në caktimin e detyrimit për ushqim mbahen parasysh nevojat e atij që e kërkon dhe mundësitë ekonomike të atij që detyrohet. Gjykata mban parasysh se detyrimi për ushqim kërkohet vetëm nga ai që është nevojtar dhe ka për qëllim të mbulojë vetëm nevojat e domosdoshme të tij.

Gjykata, me kërkesën e personit të interesuar, mund të pakësojë, të heqë ose të shtojë detyrimin për ushqim, kur rrethanat në bazë të të cilave është dhënë vendimi kanë ndryshuar më vonë. Detyrimi për ushqim mund të pakësohet edhe për shkak të sjelljes së çrregullt ose të qortueshme të personit që e përfiton atë.

5.3.5. Heqja dhe kthimi i të drejtës prindërore

E drejta prindërore mund të hiqet kur prindi shpërdoron përgjegjësinë prindërore ose tregon pakujdesi të rëndë në ushtrimin e saj, ose me veprimet e tij ndikon në mënyrë të dëmshme në edukimin e fëmijëve.

Kërkesa për heqjen e përgjegjesisë prindërore mund të bëhet nga prindi tjetër, të afërmit e fëmijës ose nga prokurori. Prindi, për të cilin kërkohet heqja, thirret si i paditur.

Përgjegjësia prindërore mund të kthehet me vendim të gjykatës, kur pushon shkaku për të cilin është hequr kjo përgjegjësi.

5.3.6. Këshilla praktike për marrëdhënien me klientin dhe palën tjetër gjatë gjykimit të mosmarrëveshjeve familjare

- Avokatët që ndjekin çështje të të drejtës familjare duhet të sillen në mënyrë konstruktive dhe me respekt, duhet të përpiqen të minimizojnë konfliktet dhe duhet të inkurajojnë edhe klientët e tyre që të sillen në të njëjtën mënyrë.
- Avokatët duhet të përpiqen të mbeten objektivë dhe të mos e identifikojnë veten me klientin e tyre. Mënyra si e ushtrojnë detyrën e tyre nuk duhet të ndikohet në mënyrë të papërshtatshme nga emocionet e klientëve.
- Avokatët duhet të shmangin shprehjet që nxisin konflikt, si në komunikimet verbale, ashtu edhe në dokumentet e shkruar. Ata duhet t'i nxisin klientët e tyre të bëjnë të njëjtën gjë.
- Avokatët duhet t'i këshillojnë klientët e tyre në lidhje me pozicionin e fëmijëve në çështje dhe t'i nxisin të vendosin interesat e fëmijëve përpara interesave të tyre. Ata duhet t'u shpjegojnë se veprimet e kundërta me sa më sipër do të kenë një ndikim të ndjeshëm në mirëqenien e fëmijës, por edhe në suksesin e çështjes.
- Avokatët duhet t'i nxisin klientët e tyre të shfrytëzojnë të gjitha mënyrat e disponueshme për ta zgjidhur konfliktin jashtë gjykatës.
- Avokatët duhet t'u shpjegojnë klientëve se pretendimet e tyre për sjelljen e palës tjetër kanë pak rëndësi për çështjen.
- Avokatët duhet të shmangin veprimet që synojnë pengimin e palës tjetër për të realizuar të drejtat e saj dhe duhet t'i nxisin klientët e tyre të bëjnë të njëjtën gjë.
- Avokatët nuk duhet të marrin pjesë në asnjë veprimtari të pandershme, të padrejtë apo të papërshtatshme dhe duhet t'i nxisin klientët e tyre të bëjnë të njëjtën gjë.

KREU 6

GJYKIMI I ÇËSHTJEVE NË GJYKATËN E APELIT

Florian BALLHYSA

6.1. E drejta e ankimit

Në frymën e lirive dhe të drejtave që Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe KEDNJ e KE parashikojnë në dispozitat përkatëse, të gjithë subjektet e gjykimit nën juridiksionin gjyqësor civil shqiptar gëzojnë të drejtën për të apeluar vendimet që janë dhënë ndaj tyre nga gjykatat e shkallës së parë të po këtij juridiksioni, apo në raste të përcaktuara në ligj nga gjykatat e arbitrazhit.

6.2. Mjetet për të ushtruar të drejtën e ankimit në gjykatën e apelit të kompetencës lëndore civile të zakonshme

K.Pr.C. në nenin 442 të tij, ka parashikuar mjetet me të cilat subjektet e gjykimit, në përfundim të të cilit është dhënë një vendim nga gjykatat e juridiksionit gjyqësor civil shqiptar, mund të ankohen. Mjetet procedurale që parashikon ligji procedural civil shqiptar janë: ankimi në gjykatën e apelit, rekursi në Gjykatën e Lartë dhe kërkesa për rishikim.

Dispozita e nenit 442/a të K.Pr.C. detajon në terma konkrete se çfarë do të kuptohet me ankim: *“Ankimi është akti me të cilin palët ose pjesëmarrësit e tjerë në proces parashitrojnë kundërshtimet e tyre ndaj vendimit të gjykatës dhe veprimeve të përmbauesit gjyqësor, për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e tyre”*.

Si mjet ankimi, ankimi në gjykatën e apelit (apeli) do të duhet të kuptohet si një instrument procedural me dy elementë të rëndësishëm, ankimin ndaj vendimeve përfundimtare dhe ankimin e veçantë. Në dispozitat e neneve 125, 126, 127 të K.Pr.C. janë të pasqyruara tre llojet e vendimeve që merren nga gjykata e juridiksionit gjyqësor civil gjatë shqyrtimit të çështjeve që, për shkak të kompetencës së tyre, u shtrohen për zgjidhje. Pra në çdo moment të kryerjes së rolit të saj kushtetues, gjykata shprehet me vendime të ndërmjetme

(neni 125 i K.Pr.C.), vendime përfundimtare (nenin 126 i K.Pr.C.) dhe vendime jopërfundimtare (neni 127 i K.Pr.C.).

Ky kategorizim i vendimeve që merr gjykata gjatë shqyrtimit të çështjes, është i lidhur dhe me llojin ankimit që subjektet e gjykimit mund të ushtrojnë ndaj tyre. Kështu ndaj vendimeve përfundimtare të gjykatës së shkallës së parë, subjekti i gjykimit ka të drejtë të ushtrojë të drejtën e ankimit. Ndërkohë që ndaj vendimeve të ndërmjetme dhe jopërfundimtare që jep gjykata e shkallës së parë, rast pas rasti, sipas parashikimit të dispozitës përkatëse në bazë të së cilës është marrë ky vendim (i ndërmjetëm/jopërfundimtar) subjektet e gjykimit kanë të drejtë të ushtrojnë ankimin e veçantë, ose në rastet e tjera ankim, që i bashkëlidhet ankimit ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

Vetë dispozita e nenit 470 të K.Pr.C. ka parashikuar rregullin e përgjithshëm, çka do të thotë që vendimet e ndërmjetme që jep gjykata e shkallës së parë gjatë zhvillimit të procesit, në vetvete janë të një karakteri të tillë procedural që mund të ndryshohen dhe tërhiqen nga po vetë ajo gjykatë gjatë gjykimit. Tërësia e vendimeve të ndërmjetme që merr gjykata e shkallës së parë gjatë gjykimit, do të mund të goditen me ankim, sikundër thuhet më lart, së bashku me ankimin kundër vendimit përfundimtar. Rast pas rasti, kur vetë dispozita e K.Pr.C. ka parashikuar ushtrimin e ankimit të veçantë ndaj një vendimi të ndërmjetëm, atëherë ky akt (ankimi) i nënshtrohet rregullave që rregullojnë afatin e paraqitjes së tij, formën, etj., sikundër do të shtjellohet më poshtë.

Nisur nga specifika e vendimeve të ndërmjetme të gjykatës së shkallës së parë, për të cilat K.Pr.C. parashikon të drejtën e ankimit të veçantë, paraqitja e këtij të fundit si rregull, nuk pezullon as gjykimin dhe as ekzekutimin e vendimit. E kundërta ndodh vetëm në rastet e veçanta të sanksionuara nga neni 471 i K.Pr.C., kur vetë ky Kod urdhëron sa më lart apo gjykata e apelit vendos pezullimin gjersa të jepet vendimi mbi ankimin e veçantë.

Në mënyrë ezauruese tërësia e vendimeve ndaj të cilave mund të ushtrohet ankim në gjykatën e apelit, është sanksionuar në përmbajtjen e dispozitës së nenit 452 të K.Pr.C., ku parashikohet se ankim mund të ushtrohet ndaj të gjitha vendimeve të dhëna nga gjykata e shkallës së parë, me përjashtim të rasteve kur vetë ligji e ka përjashtuar këtë të drejtë.

Duke gëzuar cilësinë e aktit procedural, ankimi në gjykatën e apelit i nënshtrohet afateve të përcaktuara nga dispozitat e K.Pr.C. Kështu në nenin 443/1 të K.Pr.C. parashikohet se afati i ankimit në gjykatën e apelit kundër vendimeve përfundimtare të gjykatave është 15 ditë. Ndërkohë që po i njëjti nen i K.Pr.C., paragrafi 4, sanksionon se afati i ankimeve të veçanta është 5 ditë.

Përveç rregullave të përgjithshme në lidhje me mënyrën e llogaritjes së afateve për paraqitjen e ankimit, që pasqyrohen në dispozitat e kreut V, Titulli VI, pjesa I e K.Pr.C., ligjvënësi shqiptar ka parashikuar nëpërmjet një dispozite të posaçme, fillimin e ecjes së afateve të mjeteve të ankimit ndaj vendimeve përfundimtare, mes të cilave dhe ankimit në gjykatën e apelit.

Për t'u ndalur në këtë moment është fillimi i ecjes së afatit të njoftimit për ata subjekte të gjykimit, të cilët edhe pse të njoftuar rregullisht nga gjykata, kanë qenë në mungesë gjatë dhënies së vendimit ndaj të cilit atyre u njihet e drejta e ankimit. Kështu në rast se subjektet kanë qenë të pranishëm gjatë dhënies së vendimit ndaj të cilit parashikohet e drejta për të ushtruar ankim, afati për paraqitjen e tij fillon të llogaritet nga e nesërmja e shpalljes së vendimit përfundimtar. Në rast se subjektet kanë qenë në mungesë në shpalljen e vendimit, ecja e afatit të ankimit do të bëhet sipas interpretimit të dispozitës së nenit 444/1 të K.Pr.C., që do të thotë se llogaritja e afatit u fillon nga dita e njoftimit të vendimit.

Për shkak të rasteve të hasura në praktikën gjyqësore në lidhje me llogaritjen e afatit për të ushtruar ankim ndaj vendimit përfundimtar për subjektet ndaj të cilëve është zhvilluar gjykimi në mungesë, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë unifikuar rishtazi praktikën gjyqësore. Kështu në Vendimin Unifikues nr. 2/2012, në lidhje me kohën e fillimit të ecjes së afatit për paraqitjen e ankimit ndaj vendimit përfundimtar të gjykatës, për subjektet ndaj të cilave gjykimi është zhvilluar në mungesë në momentin e shpalljes së vendimit, është mbajtur qëndrimi vijues: *“...kur çështja është gjykuar nga gjykata e shkallës së parë ose nga gjykata e apelit, në mungesë të njëres palë, afati i ankimit (apel, rekurs) për këtë palë fillon të llogaritet përkatësisht nga e nesërmja e marrjes njoftim të vendimit, sipas rregullave të përcaktuara nga dispozitat e neneve 316 dhe 148 të K.Pr.C.”*

Shtesat dhe ndryshimet që iu bënë K.Pr.C. me ligjin nr. 122/2013, preken dhe dispozitën e nenit 445 të tij, duke parashikuar se në çdo rast ankimi në gjykatën e apelit nuk mund të bëhet nëse ka kaluar një vit nga shpallja e vendimit. Është e qartë se kur subjekti i gjykimit, pretendon se për shkak se gjykimi ndaj tij është bërë në mungesë si pasojë e pavlefshmërisë së njoftimeve, kjo dispozitë nuk gjen zbatim, duke i lënë mundësinë për të ushtruar të gjitha të drejtat e tij procedurale për revizionimin e gjykimit të kryer në mungesë të tij.

Përkundër parashikimit të posaçëm që i është bërë fillimit të afateve të ankimit ndaj vendimit përfundimtar të gjykatës së shkallës së parë, përsa kohë nuk parashikohet posaçërisht, fillimi i afateve për ankimet e veçanta i nënshtrohen rregullave të përgjithshme që janë parashikuar në dispozitat e lartpërmendura të kreut V, Titulli VI, pjesa e parë e K.Pr.C.

Çfarë ndodh në rast se një subjekt i gjykimit, e humb afatin e parashikuar nga K.Pr.C për të kundërshtuar një vendim të dhënë nga gjykata e shkallës së parë? A do të duhet të konsiderohet se ky subjekt nuk ka asnjë mundësi procedurale për të ushtruar të drejtën e tij? Përgjigja është Jo. Subjektit të gjykimit, të cilit i ka humbur afati për paraqitjen e ankimit ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë, nuk i janë shterur hapësirat procedurale për t'iu drejtuar gjykatës së apelit. Në dispozitën e nenit 458 të K.Pr.C, ligjvënësi ka parashikuar të drejtën për të kërkuar rivendosjen në afat të ankimit.

Pra, ai subjekt që për shkaqe të arsyeshme, ka humbur afatin e ushtrimit të së drejtës së ankimit, ka mundësi që t'i drejtohet gjykatës që ka dhënë vendimin (në rastin e ankimit, gjykatës së shkallës së parë) duke kërkuar rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit. Në këtë rast, gjykata detyrohet t'i referohet përmbajtjes së dispozitave të neneve 151, 152 të K.Pr.C. në lidhje me bazueshmërinë e kërkesës dhe verifikimin në rast se jemi përpara afateve të karakterit prekluziv. Shkaqet e arsyeshme që çdo subjekt që kërkon rivendosjen në afat të së drejtës për ankim, shqyrtohen dhe merren parasysh rast pas rast nga gjykata, e cila vendos bazuar në bindjen e saj të brendshme.

Nisur nga fakti, që ligjvënësi ka parashikuar se ndaj vendimit për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit mund të bëhet ankim i veçantë, praktikanti i ligjit do të duhet të dijë të përcaktojë dhe momentin nga i cili fillon të ecë afati i ri për paraqitjen e ankimit pranë gjykatës së apelit. Në këto raste, është i domosdoshëm referimi tek dispozita e nenit 451 të K.Pr.C., për të llogaritur ecjen e afatit të ri nga momenti kur vendimi gjyqësor për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit merr formë të prerë, duke i dhënë në këtë mundësi subjektit të paraqesë ankimin ndaj vendimit përkatës të gjykatës së shkallës së parë.

Është e rëndësishme për t'u nënvizuar në këtë material ndihmës për praktikantët e rinj të ligjit se në çdo rast një kopje e ankimit do të duhet të mbahet e ruhet nga vetë subjekti që e ushtron këtë të drejtë. Sekretaria gjyqësore në momentin e paraqitjes së ankimit ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë, është e detyruar që në kopjen e aktit (ankimit) që do të mbahet nga subjekti që e paraqet të shënojë datën e paraqitjes së ankimit dhe të vulosë pranë këtij shënimi. Sa më lart ka rëndësi procedurale, për të provuar në çdo kohë dhe përpara çdo organi gjyqësor, ku lind e nevojshme, se subjekti që ka paraqitur ankimin ka respektuar ose jo afatin për paraqitjen e tij.

Kujtesë praktike për afatin e paraqitjes së ankimit:

- Verifiko nëse do të paraqitet ankim ndaj një vendimi përfundimtar apo i ndërmjetëm/jo përfundimtar.
- Në rast se do të kundërshtosh një vendim të ndërmjetëm/jo përfundimtar, konsulto dispozitën përkatëse të K.Pr.C. nëse lejohet të ushtrohet ankim i veçantë.
- Përcakto datën kur është marrë vendimi përfundimtar apo i ndërmjetëm/jo përfundimtar. Në rast se vendimi është shpallur në praninë e avokatit apo palës që ai përfaqëson, data e vendimit është e njëjta me datën kur është zhvilluar seanca gjyqësore kur ai është shpallur. Në rast se vendimi është marrë në mungesë të avokatit apo palës që ai përfaqëson, vendimi do të konsiderohet si i njoftuar, ditën kur avokati ose pala që përfaqëson merr njoftim nga nëpunësi gjyqësor për vendimin.
- Nëse ke humbur afatin (5 ditor për ankimet e veçanta dhe 15 ditor për ankimet ndaj vendimeve përfundimtare) për paraqitjen e mjetit të ankimit (apel) vlerëso rrethanat juridike dhe faktike, mbi të cilat mund të kërkohet rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit.
- Harto një kërkesë për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit dhe paraqite pranë gjykatës së shkallës së parë që ka dhënë vendimin ndaj të cilit do të ushtrohet ankim (apel). Në qoftë se kërkesa juaj pranohet, atëherë fillo të llogarisësh afatin nga momenti që vendimi i marrë për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit ka marrë formë të prerë.
- Në rast se do të ushtrohet ankim ndaj një vendimi përfundimtar llogarit afatin 15 ditor nga e nesërmja e shpalljes ose njoftimit të vendimit përfundimtar ose e marrjes formë të prerë të vendimit për pranimin e kërkesës për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit.
- Në rast se do të ushtrohet ankim i veçantë ndaj një vendimi të ndërmjetëm/jo përfundimtar, llogarit afatin 5 ditor nga e nesërmja e shpalljes ose njoftimit të vendimit të ndërmjetëm/jo përfundimtar ose e marrjes formë të prerë të vendimit për pranimin e kërkesës për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit, për të cilin dispozita e posaçme e K.Pr.C. parashikon të drejtën e ushtrimit të ankimit të veçantë.
- Merr masa që akti përkatës i ankimit (apeli) të dorëzohet brenda afatit ligjor, duke ruajtur kopje të aktit të ankimit (apeli) me shënimin e sekretarisë gjyqësore për datën e paraqitjes së tij. Në rast se përdoret

shërbimi postar publik ose privat për dërgimin e aktit të ankimit (apel) do të ishte e përshtatshme të përdorej shërbimi rekomandë, në mënyrë që të provohet nëpërmjet aktit postar data e dorëzimit të aktit pranë këtij shërbimi.

- Në rast se brenda afatit për paraqitjen e ankimit (apel) gjykata e shkallës së parë nuk ka arsyetuar vendimin, paraqit pranë saj, brenda afatit nga data e dhënies së vendimit, një kërkesë për zënie të afatit. Me marrjen e kopjes së arsyetuar të vendimit dorëzo ankimin e plotë.
- Në fashikullin tuaj për çështjen përkatëse, depozito kopjen e mjetit të ankimit (apel) me shënimin e sekretarisë gjyqësore për datën e depozitimit të tij ose të aktit postar.

Shpesh herë praktika ka sjellë në vëmendje dhe mangësi të orientimit të drejtë të praktikantëve të ri të ligjit në lidhje me gjykatën se ku do të depozitohet ankimi ndaj vendimit përfundimtar, jopërfundimtar e të ndërmjetëm të dhënë nga gjykata e shkallës së parë. Konstatohet, që duke u nisur nga fakti se ky akt, ankimi i drejtohet dhe merret në shqyrtim nga ana e gjykatës së apelit, por nuk është kjo e fundit të cilës do të duhet t'i paraqitet për administrim dhe përfshirje në dosjen gjyqësore. Në çdo rast ankimi, ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë, qoftë ai përfundimtar apo i dy formave të tjera të përmendura më lart, duhet të paraqitet në gjykatën që ka dhënë vendimin, pra në sekretarinë gjyqësore të gjykatës së shkallës së parë.

Por çfarë ndodh në rast se ankimi është paraqitur pranë gjykatës së apelit, të cilës i drejtohet dhe jo pranë gjykatës së shkallës së parë, që ka dhënë vendimin? Nuk është vendi për panik. E drejta e ankimit nuk ka humbur pavarësisht se brenda afatit ligjor, ankimi është paraqitur në një gjykatë të ndryshme nga ajo e parashikuar në dispozitën e nenit 446 të K.Pr.C. Akti procedural, ankimi ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë, me shënimet përkatëse të sekretarisë gjyqësore të gjykatës të cilës i është adresuar gabim në lidhje me afatin e paraqitjes së tij, do t'i përcillen gjykatës së shkallës së parë, që ka dhënë vendimin ndaj të cilit ushtrohet e drejta e ankimit. Do të jetë sekretaria gjyqësore e gjykatës së shkallës së parë, e cila do të vijojë të përmbushë veprimet procedurale përkatëse për administrimin, njoftimin dhe përcjelljen e dosjes gjyqësore në gjykatën e apelit.

Kujtesë praktike për gjykatën ku depozitohet ankimi:

- Verifiko numrin e vendimit përfundimtar, ose numrin e aktit të vendimit të ndërmjetëm/jo përfundimtar, së bashku me datën e tij (vendimit).
- Pasqyro në pjesën hyrëse të aktit të ankimit numrin dhe datën e lartpërmendur.
- Kontrolllo kompetencën tokësore të gjykatës së apelit, në të cilën përfshihet gjykata e shkallës së parë që ka dhënë vendimin ndaj të cilit do të ushtrohet ankimi ose ankimi i veçantë.
- Aktin e ankimit (apel) parashtroje pranë gjykatës së apelit, që ka në kompetencën e saj tokësore, gjykatën e shkallës së parë që ka dhënë vendimin.
- Aktin e ankimit (apel) brenda afatit përkatës e dorëzoni pranë sekretarisë së gjykatës së shkallës së parë, që ka dhënë vendimin që ankimohet, ose e dërgoni nëpërmjet shërbimit postar duke shënuar si marrës gjykatën e shkallës së parë që ka dhënë vendimin.

Nisur nga fakti se ankimi në gjykatën e apelit është një akt procedural, gjatë hartimit të tij është e detyrueshme që përsa i përket formës së tij të respektohen dispozitat e nenit 115 “Forma e Aktit” të K.Pr.C. Nga pikëpamja praktike është e rëndësishme t’i kushtohet rëndësi elementëve të përgjithshëm që radhiten në nenin 117 të K.Pr.C. me qëllim që akti të jetë i plotë dhe pa të meta, sikundër të sigurohet dhënia rrugë në një kohë sa më të shkurtër nga ana e sekretarisë gjyqësore që e administron atë (ankimin).

Duke iu referuar anës praktike të paraqitjes së ankimit është shumë e nevojshme që gjatë hartimit të tij të mbahen parasysh dhe të përmbushen elementët e anës formale dhe përmbajtësore që janë parashikuar nga ligjvënësi në dispozitat e nenit 453, 454, dhe 455 të K.Pr.C. Është e një rëndësie thelbësore që asnjëri prej elementëve që lidhen si me formën, ashtu dhe me përmbajtjen të mos neglizhohen apo nënvlerësohen pasi mangësitë në të tilla raste mund të sjellin si pasojë edhe humbjen e të drejtës që ankimi në fjalë të merret në shqyrtim nga ana e gjykatës së apelit.

Nga ana formale, ankimi si mjet procedural i rëndësishëm në gjykimin e juridiksionit gjyqësor civil shqiptar, do të duhet në çdo rast të nënshkruhet nga subjekti i gjykimit që ushtron të drejtën e ankimit, apo çdo përfaqësues tjetër i

ligjshëm i tij, i caktuar në përputhje me dispozitat e Kodit Civil (përfaqësimi) apo K.Pr.A. (autorizimet e organeve administrative). Nisur nga praktika gjyqësore ndodh që vullneti për t'u përfaqësuar i subjekteve të gjykimit të jetë shprehur me shkrim, nëpërmjet aktit noterial të hartuar nga noteri publik, por dhe verbalisht përpara gjykatës që shqyrton mosmarrëveshjen.

Do të ishte në të mirën e mbarëvajtjes së administrimit të ankimit, njoftimit dhe më tej shqyrtimit të tij, që në rastet kur ankimi nuk nënshkruhet personalisht nga palët, porse nga përfaqësuesi, ky i fundit teksa nënshkruan ankimin ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë, t'i referohet aktit procedural që e ka legjitimuar atë si përfaqësues të subjektit të gjykimit. Me pak fjalë, nënshkrimi i përfaqësuesit të shoqërohet me citimin e prokurës, seancës gjyqësore ku është bërë deklarimi i vullnetit të të përfaqësuarit, apo akti autorizues i autoritetit drejtues të organit të administratës publike.

Në rastet kur ankimi ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë, ushtrohet drejtpërdrejtë nga një subjekt i gjykimit, në mungesë të një akti noterial përfaqësimi apo autorizimi administrativ, i cili është një subjekt që gëzon personalitet juridik apo organ i administratës publike, përpos nënshkrimit të aktit do të duhej të administrohet në aktin e ankimit edhe vula e personit juridik, apo organit të administratës publike.

Po t'i referohemi dispozitës së nenit 455 të K.Pr.C., paraqitja e ankimit pranë gjykatës së shkallës së parë që ka dhënë vendimin ndaj të cilit ai, ankimi, ushtrohet shoqërohet dhe me përmbushjen e një kriteri procedural/formal. Nuk është e mjaftueshme, që ankimi i paraqitur në gjykatën e shkallës së parë të parë, të administrohet e t'i jepet rrugë, thjesht dhe vetëm me dorëzimin e tij në sekretarinë gjyqësore. Për shkak të nevojës së njoftimit të këtij akti procedural (ankimit) të gjitha subjekteve të gjykimit, ankimi ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë në momentin e dorëzimit në sekretarinë gjyqësore do të duhet të jetë në aq kopje sa janë personat që marrin pjesë në gjykimin, gjatë të cilit është dhënë vendimi, që po ankimohet. Bashkëlidhur me ankimin, subjekti i gjykimit që ushtron këtë të drejtë, mund të bashkëngjisë dhe dokumente të tjerë, që i çmon se kanë rëndësi për të mbështetur shkaqet të cilat parashtron në ankim.

Pak më lart u ndalëm në rëndësinë që ka paraqitja e ankimit në sekretarinë gjyqësore, shoqëruar me aq kopje të tij sa janë subjektet e gjykimit. Subjektet e tjera të gjykimit, ndaj vendimit të dhënë në përfundim të të cilit, është duke u ushtruar ankim, kanë të drejtën që përveç se të njoftohen për këtë fakt juridik (paraqitjen e ankimit) të ushtrojnë dhe ata të drejtën e apelit kundërshtues. Për ta shpjeguar në terma konkret, apeli kundërshtues në vetvete nuk përfaqëson një

instrument të procedurës civile, i cili investon në gjykim gjykatën e apelit.

Apeli kundërshtues përfaqëson një instrument procedural që çdo subjekt i gjykimit ka në dispozicion për të kundërshtuar shkaqet që parashtron një tjetër subjekt i po të njëjtit gjykim në lidhje me vendimin e dhënë nga gjykata e shkallës së parë. Në të tilla rrethana, subjekti që ushtron apelin kundërshtues mund të parashtrrojë qëndrimin e tij, shkaqet përkatëse për të cilat ai mendon se ankimi kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë, nuk është i bazuar në ligj dhe në prova. Pra, apeli kundërshtues eventualisht është një mjet procedural, që bashkëshoqëron ankimin, në rast se kemi një të tillë, duke kundërshtuar shkaqet e ushtrimit të tij.

Edhe në rastin e apelit kundërshtues, paraqitja e tij ndjek të njëjtën rrugë procedurale sikundër akti kryesor, vetë ankimi. Pra apeli kundërshtues do të duhet të paraqitet pranë gjykatës së shkallës së parë, e cila ka dhënë vendimin që ankimohet, në atë kopje sa subjekte ka gjykimi konkret. I rëndësishëm edhe në këtë rast është respektimi i afatit për paraqitjen e apelit kundërshtues. Dispozita e nenit 456 të K.Pr.C. parashikon se çdo subjekt i gjykimit, të cilit i njoftohet ankimi ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë, dhënë në përfundim të një gjykimi ku dhe ai ka marrë pjesë, ka të drejtë që brenda 5 ditëve nga momenti i njoftimit të ankimit, të paraqesë apel kundërshtues. Edhe në këtë rast mënyra e fillimit dhe llogaritjes së këtij afati do t'i referohet dispozitave përkatëse të njoftimit, të shtjelluara më lart.

Me depozitimin e ankimit, i lind detyra sekretarisë gjyqësore të gjykatës së shkallës së parë që ka dhënë vendimin e ankimuar që këtë akt procedural, t'ua njoftojë të gjithë subjekteve të tjera të gjykimit. Rregullat dhe mënyra e njoftimit të ankimit gjejnë parashikim në dispozitën e nenit 447 të K.Pr.C., ndryshuar me ligjin nr. 122/2013. Kjo dispozitë referuese, ngarkon sekretarinë gjyqësore të gjykatës së shkallës së parë, që në njoftimin e ankimit të zbatojë sa parashikohet në kreun IV të titullit VI të pjesës I të K.Pr.C., për njoftimet dhe thirrjet në gjykatë.

Kujtesë praktike për anën formale të ankimit:

- Akti i ankimit (apeli) hartohet gjithmonë në gjuhën shqipe.
- Akti i ankimit (apeli) nënshkruhet nga subjekti privat ose titullari i personit juridik/organ i administratës publike.
- Kontrolllo gjithmonë në rast se prokura e posaçme që ju është dhënë nga subjekti privat/shtetëror, apo autorizimi nga personi juridik/organ i administratës publike, ose deklarimi gjyqësor, ka të parashikuar shprehimisht, që ju si avokat/përfaqësues i subjektit të gjykimit, keni të drejtën për të nënshkruar ankime (apel) ndaj vendime përfundimtare dhe ankime të veçanta ndaj vendimeve të ndërmjetëm/jopërfundimtare.
- Në rast se prokura/autorizimi, deklarimi gjyqësor, nuk e ka të parashikuar të drejtën e avokatit për të nënshkruar ankime, ose ka shprehje të përgjithshme që nuk e identifikojnë specifikisht këtë të drejtë, kërkoni redaktimin e një prokurë/autorizimi të ri që të përmbajë këtë të drejtë dhe pas hartimit të saj ju si avokat nënshkruani ankimin/apelin, ose kërkoni nga subjekti privat ose titullari i personit juridik/organ i administratës publike që ankimi (apeli) të nënshkruhet personalisht prej tyre.
- Nënshkruani origjinalin e mjetit të ankimit (apelin) dhe po aq kopje sa është numri i palëve të gjykimit konkret. Secilës prej palëve ndërgjyqëse do të duhet t'i njoftohet nga sekretaria gjyqësore një kopje e ankimit tuaj, përveç asaj që do të depozitohet në dosjen gjyqësore.
- Në momentin e depozitimit të aktit të ankimit (apelit) verifiko që përpos origjinalit të jetë një numër i barabartë kopjesh të nënshkruara sa është dhe numri i palëve ndërgjyqëse. Në po aq kopje duhet të depozitoni dhe akte të tjera që i bashkëlidhen mjetit të ankimit (apelit).
- Në rast se ju nuk keni ushtruar ankim (apel) në momentin që ju njoftohet ankimi i njëres prej palëve të tjera ndërgjyqëse, llogarisni një afat 5 ditor për të ushtruar të drejtën tuaj për të depozituar një kundër ankim. Ndiqni të njëjtat rregulla formale për paraqitjen e kundër ankimit brenda një afati 5 ditor nga data e njoftimit të ankimit (apelit).

Respektimi i afateve për paraqitjen e ankimit dhe formës së tij, është njëra anë e medaljes. Rëndësi të posaçme sigurisht që ka përmbajtja e ankimit, pra shkaqet për të cilat ushtrohet ankimi dhe çfarë i kërkohet gjykatës së apelit të disponojë/vendosë mbi këtë ankim të paraqitur. Çdo praktikant i të drejtës është i lirë të çmoje e të gjykojë sipas formimit të tij profesional se cilat janë ato aspekte procedurale të gjykimit apo ato mangësi në administrimin dhe çmuarjen e provave nga ana e gjykatës, të cilat janë të tilla që mund të sjellin cenimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

Nga ana e përmbajtjes, ankimi do të duhet të ketë pjesë 4 elementë, të cilët janë të detyrueshëm, e bëjnë atë të individualizueshëm dhe i japin mundësinë e shqyrtimit nga ana e gjykatës së apelit. Kështu, në ankim, subjekti që e paraqet atë duhet të tregojë: i) palët ndërgjyqëse, ii) vendimin e gjykatës së shkallës së parë ndaj të cilit ushtrohet ankimi, iii) shkaqet për të cilat bëhet ankimi, iv) çfarë kërkohet nëpërmjet ankimit. Të katër këto kërkesa gjejnë pasqyrim në dispozitën e nenit 454 të K.Pr.C., e cila edhe pse mund të konsiderohet në pamje të parë me një përmbajtje narrative/treguese të këtyre kërkesave do të duhet të kuptohet si një dispozitë urdhëruese nga praktikantët e ligjit.

Nisur nga qëllimi që ky manual ka, çmojmë të nevojshme që të ndalemi tek një element i rëndësishëm, që do të duhet të kihet parasysh në hartimin e përmbajtjes së ankimit. Dispozita e nenit 459 të K.Pr.C. parashikon rënien në dekadencë të të gjitha kërkesave që nuk janë propozuar rishtazi në ankim. Pra të gjitha ato kërkesa, pretendime të cilat nuk janë marrë parasysh në gjykatën e shkallës së parë, që nuk përsëriten në ankim do të konsiderohen sikur nuk janë paraqitur.

Në këtë element procedural, dekadencia e kërtimeve/prendimeve, do të duhet t'i referohemi rolit që ka gjykata në shqyrtimin e çështjeve të juridiksionit gjyqësor civil. Dispozitat e neneve 6, 8, 9, 10, 12, 16, 28 dhe 29 të K.Pr.C. strukturojnë qartë pozicionin asnjans dhe arbitror që ka gjykata në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që i shtrohen për gjykim nga subjektet e të drejtës. Në rast se subjekti i gjykimit, nuk i kërkon gjykatës administrimin e një prove, apo kundërshton një veprim të posaçëm procedural, nuk mundet që vetë gjykata të investohet në këtë drejtim.

Duke iu rikthyer përmbajtjes së ankimit, pra në rast se gjatë gjykimit të çështjes në gjykatën e shkallës së parë, në qoftë se subjekti që ushtron ankim, ndaj vendimit përfundimtar ka kundërshtuar për shembull përfundimet e një akti ekspertimi, në rast se ky kundërshtim nuk gjen pasqyrim dhe në përmbajtjen e ankimit, atëherë gjykata e apelit nuk mund të vlerësojë ndryshe atë akt ekspertimi, nisur nga

kundërshtitë e parashtruara nga subjekti i gjykimit në gjykatën e shkallës së parë, përsa kohë ato do të konsiderohen si të renë në dekadencë, pasi nuk janë përsëritur në ankim. Në të tilla rrethana ligjore, është e rëndësishë së dorës së parë, që çdo mangësi e pretenduar gjatë gjykimit në gjykatën e shkallës së parë, që ka të bëjë si me zbatimin e ligjit procedural e atij material, që mund të sjellë cenimin e vendimit të ankimuar, do të duhet të gjejë vend në këtë akt procedural, ankimin në apel.

Ndryshe nga karakteri që ka rekursi ndaj vendimit të gjykatës së apelit në Gjykatën e Lartë, në ankimin ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë, subjekti ankues ka të drejtë të parashtojë shkaqe e rrethana që kanë të bëjnë jo thjesht dhe vetëm me zbatimin e keq të ligjit material dhe atij procedural nga gjykata e shkallës së parë. Duke qenë se gjykata e apelit është një gjykatë fakti, pretendimet që mund të parashtrihen në ankim nga subjekti ankues mund të jenë dhe të karakterit kundërshtues për mënyrën e vlerësimit të provave nga gjykata e shkallës së parë dhe ndikimit që ky vlerësim ka pasur në disponimin përfundimtar të gjykatës.

Të gjitha ankimet që paraqiten nga subjektet e gjykimit dhe që kundërshtojnë vendimin e marrë nga gjykata e shkallës së parë, bashkohen dhe shqyrtohen në një proces të vetëm në gjykatën e apelit. Pra, pavarësisht sa ankime mund të ketë kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë, do të jetë vetëm një proces/ gjykim që do të zhvillohet në gjykatën e apelit, tek sa kjo do t'i shqyrtojë secilin prej ankimeve dhe do të shprehet me një vendim të vetëm gjyqësor.

Kujtesë praktike për përmbajtjen e ankimit:

- Në aktin e ankimit (apelit) pasqyro palët ndërgjyqëse dhe objektin e gjykimit gjatë ose në përfundim të së cilit është dhënë vendimi i ndërmjetëm ose përfundimtar ndaj të cilit ushtrohet ankim.
- Evidento dhe pasqyro ekstremitetet formale të vendimit të gjykatës së shkallës së parë ndaj të cilit ushtrohet ankimi (apeli). Shëno gjykatën e shkallës së parë që ka marrë vendimin që ankimohet, numrin e vendimit dhe datën e shpalljes së tij, në rastet e vendimeve përfundimtarë.
- Në rast se ushtrohet ankim i veçantë jo rrallë në praktikë, nuk do të ketë një vendim të arsyetuar dhe të strukturuar si të tillë. Vendimet e ndërmjetme nuk i nënshtrohen numërtimit. Shëno në ankim numrin e aktit të çështjes, datën e dhënies së vendimit dhe mundësisht bashkëngjiti ankimit kopje të procesverbalit të seancës gjyqësore gjatë së cilit është marrë vendimi i ndërmjetëm/jo përfundimtar ndaj të cilit ushtron ankimin e veçantë.

- Në ankimin ndaj vendimit përfundimtar bëj një ekspozitë të përmbledhur të rrethanave të faktit për çështjen konkrete. Në rast se kërkon të kundërshtosh vendime të ndërmjetme ndaj të cilave K.Pr.C. lejon ankim të veçantë së bashku me ankimin ndaj vendimit përfundimtar, pas prezantimit të rrethanave të faktit radhit shkaqet procedurale për të cilat kundërshtohet vendimet e ndërmjetme.
- Në vijim të ankimit parashtro të gjitha shkaqet e tjera procedurale, për të cilat ju çmoni se vendimi i gjykatës së shkallës së parë mund të cenohet.
- Duke iu referuar arsytimit të vendimit përfundimtar të gjykatës së shkallës së parë, për çdo argument që përdoret nga ajo gjykatë në marrjen e vendimit, paraqit kundërshtitë e tua, si për zbatimin e ligjit material ashtu dhe për vlerësimin eventuale të provave. Çdo argument që përdor gjykata në arsyetimin e vendimit, prezantoje si të tillë duke e radhitur e duke parashtruar kundër argumentin përkatës.
- Pasi hartoni ankimin, rikthejuni në lexim dhe njëherë, mos harroni të përfshini asnjë argument tuajin që keni parashtruar gjatë gjykimit të çështjes në gjykatën e shkallës së parë, pasi mund të konsiderohet si i rënë në dekadencë.
- Në rast se ushtron ankim të veçantë, mos u ndal së tepërmi në prezantimin e rrethanave të faktit. Të tilla rrethana nuk janë të rëndësishme në shqyrtimin pranë gjykatës së apelit të ankimit të veçantë (përpos rasteve kur kundërshtohen vendimi për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit apo kompetencës). Përqendrohu në parashtrimin e argumenteve që ka dhënë gjykata e shkallës së parë në marrjen e vendimit të ndërmjetëm/jo përfundimtar. Në shumicën e rasteve këto argumente janë procedurale. Të tillë duhet të jenë dhe kundër argumentet tuaja që do të parashtrohen në ankim (apel).
- Në qoftë se kërkon përsëritjen e pjeshme apo të plotë të hetimit gjyqësor, pasqyrojeni në mënyrë të qartë këtë kërkesë duke argumentuar nevojën e kësaj procedurë në marrjen e një prove të re apo përsëritjen e një veprimi procedural që sipas jush ka pasur të meta gjatë gjykimit në gjykatën e shkallës së parë.
- Parashtro në mënyrë të detajuar se çfarë kërkon që të disponojë gjykata e apelit gjatë gjykimit të aktit të ankimit (apel). Referoju dispozitës përkatëse të K.Pr.C. (neni 466).

Respektimi i rregullave të mësipërme procedurale, në lidhje me formën dhe përmbajtjen e ankimit, është e rëndësishme të njihet dhe të zbatohet në çdo rast nga ana e praktikantëve të rinj të ligjit. Mungesa e secilit prej tyre mund të sjellë si pasojë që sekretaria gjyqësore e gjykatës së shkallës së parë, teksa konstaton mosplotësimin e këtyre kërkesave të njoftojë subjektin që paraqet ankimin, duke vendosur një afat 5 ditor për plotësimin e të metave që ka akti (ankimi).

Si do të veprohet në rastet kur ankimi i paraqitur nga subjekti i gjykimit nuk është paraqitur në afat, nuk është i plotë në formë apo përmbajtje? Rast pas rasti, gjykata që ka dhënë vendimin dhe që administron ankimin e subjektit të gjykimit, do të duhet të verifikojë nëse: i) ankimi është paraqitur brenda afatit, ii) nëse të metat e ankimit, për të cilat u fol më lart, janë plotësuar apo jo brenda afatit 5 ditor, iii) është ushtruar ankim kundër një vendimi ndaj të cilit nuk lejohet ankim, iv) është bërë ankim nga një person që nuk legjitimohet, v) është hequr dorë nga ankimi. Në të gjitha këto raste gjykatës që ka dhënë vendimin i lind e drejta ta kthejë atë, përsa kohë një dispozitë urdhëruese si ajo e nenit 450 të K.Pr.C. e sanksionon këtë vendimmarrje. Megjithatë në praktikën gjyqësore, do të vihet re se përmbajtja e paragrafit të dytë është ai rregull ligjor që zbatohet më së shumti.

Nisur nga fakti që mospranimi i ankimit mund të deklarohet në të gjitha shkallët e gjykimit, të tillë disponim gjykata e shkallës së parë që jep vendimin e ankimuar, ia “delegon” gjykatës së apelit, e cila detyrohet që përpara se të fillojë shqyrtimin gjyqësor të çështjes, të verifikojë nëse janë plotësuar apo jo kërkesat e mësipërme në ankimin përkatës. Edhe në këtë dispozitë, ligjvënësi ka parashikuar që ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë që vendos kthimin/mospranimin e ankimit të ushtrohet ankim i veçantë.

Kujtesë praktike për përmbushjen e të metave të ankimit:

- Bëni kujdes. Në rast se akti i ankimit (apeli) nuk është i plotë si në formë apo në përmbajtje, sekretaria gjyqësore do t’ju njoftojë ta plotësoni atë brenda një afati 5 ditor nga momenti i njoftimit. Plotësoni çdo të metë formale apo përmbajtësore dhe dorëzoheni sërish mjetin e ankimit (apel) duke ndjekur të njëjtët elementë që pasqyrohen në kujtesën përkatëse të kësaj pjese të manualit.
- Në rast se ju nuk do të plotësoni të metat e ankimit brenda afati 5 ditor apo do të paraqisni heqje dorë nga ankimi, atëherë ankimi nuk do të pranohet nga gjykata.

Praktikantët e rinj të ligjit do të duhet të kenë parasysh faktin që përmbajtja e neneve 317-319 të K.Pr.C. parashikojnë një procedurë të posaçme për atë kategori gjykimesh, vendimi i gjykatës së shkallës së parë dhënë në përfundim të të cilëve, mund të vihet në ekzekutim të përkohshëm. Edhe në këto raste, mund të ushtrohet e drejta e ankimit të veçantë ndaj vendimit të dhënë me ekzekutim të përkohshëm.

Pas dhënies së vendimit nga gjykata e shkallës së parë, është në interesin e subjektit, i cili paraqet ankim, të bëhet kujdes përsa i takon mundësisë së ekzekutimit të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Rregulli i përgjithshëm në të drejtën procedurale është që ekzekutimi i vendimit ndaj të cilit ushtrohet ankim në gjykatën e apelit pezullohet deri në përfundim të shqyrtimit të çështjes nga gjykata e apelit. Por, vetë dispozita e nenit 449 të K.Pr.C. parashikon se në raste të veçanta, kur në ligj është parashikuar ndryshe, ekzekutimi i vendimit të gjykatës së shkallës së parë mund të realizohet dhe menjëherë pas shpalljes së vendimit.

Nga ana praktike, pasi përfundojnë afatet për paraqitjen e ankimit nga subjektet e gjykimit, dosja gjyqësore e cila tashmë përmban të gjitha aktet e administruara gjatë gjykimit të çështjes në gjykatën e shkallës së parë (padi, provat, procesverbali gjyqësor) së bashku me vendimin përfundimtar të dhënë, ankimet e paraqitura nga subjektet niset nga sekretaria gjyqësore në drejtim të gjykatës së apelit, e cila për shkak të kompetencës lëndore dhe asaj tokësore ngarkohet me ligj për shqyrtimin e çështjes.

Një rregullim të detajuar në lidhje me ecurinë procedurale të dosjes gjyqësore, pas administrimit të ankimeve dhe kalimit të afateve për ushtrimin e tij, ankimit, nga të gjitha subjektet procedurale të gjykimit, ligjvënësi e ka parashikuar në përmbajtjen e dispozitës së nenit 450/a të K.Pr.C. Pas kalimit të afatit për paraqitjen e ankimeve, administrimin e ankimit të atyre subjekteve që e kanë depozituar atë në sekretarinë gjyqësore, njoftimin e ankimit të gjitha subjekteve të gjykimit, është detyrim i gjykatës së shkallës së parë, që të nesërmen e mbarimit të afatit të ankimit, ose para këtij afati kur të gjitha palët e paraqesin ankimin para afatit, t'ia nisë aktet e çështjes së bashku me ankimet gjykatës së apelit.

Në juridiksionin gjyqësor civil shqiptar aktualisht funksionojnë 6 gjykata apeli, të cilat merren me shqyrtimin e mosmarrëveshjeve civile të përgjithshme dhe një gjykatë apeli administrativ.

Në dispozitat e neneve 5, 6, 7 të ligjit nr. 9877/2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” është parashikuar mënyra e organizimit dhe funksionimit të gjykatave të apelit në Republikën e Shqipërisë. Ligji në

fjalë sanksionon krijimin e gjykatave të apelit dhe përcaktimin e kompetencës se tyre tokësore me anë të Dekretit të Presidentit të Republikës, i cili vendos mbi propozimin e Ministrit të Drejtësisë. Kështu me Dekretin e Presidentit të Republikës Nr.6217, datë 07.07.2009 janë përcaktuar kompetencat tokësore dhe qendrat e ushtrimit të veprimtarisë së gjykatave të apelit në Republikën e Shqipërisë. Po ashtu, me Dekretin e Presidentit të Republikës Nr. 7818, datë 16.11.2012 është përcaktuar kompetenca tokësore e 6 gjykatave administrative të shkallës së parë dhe e gjykatës së apelit administrative, e cila qendrën e saj e ka në Tiranë dhe ka kompetencë tokësore kombëtare (pra përfshin të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë).

Ndërkaq 6 gjykatat e apelit të juridiksionit gjyqësor civil të përgjithshëm kanë këtë kompetencë tokësore dhe qendër të ushtrimit të veprimtarisë (sipas Dekretit Nr.6217, datë 07.07.2009):

1. Gjykata e apelit Tiranë, me kompetencë tokësore në rrethet gjyqësore Dibër, Krujë, Kurbin, Mat, Tiranë dhe me qendër të ushtrimit të veprimtarisë në qytetin Tiranë.
2. Gjykata e apelit Durrës, me kompetencë tokësore në rrethet gjyqësore Elbasan, Durrës, Kavajë dhe me qendër të ushtrimit të veprimtarisë në qytetin Durrës.
3. Gjykata e apelit Shkodër, me kompetencë tokësore në rrethet gjyqësore Lezhë, Kukës, Pukë, Shkodër, Tropojë dhe me qendër të ushtrimit të veprimtarisë në qytetin Shkodër.
4. Gjykata e apelit Vlorë, me kompetencë tokësore në rrethet gjyqësore Berat, Fier, Lushnjë, Vlorë dhe me qendër të ushtrimit të veprimtarisë në qytetin Vlorë.
5. Gjykata e apelit Korçë, me kompetencë tokësore në rrethet gjyqësore Korçë e Pogradec dhe me qendër të ushtrimit të veprimtarisë në qytetin Korçë.
6. Gjykata e apelit Gjirokastrë, me kompetencë tokësore në rrethet gjyqësore Gjirokastrë, Përmet, Sarandë dhe me qendër të ushtrimit të veprimtarisë në qytetin Gjirokastrë.

Sikundër është parashikuar dhe në Dekretin e mësipërm, ankimet që ushtrohen nga subjektet e gjykimit ndaj vendimeve të gjykatës së shkallës së parë, merren në shqyrtim dhe gjykohen nga këto 7 gjykata apeli, njëra prej të cilave administrative. Selitë e gjykatave të apelit ndodhen në qytetet përkatëse dhe pranë këtyre selive zhvillohen dhe gjykimet nga trupa gjyqësore e gjykatave të apelit.

Organizimi i punës në gjykatat e apelit i referohet K.Pr.C., ligjit organik të sistemit gjyqësor dhe atij të administratës gjyqësore. Një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punës së përditshme dhe në gjykatat e apelit e ka Kancelari. Si një funksionar, i cili përzgjidhet dhe emërohet në detyra nga pushteti ekzekutiv (Ministria e Drejtësisë), Kancelari është përgjegjës për një sërë çështjesh që kanë të bëjnë ndër të tjera dhe me administrimin e dosjeve gjyqësore, mes të cilave me rëndësi të veçantë organizimi dhe hedhja e shortit për gjykimin e të gjithë ankimeve që dërgohen për shqyrtim nga gjykatat përkatëse të shkallës së parë.

Me mbërritjen e dosjes gjyqësore, së bashku me ankimin dhe njoftimet përkatëse të tij, sekretaria gjyqësore e gjykatës së apelit bën regjistrimin elektronik të saj (në ato gjykata ku është funksional sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve) apo regjistrimin manual në regjistrat përkatës, duke ia nënshtruar më pas shortit. Në përfundim të kësaj procedure, dosja gjyqësore që përmban ankimin e paraqitur nga subjekti i gjykimit, numërtohet me një numër që i përgjigjet sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore në gjykatën e apelit dhe kalon në ngarkesën e gjyqtarit përkatës të përzgjedhur me short për gjykimin e saj.

Të gjitha gjykatat e apelit në territorin e Republikës së Shqipërisë, kanë sot një sistem elektronik të menaxhimit të çështjeve gjyqësore. Çka do të thotë që shorti për përzgjedhjen e gjyqtarit që do të shqyrtojë dosjen gjyqësore dhe ankimin përkatës ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë kryhet nga sistemi elektronik. Kjo formë e operimit bën të mundur që edhe nëpërmjet faqes së internetit www.gjykata.gov.al çdo subjekt i interesuar mund të informohet në kohë reale për ecurinë e gjykimit të dosjes gjyqësore, ndaj së cilës është ushtruar ankim në gjykatën e apelit, duke u informuar për numrin e saj, gjyqtarin relator si dhe planifikimet e seancave gjyqësore.

Pjesëmarrja në gjykim e subjektit që thirret si palë në gjykimin e një mosmarrëveshje juridike civile do të duhet të kuptohet në të gjithë rëndësinë e saj, si një e drejtë kushtetuese dhe e mbrojtur posaçërisht dhe nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut. Në të tilla rrethana dhe gjykimi i çështjes në gjykatën e apelit, i nënshtrohet rregullave të posaçme përsa i përket njoftimit të subjekteve të gjykimit për zhvillimin e gjykimit në apel. Pas shpërndarjes nëpërmjet shortit elektronik të çështjeve gjyqësore, sipas një kalendari të përcaktuar nga shërbimet administrative të gjykatës së apelit, nën drejtimin e kryetarit të saj, caktohet data e gjykimit.

Përkundër rregullave për njoftimin e gjykimit të çështjes në gjykatën e shkallës së parë, njoftimi i gjykimit të çështjeve në gjykatën e apelit të juridiksionit gjyqësor civil të përgjithshëm bëhet nëpërmjet shpalljeve publike. Si funksionon

në praktikë kjo procedurë? Pranë selisë së secilës prej gjykatave të apelit ekziston një hapësirë e posaçme, në të cilën afshohen të gjithë njoftimet me karakter procedural, të urdhëruara gjatë gjykimit të çështjeve në gjykatën e apelit, sikundër listat e gjyqimeve të çështjeve që pritet të gjykohen nga gjykata e apelit.

Rregulli i përgjithshëm për njoftimin e gjykimit në gjykatën e apelit është parashikuar nga dispozita e nenit 460/3 të K.Pr.C. Kjo dispozitë ngarkon sekretarinë gjyqësore të gjykatës së apelit që jo më vonë se 10 ditë të kryejë njoftimin me shpallje publike për ditën dhe orën e gjykimit të çështjeve në gjykatën e apelit. Po sikundër e kemi paraqitur dhe më lart, kompetencat tokësore e gjykatave të apelit, përfshin edhe gjykata të rretheve gjyqësore, të cilat selitë e tyre i kanë në distanca të konsiderueshme nga selia e gjykatës së apelit. E në këto kushte, subjektet e gjykimit që kanë ushtruar ankim ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë, selia e së cilës në të shumtën e rasteve përkon me vendbanimin e tyre, do ta kishin të vështirë aksesin në gjykatën e apelit, në rast se njoftimi për zhvillimin e gjykimit do të mjaftohej me shpalljen pranë gjykatës së apelit.

Për të mundësuar aksesin e të gjithë subjekteve në gjykimin pranë gjykatës së apelit, dispozita e lartpërmendur ka parashikuar se njoftimet për zhvillimin e gjyqimeve në gjykatën e apelit, përcillen për shpallje dhe pranë gjykatave të shkallës së parë, vendimet e të cilave janë ankimuar nga subjektet e gjykimit. Pra, nëse një vendim përfundimtar i gjykatës së rrethit gjyqësor Mat është ankimuar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, sekretaria gjyqësore e kësaj të fundit ka detyrimin ligjor që shpalljen e ditës dhe orës së gjykimit të ankimit ta dërgojë për shpallje edhe pranë sekretarisë gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat duke respektuar të njëjtin afat kohor, jo më vonë se 10 ditë përpara shqyrtimit të çështjes.

Me gjithë rregullin e përgjithshëm të përmendur më lart, ka raste kur njoftimi i subjekteve të gjykimit, qofshin ata dhe vetë subjektet që kanë ushtruar ankim, të bëhet drejtpërdrejtë nëpërmjet rregullave që parashikon pjesa e përgjithshme për njoftimin e akteve. Në paragrafin e fundit të nenit 460 të K.Pr.C. ligjvënësi ka detyruar gjykatën e apelit që njoftimin për zhvillimin e gjykimit t'ua bëjë drejtpërdrejtë subjekteve të gjykimit në rastet kur kemi të bëjmë me çështje me rigjykim, kur është vendosur mbajtja për gjykim në fakt, ose kur çmohet se gjykimi duhet të kryhet përpara afatit 10 ditor të parashikuar nga dispozita e nenit 460/3 të K.Pr.C.

Përbërja e gjykatës së apelit në shqyrtimin e ankimeve ndaj vendimeve të gjykatës së shkallës së parë është gjithmonë uniforme, pra kolegjii gjyqësor i gjykatës së apelit në çdo rast përbëhet nga tre gjyqtarë. Pavarësisht nëse gjykimi

në gjykatën e shkallës së parë është realizuar nga një trupë gjyqësore prej 1 ose 3 gjyqtarësh, ankimi ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë do të gjykohet në gjykatën e apelit nga një kolegji gjyqësor i përbërë nga tre gjyqtarë. Sa më lart gjen shprehje në përmbajtjen e dispozitës së nenit 460/1 të K.Pr.C.

Gjatë gjykimit të çështjes në gjykatën e apelit, procedura e gjykimit nga trupi gjykues i përmbahet përsa janë të zbatueshme dispozitave mbi procedurën e gjykimit në gjykatën e shkallës së parë, procedura që kanë gjetur pasqyrim në pjesën përkatëse të këtij manuali (neni 465/1 i K.Pr.C.).

Në fillim të gjykimit të çështjes nga gjykata e apelit, kolegji gjyqësor bën verifikimin e paraqitjes së rregullt të palëve, kryen bashkimin e të gjithë ankimeve të bëra kundër të njëjtit vendim dhe bën përpjekjen e rastit për zgjidhjen e çështjes me pajtim. Ndryshe nga sa parashikohet në dispozitat përkatëse të K.Pr.C. për pasojat juridike të mosparaqitjes së palëve, qoftë dhe të subjektit paditës apo të subjektit që ka paraqitur ankim, gjykimi në gjykatën e apelit vijon të zhvillohet dhe në mungesë të tyre.

Në rast se njoftimi me shpallje i gjykimit të çështjes në gjykatën e apelit është bërë në përputhje me normat procedurale të lartpërmendura dhe subjekti i gjykimit nuk ka paraqitur ndonjë shkak të arsyeshëm për mungesën, atëherë kolegji gjyqësor i gjykatës së apelit vijon shqyrtimin e çështjes në mungesë të tyre. Vetëm në kushtet kur gjykata e apelit është duke e rigjykuar çështjen dhe njoftimi i subjekteve është njëra nga detyra e lëna për t'u zbatuar gjatë rigjykimit, ose kur është konstatuar se njoftimi ka qenë i parregullt, atëherë kolegji gjyqësor i gjykatës së apelit nuk mund të vijojë shqyrtimin e çështjes në mungesë të subjekteve të gjykimit (neni 461 i K.Pr.C.).

Pas verifikimit të paraqitjes së rregullt të palëve dhe veprimeve pasuese procedurale, në lidhje me kërkesat paraprake, shpalljen e kolegjit gjykues, seanca gjyqësore në gjykatën e apelit fillon me relativimin e çështjes nga relatori, anëtar i kolegjit gjykues. Pas relativimit, fjala i jepet subjektit të gjykimit që ka paraqitur ankimin për të parashtruar shkaqet e ankimit dhe kërkimet përkatëse. Vijnë me paraqitjen e pretendimeve eventuale të gjithë subjektet e tjera të gjykimit. Kjo procedurë gjen rregullim të posaçëm në dispozitën e nenit 464 të K.Pr.C.

Mbështetur në nenin 465 të K.Pr.C., ligjvënësi ka parashikuar të drejtën që mbi kërkesën e palëve ose qoftë dhe kryesisht, gjykata e apelit mund të përsërisë tërësisht apo pjesërisht hetimin gjyqësor. Përsëritja e pjesshme ose tërësore e hetimit gjyqësor bën të domosdoshëm që gjykata e apelit gjatë gjykimit të çështjes të zbatojë dispozitat përkatëse procedurale që normojnë gjykimin e çështjes në gjykatën e shkallës së parë. Gjatë përsëritjes së pjesshme ose tërësore të hetimit të

çështjes është në tagrin e gjykatës të përdorë aktet e gjykimit të shkallës së parë, qoftë dhe të vendosë marrjen e provave të reja.

E njëjta situatë procedurale, përsëritja tërësore e hetimit gjyqësor, verifikohet dhe në kushtet që parashikon dispozita e nenit 467/a e K.Pr.C. Kur gjykata e apelit, e investuar në gjykim nga apeli i subjekteve të gjykimit, shqyrton çështjen për herë të dytë, ajo nuk mund ta prishë vendimin dhe ta kthejë çështjen për rigjykim për herë të dytë në gjykatën e shkallës së parë. Në të tilla raste, pas prishjes së vendimit është vetë gjykata e apelit ajo që e gjykon çështjen si gjykatë e shkallës së parë, duke respektuar të gjitha normat procedurale që rregullojnë gjykimin e çështjes në gjykatën e shkallës së parë.

Momente të rëndësishme procedurale që lidhen me gjykimin e çështjes në gjykatën e apelit janë e drejta e subjektit që ka paraqitur ankim për të hequr dorë nga ankimi, si dhe e drejta e subjektit paditës për të hequr dorë nga padia. Në rast se K.Pr.C. në nenin 463 të tij ka të parashikuar shprehimisht se heqja dorë nga ankimi në gjykatën e apelit, sjell si pasojë pushimin e shqyrtimit të çështjes në gjykatën e apelit, rrjedhimisht marrjen formë të prerë të disponimit të gjykatës së shkallës së parë në vendimin përfundimtar të saj, heqja dorë nga e drejta e padisë në gjykatën e apelit do të duhet të shihet e lidhur me parashikimin e nenit 201 të K.Pr.C. Në rast se subjekti paditës, që mund të jetë dhe i ndryshëm nga subjekti që ka paraqitur ankim ndaj vendimit përfundimtar të gjykatës së shkallës së parë, gjatë gjykimit në gjykatën e apelit heq dorë nga e drejta e padisë, vendimi përfundimtar i gjykatës së shkallës së parë prishet dhe vendoset rrëzimi i padisë.

Është për t'u nënvizuar dhe mënyra e trajtimit të çështjes së juridiksionit dhe kompetencës gjatë shqyrtimit të ankimit në gjykatën e apelit. Në rastet kur një gjykatë, edhe pse jo kompetente, ka dhënë një vendim të drejtë pa kapërcyer kompetencat e gjykatës që i takonte çështja, gjykata e apelit mund të vendosë lënien në fuqi të vendimit, porse në arsyetimin e vendimit do të duhet të verë në dukje parregullsitë e gjykatës së shkallës së parë në lidhje me kompetencën (neni 468 i K.Pr.C.).

Ndërkohë, në rastet kur gjykata e apelit investohet në gjykimin e çështjes për shkak të ankimit dhe konstaton se çështja nuk bën pjesë në juridiksionin gjyqësor, atëherë ajo, gjykata e apelit, vendos prishjen e vendimit dhe pushimin e gjykimit të çështjes. I njëjti disponim merret dhe në rastet kur kemi të bëjmë me padi që nuk mund të ngrihen ose gjykimi nuk mund të vazhdojë (neni 468 i K.Pr.C.).

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, gjykata e apelit disponon bazuar në parashikimet e nenit 466 të K.Pr.C. si më poshtë vijon:

“Gjykata e apelit pasi shqyrton çështjen vendos:

a) lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë;

b) ndryshimin e vendimit;

c) prishjen e vendimit dhe pushimin e çështjes;

ç) prishjen e vendimit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë në rastet e parashikuara nga nenin 467 i këtij Kodi.”

Në rastet kur vendimi i gjykatës së apelit, ndryshon vendimin e gjykatës së shkallës së parë, vendim për të cilin duhet të lëshohet urdhri i ekzekutimit, ky akt, urdhri i ekzekutimit, shoqëron vendimin e gjykatës së apelit, i nënshkruar nga kryetari i kolegjit gjykues në gjykatën e apelit. Urdhri i ekzekutimit, i konfirmuar nga kancelari i gjykatës së apelit, i njoftohet gjykatës së shkallës së parë që ka dhënë vendimin, e cila ua njofton palëve sipas rregullave të pjesës së përgjithshme për njoftimin e akteve.

Nga të gjithë disponimet e parashikuara në nenin 466 të K.Pr.C., ai i shkronjës ç) gjen normim të posaçëm në nenin pasardhës 467 të po këtij Kodi. Janë shtatë rastet kur gjykata e apelit prish vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe kthen çështjen për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë. Të tilla janë: i) shkelja e dispozitave mbi juridiksionin dhe kompetencën, ii) përbërja e parregullt e trupit gjykues/mos nënshkrimi i vendimit apo cenimi i parimit të paanësisë, iii) pushimi i çështjes në kundërshtim me K.Pr.C., iv) shqyrtimi i çështjes në mungesë të palëve, që nuk kane pasur dijeni për ditën e gjykimit, v) mos formim i drejtë i ndërgjyqësisë, vi) kur mungon ose janë të pavlefshme padia, procesverbali gjyqësor, ankimi apo çdo dokument tjetër që ka ndikuar në dhënien e vendimit, vii) kur lind nevoja e marrjes së një prove vendimtare, marrja e së cilës është e vështirë në shkallë të dytë ose kur gjykata nuk është shprehur për të gjitha kërkimet e palës paditëse, që përbëjnë objektin e mosmarrëveshjes mes palëve ndërgjyqëse.

Pas marrjes së vendimit të gjykatës së apelit për prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rigjykimin e çështjes, gjatë rigjykimit gjykata e shkallës së parë është e detyruar t’i përmbahet vendimit dhe çdo detyre të lënë nga gjykata e shkallës së parë.

Në rastet kur vendimi i gjykatës së shkallës së parë prishet nga gjykata e apelit, atëherë ekzekutimi i atij vendimi pezullohet (në rastet kur ka nisur ekzekutimi i tij). Ndërkohë vetë gjykata e apelit, sipas parashikimit të nenit 469 të K.Pr.C., përsa kohë kërkohet nga palët, edhe kur vendos lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të tij. Ky disponim është i detyrueshëm të shoqërohet me ushtrimin e rekursit nga subjekti ankues, kur nga ekzekutimi i menjëhershëm mund të vijnë pasoja të rënda ose kur subjekti paraqet garanci materiale që sigurojnë ekzekutimin e vendimit.

Kujtesë praktike për gjykimin e ankimit në gjykatën e apelit:

- Njoftimi i zhvillimit të seancës gjyqësore ku do të shqyrtohet akti i ankimit (apel) që keni paraqitur, do të njoftohet jo më vonë se 10 ditë përpara, në këndin përkatës pranë selisë së gjykatës së apelit dhe këndit të njoftimeve pranë gjykatës së shkallës së parë, që ka dhënë vendimit ndaj të cilit keni ushtruar mjetin e ankimit (apel).
- Ju mund të keni një alternativë (jo procedurale) për t'u informuar për planifikimin e seancës gjyqësore në gjykatën e apelit, duke konsultuar faqen e internetit www.gjykata.gov.al. Ndiqni udhëzuesin e kësaj faqeje interneti për të gjetur informacionin e kërkuar. Ju mund të kërkonit mbi bazën e emrit/mbiemrit të subjektit ndërgjyqës ose numrit që çështja përkatëse gjyqësore ka marrë në sistemin e menaxhimit elektronik të çështjeve pranë gjykatës së apelit.
- Seanca gjyqësore në gjykatën e apelit, do të kryhet në selinë e saj, e cila mund të jetë e ndryshme nga vendbanimi juaj, ndaj duhet të merrni masa për t'u paraqitur e mos krijuar përplasje me seanca të tjera gjyqësore ku ju duhet të merrni pjesë.
- Në rast pamundësie për pjesëmarrjen tuaj në seancën gjyqësore pranë gjykatës së apelit, në datën dhe orën e shpallur merrni masa të njoftoni sekretarinë përkatëse gjyqësore, pasi gjykimi mund të vijojë edhe pa praninë tuaj si ushtrues i të drejtës së ankimit.
- Gjykimi i mjetit të ankimit (apel) do të kryhet gjithmonë nga një gjykatë kolegjiale, e përbërë prej 3 anëtarësh, njëri prej të cilëve do të jetë dhe relatori i çështjes tuaj.
- Me fillimin e gjykimit, pas parashtrimit të kërkesave eventuale paraprake, shqyrtimit të tyre, do të shpallet trupi gjykues dhe do t'ju kërkohej nëse keni ndonjë kundërshti me përbërjen e tij. Në vijim do t'ju jepet fjala në cilësinë e ushtruesit të ankimit, ose në vijim të parashtrimit të pretendimeve tuaja, në rast se subjekti ndërgjyqës që përfaqësoni nuk ka ushtruar ankim.
- Parashtroni edhe njëherë në mënyrë të përmbledhur argumentet e parashtruara në mjetin e ankimit (apel) nëse jeni ju subjekti që e keni ushtruar këtë të drejtë, ose kundërshtojini ato nëse jeni përfaqësues i subjektit në favor të së cilit është disponimi i gjykatës së shkallës së parë.

- Përmbajuni rregullave të etikës profesionale që janë pasqyruar më lart në këtë manual, duke respektuar gjykatën, palët ndërgjyqëse dhe disponimet përkatëse të gjykimit.
- Në rast të përsëritjes së pjesshme apo të plotë të hetimit gjyqësor, apo gjykimit të çështjes nga gjykata e apelit si gjykatë e shkallës së parë, ju mund të ushtroni të gjitha të drejtat procedurale që K.Pr.C. parashikon për subjektet e gjykimit në gjykatën e shkallës së parë.
- Në rast se gjykata e apelit cenon vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe e kthen çështjen për rigjykim, merr masat e nevojshme për të ushtruar të drejtën e ankimit (rekurs në Gjykatën e Lartë), ose ndiq ecurinë e vijimit të rigjykimit pranë gjykatës së shkallës së parë.
- Në rast se vendimi i gjykatës së apelit ndryshon vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke vendosur në favor të subjektit ndërgjyqës që ju përfaqësoni, sigurohu që gjykata e apelit të lëshojë urdhrin përkatës të ekzekutimit për të vijuar me procedurat përmbartimore për zbatimin e tij.

Lind pyetja: *“A ka raste të tjera kur subjektet e të drejtës mund t’i drejtohen gjykatës së apelit, duke e investuar këtë të fundit në gjykim”?*

Po ka. Të tilla janë rastet që parashikohen nga neni 434 i K.Pr.C. Kjo dispozitë sanksionon të drejtën e subjekteve të një gjykimi arbitrazhi, që pavarësisht se kanë parashikuar heqjen dorë nga ankimi në klauzolën e arbitrazhit, mund të ankimojnë vendimin e panelit të arbitrazhit në 5 rastet që parashikon dispozita e lartpërmendur. Afati i paraqitjes së ankimit në këto raste është 30 ditor. Ndërkaq gjatë gjykimit të kësaj kategorie ankimesh, gjykata e apelit zbaton të njëjtat rregullave që përcakton K.Pr.C. për shqyrtimin e ankimeve ndaj vendimeve të gjykatës së shkallës së parë.

Po ashtu, gjykata e apelit ka tagrin të shqyrtojë dhe kërkesat për njohjen e vendimeve të huaja. Këto vendime njihen dhe zbatohen në Republikën e Shqipërisë sipas kushteve të parashikuara në K.Pr.C., ligje të veçanta ose marrëveshje të posaçme ndërshtetërore të lidhura për këtë qëllim (K.Pr.C.). Kërkesa për njohjen e vendimit të huaj i paraqitet gjykatës së apelit nga vetë subjekti i interesuar ose në rrugë diplomatike. Kur kërkesa paraqitet në rrugë diplomatike, vetë kryetari i gjykatës së apelit i cakton një përfaqësues palës së interesuar, në rast se ajo vetë nuk ka emëruar një të tillë, për të paraqitur kërkesën për njohje të vendimit.

Pasi shqyrton çështjen brenda objektit të gjykimit që parashikon nenin 397 i K.Pr.C., gjykata e apelit jep vendim për njohjen eventuale të vendimit të gjykatës së huaj. Vendimi i gjykatës së huaj do të mund të ekzekutohet në territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me dispozitat përkatëse të K.Pr.C., vetëm pasi gjykata e apelit t'i ketë dhënë fuqi vendimit të gjykatës së huaj. E njëjta procedurë ndiqet edhe për njohjen e një vendimi përfundimtar të dhënë nga një panel arbitrazhi i një shteti të huaj.

Për këtë pjesë të K.Pr.C., për elementë të rëndësishëm që kanë të bëjnë me rastet kur një vendimi të një gjykate/arbitrazhi të huaj nuk i jepet fuqi në Republikën e Shqipërisë, ndërtimit të ndërgjyqësisë, aktet që duhet t'i bashkëngjiten kërkesës, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë dalë me Vendimin Unifikues nr. 6/2011.

6.3. Gjykimi i çështjeve administrative në gjykatën e apelit

Sikundër u tha më lart, me Dekretin e Presidentit të Republikës Nr. 7818, datë 16.11.2012 ndërkohë është përcaktuar kompetenca tokësore e 6 gjykatave administrative të shkallës së parë dhe e gjykatës së apelit administrativ, e cila qendren e saj e ka në Tiranë dhe ka kompetencë tokësore kombëtare (pra përfshin të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë). Ky dekret pasoi hyrjen në fuqi të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i cili krijoi në vendin tonë sistemin e gjykatave administrative, të cilat deri në atë kohë kishin funksionuar në formën e seksioneve të veçanta brenda gjykatave të disa rretheve gjyqësore.

Dispozita e nenit 4/1 të ligjit të mësipërm parashikon mënyrën e organizimit të gjykatave administrative, përkatësisht në gjykatat administrative të shkallës së parë, gjykatën administrative të apelit dhe Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë. Nisur nga përmbajtja e pikës 2 të të njëjtit nen, gjykatat e shkallës administrative të shkallës së parë janë organizuar në numër dhe territor të barabartë me atë të gjykatave të apelit civil, pra gjithsej 6 dhe një gjykatë apeli administrativ që e ka selinë në Tiranë.

Juridiksioni, kompetenca lëndore, tokësore dhe ajo funksionale e sistemit të gjykatave administrative është normuar nga dispozitat e neneve 7, 8, 9, 10 dhe 11 të ligjit nr. 49/2012. Pika 2, e nenit 10 “Kompetenca funksionale” parashikon si vijon:

“2. *Gjykata Administrative e Apelit shqyrton:*

- a) *ankimet kundër vendimeve të gjykatës administrative të shkallës së parë;*
- b) *në shkallë të parë, mosmarrëveshjet me objekt aktet nënligjore normative, si dhe raste të tjera të parashikuara me ligj.”*

Sistemi i gjykatave administrative filloi funksionimin e tij më datë 4 nëntor 2013, bazuar në Dekretin e Presidentit të Republikës Nr. 8349, datë 14.10.2013. Ndërkaq, kanë hyrë në fuqi dhe shtesat e ndryshimet në K.Pr.C., të miratuara me ligjin nr. 160/2013, ku neni 49/1 “Dispozitë kalimtare” parashikon se: *“Çështjet civile që janë në gjykim në gjykatën e shkallës së parë dhe në gjykatën e apelit, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë të gjykohen sipas ligjit të kohës së paraqitjes së kërkesë-padisë.”*

Nisur nga kjo dispozitë, gjykata e apelit administrativ ka filluar funksionimin e saj që nga data 4 nëntor 2013 dhe do të shqyrtojë të gjithë ankimet kundër vendimeve të gjykatës administrative të shkallës së parë dhe do të shqyrtojë si gjykatë e shkallës së parë mosmarrëveshjet që kanë për objekt aktet nënligjore normative, apo kur vetë ligji parashikon sa më lart.

Kompetencat lëndore në shqyrtimin e çështjeve që janë në proces gjykimi apo dhe rregullimi më i detajuar i këtij elementi procedural (kompetencës lëndore) kanë gjetur interpretim dhe unifikim të praktikës gjyqësore nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin unifikues për çështjet me nr. 3/13 akti, datë 06.12.2013 dhe nr. 4/13 akti, datë 10.12.2013. Mjetet dhe afatet e ankimit të cilat parashikohen në ligjin nr. 49/2012 janë të njëjta me ato që parashikon K.Pr.C., pasi kjo sanksionohet në nenin 44 të këtij ligji. Por jo të gjithë vendimet e gjykatës administrative të shkallës së parë mund të ankimohen. Ligjvënësi në dispozitën e nenit 45 të ligjit nr. 49/2012 ka parashikuar 4 raste përjashtuese kur vendimi i gjykatës administrative të shkallës së parë nuk është i ankimueshëm.

Ligji nr. 49/212 sjell risi përsa i takon procedurës së administrimit të ankimit. Edhe pse në thelb të tij përmbajtja e ankimit është e njëjte me atë që parashikon dispozita përkatëse e K.Pr.C., po ashtu afati që i lihet subjektit ankues për plotësimin e tij, në mënyrë taksative neni 46(2)(3) i ligjit normon se në çdo rast pranimit i ankimit për administrim bëhet nëpërmjet një vendimi gjyqësor, që gjyqtari i vetëm i gjykatës administrative të shkallës së parë e merr në dhomë këshillimi.

Në rastet kur pas kalimit të afatit 5 ditor për plotësimin e ankimit, subjekti ankues nuk i plotëson ato atëherë me vendim të gjyqtarit të vetëm ankimi i kthehet subjektit, i cili mund të ushtrojë ankim të veçantë në gjykatën administrative të apelit në lidhje me kthimin e ankimit.

Po ashtu, dispozita e nenit 47 të ligjit nr.49/2012 ndalon subjektin ankues që së bashku me ankimin të paraqesë fakte të reja apo të kërkojë fakte të reja, të ndryshme nga ato të paraqitura dhe administruara në gjykatën administrative të shkallës së parë, përveç rasteve kur provohet se pa fajin e tij kjo gjë nuk ka qenë e mundur të kryhet gjatë shqyrtimit të çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë.

Neni 48 i ligjit nr.49/2012 ka vendosur afate të prera përsa i takon administrimit të ankimit, dosjes gjyqësore, dërgimit të saj në gjykatën administrative të apelit, shqyrtimit nga kjo e fundit, marrjes së vendimit dhe përcjelljen e saj sërish në gjykatën administrative përkatëse të shkallës së parë. Ankimi, së bashku me aktet bashkëlidhur, vendimin e gjyqarit për pranimin e ankimit, aktet e komunikimit të ankimit si dhe dosja gjyqësore dërgohen në gjykatën administrative të apelit brenda 15 ditëve nga data e depozitimit të ankimit. Ndërkohë gjykata administrative e apelit detyrohet ta shqyrtojë çështjen brenda 30 ditëve nga data e ardhjes së çështjes nga gjykata administrative e shkallës së parë. 3 ditë pas përfundimit të kryerjes së njoftimit të vendimit të marrë prej saj, për të gjithë subjektet e gjykimit, gjykata administrative e apelit detyrohet të dërgojë dosjen pranë gjykatës administrative të shkallës së parë që kish përcjellë për gjykim ankimin.

Përbërja e trupit gjykues në gjykatën administrative të apelit është rregulluar nga përmbajtja e dispozitës së nenit 12/2 pika a dhe b e ligjit nr.49/2012. Kështu gjykata e apelit administrativ gjykon me trup gjykues prej 3 anëtarësh të gjitha ankimet ndaj vendimeve të gjykatave administrative të shkallës së parë dhe me trup gjykues prej 5 anëtarësh paditë ndaj akteve nënligjore normative.

Gjykimi i ankimeve të paraqitura ndaj vendimeve të marra nga gjykatat administrative të shkallës së parë, shqyrtohen nga gjykata administrative e apelit si në dhomë këshillimi, ashtu dhe në seancë gjyqësore. Rregulli i përgjithshëm për gjykimin e çështjeve në gjykatën administrative të apelit është që ai, gjykimi, kryhet mbi bazë dokumentesh, pra praninë e palëve në dhomë këshillimi. Pas përgatitjes së relacionit nga kryetari i trupit gjykues, ai përcakton datën dhe orën për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi, duke urdhëruar njëkohësisht dhe njoftimin e palëve. Sekretaria gjyqësore ka detyrimin që 15 ditë përpara shqyrtimit të çështjes, të njoftojë subjektet e gjykimit për datën dhe orën se kur do të shqyrtohet çështja në dhomë këshillimi. Deri 5 ditë përpara shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi, të gjithë subjektet e gjykimit ka të drejtë të paraqesin parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim dhe kundër ankim. Në dhomë këshillimi, gjatë shqyrtimit të çështjes mbahet një procesverbal gjyqësor (neni 49 i ligjit nr.49/2012).

Natyra e disponimit të gjykatës administrative të apelit pas përfundimit të shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi parashikohet nga dispozita e nenit 50 të ligjit të lartpërmendur. Ndërkohë gjykimi i çështjes në gjykatën administrative të apelit mund të bëhet dhe në seancë gjyqësore, me pjesëmarrjen e subjekteve të gjykimit, përsa kohë në dhomë këshillimi është çmuar se është i nevojshëm debati gjyqësor për: i) konstatimi i gjendjes faktike ka nevojë për fakte dhe

prova të reja kur janë kushtet që parashikon neni 47, ii) vendimi është marrë në shkëlqje të rënda procedurale apo gjendje faktike të konstatuar gabim a në mënyrë të paplotë, iii) konstatimi i drejtë i gjendjes faktike ka nevojë për përsëritjen e marrjes së disa ose të gjitha provave të administruara nga gjykata e shkallës së parë. Në të tilla raste, vendimi i dhomës së këshillimit për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, data dhe ora e kësaj seance, u njoftohen subjekteve të gjykimin nga sekretaria gjyqësore të paktën 10 ditë para zhvillimit të seancës gjyqësore (neni 51 i ligjit nr.49/2012).

Neni 53 i ligjit nr.49/2012 ka sanksionuar llojet e disponimit të gjykatës administrative të apelit në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore, i) lënien në fuqi të vendimit, ii) ndryshimin e vendimit, iii) prishjen e vendimit dhe pushimin e çështjes, iv) prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim. Kthimi i çështjes për rigjykim në gjykatën administrative të shkallës së parë bëhet në vija të përgjithshme për të njëjtat shkaqe që parashikon dhe K.Pr.C. për juridiksionin civil të zakonshëm. Bën përjashtim rasti i marrjes së një prove të re, rast ky që nuk përbën shkak për prishjen e vendimit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në gjykatën administrative të shkallës së parë, duke njohur kështu mundësinë e gjykatës administrative të apelit që në të tilla rrethana të veprojë vetë pa kufizime në administrimin e provave të reja.

Shpallja dhe depozitimi i vendimit të gjykatës administrative të apelit gjen rregullim të posaçëm në dispozitën e nenit 55 të ligjit nr.49/2012.

Rastet kur gjykata e apelit gjykon si gjykatë e shkallës së parë, janë ato raste kur ligje të posaçme parashikojnë këtë kompetencë funksionale të kësaj gjykate. Aktualisht janë disa ligje që parashikojnë kundërshtimin e akteve të prodhuara si pasojë e zbatimit të tyre drejtpërdrejtë në gjykatën e apelit. Kështu mund të përmendim ligjin nr. 8572/1999, ku subjektet e parashikuara në atë ligj kanë të drejtë të kundërshtojnë drejtpërdrejt në gjykatën e apelit vendimet e administratorit apo përmbaruesit gjyqësor, të dala në zbatim të ligjit.

Po ashtu, në ligjin nr. 8549/1999 “Statusi i nëpunësit civil”, i ndryshuar, në nenin 8 parashikohej e drejta e institucioneve të administratës publike që të ankimonin në gjykatën e apelit vendimet e dhëna nga K.Sh.C. për akte të nxjerra prej këtyre institucioneve në zbatim të këtij ligji. Praktika gjyqësore e gjykimin të këtyre çështjeve si gjykatë e shkallës së parë, në gjykatën e apelit gjeti rregullim edhe nëpërmjet Vendimit Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr.20/2007 ku u unifikua praktika gjyqësore në lidhje me faktin se në këto raste, kur gjykata e apelit gjykonte si gjykatë e shkallës së parë, ajo çështjen e shqyrtonte në përputhje me dispozitat e neneve 452-471 të K.Pr.C.

KREU 7

REKURSI, ANKIMI I VEÇANTË DHE KËRKESA PËR RISHIKIM NË GJYKATËN E LARTË

Ardian DVORANI

7.1. Funkzioni rishikues i Gjykatës së Lartë

Nga përmbajtja e nenit 141 (1) dhe (2) të Kushtetutës⁸⁴ rezulton se, përsa i përket gjykimit civil, Gjykata e Lartë ka vetëm juridiksion gjyqësor rishikues. Ushtrimi i këtij funksioni kushtetues realizohet nga Gjykata e Lartë nëpërmjet verifikimit gjyqësor të zbatimit të ligjit procedural dhe atij material nga gjykatat më të ulëta në gjykimin dhe vendimin e dhënë prej tyre për zgjidhjen e çështjes që është objekt gjykimi.

Në thelb, natyra rishikuese e juridiksionit të Gjykatës së Lartë është e kufizuar pikërisht vetëm në verifikimin e respektimit të ligjit procedural dhe material në gjykimin e çështjes konkrete dhe në vendimet e dhëna nga gjykatat më të ulëta për zgjidhjen e saj. Nëpërmjet interpretimit të ligjit procedural e material, Gjykata e Lartë verifikon e identifikon ligjin e zbatueshëm dhe, duke e zgjidhur çështjen objekt shqyrtimi, zbaton të drejtën mbi rrethanat e faktit që janë konstatuar dhe vlerësuar të provuara nga gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit.

Pra, në dallim, nga gjykata e shkallës së parë dhe nga gjykata e apelit, të cilat funksionojnë njëkohësisht si gjykata fakti dhe ligji, Gjykata e Lartë është vetëm gjykatë ligji.

Gjykata e Lartë, në zbatim të pikës 2 të nenit 141 të Kushtetutës, duke gjykuar çështje civile të përzgjedhura posaçërisht për këtë qëllim për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara të saj, me anë të vendimeve unifikuese jo vetëm i zgjidh këto çështje, por bën edhe njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore.

⁸⁴Neni 141 i Kushtetutës:

“1. Gjykata e Lartë ka juridiksion fillestar dhe rishikues. Ajo ka juridiksion fillestar kur gjykon akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit të Ministrave, deputetëve, gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

2. Për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë ka të drejtë të tërheqë për shqyrtim në kolegjet e bashkuara çështje të caktuara gjyqësore.”

Me anë të rregullimeve normative ligjore e nënligjore, legjislacioni reflekton apo synon të reflektojë shtrirjen, kompleksitetin, dinamikën dhe intensitetin e lindjes, ndryshimit, zhvillimit dhe mbarimit të marrëdhënieve shoqërore dhe ekonomike. Plotësia, cilësia dhe qartësia e këtij legjislacioni, shpeshësia apo intensiteti i ndryshimeve të tij, si edhe vështirësia objektive e aplikimit apo problematikat mbi aftësinë e kapacitetet profesionale të vetë gjyqësorit për ta interpretuar dhe zbatuar këtë legjislacion, në rrethana dhe periudha të caktuara, reflektojnë edhe fenomene të tilla si interpretimet dhe qëndrimet deri edhe dukshëm të ndryshme apo të kundërta nga ana e gjykatave në zgjidhjen e çështjeve, lidhur me disa rregullave normative të zbatueshme për marrëdhënie të caktuara juridike.

Prandaj, duke analizuar interpretimet e ndryshme, deri edhe të kundërta, të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave në zgjidhjen e çështjeve civile për lloje dhe natyra mosmarrëveshesh dhe gjykimesh të ngjashme madje edhe të njëjta, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë bëjnë interpretimin e unifikuar të ligjit, të detyrueshëm për t'u mbajtur parasysh nga të gjitha gjykatat në shqyrtimin dhe zgjidhjen e çështjeve. Në këtë mënyrë krijohen kushtet për të patur uniformitet në zbatimin e ligjit në nivel kombëtar nga të gjitha gjykatat më të ulëta. Ky interpretim uniform i ligjit nga ana e gjykatave është i lidhur ngushtë me respektimin e parimeve kushtetuese të sigurisë juridike, të barazisë së shtetasve para ligjit, të trajtimit të rasteve të ngjashme në mënyrë të njëjtë etj. Ndërsa ndryshimi i praktikës gjyqësore bëhet në rrethanat kur për një çështje të caktuar ekziston një praktikë gjyqësore e njëjtë dhe e konsoliduar në shqyrtimin e çështjeve nga gjykatat, por kjo praktikë gjyqësore, kryesisht për shkak të ndryshimit historik të rrethanave sociale dhe ekonomike, duhet të ndryshohet sepse konsiderohet e tejkaluar nga koha, e papranueshme apo edhe e gabuar.

7.2. E drejta e ankimit kundër një vendimi gjyqësor në Gjykatën e Lartë

Kushtetuta, në nenin 135 të saj, parashikon se pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, si dhe nga gjykatat e apelit e gjykatat e shkallës së parë. Ndërsa në nenin 141 të Kushtetutës parashikohet se Gjykata e Lartë ushtron juridiksion gjyqësor rishikues dhe fillestar.

Prandaj, ligjvënësi ka parashikuar që vendimet e dhëna nga gjykatat e apelit, mund të kundërshtohen nga palët pjesëmarrëse në gjykimin civil, nëpërmjet paraqitjes së rekursit përpara Gjykatës së Lartë.

Në raste përjashtimore, mund të kundërshtohen drejtpërdrejt në Gjykatën e

Lartë, vetëm vendimet e dhëna nga gjykatat e shkallës së parë lidhur me konfliktin mbi juridiksionin ose kompetencën lëndore apo tokësore për shqyrtimin e çështjes.

Po kështu, Gjykata e Lartë investohet drejtpërsëdrejti edhe në rastet kur palët pjesëmarrëse në një gjykim civil paraqesin kërkesë për rishikimin e një vendimi gjyqësor të dhënë në çfarëdo shkallë gjykimi, i cili, sipas ligjit procedural, ka marrë formën e prerë dhe është i paankimueshëm.

7.3. E drejta kushtetuese e ankimit kundër vendimit gjyqësor të një gjykate më të ulët në një gjykatë më të lartë. Kufizimet e saj

E drejta e ankimit kundër vendimit të dhënë nga një gjykatë më e ulët në një gjykatë më e lartë, është njëra prej të drejtave të njeriut, e njohur dhe e garantuar shprehimisht nga neni 43 i Kushtetutës, si dhe në kuadër të së drejtës për t'u dëgjuar nga gjykata, e parashikuar kjo nga neni 6 i KEDNJ.

Ushtrimi i kësaj të drejte kushtetuese varet nga vetë subjekt të cilit Kushtetuta dhe ligji ia njeh, pra është një mundësi e çdo individi për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar në një gjykatë më të lartë vendimin e dhënë ndaj tij nga një gjykatë më e ulët.

Prandaj, e drejta e ankimit kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, e parashikuar nga neni 43 i Kushtetutës, në parim është e garantuar edhe në Kodin e Procedurës Civile, si e drejta e palëve pjesëmarrëse në gjykim për të paraqitur, përpara gjykatës së apelit, ankim ndaj vendimeve të ndërmjetme, jopërfundimtare apo përfundimtare të dhëna nga gjykata e shkallës së parë.

Legjislacioni ynë proceduralo-civil, përveçse kur nuk janë respektuar rregullat formale-procedurale të paraqitjes së ankimit, si p.sh. afati, nënshkrimi i rregullt etj., nuk parashikon kufizime, për efekt të pranueshmërisë për shqyrtim nga gjykata e apelit të ankimit ndaj një vendimi gjyqësor të dhënë nga ana e gjykatës së shkallës së parë.

Ankimi mund të bëhet si për motive të lidhura me faktin dhe vlerësimin e provave, ashtu edhe për motive të lidhura me ligjin e zbatueshëm për zgjidhjen e çështjes nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e apelit, në përmbushje të funksionit të saj rishikues, ka detyrimin ta shqyrtojë ankimin e paraqitur si një gjykatë fakti dhe ligji, duke dhënë vendimin e saj për zgjidhjen e çështjes.

Sipas Kushtetutës dhe legjislacionit shqiptar, në harmoni të plotë me KEDNJ dhe me praktikën gjyqësore të GJEDNJ, ndonëse përbën njërën nga të drejtat më të spikatura të njeriut dhe një element thelbësor garantues të vetë procesit të

rregullt ligjor në një shtet të së drejtës, e drejta e kundërshtimit të një vendimi gjyqësor së paku në një gjykatë më të lartë, nuk është një e drejtë absolute. Njohja dhe ushtrimi i kësaj të drejte mund të kufizohet, në raste dhe rrethana të caktuara, gjithmonë nëpërmjet parashikimeve të shprehura në ligj, por pa e cënuar thelbin e arsyes së ekzistencës së kësaj të drejte kushtetuese të njeriut.

Kështu, deri më sot, në fushën e gjykimeve civile, në legjislacionin shqiptar është parashikuar kufizimi i së drejtës së ankimit në një gjykatë të shkallës më të lartë kundër disa prej kategorive të vendimeve gjyqësore jopërfundimtare dhe përfundimtare të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë. Këto vendime, për këtë arsye, konsiderohen vendime gjyqësore të formës së prerë dhe të paankimueshme në një gjykatë më të lartë.

7.4. Mjetet e ankimit

Realizimi i së drejtës kushtetuese të ankimit kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë bëhet nëpërmjet mjeteve procedurale civile të ankimit. Me anë të mjeteve të ankimit, palët në gjykim i kërkojnë gjykatës më të lartë që të prishë ose ndryshojë vendimin e dhënë nga gjykata më e ulët, duke e zgjidhur çështjen në mënyrën që sipas pretendimit të tyre është e ligjshme, e drejtë dhe në përputhje me interesat e tyre.

Mjetet procedurale civile të ankimit janë të zakonshme ose të jashtëzakonshme.

Mjetet e zakonshme të ankimit ushtrohen gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes, në faza dhe shkallë të ndryshme të saj. Mjet i zakonshëm i ankimit mund të ushtrohet nga ana e palës gjyqumbëse për të kundërshtuar një vendim gjyqësor jopërfundimtar ose përfundimtar, pa u kufizuar në shkaqe e pretendime, të lidhura këto si me ligjin e zbatueshëm, ashtu edhe me rrethanat e faktit të pranuar si të vërtetuara nga ana e gjykatës vendimi i së cilës kundërshtohet me ankim. I tillë është ankimi në gjykatën e apelit.

Me anë të mjetit të zakonshëm procedural të ankimit, nga pala pjesëmarrëse në gjykim mund të kundërshtohen, për çështje të faktit dhe të ligjit të zbatueshëm, nëse këtë të drejtë e parashikon shprehimisht ligji, edhe disa prej vendimeve të ndërmjetme të dhëna nga gjykata e shkallës së parë. Të tilla janë ankimet e veçanta në gjykatën e apelit.

Nëpërmjet mjetit të zakonshëm të ankimit, palët pjesëmarrëse në gjykim, mund të kundërshtojnë, për çështje të ligjit të zbatueshëm, vendimet e dhëna nga gjykata e shkallës së parë lidhur me çështjet e ekzistencës së juridiksionit

gjyqësor ose të kompetencës lëndore apo tokësore për shqyrtimin e çështjes. Të tilla janë ankimet e veçanta drejtpërdrejt në Gjykatën e Lartë.

Në të gjitha këto raste, nëse janë respektuar afatet e paraqitjes dhe kërkesat e tjera formalo-procedurale të hartimit dhe nënshkrimit të ankimit, gjykata më e lartë, pra sipas rastit, gjykatat e apelit apo Gjykata e Lartë, ka detyrimin ta shqyrtojë dhe të zgjidhë çështjen.

Së fundi, me anë të mjetit të zakonshëm të ankimit, palët pjesëmarrëse në gjykim, mund të kundërshtojnë vendimet jopërfundimtare ose përfundimtare të gjykatës së apelit dhe eventualisht të gjykatës së shkallës së parë, vetëm për disa çështje të kufizuara, të lidhura me ligjin e zbatueshëm. Ky mjet procedural ankimi është rekursi në Gjykatën e Lartë.

Në dallim nga mjetet e tjera të zakonshme të ankimit, nëse me anë të rekursit parashtrihen vetëm pretendime të lidhura me rrethanat e faktit dhe çmimin e provave nga gjykatat më të ulëta apo ai (rekursi) nuk i përmbahet shkaqeve kufizuese të vendosura nga ligji për ushtrimin e tij, atëherë Gjykata e Lartë vendos të mos e pranojë për shqyrtim rekursin.

Ndërsa, mjetet e jashtëzakonshme të ankimit ushtrohen në rrethana rigorozisht të përcaktuara, pasi ka përfunduar gjykimi i një çështjeje civile dhe vendimi gjyqësor për zgjidhjen e saj ka marrë formë të prerë dhe është i paankimueshëm. E tillë është kërkesa për rishikimin e vendimit gjyqësor e cila mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës së Lartë.

Nëse me anë të kërkesës për rishikim, parashtrihen pretendime të lidhura me prova dhe rrethana të faktit të cilat janë shqyrtuar njëherë nga gjykatat dhe nuk kanë rëndësinë e kërkuar nga ligji për efekt të rihapjes së gjykimit të çështjes, si edhe nëse është paraqitur jashtë afateve procedurale dhe në kundërshtim me kërkesat formale-procedurale për ushtrimin e saj, atëherë Gjykata e Lartë vendos të mos e pranojë për shqyrtim kërkesën për rishikim.

7.4.1. Rekursi si mjet ankimi

Rekursi, si mjet procedural i zakonshëm ankimi, ushtrohet kundër vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Në sistemin tonë gjyqësor dhe në të drejtën tonë procedurale civile, vendimet jopërfundimtare apo përfundimtare të dhëna nga gjykata e apelit në përfundim të shqyrtimit të çështjes, konsiderohen të formës së prerë.

Megjithatë, ligjvënësi i ka njohur palës gjyqumbëse të drejtën për ta

kundërshtuar vendimin e gjykatës së apelit në Gjykatën e Lartë, nëpërmjet ushtrimit dhe paraqitjes së rekursit.

Me anë të rekursit, duke parashtruar pretendimet dhe motivet e saj në mbështetje të kërkesës eventuale për prishjen ose ndryshimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë të dhënë nga gjykata e apelit, është pala ankuese gjyqumbëse ajo që vë në lëvizje Gjykatën e Lartë për të shqyrtuar çështjen dhe për të kontrolluar e verifikuar zbatimin e normave të së drejtës procedurale e të asaj materiale në gjykimin dhe dhënien e këtij vendimi gjyqësor të rekursuar.

Pretendimet dhe shkaqet e rekursit duhet të synojnë të argumentojnë dhe provojnë përpara Gjykatës së Lartë, vetëm shkelje apo zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe/ose procedurale, në gjykimin dhe në vendimin e dhënë nga gjykatat më të ulëta. Pala ankuese ka barrën e provës të shpjegojë dhe vërtetojë lidhjen shkakësorë ndërmjet shkeljes ose zbatimit të gabuar të ligjit dhe zgjidhjes së çështjes që rezulton nga disponimet e vendimit të dhënë nga gjykata e apelit.

Nuk mund të ngrihen në recurs pretendime të lidhura thjesht me rrethanat e faktit të vlerësuara dhe të pranuar nga gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit. Çështjet që lidhen me pranimin e rrethanave të faktit, në bazë të vlerësimit dhe çmimit të provave sipas bindjes së tyre të brendshme nga ana e gjykatave të faktit, nuk janë në objektin e gjykimin të Gjykatës së Lartë.

7.4.2. Kundërrekursi

Palës, kundër të cilës është paraqitur rekursi, i është njohur e drejta për t'u mbrojtur në dy mënyra, të cilat gjejnë mbështetje në nenet 477 dhe 483 të K.Pr.C., ku parashikohet se:

Neni 477 i K.Pr.C.: "Pala kundër së cilës është paraqitur rekursi, mund ta kundërshtojë atë me kundërrekurs, i cili duhet t'i njoftohet atij që ka bërë rekursin në vendbanimin e tij brenda 20 ditëve nga njoftimi i rekursit. Në mungesë të këtij njoftimi nuk mund të paraqesë kundërrekurs, por vetëm mund të marrë pjesë në diskutim me gojë. Për kundërrekursin zbatohen rregullat e parashikuara në nenet 456 dhe 457 të këtij Kodi.

Neni 483, paragrafi i dytë: "Pas relativitetit kryetari fton avokatët e palëve të paraqesin mbrojtjen e tyre."

Së pari, në zbatim të nenit 477 në lidhje me pikën 2 të nenit 483 të K.Pr.C., në formën e prapësimit të rekursit, nëpërmjet parashtrimit të qëndrimit dhe të shpjegimeve me karakter ligjor të bëra në seancë gjyqësore gjatë paraqitjes së mbrojtjes nga avokati i kësaj pale.

Së dyti, në zbatim të nenit 477, nëpërmjet kundërrekursit, pra me anë të paraqitjes së një “rekursi” kundër palës gjyqumbëse ankuese që nga ana e saj ka ngritur rekursin përpara Gjykatës së Lartë.

Elementët formalë të paraqitjes, shkaqet dhe argumentet që duhet të përmbajë kundërrekursi janë të njëjta me atë të rekursit. Në thelb, kundërrekursi është akti me anë të të cilit, në mënyrë të përmbledhur, i paraqiten Gjykatës së Lartë arsyet dhe shkaqet e lidhura me ligjin e zbatueshme, për të cilat, pala kundër së cilës është ngritur rekursi, pretendon se vendimi gjyqësor i kundërshtuar është i drejtë ndërsa shkaqet dhe motivet e paraqitura në rekursin e palës gjyqumbëse nuk gjejnë mbështetje në ligj.

Por në dallim nga rekursi, kundërrekursi nuk është e nevojshme që të plotësojë një nga shkaqet ligjore të parashikuara në nenin 472 të K.Pr.C. Ai nuk është rekursi i mirëfilltë, pra nuk është një mjet i zakonshëm ankimi kundër vendimit të gjykatës së apelit. Në këtë kuptim, kundërrekursi, jo vetëm që nuk mund të paraqitet nëse më parë nuk është ushtruar rekurs nga pala gjyqumbëse, por nuk është as akt dhe as mjet procedural që mund të qëndrojë më vete, për të vënë në lëvizje Gjykatën e Lartë. Kjo Gjykatë, nuk e shqyrton kundërrekursin nëse pala gjyqumbëse ankuese heq dorë nga rekursi. Po kështu, kundërrekursi nuk shqyrtohet edhe në rastin kur dhoma e këshillimit të kësaj gjykate ka disponuar me mospranim të rekursit.

Prandaj, kundërrekursi i shërben vetëm lehtësimit dhe qartësimin përpara gjykatës të pozicionit dhe të linjave të mbrojtjes së palës kundër së cilës është ngritur rekursi, në lidhje me bazueshmërinë në ligj të vendimit gjyqësor të kundërshtuar, si edhe çështjet ligjore të ngritura për kundërshtimin e tij, përpara se ky rekurs të shqyrtohet në dhomën e këshillimit ose në seancë gjyqësore nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë.

7.5. Shkaqet e rekursit

Në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile parashikohet se:

“Vendimet e shpallura nga gjykata e apelit dhe ato të gjykatës së shkallës së parë, në rastet që përcaktohen nga ky Kod, mund të ankimohen me rekurs në Gjykatën e Lartë vetëm kur:

- a. Nuk është respektuar ose është zbatuar keq ligji;*
- b. Ka shkelje të rënda të normave procedurale (neni 467 i këtij Kodi);”*

Është thelbësore për palët, e veçanërisht për avokatët e tyre, si dhe për gjykatat që të njohin, përvetësojnë dhe të zbatojnë me korrektësi e saktësi kuptimin e shkaqeve ligjore të ngritjes së rekursit, se cilat janë bazat dhe kufijtë e shtrirjes së

këtyre shkaqeve për efekt të pranueshmërisë së rekursit nga dhoma e këshillimit, si edhe për shqyrtimin më pas të këtij rekursi, në seancë gjyqësore, nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë.

7.5.1. Rregullat bazë për pranueshmërinë dhe për shqyrtimin e shkaqeve të rekursit

Rekursi, si mjeti procedural me anë të të cilit parashtrohet kundërshtimi i vendimit të gjykatës së apelit, në mënyrë që të pranohet për shqyrtim paraprak në dhomën e këshillimit, duhet të përmbajë elementët e kërkuar dhe të respektojë procedurat formale lidhur me hartimin dhe paraqitjen e rekursit në Gjykatën e Lartë, sikurse janë ato të parashikuara nenet 453-455 të K.Pr.C.

Por edhe në përmbajtje, motivet dhe argumentet e parashtruara në rekurs, duhet t'i referohen dhe të përmbajnë shkaqe ligjore e argumente të cilat lidhen me ligjin material e procedural të zbatueshëm dhe që e bëjnë rekursin të pranueshëm, duke hapur në këtë mënyrë rrugën gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë.

Kështu, në mënyrë që rekursi i paraqitur të jetë i pranueshëm për shqyrtim paraprak në Kolegjin Civil, në dhomën e këshillimit, e që të shërbejë më pas si argument për të cënuar vendimin gjyqësor të kundërshtuar me atë rekurs në seancë gjyqësore, ai duhet t'i përmbahet domosdoshmërisht njërit prej shkaqeve të parashikuara në ligj.

Më tej, rekursi duhet të argumentojë, qartë dhe konkretisht, se cilat janë ato shkelje dhe zbatime të gabuara të ligjit, në procedim dhe/ose në gjykim, të tilla që përbëjnë motiv ligjor për të disponuar prishjen ose ndryshimin e vendimeve të gjykatave më të ulëta nga ana e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Shkaqet ligjore të paraqitura në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, duhet të gjejnë mbështetje dhe të përfshihen në njërën prej kategorive të rasteve që parashikohen nga shkronjat “a” dhe “b” të nenit 472 të K.Pr.C.

Rastet që përfshihen në secilën kategori të shkaqeve ligjore janë ato që, në interpretim dhe në zbatim të drejtë të ligjit, kualifikohen si zbatim i gabuar i dispozitave konkrete të së drejtës materiale ose si shkelje procedurale të dispozitave konkrete të së drejtës procedurale civile.

Së fundi, zbatimi i gabuar i ligjit material dhe shkeljet procedurale duhet të jenë të një shkalle të tillë që të sjellin Gjykatën e Lartë në përfundimin se vendimi gjyqësor është i padrejtë apo rrjedhë e procesit jo të rregullt ligjor, në kuptim

të neneve 4, 42 pika 1 dhe 43 të Kushtetutës, njëvlefshmërisht të nenit 6 të KEDNJ. Në të kundërt rekursi nuk pranohet për shqyrtim, sikurse parashikon qartë neni 480 i K.Pr.C.: “Gjykata vendos mospranimin e rekursit kur bëhet për shkaqe të tjera nga ato të parashikuara në ligj.”

7.5.1.1. Thelbi dhe rastet e zbatimit të shkakut ligjor “Nuk është respektuar ose është zbatuar keq ligji” parashikuar nga neni 472, shkronja “a”

Në shkronjën “a” të nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile, si shkak ligjor për ngritjen e rekursit parashikohen rastet kur: “Nuk është respektuar ose është zbatuar keq ligji”.

Nga vetë përmbajtja e kësaj dispozite vërehet se ajo përfshin dy kategori rastesh:

- Moszbatimin (mosrespektimin) e ligjit nga gjykata; dhe
- Zbatimin i gabuar të ligjit nga gjykata.

Kjo dispozitë nuk tregon shprehimisht nëse bëhet fjalë për ligjin material ose atë procedural, apo për të dyja së bashku. Megjithatë, nga interpretimi në tërësi i përmbajtjes së nenit 472 dhe shkronjës “b” në veçanti, do të ishte më i drejtë qëndrimi se, në rastin e shkronjës “a” referohen moszbatimi ose zbatimi i gabuar i ligjit material.

Në thelb, rastet e moszbatimit të ligjit apo të zbatimit të gabuar të ligjit kanë të bëjnë me gabimet në gjykim, me ato gabime të gjykatës në identifikimin e së drejtës së zbatueshme, me gabimet e tyre në interpretimin e normave konkrete të së drejtës apo në kualifikimin e gabuar juridik të rrethanave të faktit që janë pranuar të vërtetuara prej po asaj gjykate.

Rastet e “moszbatimit të ligjit” janë ato raste kur, për shkak të gabimit në gjykim, nga ana e gjyqtarit nuk është zbatuar në zgjidhjen e çështjes ligji që duhet të zbatohet prej saj, njësoj sikur kjo e drejtë të mos ekzistonte. Shpesh kjo është rrjedhojë e gabimit në cilësimin ligjor dhe kualifikimin juridik të së drejtës, të normës juridike konkrete të zbatueshme, duke aplikuar norma të tjera juridike që nuk lidhen me natyrën dhe objektin e marrëdhënies juridike, rreth së cilës ka lindur mosmarrëveshja mes palëve në çështjen objekt gjykimi. P.sh., kur gjykata zbaton normat juridike të legjislacionit mbi statusin e nëpunësit civil, pasi ka vërtetuar rrethanat e faktit të një konflikti gjyqësor për një marrëdhënie pune mes një punëdhënësi dhe një punëmarrësi që nuk e gëzon këtë status apo në një marrëdhënie pune që zhvillohet në një sipërmarrje private.

Ndërsa në rastet e “zbatimit të gabuar i ligjit”, ndonëse nga ana e gjyqtarit është identifikuar e drejta e zbatueshme, përsëri ai ka gabuar në kuptimin, interpretimin dhe zbatimin e normave juridike konkrete të kësaj të drejte të zbatueshme. Pra, nga ana e gjykatës, ndonëse është cilësuar drejt marrëdhënia juridike rreth së cilës ka lindur mosmarrëveshja objekt gjykimi, duke identifikuar edhe ligjin e zbatueshëm për të, përsëri nga gjykata është gabuar në zbatimin e drejtë të normës konkrete juridike ku ajo duhet të mbështetet për zgjidhjen e drejtë të çështjes. P.sh., kur nga njëra anë, gjykata me të drejtë identifikon parimet dhe normat juridike të Kodit të Punës si ligj të zbatueshëm për rrethanat e faktit të pranuar prej saj: konfliktit mbi marrëdhëniet e punës mes punëdhënësit dhe punëmarrësit në një sipërmarrje private. Por, nga ana tjetër, ndonëse pranon se zgjidhja e kontratës së punës është bërë në mënyrë të menjëhershme dhe pa shkaqe të arsyeshme, gabon kur disponon në vendimin e saj për rrëzimin e pjeshëm të padisë lidhur me kërkimin e pagave për periudhën e afatit të njoftimit dhe për mosrespektimin e procedurës për zgjidhjen e kontratës së punës.

Në të dy rastet, atij të moszbatimit ose zbatimit të gabuar të ligjit, gabimi në gjykim nga an e gjykatës më të ulët duhet të jetë i asaj natyre dhe shkalle që, vendimi i dhënë prej saj për zgjidhjen e çështjes të rezultojë i ndryshëm nga ai që do të ishte dhënë në rast se do të ishte zbatuar drejt ligji. Pashmangshmërisht, për të garantuar dhënien e drejtësisë, kjo gjendje duhet të sjellë Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë në përfundimin ligjor se vendimi i gjykatës së apelit apo edhe ai i gjykatës së shkallës së parë duhet të prishen ose të ndryshohen sipas parashikimeve të nenit 485 të Kodit të Procedurës Civile.

7.5.1.2. Qëllimi dhe thelbi i zbatimit të shkakut ligjor “*Ka shkelje të rënda të normave procedurale (neni 467 i këtij Kodi)*” parashikuar nga neni 472, shkronja “b”

Në shkronjën “b” të nenit 472 të K.Pr.C, si shkak ligjor për ngritjen e rekursit parashikohen rastet kur “*Ka shkelje të rënda të normave procedurale*” (neni 467 i Kodit)”.

Nga vetë përmbajtja e kësaj dispozite vërehet se ajo përfshin rastet që lidhen me shkeljen e normave procedurale, pra me gabimin në procedim me pasojë dhënien e një vendimi gjyqësor të padrejtë, rrjedhoje e shkeljeve të ligjit procedural, të asaj natyre dhe shkalle, që kanë cënuar një ose disa nga të drejtat të cilat ligji procedural ia njeh palëve në gjykim, si mjete dhe garanci konkrete për respektimin e të drejtës kushtetuese të njeriut për të patur “*një gjykim të drejtë*”

dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj” (neni 42 pika 2 e Kushtetutës).

Nga vetë përmbajtja e shkronjës “b” të nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile rezulton qartë se, përsa i përket “shkeljeve të rënda” procedurale, kjo dispozitë i referohet në mënyrë taksative dhe shteruese-kufizuese rasteve të shkeljeve të rënda procedurale të parashikuara nga neni 467 i këtij Kodi, në baze të të cilave gjykata e apelit duhet të dispononte në prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues.

Në nenin 467 të K.Pr.C. parashikohet se: *“Gjykata e apelit prish vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe e dërgon çështjen për rigjykim kur:*

1. *gjykata e shkallës së parë ka shkelur dispozitat mbi juridiksionin dhe kompetencën;*
2. *përbërja e trupit gjykues nuk ka qenë e rregullt apo vendimi nuk është nënshkruar nga anëtarët e tij;*
3. *gjykata ka vendosur pushimin e çështjes në kundërshtim me rregullat e përcaktuara nga ky Kod;*
4. *çështja është gjykuar në mungesë të pjesëmarrësve në proces, pa pasur dijeni për ditën e gjykimit;*
5. *nuk është formuar drejt ndërgjyqësia;*
6. *kur mungojnë ose janë të pavlefshme padia, procesverbali gjyqësor, ankimi, si dhe çdo dokument tjetër që ka ndikuar në dhënien e vendimit.*
7. *kur lind nevoja për marrjen e një prove vendimtare, marrja e së cilës është e vështirë në shkallë të dytë.”*

Në tërësi, nga shqyrtimi i përmbajtjes së dispozitës së nenit 467, rezulton se aty parashikohen raste tipike dhe thelbësore të shkeljeve të rënda procedurale, të cilat cenojnë dukshëm dhe rëndë respektimin e garancisë së palëve në gjykim për të patur një gjykim të drejtë nëpërmjet një procesi të rregullt ligjor. Këto shkelje procedurale janë të tilla që sjellin vetvetiu si pasojë pavlefshmërinë e gjykimit civil të realizuar nga gjykatat apo konstatimin e nulitetit të vendimit gjyqësor që ka zgjidhur çështjen, pavarësisht faktit nëse ajo gjykatë e ka zbatuar ose jo drejt ligjin material në dhënien e atij vendimi.

Nëse konstatohet, edhe kryesisht, se shkeljet e rënda procedurale që neni 472 shkronja “b” referon tek dispozita e nenit 467 të K.Pr.C, kanë ndodhur gjatë shqyrtimit të çështjes në gjykatën e shkallës së parë, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë disponon prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke e dërguar çështjen për shqyrtim në gjykatën e shkallës së parë. Vendimi i gjykatës së apelit priset, për shkak se kjo gjykatë, nga

ana e saj, duhet të kishte konstatuar shkeljen e rëndë procedurale të gjykatës së shkallës së parë, gjykimi a vendimi i së cilës për këto shkaqe është i pavlefshëm, duke i mohuar palëve në proces, shkallën e parë të gjykimit.

Nëse konstaton, edhe kryesisht, se këto shkelje të rënda kanë ndodhur vetëm gjatë shqyrtimit të çështjes në gjykatën e apelit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë disponon vetëm prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjet për rishqyrtim po në atë gjykatë me tjetër trup gjykues. Palët në gjykim, kanë të drejtën kushtetuese që të kërkojnë, me anë të ankimit, shqyrtimin të çështjes së tyre së paku në një gjykatë më të lartë. Nëse gjykimi në apel konstatohet të jetë me shkelje të rënda procedurale, atëherë palëve ende nuk u është ezauruar kjo e drejtë kushtetuese, rrjedhimisht Gjykata e Lartë nuk mund të diskutojë dhe as të disponojë lidhur me drejtësinë e vendimit që ishte dhënë nga gjykata e shkallës së parë në atë proces civil.

7.5.1.3. Rastet e zbatimit të shkakut ligjor “*Ka shkelje të rënda të normave procedurale (neni 467 i këtij Kodi)*” parashikuar nga neni 472, shkronja “b”

7.5.1.3.1. Gjykata e shkallës së parë ka shkelur dispozitat mbi juridiksionin dhe kompetencën (neni 467, shkronja “a”)

Respektimi i parimeve dhe i rregullave normative mbi juridiksionin dhe kompetencën lëndore apo funksionale, lidhen me respektimin e vetë parimeve kushtetuese të ndarjes së pushteteve dhe atij të gjykimit të çështjes nga gjykata e caktuar me ligj, në një shtet të së drejtës.

Nëse këto parime e rregulla nuk janë respektuar nga ana e gjykatës, atëherë jemi përpara një procesi jo të rregullt ligjor, përderisa këto shkelje procedurale janë të tilla që sjellin pavlefshmërinë e gjithë procesit dhe është e nevojshme që kjo paligjshmëri të korrigjohet që në momentin që konstatohet një shkelje e tillë.

Këto janë çështje parimore të gjykimit civil, zbatimin e të cilave, gjykata e shkallës së parë duhet ta verifikojë e garantojë, në përgjigje të kërtimeve të palëve, apo edhe kryesisht, në çdo gjendje e shkallë të gjykimit (neni 59), që nga faza përgatitore e gjykimit të çështjes dhe deri në dhënien e vendimit gjyqësor për zgjidhjen e asaj çështjeje.

Nga ana tjetër, nëse kanë pretendime se gjykata e shkallës së parë nuk ka respektuar parimet dhe rregullat mbi juridiksionin e kompetencën lëndore, kundër vendimit të saj që rrëzon kërkesën, palët kanë të drejtën e ushtrimit të

ankimit të veçantë në Gjykatën e Lartë. Por, edhe në rast se gjykatat më të ulëta nuk shprehen kryesisht apo palët nuk paraqesin ankim të veçantë, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, i cili është investuar në gjykim nëpërmjet rekursit të zakonshëm, ka të drejtën dhe detyrimin që të konstatojë shkelje të tilla edhe kryesisht, duke i prishur vendimet e dhëna nga gjykatat më të ulëta për këtë motiv, pavarësisht se një kërkesë e tillë nuk është parashtruar në shkaqet e rekursit.

7.5.1.3.2. Përbërja e trupit gjykues nuk ka qenë e rregullt apo vendimi nuk është nënshkruar nga anëtarët e tij, ose është cenuar parimi i paanësisë (neni 467, shkronja “b”)

Në fakt, kjo dispozitë, përfshin brenda saj tre raste të ndryshme me problematikë komplekse të shkeljeve të rënda procedurale.

(a) Parregullsia në përbërjen e trupit gjykues

Në nenin 43 të Kushtetutës sanksionohet parimi i shqyrtimit të çështjeve gjyqësore nga gjykata e caktuar me ligj, si një nga elementët thelbësorë të garantimit të procesit të rregullt ligjor në një shtet të së drejtës.

Krahas parimeve dhe rregullave procedurale të lidhura me juridiksionin dhe kompetencën, të trajtuara më sipër, garantimi i këtyre parimeve kushtetuese kërkon që të jenë respektuar rigorozisht edhe procedurat për caktimin e gjykatës (gjyqtarit apo të trupës gjyqësore) së cilës i ngarkohet për shqyrtim një çështjeje civile konkrete. Legjislacioni ynë procedural në fuqi parashikon se për shqyrtimin e një çështjeje gjyqësore konkrete gjyqtarët “natyralë“ caktohen nëpërmjet shortit. Palët nuk duhet ta zgjedhin gjyqtarin, sikurse edhe gjyqtari nuk duhet ta përzgjedhë çështjen që do të shqyrtojë. Në rast se procedura e shortit nuk respektohet atëherë përbërja e trupit gjykues nuk është e rregullt.

Një tjetër rast që vlerësohet si ndërtim dhe përbërje e parregullt e trupit gjykues është ai i numrit të gjyqtarëve që duhet të shqyrtojnë një çështje, nëse ajo duhet të gjykohet me përbërje monokratike apo me përbërje kolegjiale dhe nëse duhet të jetë kolegjiale me çfarë numri gjyqtarësh në përbërje të atij kolegji. Nëse çështja gabimisht është shqyrtuar nga gjyqtari i vetëm apo nga një kolegj me numër më të vogël gjyqtarësh nga ajo që urdhëron ligji procedurale, atëherë palët në gjykim legjitimohen të ngrenë rekurs me këtë shkak ligjor sepse kjo konsiderohet si shkelje e rëndë procedurale, e cila cenon thelbin e garancisë të vendosur nga Kushtetuta për gjykimin e çështjes nga një gjykatë e caktuar me ligj.

Por, në situatën e kundërt, pra kur gabimisht çështja është shqyrtuar me përbërje kolegjiale e jo monokratike, apo në kolegj me numër më të madh gjyqtarësh se

ai që parashikon ligji, edhe pse jemi përpara një gabimi në procedim, ky është një gabim dhe shkelje e cila gjithsesi mbetet formale, përderisa konflikti për të cilin palët i janë drejtuar gjykatës, i është nënshtruar shqyrtimit dhe zgjidhjes nga një gjykatë, e cila objektivisht ka ofruar më shumë garanci kushtetuese për një gjykim të pavarur dhe të drejtë sesa ajo me përbërje në numër më të vogël gjyqtarësh që ligjvënësi kishte çmuar dhe ka parashikuar për gjykimin e çështjeve të asaj natyre. Sa më i madh të jetë numri i gjyqtarëve që marrin pjesë në përbërje të kolegjit gjykues të një çështjeje aq më e lartë është garancia për mbrojtjen e interesave të palëve në gjykim. Prandaj, në këtë rast gjykata e apelit apo Gjykata e Lartë, nuk e gjen të mbështetur në ligj një shkak të tillë të ngritur në rekurs për të cenuar vendimin e dhënë nga gjykatat më të ulëta, duke u mjaftuar vetëm me tërheqjen e vëmendjes së tyre për gabimin e lejuar në procedimin me çështjen objekt gjykimi.

Numri i gjyqtarëve që duhet të shqyrtojnë një çështje, sipas llojeve të mosmarrëveshjeve dhe natyrës së gjykimit, përcaktohet nga neni 35 i Kodit të Procedurës Civile, si edhe nga dispozita të tjera të posaçme, sikurse janë nenet 12 dhe 13 të Ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Sipas nenit 35 të K.Pr.C, shqyrtimi i çështjeve civile në shkallë të parë bëhet me trup gjykues të përbërë nga një ose tre gjyqtarë. Edhe kur përfshihet në rastet e shqyrtimit në kolegji prej tre gjyqtarësh, në disa lloje gjykimesh, gjykimi kolegji është i detyrueshëm vetëm nëse këtë e kërkon ndonjëra nga palët që në seancën përgatitore. Në Gjykatën e apelit shqyrtimi i çështjeve civile bëhet me tre gjyqtarë, ndërsa në Gjykatën e Lartë në kolegji të përbërë nga 3 ose 5 gjyqtarë.

Sipas neneve 12 dhe 13 të ligjit nr. 49/2012 çështjet administrative, sipas llojit dhe natyrës së tyre, shqyrtohen në shkallë të parë me trupë gjykuese të përbërë nga një ose tre gjyqtarë, në shkallë të dytë (apel) me 3 ose pesë gjyqtarë dhe, në Gjykatën e Lartë, nga kolegji administrativ i përbërë nga pesë gjyqtarë, përjashtuar zgjidhjen e mosmarrëveshjes mbi kompetencën që shqyrtohet nga ai kolegji por me tre gjyqtarë.

(b) Cenimi i parimit të paanshmërisë në gjykim

Në nenin 43 të Kushtetutës parashikohet edhe garancia sipas së cilës kushdo ka të drejtën e gjykimit nga një gjykatë e paanshme.

Në pajtim dhe zbatim të Kushtetutës, Kodi i Procedurës Civile, në nenin 72 të tij parashikon shprehimisht një numër rastesh kur, gjyqtari i çështjes duhet

të heqë dorë nga gjykimi i saj apo të kërkohet nga palët përjashtimi i tij nga trupi gjykues për shkak ekzistencës së gjendjes së njëanshmërisë së gjyqtarit në kuptimin objektiv të saj, pra pavarësisht nga sjellja dhe qëndrimi subjektiv që mban gjyqtari në gjykimin e çështjes.

Njëkohësisht, gjyqtari gjendet në kushtet e njëanshmërisë dhe mungesës së neutralitetit edhe në rast të tjera kur, ndonëse nuk ekzistojnë shkaqe objektive njëanshmërie, në shkelje të ligjit apo të etikës gjyqësore, me sjelljen dhe qëndrimet e tij, gjatë veprimtarisë gjyqësore ose jashtëgjyqësore, ka bërë deklarime publike dhe ka kryer veprime ose shfaqur opinione që shprehin pozicionim emocional ose interesash të lidhura me ndonjërin nga palët pjesëmarrëse në gjykim apo është shprehur paraprakisht për mënyrën e gjykimit dhe të zgjidhjes së çështjes që i është caktuar për gjykim.

(c) Vendimi gjyqësor nuk është nënshkruar nga të gjithë gjyqtarët që përbëjnë trupin gjykues

Në pikën 1 të nenit 308 të Kodit të Procedurës Civile parashikohet se:

“Vendimi duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues që kanë marrë pjesë në dhënien e tij. Gjyqtari, mendimi i të cilit ka mbetur në pakicë, shkruan fjalën “kundër” dhe nënshkruan vendimin.”

E vetmja mënyrë dhe mjet nëpërmjet të cilit gjyqtari shprehet publikisht mbi motivet dhe qëndrimin e tij për kërkesat e ngritura në gjykim dhe për zgjidhjen përfundimtare të çështjes, është vendimi gjyqësor. Vendimet e ndërmjetme, jo përfundimtare apo përfundimtare pasqyrohen apo përpilohen me shkrim. Prandaj, nënshkrimi i vendimit gjyqësor të arsyetuar nga ana e gjyqtarit finalizon dhe vërteton se cili ka qenë vlerësimi i tij mbi rrethanat e faktit të provuara në gjykim. Po kështu, është veprimi me anë të të cilit vërtetohet se cili ka qenë ligji i zbatueshëm i përcaktuar prej tij dhe interpretimi që atij i bëhet nga ana e gjyqtarit për këto rrethana të faktit, cilat janë arsyet, konkluzionet dhe disponimi i tij për zgjidhjen e kërkesave të palëve gjatë gjykimit apo për zgjidhjen e çështjes në përfundim të hetimit gjyqësor.

Pavarësisht nga fakti nëse vendimi gjyqësor përmban elementët e kërkuar nga neni 310 i Kodit të Procedurës Civile, është ose jo i arsyetuar, mungesa e nënshkrimit të tij nga gjyqtari e bën atë të pavlefshëm në kuptim të nenit 123 dhe të shkronjës “b” të nenit 467 të këtij Kodi.

7.5.1.3.3. Gjykata ka vendosur pushimin e çështjes në kundërshtim me rregullat e përcaktuara nga ky Kod (neni 467, shkronja “c”)

Si rregull, gjykimi civil ndjek fazat e tij të përcaktuara nga ligji procedural për çdo shkallë gjykimi dhe, në përfundim të hetimit gjyqësor, gjykata jep një vendim përfundimtar për zgjidhjen në themel të çështjes.

Megjithatë, në rrethana të caktuara të faktit dhe të ligjit të zbatueshëm, gjykata jep vendim jo përfundimtar pa e zgjidhur në themel çështjen. Sipas nenit 127 të K.Pr.C.:

“Vendimet jo përfundimtare janë vendimet e pushimit të çështjes, me të cilët gjykata ose gjyqtari në rastet e parashikuara në këtë Kod i japin fund procesit gjyqësor civil pa e zgjidhur çështjen në themel, si edhe çdo vendim tjetër që pa e zgjidhur çështjen në themel i jep fund procedimit gjyqësor të filluar.”.

Rastet se kur gjykata mund të vendosë pushimin e gjykimit të çështjes janë taksative dhe të parashikuara shprehimisht në dispozita të tjera konkrete të K.Pr.C. Kështu, në nenin 299 parashikohet se vendoset pushimi i gjykimit, kur asnjë palë nuk kërkon rifillimin e gjykimit të pezulluar dhe kur paditësi heq dorë nga gjykimi i padisë. Raste të tjera të pushimit të gjykimit janë edhe ato të parashikuara nga nenet 468, 490 etj., të këtij Kodi, kur gjykata vlerëson se ndodhet para një padie që nuk mund të ngrihet, heqjes dorë nga rekursi etj..

Nëse gjykatat më të ulëta vendosin pushimin e gjykimit të çështjes jashtë rasteve të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile dhe në kundërshtim me rregullat e tjera të parashikuara nga ky Kod, atëherë këto vendimi duhet të prishen nga gjykata më e lartë.

Arsyeja është se palët i janë drejtuar gjykatës për zgjidhjen në themel të mosmarrëveshjes mes tyre, mbështetur në garancitë dhe të drejtat kushtetuese që ato kanë për t’u dëgjuar nga gjykata lidhur me themelin në një proces të rregullt ligjor, për thelbin e arsyes për të cilat atë kanë vënë në lëvizje gjykatën. Gabimi në gjykim e procedim i gjykatës që sjell padrejtësisht pushimin e gjykimit të çështjes, përbën shkelje të rëndë procedurale pikërisht për faktin se cenon garancitë kushtetuese të sipërcituara.

7.5.1.3.4. Çështja është gjykuar në mungesë të pjesëmarrësve në proces, pa pasur dijeni për ditën e gjykimit (neni 467 shkronja “ç”)

Kodi i Procedurës Civile përmban rregulla të hollësishme lidhur me mënyrat dhe afatet e njoftimit të akteve procedurale dhe të zhvillimit të seancave gjyqësore. Ndërmjet të tjerave, njoftimi i palëve për vendin, ditën dhe orën e gjykimit është detyrë e gjykatës sepse në këtë mënyrë materializohen të drejtat kushtetuese të palëve për të kërkuar dhe për të mbrojtur para gjykatës të drejtat subjektive dhe interesat e tyre të ligjshme, duke i vendosur në pozita të barabarta në kuadër të një gjykimi kontradiktor.

Prandaj, nëse nga ana e gjykatës nuk janë kryer ose janë të parregullta njoftimet mbi çështjen, ditën dhe orën e gjykimit, atëherë palëve pjesëmarrëse në gjykim u pamundësohet ushtrimi i të drejtave kushtetuese të tyre të sipërcituara, duke shkelur në këtë mënyrë parimin themeltar të zhvillimit të procesit të rregullt ligjor.

Një gjendje e tillë e procedimit, konstatohet edhe kryesisht nga gjykata më e lartë që procedon me çështjen. Prandaj, nëse nga gjykata më e lartë vërtetohet se mungesa e palës në gjykim ka ardhur për shkak të mos njoftimit apo parregullsisë së njoftimit, kjo është arsye për ta bërë të pavlefshëm të gjithë gjykimin, rrjedhimisht edhe vendimin e dhënë në atë gjykim nga gjykatat më të ulëta.

7.5.1.3.5. Nuk është formuar drejtë ndërgjygjësia (neni 467, shkronja “d”)

Një nga aspektet kryesore të procesit gjyqësor civil është ndërtimi i rregullt i ndërgjyqësisë, pra përcaktimi i saktë i palëve që duhet të marrin pjesë në proces. Ndërgjyqësia është një nga parakushtet procedurale, me pasoja direkte në vlefshmërinë e gjykimit, e cila lidhet edhe me pamundësinë e gjykatës për të hyrë në shqyrtimin e themelit të çështjes. Përcaktimi i saktë i ndërgjyqësisë në një proces civil ka lidhje direkt me njërin nga dy kushtet themelore që duhet të plotësojë padia, me atë të legjitimitetit për të vepruar, pra me përcaktimin e personit të cilit i përket interesi për të ngritur padi dhe personit kundrejt të cilit padia duhet të ngrihet.

Gjykata nuk mund të krijojë vetë ndërgjyqësi të ndryshme nga ajo që kërkojnë palët, por në rastin e një ndërgjyqësie të gabuar gjykata ka detyrimin t'i orientojë palët për rregullimin e ndërgjyqësisë, pavarësisht së është në diskrecion të këtyre të fundit për të vendosur nëse do ta rregullojnë ndërgjyqësinë apo jo.

Nëpërmjet gjykimit kontradiktor, gjykata mund të shqyrtojë çështjen e ngritur para saj nga ana e paditësit, nëse qëndrojnë ose jo kërkimet e ngritura në padi, jo

vetëm duke dhënë një vendim të drejtë e të bazuar në ligj, por edhe një vendim gjyqësor të tillë që të sjellë efekte juridike kundrejt palëve në gjykim. Nëse ndërëgjygjësia ndërtohet në mënyrë të gabuar, kjo gjendje e cila sipas ligjvënësit vlerësohet si shkelje e rëndë procedurale, ka për pasojë prishjen e vendimeve gjyqësore dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim.

Kjo shkelje e rëndë procedurale shqyrtohet dhe kryesisht nga gjykatat, si nga gjykata e apelit, ashtu edhe nga Gjykata e Lartë, pa qenë e domosdoshme që ato të jenë pjesë e ankimit apo rekursit të palës që investon gjykatën.

7.5.1.3.6. Kur mungojnë ose janë të pavlefshme padia, procesverbali gjyqësor, ankimi, si dhe çdo dokument tjetër, që ka ndikuar në dhënien e vendimit (neni 467, shkronja “e”)

Gjykimi civil ndërtohet dhe mbi të gjitha realizohet e verifikohet, nëpërmjet akteve procedurale. Nga njëra anë, parashtrimi i kërkimeve, prapësimeve, shpjegimeve dhe paraqitja e marrja provave nga ana e palëve, e nga ana tjetër, veprimet, qëndrimet, orientimet dhe vendimet e gjykatës që shqyrton çështjen, duhet të gjejnë pasqyrim dhe bashkëlidhen në dosjen gjyqësore të çështjes.

Mungesa e këtyre akteve në dosjen gjyqësore për çfarëdo lloj motivi, paraqitja e parregullt e këtyre akteve, mungesa e nënshkrimit apo rregullsisë së nënshkrimit kur kjo kërkohet sipas ligjit, etj., shkelje të tilla këto që i bëjnë aktet e sipërpërmendura të pavlefshme, mos pasqyrimi në procesverbalin e seancës të veprimeve, deklarimeve dhe akteve që paraqesin palët dhe veprimeve, orientimeve dhe vendimeve që merr gjykata apo mos nënshkrimi i këtij procesverbali gjyqësor nga kryesuesi i seancës, si edhe të tjera mangësi e shkelje procedurale që ndikojnë në dhënien e vendimit gjyqësor, përbëjnë shkak ligjor për t'u ankuar në gjykatën e apelit ose për rekurs në Gjykatën e Lartë.

Mosrespektimi i rregullave të mësipërme sjell një vendim të ndryshëm nga ai që do të arrihej nëse do të ishin respektuar këto rregulla, e bëjnë të pavlefshëm jo vetëm aktin procedural përkatës, por sjellin edhe prishjen e vendimit përfundimtar të gjykatës, duke e dërguar çështjen për rigjykim në gjykatën ku ka ndodhur ajo shkelje e rëndë procedurale.

7.5.1.3.7. Gjykata nuk është shprehur për të gjitha kërkesat e parashtruara nga palët në padi dhe që përbëjnë objektin e mosmarrëveshjes midis palëve ndërgjyqëse (neni 467, shkronja “ë“)

Në nenin 6 të K.Pr.C parashikohet se: *“Gjykata që gjykon çështjen duhet të shprehë mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet”*

Ky është një rregull procedural parimor dhe rigorozisht i detyrueshëm për t’u zbatuar nga gjykata që shqyrton çështjen. Sipas këtij rregulli duhet që gjykata të shprehë për atë që kërkohet në objektin e padisë dhe vetëm për atë që kërkohet në objekt. Këtë detyrim gjykata duhet ta përmbushë jo vetëm në arsyetim sepse ajo duhet të shprehë për të gjitha këto kërkime shprehimisht në dispozitivin e vendimit. Nga ana tjetër, duhet që lënda e arsyetuar në vendimin e gjykatës të përputhet me atë që vendoset në dispozitivin e atij vendimi. Së fundi, vendimi i gjykatës si në arsyetim edhe në dispozitivin e tij, duhet të kufizohet domosdoshmërisht brenda objektit të kërimit të palëve në gjykim.

Prandaj, gjykata kryen shkelje procedurale si në rastin kur shprehë më shumë se ajo që është kërkuar në objekt, ashtu edhe kur ajo nuk shprehë për të gjitha ato që kërkohen nga paditësi në padi apo i padituri në kundërpadi, kjo për faktin se gjykata nuk mund të dalë jashtë kufijve procedurale të gjykimit midis palëve në konflikt.

7.5.1.3.8. Kur lind nevoja për marrjen e një prove vendimtare, marrja e së cilës është e vështirë në shkallë të dytë (neni 467, shkronja “ë“)

Në nenin 14 të K.Pr.C. parashikohet se: *“Gjykata ka për detyrë të zhvillojë një proces të rregullt nëpërmjet garantimit të zhvillimit të një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm në përputhje me ligjin.”*

Zgjidhja e drejtë e çështjes duke dhënë një vendim të drejtë e të bazuar në ligj, si edhe të gjitha garancitë dhe të drejtat e parashikuara nga Kushtetuta jetësohen në procesin civil, mes të tjerave, nëpërmjet zhvillimit të një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes, në të cilin kryen të gjitha veprimet procedurale për të sqaruar dhe analizuar kërkesat, prapësimet dhe çdo pretendim të palëve që lidhen me objektin e gjykimit.

Nëse gjykata nuk bën një hetim të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes, ajo ka cenuar vetë procesin e rregullt ligjor duke legjitimuar të drejtën e palës

gjyqumbëse për të ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë kundër vendimit të dhënë nga gjykata më e ulët. Këtë mangësi të hetimit gjyqësor të çështjes nuk mund ta riparojë Gjykata e Lartë për shkak se ajo është vetëm gjykatë ligji dhe jo fakti.

7.5.1.3.9. Shkelje të tjera të rënda procedurale, që sjellin cenimin e vendimit të gjykatës

Deri në hyrjen në fuqi të ligjit nr. 122/2013, në nenin 472 të K.Pr.C përmbahej edhe një dispozitë tjetër (shkronja “c”), me të cilën, si shkak i rekursit në Gjykatën e Lartë, parashikohej edhe motivi “*Për shkelje procedurale që kanë ndikuar në dhënien e vendimit*”.

Është e kuptueshme se jo çdo shkelje e ligjit procedural përbën shkak për rekurs dhe cenimin e vendimit të gjykatës ku ajo ka ndodhur. Por, praktika gjyqësore është e pasur me raste se kur shkeljet procedurale konsiderohen janë të tilla që kanë ndikuar në drejtësinë e dhënies së vendimit. Me shfuqizimin e kësaj dispozite procedurale, duket sikur përtej kategorive të rasteve të parashikuara nga shkronjat “a” dhe “b” të nenit 472, nuk ekzistojnë më shkelje të tjera procedurale të tilla që ndikojnë në ligjshmërinë dhe drejtësinë e vendimit gjyqësor të dhënë, duke sikur janë kufizuar rastet e shkeljeve procedurale se kur ato janë të tilla që legjitimojnë ngritjen e rekursit nga pala dhe prishjen e vendimit të gjykatës më të ulët nga Gjykata e Lartë.

Në të vërtetë, pavarësisht shfuqizimit të ish shkronjës “c” të nenit 472 të K.Pr.C, nuk do të thotë që disa shkelje të tjera procedurale, të cilat nuk përfshihen në rastet e treguara në nenin 467, nuk për bëjnë shkak për ngritjen e rekursit dhe cenimin e vendimit të gjykatës ku ato janë evidentuar. Gjykimi civil duhet të garantojë se ai zhvillohet në kuadër të një procesi të rregullt ligjor. Nëse për shkak të shkeljeve në procedimin civil vlerësohet se është cenuar procesi i rregullt ligjor, atëherë nuk ka asnjë justifikim juridik dhe ligjor formal që të mos cenohet vendimi gjyqësor i gjykatës, ku ato shkelje kanë ndodhur.

Në analizë të fundit, Kodi i Procedurës Civile, në parimet e përgjithshme, qartazi parashikon në nenin 4 të tij se: “*Gjykata kujdeset për zhvillimin e rregullt të procesit gjyqësor*”, ndërsa në nenin 14 parashikon se: “*Gjykata ka për detyrë që të zhvillojë një proces të rregullt ligjor, nëpërmjet garantimit të zhvillimit të një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, në përputhje me ligjin*”. Këto dispozita parimore janë në harmoni me parimet kushtetuese dhe të KEDNJ për garantimin e procesit të rregullt ligjor. Shkeljet e ligjit procedural që përbëjnë mosrespektim të këtyre parimeve

kushtetuese dhe procedurale sjell dështimin e dhënies së drejtësisë. Prandaj shkelje të tilla procedurale janë motiv dhe shkak që me kërkesën e palëve apo edhe kryesisht, Gjykata e Lartë të prishë vendimet e gjykatave më të ulëta, kur janë vërtetuar shkelje të kësaj natyre.

Edhe nëse Gjykata e Lartë do t'i shmangej shqyrtimit të shkaqeve të rekursit mbi këto lloj shkeljesh procedurale me justifikimin se është shfuqizuar shkronja “c” e nenit 472 të K.Pr.C., është Gjykata Kushtetuese ajo që krejt natyrshëm do të shqyrtonte çështjen mbi ankimin e palës së cenuar nga shkelja procedurale dhe do të prishte vendimet gjyqësore duke konstatuar cenimin e procesit të rregullt ligjor.

Në mënyrë të përmbledhur, por jo në kuptimin shterues, nga dispozitat parimore dhe shtjelluese të Kodit të Procedurës Civile, praktika gjyqësore, si edhe ajo e Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ, rezultojnë një numër rastesh ku shkelje të ndryshme procedurale janë të tilla që cenojnë procesin e rregullt ligjor dhe pasjellin detyrimin për të disponuar prishjen e vendimit të gjykatës ku ka ndodhur ajo shkelje procedurale.

I tillë është rasti kur gjykata nuk ka pranuar ta shqyrtojë mosmarrëveshjen që i është paraqitur për gjykim nga palët dhe të japë vendim me arsyetimin se “*ligji mungon, nuk i plotë, ka kundërbënie ose është i paqartë*”. Kjo përbën shkelje serioze dhe të rëndë të vetë parimit të përgjithshëm të parashikuar nga neni 2 i K.Pr.C., edhe pse nuk parashikohet shprehimisht nga neni 467 i këtij Kodi, për shkak se lidhet me të drejtën e palës për të marrë një zgjidhje nga gjykata për konfliktin e tij dhe me detyrimin e gjykatës për t'i dhënë zgjidhje dhe për t'u shprehur me vendim për të gjitha konfliktet që paraqiten para saj për shqyrtim.

Po kështu, mund të ndodhë që gjykata të mos respektojë parimin e vendosur në nenin 10 të K.Pr.C.: “*Gjykata mbështet vendimin e saj vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor*”. Nëse faktet mbi të cilat gjykata mbështet vendimin e saj nuk janë nga ato që i janë nënshtruar shqyrtimit dhe hetimit gjyqësor, nuk janë administruar prej saj apo nuk i janë nënshtruar debatit mes palëve, nëse fakte të tilla janë nga ato që duken se kanë krijuar bindjen e brendshme të gjykatës për zgjidhjen e çështjes duke ndikuar në dhënien e vendimit, atëherë në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit duhet të konkludohet se jemi përpara shkeljeve procedurale që e kanë cenuar procesin e rregullt ligjor.

Një rast tjetër që mund të evidentohet si shkelje procedurale që cenon procesin ligjor është shkelja nga ana e gjykatës e parimit kushtetues që “*Vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara*” (neni 141 i Kushtetutës). Nëse gjykata nuk respekton këtë detyrim, atëherë ka shkelur një të drejtë procedurale që mund të ndikojë

në dhënien e një vendimi të drejtë dhe të bazuar në ligj. Mungesa e arsytimit rezulton kur gjykata nuk i ka trajtuar kërkimet e ngritura në padi dhe prapësimet e palëve, nuk ka analizuar provat dhe ligjin e zbatueshëm lidhur me to, por edhe kur gjykata thjesht përshkruan qëndrimet e palëve ose arsytimin e gjykatës më të ulët pa shprehur qëndrimin e saj mbi çështjet e faktit e të ligjit. Nuk është e mjaftueshme për gjykatën që ta zgjidhë “drejtë” çështjen vetëm me atë që shpreh në dispozitiv sepse ajo që disponon gjykata duhet të jetë përfundim i asaj që është analizuar në mënyrë ezauruese në pjesën përshkruese- arsyetuese të vendimit.

Në vendimin nr. 20 datë 13.04.2012, lidhur me këtë problematikë Gjykata Kushtetuese është shprehur se: *“Arsytimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse dhe, që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit, në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm, të cilat e kanë çuar në gjetjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Argumentet e dhëna në vendim duhet të jenë të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik.”*

7.6. Procedura e paraqitjes së rekursit dhe kundër rekursit, në Gjykatën e Lartë

7.6.1. Interesi dhe legjitimiteti i palës për të ushtruar të drejtën e rekursit

Ushtrimi i rekursit në Gjykatën e Lartë, rregullohet në mënyrë të posaçme në dispozitat e neneve 472 dhe vijues të K.Pr.C. Rekursi ushtrohet nga pala pjesëmarrëse në gjykim e cila ka interes dhe legjitimohet për paraqitjen e tij në Gjykatën e Lartë.

Sikurse çdo mjet tjetër procedural ankimi për kundërshtimin e një vendimi gjyqësor, interesin për ushtrimin e të drejtës së rekursit e ka pala gjyqumbëse që pretendon prishjen ose ndryshimin pjesërisht apo tërësisht të vendimit të gjykatës së apelit dhe/ose të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit material ose shkeljes së ligjit procedural, me synimin për të vendosur në vend të drejtën materiale ose personale që i është cenuar nga këto vendime.

Me paraqitjen e rekursit, vetë pala gjyqumbëse që e ushtron atë, ka detyrimin të tregojë se ka një interes të ligjshëm për të mbrojtur interesat e tij personale e pasurore, i cili duhet të ekzistojë që nga momenti i bërjes së kërkesës për recurs

deri në përfundimin e gjykimit nga kolegji civil i Gjykatës së Lartë. Pala që e ushtron duhet të tregojë në rekurs faktet formuese të së drejtës si edhe faktet që kanë cenuar të drejtën e tij, për të cilat vendimi gjyqësor që kundërshtohet, sipas tij, është dhënë në zbatim të gabuar të ligjit material dhe në shkelje të ligjit procedural. Në të kundërt, nuk ka vend për ta pranuar për shqyrtim rekursin nëse ushtrohet nga një palë duke synuar pretendime në mbrojtje të një pale tjetër pjesëmarrëse po në atë gjykim, qoftë kjo edhe palë kundërshtare me palën gjyqësuese. Secila palë duhet të mbrojë vetë interesat e saj të ligjshme në gjykim.

Për sa i përket legjitimitetit, duhet të mbahet parasysh se rekursi mund të ushtrohet vetëm nga ato palë ndaj të cilëve vendimi i rekursuar është i detyrueshëm dhe sjellë efekte. Të tilla janë të gjitha ato subjekte procedurale që kanë qenë palë pjesëmarrëse gjatë gjykimit ku është dhënë vendimi i gjykatës së apelit që kundërshtohet me rekurs, përfshirë personat e tretë. Po kështu edhe avokati i shtetit në mbrojtje të interesave të shtetit sipas ligjit, pavarësisht nëse është thirrur ose jo për të marrë pjesë në gjykim.

7.6.2. Afati për ushtrimin e rekursit

Pala pjesëmarrëse në gjykim, nëse vlerëson vetë se ka interes të ligjshëm dhe legjitimitet, mund ta kundërshtojë vendimin e gjykatës së apelit me anë të rekursit. Por këtë të drejtë kushtetuese dhe ligjore mund ta ushtrojë vetëm brenda afatit të parashikuar shprehimisht në ligj.

Rekursi përpara Gjykatës së Lartë mund të ngrihet nga pala e interesuar brenda 30 ditëve nga e nesërmja e shpalljes ose e njoftimit të vendimit. Ky afat është i prerë dhe nuk mund të zgjatet. Megjithatë, pala e interesuar mund të kërkojë rivendosjen në afat duke u mbështetur në kushtet dhe procedurat e parashikuara në nenet 151 dhe 152 të K.Pr.C.

Rregullat mbi afatin e ushtrimit të rekursit janë parashikuar shprehimisht nga nenet 443, 444 dhe 476 të K.Pr.C ku respektivisht parashikohet se:

“Afati për të bërë rekurs në Gjykatën e Lartë, kundër vendimeve të gjykatës së apelit, është 30 ditë” (Neni 443)

“Afatet e caktuara në nenin e mësipërm janë të prerë dhe fillojnë nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit përfundimtar. Kur çështja është gjykuar nga gjykata e shkallës së parë ose nga gjykata e apelit, në mungesë të njëjës palë, ky afat fillon nga dita e njoftimit të vendimit” (Neni 444)

“Rekursi depozitohet në sekretarinë e gjykatës që ka dhënë vendimin, në afatin prej 30 ditësh nga njoftimi që u është bërë palëve” (Neni 476)

Për palën që ka qenë e pranishme në gjykatën e apelit, në seancën gjyqësore ku është shpallur vendimi që kundërshtohet, afati për ushtrimin e rekursit fillon të ecë nga e nesërmja e ditës kur është shpallur vendimi. Ndonëse në dukje përmbajnë rregullime të ndryshme, ky përfundim rezulton nga interpretimi sistematik i dispozitave të neneve 148, 444, 472 dhe 476 të K.Pr.C, i kryer edhe nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me anë të dy vendimeve unifikuese (vendimet nr.14, datë 16.02.2001 dhe nr.2, datë 27.03.2012).

Mbi bazën e të njëjtit interpretim sistematik të normave procedurale të sipërcituara dhe praktikës së unifikuar gjyqësore, për palën e cila ka qenë në mungesë në ditën e shpalljes së vendimit nga gjykata e apelit, afati 30 ditor për ushtrimin e rekursit fillon nga e nesërmja e ditës kur i është njoftuar ky vendim i gjykatës së apelit e që kundërshtohet prej saj me recurs. Pala në mungesë ka të drejtën për të marrë dijeni për vendimin e dhënë nga gjykata e apelit, së cilës i përgjigjet detyrimi i gjykatës për të realizuar njoftim sipas mënyrave dhe rregullave që parashikohen nga ligji procedural civil. Sikurse për aktet e tjera procedurale, vetëm nga e nesërmja e njoftimit fillon të ecë edhe afati i kundërshtimit me recurs të vendimit të gjykatës së apelit.

Nëse rekursi nuk ushtrohet brenda afatit 30 ditor atëherë vendimi i gjykatës së apelit nuk mund të kundërshtohet më përpara Gjykatës së Lartë. Megjithatë, me dispozitën e nenit 445 të K.Pr.C, ligjvënësi ka parashikuar edhe një afat prekluziv një vjeçar që fillon nga shpallja e vendimit, përtej të cilit, në asnjë rast e rrethanë, nuk mund të justifikohet ushtrimi i rekursit, qoftë edhe nëpërmjet rivendosjes në afat të së drejtës së rekursit. Përjashtim, sipas kësaj dispozite, bëhet vetëm në rastin kur, pala në mungesë ditën e shpalljes së vendimit, vërteton në gjykatë se nuk ka qenë në dijeni të procesit për shkak të pavlefshmërisë së njoftimeve. Nëse gjykata, me vendim të formës së prerë pranon kërkesën për pavlefshmërinë e njoftimeve, rekursi duhet të paraqitet brenda 30 ditëve nga marrja formë të prerë të këtij vendimi, pa qenë nevoja e paraqitjes së ndonjë kërkesë për rivendosjen në afat të rekursit.

7.6.3. Rivendosja në afat e rekursit

Afati 30 ditor për të ushtruar recurs është i prerë. Nëse nuk ushtrohet në afat kjo e drejtë humbet. Por, kur kjo e drejtë nuk është arritur të ushtrohet për shkaqe të arsyeshme që nuk varen saj, pala mund të kërkojë rivendosjen në afat për t'i dhënë mundësi palës së interesuar që të paraqesë recurs para Gjykatës së Lartë.

Pala që bën kërkesën për rivendosje në afat duhet të shpjegojë para gjykatës

shkaqet prej të cilave e humbi afatin e ankimit dhe shkaqet për të cilat e kërkon këtë rivendosje. Njëkohësisht, kërkesa për rivendosjen në afat duhet të shoqërohet edhe rekursin për të cilin kërkon rivendosjen në afat.

7.6.4. Njoftimi i rekursit dhe kundërrekursit

Në nenin 476 të K.Pr.C parashikohet se: *“Rekursi depozitohet në sekretarinë e gjykatës që ka dhënë vendimin, në afatin prej 30 ditësh nga njoftimi që u është bërë palëve.”*

Palës kundër së cilës është ngritur rekursi, i njihet nga ligji e drejta për t’u njoftuar mbi paraqitjen e rekursit nga pala gjyqumbëse si edhe për përmbajtjen e tij, në mënyrë që të vlerësojë nëse do të mbrohet dhe për mënyrën se si do të mbrojnë interesat e saj në gjykimin para Gjykatës së Lartë. Mungesa e njoftimit të rekursit i mohon palës kundërshtare gjyqfituese, por edhe palëve të tjera në atë gjykim, të drejtën e pjesëmarrjes në gjykim dhe të mbrojtjes.

Njoftimi i rekursit bëhet sipas rregullave të përgjithshme për njoftimet.

7.6.5. Struktura, elementët formalë dhe dokumentet që i bashkëlidhen rekursit

Rekursi, për efekt të pranueshmërisë formale për shqyrtimin e tij lidhur me përmbajtjen dhe e shkaqeve për të cilat vihet në lëvizje Gjykata e Lartë, duhet të përmbajë disa elementë formalë-proceduralë, të cilat janë të parashikuara veçanërisht nga nenet 474, 475 dhe 476 të K.Pr.C.

Kështu, sipas dispozitave të sipërcituara, rekursi duhet të përmbajë në strukturën e tij këto elementë:

- **palët ndërgjyqëse.** Në mënyrë që rekursi të jetë i pranueshëm nga pikëpamja formale duhet që të parashikojë në përmbajtje të tij gjeneralitetet e palëve dhe të dhënat e tjera identifikuese ku përfshihen emri, mbiemri, vendbanimi, adresa e saktë, kur është person juridik duhet të tregohet emri, qendra e personit juridik dhe vendi ku ushtron veprimtarinë e tij.

Pala që bën rekursin duhet të ketë identifikuar dhe përcaktuar në mënyrë të saktë se cili është personi kundër të cilit drejtohet rekursi, pra cili është personi kundër të cilit ai e drejton kërkimin e tij. Po kështu, mund të jetë e nevojshme që këtyre palëve t’i njoftohen veprime të ndryshme procedurale të gjykatës.

- **vendimin që kundërshtohet.** Rekursi, duke filluar edhe nga pjesa hyrëse e tij, duhet të tregojë ekstremitetet dhe të individualizojë vendimin që kundërshtohet si edhe një përmbledhje të asaj që është disponuar me atë vendim.

Nëse këto të dhëna nuk janë plotësuar deri në ditën e fundit të afatit 30 ditor për ushtrimin e rekursit për shkak se mungon vendimi i arsyetuar i gjykatës, një mangësi e tillë nuk mund t'i ngarkohet palës që ushtron rekursin. Kjo për shkak se numërtimi dhe nxjerrja e vendimit të arsyetuar e më pas njoftimi i palëve për zbardhjen e tij përtej afateve ligjore është detyrim për gjykatën që ka dhënë vendimin. Në praktikën gjyqësore, për këto rrethana ka gjetur përdorim një mënyrë e veçantë e shprehjes së vullnetit të palës për ta kundërshtuar me rekurs vendimin gjyqësor, shpesh e emërtuar “*zënie afat*”, ku pala tregon se është në pamundësi për të paraqitur shkaqet e rekursit por nuk dëshiron të humbasë për këtë rrethanë të drejtën e rekursit. Në këto raste duhet që ankuesi të konsiderohet brenda afatit të paraqitjes së rekursit por duhet ta plotësojë atë me të gjitha elementët e kërkuara nga ligji pasi të njoftohet posaçërisht për këtë qëllim me depozitim të zbardhur të vendimit gjyqësor që kundërshtohet.

Pavarësisht nga data që mund të përmbajë vetë teksti i rekursit, pala që paraqet atë apo avokati i saj duhet të bëjnë kujdes që të marrin konfirmimin me shkrim të postës nëse ankimi dërgohet në gjykatë me këtë mënyrë, ose të sekretarisë së gjykatës nëse depozitohet aty, lidhur me datën se kur rekursi konsiderohet i depozituar dhe i pranuar prej saj.

- **paraqitjen e përmbledhur të fakteve të çështjes.** Përshkrimi i fakteve në mënyrë të përmbledhur tregon se cila është arsyeja apo motivi për të cilin pala e kundërshton me rekurs vendimin e gjykatës së apelit, duke paraqitur vetëm rrethanat më të rëndësishme të faktit dhe të zhvillimit të gjykimeve në gjykatat më të ulëta, pra çfarë ka ndodhur, përse pala po kërkon të godasë vendimin me rekurs dhe nëse ky është i mbështetur apo jo. Mbi këtë bazë parashtrohen shkaqet ligjore për të cilat ai vendim kundërshtohet me rekurs, cilat janë motivet e zbatimit të gabuar të ligjit material apo të shkeljeve procedurale për shkak të të cilave vendimi duhet të prishet ose të ndryshohet nga Gjykata e Lartë.

- **shkaqet për të cilat kërkohet prishja e vendimit, duke iu referuar normave ligjore mbi të cilat mbështetet.** Pala që ushtron rekursin duhet të shpjegojë se përse e drejta i takon atij dhe jo palës tjetër, duhet të tregojë argumentet ligjore, duke referuar sa më konkretisht të drejtat subjektive të cenuara, të drejtën pozitive materiale dhe/ose procedurale të pazbatuar ose të zbatuar gabim në gjykimin dhe zgjidhjen e çështjes, dispozitat konkrete ligjore ku përmbahet kjo e drejtë (për aq sa është e mundur), si edhe shpjegimin për lidhjen e tyre konkrete me parashikimet e nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile. Shpjegimi i këtyre shkaqeve në rekurs ndihmon fillimisht gjyqtarin e dhomës së këshillimit për të parë nëse ekzistojnë shkaqe ligjore të parashikuara në nenin 472 në mënyrë që t'i hapet rrugë shqyrtimit të saj në seancë gjyqësore nga dhoma e

këshillimit, si dhe për t'i dhënë mundësi gjyqtarëve të seancës gjyqësore për të patur dijeni sa më të plota mbi objektin e kundërshtimit me recurs, për ligjin e aplikueshëm që duhet të zbatohet dhe që duhet të verifikohet nëse është shkelur ose jo nga gjykata që ka dhënë vendimin që kundërshtohet me recurs.

Mungesa e tregimit të normave ligjore konkrete që janë shkelur, nuk përbën shkak për mospranimin e recursit për këtë arsye. Gjykata ka detyrimin kushtetues që ta identifikojë këtë normë bazuar në faktet dhe shkaqet e paraqitura nga palët sipas parimit “gjykata e njeh ligjin” (*iuria novit curia*) pa u lidhur me dispozitën e ligjit të treguar nga palët. Në këtë mënyrë kanë konkluduar edhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin unifikues nr. 2 të datës 19.03.2012.

- **Tregimi i prokurës nëse recursi është bërë nga avokati ose nga përfaqësuesi i ankuesit.** Sipas nenit 474 të K.Pr.C. recursi mund të “...nënshkruhet nga vetë pala, avokati apo përfaqësuesi i pajisur me prokurë”. Në këtë rast avokati duhet të gëzojë tagrat për të përfaqësuar palën duke qenë i pajisur me prokurë ose me deklaram të palës së përfaqësuar përpara gjykatës që shqyrton mosmarrëveshjen. Por recursi mund të nënshkruhet edhe nga përfaqësues me prokurë që nuk janë avokatë, por që tregohen në parashikimet e nenit 96 të këtij Kodi.

Neni 474 dhe neni 475 të K.Pr.C përmban termin “prokurë”, ndërsa neni 476 përmban termin “prokurë e posaçme”. Ligji procedural nuk parashikon ndonjë dispozitë urdhëruese sipas së cilës e drejta e avokatit për të paraqitur recurs në emër të palës që mbron, duhet të jetë e treguar shprehimisht në prokurë apo duhet të jetë deklaruar shprehimisht para gjykatës, as edhe vendimi konkret që kundërshtohet me recurs. Megjithatë, është e rekomandueshme që prokura të parashikojë shprehimisht të drejtën e avokatit për ta përfaqësuar palën në të gjitha shkallët e gjykimit, përfshirë edhe të drejtën për të paraqitur ankim apo recurs, ose në të kundërt të tregojë kufijtë e këtij përfaqësimi p.sh. sipas shkallëve të gjykimit.

Së fundi, ndërkohë që recursi drejtuar Gjykatës së Lartë mund të nënshkruhet nga vetë pala që kundërshton vendimin e gjykatës së apelit ose nga avokati i cili e përfaqëson rregullisht (neni 474), mbrojtjen e interesave të tij në seancën gjyqësore përpara kolegjit civil ku shqyrtohet ai recurs, nisur nga dispozita e pikës 3 të nenit 483 të K.Pr.C., mund ta realizojë vetëm nëpërmjet avokatit. Aty parashikohet se: “Pas relativitetit kryetari fton avokatët e palëve të paraqesin mbrojtjen e tyre.” Gjithsesi seancat gjyqësore në Gjykatën e Lartë janë publike, pra në të mund të marrin pjesë edhe palët, edhe nëse kanë vlerësuar vetë të mos mbrohen me avokat. Por ato, nuk mund të marrin fjalën dhe të dëgjohen drejtpërdrejt nga ana e kolegjit civil.

- **Aktet që i bashkëlidhen rekursit.** Në nenin 476 të K.Pr.C. parashikohet se rekursit i bashkëlidhen për t'u depozituar, *“kopja e vërtetuar e vendimit të kundërshtuar dhe kur është rasti edhe e njoftimit kur ky është bërë; prokura e posaçme; si edhe aktet e dokumentet mbi të cilat është bazuar rekursi, në atë qasje sa janë palët”*.

Nga njëra anë, parashikimi i shprehur i akteve që shoqërojnë rekursin duket sikur e kufizon pranimin e akteve dhe dokumenteve të tjera, duke patur parasysh se Gjykata e Lartë është gjykatë ligji ku nuk mund të paraqiten prova. Nga ana tjetër, kërkohet që rekursi të shoqërohet me paraqitjen e kopjes së vërtetuar të vendimit që kundërshtohet, pra ai nuk duhet të jetë kopje e njësuar me origjinalin por vetë vendimi origjinal i vërtetuar rregullisht nga gjykata që e ka dhënë atë vendim.

7.6.6. Verifikimi i plotësimit të elementëve formal-procedural

Verifikimi i plotësimit të këtyre elementëve formalo-procedural, sipas nenit 476 të këtij Kodi, është detyrim ligjor procedural i sekretarisë së gjykatës që ka dhënë vendimin i cili kundërshtohet me rekurs. Nëse pas njoftimit lidhur me mangësitë, ato nuk plotësohen nga pala që paraqet rekursin, ky i fundit kthehet.

Edhe dhoma e këshillimit e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, e fillon shqyrtimin e rekursit duke verifikuar plotësimin e elementeve formalo-procedural të rekursit. Ky kontroll është veprimi dhe diskutimi i parë që bën dhoma e këshillimit, përpara se të shqyrtojë përmbajtjen, pra ekzistencën e shkaqeve ligjore të rekursit.

Nëse rekursi ka mangësi në ndonjërin prej elementeve formalo-procedural, dhoma e këshillimit disponon mospranimin e ankimit për këtë motiv, por pala mund të ngrejë përsëri kërkesën për rekurs nëse plotësohen kërkesat formale të rekursit dhe nëse është ende brenda afateve të caktuara në ligj. Nëse, nga shqyrtimi në përmbajtje rezulton se mungon shkak ligjor për pranimin e kërkesës, pra rekursi është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që parashikon ligji, atëherë dhoma e këshillimit disponon mospranimin e ankimit për këtë motiv, por tashmë rekursi nuk mund të paraqitet përsëri, madje edhe nëse pala është ende brenda afatit të parashikuar në ligj (neni 480 i K.Pr.C.).

7.7. Kërkesa për pezullimin e vendimit që kundërshtohet me rekurs

Bazuar në shkronjën “ç” të nenit 451 të K.Pr.C, vendimi i gjykatës së apelit quhet i formës së prerë. Si i tillë, sipas shkronjës “a” të nenit 510 të këtij Kodi, ky vendim përbën titull ekzekutiv. Prandaj, duke qenë se ky Kod nuk përmban

ndonjë dispozitë që shprehimisht të parashikojë ndryshe, ushtrimi i së drejtës së rekursit në Gjykatën e Lartë kundër vendimit të gjykatës së apelit, nuk e pezullon ekzekutimin e atij vendimi.

Përjashtimisht ky ekzekutim pezullohet vetëm nëse përmbushet kushtet e parashikuara nga neni 479 K.Pr.C.:

- a) *ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme;*
- b) *pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin e vendimit.”*

Kërkesa për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të gjykatës së apelit i paraqitet Gjykatës së Lartë me shkrim dhe e argumentuar. Kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit që ka marrë formë të prerë, duhet t'i bashkëlidhen:

- vendimi i gjykatës së apelit dhe ai i gjykatës së shkallës së parë;
- rekursi kundër vendimit të gjykatës së apelit dhe shënimi a vërtetimi se ai është paraqitur dhe pranuar nga sekretaria e gjykatës ku është depozituar,
- kopje të vërtetuara të akteve procedurale përmbartimore që tregojnë se ka filluar ekzekutimi i vendimit dhe gjendet në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm. Ka disa përjashtime si p.sh. vendimet që përmbajnë detyrimin e ZRRPP të kryejë veprime të caktuara në regjistrat e pasurive të paluajtshme;
- nëse është rasti, akti që vërteton se pala debitore që ka ushtruar rekursin ka depozituar garanci materiale që siguron ekzekutimin e vendimit.

Ligji procedural nuk parashikon rregulla dhe kritere orientuese për Gjykatën e Lartë se si ajo duhet të vlerësojë kërkesën për pezullim. Ajo ka diskrecion të vlerësojë rast pas rasti nëse gjendet ose jo përpara pasojave të rënda e të pariparueshme duke patur parasysh se pezullimi është përjashtim nga rregulli. Nëse do të kthehej në rregull atëherë cilësia e formës së prerë e vendimeve të gjykatës së apeli do të kthehej në përjashtim.

Kërkesat për pezullim gjykohen menjëherë, në kohën më të shkurtët të mundshme, në dhomën e këshillimit të Gjykatës së Lartë, me një përbërje prej 3 ose 5 gjyqtarësh, kjo në vartësi të llojit të konfliktit civil apo administrativ, për zgjidhjen e të cilit është dhënë vendimi që kundërshtohet me rekurs.

7.8. Heqja dorë nga rekursi

Pala që e ka ushtruar rekursin, ka edhe të drejtën të “tërhiqet” prej tij. Heqja dorë është një veprim i vullnetshëm, i njëanshëm dhe ngushtësisht personal. Kjo do të thotë se, mund të hiqet dorë nga rekursi vetëm me vullnetin e shprehur të

palës rekursuese, kërkesë të cilën e paraqet para Gjykatës së Lartë ajo vetë ose nëpërmjet përfaqësuesit të saj ligjor/avokatit. Në rastin e fundit avokati mund të heqë dorë nga rekursi i klientit të tij vetëm kur kjo e drejtë i është dhënë shprehimisht në aktin e prokurës së posaçme.

Akti i prokurës që pala i jep avokatit për të hequr dorë nga rekursi nuk është e nevojshme që të parashikojë shprehimisht shkakun për të cilin avokati duhet të heqë dorë nga rekursi. Kjo është një e drejtë apo prerogativë që avokati e vlerëson vetë, pasi ai është përfaqësuesi ligjor kompetent i palës, nisur edhe nga lloji i gjykimit në Gjykatën e Lartë si gjykim ligji ku përfaqësimi bëhet vetëm me avokat.

Heqja dorë nga rekursi bëhet me shkrim, duke u nënshkruar rregullisht nga vetë pala ose avokati i pajisur me prokurë, të cilit i është dhënë shprehimisht nga i përfaqësuar i një tagër i tillë për nënshkrimin e atij akti.

Heqja dorë nga rekursi depozitohet në sekretarinë e Gjykatës së Lartë.

Nëse çështja është në fazën e shqyrtimit në dhomën e këshillimit, për çështjet civile heqjen dorë nga rekursi e shqyrton dhe vendos po në dhomë këshillimi një kolegji i përbërë nga 3 gjyqtarë, ndërsa për çështjet administrative një kolegji i përbërë nga 5 gjyqtarë.

Nëse rekursi ka kaluar për shqyrtim në seancë gjyqësore, heqja dorë nga rekursi paraqitet në sekretarinë e Gjykatës së Lartë dhe kolegji përkatës ku bën pjesë gjyqtari relator cakton shqyrtimin e saj në seancë gjyqësore në datën më të afërt të mundshme.

Nëse kërkesa për heqje dorë paraqitet ditën e seancës gjyqësore në Gjykatën e Lartë, ajo shqyrtohet drejtpërdrejt nga kolegji përkatës i ngarkuar me shqyrtimin e çështjes, por sipas nenit 490 të K.Pr.C., me kushtin që të mos ketë filluar relatimi i çështjes, pra deri sa nuk është ezauruar faza e parashtrimit të kërkesave paraprake dhe vendimet e ndërmjetme të kolegjit në përgjigje të tyre.

Akti i heqjes dorë u njoftohet palëve që janë paraqitur ose u komunikohet avokatëve të palëve në rastin kur pala ka qenë e përfaqësuar në seancë. Në këto raste kolegji civil vendos pushimin e gjykimit të çështjes dhe njoftimi i këtij vendimi quhet i bërë për palën që ka qenë e pranishme vetë ose përfaqësuesi i saj.

7.9. Mënyra e shqyrtimi të rekursit dhe kundërrekursit nga Gjykata e Lartë

Rekursi në Gjykatën e Lartë bëhet për shkaqe ligjore që lidhen me moszbatimin ose zbatimin e gabuar të ligjit material apo procedural. Pra, gabimet e pretenduara në gjykimin e një çështjeje dhe dhënien e vendimit nga gjykatat më të ulëta mund

të jenë gabime në procedim (*errores in procedendo*) ose gabime në gjykim (*errores in iudicando*), ose të dyja së bashku.

Gjykata e Lartë është gjykatë ligji ndaj nuk ka në objektin e gjykimit të saj gabimin në fakt të gjykatave më të ulëta. Pra, palët nuk mund t'i kërkojnë dhe Gjykata e lartë të shqyrtojë e vendosë për cenimin e vendime gjyqësore me motivin se fakti është i ndryshëm nga ai që kanë konkluduar gjykatat më të ulëta ose se fakti nuk ekziston etj.

Gjykata e Lartë nuk vlerëson dhe çmon prova, as nuk i hyn rivlerësimit të rrethanave të faktit të përcaktuara nga gjykatat më të ulëta. Nëse vëren se ligji është zbatuar gabim në procesin e vlerësimit të provave dhe pranimit të rrethanave të faktit, Gjykata e Lartë e prish vendimin e gjykatës më të ulët për gabime në procedim apo në gjykim dhe jo për gabime në fakt.

I vetmi përjashtim kur Gjykata e Lartë shqyrton pjesërisht edhe gabimin në fakt në gjykimin dhe vendimet e gjykatave më të ulëta, të cilën e ka parashikuar vetë ligjvënësi si kompetencë lëndore ekskluzive për Gjykatën e Lartë, është ai i shqyrtimit të kërkesës për rishikim, këtij mjeti të jashtëzakonshëm procedural për kundërshtimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe të pa ankimueshëm.

Në rastin e gabimeve në procedim, Gjykata e Lartë verifikon nëse janë respektuar ose jo normat juridike që rregullojnë procedurën civile të zbatueshme për shqyrtimin e një çështjeje gjyqësore, ekzaminon dhe vë në bisedim, si rregull edhe kryesisht, aktet procedurale dhe veprimet procedurale që janë në dosjen gjyqësore, cila është pasoja e ardhur në gjykim nga gabimet në procedim të konstatuara e që kanë sjellë një vendim gjyqësor të padrejtë dhe se cila është zgjidhja e disponimi i Gjykatës së Lartë për të riparuar këto gabime procedurale të konstatuara prej saj në shqyrtimin e çështjes dhe vendimin e dhënë nga gjykatat më të ulëta.

Për sa i përket gabimeve në gjykim, Gjykata e Lartë verifikon se si është zgjidhur thelbi, themeli i mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi gjyqësor, pra nëse është zbatuar ligji që rregullon marrëdhënien juridike objekt i mosmarrëveshjes gjatë gjykimit dhe në vendimin e dhënë nga gjykatat më të ulëta apo nëse ky ligj është zbatuar gabim me pasojë dhënien e një vendimi të padrejtë.

Për sa i përket “radhës” së verifikimit dhe më pas përfundimeve që mund të arrijë Gjykata e Lartë gjatë shqyrtimit të çështjes për të cilën është paraqitur rekursi, në radhë të parë verifikohen pretendimet e palëve dhe qëndrimet e gjykatave më të ulëta në lidhje me gabimet në procedim, pra lidhur me respektimin e ligjit procedural, duke i marrë në analizë sipas rëndësisë së normës procedurale dhe

shkallës së cenimit të tyre. Nëse Gjykata e Lartë konstaton se ka shkelje të tilla procedurale që janë të rënda dhe të tjera, të tilla me efekte e ndikim në cenimin e procesit të rregullt ligjor dhe drejtësisë së vendimeve të dhëna nga gjykatat më të ulëta, atëherë nuk ka më vend për të proceduar më tej me verifikimet e hollësishme të gabimeve të pretenduara në gjykim.

Në të njëjtën radhë dhe mënyrë duhet të parashtrohen edhe nga palët pretendimet e tyre në rekursin dhe kundërrekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, si edhe gjatë parashtrimit të shpjegimeve të mbrojtjes në seancën gjyqësore. Fillimisht parashtrohen gabimet në procedim dhe më pas gabimet në gjykim, secila sipas rëndësisë së normës procedurale a materiale dhe shkallës së shkeljes së ligjit lidhur me to nga gjykatat më të ulëta.

7.9.1. Kufijtë dhe procedura e shqyrtimit në dhomën e këshillimit

Nenet 59-63, 480 etj. të K.Pr.C., sikurse edhe neni 61 e vijues i Ligjit nr. 49/2012, përkatësisht për çështjet civile dhe për çështjet administrative, parashikojnë disa rregulla më të hollësishme për përbërjen, afatet dhe procedurën që ndiqet për shqyrtimin e rekursit, si edhe mënyrën e disponimit të dhomës së këshillimit të kolegjit civil dhe kolegjit administrativ të Gjykatës së Lartë.

Karakteristikë e përbashkët e natyrës së gjykimit në dhomën e këshillimit është se shqyrtimi i rekursit nuk bëhet në seancë gjyqësore publike, as nuk realizohet thirrja dhe dëgjimi i palëve nga gjykata në një seancë, por shqyrtohen plotësisht i elementëve formalë të paraqitjes së rekursit.

Shqyrtimi i rekursit në dhomën e këshillimit, si për çështjet civile edhe për ato administrative, kalon në dy etapa. Fillimisht bëhet verifikimi formal i plotësisë së rekursit të paraqitur, pra nëse pala që ushtron rekursin ka interes dhe legjitimitet në paraqitjen e tij, nëse rekursi formalisht i përmban elementët e tij të domosdoshëm dhe dokumentacionin që i duhet bashkëlidhur, nëse palët reciprokisht janë të njoftuara mbi vendimin gjyqësor të rekursuar dhe rekursit e paraqitura kundër tij etj.

Pas kësaj, dhoma e këshillimit kalon në shqyrtimin e rekursit në përmbajtje, por fillimisht për të verifikuar nëse shkaqet e rekursit të paraqitur janë të tilla që lidhen me kriteret e nenit 472 të K.Pr.C. dhe nëse pretendimet për shkelje të ligjit janë konkrete përsa i përket së drejtës së zbatueshme dhe janë konkrete referimet për gabime në gjykim e procedim nga gjykatat më të ulëta. Referimi formal në nenin 472 dhe pretendimi i papërcaktueshëm për shkelje a zbatim të gabuar të ligjit material dhe procedural nga gjykatat nuk aspak janë të mjaftueshme

që dhoma e këshillimit të kalojë çështjen në seancë gjyqësore apo ta shqyrtojë rekursin për efekti të konfirmimit apo cenimit të vendimeve të gjykatave më të ulëta nga vetë dhoma e këshillimit.

Nëse dhoma e këshillimit, civile apo administrative, vjen në përfundimin se rekursi është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që lejon ligji apo se nuk janë plotësuar kërkesat procedurale për paraqitjen e tij, atëherë vendos mospranimin e rekursit.

Ekziston edhe një etapë e tretë në rastet kur dhoma e këshillimit, sipas ligjit, ka edhe kompetencën për të vendosur nëse duhet të konfirmohen ose cenohen vendimet e gjykatës të kundërshtuara me ankim të veçantë ose rekurs. Këto janë rastet kur bëhet ankim i veçantë për kompetencën dhe juridiksionin si për çështjet civile dhe ato administrative (nenet 59-63 të Kodit të Procedurës Civile), si edhe rastet kur ligji parashikon mundësinë që në çështjet administrative të disponojë vetë dhoma e këshillimit me vendim konfirmues apo cenes të atyre të dhëna nga gjykatat administrative më të ulëta (nenet 62 dhe 63 të ligjit 49/2012)

Dhoma e këshillimit të Gjykatës së Lartë, për shqyrtimin e çështjeve civile ka në përbërje të saj tre gjyqtarë (neni 480 i K.Pr.C.), ndërsa ajo për çështjet administrative pesë gjyqtarë (neni 12 pika 2 e ligjit nr. 49/2012).

Kodi i Procedurës Civile nuk parashikon ndonjë normë të hollësishme lidhur me procedurën se si caktohet për shqyrtim, bisedohet dhe merret vendimi në dhomën e këshillimit të Gjykatës së Lartë. Caktimi për shqyrtim i rekursit, si rregull vjen sipas radhës kronologjike të paraqitjes së rekurseve në Gjykatën e Lartë. Palët janë në dijeni të gjyqtarit relator, por nuk njoftohen për ditën dhe orën e shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi. Përsa i përket bisedimit të çështjes dhe vendimmarrjes zbatohet përgjithësisht rregullimet e përgjithshme procedurale përkatëse për aq sa janë të aplikueshme për dhomën e këshillimit.

Ligji nr. 49/2012, në nenin 61 parashikon disa rregullime procedurale shtesë sikurse janë caktimi i datës dhe orës së gjykimit të rekursit në dhomë këshillimi duke u njoftuar për këtë qëllim edhe palët jo më vonë se 21 ditë nga dita e shqyrtimit. Palëve u njoftohet edhe përbërja e dhomës së këshillimit. Parashikohet edhe se për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi mbahet procesverbal.

Për çështjet civile, rekursi duhet të shqyrtohet në dhomën e këshillimit brenda 60 ditëve nga depozitimi i tij në Gjykatën e Lartë (neni 480 i K.Pr.C.), ndërsa për çështjet administrative për të cilat ligji nuk bën dallime, ky afat është 90 ditor por që përfshin edhe gjykimin eventualisht në seancë gjyqësore (neni 60 pika 2 e ligjit nr.49/2012).

Së fundi, përsa i përket çështjeve civile, Kodi i Procedurës Civile nuk përmban parashikime lidhur me arsyetimin e vendimit të dhomës së këshillimit kur ajo shqyrton rekursin ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Megjithatë, me evolucionin e legjislacionit dhe jurisprudencës sonë gjyqësore, asaj kushtetuese dhe të GJEDNJ, tashmë kërkohet që minimalisht vendimi i dhomës së këshillimit për mospranimin e rekursit të tregojë qartë shkaqet për të cilat është ngritur rekursi, si edhe një arsyetim të përmbledhur parimor të motiveve për të cilat është vendosur mospranimi i rekursit.

Ndërsa, përsa i përket çështjeve administrative, lidhur me arsyetimin e vendimit, ligji nuk bën dallime ndërmjet atyre që merren nga Kolegji Administrativ në dhomë këshillimi apo në seancë gjyqësore. Neni 64 i ligjit nr. 49/2012 parashikon se vendimi i kolegjit administrativ të Gjykatës së Lartë *“pavarësisht formës së gjykimit, duhet të shpallet detyrimisht i arsyetuar”*.

7.9.2. Kufijtë dhe procedura e shqyrtimit në seancë gjyqësore

Gjykimi në seancë gjyqësore nga kolegji civil i Gjykatës së Lartë bëhet me tre gjyqtarë për çështjet që në gjykimin në shkallë të parë zhvillohen me një gjyqtar dhe me pesë gjyqtarë për çështjet që në shkallë të parë gjykohen me trupë gjykuese të përbërë nga tre gjyqtarë (neni 35 i K.Pr.C.). Ndërsa gjykimi i çështjeve nga kolegji administrativ i Gjykatës së Lartë bëhet me pesë gjyqtarë (neni 12 pika 2 e ligjit nr. 49/2012).

Nëse është vendosur nga dhoma e këshillimit që çështja të shqyrtohet në seancë gjyqësore, gjykimi i saj nga Kolegji Civil realizohet duke zbatuar rregullat e zakonshme të gjykimit që zbatohen edhe nga gjykatat më të ulëta, për aq sa ato mund të gjejnë zbatim.

Sipas nenit 482 të K.Pr.C., njoftimi i palëve lidhur me ditën, orën e gjykimit dhe përbërjen e kolegjit të Gjykatës së Lartë që shqyrton çështjet civile në seancë gjyqësore bëhet me anë të shpalljes publike, 15 ditë para ditës së gjykimit.

Ndërsa pika 2 e nenit 62 të ligjit nr.49/2012, lidhur me çështjet administrative, parashikon se palët njoftohen nga sekretaria gjyqësore të paktën 15 ditë para datës së zhvillimit të seancës gjyqësore, pa u shprehur nëse ky njoftim bëhet me shpallje apo me njoftim drejtpërdrejt palëve në adresat përkatëse. Pavarësisht nga kjo, bëhet fjalë për ometim në shkrimin e normës juridike duke mos ekzistuar asnjë arsye që të parashikohej një mënyrë tjetër njoftimi nga ajo që zakonisht bëhet nga Gjykata e Lartë.

Seanca gjyqësore është publike dhe në të mund të mund të marrin pjesë edhe palët, për të debatuar lëndën e gjyqimit të Gjykatës së Lartë sipas parimit të kontradiktoritetit. Në dallim nga gjyqimet në shkallë të parë dhe në apel, debati gjyqësor orientohet e zhvillohet duke u kufizuar vetëm për çështjet e ligjit. Po kështu, megjithëse mund të jenë të pranishme, palët nuk dëgjojnë drejtpërdrejt por vetëm nëpërmjet parashtrimit të qëndrimit e të shpjegimeve nga avokatit e tyre.

Por, përjashtimisht, përpara se të fillojë relatimi i çështjes dhe debati gjyqësor mbi shkaqet e rekursit, në kontekstin e veprimeve procedurale për verifikimin e paraqitjes së palëve dhe avokatëve të tyre, si edhe të paraqitjes së kërkesave paraprake, Gjykata e Lartë mund të marrë në shqyrtim kërkesa me shkrim, të dëgjojë deklarime të vetë palëve apo të kërkojë ndonjë sqarim direkt prej tyre nëse janë të pranishme. P.sh. lidhur me pretendimet e pamundësisë për t'u mbrojtur me avokat apo shkaqeve të jashtëzakonshme të mosparaqitjes së tyre në seancë, vënia në dijeni e gjykatës se një palë në gjykim ka vdekur dhe kërkohet kalimi procedural, pala nuk ka dijeni e njoftim për vendimin e gjykatave më të ulëta të dhëna në mungesë të saj apo se nuk ka dijeni për rekursin e palës tjetër dhe përmbajtjen e tij, etj.

Pas mbarimit të veprimeve lidhur me prezencën dhe kërkesat paraprake, duke filluar shqyrtimin e shkaqeve të rekurseve që e kanë vënë në lëvizje, Gjykata e Lartë dëgjon shpjegimet e avokatëve të palëve nëse janë të pranishëm. Kryesuesi i kolegjit i jep fjalën avokatëve të palëve që kanë paraqitur rekurs, fillimisht atyre të paditësve dhe më pas palëve të tjera që kanë ushtruar rekurs. Më tej, me të njëjtën radhë dëgjojnë avokatët e palëve që kanë paraqitur kundërrkurs e së fundi avokatët e palëve të tjera nëse janë të pranishëm.

Koha e gjyqimit të çështjes në Gjykatën e Lartë është e kufizuar, prandaj avokatët duhet të përgatiten dhe orientohen nga kolegji për të parashtruar me gojë në mënyrë të përmbledhur pretendimet dhe shpjegimet e tyre, eventualisht për bazueshmërinë ose jo në ligj të rekursit dhe të vendimeve të gjykatave më të ulëta që kërkohet të cenohen me anë të rekursit. Në seancë nuk lejohet replika mes avokatëve, ata flasin vetëm një herë dhe nuk mund të kërkojë fjalën pas diskutimit të palës tjetër, për të kundërshtuar deklaratimet e kësaj të fundit.

Po kështu, avokatët duhet të jenë të përgatitur për t'iu përgjigjur pyetjeve që u bëhen në çdo kohë, aq herë dhe për aq sa i e çmojnë të nevojshme anëtarët e kolegji gjykues të Gjykatës së Lartë. Nëse avokati i palës dështon dhe nuk i konformohet orientimit të kolegjit për kohën e kufizuar të parashtrimit të shpjegimeve dhe të përgjigjes së pyetjeve që i drejtohen nga kolegji, atëherë, sipas situatave konkrete të çdo gjykimi, kryesuesi i kolegjit detyrohet të urdhërojë avokatin të përfundojë

shpjegimin dhe të deklarojë menjëherë qëndrimin përfundimtar të tij në emër të palës që përfaqëson.

Prandaj, është më shumë se e këshillueshme që secili avokat, krahas rekursit dhe kundërrkursit të paraqitur paraprakisht, krahas shpjegimeve të përmbledhura me gojë në seancë gjyqësore dhe përgjigjeve të pyetjeve të drejtuara nga kolegji, të përgatisë paraprakisht dhe të depozitojë në mbarim të fjalës së tij tek sekretari i seancës, materialin përkatës me shkrim.

Pas dëgjimit të palëve kolegji i Gjykatës së Lartë tërhiqet në dhomën e këshillimit për të biseduar lidhur me pretendimet e palëve mbi zbatimin e ligjit material dhe procedural nga gjykatat më të ulëta dhe në përfundim vendos unanimisht apo me shumicë votash për zgjidhjen e çështjes. Mendimi pakicës bëhet publik dhe duhet të jetë i arsyetuar. Si rregull, kolegji shpall dispozitivin e vendimit të tij menjëherë duke patur detyrimin e depozitimit të vendimit të arsyetuar brenda 30 ditëve. Nëse çështja paraqet problematika që kërkojnë më shumë kohë për t'u analizuar dhe vendosur, kolegji shtyn shpalljen e vendimit dhe i deklaron palëve ditën kur do të bëhet shpallja e tij.

Gjykata e Lartë, si në kolegjit civil, ashtu edhe në atë administrativ, pas shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore vendos:

- lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit;
- prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë;
- prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim po në atë gjykatë me tjetër trup gjykues;
- prishjen si të vendimit të gjykatës së apelit ashtu edhe të gjykatës së shkallës së parë duke e dërguar çështjen për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë me tjetër trup gjykues,
- ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe gjykatës së apelit;
- prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe të vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe pushimin e çështjes.

Kur Gjykata e Lartë disponon prishjen e vendimeve dhe kthimin e çështjeve për rishqyrtim në gjykatat më të ulëta, ushtron atë që jurisprudenca e njeh si “funksioni kasacional”, me të cilin urdhërohet fillimi i një gjykimi *ex novo* dhe rregullat e gjykimit në këto raste janë ato që i përkasin shkallës së gjykimit ku do të rishqyrtohet çështja.

Kur Gjykata e Lartë disponon për ndryshimin e vendimeve të dhëna nga të dy gjykatat më të ulëta, ushtron atë që jurisprudenca e njeh si “funksioni

revizional”. Në këtë rast duke konstatuar gabimet në gjykim, pra ato të lidhura me moszbatimin ose zbatimin e gabuar të ligjit material, ajo e zgjidh vetë çështjen, meqenëse nuk lind nevoja për hetim të mëtejshëm të çështjes dhe nuk ka diskutime mbi faktet e pranuar nga gjykatat më të ulëta.

Së fundi, Gjykata e Lartë mund të disponojë prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe atij të gjykatës së shkallës së parë duke e pushuar çështjen. Gjykata disponon në këtë mënyrë kur jemi para një padie që nuk mund të ngrihet ose kur çështja nuk hyn në juridiksionin gjyqësor por në atë administrativ në kuptim të nenit 468 të Kodit të Procedurës Civile, për rrjedhojë duhet të prishen të dy vendimet e dhëna nga gjykatat më të ulëta e të pushohet gjykimi i çështjes pasi një gjykim i tillë nuk mund të vazhdojë as në Gjykatën e Lartë dhe as në gjykatat e tjera të mëposhtme.

7.10. Ankimet e veçanta mbi juridiksionin dhe kompetencën

Përsa i përket mjeteve procedurale të ankimit, përveç rekursit, në Kodin e Procedurës Civile parashikohen edhe ankimet e veçanta. Rastet kur mund të ushtrohet ankimi i veçantë parashikohet vetëm shprehimisht nga dispozitat e veçanta të Kodit të Procedurës Civile.

Ndërkohë që, përjashtimisht, në nenet 59-64 të K.Pr.C., parashikohet që, lidhur me konfliktin e kompetencës dhe të juridiksionit, ankimi i veçantë të bëhet drejtpërdrejt në Gjykatën e Lartë.

Afati i ankimit të veçantë në Gjykatën e Lartë është 5 ditor, duke filluar nga e nesërmja e shpalljes së vendimit.

Pavarësisht se dispozita e nenit 59 në lidhje me atë të nenit 63 të K.Pr.C., paraqesin ndonjë problem nga pikëpamja e teknikës legislative, duke e bërë normën të duket e paqartë, gjë e cila mund të ndreqet lehtësisht nga ligjvënësi, interpretimi ligjor sistematik të sjell në përfundimin se, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 122/2012 për amendimin e këtij Kodi, shqyrtimi i ankimeve të veçanta lidhur me konfliktin e kompetencës dhe të juridiksionit bëhet në dhomë këshillimi nga kolegji civil i përbërë nga tre gjyqtarë.

Ndërsa sipas ligjit nr. 49/2012, nenit 9 të tij, ankimet e veçanta lidhur me konfliktin për juridiksionin në çështjet administrative shqyrtohen në dhomë këshillimi nga kolegji administrativ i përbërë nga pesë gjyqtarë. Por, lidhur me konfliktin për kompetencën, neni 12 pika 6 parashikon se kolegji administrativ përbëhet nga tre gjyqtarë.

Në të gjitha rastet e shqyrtimit të çështjeve lidhur me juridiksionin ose kompetencën, dhomat e këshillimit shprehen me vendim gjyqësor të arsyetuar.

7.10.1. Gjykimi mbi juridiksionin

Mungesa e juridiksionit gjyqësor sipas nenit 59, mund të ngrihet me kërkesën e palëve ose kryesisht nga gjykata në çdo fazë dhe shkallë të procedimit. Edhe në rastet kur rrëzohet kërkesa e palës për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit nga gjykata që shqyrton çështjen, pala ka të drejtën që ta përsërisë përsëri këtë kërkesë. Edhe pse nuk pengohet formalisht që të paraqitet dhe shqyrtohet, normalisht, kërkesa e re duhet të përmbajë motive të tjera të ndryshme të faktit e të ligjit për të pranuar eventualisht nga ana e gjykatës.

Në nenin 59 të K.Pr.C. parashikohet se: *“Gjykata në çdo fazë dhe shkallë të gjykimit, qoftë edhe kryesisht, merr në shqyrtim nëse çështja që shqyrton, bën pjesë në juridiksionin gjyqësor apo atë administrativ. Kundër vendimit të dhënë për një rast të tillë, mund të bëhet ankimi i veçantë në Gjykatën e Lartë”*.

Ankimi bëhet direkt në Gjykatën e Lartë, si gjykata e shkallës sipërore e cila, duke interpretuar dhe zbatuar drejt ligjin, rast pas rasti, ka autoritetin ekskluziv të përcaktojë shtrirjen ose jo të juridiksionit gjyqësor në çështjen objekt gjykimi, duke vendosur dhe ndarë kufijtë e pushtetit gjyqësor dhe atij ekzekutiv. Po kështu, për të vendosur nëse gjykimi i çështjes është ose jo në juridiksionin e gjykatave shqiptare, duke garantuar ushtrimin e sovranitetit shtetëror shqiptar dhe të pushtetit gjyqësor të saj në rastet kur lindin konflikte se pushteti shtetëror i kujt shteti ka juridiksionin gjyqësor për ta zgjidhur atë.

Gjykata e Lartë, e shqyrton ankimin e veçantë lidhur me juridiksionin duke patur për objekt vetëm pretendimet e prapësimet e palëve, si dhe ligjin e zbatueshëm që vetë Kolegji Civil vlerëson se duhet të gjejë zbatim, pa lejuar palët dhe pa trajtuar në qëndrimin e saj çështjet e zgjidhjen në themel të saj.

Pas shqyrtimit të ankimit të veçantë Gjykata e Lartë vendos nëse çështja bën pjesë në juridiksion gjyqësor apo administrativ dhe ia dërgon çështjen për shqyrtim, sipas rastit gjykatës ose organit administrativ që duhet të procedojë me zgjidhjen e mosmarrëveshjes sipas ligjit.

Si rregull, kur disponon se çështja bën pjesë në juridiksionin gjyqësor, Gjykata e Lartë ia dërgon çështjen për vazhdimin e gjykimit të njëjtës gjykatë dhe trupë gjyqësore. Por mund të ndodhë që, gjykata e shkallës së parë që ka dhënë vendimin e ankimuar, të ketë tejkualuar objektin e gjykimit kur është shprehur

lidhur me juridiksionit duke shfaqur në arsyetim, analizën dhe konkluzionet e saj qëndrime që lidhen me mënyrën e zgjidhjes në themel të çështjes. Në raste të tilla, duke e paragjykuar zgjidhjen e çështjes, meqenëse është cenuar paanshmëria e gjyqtarit, element thelbësor për procesin e rregullt ligjor, ndonëse çështja është në juridiksionin gjyqësor dhe kompetencën territoriale e ka e njëjta gjykatë, shqyrtimi i çështjes duhet t'i ngarkohet një trupe tjetër gjyqësore.

7.10.2. Gjykimi mbi kompetencën

Procedura e gjykimit mbi kompetencën ka shumicën e elementëve të njëjtë me gjykimin mbi juridiksionin. E veçanta e gjykimit mbi kompetencën është se ankimi i veçantë në Gjykatën e lartë lejohet vetëm kundër vendimit të gjykatës që ka pranuar kërkesën për shpalljen e moskompetencës së asaj gjykate duke ia dërguar çështjen një gjykatë tjetër. Kjo rezulton qartë nga përmbajtja e nenit 62 të K.Pr.C. ku parashikohet se ankimi i veçantë në Gjykatën e Lartë bëhet vetëm kundër vendimit të gjykatës që ka shpallur moskompetencën për gjykimin e çështjes. Nëse bëhet ankim kundër vendimit të ndërmjetëm që e rrëzon kërkesën për shpalljen e moskompetencës, Gjykata e Lartë nuk shqyrton shkaqet e ankimit, por vendos vetëm “pushimin e gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë”. Kjo për shkak se vendimi për mospranimin e kërkesës për shpalljen e moskompetencës mund të ankimohet vetëm së bashku me vendimin përfundimtar.

E veçantë tjetër në gjykimin mbi kompetencës është se, Gjykata e Lartë mund të vihet në lëvizje jo vetëm mbi ankimin e veçantë të palëve por edhe nëpërmjet paraqitjes së qëndrimit mbi kompetencën nga ana e gjykatës së cilës çështja i është dërguar për kompetencë nga një gjykatë tjetër. Ligji procedural (neni 64) parashikon se konflikti mes gjykatave lidhur me kompetencën nuk lejohet, por gjykata së cilës i dërgohet çështja, pasi e pranon atë për gjykim, “... *pa ndërprerë gjykimin e çështjes, ka të drejtë t'i parashtrijë qëndrimin e saj Gjykatës së Lartë, e cila vendos për rregullimin e kompetencës*”.

KREU 8

EKZEKUTIMI I DETYRUESHËM

Av. Julian HODAJ dhe av. Besmir BEJA

8.1. Hyrje

Në procesin e ekzekutimit të detyrueshëm roli i avokatit është disi më i kufizuar për shkak se ky proces drejtohet nga përmbaruesi gjyqësor. Megjithatë avokati luan një rol të rëndësishëm për fillimin e këtij procesi. Kështu, avokati ndjek procedurat për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, në ato raste kur urdhri i ekzekutimit lëshohet me kërkesë, si dhe këshillon kreditorin për dokumentet e nevojshme për vënien në ekzekutim të tij. Gjithashtu, avokati luan një rol të rëndësishëm edhe gjatë procesit të ekzekutimit të detyrueshëm, duke përfaqësuar dhe mbrojtur interesat e ligjshme të klientit të tij, pavarësisht nëse ky është në cilësinë e kreditorit, debitorit ose personit të tretë.

Gjatë procesit të ekzekutimit të detyrueshëm avokati mbron interesat e klientit të tij duke e përfaqësuar atë në marrëdhëniet me përmbaruesin gjyqësor dhe palën tjetër. Gjatë punës së tij, avokati garanton që veprimet e përmbaruesit gjyqësor të kryhen në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi. Gjithashtu, avokati ka një rol thelbësor për mbrojtjen kundër ekzekutimit të vendimeve, duke përdorur mjetet ligjore në dispozicion të cilat sipas rastit janë: pavlefshmëria e titullit ekzekutiv, kundërshtimi i veprimeve të përmbaruesit gjyqësor si dhe padia për kërkimin e sendit nga personi i tretë.

Ky kapitull përmban këshilla dhe udhëzime mbi rolin në praktikë të avokatit gjatë procesit të ekzekutimit të detyrueshëm.

8.2. Roli i avokatit në fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm

Ekzekutimi i detyrueshëm vihet në lëvizje vetëm pasi klienti juaj të ketë marrë titullin ekzekutiv. Pas marrjes së titullit ekzekutiv, pavarësisht llojit të tij⁸⁵, avokati

⁸⁵ Aktet që përbëjnë titull ekzekutiv janë të përcaktuara në nenin 510 të K.Pr.C.

mund të fillojë procesin e ekzekutimit të detyrueshëm vetëm pas lëshimit nga ana e gjykatës të urdhrit të ekzekutimit⁸⁶. Avokati, në varësi të titullit ekzekutiv që kërkon të përmbushë me anë të ekzekutimit të detyrueshëm, duhet të ndjekë dy procedura të ndryshme. Kështu, për rastet e parashikuara nga shkronja “a” dhe “b” të nenit 510 të K.Pr.C., urdhri i ekzekutimit përgatitet dhe nënshkruhet nga gjyqtari ose kryetari i trupit gjykues që ka dhënë vendimin, së bashku me vendimin që zgjidh çështjen në themel. Urdhri është pjesë e dosjes dhe ruhet në sekretarinë gjyqësore dhe, në rast se vendimi i gjykatës merr formë të prerë, konfirmohet nga kancelari dhe i njoftohet klientit tuaj dhe palës kundërshtarë.

Në rastin kur gjykata e apelit e ndryshon vendimin e dhënë nga gjykata e shkallës së parë, ajo e shoqëron vendimin e ri me urdhrin përkatës të ekzekutimit, i cili nënshkruhet nga kryetari i trupit gjykues që ka dhënë vendimin. Në këtë rast, urdhri i ekzekutimit konfirmohet nga kancelari i gjykatës së apelit, dhe i njoftohet gjykatës së shkallës së parë që ka dhënë vendimin e ndryshuar, klientit tuaj si dhe palës kundërshtarë.

Siç shihet, kur titulli ekzekutiv është një vendim gjyqësor, me ndryshimet e kryera në Kodin e Procedurës Civile⁸⁷, është hequr roli i avokatit dhe i palëve në paraqitjen e kërkesës për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit. Megjithatë, me qëllim mbrojtjen dhe përmbushjen sa më mirë të interesave të klientit, është e këshillueshme që avokati së pari, të sigurohet që ka depozituar saktësisht adresën dhe të dhënat e tjera të kontaktit të tij dhe të palës që përfaqëson në sekretarinë e gjykatës (këto të dhëna duhet të jenë të përcaktuara në kërkesë-padinë që është paraqitur në gjykatë në fillim e gjykimit, sipas përcaktimit të nenit 154 të K.Pr.C.), si dhe së dyti, të sigurohet që kancelari (i gjykatës së shkallës së parë apo i gjykatës së apelit, sipas rastit) është njoftuar që vendimi ka marrë formë të prerë dhe e ka konfirmuar urdhrin e ekzekutimit të lëshuar nga gjykata në momentin që ka zgjidhur çështjen në themel. Në këtë mënyrë, avokati mund të shmangë vonesat burokratike të panevojshme.

Për rastet e tjera të parashikuara nga shkronjat “c”, “ç”, “d”, “dh” dhe “e” të nenit 510 të K.Pr.C. avokati luan një rol të rëndësishëm për nxjerrjen e urdhrit të ekzekutimit pasi (a) identifikon gjykatën kompetente për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit bazuar në llojin e titullit ekzekutiv, (b) përgatit kërkesën për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit dhe e depoziton atë në sekretarinë e gjykatës përkatëse, (c) mbledh provat që provojnë ekzistencën e titullit ekzekutiv dhe i depoziton

⁸⁶ Në përputhje me paragrafin e fundit të nenit 511 nuk lëshohet urdhri i ekzekutimit për vendimet e sigurimit të padisë dhe për gjobat e dhëna nga gjykata, të cilat ekzekutohen drejtpërdrejtë nga përmbartuesit gjyqësorë, pas njoftimit të vendimit.

⁸⁷ Ligji 122/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar””

ato në seancë gjyqësore, (ç) në rast se gjykata e ka pranuar kërkesën për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit, tërheq urdhrin e ekzekutimit nga sekretaria, në rast të kundërt, në varësi të shkakut të refuzimit të kërkesës për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit bën ankimin në gjykatën e apelit ose depoziton kërkesë të re duke plotësuar të metat e kërkesës fillestare. Më poshtë, është shtjelluar më në detaje puna e avokatit për nxjerrjen e urdhrin të ekzekutimit:

(a) kompetenca territoriale e gjykatës për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit

Gjykata kompetente për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit përcaktohet nga lloji i titullit ekzekutiv që kërkohet të vihet në ekzekutim. Kështu, vendimet e gjykatave të shteteve të huaja e të gjykatave të arbitrazhit të huaj, urdhri i ekzekutimit lëshohet nga gjykata e apelit përkatëse. Kërkesa paraqitet në të njëjtën gjykatë apeli që ka njohur vendimin e gjykatës së huaj apo, sipas rastit, vendimin e gjykatës së arbitrazhit të huaj⁸⁸.

Neni 511 (b) i K.Pr.C. parashikon që gjykata e apelit e lëshon urdhrin e ekzekutimit brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së kreditorit. Megjithatë, duke marrë parasysh ngarkesën e gjykatave të apelit, jo gjithmonë është e mundur të lëshohet urdhri i ekzekutimit brenda këtij afati. Për këtë arsye do të ishte e këshillueshme që avokati, në komunikimet me klientin e tij, t'i shpjegojë atij edhe vonesat që mund të vijnë si pasojë e ngarkesës së gjykatave në shqyrtimin e çështjeve.

Në rastin kur titull ekzekutiv është një vendim gjykate arbitrazhi në Republikën e Shqipërisë urdhri i ekzekutimit lëshohet nga gjykata e vendit që ka kompetencën territoriale mbi vendin ku është dhënë vendimi. Kompetenca territoriale e gjykatave të rretheve gjyqësore përcaktohen nga Dekreti i Presidentit të Republikës nr. 6201, datë 8.6.2009 “Për caktimin e kompetencave tokësore të gjykatave të rretheve gjyqësore dhe të qendrës së ushtrimit të veprimtarisë të secilës prej tyre” (i ndryshuar).

Rrjedhimisht, avokati ia drejton kërkesën për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit gjykatës së rrethit gjyqësor që sipas Dekretit të mësipërm ka kompetencën tokësore mbi vendin ku gjykata e arbitrazhit ka dhënë vendimin. Kërkesës i bashkëlidhet vendimi i gjykatës së arbitrazhit (në origjinal ose kopje e njëzuar me origjinalin nga noteri) si dhe prokura apo autorizimi për avokatin.

Kur titull ekzekutiv janë aktet noteriale që përmbajnë detyrim në të holla, aktet për dhënie e kredive bankare, kambialet, çeket e letrat me urdhër që barazohen

⁸⁸ Gjykata e apelit që ka kompetencën territoriale për njohjen e vendimit të gjykatës së shtetit të huaj përcaktohet sipas kriterëve të nenit 49 të K.Pr.C. Për më shumë shikoni Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 6/2011.

me ato, si dhe aktet e tjera që sipas ligjeve të veçanta quhen tituj ekzekutiv, urdhri i ekzekutimit lëshohet nga gjykata e vendit ku do të përmbushen detyrimet që përmban titulli ekzekutiv.

Përcaktimi i vendit ku do të përmbushet detyrimi kryhet duke u bazuar në kriteret që përcakton Kodi Civil për përmbushjen e detyrimeve. Kështu, në rastin e detyrimeve monetare, detyrimi përmbushet si rregull, në vendbanimin e kreditorit. Megjithatë, kreditori mund të caktojë një vend tjetër brenda kufijve të shtetit ku ka vendbanimin në kohën e pagimit ose të lindjes së detyrimit⁸⁹.

Rrjedhimisht, gjykata kompetente për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit për titujt ekzekutiv të parashikuar nga pikat “d”, “dh” dhe “e” të nenit 510 të K.Pr.C. është gjykata e vendbanimit të kreditorit ose çdo gjykatë tjetër në territorin e së cilës palët kanë përcaktuar përmbushjen e detyrimit.

(b) përgatitja e kërkesës, provat dhe seanca për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit

Pas përcaktimit të gjykatës kompetente, avokati harton kërkesën që i drejtohet gjykatës për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit. Kërkesa, duhet të përmbajë (1) Gjykatën përpara së cilës paraqitet kërkesa; (2) Të dhënat identifikuese të kërkuarit dhe të përfaqësuesit të tij (emrin, atësinë, mbiemrin, vendbanimin ose vendqëndrimin, si dhe të dhënat elektronike të kontaktit të tij ose të përfaqësuesit); (3) Objektin e kërkesës (pra lëshimi i urdhrin të ekzekutimit për titullin ekzekutiv përkatës) (4) Bazën ligjore; (5) Tregimin e fakteve, rrethanave, dokumenteve, mjeteve të tjera provuese dhe argumentimin e të drejtës mbi të cilën mbështetet kërkesa; si dhe (6) kërkimin (pra lëshimi i urdhrin të ekzekutimit për titullin ekzekutiv përkatës). Në dokumentet bashkëlidhur manualit, mund të gjeni një model kërkesë për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit kur titull ekzekutiv janë aktet e dhënies së kredive bankare.

Më poshtë mund të gjeni shembuj mbi mënyrën se si duhet të hartohet objekti i një kërkesë në varësi të llojit të titullit ekzekutiv.

Shembuj praktikë të objektit të kërkesës për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit:

Objekti i kërkesës për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit për vendim Gjykate Arbitrazhi në shtet të huaj:

“Lëshimin e Urdhrin të Ekzekutimit për Vendimin e Gjykatës së Arbitrazhit “Qendra Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimeve” me qendër në Uashington me nr. ARB/11/18, datë 29.05.2013”

⁸⁹ Neni 448 i Kodit Civil

Objekti i kërkesës për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për vendim Gjykatë Arbitrazhi në Shqipëri:

“Lëshimin e Urdhrit të Ekzekutimit për Vendimin e Gjykatës së Arbitrazhit “Qendra Shqiptare e Ndërmjetësimit dhe Arbitrazhit Tregtar” me nr. 315, datë 21.05.2013”

Objekti i kërkesës për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për aktet për dhënien e kredive bankare:

“Lëshimin e Urdhrit të Ekzekutimit për Kontratën e Kredisë me Nr. 1425 Rep. dhe Nr. 854 Kol. të datës 12.03.2013, para noterit

Objekti i kërkesës për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për akte të tjera që sipas ligjeve të veçanta quhen tituj ekzekutiv:

“Lëshimin e Urdhrit të Ekzekutimit për Faturën tatimore të konsumit të ujit të pijshëm dhe largimit të ujërave të përdorura me nr. 875469, për detyrimet që rrjedhin nga Kontrata nr. 8547, datë 21/05/2013”

Pasi përgatit dhe nënshkruan kërkesën, Avokati përcakton dhe mbledh dokumentet që provojnë ekzistencën e titullit ekzekutiv. Më poshtë, mund të gjeni një listë treguese me dokumentet që përgjithësisht janë të nevojshme për të provuar ekzistencën e titullit ekzekutiv.

Listë treguese e dokumenteve që i bashkëlidhen kërkesës për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit

Në rastin kur titull ekzekutiv është një vendim i një gjykatë apo një arbitrazhi të një shteti të huaj që u është dhënë fuqi në Republikën e Shqipërisë, kërkesës i bashkëlidhen dokumentet provuese si më poshtë:

- Kopja e vendimit që duhet të zbatohet dhe përkthimi i tij në gjuhën shqipe i legalizuar nga noteri;
- Vendimin e gjykatës së apelit për njohjen e vendimit të gjykatës së shtetit të huaj;
- Prokurën apo autorizimin për avokatin (në rastet kur këto janë hartuar jashtë Republikës së Shqipërisë duhet të jenë të përkthyer dhe legalizuara nga noteri);
- Fotokopje e kartës së identitetit të avokatit.

Avokati duhet të ketë kujdes që vendimi dhe prokura të jenë të legalizuara sipas procedurës përkatëse për legalizimin e dokumenteve ose të mbajnë vulën e apostilës, për dokumente që janë lëshuar në shtete të cilat janë anëtare të Konventës “Për heqjen e kërkesës për legalizim të dokumenteve

zyrtare të huaja” (Konventa e Hagës e datës 5 tetor 1961)⁹⁰.

Në rastin kur titull ekzekutiv është një vendim i një gjykate arbitrazhi në Republikën e Shqipërisë, kërkesës i bashkëlidhen dokumentet provuese si më poshtë:

- Vendimi i gjykatës së arbitrazhit;
- Kopje e marrëveshjes së arbitrazhit;
- Vërtetim nga gjykata e arbitrazhit që palët kanë hequr dorë nga ankimi ose nuk kanë bërë ankim kundër vendimit të dhënë nga gjykata brenda afatit ligjor; ose
- Vendimin e gjykatës së apelit që ka rrëzuar kërkesën ankimore, ka prishur ose ndryshuar vendimin e gjykatës së arbitrazhit, duke shqyrtuar çështjen në themel;
- Prokurën apo autorizimin;
- Fotokopje e kartës së identitetit të avokatit.

Në rastin kur titulli ekzekutiv është një akt noterial që përmban detyrim në të holla si dhe aktet për dhënien e kredive bankare, kërkesës i bashkëlidhen dokumentet provuese si më poshtë:

- Kontrata e kredisë bankare, apo akti noterial që përmban detyrim në të holla⁹¹;
- Për aktet e dhënies së kredive bankare: licenca për të vepruar si bankë në Republikën e Shqipërisë;
- Vërtetimi i mos përmbushjes së detyrimit;
- Njoftimi për vendosjen në vonesë të debitorit, kur nuk është parashikuar një afat për përmbushjen e detyrimit;
- Prokurën apo autorizimin;
- Fotokopje e kartës së identitetit të avokatit.

Në rastet e tjera të parashikuara nga shkronjat “dh” dhe “e”, kërkesës i bashkëlidhen dokumentet e mëposhtme:

- Titulli ekzekutiv (pra, kambiali, çeku dhe letrat me urdhër që barazohen me to, si dhe çdo akt tjetër që sipas një ligji të posaçëm konsiderohet titull ekzekutiv, p.sh. fatura tatimore e konsumit të ujit të pijshëm dhe largimit të ujërave të përdorura⁹² ose fatura tatimore e konsumit të

⁹⁰ Republika e Shqipërisë ka aderuar në këtë konventë me ligjin nr. 9060, datë 08.05.2003 Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën për heqjen e kërkesës për legalizim të dokumenteve zyrtare të huaja (5 tetor 1961)”

⁹¹ Për elementët që duhet të përmbajë akti noterial si titull ekzekutiv shikoni Vendimin Unifikues të Gjykatës së Lartë nr. 980, datë 29.09.2000.

⁹² Ligji 8975, datë 21.11.2002 “Për trajtimin e faturave tatimore të ujit të pijshëm si titull ekzekutiv” (i ndryshuar)

energjisë elektrike⁹³);

- Vërtetimin e mos përmbushjes së detyrimit që përmban titulli ekzekutiv;
- Prokurën apo autorizimin;
- Fotokopje e kartës së identitetit të avokatit.

Kërkesa, së bashku me dokumentet shoqëruese⁹⁴, paraqitet në sekretarinë e gjykatës kompetente për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit ose mund të dërgohen edhe me postë. Këshillohet që në rast se përdoret shërbimi postar, të dërgohet me postë të porositur (rekomandë), me anë të së cilës, mund të provohet marrja në dorëzim e kërkesës nga gjykata.

Sekretaria e gjykatës, si edhe në rastin e kërkesë-padive, vulos kërkesën me datën e paraqitjes dhe krijohen dosjen përkatëse, në të cilën depozitohet edhe çdo dokument që është paraqitur me kërkesën, si edhe çdo dokument i paraqitur më vonë e çdo dokument procedural i krijuar nga gjykata, përfshirë procesverbalin e seancës dhe vendimet gjyqësore. Çështja i caktohet me short një gjyqtari të gjykatës, i cili cakton datën dhe orën e seancës për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit.

Data dhe ora e seancës i njoftohet kërkuarit ose avokatit nëpërmjet letër-thirrjes. Gjithashtu, letër-thirrja përmban informacione mbi gjykatën që e ka nxjerrë, emrin dhe mbiemrin e kërkuarit për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, si dhe çështjen për të cilën kërkuari thirret në gjykatë, që në këtë rast është lëshimi i urdhrit të ekzekutimit për titullin ekzekutiv përkatës. Megjithatë, mund të ndodhë që për shkak të pasaktësive në adresa, ose për shkaqe të tjera praktike, të mos merret letër-thirrja nga kërkuari. Për këtë shkak, në rast se pas kalimit të një afati të arsyeshëm nga data e depozitimit të kërkesës nuk ka ardhur letër-thirrja, është e këshillueshme që avokati të marrë informacion pranë sekretarisë së gjykatës për emrin e gjyqtarit që i është caktuar çështja. Në këtë mënyrë, avokati mund të marrë informacion të drejtpërdrejtë për datën dhe orën që do të shqyrtohet kërkesa për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit nga gjyqtari, apo sekretarja gjyqësore, të cilit i është caktuar shqyrtimi i kërkesës.

Seanca gjyqësore për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit zhvillohet pa palë kundërshtare dhe me një gjyqtar të vetëm. Avokati duhet të jetë i përgatitur që t'i përgjigjet pyetjeve që mund të ketë gjyqtari për kompetencën territoriale të

⁹³ Ligji 8662, datë 18.09.2000 "Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike" (i ndryshuar)

⁹⁴ Dokumentet shoqëruese mund të paraqiten edhe në seancë dhe në sekretarinë e gjykatës të paraqiten vetëm kërkesa, procura apo autorizimi dhe fotokopje e kartës së identitetit të avokatit.

gjykatës, dokumentet provuese që i bashkëlidhen kërkesës, apo dhe çdo çështje tjetër që gjyqtari mund ta çmojë të nevojshme për t'u shpjeguar nga kërkuesi.

Në përfundim të gjykimit (i cili zakonisht zgjat një seancë të vetme), gjykatësi mund të vendosë pranimin ose refuzimin e kërkesës, pezullimin apo pushimin e gjykimit ose edhe mos kompetencën e saj. Në rast se gjykatësi vendos të refuzojë dhënien e urdhrit të ekzekutimit ose të pushojë (pezullojë) gjykimin avokati mund të bëjë ankim ndaj këtij vendimi sipas rregullave mbi ankimet e veçanta të cilat janë trajtuar në kapitullin e apelit të këtij manuali. Në rastin kur, sipas parashikimit të neneve 61 dhe 62 të K.Pr.C., gjykata konstaton që nuk është kompetente për të shqyrtuar kërkesën dhe ia dërgon aktet gjykatës kompetente, avokati ka të drejtë të bëjë ankim të veçantë në Gjykatën e Lartë, sipas rregullave të cilat janë trajtuar në kapitullin e gjykimeve të Gjykatës së Lartë. Në rast se gjykatësi vendos pranimin e kërkesës, avokati mund të marrë urdhrin e ekzekutimit në sekretarinë e gjykatës pasi ai të jetë arsyetuar nga gjykatësi.

Urdhri i ekzekutimit lëshohet vetëm në një kopje. Rrjedhimisht, në rastet kur kërkohet të dorëzohen disa pasuri të veçanta, apo avokati përfaqëson disa kërkues ose në rast se titulli ekzekutiv është kundër disa debitorëve, avokati mund t'i kërkojë gjykatës që të lëshojë urdhra ekzekutimi të veçantë. Në këtë rast, urdhri i ekzekutimit do të përcaktojë se cila pjesë e titullit ekzekutiv do të ekzekutohet nga ky urdhër. Avokati, në kërkesën për lëshimin e urdhrave të ekzekutimit të veçantë duhet të argumentojë nevojën për të pasur urdhra ekzekutimi të veçantë dhe shkakun që kjo nevojë nuk përmbushet nga lëshimi i një urdhri ekzekutimi të vetëm.

8.3. Vënia në ekzekutim

Lëshimi i urdhrit të ekzekutimit nga gjykata nuk nënkupton nisjen e menjëhershme dhe automatike të procesit të ekzekutimit. Urdhri i ekzekutimit vihet në ekzekutim vetëm me anë të kërkesës së kreditorit.

Megjithatë, në raste të caktuara, pas marrjes së urdhrit të ekzekutimit, është e këshillueshme që përpara vënies në ekzekutim t'i kërkohet debitorit të përmbushë detyrimin vullnetarisht. Një model kërkesë mund të gjendet në aktet bashkëlidhur manualit. Pavarësisht që K.Pr.C. nuk parashikon një procedurë të tillë, këshillohet që me qëllim që të shmangen shpenzimet e ekzekutimit, veçanërisht në rastet kur objekti i ekzekutimit është përmbushja e detyrimit në të holla apo dorëzimi i sendit, avokati t'i dërgojë një kërkesë debitorit për

përmbushen e detyrimit përpara vënies në ekzekutim të tij. Sigurisht që një veprim i tillë, jo vetëm është në interesin më të mirë të klientit (kreditorit) por, njëkohësisht, edhe debitori është i motivuar për të kryer përmbushjen e detyrimit sepse nuk paguan shpenzimet e ekzekutimit të detyrueshëm. Sigurisht që kjo procedurë nuk është e këshillueshme në rastet kur është e rëndësishme që të kryhet sa më shpejt vënia e sekuestros nga përmbaruesi në mënyrë që të pengohen veprimet e debitorit për të fshehur ose tjetërsuar pasurinë e tij.

Kur procedura e mësipërme është e papërshtatshme ose nuk jep rezultat avokati duhet të hartojë kërkesën për vënien në ekzekutim të urdhri i ekzekutimit. Një model kërkesë mund të gjendet në aktet bashkëlidhur këtij manuali. Urdhri mund të vihet në ekzekutim nga shërbimi përmbarimor gjyqësor, privat ose shtetëror, nëpërmjet përmbaruesve gjyqësor. Avokati duhet të ketë kujdes që në rast se këshillon klientin e tij që urdhrin e ekzekutimit ta vërë në ekzekutim nëpërmjet përmbarimit gjyqësor shtetëror t'ia drejtojë kërkesën përmbaruesit gjyqësor që ka kompetencën tokësore sipas parashikimit të nenit 516 të K.Pr.C. Ndërkohë që një kufizim i tillë nuk ekziston për përmbaruesit gjyqësor privat të cilët ushtrojnë funksionin e tyre në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë⁹⁵.

Avokati, kërkesës për ekzekutim, duhet t'i bashkëlidhë edhe aktet e mëposhtme:

- a) titullin ekzekutiv (origjinal ose i noterizuar);
- b) urdhrin e ekzekutimit (origjinal);
- c) mandatin bankar të kryerjes së pagesës së tarifës së vënies në ekzekutim;
- ç) prokurën apo autorizimin i cili i jep të drejtën avokatit për të vënë në ekzekutim urdhrin e ekzekutimit. Gjithashtu, këshillohet që prokura të autorizojë avokatin të përfaqësojë klientin (kreditorin) në çdo marrëdhënie me përmbaruesin gjyqësor si dhe çdo lloj përfaqësimi përpara gjykatave të çdo niveli për çështje që mund të lindin gjatë procesit të ekzekutimit të detyrueshëm.

Tarifat për vënien në ekzekutim nga shërbimi përmbarimor gjyqësor privat caktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrisë të Drejtësisë dhe Ministrisë të Financave.⁹⁶ Avokati duhet të ketë kujdes që në këshillimin e klientit për tarifën që duhet të parapaguajë të llogarisë edhe taksat dhe tatimet e zbatueshme (veçanërisht tatimin mbi vlerën e shtuar) që zbatohen për vënien në ekzekutimit të urdhrin të ekzekutimit përkatës⁹⁷.

Hapi i fundit për vënien në ekzekutim të urdhrin të ekzekutimit nëpërmjet shërbimit përmbarimor gjyqësor privat është lidhja e kontratës ndërmjet kreditorit

⁹⁵ Neni 7 i ligjit nr. 10031, datë 11.12.2008 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat” (i ndryshuar)

⁹⁶ Udhëzim i përbashkët i Ministrisë të Drejtësisë dhe Ministrisë të Financave nr.1240/5 datë 15.09.2009 “Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbarimor gjyqësor privat”

⁹⁷ Neni VIII i Udhëzimit

dhe përmbaruesit ose shoqërisë përmbarimore. Kontrata lidhet sipas një modeli tip të miratuar me urdhër⁹⁸ të Ministrit të Drejtësisë. Kontrata parashikon të drejtat dhe detyrimet e kreditorit, të drejtat dhe detyrimet e përmbaruesit ose shoqërisë së përmbarimit, mënyrën e kryerjes së pagesave, përgjegjësinë profesionale të përmbaruesve dhe rastet e zgjidhjes së kontratës. Një model i saj mund të gjendet në aktet bashkëlidhur këtij Manuali.

Përmbaruesi pasi administron të gjitha aktet e përcaktuara më sipër dhe pas lidhjes së kontratës me Kreditorin në përputhje me nenin 516 të K.Pr.C. regjistron çështjen në regjistrin qendror që administrohet nga Ministria e Drejtësisë dhe fillon ekzekutimin, duke i dërguar debitorit një lajmërim për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban urdhri i ekzekutimit brenda afateve të përcaktuara në ligj.

8.4. Roli i avokatit gjatë procesit të ekzekutimit

Procesi i ekzekutimit drejtohet nga përmbaruesi gjyqësor i cili e fillon procesin nëpërmjet lajmërimit për ekzekutim vullnetar. Nga ky moment, roli i avokatit kufizohet në përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të ligjshme të klientit të tij duke garantuar që veprimet e përmbaruesit gjyqësor të kryhen në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi. Më poshtë jepen rastet në të cilat avokati ndërhyt gjatë procesit të ekzekutimit për të mbrojtur interesat e klientit të tij, pavarësisht pozicionit juridik që ka klienti në procesin e ekzekutimit, pra, nëse është kreditori, debitori apo palë e tretë.

Momenti i parë në të cilën mund të ndërhyjë avokati për të mbrojtur interesat e klientit të tij në pozicionin e debitorit është kërkesa për shtyrjen e afatit të ekzekutimit të detyrimit në të holla ose ndarja e detyrimit në këste. Kërkesa bëhet menjëherë pas fillimit të procesit të ekzekutimit të detyrueshëm, pra pas marrjes së lajmërimit për ekzekutim vullnetar, por megjithatë dispozita nuk ka një afat prekluziv dhe rrjedhimisht kjo kërkesë mund të bëhet edhe në momentet e tjera gjatë procesit të ekzekutimit. Kërkesa depozitohet në sekretarinë e gjykatës së shkallës së parë të vendit të ekzekutimit. Kreditori dhe përmbaruesi gjyqësor thirren në gjykim si persona të tretë.

Në këtë kërkesë avokati duhet të arsyetojë që për shkak të gjendjes financiare të përkohshme të debitorit, është e pamundur të përmbushet i gjithë detyrimi sipas lajmërimit për ekzekutim vullnetar. Megjithatë, duhet të provohet që debitori ka mundësitë financiare që ta përmbushë detyrimin me këste, ose që

⁹⁸ Urdhri i Ministrit të Drejtësisë nr. 8543/2, datë 01.11.2010

gjendja financiare e debitorit do të përmirësohet në të ardhmen dhe rrjedhimisht shtyrja e afatit të ekzekutimit është e justifikuar. Kërkesës duhet t'i bashkëlidhet çdo dokument financiar që provon gjendjen financiare të debitorit si bilanci i një shoqërie, vërtetimi i pagës, kontrata etj. si dhe prokura. Kjo kërkesë nuk mund të paraqitet në rastet kur detyrimi në të holla rrjedh nga një akt për dhënie e kredisë bankare. Një model kërkesë mund të gjendet në aktet bashkëlidhur manualit.

Avokati luan një rol të rëndësishëm edhe në zëvendësimin e sendit ndaj të cilit është vënë sekuestroja nga përmbaruesi gjyqësor. Kështu, në përputhje me parashikimet e nenit 528 të K.Pr.C. është e këshillueshme që avokati i debitorit, në qoftë se është në interesin e klientit të tij, t'i kërkojë përmbaruesit që masa e sekuestros të vihet mbi një pasuri tjetër të debitorit, e cila plotëson detyrimin e kreditorit. Kërkesa duhet të argumentojë së pari që detyrimi i kreditorit përmbushet plotësisht edhe nga pasuria e re zëvendësuese, si dhe së dyti, që mbrohet interesi i debitorit për të ruajtur të drejtën e pronësisë mbi një pasuri të caktuar, e cila përveç një interesi pasuror mund të ketë edhe një interes jopasuror për debitorin.

Është e këshillueshme që kërkesës t'i bashkëlidhet edhe një vlerësim paraprak i pasurisë zëvendësuese i përgatitur nga një ekspert i licencuar, në mënyrë që të provohet që pasuria e re e përmbush plotësisht detyrimin. Gjithashtu, kërkesës duhet t'i bashkëlidhet edhe prokura apo autorizimi që lejon avokatin të përfaqësojë debitorin në marrëdhëniet me përmbaruesin gjyqësor apo çdo palë tjetër të tretë.

Një funksion tjetër i rëndësishëm i avokatit gjatë procesit të ekzekutimit është asistenca dhe këshillimi i klientit për mbrojtjen e interesave pasurore të tij. Një nga këto raste është marrja pjesë në ekzekutim të kreditorëve të tjerë. Kështu, avokati sapo të informohet që mbi debitorin e klientit të tij, ka filluar procedura e ekzekutimit të detyrueshëm duhet të paraqesë menjëherë kërkesën për marrjen pjesë në ekzekutim të kreditorëve të tjerë sipas parashikimeve të nenit 534 të K.Pr.C. Kërkesa i drejtohet përmbaruesit gjyqësor ose zyrës së përmbarimit që ka filluar i pari ekzekutimin ndaj debitorit dhe duhet të paraqitet përpara se përmbaruesi gjyqësor të ketë përgatitur projektin e ndarjes së shumave të nxjerra (neni 537 i K.Pr.C.).

Kërkesës duhet t'i bashkëlidhen urdhri i ekzekutimit (dokumenti origjinal) ose një vendim nga përmbaruesi gjyqësor që urdhri i ekzekutimit i është bashkëngjitur një çështje tjetër që është në ekzekutim. Gjithashtu, kërkesës duhet t'i bashkëlidhen edhe titulli ekzekutiv (origjinali ose kopje e njësuar me

originalin nga noteri), mandat pagesa bankare që vërteton pagimin e tarifës së vënies në ekzekutim dhe prokura që autorizon avokatin të përfaqësojë kreditorin.

Kërkesa me shkrim është një veprim procedural që ka rëndësi themelore për klientin, pasi në këtë mënyrë, klienti juaj përfiton të njëjta të drejta mbi debitorin sikurse edhe kreditori që ka filluar i pari procesin e ekzekutimit të detyrueshëm ndaj debitorit të përbashkët, përveç rasteve kur ekzistojnë shkaqe të ligjshme të preferimit të parashikuara nga neni 605 i K.C. Në rast të kundërt, nëse përmbaruesi gjyqësor ka marrë vendim dhe ka përgatitur projektin e ndarjes së shumave, procesi i ekzekutimit duhet të fillojë nga e para dhe nuk mund të përfitohet nga shumat e nxjerra nga ekzekutimi i parë.

Një procedurë tjetër gjatë procesit të ekzekutimit është edhe shitja e sendeve të sekuestruara. Shitja mund të kryhet me anë të shitjes në dyqane të shitjes së lirë (sendet e luajtshme) ose me anë të ankandit (sendet e luajtshme dhe sendet e paluajtshme). Avokati, pavarësisht nëse përfaqëson dhe mbron interesat e kreditorit apo debitorit, luan rol të rëndësishëm në caktimin e çmimit të sendit të sekuestruar. Për caktimin e çmimit të sendit kreditori dhe debitori mund të arrijnë një marrëveshje (neni 552 dhe neni 564 i K.Pr.C.). Gjatë negociatave për arritjen e marrëveshjes avokati duhet të ketë si qëllim që çmimi i shitjes së sendit të jetë sa më afër vlerës së tregut. Në këtë mënyrë palët janë më të prirura për të arritur një marrëveshje për shkak se debitori mbron interesat e tij duke shitur sendin me çmimin më të lartë të mundshëm dhe nga ana tjetër rritet mundësia për të përmbushur detyrimin ndaj kreditorit. Gjithashtu, arritja e një marrëveshje bën të mundur që shpenzimet e ekzekutimit të jenë më të vogla duke qenë se nuk është e nevojshme caktimi i një eksperti për të përcaktuar vlerën e tregut të sendit.

Në rastin e shitjes me ankand të sendeve të luajtshme, avokati mund të mbrojë interesat e klientit të tij në pozicionin e debitorit duke përcaktuar radhën e shitjes së sendeve në ankand sipas nenit 558 të K.Pr.C. Kështu, avokati, duke marrë në konsideratë mundësinë që ndonjëri nga sendet e sekuestruara nga përmbaruesi mund ta përmbushë të gjithë detyrimin e debitorit, mund t'i caktojë përmbaruesit që fillimisht të shesë në ankand këtë send. Kërkesa e debitorit është e detyrueshme për përmbaruesin. Në rast se nga shitja në ankand përmbushet i gjithë detyrimi ndaj kreditorit, ankandi përfundon dhe sendet e tjera nuk shiten.

Praktika e shitjes së sendeve me ankand, kryesisht e sendeve të paluajtshme, ka treguar që, në të shumtën e rasteve, sendet shiten nën vlerën e tyre të tregut. Për të evituar këtë praktikë, avokati mund të këshillojë kreditorin (klientin) që të marrë pjesë vetë në ankandin e dytë me qëllim blerjen e sendit. Kreditori nuk

është një nga personat që neni 572 i K.Pr.C. i ka hequr të drejtën të marrë pjesë në ankand. Rrjedhimisht, në rast se kreditori merr pjesë në ankand dhe fiton pronësinë e sendit së pari, shmang mundësinë që sendi të shitet nën vlerën e tregut dhe si rrjedhojë nuk përmbushet detyrimi që debitori ka ndaj kreditorit dhe, së dyti, kreditori ka mundësi që në një kohë të dytë, ta shesë sendin me vlerën e tregut, duke garantuar në këtë mënyrë mbrojtjen e interesave të tij.

Përveç praktikave të mësipërme që lidhen me mbrojtjen e interesave të klientit në rrugë jo gjyqësore, avokati mund të mbrojë interesat e ligjshme të klientit të tij nëpërmjet instrumenteve gjyqësore të mbrojtjes kundër ekzekutimit të cilët trajtohen në pjesën e mëposhtme.

8.5. Mjetet e mbrojtjes ndaj ekzekutimit të detyrueshëm

Nenet 609 dhe vijues të Kodit të Procedurës Civile, parashikojnë disa nga mënyrat e mbrojtjes ndaj ekzekutimit të detyrueshëm. Personat që preken nga ekzekutimi i detyrueshëm kanë, në thelb, dy mënyra mbrojtjeje; ose të godasin vlefshmërinë e titullit ekzekutiv ose të godasin mënyrën e kryerjes së veprimeve nga ana e përmbaruesit gjyqësor.

Duhet kujtuar se të dyja procedurat janë procedura themeli, që nuk kanë lidhje direkte me ekzekutimin e detyrueshëm por që mund të prodhojnë efekte indirekte mbi të. Themeli që nuk kanë lidhje direkte për faktin se të dyja këto procedura zhvillohen në mënyrë autonome ndaj procesit të ekzekutimit, nuk e pezullojnë automatikisht atë gjatë kohës së zhvillimit të tyre por, në rast suksesi, mund të kenë efekte të rënda për atë proces që shkojnë nga anulimi i disa prej veprimeve të përmbaruesve gjyqësorë deri tek pushimi i ekzekutimit në rastet e pranimin të padive përkatëse.

8.5.1. Pavlefshmëria e titullit ekzekutiv (neni 609)

Me kërkesën për pavlefshmëri të titullit ekzekutiv kundërshtohet thelbi i të drejtës së kreditorit për të kryer ekzekutimin e detyrueshëm. Pa një titull të vlefshëm nuk mund të ketë një ekzekutim të vlefshëm. Siç u përmend edhe më sipër kjo është një procedurë gjyqësore në themel që ndjek të njëjtat rregulla të gjykimeve të shkallës së parë.

Lloji i aktit

Duke qenë procedurë themeli, ajo fillohet me padi nga debitori. Duhet pasur pak kujdes me termin “debitor” të përdorur në këtë rast nga Kodi. Për

mendimin tonë ky term nuk e kufizon mundësinë për të paraqitur padi vetëm për ata persona të cilët mund të rezultojnë si “debitorë” në titullin ekzekutiv por, më gjerë, ky term përfshin të gjithë ata persona që preken nga ekzekutimi i detyrueshëm. Kuptohet që, në momentin e verifikimit të legjitimitetit të palëve në proces, edhe këta do të nënshtrohen verifikimeve të rastit nga ana e gjykatës apo kundërshtimeve të mundshme nga ana e të paditurve. Nga ana tjetër, i paditur do të jetë kreditori që ka kërkuar ekzekutimin si dhe kreditorët e tjerë që mund të kenë ndërhyrë në ekzekutimin e detyrueshëm.

Momenti i ngritjes së padisë dhe gjykata kompetente

Padia për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv mund të ngrihet qoftë përpara fillimit të ekzekutimit të detyrueshëm qoftë gjatë tij. Sipas kodit, padia ngrihet para “gjykatës kompetente të vendit të ekzekutimit” dhe një formulim i tillë nuk i thjeshton gjërat në praktikë. Huazimi i këtij termi, nga legjislacioni përkatës italian, duket se i komplikon gjërat në Shqipëri, duke patur parasysh se sistemi i ekzekutimit të detyrueshëm ndryshon thelbësisht në këto dy vende. Ndërsa mund të kishte një lloj analogjie me sistemi ekzekutiv italian, deri kur ekzekutimi i detyrueshëm kryhej, edhe në Shqipëri, vetëm nga një shërbim përmbarimor shtetëror organizuar në zyra qendrore dhe lokale, reforma e re e sistemit të përmbaruesve gjyqësore, me hyrjen e përmbaruesve privatë, duket se e vështirëson punën në praktikë. Problemi kryesor lind, sidomos, në rastet kur titulli ekzekutiv që paraqitet për ekzekutim të detyrueshëm është një “akt për dhënien e kredive bankare” apo thjesht kontratë kredie për garantimin e të cilës është vendosur peng mbi sende të luajtshme apo hipotekë mbi sende të paluajtshme. Në këto raste duhet patur kujdes me zgjedhjen e gjykatës kompetente. Zgjidhja më korrekte është që fokusi të vendoset tek detyrimi që duhet të ekzekutohet dhe jo tek mënyra e ekzekutimit. Për mendimin tonë detyrimi që duhet të ekzekutohet është, në rastin konkret, shlyerja e detyrimit monetar kundrejt kreditorit ndërsa sekuestrimi dhe eventualisht shitja e sendeve janë thjesht mjete për të ekzekutuar detyrimin. Në paraqitjen e një padie të tillë duhet patur parasysh gjithashtu nëse titulli ekzekutiv parashikon specifikisht se ku duhet të kryhet ekzekutimi apo nëse palët kanë rënë dakord paraprakisht për të shmangur rregullat e kompetencës vendore apo lëndore.

Një tjetër element që mund të ndikojë në zgjedhjen e gjykatës kompetente, është nëse ekzekutimi i detyrueshëm ka filluar apo jo. Mendojmë se, pavarësisht paqartësive të Kodit të Procedurës Civile, ekzekutimi i detyrueshëm fillon me vënien e sekuestrimit mbi sendet e luajtshme apo të paluajtshme të debitorit. Pikërisht ky është momenti i cili e bën të detyrueshëm ngritjen e padisë në

gjykatën e vendit të ekzekutimit duke i hequr mundësinë debitorit të zgjedhë, eventualisht , se në cilën gjykatë mund të ngrihet padia.

Çfarë mund të kërkohet

Objekti i procesit është shqyrtimit i të drejtës së kreditorit për të kryer ekzekutimin e detyrueshëm. Pavlefshmëria e titullit ekzekutiv mund të kërkohet goftë për dy lloj arsyesh të përgjithshme që ndoshta mund të quhen procedurale dhe materiale.

Mund të konsiderohen arsye procedurale apo formale të gjitha ato që lidhen me aftësinë që ka titulli ekzekutiv për të vënë në lëvizje procesin e ekzekutimit të detyrueshëm si për shembull fakti që titulli ekzekutiv nuk ka ekzistuar kurrë apo është bërë i pavlefshëm në një fazë të mëvonshme, nuk përmbush asnjë nga kriteret për të qenë i tillë, që nëpërmjet tij nuk mund të kryhet ekzekutimi i detyrueshëm kundrejt një subjekti të caktuar, ose që ai titull nuk mund të shërbejë për të filluar fare ekzekutimin apo se detyrimi nuk është ai i kërkuari në titullin ekzekutiv.

Mund të konsiderohen arsye materiale apo substanciale të gjitha herët kur nuk kundërshtohet aftësia e titullit për të vënë në lëvizje procedurën e ekzekutimit por kundërshtohet pikërisht e drejta që përmbahet në titullin ekzekutiv. Mund të pretendohet gjatë gjykimit se e drejta e përmbajtur në titull nuk ka ekzistuar kurrë apo se ajo e drejtë nuk është më e kërkueshme apo se detyrimi i kërkuar është përmbushur.

Në të gjitha rastet duhet pasur parasysh nëse titulli ekzekutiv është vendim gjyqësor apo jo. Në rastet kur titulli ekzekutiv është vendim gjyqësor mundësia për ta kundërshtuar është më e vogël për shkak të parimit të gjësë së gjykuar dhe faktit që gjykimi për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv nuk mund të konceptohet si mjet ankimi ndaj një vendimi gjyqësor. Kjo do të thotë që një titull ekzekutiv i tillë mund të kundërshtohet vetëm për fakte të ngjara pas dhënies së vendimit. Ky dallim duket me vlerë veçanërisht në rastet kur vendimit gjyqësor i është dhënë ekzekutim i përkohshëm dhe si i tillë mund të shërbejnë si titull ekzekutiv dhe ndaj tyre nuk mund të ngrihen, gjatë gjykimit për pavlefshmëri, arsye që mund apo duhet të jenë motive ankimi para gjykatës së apelit, siç mund të jenë vlerësimi jo i drejtë i provave dhe i fakteve apo interpretimi i gabuar i ligjit nga ana e gjykatës. Gjithashtu, arsyet që mund të çojnë në gjykimin për pavlefshmëri të titullit ekzekutiv nuk mund të jenë ato që mund të formojnë objekt të një kërkese për rishikimi pasi edhe ky është mjet ankimi dhe si i tillë është i ndarë nga gjykimi për pavlefshmëri të titullit ekzekutiv.

Peçullimi i ekzekutimit gjatë gjykimit të çështjes

Si rregull gjykata mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit me apo pa garanci. Një ndërhyrje domethënëse në këtë nen në vitin 2013 e ka ngushtuar mjaft këtë kompetencë të gjykatës në rastet kur titulli ekzekutiv është një “akt për dhënien e kredive” bankare apo të institucioneve financiare. Në këto raste pezullimi jepet vetëm me garanci dhe vetëm për një kohë të kufizuar prej 3 muajsh.

Në këtë kontekst meriton pak trajtim se sa duhet të jetë masa e garancisë së ofruar apo të vendosur nga gjykata. Në mungesë të termave të qartë të referencës mendojmë se interpretimi më i saktë i normës është që garancia të mbulojë vetëm dëmin që mund t’i shkaktohet kreditorit nga vonesa në ekzekutim për shkak të gjykimit mbi pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv.

Gjykata e merr në shqyrtim padinë për pavlefshmëri të titullit ekzekutiv brenda pesë ditëve, pra në një kohë relativisht të shpejtë dhe kundër vendimit të saj mund të ushtrohet ankim sipas dispozitave mbi ankimet e veçanta.

8.5.2. Kundërshtimi i veprimeve të përmbaruesit gjyqësor (neni 611)

Ndryshe nga padia për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, kundërshtimi i veprimeve të përmbaruesit gjyqësor nuk ka për qëllim të godasë të drejtën për të kryer ekzekutimin e detyrueshëm por zhvillimit e rregullt të vetë ekzekutimit.

Duhet përmendur që në fillim se mundësia për kundërshtuar veprimet përmbarimore nuk parashikohet vetëm në neni 610 të K.Pr.C. por edhe në nene të tjera të veçanta si neni 527 për vënien e sekuestros përtej masës që është e nevojshme për plotësimin e detyrimit, neni 529 për vendosjen e sekuestros mbi sende mbi të cilat nuk mund të vihet sekuestroja, neni 533 për sekuestron mbi pagën përtej minimumit jetik, nenet 538 dhe 539 mbi projektin e ndarjes së shumave, neni 564 mbi vendimin për caktimin e çmimit të sendit, neni 580 mbi pronësinë e sendit të shitur në ankand, nenet 583, 588, 598, 601 dhe 606 mbi gjrobat e vendosura nga përmbaruesi gjyqësor.

Lloji i aktit

Kjo është pjesa më e paqartë dhe që mund të jetë akoma objekt diskutimi. Vetë Kodi i Procedurës Civile përdor në dy nene terminologji të ndryshme. Nga njëra anë përdor termin “ankim”⁹⁹ si akt të parë të këtij gjykimi në nenin 610, po në të njëjtin nen cilëson se përmbaruesi thirret në gjykim me cilësinë e personit të paditur dhe nga ana tjetër përdor termin “padi”¹⁰⁰ kur në nenin 616 rreshton

⁹⁹ Kodi i Procedurës Civile, neni 610, paragrafi i parë

¹⁰⁰ Kodi i Procedurës Civile, neni 616, shkronja ç)

shkaqet e pushimit të ekzekutimit. Pavarësisht nga paqartësia në gjuhën e Kodit, duhet theksuar se praktika gjyqësore është tashmë e konsoliduar në bindjen se akti fillestar i gjyqimit mbi kundërshtimet ndaj veprimeve përmbartimore është një padi dhe si e tillë duhet të përmbushë të gjitha kërkesat e parashikuara nga nenet përkatëse të Kodit të Procedurës Civile.

Subjektet që mund të ngrenë këtë lloj padie janë edhe më të shumtë se sa në rastin e kërimit të pavlefshmërisë së titullit ekzekutim pasi këtu përfshihen jo vetëm palët klasike në procesin e ekzekutimit, por edhe subjekte të tjera që mund të preken, jo nga thelbi i ekzekutimit por nga veprimet e veçanta të përmbartuesit gjyqësor. Një rrethanë e tillë pranohet e dhe nga vetë Kodi i cili në rastin e nenit 610 përdor shprehjen “palët” dhe jo debitori si në rastin e nenit 609. Pra, i legjitimuar për të ngritur këtë lloj padie është jo vetëm debitori por të gjithë ato subjekte të cilëve u paragjykohej te drejta apo interesa të ligjshme nga kryerja e një veprimi apo nga refuzimi për të kryer një veprim. Përmbartuesi gjyqësor thirret në cilësinë e të paditurit ndërsa të gjithë të tjerët, përfshirë kreditorin që ka kërkuar fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm, thirren me cilësinë e personit të tretë.

Një tjetër veçanti e kundërshtimit të veprimeve përmbartimore është se gjykata mund të procedojë dhe të marrë vendim edhe pa i thirrur palët në gjykim. Gjithsesi, Gjykata e Lartë është munduar ta kufizojë këtë mundësi me anën e një vendimi unifikues¹⁰¹ ku konsiderohet si e domosdoshme thirrja e palëve në gjykim sa herë që ky është i vetmi mjet për të garantuar pjesëmarrjen e tyre në proces dhe tutelën e të drejtave apo interesave të tyre.

Momenti i ngritjes së padisë dhe gjykata kompetente

Normalisht, ngritja e një padie të tillë presupozon veprime përmbartimore kështu që një padi e tillë mund të ngrihet vetëm kur ekzekutimi nga filluar. Padia ngrihet brenda pesë ditëve nga kryerja e veprimit apo mosveprimit ose nga momenti i marrjes dijeni për të.

Sipas nenit 610, padia ngrihet para “gjykatës që ekzekuton vendimin” apo “gjykatës ku ekzekutohet titulli ekzekutiv” në varësi të faktit nëse përmbartuesi gjyqësor është organi shtetëror apo një privat i licencuar për të ushtruar funksionet e përmbartuesit. Përveç faktit që duket shumë e vështirë të dallohet ndërmjet dy mundësive nuk kuptohet as arsyeja që shtyn legjislatorin të adoptojë dy kritere apo dy paragrafë të ndryshëm për të njëjtin fenomen, atë të kundërshtimit të veprimeve përmbartimore. Gjithsesi, mendojmë se interpretim më korrekt ngelet se padia duhet të paraqitet në gjykatën e vendit kompetente për ekzekutimit që, sa kohë i paditur ngelet përmbartuesi gjyqësor, është gjykata ku ky i fundit ka selinë apo zyrën.

¹⁰¹ Gjykata e Lartë, Vendim Unifikues nr. 13 datë 23.03.2004

Çfarë mund të kërkohet

Gjykimi është gjykim themeli mbi veprime të veçanta përmbartimore dhe për rrjedhojë para gjykatës i kërkohet anulimi/shfuqizimi i veprimit përkatës përmbartimor qoftë për arsye formale qoftë për arsye substanciale.

Peçullimi i ekzekutimit gjatë gjykimit të çështjes

Gjykata mund të vendosë të pezullojë ekzekutimin por, në rastet kur titulli ekzekutiv është “akt për dhënien e kredive” nga banka apo institucione financiare, pezullimi e humbet fuqinë pas 20 ditësh nga vendosja e tij.

Gjykata e merr në shqyrtim padinë për pavlefshmëri të titullit ekzekutiv brenda njëzetë ditëve dhe kundër vendimit të saj mund të ushtrohet ankim sipas dispozitave mbi ankimet e veçanta.

8.5.3. Padia e personit të tretë (neni 612)

Së fundmi, mundësia për të kundërshtuar ekzekutimin e detyrueshëm i jepet edhe personave të tretë që pretendojnë se janë pronarë të sendeve mbi të cilët po kryhet ekzekutimi. Kjo procedurë ekziston në mënyrë që të tutelojë personat e tretë nga sakrificimi i paligjshëm i të drejtave të tyre si rrjedhojë e përfshirjes së gabuar, të sendeve në pronësi të tyre, në ekzekutimin e detyrueshëm.

Sërisht jemi përpara një gjykimi themeli që ndjek rregullat e përgjithshme të gjykimeve civile dhe ku të tretit i takon të provojë pronësinë mbi sendet. Një padi e tillë ngrihet më shpesh në rastet kur objekt i ekzekutimit janë sendet e luajtshme dhe vetëm bë raste të rralla kur sendet janë të paluajtshme.

Lloji i aktit

Kodi e përcakton shumë qartë që gjykimi fillon me padinë e të tretit ku të paditur janë debitori dhe kreditori. Përmbartuesi gjyqësor duhet të thirret me cilësinë e personit të tretë.

Momenti i ngritjes së padisë gjykata kompetente

Duke qenë se padia e të tretit është një nga mjetet e mbrojtjes gjatë ekzekutimit, atëherë padi mund të ngrihet vetëm gjatë ekzekutimit të detyrueshëm. Kjo do të thotë që i tretë mund të ngrëjë këtë lloj padie fill pas vendosjes së sekuestros mbi sendin dhe derisa të ketë përfunduar ekzekutimi. Padia duhet të ngrihet para gjykatës së vendit ku duhet të kryhet ekzekutimi.

Çfarë kërkohet

Me padinë gjykatës i kërkohet të njohë pronësinë e të tretit mbi sendin dhe të heqë sekuestron apo të përjashtojë sendin nga shitja.

Pezullimi i ekzekutimit gjatë gjykimit të çështjes

Gjykata mund të pezullojë ekzekutimin me ose pa garanci.

Efektet ndaj personit te tretë

Nenet vijues parashikojnë një seri efektesh për personin e tretë në rast se padia pranohet nga gjykata dhe sendi ndërkohë është shitur. Efektet ndryshojnë në varësi të faktit nëse sendi është i luajtshëm apo i paluajtshëm, nëse çmimi i shitjes apo sendi i është dhënë kreditorit dhe nëse kreditori kishte dijeni se debitori nuk ishte pronar në kohën e shitjes. Kodi ka një preferencë për qarkullimin e lirë të sendeve të luajtshme dhe tregohet i ngurtë kur sendet janë të paluajtshme dhe në të dyja rastet tutëlon të drejtat e blerësve të tretë në mirëbesim.

Kështu, nëse sendi është i luajtshëm dhe sendi është shitur ai ka të drejtë të marrë ose çmimin e shitjes nga përmbaruesi apo nga debitori. Nëse kreditori kishte dijeni se sendi nuk ishte pronë e debitorit, i treti merr nga debitori çmimin e përfituar apo sendin nëse i është dorëzuar këtij të fundit.

Siç u përmend më sipër, Kodi është më i ngurtë në rastet e sendeve të paluajtshme. I treti ka gjithmonë të drejtë të marrë sendin qoftë kundrejt kreditorit nëse sendi i është dorëzuar këtij, qoftë ndaj blerësit nëse sendi është shitur në ankand.

Në të gjitha rastet blerësit në ankand apo shitje të lirë kanë të drejtë ose të mbajnë sendin, në rastet e sendeve të luajtshme ose të rikuperojnë të gjitha shumat e paguar në rastet e sendeve të paluajtshme.

KREU 9

PARAQITJA DHE SHQYRTIMI I KËRKESËS PËRPARA GJYKATËS EVROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT

Holger HEMBACH

9.1. Hyrje

Neni 1 i KEDNJ-së i ngarkon shtetet anëtare me detyrim që t'u sigurojnë personave nën juridiksionin e tyre, të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Konventë, ndërsa Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut është instrumenti të cilës i është besuar garantimi i respektimit të këtij angazhimi, të marrë nga shtetet palë të KEDNJ. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut e ushtron këtë funksion duke gjykuar kryesisht mbi kërkesat e paraqitura nga shtetet (neni 33 i KEDNJ) ose nga individët (neni 34 i KEDNJ).

Në këtë kapitull do të trajtojmë vetëm kushtet që duhet te plotësojë një kërkesë individuale që kjo të pranohet përpara Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Individët ose grupe të caktuara individësh që mendojnë se një (ose disa) prej të drejtave të tyre të parashikuara në këtë Konventë, janë shkelur nga një shtet i cili e ka ratifikuar KEDNJ, mund t'i paraqesin një kërkesë Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Kjo e fundit, pasi e shqyrton kërkesën në fjalë mund të vendos nëse kërkesit i është shkelur apo jo një e drejtë që parashikohet nga KEDNJ. Në vendimin e saj, Gjykata, përveç deklaramit se një shtet anëtar e ka shkelur në rastin konkret Konventën, mund të japë edhe një dëshmëpërbllim për dëme morale apo materiale, ose të urdhërojë ndryshime të caktuara strukturore në sistemin ligjor dhe institucional të shtetit të paditur. Kështu, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ofron një rrugë më shumë për t'u ndjekur nga individi, në rast të mos respektimit nga ana e shtetit anëtar të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të mishëruara në Konventë.

Kërkesa drejtuar Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut duhet të përmbushë disa kritere. Fillimisht Gjykata verifikon nëse janë plotësuar ose jo këto kritere dhe më pas ajo vendos nëse do ta pranojë apo jo kërkesën për ta

shqyrtuar atë në themel. Nëse Gjykata del në përfundimin se në kërkesë nuk janë përmbushur të gjitha kriteret, ajo e refuzon kërkesën si të papranueshme – pavarësisht rëndësisë që ka shkelja e të drejtave të njeriut në përmbajtjen e kërkesës. Ky vendim mund të jepet ose si një hap i veçantë procedural në formën e një vendimi jo përfundimtar ose si pjesë e një gjykimi.

Në praktikë, pranueshmëria rezulton të jetë pragu të cilin mund të mos e kalojnë, e për pasojë të rrezohen, shumë kërkesa; në vitin 2013, nga 49 952 raste të gjykuara nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, 48 112 kërkesa janë shpallur të papranueshme¹⁰². Nga 111 kërkesa në lidhje me Shqipërinë që Gjykata i ka trajtuar në vitin 2012, 100 u shpallën të papranueshme¹⁰³. Si rrjedhojë, avokatët që mendojnë të paraqesin një rast përpara Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, këshillohen të analizojnë me detaje nëse çështja e tyre është gati për t'u paraqitur në Gjykatën e Strasburgut apo jo. Kriteret e pranueshmërisë u duhet kushtuar vëmendje që më parë. Baza për një kërkesë të suksesshme në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, krijohet gjatë procedimit në vetë shtetin në fjalë dhe mosveprimi në këtë fazë mund t'i shkaktojë një çështjeje konkrete, një dëm të pariparueshëm sa i përket paraqitjes së saj para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Kriteret për pranueshmërinë e kërkesave mund të nxirren edhe nga funksioni që ka dhe mandati i vetë Gjykatës. Në këtë kuadër disa nga kriteret specifikohen në nenin 34 e 35 të KEDNJ-së. Kështu për shembull përcaktohet se Gjykata ka mandatin të sigurojë respektimin e detyrimeve që u lindin shteteve nga KEDNJ-ja. Ndërsa, Konventa është detyrim ligjor për një shtet që në çastin e hyrjes së saj në fuqi në atë shtet dhe pikërisht nga ai çast Gjykata ka për detyrë t'i vërë në zbatim detyrimet që lindin për shtetin e anëtarësuar. Si pasojë, Gjykata mund të trajtojë vetëm shkeljet (e mundshme) të kryera pas vënies në zbatim të Konventës në shtetin e paditur. Ky është juridiksioni ne kohe ose *ratione temporis* i Gjykatës.

Meqenëse Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut siguron respektimin e KEDNJ-së, ajo mund të përdoret vetëm për kërkesat e bazuara në një nga të drejtat e garantuara nga Konventa. Ky është juridiksioni lëndor i Gjykatës (*ratione materiae*).

Detyrimi për të siguruar të drejtat dhe liritë themelore të parashtruara në përmbajtjen e Konventës, është një detyrim që rëndon mbi shtetet nënshkruese. Për rrjedhojë, edhe kërkuessit mund të ankohen vetëm ndaj veprimeve ose

¹⁰² Statistikat në website-in e Gjykatës nga data 1 gusht 2013 http://www.echr.coe.int/Documents/Stats_month_2013_ENG.pdf

¹⁰³ Profili i Shqipërisë në website-in e Gjykatës: http://www.echr.coe.int/Documents/CP_Albania_ENG.pdf

mosveprimeve të këtyre shteteve ose agjentëve të tyre. Në të njëjtën logjikë, vetëm personat të cilët janë subjektet përfituese të të drejtave që parashikon Konventa, kanë të drejte që të paraqesin përpara Gjykatës, kërkesë. Ky është juridiksioni ***ratione personae*** i Gjykatës.

Neni 34 sqaron se personat e mbrojtur nga KEDNJ-ja mund ta bazojnë kërkesën e tyre vetëm mbi veprime apo mosveprime që kanë ndikuar tek ata si persona, jo mbi shkelje të të drejtave të të tjerëve, d.m.th. ata duhet të jenë (ose, në fazën e pranueshmërisë – të pretendojnë të jenë) **viktima** të një shkeljeje. Për këtë arsye, nuk ka *actio popularis*.

Si një Gjykatë ndërkombëtare, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut është hapi i fundit për të dhënë zgjidhje. Është parim i së drejtës ndërkombëtare që shteteve t'u jepet mundësia t'i zgjidhin vetë çështjet para se të futet në skenë, kontrolli ndërkombëtar¹⁰⁴. Prandaj, para se një kërkesë t'i paraqitet Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, duhet të **shterohen zgjidhjet e ofruara në vend** (neni 35 KEDNJ).

Shtetet kanë interes të justifikueshëm për të ditur nëse sjellja e tyre, në një çështje të caktuar, do të shqyrtohet nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut. Për këtë arsye, kërkesat duhet të paraqiten brenda një **periudhe të caktuar kohore**. Neni 34 i KEDNJ-së, sipas përmbajtjes së tij në kohën që po shkruajmë, përcakton një afat gjashtë mujor; me hyrjen në fuqi të protokollit 15 të KEDNJ-së, kjo periudhë shkurtohet në katër muaj.

Konventa mbron të drejtat dhe liritë themelore. Për këtë arsye, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut i shpall çështjet e parëndësishme si të papranueshme. Ky është kriteri i **disavantazhit të konsiderueshëm** sipas nenit 35 paragrafi 3 (b).

9.2. Faza e pranueshmërisë së kërkesës

9.2.1. Pajtueshmëria

9.2.1.1. Juridiksioni *ratione temporis*

Siç u përmend më sipër, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka misionin të sigurojë respektimin e detyrimeve që lindin nga KEDNJ-ja. Këto detyrime lindin për shtetet nënshkruese, në çastin e hyrjes në fuqi të KEDNJ-së në shtetin përkatës. Për pasojë, Gjykata e Strasburgut mund të shqyrtojë sjelljen

¹⁰⁴ Tanase kundër Moldavisë (kërkesa nr. 7/08), gjykim i Dhomës së Madhe i datës 27 prill 2010, paragrafi 120, Remli kundër Francës (kërkesa nr. 16839/90), gjykim i datës 23 prill 1996.

e një shteti nën dritën e KEDNJ-së, duke filluar vetëm nga çasti i hyrjes në fuqi të Konventës në këtë shtet. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka juridiksion *ratione temporis*, që nga data e fillimit të zbatimit të KEDNJ-së¹⁰⁵.

Në Republikën e Shqipërisë, KEDNJ-ja hyri në fuqi më 2 tetor 1996, e për pasojë kërkesat ndaj shtetit shqiptar mund të bazohen vetëm mbi shkelje të KEDNJ-së duke filluar që nga kjo datë. Zbatimi i këtij rregulli mund të jetë i vështirë sidomos në rastet kur një sërë ngjarjesh kanë filluar të ndodhin përpara zbatimit të KEDNJ-së në shtetin e paditur dhe kanë përfunduar pas kësaj date. Në këto raste duhet përcaktuar se cilat nga faktet përbëjnë ndërhyrje/shkelje në të drejtat e njeriut të garantuara nga Konventa dhe kur kanë ndodhur ato. Për shembull, nëse një gazetar para hyrjes në fuqi të KEDNJ-së, publikon një artikull dhe për shkak të tij ai dënohet për shpifje, vendim ky që shpallet pas datës së hyrjes në fuqi të Konventës, lind pyetja nëse ka apo nuk ka juridiksion *ratione temporis* Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, për të shqyrtuar kërkesën e gazetarit?

Në përgjithësi, çasti vendimtar për përcaktimin e juridiksionit *ratione temporis* të Gjykatës, është koha e saktë e ndërhyrjes faktike të saj në shtetin përkatës. Gjithashtu, duhet përcaktuar se cilat fakte nga një seri ngjarjesh, përbëjnë shkelje të një të drejte të Konventës¹⁰⁶, pasi në lidhje me këtë rregull ekzistojnë dy përjashtime. Një përjashtim zbatohet në rastin e të ashtë quajturave “*detyrime të ndashme*” dhe ka lidhje me shkeljet e nenit 2 (e drejta e jetës) ose nenit 3 (ndalimi i torturës, trajtimit çnjerëzor dhe degradues) të KEDNJ-së, shkelje këto që kanë ndodhur përpara pasjes së juridiksionit *ratione temporis* të Gjykatës, por që krijojnë detyrime të veçanta procedurale të cilat mund të ekzistojnë ende (dhe të shkelen) edhe pas hyrjes në fuqi të Konventës. Një tjetër përjashtim nga ky rregull vlen për rastet e të ashtë quajturave “*shkelje të vazhdueshme*”. Me këto të fundit duhet të kuptojmë situata të ndryshme ku një sjellje e caktuar nga një shtet, ka filluar të kryhet përpara hyrjes në fuqi të Konventës dhe ka vazhduar ose është përfunduar pas hyrjes së saj në fuqi.

Në fund, kur Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vendos se ka juridiksion *ratione temporis* në një çështje të caktuar, ajo prapë se prapë mund të marrë parasysh në vendimet e saj, edhe fakte që kanë ndodhur përpara datës së hyrjes së saj në fuqi.

¹⁰⁵ Përpara krijimit të GJEDNJ-së si një gjykatë e përhershme në vitin 1998, shtetet mund të vendosnin nëse dhe nga cila datë të praninin juridiksionin e Gjykatës. Në këtë rast, kjo datë ishte data vendimtare. Meqenëse ky opsion nuk ekziston më, teksti i referohet si datë relevante datës kur Konventa hyri në fuqi.

¹⁰⁶ Blečić kundër Kroacisë, paragrafi 81 (kërkesa nr. 59532/00) vendim i Dhomës së Madhe i datës 8 mars 2006, paragrafi 82

9.2.1.1.1. Përcaktimi i momentit të veprimit të Konventës

Në rastin kur, një sërë ngjarjesh kanë ndodhur, pjesërisht përpara hyrjes në fuqi të KEDNJ-së dhe pjesërisht më pas hyrjes në fuqi të saj, duhet të përcaktohet se cila ka qenë koha e saktë e ndodhjes së ngjarjeve në raport me atë të hyrjes në fuqi të Konventës. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut e bën këtë vlerësim duke marrë në konsideratë, faktet mbi të cilat e bazon kërkesën e kërkesës në fuqi të saj, si dhe fushën e veprimit në kohë të Konventës në fjalë¹⁰⁷.

Pyetja se cili veprim në një seri ngjarjesh përbën shkelje, lind shpesh nëse një shtet ka ndërmarrë një veprim përpara hyrjes në fuqi të Konventës dhe kërkesi e ka kundërshtuar këtë veprim para gjykatave të vendit, të cilat e kanë marrë vendimin pas datës së hyrjes në fuqi të Konventës. Lidhur me këtë çështje, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut është shprehur në shumë vendime të saj se ajo nuk ka juridiksion *ratione temporis*, për faktin se procedurë ligjore kombëtare ka qenë ende në proces, në kohën e hyrjes në fuqi të KEDNJ-së.

Në çështjen *Jovanovic kundër Kroacisë*¹⁰⁸, kërkesi ishte i punësuar në administratën publike. Ai ishte pushuar nga puna në vitin 1992 sepse kishte votuar në një referendum për autonominë politike serbe në Kroaci, çka konsiderohej e paligjshme. Ai e kundërshtoi pushimin nga puna duke iu drejtuar gjykatës kroate. Më 5 nëntor 1997, në Kroaci hyri në fuqi KEDNJ-ja. Vendimi përfundimtar i Gjykatës Kushtetuese të Kroacisë i cili rrëzoi ankimin kushtetues të kërkesit, u shpall në vitin 1999. Kërkesi iu drejtua Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, e cila vendosi se ajo nuk kishte juridiksion *ratione temporis*, për të trajtuar këtë kërkesë. Gjykata u shpreh se kërkesi ishte pushuar nga puna përpara hyrjes në fuqi të KEDNJ-së në Kroaci. Në këtë rast Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut çmoi se nuk mund të ndante vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kroacisë nga faktet që çuan në marrjen e këtij vendimi, përndryshe një vendim pranimi do t'i jepte Konventës fuqi prapaveprues dhe do ta bënte të pavlefshme deklaratën e Kroacisë për " *marrje përgjegjësie para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut për shkelje të ndodhura pas 5 nëntorit 1997*".

Në çështjen *Blecic kundër Kroacisë*¹⁰⁹, kërkesi kishte një të drejtë të veçantë qiramarrjeje mbi një apartament në Zadar, Kroaci. Sipas ligjit në fuqi, kjo e drejtë përfundonte në rast se mbajtësi i saj nuk qëndronte në apartament për më shumë se gjashtë muaj radhë pa arsye. Në vitin 1991, kërkesja shkoi për vizitë tek

¹⁰⁷ Blecic kundër Kroacisë (Kërkesa nr. 59532/00) Vendim i Dhomës së Madhe i datës 8 mars 2006, paragrafi 82

¹⁰⁸ Kërkesa nr. 59109/00, vendim për pranueshmërinë i datës 28 shkurt 2002

¹⁰⁹ Shihni më sipër

e bija në Itali. Për arsye të ndryshme të lidhura me konfliktin në Jugosllavi, ajo nuk u kthye në apartamentin e vet. Në vitin 1992, Bashkia e Zadarit filloi procedurat kundër kërkuesit për t'i hequr të drejtën e qiramarrjes së veçantë. Gjykata e shkallës së parë e pranoi kërkesën; kërkuesi e apeloj vendimin; në vitin 1996, Gjykata Supreme e hodhi poshtë përfundimisht apelimin dhe konfirmoi ndërprerjen e kushteve të veçanta të qiramarrjes. Kërkuesi apeloj në Gjykatën Kushtetuese, e cila në vitin 1999 gjykoj se ndërprerja e qiramarrjes me kushte të veçanta nuk përbënte ndonjë shkelje të të drejtave kushtetuese të kërkuesit. Meqë KEDNJ kishte hyrë në fuqi në Kroaci në nëntor 1997, kërkuesi iu drejtua Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Dhoma e Madhe e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut vendosj se nuk kishte juridiksion *ratione temporis* për të shqyrtuar kërkesën në fjalë e cila ishte e bazuar ne përmbajtjen e nenit 8 (e drejta për banesë) dhe të nenit 1 të protokollit 1 të KEDNJ-së. Gjykata e Strasburgut e rrëzoi argumentin e kërkuesit se, ndërprerja e të drejtës së veçantë për qiramarrje përbënte shkelje të neneve të sipërpërmendura te Konventës, me argumentin se drejta për qiramarrje mund të ndërpritej vetëm me anë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë. Në rastin konkret Gjykata Evropiane të të Drejtave të Njeriut konstatoi se kërkuesit i ishte ndërprerë e drejta e veçantë e qirasë me dhënien e vendimit civil nga Gjykata Supreme i cili konsiderohej si i formës së prerë. Meqenëse ky vendim ishte shpallur përpara hyrjes në fuqi të Konventës, Gjykata nuk kishte juridiksion *ratione temporis* për të shqyrtuar rastin. Për sa i përket gjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Kroacisë në këtë rast (i cili ishte shpallur pas datës së hyrjes në fuqi të Konventës), Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut u shpreh se ai vetëm sa konfirmonte ligjshmërinë e vendimit të Gjykatës Supreme dhe nuk mund të konsiderohej si shkelje e mundshme e të drejtave të njeriut në të drejtën e vet (është dëshmi e ndërlikimit të përcaktimit nëse Gjykata ka juridiksion, pavarësisht se, një Dhomë e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut e kishte shpallur kërkesën të pranueshme; për sa i përket procedurës përpara Gjykatës së Strasburgut shihni më poshtë).

Ndryshe nga ky rast, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut u shpreh se kishte juridiksion *ratione temporis* në çështjen *Zana kundër Turqisë*¹¹⁰. Kërkuesi ishte mbështetës i PKK (Partia e Punëtorëve Kurdë). Përpara hyrjes në fuqi të KEDNJ-së në Turqi, ai kishte deklaruar se vrasjet e kryera nga PKK ishin të justifikuar. Ai u akuzua dhe u dënua për “justifikim të një krimi serioz” (shkelje sipas të drejtës turke), pas hyrjes në fuqi të Konventës në Turqi. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut u shpreh se kishte juridiksion *ratione temporis*

¹¹⁰ Kërkesa nr. 69/1996/6888/880, Gjykim i Dhomës së Madhe i datës 8 mars 2006

për kërkesën e bazuar në nenin 10 (e drejta e shprehjes). Gjykata u shpreh se nuk ishte data e shpalljes së vendimit momenti në kohë që duhej të merrej si bazë për të gjykuar nëse Gjykata kishte apo jo juridiksionin *ratione temporis*, por data e dënimit të kërkuarit, sepse ishte dënimi ai që përbënte shkeljen e mundshme të të drejtave të Konventës (në themel Gjykata nuk gjeti shkelje të së drejtës së lirisë së shprehjes).

9.2.1.1.2. Detyrimet e ndashme

E drejta e jetës (neni 2 i KEDNJ-së) dhe ndalimi i torturës, i trajtimit çnjerëzor e degradues (neni 3 i KEDNJ-së) zënë një vend të rëndësishëm midis të drejtave të garantuara në Konventë. Është në juridiksionin afatgjatë dhe të përhershëm të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, vlerësimi i përmbushjes së detyrimit që kanë shtetet kontraktuese, për të hetuar rastet efektive të shkeljeve të mundshme të këtyre të drejtave. Vetëm kështu mund të sigurohet që këto të drejta të jenë praktike dhe efektive, ashtu siç edhe kërkohet nga Konventa. Këto detyrime me të cilat ngarkohet shteti anëtar, evidentohen si gjymtyrët proceduralë të neneve 2 dhe 3 dhe janë të ndara nga detyrimet materiale që parashikohen në këto nene (d.m.th. të mos torturosh ose të mos marrësh jetën), e për pasojë mund të jenë më vete, objekt shkeljesh.

Një shkelje e mundshme ndaj të drejtës së jetës apo ndaj ndalimit të torturës, e ndodhur kjo para zbatimit të Konventës, mundet që ende të nxisë për shtetin një detyrim procedural i cili vazhdon të ekzistojë edhe pas hyrjes së saj në fuqi dhe dhënies së një vendimi gjyqësor. Nëse një shtet nuk përmbush detyrimin e tij për të kryer një hetim efektiv në këtë fazë, kjo mund të çojë në një shkelje të veçantë të gjymtyrës procedurale të nenit 2 apo 3, e cila futet nën juridiksionin *ratione temporis* të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Gjykata e ka përcaktuar këtë në çështjen *Silib kundër Sllovenisë*¹¹¹. Në këtë rast, i biri i kërkuarve kishte pasur reaksion alergjik nga mjekimet që i ishin dhënë në një spital. Ai vdiq në maj të vitit 1993. Sllovenia ratifikoi Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut në qershor të vitit 1994. Kërkuarët u përfshinë në një proces të gjatë gjyqësor në Slloveni, me pretendimin se vdekja e djalit të tyre kishte ardhur si pasojë e neglizhencës mjekësore dhe se mjekët e tij duhet të mbanin përgjegjësi. Meqë nuk patën sukses, ata paraqitën një kërkesë para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në të cilën iu referuan, midis të tjerash, nenit 2 të KEDNJ-së. Qeveria sllovene kundërshtoi juridiksionin *ratione temporis* të Gjykatës, sepse vdekja kishte ndodhur përpara hyrjes në fuqi të Konventës.

¹¹¹ Kërkesa nr. 71463/01, Gjykim i Dhomës së Madhe i datës 9 prill 2009

Dhoma e Madhe e Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut deklaroi se rëndësia e veçantë e të drejtave të parashtruara në nenin 2 dhe 3 të Konventës justifikojnë devijimin nga rregullat e përgjithshme për *ratione temporis*. Ajo theksoi se shtetet kontraktuese kanë detyrimin për të kryer një hetim efektiv në rast vdekjesh në rrethana të caktuara, detyrim ky që ishte shndërruar në një detyrë autonome. Gjykata theksoi gjithashtu se parimi i sigurisë juridike kërkonte që përgjegjësia e shtetit të kufizohej në dy mënyra:

- Vetëm aktet procedurale të kryera nga shteti i paditur, pas ratifikimit të Konventës, mund të jenë objekt shqyrtimi në lidhje me detyrimin e shtetit për të kryer një hetim efektiv.
- Një pjesë domethënëse e hapave të kërkuar proceduralë duhet të jenë kryer pas ratifikimit të Konventës nga shteti në fjalë.

Në çështjen *Silih*, Gjykata ka lënë “një derë hapur” për të zgjeruar më tej përgjegjësinë e shtetit, duke u shprehur se “*Gjykata nuk përjashton rastin se në rrethana të caktuara, shkak mund të bazohet edhe mbi nevojën për të siguruar mbrojtjen reale dhe efektive të garancive dhe vlerave të Konventës*’.

Megjithatë, në gjykimin e kohëve të fundit në çështjen *Janowiec dhe të tjerë kundër Rusisë*¹¹², Dhoma e Madhe konfirmoi kriteret e përcaktuara më sipër. Çështja kishte të bënte me hetimin e vrasjeve të qytetarëve polakë në kampet e të dënuarve të luftës nga forcat ruse në vitin 1940 (tragjedia *Katyn*). Dhoma e Madhe gjykoi që rasti nuk mund të pranohej për shkak të mungesës së *ratione temporis*, sepse pas hyrjes në fuqi të Konventës, nuk ishte bërë ndonjë hetim domethënës.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut nëpërmjet vendimeve të saj ka synuar të shpjegojë konceptin e detyrimeve procedurale që rrjedhin nga neni 2 ose 3 i KEDNJ-së. Kështu p.sh. neni 2 i KEDNJ-së bën fjalë për të drejtën se jetës. Referuar përmbajtjes së tij, shtetet nuk duhet të “marrin jetë”, përveçse në rrethanat e parashikuara po në nenin 2 të Konventës. Përveç kësaj, shteti anëtar ngarkohet me një detyrim të ndashëm i cili konsiston në kryerjen e një hetimi efektiv në rast të një vdekje të ndodhur në rrethana të veçanta. Ky detyrim lind nëse një individ vritet si pasojë e përdorimit të forcës nga agjentë shtetërorë¹¹³. Kjo nuk është e kufizuar vetëm për ato situata kur është e sigurt që ka pasur agjentë shtetërorë të përfshirë në vrasje apo kur veprimi që shkaktoi vdekjen është apo mund të jetë planifikuar që më përpara¹¹⁴. Edhe në ato raste kur nuk

¹¹² Kërkesa nr. 55508/07 dhe 29520/09, Gjykim i Dhomës së Madhe i datës 21 tetor 2013

¹¹³ McCann dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa nr. 18984/91, Gjykim i Dhomës së Madhe i datës 27 shtator 1995

¹¹⁴ Ergi kundër Turqisë (Kërkesa nr. 66/1997/850/1057), gjykim i datës 28 korrik 1998

ka dyshime për përfshirje të shtetit në vrasje, detyrimi procedural sipas nenit 2 të KEDNJ-së kërkon ekzistencën e një sistemi gjyqësor efikas dhe të pavarur për të përcaktuar shkakun e vrasjes dhe për të ndëshkuar palët fajtores¹¹⁵. Kjo vlen edhe në rastin e vdekjeve të pacientëve nën kujdes mjekësor, qoftë në një institucion shtetëror apo në sektorin privat¹¹⁶. Mospërmbushja e këtyre kritereve mund të përbëjë shkelje të veçantë të nenit 2.

Detyrimi i shtetit për të kryer një hetim zyrtar efektiv nuk është një detyrim që lidhet me rezultatin, por me mënyrat e hetimit. Kjo do të thotë se hetimi duhet të jetë i plotë dhe në gjendje të identifikojë në parim se kush është përgjegjës për shkeljen e të drejtave të njeriut, por fakti që autorët nuk identifikohen nuk do të thotë që hetimi nuk ka qenë efektiv. Autoritetet duhet të ndërmarrin të gjithë hapat e arsyeshëm të mundshëm për të siguruar prova¹¹⁷.

9.2.1.1.3. Shkelja e vazhdueshme

Nëse një ngjarje ka ndodhur përpara hyrjes në fuqi të KEDNJ-së, ajo mund të përfshihet në juridiksionin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut kur ka në themel të saj një shkelje të vazhdueshme, e cila vazhdon edhe pas datës së hyrjes në fuqi të Konventës. Koncepti “shkelje e vazhdueshme” nënkupton një situatë që jo vetëm nuk është në përputhje me KEDNJ-në, por që njëkohësisht edhe zgjat në kohë, dhe me vazhdimësinë e saj shkel në mënyrë të vazhdueshme Konventën.

Ky koncept merr më shumë kuptim në fushën e të drejtës së pronës. Një privim i thjeshtë nga pronësia mbi një send apo marrja e pronës së dikujt, është një veprim i menjëhershëm dhe nuk përbën shkelje të vazhdueshme. Gjykata nuk ka juridiksion *ratione temporis*, në rastet e konfiskimit të pronës përpara hyrjes në fuqi të KEDNJ-së, në një shtet përkatës. Kështu Gjykata vendosi në çështjen *Kopecky kundër Sllovenisë*¹¹⁸ se konfiskimi i monedhave të arit gjatë sundimit komunist ishte jashtë juridiksionit *ratione temporis*. Në çështjen *Hans Adam von Liechtenstein kundër Gjermanisë*¹¹⁹, Gjykata vendosi se konfiskimi i një pikturë, bazuar në dekretin e Benës pas Luftës së Dytë Botërore (dhe përpara hyrjes në fuqi të Konventës) kishte qenë një veprim i menjëhershëm për të cilin Gjykata nuk kishte juridiksion *ratione temporis*.

¹¹⁵ Mastromatteo kundër Italisë (Kërkesa nr. 37703/97), Gjykim i Dhomës së Madhe i datës 24 tetor 2002

¹¹⁶ Powell kundër Mbretërisë së Bashkuar (Kërkesa nr. 45305/99), vendim për pranueshmërinë i datës 4 maj 2000

¹¹⁷ Karabet dhe të tjerë kundër Ukrainës (Kërkesa nr. 38906/07), gjykim i datës 17 janar 2013

¹¹⁸ Kërkesa nr. 44912/98, Gjykim i datës 28 shtator 2004

¹¹⁹ Kërkesa nr. 42527/98, Gjykim i Dhomës së Madhe i datës 12 korrik 2001

Megjithatë, marrja e pronës dikujt mund të përbëjë shkelje të vazhdueshme nëse kjo shoqërohet paralelisht edhe me veprime të tjera, të cilat e përkeqësojnë ose thellojnë shkeljen e të drejtës së pronës. Në çështjen *Papamichaloupoulos kundër Greqisë*²⁰, kërkuessit ishin pronarë të një sipërfaqe toke. Pas vendosjes së regjimit diktatorial në Greqi në vitin 1967, fondi i Marinës Greke filloi ta përdorte këtë tokë, duke u mohuar kërkuessve aksesin mbi të. Ata e kundërshtuan këtë veprim dhe u përfshinë në një proces ligjor për 25 vjet. Edhe kur si rezultat i urdhrat të gjykatës për rikthimin e pronës kërkuessve, institucioni i përmbartimit u përpoq ta zbatonte vendimin e gjykatës duke i kthyer tokën kërkuessve, këtyre të fundit iu mohua aksesin në këtë tokë nga fondi i Marinës. Greqia e ratifikoi Konventën në vitin 1985. Edhe pse fondi i Marinës kishte marrë në “zotërim” pronën e kërkuessve shumë kohë përpara hyrjes në fuqi të Konventës në Greqi, Gjykata konstatoi se kishte juridiksion *ratione temporis* për të shqyrtuar këtë ankesë. Gjykata u shpreh se kishte pasur shkelje të vazhdueshme të Konventës, pasi shteti i paditur kishte penguar çdo përpjekje të kërkuessve për të rifituar tokën e tyre, duke mos zbatuar urdhrat e Gjykatës që u njihnin të drejtën e pronësisë kërkuessve.

Në çështjen *Hutten Czapska kundër Polonisë*²¹, kërkuessa ishte pronare e një banese dhe u ankua se, një sërë rregullash që kufizonin shumën e qirasë që ajo mund t’u caktonte qiramarrësve të saj, i shkelnin të drejtën e saj të pronësisë. Baza ligjore për këtë kufizim ishte krijuar në vitin 1974. Qeveria polake kundërshtoi juridiksionin *ratione temporis* të Gjykatës me argumentin se Polonia e kishte ratifikuar nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së, i cili përmban të drejtën e pronës, në vitin 1994. Gjykata e rrëzoi këtë argument duke u shprehur se kishte pasur shkelje të vazhdueshme. Gjykata vuri në dukje se ishte miratuar një legjislacion shtesë për kufizimin e qirasë pas datës përkatëse; ajo theksoi gjithashtu se ligjet në fjalë vazhdonin të preknin një numër të madh pronarësh në Poloni.

Fusha kryesore ku vihen në dukje shkeljet e vazhdueshme, është ajo e së drejtës së pronësisë. Megjithatë, shkelje të vazhdueshme mund të ketë edhe në lidhje me të drejta të tjera të parashtruara në Konventë. Për shembull, në çështjen *Kurica dhe të tjerë kundër Sllovenisë*²², kërkuessit ishin qytetarë të ish Jugosllavisë. Pas rënies së Jugosllavisë, atyre iu ishte mohuar shtetësia apo lejet e banimit në Slloveni. Vendimi në fjalë i autoriteteve sllovene, ishte miratuar përpara hyrjes në fuqi të Konventës në Slloveni dhe ishte bazuar në legjislacionin e miratuar përpara kësaj date. Megjithatë, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut konstatoi se kishte juridiksion *ratione temporis* për ta gjykuar këtë kërkesë, pasi “heqja” e kërkuessve

²⁰ Kërkesa nr. 14556/89, gjykim i datës 24 qershor 1993

²¹ Kërkesa nr. 35014/97, Gjykim i Dhomës së Madhe i datës 19 qershor 2006

²² Kërkesa nr. 26828/06, Gjykim i Dhomës së Madhe i datës 26 qershor 2012

nga regjistri civil, ndikonte tek ata edhe në kohën e fillimit të zbatimit të KEDNJ-së dhe vazhdoi t'i prekte ata edhe 15 vjet pas miratimit të Konventës.

Një çështje që vlen të trajtohet në kuadër të veprimit *ratione temporis* të Konventës, është edhe ai i trajtimit të kërkesave mbi rastet e zhdukjes së personave. Në çështjen *Varnava kundër Turqisë*¹²³, Dhoma e Madhe e Gjykatës vuri në dukje se, zhdukjet e personave duhet të dallohen si nga shkeljet e vazhdueshme, ashtu edhe nga vdekjet që sjellin detyrimin e shtetit për të hetuar. Ndryshe nga rasti i vdekjeve, zhdukjet e personave nuk konsiderohen një veprim i çastit. Nëse shteti përkatës ka pasur detyrimin për të hetuar apo dhe çfarë implikimesh kanë këto për juridiksionin *ratione materiae*, një fakt i tillë sipas qëndrimit të Gjykatës, duhet vlerësuar rast pas rasti.

9.2.1.1.4. Marrja në konsideratë e rrethanave që kanë ekzistuar përpara datës së hyrjes në fuqi të Konventës

Siç përmendet më sipër, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka juridiksion vetëm për ngjarje të ndodhura pas vënies në zbatim të KEDNJ-së në shtetin e supozuar përgjegjës për një shkelje. Ky kufizim nuk e pengon Gjykatën të marrë në konsideratë fakte të cilat kanë ndodhur para kësaj date, nëse kjo është e nevojshme për të kuptuar një shkelje të mundshme që ka ndodhur pas përcaktimit të juridiksionit *ratione temporis*¹²⁴.

Ky parim luan shpesh rol kur Gjykata shqyrton ankesa në lidhje me procese gjyqësore të cilat kanë zgjatur më shumë sesa duhet: Gjykata zakonisht fillon analizën me vlerësimin nëse ka pasur shkelje të së drejtës për gjykim të shpejtë duke përcaktuar me këtë rast edhe periudhën kohore që duhet të ishte marrë në konsideratë, d.m.th. kohëzgjatjen e procesit gjyqësor sipas Konventës. Meqë Gjykata ka juridiksion *ratione temporis* të shqyrtojë vetëm ankesa që janë bërë duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të KEDNJ-së në shtetin e paditur, periudha që merret në konsideratë nuk mund të fillojë përpara kësaj date. Megjithatë, Gjykata e Strasburgut merr parasysh fazën në të cilën duhet të ndodhë procesi ligjor në kohën e hyrjes në fuqi të KEDNJ-së¹²⁵. Për shembull, në çështjen *Atanasovic kundër Maqedonisë*¹²⁶, kërkesit kishin marrë një vendim gjyqësor për një çështje pronësie, në vitin 1988. Ata e filluan procesin e zbatimit të vendimit 14 vjet përpara, proces ky i cili nuk dha ndonjë rezultat të prekshëm. Në vitin 2002, ata

¹²³ Kërkesa nr. 16064/90, Gjykim i Dhomës së Madhe më 18 shtator 2009

¹²⁴ Broniowski kundër Polonisë (Kërkesa nr. 31443/96), vendim i Dhomës së Madhe për pranueshmërinë, datë 19 dhjetor 2002, paragrafi 74

¹²⁵ Foti kundër Italisë (Kërkesa nr. 7604/76), gjykim i datës 10 dhjetor 1982

¹²⁶ Kërkesa nr. 13886/02, gjykim i datës 22 dhjetor 2005

paraqitën një kërkesë para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Gjykata vërejtë se KEDNJ-ja kishte hyre në fuqi në Maqedoni më 10 prill 1997, e cila ishte edhe data e fillimit të periudhës që duhet të merrej në konsideratë për të vlerësuar nëse kohëzgjatja e procesit ishte e arsyeshme apo jo. Megjithatë, gjykata vuri në dukje se ne rastin konkret duhej të ishte marrë parasysh edhe situata ku ndodhej çështja në këtë datë. Në këtë drejtim, Gjykata vërejtë se procesi kishte zgjatur për mëse 6 vjet para hyrjes në fuqi të KEDNJ-së në Maqedoni.

9.2.1.2. Juridiksioni *ratione loci*

Shtetet që ratifikojnë KEDNJ-në angazhohen të sigurojnë të drejtat e parashtruara në Konventë për cilindo subjekt brenda juridiksionit të tyre. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka për detyrë të sigurojë respektimin e detyrimeve që lindin nga KEDNJ-ja, që do të nënkuptohet se ajo ka juridiksionin të vlerësojë vetëm kërkesat e personave që mbrohen nga Konventa, d.m.th. të personave brenda juridiksionit të njërit prej shteteve kontraktuese.

Termi “juridiksion” është kryesisht territorial¹²⁷. Shtetet kanë juridiksion mbi personat brenda kufijve territorialë të tyre; kjo nuk përfshin vetëm qytetarët e shteteve përkatëse, por mund të përfshijë edhe persona që jetojnë përkohësisht në një shtet të caktuar, turistë, kërkues për azil, dhe individë që qëndrojnë në mënyrë të paligjshme në një vend të caktuar. Kur ushtrojnë këtë juridiksion, shtetet kontraktuese duhet të respektojnë Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Nëse nuk e bëjnë këtë gjë, individët e ndikuar mund të paraqesin në fund një kërkesë para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Ndonëse koncepti “brenda juridiksionit” përgjithësisht i referohet kufijve të një vendi, në disa raste, referuar përmbajtjes së Konventës, veprimet e kryera jashtë territorit të tij mund të angazhojnë përgjegjësinë e një shteti. Megjithatë, siç është shprehur edhe Gjykata në çështjen *Bankovic kundër Belgjikës dhe të tjerë*¹²⁸, KEDNJ-ja është një “koncentrat i rendit publik evropian që vepron kryesisht në kontekstin rajonal dhe veçanërisht në hapësirën ligjore të shteteve kontraktuese”. Kështu që, vlerësimi i sjelljes së shteteve ne raport me Konventën jashtë kësaj hapësire, duhet të jetë objekt kushtesh të rrepta.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut është shprehur se një shtet duhet të sigurojë të drejtat e përmendura në Konventë edhe në një zonë jashtë kufijve të vet, nëse ushtron kontroll efektiv mbi këtë zonë. Në çështjen *Al-Skeini dhe të tjerë*

¹²⁷ Hirisjama dhe të tjerë kundër Italisë (Kërkesa nr. 27795/09), Gjykim i Dhomës së Madhe i datës 23 shkurt 2012

¹²⁸ Kërkesa nr. 52207/09, Vendim i Dhomës së Madhe për pranueshmërinë i datës 12 dhjetor 2001

*kundër Mbretërisë së Bashkuar*¹²⁹ familjarë të civilëve irakianë të vrarë nga ushtarë britanikë në Irak, u ankuan (në lidhje me të drejtën e anëtarëve të familjes për të paraqitur kërkesë) ndaj Mbretërisë së Bashkuar se kjo e fundit kishte shkelur detyrën për të kryer hetim efektiv, sipas nenit 2 të KEDNJ-së (e drejta e jetës). Gjykata e rrëzoi argumentin e qeverisë britanike se Konventa nuk aplikohej në këtë rast. Gjykata u shpreh se Mbretëria e Bashkuar – bashkë me Shtetet e Bashkuara – kishin ushtruar kontroll efektiv në territorin irakian dhe kishin ushtruar përkohësisht kompetenca qeveritare. Kështu që në këtë rast jo vetëm Konventa zbatohet, por edhe Gjykata e Strasburgut kishte juridiksion. Ndryshe ndodhi në çështjen *Bankovic kundër Belgjikës dhe të tjerë*¹³⁰, një kërkesë kjo e drejtuar kundër të gjithë shteteve anëtare të NATO-s për vdekjet e shkaktuara si pasojë e bombardimit në Beograd, ku Gjykata vendosi se nuk kishte juridiksion. Ajo vuri në dukje se fakti i thjeshtë që një shtet bombardoi një territor, nuk përbënte kontroll efektiv mbi atë territor. Po kështu, Gjykata vendosi që Beogradi dhe qytetarët e tij nuk ishin brenda juridiksionit të shteteve të paditura dhe e deklaroi kërkesën të papranueshme për arsye të mungesës së juridiksionit.

Juridiksioni mund të përcaktohet edhe kur një shtet anëtar ushtron kontroll fizik të një personi. Për shembull, në çështjen *Ocalan kundër Turqisë*¹³¹, kërkuesi ishte arrestuar nga forcat e sigurisë turke në aeroportin e Najrobit (Kenia). Ai u detyrua të hipë në një aeroplan turk dhe u dërgua në Turqi. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut u shpreh se kërkuesi ishte në juridiksionin e Turqisë që nga çasti i arrestimit në Najrobi, për shkak të kontrollit fizik të tij të kryer nga agjentët turq. Në të njëjtën linjë, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vendosi se ajo kishte juridiksion në çështjen *Medvedye kundër Francës*¹³². Në këtë rast, një anije luftime franceze kishte identifikuar një anije që lundronte nën flamurin e Kamboxhias dhe që besohet se transportonte drogë. Ushtarët francezë hynë në anije dhe e vendosën ekuipazhin e saj në izolim në zyrat e tyre për 14 ditë. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut u shpreh se ushtarët kishin qenë brenda juridiksionit të qeverisë franceze gjatë kësaj periudhe kohe për shkak të kontrollit fizik të ushtruar ndaj tyre nga ushtarët francezë.

9.2.1.3. Juridiksioni *ratione personae*

KEDNJ-ja u jep të drejta personave (dhe disa grupeve personash) kundrejt shteteve që kanë ratifikuar Konventën. Si pasojë, kushdo brenda juridiksionit

¹²⁹ Kërkesa nr. 55721/07, Gjykim i Dhomës së Madhe i datës 7 korrik 2011

¹³⁰ Shihni më sipër

¹³¹ Kërkesa nr. 46221/99, Gjykim i Dhomës së Madhe i datës 15 maj 2005

¹³² Kërkesa nr. 3394/03, Gjykim i Dhomës së Madhe më 29 mars 2010

të një shteti nënshkrues mund të bëjë kërkesë para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, për t'u ankuar se sjellja e këtij shteti nuk është në pajtim me Konventën. Dy aspektet e juridiksionit *ratione personae* të Gjykatës janë: (1) ajo mund të vendosë mbi veprimet apo mosveprimet që i atribuohen një shteti ratifikues të Konventës si dhe (2) ajo ka juridiksion vetëm për kërkesat e individëve të cilëve Konventa u jep të drejtën t'i drejtohen Gjykatës.

9.2.1.3.1. Shkeljet që i atribuohen një shteti anëtar

Kërkuesit mund ta bazojnë kërkesën që i drejtojnë Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut mbi sjelljen e një shteti që ka ratifikuar KEDNJ-në. Kjo sjellje përfshin (por jo vetëm) vendime, akte administrative, gjykime, ligje dhe rregullore. Po kështu në këtë sjellje mund të përfshihet edhe një leje e dhënë nga shteti, nëse ky i fundit ka pasur detyrim nga Konventa për të marrë masa. Detyrimi i shtetit për të garantuar të drejtat dhe liritë themelore të përcaktuara në Konventë nuk ndryshon për nga lloji i rregullit apo masës përkatëse¹³³.

Shtetet nuk mund t'i anashkalojnë përgjegjësitë e tyre të caktuara nga Konventa, duke themeluar subjekte ligjore apo duke regjistruar kompani të cilat janë objekt i të drejtës private. Nëse një subjekt ligjor i rregulluar nga e drejta private, zotërohet plotësisht apo pjesërisht nga shteti, pyetja nëse sjellja e tij përfshin përgjegjësinë e shtetit sipas KEDNJ-së, varet nga fakti se sa i pavarur është ky subjekt nga shteti në fjalë. Shkalla e pavarësisë së një kompanie duhet të vlerësohet rast pas rasti. Për shembull, në çështjen *Mykhalenko dhe të tjerë kundër Ukrainës*¹³⁴, kërkuesit u ankuan në lidhje me moszbatimin e një gjykimi kundër Atomsped, një kompani kjo shtetërore e cila duhet të kryente punime në zonën e aksidentit bërthamor të Çernobilit. Qeveria ukrainase argumentoi se Atomsped, pavarësisht se zotërohej nga shteti, ishte një subjekt i pavarur ligjor dhe se shteti nuk mund të ishte përgjegjës për detyrimet e saj. Gjykata e rrëzoi këtë argument. Ajo theksoi se kompania kishte “operuar në sferën e energjisë bërthamore, e cila është tejte e rregulluar si fushë, edhe nën një kontroll të rreptë qeveritar”. Shteti i paditur kishte pasur ndikim edhe në lidhje me kushtet e punësimit të kërkuesve, duke përfshirë këtu edhe pagën e tyre. Madje, dikur edhe menaxhimi i kompanisë i kishte kaluar një ministrie të Ukrainës. Në bazë të këtyre rrethanave, parë në optikën e Konventës Gjykata vendosi se kompania do të konsiderohej si publike dhe se Ukraina ishte përgjegjëse për sjelljen e saj, e për pasoje Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vlerësoi se në këtë rast ajo kishte juridiksion.

¹³³ *Wos kundër Polonisë* (Kërkesa nr. 222860/02), vendim për pranueshmërinë 1 mars 2005, paragrafi 60

¹³⁴ Kërkesa nr. 35091/02, gjykim i datës 30 nëntor 2004

Në çështjen *Wos kundër Polonisë*¹³⁵, kërkuesi ishte bërë objekt i punës së detyruar nga Gjermania Naziste. Në vitet 1990, Polonia kishte krijuar një fondacion, i cili do të dëmshpërblente viktimat e punës së detyruar dhe skllavërisë. Pretendimi i kërkuetit ishte mohuar. Sipas të drejtës polake në fuqi në atë kohë, vendimi i këtij fondacioni nuk mund të apelohej. Kërkuesi bëri kërkesë para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në bazë të nenit 6 (e drejta për një proces të rregullt). Edhe pse fondacioni ishte një organ i pavarur i rregulluar sipas së drejtës private, Gjykata konstatoi se Polonia ishte përgjegjëse sipas Konventës për veprimet e fondacionit, sepse ai ishte themeluar në mënyrë të tillë që vendimet e tij të mos apelohehin.

Në çështjen *Cooperativa Agricola Slobozianasei kundër Moldavisë*¹³⁶, rezultoi se gjatë procesit të privatizimit të sektorit energjetik, në Moldavi ishte themeluar një kompani së cilës i ishte ngarkuar mbledhja e pagesave të prapambetura kundrejt ofruesve të energjisë elektrike si dhe për t'i paguar borxhet e tyre palëve të treta. Kërkuesi bëri kërkesë para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut ku ankohej për mosekzekutimin e një vendimi gjyqësor kundër kompanisë. Gjykata përcaktoi se kishte juridiksion *ratione personae*, për shkak se kompania kishte kryer një funksion publik dhe ishte përdorur si një instrument gjatë procesit të privatizimit.

Edhe pse avokatët kryesisht ose juristët *ex-officio* të cilët veprojnë në bazë të ndihmës ligjore, emërohen nga gjykatat shtetërore dhe paguhen nga shteti, ky i fundit në parim, nuk ka përgjegjësi, sipas KEDNJ-së, për veprimet e tyre.

Një avokat kryesisht nuk është organ shtetëror, edhe pse ai është caktuar zyrtarisht¹³⁷. Pasi një avokat kryesisht caktohet, i takon atij dhe klientit të vendosin si do ta trajtojnë çështjen. Kjo është pasojë e pavarësisë së profesionit ligjor. Një shtet nuk mund të jetë përgjegjës për çdo të metë të avokatit kryesisht i cili vepron në bazë të dhënies së ndihmës ligjore¹³⁸. Megjithatë, një shtet duhet të kujdeset që të drejtat e parashtruara në KEDNJ të jenë praktike dhe efektive. Nëse një shtet anëtar, vihet në dijeni se ndihma ligjore nuk përmbush qëllimin e saj për të garantuar aksesin në drejtësi dhe një gjykim të drejtë, atëherë ai duhet të ndërhyjë¹³⁹, pasi në rast të kundërt, pra nëse nuk ndërhyt, shteti përkatës mund të ketë përgjegjësi¹⁴⁰. Ndërmarrja e një veprimi nga një shtet për shkak se ndihma ligjore e ofruar nuk është efektive varet nga rrethanat e rastit. Shteti është

¹³⁵ Kërkesa nr. 222860/02), vendim për pranueshmërinë i datës 1 mars 2005

¹³⁶ Kërkesa nr. 39745/02, gjykim i datës 3 prill 2007

¹³⁷ Staroszyk kundër Polonisë, paragrafi 121

¹³⁸ Kamasinski kundër Austrisë, paragrafi 65; Artico kundër Italisë, paragrafi 36

¹³⁹ Kamasinski k. Austrisë, paragrafi 65

¹⁴⁰ Daud k. Portugalisë, paragrafi 38

i detyruar të vendosë një ekuilibër midis të drejtës për një përfaqësim efektiv nga njëra anë, dhe pavarësisë së profesionit ligjor nga ana tjetër.

Në çështjen *Daud kundër Portugalisë*¹⁴¹, kërkuesi kishte hyrë në Portugali me një pasaportë të falsifikuar dhe në valixhe kishte edhe 1.5 kg kokainë. Atij iu caktua një avokat për ta përfaqësuar në procesin penal, por avokati nuk ndërmoi asnjë veprim. Kërkuesi u ankua personalisht para gjykatës portugeze pasi avokati i tij nuk e kishte kontaktuar. Atij iu caktua një avokat i ri. Avokati i ri u njoftua për emërimin vetëm tre ditë para seancës kryesore. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut u shpreh se shteti nuk e kishte kryer në mënyrë efektive detyrën e tij për të ofruar ndihmë ligjore, thjesht duke i caktuar kërkuetit një avokat. Sipas Gjykatës, shteti i paditur ishte në dijeni të të metave të përfaqësimit ligjor të kërkuetit sepse kërkuesi ishte ankuar për mungesë kontakti me avokatin pasi ky i fundit nuk kishte ndërmarrë asnjë hap të dukshëm. Mosveprimi në këto rrethana e bën shtetin përgjegjës sipas Konventës.

Në çështjen *Starosezyk kundër Polonisë*¹⁴², një avokat kishte përfaqësuar kërkuetit në një çështje pronash, në bazë të ndihmës ligjore. Kërkuetit dëshironin të apelonin vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Avokati refuzoi, duke u shprehur verbalisht se nuk shihet ndonjë arsye për apel. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut konstatoi se atyre nuk u ishte ofruar ndihmë ligjore e përshtatshme. Gjykata vuri në dukje tendencën e përgjithshme të mungesës së interesit nga avokati në përfaqësimin e kërkuetve dhe theksoi në veçanti se kërkuetit nuk kishin pasur mundësinë të vlerësonin korrektësinë e këshillës ligjore të ofruar prej tij.

9.2.1.3.2. Përgjegjësia e sjelljes në lidhje me organizatat ndërkombëtare

Shumë shtete palë të KEDNJ-së, janë gjithashtu edhe anëtare të organizatave ndërkombëtare si dhe aderojnë në traktate ndërkombëtare. Ky fakt përfshin edhe ngarkimin me disa detyrime për shtetet në fjalë. Nëse shtetet kryejnë detyrimet e tyre sipas marrëveshjeve ndërkombëtare ose kryejnë veprime në lidhje me anëtarësimin e tyre në organizatat ndërkombëtare, mund të jetë e vështirë që sipas Konventës, të vlerësosh nëse ato janë përgjegjëse apo jo për këto veprime. Kjo varet nga shkalla e pavarësisë që gëzojnë ose nga shkalla e kontrollit që ushtrojnë.

Anëtarësimi në një organizatë ndërkombëtare në vetvete, nuk e bën shtetin përgjegjës për sjelljen e organizatës. Në çështjen *Beygo kundër 46 Shteteve Anëtare*

¹⁴¹ Kërkesa nr. 22600/93, gjykim i datës 21 prill 1998

¹⁴² Kërkesa nr. 59519/00, gjykim i datës 22 mars 2007

të Këshillit të Evropës¹⁴³, kërkuesi ishte pushuar nga puna në Këshillin e Evropës pas një procedure disiplinore. Ai bëri ankesë kundër të gjithë Shteteve Anëtare të Këshillit të Evropës, duke pretenduar se, gjatë procedurave që çuan në pushimin e tij nga puna, i ishte shkelur e drejta për një gjykim të drejtë. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vuri në dukje se vetëm disa organe të Këshillit të Evropës, e në veçanti Sekretariati i Përgjithshëm, ishin në dijeni të procedurave. Asnjë nga shtetet anëtare nuk kishte ndërhyrë në ndonjë mënyrë të mundshme në procedurë dhe as nuk kishte marrë ndonjë veprim i cili mund t'i bënte përgjegjës për procedurën apo mënyrën e kryerjes së saj. Si pasojë, Gjykata vendosi se nuk kishte juridiksion *ratione personae* për ta shqyrtuar këtë kërkesë.

Sipas të njëjtit arsyetim, Gjykata e shpalli të papranueshme kërkesën në çështjen *Boivin kundër 34 Shteteve Anëtare të Këshillit të Evropës*¹⁴⁴ ku kërkuesi kishte aplikuar pa sukses për një punë në Organizatën Evropiane për Sigurinë e Navigimit Ajror. Ai e kishte kundërshtuar vendimin për të mos e emëruar atë në pozicionin e dëshiruar, duke iu drejtuar një gjykate të themeluar nga Organizata Evropiane për Sigurinë e Navigimit Ajror, por kërkesa e tij ishte rrëzuar. Atëherë kërkuesi iu drejtua Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, duke u bazuar, midis të tjerash, kërkesën e tij në nenin 6 të KEDNJ-së (e drejta për gjykim të drejtë). Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vuri në dukje se gjykata e organizatës së sipërpërmendur e cila kishte rrëzuar fillimisht kërkesën ishte jashtë juridiksionit të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës. Asnjë prej shteteve anëtare të Këshillit të Evropës nuk kishte ndërhyrë në procedurë dhe as nuk kishte fuqi ligjore për të ndërhyrë. Si rrjedhojë, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut u shpreh se nuk kishte juridiksion *ratione personae* për këtë kërkesë.

Nëse shtetet kontribuojnë aktivisht në lidhje me masat e marra nga një organizatë ndërkombëtare, ngarkimi ndaj tyre i një veprimi apo mosveprimi të caktuar, varet nga shkalla e kontrollit që ato ushtrojnë. Në rast se organizata ndërkombëtare ushtron kontroll dhe autoritet efektiv, shtetet individuale pjesëmarrëse në veprim nuk mbajnë përgjegjësi sipas Konventës, sepse përgjegjësia i takon organizatës. Në çështjen *Behrami dhe Saramati kundër Francës, Norvegjisë dhe shteteve të tjera anëtare*¹⁴⁵, kërkuesi u ankuan se shtetet e paditura ishin përgjegjëse për shkeljet e të drejtave të tyre të mbrojtura nga Konventa, si anëtarë të KFOR-it, një prezencë ndërkombëtare kjo e krijuar në Kosovë gjatë konfliktit. Djali i kërkuetit të parë ishte vrarë nga një minë. Ai pretendoi se KFOR-i kishte detyrimin të hiqte minat sepse mandati i kësaj prezence ishte të pastronte zonën

¹⁴³ Kërkesa nr. 6099/06, vendim për pranueshmërinë, më 16 qershor 2009

¹⁴⁴ Kërkesa nr. 73250/01, vendim për pranueshmërinë, më 9 shtator 2008

¹⁴⁵ Kërkesa nr. 71412/01, vendimet e Dhomës së Madhe për pranueshmërinë, më 2 maj 2007

nga minat dhe anëtarët e stafit ishin informuar për ekzistencën e minave në zonën ku ishte vrarë djali i tij, por refuzuan të vepronin. Kërkuesi i dytë pretendoi se ndalimi i tij nga stafi i KFOR-it kishte shkelur nenin 5 të KEDNJ-së (e drejta për liri dhe siguri). Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut shqyrtoi nëse sjellja e KFOR-it mund t'u ngarkohej shteteve kontraktuese që kishin kontribuar me trupa në KFOR. Ajo u shpreh se Këshilli i Sigurisë i Kombeve të Bashkuara kishte ushtruar kontroll efektiv dhe kishte autoritet mbi operacionin e kryer në Kosovë, kështu që sjellja mbi të cilën kërkuetit bazuan kërkesën e tyre i atashohej Kombeve të Bashkuara. Gjykata vuri në dukje se Kombet e Bashkuara ishin një subjekt ligjor i pavarur dhe se vendimet e saj ishin detyruese për shtetet anëtare. Duke marrë në konsideratë që veprimet në fjalë nuk kishin ndodhur në territorin e ndonjërit prej shteteve të paditura dhe jashtë kompetencës së veprimit të autoriteteve përkatëse shtetërore, Gjykata konstatoi se veprimet apo mosveprimet nuk mund të ishin përgjegjësi e shteteve të paditura. Gjykata vendosi se nuk kishte juridiksion *ratione personae* për ta shqyrtuar këtë kërkesë.

Në çështjen *Al Jedda kundër Mbretërisë së Bashkuar*¹⁴⁶, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut arriti në një tjetër përfundim. Rasti kishte të bënte me burgimin e kërkuetit, një qytetari britanik me prejardhje nga Iraku, i cili ishte ndaluar nga trupat britanike gjatë një udhëtimit në Irak, pas luftës së Irakut. Gjykata konstatoi se, edhe pse kishte një rezolutë të Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara që mirëpriste praninë e trupave ndërkombëtare, këto trupa nuk ishin nën komandimin e Kombeve të Bashkuara. Sjellja e tyre mund t'i ngarkohej kombeve që i kishin dërguar, kështu që Mbretëria e Bashkuar ishte ende përgjegjëse sipas Konventës.

Në disa raste, shtetet duhet të marrin disa masa për shkak të anëtarësisë së tyre në një organizatë ndërkombëtare apo të zbatojnë vendime të marra nga kjo organizatë. Fakti që një shtet ka vepruar në përputhje me detyrimet ndërkombëtare, nuk e çliron atë nga detyrimi për t'u përmbajtur KEDNJ-së. Për shembull, në çështjen *Bosphorus kundër Irlandës*¹⁴⁷, një aeroplan i dhënë me qira nga një kompani ajrore jugosllave një kompanie turke, ishte konfiskuar në një aeroport irlandez. Kombet e Bashkuara kishin miratuar sanksione kundër Jugosllavisë dhe Komuniteti Evropian e kishte zbatuar regjimin e sanksioneve duke miratuar një Rregullore të Këshillit që i detyronte shtetet anëtare të konfiskonin të gjithë avionët jugosllavë. Shteti i paditur, Irlanda, e kishte zbatuar këtë rregullore përmes miratimit të një ligji kombëtar. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vendosi se kishte juridiksion *ratione personae* për të shqyrtuar

¹⁴⁶ Kërkesa nr. 27021/08, Gjykim i Dhomës së Madhe më 7 korrik 2011

¹⁴⁷ Kërkesa nr. 45036/98, Gjykim i Dhomës së Madhe më 30 qershor 2005

këtë kërkesë të kompanisë turke e cila kishte marrë me qira aeroplanin e konfiskuar në aeroportin irlandez. Ndonëse sjellja e Irlandës ishte në pajtim me rezolutën e Kombeve të Bashkuara dhe me rregulloren e miratuar nga Komuniteti Evropian, vendimi për të konfiskuar avionin ishte marrë nga autoritetet irlandeze në bazë të ligjeve të Irlandës. Kjo çoi në përgjegjësinë që duhet të mbahej sipas Konventës.

Në çështjen *Nada kundër Zvicrës*¹⁴⁸, kërkuesi kishte jetuar në një zonë të vogël administrimi italiane brenda territorit zviceran, zonë kjo e cila konsiderohej si hapësirë territoriale italiane. Meqë ai dyshohej si mbështetës i *al-Qaeda*-s, emri i tij ishte përfshirë në listën e zezë nga Kombet e Bashkuara. OKB-ja kishte nxjerrë një rezolutë sipas së cilës personat e përfshirë në këtë listë nuk duhet të lejohen të udhëtojnë. BE-ja kishte detyruar shtetet anëtare ta zbatonin këtë rregullore. Si rrjedhojë, kërkuesi nuk ishte lejuar të futej në Zvicër dhe si rrjedhojë, nuk ishte lënë që të largohej nga territor italian ku jetonte. Edhe pse lista e zezë ishte krijuar sipas rezolutave të Kombeve të Bashkuara dhe BE-së, Gjykata konstatoi se kishte juridiksion *ratione personae* për ta shqyrtuar këtë kërkesë. Gjykata u shpreh se qeveria zvicerane kishte pasur liri veprimi të caktuar në zbatimin e juridiksionit dhe se kishte pasur mundësinë ta hiqte emrin e kërkuetit nga lista, dhe se sipas Konventës ajo duhet të mbante përgjegjësi për këtë.

9.2.1.3.3. Kërkesa nga persona që gëzojnë të drejtën t'i drejtohen Gjykatës

Kërkesat mund të paraqiten nga persona brenda juridiksionit të shteteve kontraktuese. Kështu që lind një mbivendosje me juridiksionin *ratione loci* të diskutuar më sipër. Disa nga kriteret specifike për kërkuetit përcaktohen në nenin 34 dhe do të diskutohen në vijim.

9.2.1.4. Juridiksioni *ratione materiae*

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka juridiksion vetëm në lidhje me pajtueshmërinë e legjislacionit dhe veprimtarisë së shteteve kontaktuese, në raport me KEDNJ-në. Si pasojë, kërkesat që i paraqiten Gjykatës mund të bazohen vetëm në shkelje të një të drejte të parashtruar në Konventë ose në një shkelje të protokollit të KEDNJ-së të ratifikuar këto nga shteti i paditur (protokollet krijojnë të drejta shtesë përveç atyre që përmban Konventa. Ato kanë karakter detyrues për ato shtete që kanë ratifikuar protokollin në fjalë).

Prandaj, para se të paraqitet një kërkesë në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, duhet të shqyrtohet me kujdes nëse e drejta mbi të cilën dëshiron të

¹⁴⁸ Kërkesa nr. 10593/08, Gjykim i Dhomës së Madhe më 12 shtator 2012

bazohet kërkuksi, garantohet nga KEDNJ-ja apo nga një protokoll i ratifikuar nga shteti i paditur. Në disa raste, vlerësimi nëse një e drejtë e caktuar është apo jo pjesë e objektit të Konventës mund të jetë më i ndërlikuar sepse disa aspekte të drejtash, që nuk parashikohen shprehimisht në KEDNJ, mund të përfshihen nga të drejta apo liri themelore të parashtruara në Konventë. Për shembull, KEDNJ-ja nuk i jep individit të drejtën për azil apo të drejtën për të përfutuar leje qëndrimi në një vend të caktuar. Megjithatë, e drejta për jetë familjare (neni 8 i KEDNJ-së) mund të ndalojë dëbimin e të huajve nëse ekzistojnë lidhje familjare në shtetin e paditur ose i detyrojnë shtete t'u japin statusin e rezidentit. Konventa nuk garanton të drejtën për pension, por e drejta për pension mund të gëzojë mbrojtje nga neni 1 ose Protokollu 1, pas dhënies së tyre¹⁴⁹. Për këtë arsye, mund të jetë me vlerë të shqyrtohet nëse, dhe deri në çfarë shkalle, objektivi i një klienti, i cili në *prima facie* nuk duket se është pjesë e objektit të Konventës, mund të nënkuptohet nga një nga të drejtat që garanton KEDNJ-ja. Në këtë kontekst, duhet mbajtur parasysh se termat ligjore dhe konceptet e përdorura në KEDNJ duhet të interpretohen në mënyrë autonome; kuptimi i tyre mund të ndryshojë nga ai që ato marrin në juridiksionet e shteteve anëtare. Për shembull, edhe pse marrëdhëniet midis homoseksualëve në shtete anëtare të caktuara mund të mos mbrohen nga e drejta kushtetuese për jetë familjare, ato ende gëzojnë mbrojtjen e dhënë nga neni 8 i KEDNJ-së (e drejta për jetë familjare).

Nga ana tjetër, edhe nëse identifikohet një e drejtë përkatëse në Konventë, përcaktimi i fushëveprimit të saj mund të jetë i vështirë. Në çështjen *Delfi AS kundër Estonisë*¹⁵⁰, kërkuksja ishte një kompani që zotëronte një portal lajmesh në internet. Ajo ishte dënuar me dëmshpërblim për shkak të komenteve të postuara nga përdoruesi poshtë artikujve të publikuar në portalin e kërkuksit. Kjo e fundit u ankua përpara Gjykatës për shkelje të lirisë së shprehjes. Shteti i paditur pretendoi se kërkuksi nuk ishte as autori dhe as personi që kishte zbuluar komentet. Shteti pretendoi gjithashtu se Konventa mbron vetëm lirinë e shprehjes së autorëve apo atyre që shfaqin komentet, kështu që kërkesa nuk pajtohej *ratione materiae* me Konventën. Megjithatë, Gjykata e rrëzoi këtë argumentim duke vënë në dukje se kompania kërkuksë ishte denoncuar për shpifje dhe ishte gjykuar përgjegjëse për këtë.

¹⁴⁹ Shihni si shembull Lakicevic dhe të tjerë kundër Serbisë dhe Malit të Zi, Kërkesa nr. 27458/06, gjykim i datës 13 dhjetor 2012

¹⁵⁰ Kërkesa nr. 64569/09, gjykim i datës 10 tetor 2013

9.2.2. Pranueshmëria *strictu sensu*

9.2.2.1. Viktima

Neni 34 i KEDNJ-së parashikon që kërkuesi duhet të pretendojë se është viktimë e shkeljes së një të drejte të dhënë nga Konventa. Ky kriter përmban dy elemente:

- Kërkuesi duhet të jetë cenuar nga një veprim apo mosveprim i një shteti anëtar
- Kërkuesi nuk duhet të ketë përfutuar ende një zgjidhje të mjaftueshme

9.2.2.1.1. Cenimi i kërkuetit nga sjellja e një shteti

KEDNJ-ja nuk parashikon në përmbajtjen e saj një “*actio popularis*”. Kërkesat nga individët (ose grupe individësh) pranohen vetëm nëse kërkuesi është në gjendje të provojë se është cenuar nga sjellja e një shteti anëtar. Konventa nuk jep të drejtën e gjyqimit “*in abstracto*” të masave të marra nga shtetet, duke u nisur nga këndvështrimi i përputhshmërisë së tyre me të drejtat dhe liritë e parashtruara në të. Edhe nëse një ligj, vendim gjyqësor apo masë tjetër e marrë nga shteti përbën shkelje të KEDNJ-së, kërkesa nuk mund të bazohet mbi këtë sjellje nëse ajo nuk e cenon kërkuetin. Megjithatë, në rrethana të caktuara, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut u jep të drejtë individëve të cilët nuk janë cenuar vetë personalisht nga një veprim apo mosveprim, që këta të veprojnë në emër të personit të cenuar.

9.2.2.1.1.1. Kërkesat e paraqitura nga personat e cenuar nga një veprim apo mosveprim

Individë (ose grupe individësh) mund të paraqesin kërkesë para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, nëse janë cenuar nga një veprim apo mosveprim i një shteti apo i një prej agjentëve të tij. Cenimi nga sjellja e shtetit mund të marrë forma të ndryshme:

- Një masë që drejtohet kundër një individ dhe që e cenon atë në mënyrë të drejtpërdrejtë “**viktima e drejtpërdrejtë**”
- Një veprim apo mosveprim që cenon një individ në mënyrë të drejtpërdrejtë, mund të ketë një ndikim të fortë edhe mbi një person tjetër. Në këtë rast, personi tjetër mund të konsiderohet si “**viktimë e tërthortë**”
- Një person mund të mos jetë cenuar ende, por rreziku për t’u cenuar është i menjëhershëm, ose ka shumë gjasa që të cenohet në të ardhmen, por nuk ka prova të qarta. Në këtë rast, individët në fjalë mund të konsiderohen si “**viktima të mundshme**”, të cilat janë në pozitë për të paraqitur kërkesë.

9.2.2.1.1.1.1. Viktima e drejtpërdrejtë

Viktimë e drejtpërdrejtë është personi, organizata apo grupet e personave që cenohen drejtpërsëdrejti nga një veprim apo mosveprim¹⁵¹. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut e interpreton këtë term në mënyrë autonome, d.m.th. një person apo organizatë mund të konsiderohet viktimë nga Gjykata, edhe nëse nuk kualifikohet si i tillë sipas të drejtës së vendit përkatës. Marrja e statusit të viktimës nuk kërkon si kusht të qenit i paragjykuar¹⁵², por prapëseprapë nuk mund të jesh viktimë e një akti që nuk ka ndonjë fuqi ligjore¹⁵³. Në çështjen *Benamar dhe të tjerë kundër Francës*¹⁵⁴, kundër kërkuesit ishte nxjerrë një urdhër dëbimi. Ai ishte dëbuar, pastaj ishte rikthyer fshehtazi në Francë dhe së fundi kishte hyrë në punë dhe kishte marrë leje qëndrimi. Megjithatë, urdhri i dëbimit nuk ishte revokuar asnjëherë zyrtarisht. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut e refuzoi kërkesën e tij ku pretendonte se urdhri i dëbimit shkelte të drejtat e tij sipas nenit 8 të KEDNJ-së si të papranueshme ,sepse urdhri nuk kishte fuqi ligjore. Edhe efektet e përkohshme ligjore mbi personin përkatës, mund të mjaftojnë për t'u konsideruar viktimë. Efektet e përkohshme ligjore mbi kërkuesin mund të mjaftojnë për ta konsideruar viktimë. Në çështjen *Monnat kundër Zvicrës*¹⁵⁵, kërkuesi ishte gazetar në radio. Pas ankesave ndaj një prej transmetimeve të tij, organi kompetent për rregullimin e medias konstatoi se transmetimi në fjalë shkelte rregulloren e medias. Ndonëse pritej vendimi mbi ankesën e kërkuesit, programi nuk po transmetohej më për dëgjuesit. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vendosi që ky ndikim i përkohshëm ishte i mjaftueshëm për ta konsideruar kërkuesin si viktimë. Gjithashtu, Gjykata vuri në dukje ndikimet negative në reputacionin profesional të kërkuesit. Për t'i dhënë fuqi të plotë dispozitave të Konventës, kriteret e të qenit viktimë nuk duhet të zbatohen në mënyrë të ngurtë dhe mekanike¹⁵⁶.

9.2.2.1.1.1.2. Viktimë e tërthortë

Veprimet apo mosveprimet që e cenojnë një individ drejtpërdrejt, mund të kenë ndikim edhe mbi palë të treta, si për shembull, anëtarë të afërt të familjeve së personave të ndaluar ilegalisht, mund të vuajnë nga ankthi apo hidhërimi. Palë

¹⁵¹ Brumarescu kundër Rumanisë (Kërkesa nr. 28342/95), Gjykim i Dhomës së Madhe më 28 tetor 1999, paragrafi 50

¹⁵² Brumarescu kundër Rumanisë, para 50

¹⁵³ Monnat kundër Zvicrës (Kërkesa nr. 73604/01), gjykim i datës 21 shtator 2006

¹⁵⁴ Benamar dhe të tjerë kundër Francës (Kërkesa nr. 42216/08), vendim për pranueshmërinë, më 14 nëntor 2000

¹⁵⁵ Kërkesa nr. 73604/01, gjykim i datës 21 shtator 2006

¹⁵⁶ Karner kundër Austrisë (Kërkesa nr. 40016/98), gjykim i datës 24 korrik 2003

të treta të ndikuara nga shkelja e të drejtave të njeriut të një individi tjetër mundet, në rrethana të caktuara, të kenë të drejtën të paraqesin kërkesë para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në emër të tyre si “viktima të tërthorta”.

Në përgjithësi, personat e afërt të viktimës së drejtpërdrejtë të një shkeljeje të të drejtave të njeriut përjetojnë një farë vuajtjeje, parehati dhe shqetësim. Kjo nuk justifikon automatikisht konsiderimin e tyre si viktima të tërthorta apo t'u japë të drejtën këtyre të paraqesin kërkesë para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Personat e ndikuar në mënyrë të tërthortë kanë të drejtë të paraqesin kërkesë vetëm nëse vuajtja e tyre shkon përtej normales apo është e pashmangshme, në rast se një familjari i shkelen të drejtat e njeriut. Gjykata vendosi në çështjen *Cakici kundër Turqisë*¹⁵⁷, se të afërmit do të konsiderohen viktima të tërthorta “në varësi të ekzistencës së faktorëve të veçantë, të cilët i japin vuajtjes së kërkuarit një dimension dhe karakter të veçantë nga shqetësimi emocional që mund të konsiderohet si i shkaktuar në mënyrë të pashmangshme ndaj të afërmit të viktimës së një shkeljeje të rëndë të të drejtave të njeriut”¹⁵⁸.

Është e vështirë të përcaktohen qartë kriteret që vendosin se, në cilat raste këta persona kanë të drejtë të paraqesin kërkesë para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në bazë të ndikimit që ka mbi ta, shkelja e të drejtave të një personi tjetër. Gjykata i është referuar:

- Afërsisë apo shkallës së marrëdhënies midis viktimës së drejtpërdrejtë dhe asaj të tërthortë, duke i dhënë rëndësi të veçantë lidhjes midis prindit dhe fëmijës dhe bashkëshortit e bashkëshortes
- Interesit që ka treguar viktima e tërthortë në proceset lidhur me shkeljen e të drejtave të viktimës së drejtpërdrejtë
- Sjelljen e autoriteteve kundrejt viktimës së tërthortë
- Nëse viktima e tërthortë ka qenë dëshmitar i shkeljes së të drejtave të njeriut
- Nëse çështja ligjore në fjalë ka më shumë interes sesa thjesht për rastin individual në fjalë

Megjithatë, juridiksioni i Gjykatës nuk shfaqet gjithmonë plotësisht konsistent në këtë drejtim. Në çështjen *Kurt kundër Turqisë*, kërkuarja dhe djali i saj jetonin në një fshat që shërbente si fortesë e PKK-së. Forcat e sigurisë turke ndërmorën një aksion për të arrestuar terroristët në këtë fshat. Djali i kërkuarës u zhduk gjatë këtij aksioni. Kërkuarja pretendon se për herë të fundit djalin e saj e kishte parë kur ishte arrestuar. Kërkuarja iu ishte drejtuar autoriteteve të ndryshme për të gjetur vendndodhjen e të birit, por nga ana e tyre nuk u ndërmor asnjë veprim. Ajo bëri kërkesë para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në emrin e

¹⁵⁷ Kërkesa nr. 23657/94, Gjykim i Dhomës së Madhe më 8 korrik 1999

¹⁵⁸ Paragrafi 98

saj dhe në emër të djalit të saj, ku pretendonte, midis të tjerash, se i ishin shkelur të drejtat sipas nenit 3 të KEDNJ-së (ndalimi i torturës, trajtimit çnjerëzor dhe degradues). Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vendosi se kërkuesja ishte viktimë (e tërthortë). Ajo konstatoi se zhdukja e djalit të saj dhe vetëkënaqësia e autoriteteve turke me aq sa kishin bërë kishin shkaktuar ankth dhe shqetësim që çonin në shkelje të nenit 3 të KEDNJ-së.

Ndryshe vendosi Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në çështjen *Cakici kundër Turqisë*¹⁵⁹. Në këtë rast Gjykata vendosi që kërkuesi nuk ishte viktimë e tërthortë për shkak të arrestimit të paligjshëm dhe torturimit të vëllait të tij. Vëllai i kërkuesit ishte arrestuar nga forcat e sigurisë turke gjatë një aksioni kundër terroristëve të lidhur me PKK. Kërkuesi kishte paraqitur një kërkesë, si në emrin e vet si ashtu edhe në emër të të vëllait. Duke u bazuar te rasti i sipërpërmendur *Kurt kundër Turqisë*, kërkuesi pretendoi se ankthi dhe vuajtja që i ishin shkaktuar arrinin në nivel trajtimi çnjerëzor dhe degradues. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut e rrëzoi këtë argument. Ajo sqaroi se nuk kishte rregull të përgjithshëm sipas së cilit të afërmit e rrethit të ngushtë të konsiderohen viktimë të shkeljes së të drejtave të familjarëve të tyre, por se duhet të ekzistonin rrethana të caktuara.

Në rastin më të fundit, *Koch kundër Gjermanisë*¹⁶⁰, bashkëshortja e kërkuesit ishte e paralizuar nga qafa e poshtë për më tepër se 10 vjet. Për shkak se kishte nevojë për ndihmë në çdo moment, edhe për frymëmarrje me aparaturë, ajo dëshironte t'i jepte fund jetës, të cilën ajo e perceptonte si të dhimbshme dhe pa dinjitet, duke kërkuar që t'i jepnin një substancë vdekjeprurëse, por autoritetet gjermane refuzuan. Kërkuesi (bashkëshorti) kishte iniciuar një proces ligjor në Gjermani për të kërkuar një medikament që do ta ndihmonte bashkëshorten e tij t'i jepte fund jetës. Gjykatat gjermane vendosën se ai nuk kishte të drejtë dhe e rrëzuan kërkesën e tij si të papranueshme. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vendosi se ai ishte viktimë e tërthortë e shkeljes së nenit 8 të KEDNJ-së (e drejta për jetë private dhe familjare). Ajo vuri në dukje se kërkuesi kishte qenë një bashkëshort i dhembshur, i cili kishte shoqëruar gruan e tij gjatë një periudhe të gjatë vuajtjeje. Kriteria të tjera të zbatuara nga Gjykata ishin interesi i treguar nga kërkuesi gjatë proceseve ligjore në vend, interesi personal për rezultatin e procesit në vend.

Nëse shkelen të drejtat që Konventa i jep një personi juridik, organizatë apo shoqëri, anëtarët e bordit apo aksionerët nuk konsiderohen automatikisht viktimë të tërthorta. Kjo justifikohet vetëm në rrethana të veçanta për të mos konsideruar personalitetin juridik të kompanisë si “person” i prekur nga veprimi

¹⁵⁹ Kërkesa nr. 23657/94, Gjykim i Dhomës së Madhe më 8 korrik 1999

¹⁶⁰ Kërkesa nr. 497/09, gjykim i datës 19 korrik 2012

apo mosveprimi në fjalë, në veçanti, kur është e pamundur për kompaninë që t'i drejtohet Gjykatës përmes organeve të përcaktuara në aktin e themelimit të saj¹⁶¹. Fakti i thjeshtë që aksionet zhvlerësohen si pasojë e shkeljes së të drejtave të një kompanie, nuk i bën aksionerët e saj viktime të tërthorta të kësaj shkelje¹⁶².

Për shembull, në çështjen *Amat G Ltd dhe Mebagishvili kundër Gjeorgjisë*¹⁶³, kërkuesi i parë ishte një kompani e cila importonte peshk në Gjeorgji, ndërsa kërkuesi i dytë ishte drejtori i kompanisë. Kompania kishte përfutur nga një vendim gjykatë kundër Ministrisë së Mbrojtjes së Gjeorgjisë, ku kjo e fundit nuk kishte paguar për sasinë e peshkut. Vendimi i gjykatës nuk u zbatua për më tepër se pesë vjet. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut pranoi kërkesën e kompanisë sipas nenit 6 dhe nenit 1 të protokollit 1 (e drejta e pronës) të KEDNJ-së; megjithatë, ajo nuk pranoi kërkesën e drejtorit të kompanisë, sepse ai nuk ishte prekur dhe nuk mund të pretendonte të ishte viktimë.

Në çështjen *Agrotexim kundër Greqisë*¹⁶⁴, kërkuetit ishin kompani që kishin aksione në një fabrikë birre greke. Kjo fabrikë birre kishte planifikuar të ndërtonte një qendër tregtare dhe biznesi, në një tokë të ndodhur në Athinë, të cilën e kishte në pronësinë e saj. Gjykata Bashkiake e Athinës kishit pezulluar përkohësisht përgatitjet dhe kishin filluar procedurat e zgjatura; fabrika e berrës shpalli falimentimin. Kërkuetit i paraqitën kërkesë Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut duke u ankuar, midis të tjerash, për shkelje të së drejtës së tyre për të gëzuar në mënyrë paqësore zotërimet e tyre. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut sqaroi se kërkuetit nuk mund të konsideroheshin viktime të tërthorta të shkeljes së të drejtës së fabrikës së berrës, për pronën, meqë aksionet e tyre kishin humbur vlerën. Ajo u shpreh se aksionerët mund të konsideroheshin si viktime të tërthorta vetëm të një mase kundër një kompanie në rrethana të veçanta, për shembull nëse do të ishte e pamundur për kompaninë të vepronte përmes organeve të saj.

Ndonëse si rregull, Gjykata bën dallimin midis interesit të kompanisë me personalitet juridik të veçantë dhe interesit të aksionerëve, mund të bëhet përjashtim në rastet kur një person është jo vetëm aksioner i vetëm i kompanisë, por edhe personi që merret me menaxhimin e saj¹⁶⁵.

¹⁶¹ G.J. kundër Luksemburgut, paragrafi 23

¹⁶² Agrotexim kundër Greqisë (Kërkesa nr. 14807/89, gjykim i datës 24 tetor 1995)

¹⁶³ Kërkesa nr. 2507/03, gjykim i datës 27 shtator 2005

¹⁶⁴ Kërkesa nr. 14807/89, gjykim i datës 24 tetor 1995

¹⁶⁵ Groppera Radio AG dhe të tjerë kundër Zvicrës, gjykim i datës 28 mars 1990; Glas Nadezhda EOOD dhe Anatoliy Elenkov kundër Bullgarisë (Kërkesa nr. 14134/02), gjykim i datës 11 tetor 2007

9.2.2.1.1.1.3. Viktima e mundshme

Për sa më sipër, në përgjithësi kërkuesi duhet të jetë në gjendje të pretendojë se ai është cënuar nga një veprim apo mosveprim i një shteti anëtar. Megjithatë, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në disa raste lejon përjashtime nga ky parim, me qëllim për t'i dhënë fuqi të plotë mbrojtjes së siguruar nga Konventa. Kategoritë kryesore të rasteve, kur “viktimat e mundshme” kanë të drejtë të paraqesin kërkesë para Gjykatës, janë:

- Masa të marra në fshehtësi
 - Ligje që ndikojnë në sjelljen e kërkuesit ose që mund të ndikojnë në të ardhmen
 - Rrezik i afërt ndaj një të drejte të mbrojtur nga Konventa
- **Masa të marra në fshehtësi**

Ky kriter mund ta vendosë kërkuesin në një pozitë të vështirë, në rast se masat në fjalë janë marrë në fshehtësi, si për shembull përgjimi i telefonit. Meqenëse viktima zakonisht nuk e di që i është përgjuar telefoni, nuk është në gjendje të provojë se është viktimë e një shkeljeje. Për këtë arsye, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut e ul prapun e kritereve të konsiderimit si “viktimë” në raste masash të marra në fshehtësi.

Në raste të tilla, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut e konsideron të mjaftueshëm faktin që kërkuesit mund të ndikohen, ose i përkasin kategorisë së personave që mund të jenë objekt i një mase të caktuar. Përndryshe, personat të drejtat e të cilëve janë shkelur nga një masë e fshehtë pa dijeninë e tyre, nuk do të kishin aspak mundësi të paraqisnin kërkesë para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe mbrojtja e ofruar nga neni 8 i KEDNJ-së do të shfuqizohej.

Në çështjen *Klass dhe të tjerë kundër Gjermanisë*¹⁶⁶, kërkuesit ishin prokurorë dhe gjyqtarë gjermanë. Ata u ankuan se ligji gjerman për përgjimet telefonike nga shërbimet informative shkelte të drejtën e tyre për jetë private dhe liri sipas nenit 8. Qeveria gjermane kundërshtoi statusin e tyre si viktimë dhe deklaroi se telefonatat e tyre nuk ishin përgjuar asnjëherë. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut e rrëzoi këtë argument. Ajo u shpreh se e drejta gjermane lejonte përgjimin e fshehtë të komunikimi telefonik dhe kështu mund të ndikonte mbi të gjithë përdoruesit e telefonave dhe, si rrjedhojë, edhe mbi kërkuesit. Ajo deklaroi gjithashtu se thjesht *rreziku i përgjimit të fshehtë* mund të konsiderohej si kufizim i komunikimit të lirë përmes shërbimeve të telekomunikacionit.

¹⁶⁶ Kërkesa nr. 5029771, gjykim i datës 6 shtator 1978; Ekziston versioni në shqip

Në çështjen *Iordachi kundër Moldavisë*¹⁶⁷, Gjykata shqyrtoi një ankesë të paraqitur nga një numër avokatësh të të drejtave të njeriut në Moldavi, të cilët kishin përfaqësuar shpesh klientët para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Ata pretenduan se e drejta moldave mbi masat e veçanta hetuese shkelte të drejtën e tyre sipas nenit 8 të KEDNJ-së. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vuri në dukje se ligji në fjalë shërbente si bazë për përgjimin e një kategorie të caktuar personash. Si avokatë të të drejtave të njeriut, kërkuessit mund të ishin në kontakt me persona të kësaj kategorie, kështu që nuk përjashtohej mundësia që edhe ata të ishin objekt i përgjimit të komunikimit. Gjykata vendosi se kërkuessit ishin viktimë dhe se kërkesa e tyre pranohej.

Çështja *Weber dhe Saravia kundër Gjermanisë*¹⁶⁸ ka lidhje me përgjimin (e mundshëm) të telefonatave nga jashtë shtetit. Kërkuessit ishin një gazetare gjermane dhe asistenti i saj. Që të dy ishin me banim në Uruguai. Ata bënë kërkesë ku pretendonin se “G 10”-ta gjermane, ligji për përgjimet telefonike nga shërbimet informative, shkelte të drejtën e tyre për jetë private. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vendosi se ata kishin statusin e viktimës sepse i përkisnin asaj kategorie të personave që mund të ishin objekt i monitorimit të telekomunikimit¹⁶⁹.

- Ligjet që ndikojnë në sjelljen e kërkuessit, ose që mund të kenë ndikim mbi kërkuessin në të ardhmen

Kërkuessit mund të ankohen vetëm për masa që ndikojnë drejtpërdrejt mbi ta; ata nuk mund të pretendojnë që një ligj, i cili mendohet se kundërshton Konventën, të shqyrtohet “*in abstracto*”. Megjithatë, kur vihet në pikëpyetje përputhshmëria e një ligji me KEDNJ-në, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut është e mendimit se këta kërkuess kanë statusin e viktimës, nëse i përkasin asaj kategorie personash që mund të ndikohet nga ky ligj dhe që mund t’u duhet të ndryshojnë sjellje për shkak të tij, ose që mund të ndikohen në të ardhmen e afërt.

Shembull i një rasti ku Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut gjykoj se kërkuessi kishte statusin e viktimës, për shkak se i përkiste një kategorie personash që janë objekt i një ligji dhe se mund të ndryshonte sjelljen e tij, është rasti *Dudgeon kundër Mbretërisë së Bashkuar*¹⁷⁰: Kërkuessi ishte homoseksual. Në kohën në fjalë, në Irlandën Veriore ishin në fuqi ligjet që penalizonin aktet homoseksuale midis meshkujve në moshë madhore. Megjithatë, në Irlandën Veriore kishte vite që nuk ishin iniciuar procese penale për vepra të tilla. Pavarësisht kësaj, Gjykata

¹⁶⁷ Kërkesa nr. 25198/02, gjykim i datës 10 shkurt 2009

¹⁶⁸ Kërkesa nr. 54934/00, gjykim i datës 29 qershor 2006

¹⁶⁹ Megjithatë, Gjykata vendosi se kërkesa nuk pranohej për arsye të tjera

¹⁷⁰ Kërkesa nr. 7526/76, gjykim i datës 22 tetor 1981; Ekziston versioni në shqip

gjykoi se kërkuesi kishte statusin e viktimës sepse duhet të jetonte me frikën se mund të ndiqej penalisht për veprime homoseksuale.

Sipas të njëjtës logjikë, Gjykata konstatoi në çështjen ”*Norris kundër Irlandës*”¹⁷¹ se vetë ekzistenca e ligjeve penale kundër akteve homoseksuale ndërhynte në të drejtën e jetës private. Ajo theksoi se mundësia e një ndjekjeje penale që e mbante kërkuesin nën presionin e frikës së vazhdueshme, ndërhynte në të drejtën për një jetë private. Meqë Gjykata nuk shihte ndonjë arsye për ekzistencën e këtij legjislacioni, gjykoi se përbënte shkelje të nenit 8 të KEDNJ-së.

Në çështjen *Burden kundër Mbretërisë së Bashkuar*¹⁷², dy motra kishin jetuar gjithë jetën së bashku në shtëpinë e trashëguar nga prindërit. Sipas të drejtës britanike të tatimeve, në rast se njëra prej tyre vdiste, motra tjetër duhet të paguante taksë për pjesën tjetër të shtëpisë, të trashëguar nga motra e saj. Bashkëshortët përjashtoheshin nga ky ligj për tatimet dhe sipas kërkueses, ky ishte diskriminim. Dhoma e Madhe gjykoi se duke marrë parasysh moshën e kërkueseve, kjo mjaftonte për të gjykuar se ato do të ndikoheshin nga këto rregullore në të ardhmen e afërt dhe si rrjedhojë mund të konsideroheshin viktimë sipas nenit 34 të KEDNJ-së.

- Rrezik i afërt për shkelje të një të drejte të njeriut

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka bërë përjashtime nga parimi i përgjithshëm që kërkuesi duhet të ndikohet nga një masë, në rastet kur ky ndikim nuk është materializuar ende, por do të ndodhë në të ardhmen e afërt. Në këtë rast flitet kryesisht për masën e ekstradimit apo dëbimit. Në çështjen *Soering kundër Mbretërisë së Bashkuar*¹⁷³, kërkuesi ishte i dyshuar për vrasje në SHBA. SHBA-ja kishte kërkuar ekstradimin e tij nga Britania ku ai ishte arrestuar. Kërkuesi argumentoi se ndodhej para një dënimi me vdekje dhe futjes së tij në listën e të dënuarve me vdekje në SHBA, çfarë përbënte shkelje të nenit 3 të KEDNJ-së. Gjykata gjykoi se një rrezik i afërt për shkelje të një të drejte mund ta bëjë, në parim, përgjegjës shtetin përkatës.

9.2.2.1.1.2 Kërkesa nga palë të treta në emër të personit të prekur

Në disa rrethana, edhe personat ndaj të cilëve nuk është drejtuar masa e marrë nga shteti, mund të kenë të drejtë t’i paraqesin kërkesë Gjykatës. Në këtë kontekst, duhen dalluar dy situata juridike:

¹⁷¹ Kërkesa nr. 10581/83, gjykim i datës 26 tetor 1988

¹⁷² Kërkesa nr. 13378/05, Gjykim i Dhomës së Madhe më 29 prill 2008

¹⁷³ Kërkesa nr. 14038/88, gjykim i datës 7 korrik 1989; Ekziston versioni në shqip

- Nëse kërkuesi vdes pas paraqitjes së kërkesës para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Gjykata në rrethana të caktuara, i jep të drejtën për të ndjekur kërkesën, të afërmit të kërkuetit të vdekur;
- Nëse një person i cënuar nga një shkelje (e mundshme) e të drejtave të parashikuara në Konventë, vdes përpara se të ketë mundësinë të paraqesë kërkesë para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, palët e treta në varësi të të drejtave të shkelura, mund ta paraqesin ato çështjen para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

9.2.2.1.1.2.1. Kërkuesi vdes pas paraqitjes së kërkesës

Nëse kërkuesi vdes pas paraqitjes së kërkesës para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Gjykata zakonisht i jep të afërmit më të ngushtë, apo anëtarëve të tjerë të familjes, mundësinë për të vazhduar me kërkesën, me kusht që ai/ajo të ketë interes për çështjen¹⁷⁴. Kjo ndodh për shkak se çështjet e paraqitura në Gjykatë kanë dimension moral, e për pasojë familjarët e kërkuetit mund të kenë interes të ligjshëm të shohin dhënien e drejtësisë edhe pas vdekjes së vetë kërkuetit. Interesi i ligjshëm mund të lindë, midis të tjerash, nga një interes financiar si rezultati i procesit¹⁷⁵ ose nga një interes moral për të parë vënien në vend të drejtësisë¹⁷⁶. Për shembull, në çështjen *Craxi kundër Italisë*¹⁷⁷, telefonatat e ish Kryeministrit italian, Craxi, ishin përgjuar dhe përmbajtja e tyre kishte dalë në media. Z. Craxi paraqiti ankesë për shkelje të të drejtës për jetë private dhe korrespondencë sipas nenit 8 të KEDNJ-së. Ai vdiq pas paraqitjes së kërkesës, por Gjykata i dha djalit dhe bashkëshortes së tij mundësinë për të vazhduar me procesin meqenëse ata kishin interes të justifikuar për vendimin që do të jepte Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

E drejta e familjarëve për të vazhduar me procesin nuk varet domosdoshmërisht nga afërsia e kësaj lidhjeje familjare. Edhe pse Gjykata lejon në shumicën e rasteve që personi më i afërt të vazhdojë procesin ligjor në Gjykatë, ajo mund t'u japë mundësinë edhe familjarëve të tjerë nëse ata kanë interes në çështje. Për shembull, në çështjen *Malbous kundër Republikës Çeke*¹⁷⁸, nipit të kërkuetit iu lejua të vazhdonte të ndiqte çështjen pas vdekjes së kërkuetit, sepse ai pretendonte se ishte trashëgimtari testamentar i pronës së kërkuetit, prone kjo objekt shqyrtimi në procesin ligjor në vendin e tij (i cili ishte ende pezull në atë kohë) dhe se fëmijët e kërkuetit nuk e kishin kundërshtuar testamentin.

¹⁷⁴ Micaloff kundër Maltës, paragrafi 47

¹⁷⁵ Mijanovic kundër Kroacisë

¹⁷⁶ Dalban kundër Rumanisë (Kërkesa nr. 28114/95) Gjykim i Dhomës së Madhe, më 28 shtator 1999

¹⁷⁷ Kërkesa nr. 25337/94, vendim për pranueshmërinë, më 7 dhjetor 2000

¹⁷⁸ Kërkesa nr. 33071/96, Vendim i Dhomës së Madhe për pranueshmërinë, më 13 dhjetor 2000

Nëse familjarët dëshirojnë të vazhdojnë të ndjekin çështjen pas vdekjes së kërkuarit, ata duhet ta informojnë Gjykatën me shkrim për vdekjen e kërkuarit, të deklarojnë se dëshirojnë të vazhdojnë procesin ligjor në vend të kërkuarit si dhe të përcaktojnë arsyet e interesit të tyre të ligjshëm. Kjo kërkesë zakonisht nuk krijon debat apo kundërshtime. Megjithatë, ka përjashtime. Në çështjen *Mijanovic kundër Malit të Zi*¹⁷⁹, kërkuari ishte ankuar për moszbatimin e vendimeve gjyqësore që ishin dhënë. Ai vdiq ndërsa çështja ishte ende pezull në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe bashkëshortja e dy vajzat e tij deklaruan se dëshironin ta vazhdonin procesin. Qeveria kundërshtoi. Gjykata u shpreh se bashkëshortja dhe vajzat e kërkuarit ishin trashëgimtarët e tij ligjorë ndërsa në veçanti njëra nga vajzat, e cila trashëgonte pretendimin në fjalë, kishte interes financiar në lidhje me rezultatin e çështjes. Kështu që Gjykata i dha vajzës të drejtën të vazhdonte me procesin ligjor.

Në rast se kërkuari vdes para përfundimit të procesit nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe asnjë trashëgimtar nuk shpreh interes për ta vazhduar atë më tej, Gjykata zakonisht nuk e vazhdon procesin dhe çështja hiqet nga lista. Megjithatë, ka raste kur Gjykata vendos ta vazhdojë procesin në interes të të drejtave të njeriut. Për shembull, në çështjen *Karner kundër Austrisë*¹⁸⁰, kërkuari u ankua se disa përfitime që ligji austriak për banesat, u jepte bashkëshortëve, nuk zbatoheshin për personat homoseksualë që bashkëjetonin. Kërkuari vdiq përpara përfundimit të procesit. Gjykata vuri në dukje se duhet marrë në konsideratë dimensionin moral i çështjeve pezull kur vendoset nëse do të hiqen apo jo nga lista. Ajo u shpreh se kjo çështje i jepte Gjykatës mundësinë të elaboronte në lidhje me parime të rëndësishme të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe për këtë arsye duhej të vazhdonte si proces.

9.2.2.1.1.2.2. Personi i cenuar drejtpërsëdrejti vdes para paraqitjes së kërkesës në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut

Rastet në të cilat kërkuari vdes para paraqitjes së kërkesës në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut duhet të dallohen nga rastet kur një person që cenohet nga një shkelje e të drejtave të Konventës, vdes para se të ketë mundësinë të bëjë kërkesë në Gjykatë. Në rastin e fundit, fakti nëse të afërmit mund ta çojnë çështjen para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në emër të personit të vdekur, varet nga e drejta (e mundshme) e shkelur. Vendimet

¹⁷⁹ Kërkesa nr. 19580/06, gjykim i datës 17 shtator 2013

¹⁸⁰ Kërkesa nr. 40016/98, gjykim i datës 24 korrik 2003

e Gjykatës në raste të tilla, vështirë se mund të parashikohen, d.m.th. nuk është e lehtë të vlerësohet nëse kërkesat nga të afërmit e personave, të cilëve mund t'u jetë shkelur një e drejtë e dhënë nga Konventa, mund të jenë të suksesshme. Një aspekt i rëndësishëm është pyetja nëse e drejta e shkelur është personale apo deri në çfarë mase kjo shkelje ka prekur edhe persona të tjerë, në veçanti kërkuesin.

- **Zhdukja ose vdekja e personit në përgjegjësi të shtetit**

Nëse një person vdes apo zhduket dhe ka arsye për të besuar se në këtë vdekje apo zhdukje ka përgjegjësi shteti, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut gjykon se personi më i afërt ka të drejtë të paraqesë kërkesë. Në çështjen *Bazorkinova kundër Rusisë*¹⁸¹, i biri i kërkuesit ishte zhdukur pas arrestimit nga një anëtar i forcave ruse në Çeçeni. Gjykata nuk pati asnjë dyshim për faktin që kërkuesi kishte të drejtë të paraqiste kërkesë në lidhje me zhdukjen e të birit.

- **Raste në lidhje me nenin 8 (e drejta për jetë private, autonomi)**

Në rastet që kanë të bëjnë me të drejtën për jetë private dhe autonomi personale, Gjykata është shprehur se personi më i afërt nuk ka të drejtë të paraqesë kërkesë para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në emër të të afërmit të vdekur. Në çështjen *Sanles Sanles kundër Spanjës*¹⁸², kërkuesi ishte kunata e një personi të paralizuar, i cili kishte kërkuar ndihmë nga autoritetet për t'i dhënë fund jetës. Ai kishte kryer vetëvrasje dhe kishte caktuar kunatën për të vazhduar më tej çështjen. Ajo paraqiti kërkesë para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Gjykata vendosi se ajo nuk kishte të drejtë të pretendonte se ishte viktimë e një të drejte sipas Konventës. Gjykata u shpreh se e drejta për jetë private mbi të cilën ajo bazoi kërkesën (e drejta për autonomi), ishte plotësisht personale dhe mund të pretendohet vetëm nga personi i cenuar drejtpërdrejt.

- **Çështje në lidhje me nenet 5, 6 dhe 8**

Në rastet që kanë të bëjnë me nenet 5, 6 dhe 8 të KEDNJ-së, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut u ka dhënë mundësinë personave të afërm apo bashkëshortëve, të paraqesin kërkesë nëse reputacioni i tyre është cenuar në ndonjë mënyrë, ose kur këta kanë treguar interes moral për çështjen. Për shembull, në çështjen *Nölkenbockhoff kundër Gjermanisë*¹⁸³, bashkëshorti i kërkueses ishte dënuar për një vepër penale. Ai vdiq gjatë kohës kur procesi i apelit ishte në vazhdim. Në një vendim mbi shpenzimet e procesit, një gjykatë gjermane shprehej se bashkëshorti i kërkueses me shumë siguri do të ishte dënuar. Kërkuesja paraqiti kërkesë ku pretendonte shkelje të prezumimit të

¹⁸¹ Kërkesa nr.69481/01, gjykim i datës 27 korrik 2006

¹⁸² Kërkesa 48335/95, gjykim i datës 26 tetor 2010

¹⁸³ Kërkesa nr. 10300/83, gjykim i datës 25 gusht 1987

pafajësisë (neni 6 i KENDJ). Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut rrëzoi argumentin e qeverisë gjermane se ajo nuk mund të konsiderohej viktimë, duke u shprehur se kërkesja kishte interes moral që bashkëshorti i saj i ndërë të shpallej i pafajshëm.

Me të njëjtën logjikë, në çështjen *Gradinar kundër Moldavisë*¹⁸⁴, bashkëshorti i kërkeses ishte dënuar për një vepër penale. Ai vdiq ndërkohë që priste një rigjykim. Gjykata vendosi se kërkesja kishte të drejtë të paraqiste kërkesë për shkak të interesit të saj moral në lidhje me përfundimin e çështjes.

Gjithashtu Gjykata, në disa raste kur viktima e drejtpërdrejtë kishte vdekur para paraqitjes së kërkesës, kishte supozuar se të afërmit mund të kishin të drejtë të paraqisnin kërkesë nëse, përveç interesave individuale, viheshin në lojë edhe interesa të përgjithshme¹⁸⁵, veçanërisht në rastet në lidhje me të drejtat sipas nenit 6 të KEDNJ-së. Për shembull, në çështjen *Micallef kundër Maltës*¹⁸⁶, kunata e kërkesit ishte përfshirë në procesin civil. Gjyqtari kishte ndryshuar datën e një seance pa e informuar duke ia bërë të pamundur praninë në seancë. Ajo ndërroi jetë gjatë kohës kur po kërkonte zgjidhje të çështjes në vendin e saj. Kunati i saj iu drejtua Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut duke pretenduar se ajo kishte treguar vullnetin për t'iu drejtuar kësaj gjykate që kur ishte gjallë. Gjykata vuri në dukje diskrecionin e tij kur i dha statusin e viktimës. Ajo iu referua gjykimit të mëparshëm në lidhje me të afërmit që mund të kishin të drejtë të paraqisnin kërkesë kur vihej në rrezik një interes i përgjithshëm. Duke u shprehur se kërkesa kishte lidhje me një aspekt të rëndësishëm të kuadrit ligjor të Maltës, Gjykata vendosi se kërkesi e kishte këtë të drejtë¹⁸⁷.

- Raste në lidhje me ndalimin e torturës (neni 3 i KEDNJ-së)

Për sa i përket ndalimit të torturës, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut është shprehur se neni 3 përmban një të drejtë plotësisht personale, që ka lidhje me sulmet ndaj një individi dhe vuajtjet e tij. Si rregull, kjo e drejtë nuk transferohet dhe nuk mund të pretendohet nga të tjerë. Në çështjen *Kaburov kundër Bullgarisë*¹⁸⁸, ekzistonte dyshimi se i ati i kërkesit ishte keqtrajtuar nga policia. Kërkesi ishte përpjekur të përfonte dëmshpërblim në vendin e vet. Ndërkohë që procesi ishte ende në vazhdim, ai vdiq dhe kërkesi vazhdoi procesin. Pas rrëzimit të kërkesës së tij, kërkesi i kishte bërë kërkesë Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Gjykata e konsideroi kërkesën të papranueshme, sepse kërkesi nuk

¹⁸⁴ Kërkesa nr. 7170/02, gjykim i datës 8 prill 2008

¹⁸⁵ Nassau Verzekering Matschaapij kundër Holandës (Kërkesa nr. 57602/09), vendim për pranueshmërinë, më 4 tetor 2011

¹⁸⁶ Kërkesa nr. 17056/06, Gjykim i Dhomës së Madhe, më 15 tetor 2009

¹⁸⁷ Paragrafi 46 - 50

¹⁸⁸ Kërkesa nr. 9035/06, vendim për pranueshmërinë, më 19 qershor 2012

mund të pretendonte se ishte viktimë, për shkak të natyrës personale të së drejtës së shkelur. Megjithatë, ajo vuri në dukje se mund të ketë raste kur të afërmit e viktimave të torturës kanë të drejtë të paraqesin kërkesë, nëse do të ishin në gjendje të tregonin interes të lartë moral për rezultatin e çështjes¹⁸⁹.

9.2.2.1.2. Jo “*actio popularis*”

Siç përmendet më sipër, nuk ka “*actio popularis*” sipas KEDNJ¹⁹⁰. Shqyrtimi i ligjeve nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut “*in abstracto*” nuk parashikohet nga Konventa¹⁹¹. Kërkuesit nuk mund të paraqesin kërkesë për shqyrtim të një ligji apo rregulloreje nga Gjykata, vetëm sepse mendojnë se kjo është në kundërshtim me Konventën. Kërkuesit duhet të provojnë se cenohen personalisht prej tyre¹⁹².

Në rastin e ligjeve apo akteve ligjore, nuk është e lehtë të përcaktohet nëse një kërkues cenohet në mënyrë të atillë që i jep atij të drejtën të paraqesë kërkesë. Në veçanti, mund të jetë e vështirë të bëhet dallimi midis rasteve kur kërkuesi konsiderohet viktimë e mundshme e një akti ligjor (shih me poshtë) dhe një kërkuesi që kërkon një shqyrtim abstrakt të një ligji. Kriteri kryesor është nëse ligji mund ta cenojë kërkuesin aty për aty apo në të ardhmen e afërt. Në çështjen *Liguedes Musulmans de Suisse tautes kundër Zvicrës*¹⁹³, kërkuesit ishin myslimanë që i përkisnin organizatave që përkrahnin pajtimin midis Islamit dhe feve të tjera. Ata kundërshtuan rezultatin e një referendumi ku shumica e popullsisë zvicerane kishte votuar për ndalimin e ndërtimit të minareve në Zvicër. Ndalimi nuk kishte hyrë ende në fuqi. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut e shpalli kërkesën të papranueshme, sepse kërkuesi nuk mund të pretendonte se ishte viktimë. Ajo gjykoi se rezultati i një vote popullore prapëseprapë nuk ndikonte tek kërkuesit dhe nuk i detyronte ata të ndryshonin sjellje.

Nuk mjafton që kërkuesi të cenohet nga mënyra se si një ligj apo masë që zbatohet ndaj tij, në kuptimin që ai është qytetar i një vendi të caktuar ku është miratuar një akt ligjor ose anëtar i publikut të gjerë. Për shembull, në *L.Z. kundër Sllovakisë*¹⁹⁴, kërkuesi u ankua që një rrugë i ishte vendosur emri i një personi i cili, sipas kërkuesit, kishte qenë bashkëpunues i nazistëve gjatë Luftës së Dytë Botërore. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut pranoi që çështja

¹⁸⁹ Paragrafi 56

¹⁹⁰ Burden kundër Britanisë (Kërkesa nr. 13378/05), Gjykim i Dhomës së Madhe më 5 mars 2008, paragrafi 33

¹⁹¹ Federata e Krishterë e Dëshmitarëve të Jehovait në Francë kundër Francës (Kërkesa nr. 53430/99), vendim për pranueshmërinë, më 6 nëntor 2011

¹⁹² Tanase k Moldavisë (Kërkesa nr. 07/08), Gjykim i Dhomës së Madhe më 27 prill 2010

¹⁹³ Kërkesa nr. 666274/09, vendim për pranueshmërinë, më 28 qershor 2011

¹⁹⁴ Kërkesa nr. 27753/06, vendim për pranueshmërinë, më 27 shtator 2011

e ngritur nga kërkuesi ishte e rëndësishme. Megjithatë, konstatoi se kërkuesi nuk kishte paraqitur ndonjë provë që të tregonte se rrimërtimi i rrugës kishte pasur ndikim negativ në jetën e tij private¹⁹⁵. Për këtë arsye, ajo e shpalli kërkesën të papranueshme.

9.2.2.1.3. Zgjidhje e pamjaftueshme në nivel kombëtar

Përveç ndikimit, statusi i viktimës kërkon edhe që kërkuesi të mos ketë marrë ende zgjidhje të mjaftueshme brenda vendit të tij. Është një parim i përgjithshëm i të drejtës ndërkombëtare që, në fillim shteteve t'u jepet mundësia që të gjejnë vetë zgjidhjen lidhur me rastet e supozuara të shkeljeve të të drejtave të njeriut, përpara se ato të përfshihen në mekanizmat ndërkombëtarë¹⁹⁶. Nëse shtetet ofrojnë vetë zgjidhje, nuk ka hapësirë dhe nevojë për ndërhyrje apo vendim në plan ndërkombëtar. Pra, kërkesat në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut janë të pranueshme vetëm nëse shteti i paditur nuk ka ofruar ende zgjidhje të mjaftueshme.

Jo çdo vendim administrativ i dhënë në favor në kërkuesit, i heq atij statusin e viktimës¹⁹⁷. Që të bëhet kjo, vendimi duhet të përmbushë dy kushte:

- duhet të njohë shprehimisht ose në substancë një shkelje të të drejtës(ave) të kërkuesit
- duhet të japë zgjidhje të mjaftueshme

9.2.2.1.3.1. Njohja e shkeljes

Njohja, se ka pasur një shkelje të të drejtave të kërkuesit, mund të paraqitet shprehimisht ose në substancë. Kjo mund të jetë për shembull në formën e gjykimit duke deklaruar se ka pasur një shkelje, P.sh. në *Gafgen kundër Gjermanisë*¹⁹⁸, një oficer policie kishte kërcënuar kërkuesin, i cili kishte rrëmbyer një fëmijë, se do ta torturonte për të marrë informacione. Në procedimet penale kundër kërkuesit për rrëmbimin e fëmijës, Gjykata kompetente kishte deklaruar shprehimisht se kjo kishte qenë një metodë e ndaluar e marrjes në pyetje. Përveç kësaj, oficeri i policisë ishte dënuar me gjobë. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ishte e kënaqur që ishte pranuar se kishte pasur shkelje të të drejtave të kërkuesit (sidoqoftë, ajo mësoi se nuk ishte ofruar një zgjidhje e mjaftueshme, shih më

¹⁹⁵ Paragrafi 75

¹⁹⁶ Tanase kundër Rumanisë (kërkesa nr. 07/08), vendimi i Dhomës së Madhe i datës 27 prill 2010

¹⁹⁷ Gafgen kundër Gjermanisë (kërkesa nr. 22987/05, vendimi i Dhomës së Madhe i datës 1 qershor 2010) paragrafi 115

¹⁹⁸ Kërkesa nr. 22987/05, vendimi i Dhomës së Madhe i datës 1 qershor 2010

poshtë). Ndryshe nga kjo, në çështjen *Dalban kundër Rumanisë*¹⁹⁹, Dhoma e Madhe e Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut konstatoi se nuk kishte pasur një vendim që njëjtte shkeljen e të drejtës së kërkuarit që mund t'i hiqte atij statusin e viktimës. Rasti kishte të bënte me një gazetar rumun të dënuar për shpifje, për shkak të supozimeve që ky kishte ngritur kundër dy zyrtarëve publikë. Ndërsa apeli i paraqitur Gjykatës Supreme ishte ende në pritje të vendimit, kërkuarisi vdiq dhe Gjykata Supreme vendosi që t'i mbyllë procedimet për shkak të vdekjes së kërkuarit. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut theksoi se vendimi i Gjykatës Supreme, ndonëse nuk e mbështeti dënimin e kërkuarit, nuk e njohu shkeljen e të drejtave të tij, sepse ishte bazuar vetëm tek vdekja e kërkuarit. Prandaj, ajo gjykoj që kërkuarisi duhej konsideruar viktimë, sipas nenit 34 të KEDNJ-së.

9.2.2.1.3.2. Zgjidhje e mjaftueshme

Përveç njohjes së shkeljeve të të drejtave të kërkuarit, masa apo vendimi i dhënë nga shteti duhet të ofrojë zgjidhje të mjaftueshme në mënyrë që të mund t'ia heqë kërkuarit “statusin e viktimës”. Se ç'loj zgjidhjeje është e mjaftueshme, kjo duhet vlerësuar rast pas rasti, duke marrë në konsideratë të gjitha rrethanat e rastit. Njohja e **dëmshpërblimit** për viktimën dhe masa e dhënë, janë faktorë të rëndësishëm kur vlerësohet nëse zgjidhja është e mjaftueshme për kërkuarin, në mënyrë që atij t'i hiqet statusi i viktimës. Nëse masa e dëmshpërblimit është mjaft më e ulët sesa jepet zakonisht nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut për raste të ngjashme, ky është një argument që tregon se kërkuarisi nuk i është hequr statusi i viktimës. Për shembull, në çështjen *Ciorap kundër Moldavisë (nr.2)*²⁰⁰, kërkuarisi e kishin mbajtur në paraburgim në kushte poshtëruese që shkelnin si standardet ndërkombëtare, ashtu si edhe ato të ligjit të Moldavisë. Gjykatat në Moldavi e pranuan këtë dhe caktuan një dëmshpërblim në shumën prej 600 eurosh. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut theksoi se vete Gjykata në çështjen *Gavrilovici kundër Moldavisë*²⁰¹, kishte caktuar një dëmshpërblim prej 6.000 eurosh për dhjetë ditë të kaluara në paraburgim në kushte çnjerëzore. Meqë shuma e caktuar për kërkuarin ishte shumë më e ulët, Gjykata ishte e mendimit se ai nuk e kishte humbur statusin e viktimës.

Gjithsesi, nga ky rregull ka edhe përjashtime. Në veçanti, në rastin e **procedimeve tejet të zgjatura**, shumat e caktuara si dëmshpërblim konsiderohen ende si zgjidhje e mjaftueshme nëse janë më të ulëta sesa shumat e caktuara nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, me kusht që të mos jenë

¹⁹⁹ Kërkesa nr. 28114/95, vendimi i Dhomës së Madhe i datës 28 shtator 1999

²⁰⁰ Kërkesa nr. 7481/06, vendimi i datës 20 korrik 2010

²⁰¹ Kërkesa nr. 25464/05, vendimi i datës 15 dhjetor 2009

të paarsyeshme. Kjo është veçanërisht e vërtetë në shtetet që kanë zgjedhur të ofrojnë zgjidhje në vend, të cilat janë të destinuara që të përshpejtojnë procedimet dhe të përballojnë dëmshpërblimin²⁰².

Nëse shkelen të drejtat e kërkuarit sipas **nenit 3** (ndalimi i torturës), zgjidhja e mjaftueshme kërkon

- që të jetë kryer një hetim efikas, që mund të të çojë në identifikimin dhe ndëshkimin e personave përgjegjës
- që viktimat të ketë marrë dëmshpërblim të mjaftueshëm apo që të paktën të ketë mundësinë për të marrë dëmshpërblim.

Kur vlerësohet nëse hetimi ka qenë efikas, Gjykata Evropiane merr në konsideratë shpejtësinë me të cilin ai është kryer. Detyrimi për të kryer një hetim efikas është një detyrim për kryerjen e tij, dhe jo për rezultatet. Vetë fakti që hetimi nuk ka çuar në identifikimin e personave përgjegjës për keqtrajtimin nuk e bën atë domosdoshmërisht jo efikas, gjithsesi veprimet e ndërmarra duhet që në parim të jenë të duhurat për identifikimin e personit/personave përgjegjës për keqtrajtimin. Sidoqoftë, në rastet kur është identifikuar personi përgjegjës, duhen vendosur sanksione që reflektojnë sesa e rëndë ka qenë vepra penale. Këto përgjithësisht përfshihen sanksionet penale dhe ato disiplinore.

Në rastin e sipërpërmendur *Gafgen kundër Gjermanisë* (në të cilin një oficer policie kishte kërcënuar një të dyshuar se do ta torturonte), oficeri përgjegjës ishte dënuar dhe kishte marrë një gjyq, e cila ishte anuluar. Gjykata Evropiane nuk e konsideroi këtë zgjidhje të mjaftueshme, të tillë sa për t'ia hequr kërkuarit statusin e viktimës.

9.2.2.3. Subjektet potencialë që mund të paraqesin kërkesë përpara Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut

Kërkesat përpara Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, mund të paraqiten nga individë, organizata jo-qeveritare si dhe nga grupe individësh.

9.2.2.3.1. Individët

Përpara Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut mund të paraqesin kërkesa individët. Të miturit përfaqësohen nga prindërit e tyre apo kujdestarët ligjorë.

²⁰² Vidakovic kundër Serbisë.

9.2.2.3.2. Organizatat jo-qeveritare

9.2.2.3.2.1. Organizatat

Organizatat jo-qeveritare kanë të drejtë t'i paraqesin kërkesa Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. E vetmja e drejtë sipas kësaj Konvente që u jepet shprehimisht personave juridikë është e drejta e gëzimit paqësor të pasurisë (Neni 1 i Protokollit 1 të KEDNj-së). Pavarësisht kësaj, të drejtat e tjera të parashikuara në KEDNj mund të kërkojnë nga organizatat apo personat juridikë, me kusht që natyra e së drejtës në fjalë ta lejojë një gjë të tillë (për shembull, ndalimi i torturave nuk luan asnjë rol për subjektet ligjore). Organizatat në kuptimin të Neni 34 përfshijnë (por nuk kufizohen vetëm me kaq) sindikatat, partitë politike, kompanitë, fondacionet dhe shoqatat.

Një kërkesë e bërë nga organizatat mund të bazohet vetëm në shkeljen e të drejtave të tyre, jo në shkeljen e të drejtave personale të anëtarëve të organizatës. Për shembull, në çështjen *Kisha e Shkencologjisë së Gjermanisë kundër Gjermanisë*²⁰³, kërkuesi ishte një shoqatë e regjistruar, pjesë e *Shkencologjisë*. Ajo u ankua se një numër masash, të cilat kishin për qëllim minimizimin e ndikimit të *Shkencologjisë* në Gjermani (duke përfshirë një fushatë informative me paralajmërime publike), kishte shkelur të drejtat e anëtarëve të saj. Komisioni Evropian i të Drejtave të Njeriut theksoi se një shoqatë e tillë nuk kishte të drejtë që ta bazonte kërkesën e saj tek një shkelje e të drejtave të anëtarëve të saj; ajo gjithashtu deklaroi se shoqata kërkuese nuk kishte arritur të përcaktonte identitetin e anëtarëve që hamendësohej se përfaqësonin atë. Kështu që ajo e refuzoi kërkesën si të papranueshme.

Organizatat që janë themeluar pikërisht për të iniciuar procedimet për një grup të caktuar personash, nuk kanë të drejtë të paraqesin një kërkesë në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Për shembull, në çështjen *Nënat e Srebrenicës kundër Holandës*²⁰⁴, kërkuesi ishte një fondacion i themeluar me qëllim nisjen e procedimit në emër të të afërmeve të personave të vrarë në masakrën e Srebrenicës. Ata kishin filluar procedimin gjyqësor përpara gjykatës holandeze, kundër OKB-së për mos mbrojtjen nga ana e saj të popullsisë civile të Srebrenicës. Ndër të tjera ato u ankuan se imuniteti ndërkombëtar i OKB-së i pengonte në marrjen e drejtësisë dhe në arritjen e zgjidhje ligjore efikase. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut e refuzoi kërkesën si të papranueshme, duke deklaruar se kërkuesi nuk arriti të tregonte se ishin shkelur të drejtat e atij vetë.

²⁰³ Kërkesa nr. 34614/97, vendim për pranueshmërinë i datës 7 prill 1997

²⁰⁴ Kërkesa nr. 65542/12, vendim për pranueshmërinë i datës 11 qershor 2013

Organizatave të drejtave të njeriut nuk kanë të drejtë që të paraqesin kërkesa në lidhje me shkeljen e të drejtave të personave apo grupeve që ato mbrojnë²⁰⁵. Megjithatë, vlen të theksohet se një rast,²⁰⁶ që kishte të bënte me të drejtën e një organizatë jo-qeveritare për të paraqitur një kërkesë të një individi me aftësi të kufizuara mendore që kishte vdekur, iu referua Dhomës së Madhe të Gjykatës në mars të vitit 2013. Kështu që, mbetet për t'u parë nëse Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut do ta modifikojë qasjen e saj ndaj qëndrimeve të organizatave të të drejtave të njeriut.

9.2.2.3.2.2. Organizmat jo shtetërorë / entet jo publikë

Organizmat që paraqesin kërkesa në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, duhet të jenë jo shtetërorë. KEDNJ-ja rregullon sjelljen e shteteve anëtare në raport me çdo individ që ndodhet në juridiksionet e tyre. Ajo u referohet të drejtave ndaj shtetit dhe nuk aplikohet në lidhje me mënyrën se si sillen me njëra-tjetrën, entet e ndryshme shtetërore. Si pasojë, e drejta për të paraqitur një kërkesë i jepet organizatave jo shtetërore.

Organizatave shtetërore nuk kanë të drejtë të paraqiten në Gjykatë. Subjektet që janë nën-struktura të shtetit apo që ushtrojnë pushtet publik, nuk mund të konsiderohen viktime të sjelljes së shtetit. Të tilla janë jo vetëm organet qendrore të shtetit, por edhe autoritetet e decentralizuara që kryejnë funksione publike ndaj autoriteteve vendore apo rajonale.²⁰⁷ Një gjë e tillë vlen edhe për ato organizata që gëzojnë një pavarësi të një shkalle të caktuar nga pushteti qendror si, bashkitë, komunat, qytetet, etj. Në çështien *Bari, Sorrentino dhe Messini Nemagna kundër Italisë*²⁰⁸, bashkia e Barit u ankua se shteti italian nuk i kishte siguruar asnjë ndihmë për ndërtimin e pallatit të operës i cili ishte djegur. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut theksoi se provincat në Itali janë autoritete publike ligjore që kryejnë detyra që u ngarkohen nga Kushtetuta dhe legjislacioni dhe për këtë arsye nuk mund të konsiderohen organizata joshetërore. Ajo vendosi të mos e pranojë kërkesën.

Për të vendosur nëse një organizatë duhet të konsiderohet jo shtetërore apo jo, mund të rezultojë e vështirë, nëse në të përfshihen shoqëri apo subjekte të tjera juridike që janë pjesërisht apo plotësisht në pronësi të shtetit. Ku vlerësohet nëse një shoqëri apo subjekt i tillë juridik ka të drejtë apo jo për të paraqitur një

²⁰⁵ Van Melle dhe të tjerë kundër Holandës, Kërkesa nr. 19221/08, vendim për pranueshmërinë i datës 29 shtator 2009

²⁰⁶ Qendra për Burime Ligjore kundër Rumanisë (Kërkesa nr. 47848/08)

²⁰⁷ Radio France kundër Francës, vendim për pranueshmërinë, paragrafi 26

²⁰⁸ Kërkesa nr. 41877/08, gjykim i datës 31 mars 2009

kërkesë në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Gjykata merr parasysh kriteret e mëposhtme:

- Statusin ligjor dhe të drejtat që ky status i jep subjektit në fjalë
- Natyrën e aktiviteteve që kryen dhe kontekstin ku ato zhvillohen
- Masën e pavarësisë nga autoritetet shtetërore

Pronësia e një subjekti apo shoqërie është vetëm një faktor i cili duhet të përfillet kur vlerësohet nëse organizata është jo-shtetërore apo shtetërore. E marrë veçmas, kjo gjë nuk është vendimtare. Një subjekt mund të jetë plotësisht në pronësi të shtetit dhe konsiderohet shtetërore, ndërkohë që në anën tjetër një organizatë e cila në një pjesë të madhe është private, mund të jetë po ashtu shtetërore. Për shembull, në çështjen *Linja e Transportit Iranian e Republikës Islamike kundër Turqisë*²⁰⁹, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vendosi që një shoqëri në pronësi 100% të shtetit të Iranit, ishte joshtetërore. Në këtë rast, autoritetet turke kishin konfiskuar një anije që ishte marrë me qira nga kërkuesi, për shkak të dyshimit që ata kishin se ajo mbante armë kontrabandë.

Shoqëria kërkuese ishte në pronësi të shtetit iranian. Pasi hapat ligjore në nivel kombëtar të ndërmarë kundër këtij konfiskimit nuk patën sukses, shoqëria paraqiti një kërkesë në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. E paditura, qeveria turke, pretendoi se kërkuesi nuk kishte të drejtë, pasi anija ishte në pronësi të shtetit dhe jo të një organizate jo qeveritare. Gjykata theksoi se kërkuesi ishte objekt i ligjit për shoqëritë tregtare dhe përfshihej në aktivitetet tregtare. Kështu që nuk kishte asnjë arsye që ta trajtonte atë ndryshe nga shoqëritë e tjera private. Në krahasim me këtë, në çështjen *Transpetrol kundër Sllovakisë*²¹⁰, Gjykata vendosi që një shoqëri duhej të konsiderohej shtetërore, megjithëse 49% e aksioneve të saj ishin në duart e privatëve.

Kur shqyrtohet natyra e aktiviteteve dhe konteksti ku zhvillohen ato, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut merr parasysh faktin nëse organizata apo subjekti në fjalë siguron shërbime publike apo përbush funksione publike apo nëse është i përfshirë në aktivitetet që konsiderohen prova si aktivitetet tregtare. Përsëri, ky është vetëm një ndër shumë faktorë të tjerë.

Pavarësia nga shteti ka të bëjë me shkallën deri ku shteti është në gjendje të ushtrojë ndikimin ndaj një organizate të caktuar. Një organizatë mund të jetë pronë shtetërore, por përsëri mund të ketë një mburojë kundrejt ndikimit të shtetit në atë mënyrë që e justifikon faktin që shteti ta konsiderojë atë si joqeveritare. Për shembull, në çështjen *Radio France kundër Francës*²¹¹, kërkuesi

²⁰⁹ Kërkesa nr. 40998/98, gjykim i datës 13 dhjetor 2007

²¹⁰ Kërkesa nr. 28502/08, vendim për pranueshmërinë i datës 15 nëntor 2011

²¹¹ Shiko shënimin e mësipërm 102

ishite në pronësi të shtetit të paditur dhe financohej prej tij, por kontrollohej nga një trupë e pavarur e cila e mbronte atë nga ndikimi i drejtpërdrejtë dhe e arsyetoi pozicionin e tij si të një organizate jo-shtetërore.

9.2.2.3.2.3. Grupe individësh

Nocioni i grupit të individëve mbivendoset si me individët, ashtu edhe me organizatat jo-qeveritare. Një gjë e tillë rrallë ka qenë problematike në juridiksionin e Gjykatës.

9.2.3. Shterimi i mjeteve ligjore në nivel kombëtar

9.2.3.1. Tablo e përgjithshme

Para se të paraqesë një kërkesë në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, kërkuuesi duhet të shterojë mjetet ligjore në nivel kombëtar. Detyrimi për sigurimin e të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, bie mbi shtetet që aderojnë në të. Kështu që, shtetet janë ato ku duhet se pari drejtuar duhet te drejtohesh që duhen adresuar kur ne rast se një qëndrim i cili bie ndesh me Konventën, duhet të ndreqet apo të rigjykohet²¹². Vetëm në rast se ato nuk e bëjnë një gjë te tillë, hyn në funksion makineria mbrojtëse në shkallë ndërkombëtare. Shtetet përjashtohen nga dhënia e përgjigjes para një organi ndërkombëtar për veprimet e tyre derisa të kenë pasur mundësi që t'i rregullojnë gjërat përmes sistemit të tyre ligjor.²¹³ Kjo do të thotë se kërkuuesi duhet të ndjekë çdo shkallë në dispozicion të tij në vendin e vet për të fituar të drejtën e parashikuar nga Konventa dhe për të kërkuar ndreqje të shkeljeve që ka vuajtur.

Në anën tjetër, shfrytëzimi i mjeteve ligjore në nivel kombëtar ka kuptim vetëm nëse këto mjete mbartin mundësinë e ndreqjes së këtyre shkeljeve. Konventa synon një mbrojtje praktike dhe efikase të të drejtave që ajo parashikon. Do të ishte në kundërshtim me këtë objektiv, që t'i detyroje kërkuuesit e mundshëm t'iu drejtoheshin proceseve gjyqësore të pakuptimta në vendin e tyre. Kështu që kërkuuesi duhet të angazhojë vetëm mjetet efikase ligjore në nivel kombëtar.²¹⁴

Shterimi i mjeteve ligjore në nivel kombëtar luan një rol të rëndësishëm në praktikë, sidomos në këto dy aspekte:

²¹² Denisov kundër Rusisë, para 4; Demopoulos kundër Turqisë (Dhoma e Madhe) paragrafi 69

²¹³ Taron kundër Gjermanisë; Riedl-Riedenstein kundër Gjermanisë, f. 14

²¹⁴ Akdivar kundër Turqisë, paragrafi 67

- Së pari, shtetet e paditura shpesh kundërshtojnë duke thënë se kërkuesi nuk ka shteruar mjetet ligjore në nivel kombëtar, kështu që çështja mund të vihet në pikëpyetje para Gjykatës.

- Së dyti, shterimi i mjeteve ligjore në nivel kombëtar lidhet edhe me periudhën brenda së cilës çështjet duhen sjellë në Gjykatë. Periudha gjashtë-mujore llogaritet duke filluar nga data e vendimit të formës së prerë për mjetin e fundit ligjor. Ky fakt përcaktohet përfundimisht nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut. Kërkuesi duhet të marrin parasysh riskun se ata po shfrytëzojnë një mjet ligjor në nivel kombëtar, të cilën ata, në mënyrë të gabuar e konsiderojnë efikas dhe duke vepruar kështu ata nuk arrijnë të paraqesin brenda afatit kërkesën, pasi Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut e llogarit fillimin e periudhës gjashtë-mujore që nga vendimi i një mjeti tjetër ligjor²¹⁵ (të cilën Gjykata e konsideron si mjetin e fundit ligjor në fuqi).

Prandaj, avokatët që i këshillojnë klientët e tyre që t'i drejtohen Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, duhet të shohin me shumë kujdes nëse janë shteruar të gjithë mjetet ligjore efikase në nivel kombëtar dhe se cili mjet ligjor i ndjekur ishte efikas.

Se cilat mjete ligjore janë efikase duhet të vlerësohet rast pas rasti, duke marrë parasysh të gjithë rrethanat e çështjes. Për disa lloj mjetesh ligjore (për shembull për ankesa të jashtëzakonshme), Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka deklaruar se në përgjithësi ato nuk konsiderohen efikase (shiko më poshtë). Sidoqoftë, duhet parë me kujdes në secilin rast, nëse ekzistojnë rrethana të veçanta që mund të përlligjin një devijim nga ky vendim.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vlerëson rregullisht efikasitetin e mjeteve të caktuara ligjore në juridiksione të ndryshme, të ashtu quajtura procedime-pilot (shiko më poshtë). Rezultatet e këtyre procedimeve botohen në faqen e internetit të Gjykatës. Kur analizohet nëse një mjet ligjor është efikas apo jo, ia vlen të shikohet nëse Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka dhënë më herët ndonjë vendim në lidhje me këtë çështje. Në fund të çdo viti, Gjykata boton "*shënimet informuese të çështjeve gjyqësore*" ku ajo i referohet vendimeve të rëndësishme. Në këto shënime informuese, mjetet ligjore të shqyrtuara nga Gjykata renditen sipas vendeve.

9.2.3.2. Mjetet ligjore efikase

Para se të paraqesin një kërkesë në Gjykatë, kërkuesi duhet të shfrytëzojnë mjetet ligjore efikase dhe të realizueshme, në nivel kombëtar. Kjo kërkesë ka dy

²¹⁵ Tucka kundër Mbretërisë së Bashkuar, paragrafi 14

aspekte: Kërkuesi duhet të shfrytëzojë mjetet ligjore në dispozicion dhe duhet të paktën ta ngrejë në thelb çështjen apo shkeljen e të drejtave të Konventës.

9.2.3.2.1. Mjetet ligjore të realizueshme që sigurojnë rigjykime të mjaftueshme

Kërkuesit duhet të përdorin këto mjete ligjore që janë normalisht të realizueshme dhe të mjaftueshme për të vënë në vend shkeljen (e hamendësuar) të të drejtave të Konventës²¹⁶. Për të qenë efektive dhe të realizueshme, ekzistenca e këtyre mjeteve ligjore duhet të jetë mjaftueshmërisht e sigurt jo vetëm në teori, por edhe në praktikë.²¹⁷ Kur vlerësohet nëse një mjet është efektive apo jo, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ndër të tjera, merr parasysh numrin e personave që e kanë shfrytëzuar më herët me sukses këtë mjet (në lidhje me barrën e provës, shiko më poshtë). Për shembull, në çështjen *Demopoulos kundër Turqisë*²¹⁸, Gjykata mori një vendim për efikasitetin e mjeteve ligjore të paraqitura në Turqi për të siguruar një rigjykim për shpronësimin e pronës në Qipro. Ajo e bazoi vlerësimin e saj në faktin se mjetet ligjore në nivel kombëtar, mes faktorëve të tjerë, ishin përdorur më herët nga 85 persona të privuar nga prona e tyre dhe se atyre u ishte dhënë një shumë e madhe parash.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut merr gjithashtu parasysh, kontekstin ligjor dhe politik ku ndodhet kërkuesi para se të paraqesë kërkesën. Në çështjen *Akdivar kundër Turqisë*²¹⁹, kërkuesi u ankua për shkatërrimin e shtëpisë së tij nga forcat turke të sigurisë. Qeveria turke kundërshtoi, duke thënë se ai nuk kishte bërë një padi civile për të përfituar kompensimin në Turqi. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut nënvizoi situatën e mosmarrëveshjeve civile në zonën ku jetonte kërkuesi, dhunën e terroristëve dhe përplasjet e vazhdueshme mes forcave turke të sigurisë dhe Partisë Turke të Punës. Gjykata arriti në përfundimin se kërkuesi ishte në një gjendje shumë të cënueshme dhe i varur nga shteti. Duke pasur parasysh se masat ndëshkuese nuk mund të përjashtoheshin, Gjykata vendosi se nuk ishte e arsyeshme që të pritej nga kërkuesi të bënte një padi civile kundër forcave të sigurisë.

Kërkuesi nuk duhet vetëm të shfrytëzojë masa të tilla për të cilat është i sigurt se do ta çojnë në një rigjykim të çështjes. Thjesht, dyshimet e kërkuesit në lidhje me rezultatet e pritshme, nuk e bëjnë një mjet ligjor të pavlefshëm. Megjithatë, nëse kërkuesi këshillohet në mënyrë kompetente se mjeti ligjor nuk

²¹⁶ Burden kundër Mbretërisë së Bashkuar (Gjykim i Dhomës), paragrafi 35

²¹⁷ Akdivar kundër Turqisë, paragrafi 66

²¹⁸ Kërkesa nr. 46113/99 vendim i Dhomës së Madhe për pranueshmërinë i 1 mars 2010

²¹⁹ Kërkesa nr. 21893/93, vendim i Dhomës së Madhe i datës 16 shtator 1996

ka për të qenë i suksesshëm në vijim, ai nuk është i detyruar ta përdorë atë. Në çështjen *Van Oostervijk kundër Belgjikës*²²⁰, kërkuesi ishte një femër transeksuale e kthyer në mashkull. Ai kishte kërkuar që të ndryshonte emrin e tij në dokumentet zyrtare. Gjykata e shkallës së parë e kishte refuzuar kërkesën. Kërkuesi nuk e ankimoi këtë vendim në Gjykatën e Apelit, por menjëherë paraqiti një kërkesë në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Ai theksoi se një numër personash të kualifikuar e kishin këshilluar duke i thënë se ankimimi në Gjykatën e Apelit do të ishte i pakuptimtë. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut deklaroi se një pohim i tillë nuk ishte i mjaftueshëm për të treguar se një ankesë nuk do të kishte qenë mjet efikas ligjore; veçanërisht për shkak se kërkuesi nuk kishte dhënë hollësi se tek cilët persona të kualifikuar kishte qenë dhe ku saktësisht e kishin bazuar ata mendimin e tyre. Ndryshe nga ky rast, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në një rast tjetër që kishte të bënte me mosparaqitjen e një ankimi në Belgjikë, u shpreh se mjetet ligjore në nivel kombëtar ishin shteruar.

Në çështjen *Chapman kundër Belgjikës*²²¹, kërkuesi kishte paraqitur një padi kundër NATO-s në një mosmarrëveshje lidhur me marrëdhëniet e punës. Pasi kishte humbur çështjen në shkallë të parë, ai kërkoi nga një avokat i një Gjykate Apeli një mendim për të ardhmen e një ankimi. Në Belgjikë, është traditë që avokatët që punojnë në Gjykatën e Apelit, të inspektojnë dosjen gjyqësore në mënyrë që të ofrojnë këshilla nëse duhet ankimuar vendimin apo jo. Duke ndjekur këtë procedurë, avokati i Gjykatës së Apelit deklaroi se një ankimi do të ishte pothuajse i pasuksesshëm. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, vendosi se kërkuesi nuk ishte i detyruar që të paraqiste një ankesë për të shteruar mjetet ligjore në nivel kombëtar. Ndryshe nga rasti i sipërpërmendur i *Van Oostervijk*, ishte e qartë se ky avokat që i kishte dhënë këshilla, ishte një avokat i licencuar për të kryer funksionet e kërkuara dhe kishte përvojë në Gjykatën e Apelit. Ishte gjithashtu e qartë se ai kishte bërë një analizë të përpiktë të dosjes gjyqësore dhe të gjitha aspekteve ligjore të çështjes. Po kështu, një mjet ligjor nuk mund të konsiderohet efikas nëse ekziston një **praktike ligjore** për sa kohë që ajo nuk ofron asnjë perspektivë të suksesshme për një rigjykim të çështjes së kërkuarit. Megjithatë, një mjet ligjor që nuk konsiderohet efikas për shkak të një praktike të vendosur ligjore mund të konsiderohet efikas në rast se gjykatat ndryshojnë mënyrën se si e kanë interpretuar ligjin. Për shembull, në çështjen *Shkalla kundër Shqipërisë*, kërkuesi ishte dënuar në mungesë. Ai paraqiti një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, e cila u refuzuar për shkak se kërkesa nuk ishte paraqitur brenda afatit të parashikuar nga ligji. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vendosi

²²⁰ Kërkesa nr. 7654/76, vendim për pranueshmërinë i datës 6 nëntor 1980

²²¹ Kërkesa nr. 39619/06, vendim për pranueshmërinë i datës 5 mars 2013

se mënyra e llogaritjes së afatit nga Gjykata Kushtetuese cenonte nenin 6 dhe arriti në përfundimin që një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese nuk kishte qenë një mjet ligjor efikas. Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë ndryshoi qëndrimin e saj për dënimet në mungesë, duke sqaruar që afati për paraqitjen e një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese fillonte në çastin kur i dënuari vihej në dijeni për dënimin. Pas ndryshimit të qëndrimit të Gjykatës Kushtetuese Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në çështjen *Izet Haxhia kundër Shqipërisë* vendosi që kërkesat e paraqitura në Gjykatën Kushtetuese konsideroheshin si mjete ligjore efikase.

Kërkuesit gjithashtu nuk janë të detyruar që të përdorin një mjet ligjor të caktuar nëse shumë persona të tjerë, më herët, nuk kanë arritur rigjykimin në një rast të ngjashëm.

Kërkuesi duhet të ndjekë mjetet ligjore që mund të jenë efikase dhe të mjaftueshme. Nëse ai ka shfrytëzuar një mjet ligjor pa pasur akses, atëherë nuk kërkohet përdorimi i një mjeti tjetër i cili **ka në thelb të njëjtin objektiv**²²². Në çështjen *Kozacioglu kundër Turqisë*²²³, kërkuesi ishte shpronësuar. Ai ngriti një padi civile duke pretenduar se, vlera historike e ndërtesës së tij duhej të ishte marre parasysh, në përcaktimin e shumës së kompensimit. Ky argument ishte refuzuar nga gjykatat civile turke. Në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, qeveria turke pretendoi se kërkuesi duhej ta kishte çuar rastin në një gjykatë administrative. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut e refuzoi këtë argument. Ajo theksoi se kërkuesi kishte ngritur çështjen e vlerës historike tek gjykata civile dhe se prej tij natyrisht nuk pritej që ta çonte të njëjtën çështje përsëri tek gjykata administrative.

Mjetet ligjore, përdorimi i të cilave varet nga **pushteti diskrecional** i zyrtarëve publikë dhe ku kërkuesi nuk ka akses të drejtpërdrejtë nuk duhet të konsiderohen efikase. Në çështjen *Tanase kundër Moldavisë*²²⁴, kërkuesi kishte nënshtetësi si moldave, ashtu edhe rumune. Republika e Moldavisë kishte miratuar një ligj sipas të cilit personat me nënshtetësi rumune nuk mund të garonin në zgjedhje për president. Kërkuesi nuk kishte asnjë të drejtë për të paraqitur një ankesë kushtetuese në Moldavi. Ai paraqiti një kërkesë në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. I padituri deklaroi me forcë se ai nuk kishte shteruar mjetet ligjore në nivel kombëtar. I padituri argumentoi se kërkuesi mund të kishte paraqitur një kërkesë tek Avokati i Popullit, i cili mund të kishte paraqitur një ankesë kushtetuese dhe në këtë mënyrë mund të kishte sfiduar ligjin në Gjykatën

²²² Riad dhe Idiab kundër Belgjikës, paragrafi 84; Ruminski kundër Suedisë (Kërkesa nr. 10404/10), vendim për pranueshmërinë i datës 21 maj 2013, paragrafi 38

²²³ Kërkesa nr. 2334/03, Vendim i Dhomës së Madhe i 19 shkurt 2009

²²⁴ Kërkesa nr. 7/08, Vendim i Dhomës së Madhe i 27 prill 2010

Kushtetuese të Moldavisë. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut e refuzoi këtë argumentim. Ajo theksoi se Avokati i Popullit kishte diskrecionin për ta paraqitur ose jo një ankesë kushtetuese, kështu që kërkuesi nuk kishte qasje ndaj këtij mjete ligjor dhe për këtë arsye ai ishte një mjet jo efikas. Përveç kësaj, **Avokati i Popullit** në shumicën e shteteve nuk ka fuqinë për të marrë vendime detyruese, por i është dhënë fuqi për të siguruar opinione këshilluese apo për të dhënë rekomandime. Për këtë arsye, ato nuk duhen konsideruar si mjete efikase.²²⁵

Një kërkesë për **rihapjen e një procedure**, zakonisht nuk mund të konsiderohet si një mjet ligjor efikas, në kuptim të Nenit 35, paragrafi 1 i KEDNJ-së²²⁶. E njëjta gjë vlen edhe për mjetet ligjore të jashtëzakonshme²²⁷.

Për të njëjtat arsye, mjetet ligjore të cilat kanë **afate kohore të paqarta** nuk duhet të konsiderohen si mjete ligjore efikase²²⁸. Siç u theksua, shterimi i mjeteve ligjore në nivel kombëtar është i lidhur ngushtë me afatin kohor për paraqitjen e kërkesës, pasi vendimi përfundimtar i mjetit të fundit ligjor në fuqi është edhe fillimi i periudhës gjashtë-mujore. Afati kohor, ndër të tjera, ekziston për të krijuar një siguri ligjore²²⁹. Ky qëllim nuk mund të arrihet nëse fillimi i periudhës brenda së cilës duhet të paraqitet një kërkesë varet nga një mjet ligjor i cili në vetvete ka një afat kohor të paqartë. Për shembull, në çështjen *Denisov kundër Rusisë*²³⁰, kërkuesi kishte paraqitur një kërkesë për një shqyrtim mbikëqyrës. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut iu referua vendimeve të ndryshme që mund të ishin marrë në procedime të këtij lloji dhe mundësisë së korrigjimit të tyre. Ajo arriti në përfundimin se një kërkuar në mënyrë që t'i shterojë ato duhej të shkelte qëllimin e sigurisë juridike.

Në rastet e keqtrajtimit nga ana e oficerëve të policisë, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut mendon se kërkuesi e përmbush detyrimin e tij për shfrytëzimin e mjeteve ligjore në nivel kombëtar, nëse ai ndjek rrugën e parashikuar në sistemin penal të drejtësisë, duke bërë për shembull një kërkesë për ndjekje, një ankesë apo denoncim në prokurori apo polici. Kërkuesi nuk është i detyruar që të ndërmarrë veprime civile (p.sh. për kompensim), apo të fillojë procedimet administrative.²³¹

²²⁵ Jasar kundër Maqedonisë (kërkesa nr. 69908/01), vendim për pranueshmërinë i datës 11 prill 2006, f. 11;

²²⁶ Riedl-Riedenstein kundër Gjermanisë (kërkesa nr. 48662/09), vendim për pranueshmërinë i datës 22 janar 2002, f. 15

²²⁷ Tucka kundër Mbretërisë së Bashkuar (kërkesa nr. 34586/10), vendim për pranueshmërinë i datës 18 janar 2011, paragrafi 15

²²⁸ Williams kundër Mbretërisë së Bashkuar (kërkesa nr. 32567/06), vendim për pranueshmërinë i datës 17 shkurt 2009

²²⁹ Williams kundër Mbretërisë së Bashkuar, f. 8

²³⁰ Kërkesa nr. 33408/03, vendim për pranueshmërinë I datës 6 maj 2004

²³¹ Assenov kundër Bullgarisë; Jasar kundër Maqedonisë

Vlerësimi nëse një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese është ose jo mjet ligjor efikas, kjo varet nga rrethanat e rastit në fjalë. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka vendosur për Gjermaninë²³², Spanjën²³³, Republikën Çeke dhe Turqinë²³⁴ se një ankesë kushtetuese është në parim, mjet ligjor efikas. Gjykata është e mendimit se faktorët e mëposhtëm janë në favor të ankesës kushtetuese si një mjet efikas ligjor në nivel kombëtar²³⁵:

- Ekzistenca e një mjetei specifik kushtetues
 - e cila lejon gjykatën kushtetuese që të zgjidhë shkeljet e të drejtave dhe lirive që kryhen nga autoritetet shtetërore
 - ose, nëse shkeljet e një të drejte të garantuar me kushtetutë përbëjnë një ndërhyrje dhe jo një vendim, për të penguar autoritetet përkatëse që të mos vazhdojnë shkeljen e kësaj të drejte.
 - dhe për të urdhëruar rikuperimin e statusit, siç ishte para shkeljes.
- Fakti që mjetei kushtetuese ofron një rigjykim për shkeljet që shkaktohen drejtpërsëdrejti nga një akt i një organi gjyqësor, pavarësisht fakteve të cilat kanë çuar në procedurë.

Në çështjen *Izet Haxhia kundër Shqipërisë* Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka vendosur që një kërkesë e paraqitur në Gjykatën Kushtetuese është një mjet ligjor efikas për të kundërshtuar një dënim në mungesë. Llogaritja e afatit për paraqitjen e kërkesës fillon sapo kërkuesi të ekstradohet në Shqipëri dhe t'i njoftohet një kopje e vendimit.

Sa i përket pyetjes nëse një ankesë kushtetuese përbën mjet efikas në lidhje me kohëzgjatjen e procedimeve, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut e konsideron atë si një faktor të rëndësishëm, nëse kriteret e zbatuara në Gjykatën Kushtetuese janë të njëjta me ato që zbaton Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut. Në çështjen *Boucke kundër Malit të Zi dhe Mijanovic kundër Malit të Zi*, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut u shpreh se një **ankim kushtetues** në Malin e Zi nuk është një mjet ligjor efikas për vënien në vend të shkeljes së të drejtës për një proces gjyqësor brenda një kohe të arsyeshme.

9.2.3.2.2. Ngritja para Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut e të njëjtës çështje, si ajo e ngritur në nivel kombëtar

Për të shteruar mjetet në vend, nuk mjafton që kërkuesi të përfitojë nga mjetet e disponueshme dhe efikase. Ai gjithashtu ka nevojë – të paktën në thelb – që të

²³² Schädlich kundër Gjermanisë (kërkesa nr. 21423/07), gjykim i datës 11 mars 2008

²³³ Arcadio Fernandez Molina Gonzalez kundër Spanjës (kërkesa nr. 64359/01), gjykim i datës 8 tetor 2002

²³⁴ Uzun kundër Turqisë (kërkesa nr. 10755/13), gjykim i datës 30 prill 2013

²³⁵ Shiko përmbledhjen e Uzun kundër Turqisë (shiko më lart)

ngrejë të njëjtën ankesë që ka ndërmend të paraqesë para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Arsyeja pse kërkohet që të shterohen mjetet në vend është që shtetit të paditur t'i jepet mundësia që të ndreqë situatën ose të ofrojë zgjidhje përpara se çështjes t'i japë përgjigje një organizëm ndërkombëtar (shih më sipër). Ai do të jetë në gjendje ta bëjë këtë vetëm nëse njoftohet qartësisht për natyrën e saktë të ankesës. Për këtë, çështja në fjalë duhet ngritur në nivel kombëtar.

Kjo nuk do të thotë se kërkuesi duhet t'i referohet shprehimisht një të drejte specifike sipas Konventës apo qoftë edhe Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Por duhet të bëhet e qartë nga paraqitjet e tij në nivel kombëtar se çfarë përbën, sipas mendimit të tij, shkelje të të drejtave të tij apo se deri në cilin nivel janë shkelur të drejtat e tij. Nëse kërkuesi ankohet, për shembull, për një shkelje të të drejtës së lirisë së shprehjes, ai nuk duhet t'i referohet nenit 10 të KEDNj-së apo të përdorë termin 'liri e shprehjes'. Ai duhet të tregojë që ai mendon se i është kufizuar mundësia për të publikuar informacione, apo për të shprehur mendimin e tij. Mos ngritja në nivel kombëtar e çështjes në të cilën bazohet kërkesa e paraqitur në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, e bën të papranueshëm kërkesën e tij. Për shembull, në çështjen *Azinas kundër Qipros*²³⁶, kërkuesi u ankua për humbjen e disa të drejtave lidhur me pensionin. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut i trajton këto të drejta si pjesë e të drejtës për pronën sipas nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNj-së. Avokati i kërkuesit kishte deklaruar shprehimisht para Gjykatës Supreme të Qipros se padia nuk ishte bazuar tek neni përkatës i Kushtetutës së Qipros që mbron të drejtën e pronës. Për këtë arsye, Dhoma e Madhe e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut vlerësoi se kërkuesi nuk e kishte ngritur shkeljen në çështje, në nivel kombëtar, duke mos shteruar kështu mjetet në nivel kombëtar.

Ndonëse referencat ndaj neneve të KEDNj-së apo juridiksionit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut nuk janë të nevojshme për të shteruar zgjidhjet në nivel kombëtar, shpesh një gjë e tillë është e këshillueshme për një avokat (p.sh. një avokat që përfaqëson një palë private kundër shtetit). Në shumicën e rasteve, avokatët nuk kanë synim që të çojnë një çështje para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, por që ta fitojnë atë në nivel kombëtar. Meqë KEDNj-ja është një ligj me karakter detyrues në Shqipëri, referenca në Konventë dhe/ose në praktikën e Gjykatës, mund të ndihmojë që të bindë Gjykatën kompetente në nivel kombëtar. Ashtu siç e ka deklaruar Gjykata: *'Padyschim, në procedimet në nivel kombëtar, Konventa, si rregull, ofron një bazë plotësuese argumentimi, për t'u përdorur në rast se gjykohet e arsyeshme për arritjen e një objektivi që në parim është bërë i pamundur për*

²³⁶ Kërkesa nr. 56679/2000, vendimi i Dhomës së Madhe i datës 28 prill 2004

shkak të argumenteve të tjera ligjore.²³⁷

Në rast se kjo dështon, një referim i saktë tek KEDNj-ja pakëson në minimum mundësinë që të ngrihen kundërshtime lidhur me shterimin e mjeteve në nivel kombëtar.

9.2.3.3. Koha e disponueshmërisë së mjeteve

Në përgjithësi, kërkuesi duhet të përfitojë nga mjetet që janë të disponueshme në kohën kur ai e paraqet kërkesën para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Normalisht, Gjykata kryen vlerësimin për të parë nëse janë shteruar mjetet në nivel kombëtar duke iu referuar datës në të cilën i është paraqitur asaj kërkesa²³⁸. Prezantimi (nëse është e mundur) i mjeteve efikase në shtetin e paditur pas paraqitjes së kërkesës, si rregull, nuk e bën të paefektshëm kërkesën. Sidoqoftë, Gjykata, në disa raste **nuk i ka qëndruar këtij rregulli**.

9.2.3.3.1. Përjashtim: Mjetet në nivel kombëtar dhe lidhja e tyre me kohëzgjatjen e procedimeve

Neni 6 i KEDNj-së parasheh të drejtën për një gjykim brenda një kohe të arsyeshme. Në çështjen *Kudla kundër Polonisë*²³⁹, Dhoma e Madhe e Gjykatës ka pasur qëndrimin që mbrojtja efikase e kësaj të drejte dhe e drejta për një zgjidhje efektive në përputhje me nenin 13 të KEDNj-së të lexuar së bashku, kërkojnë që shtetet anëtare të krijojnë një mjet në nivel kombëtar nga i cili palët ndërgjygjëse të mund të përfitojnë nëse konsiderojnë që procedimet kanë qenë në mënyrë të pajustificueshme të gjata. Në vijim të këtij vendimi (dhe të tjerëve), shumë shtete palë kanë futur në përdorim procedura, në të cilat kohëzgjatja e procedimeve të tyre mund të kundërshtohet.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në një sërë çështjesh, ka vendosur që, edhe kërkuesit që kishin paraqitur një kërkesë në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, duhet të përfitojnë nga mjeti i ri në nivel kombëtar²⁴⁰. Në rast të kundërt, kërkesa mund të bëhet e papranueshme. Kjo mund të vlejë edhe nëse kërkesa ka qenë pezull për një kohë të gjatë në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut²⁴¹.

²³⁷ Van Oosterëijck kundër Belgjikës, paragrafi 33

²³⁸ Demoupoulos kundër Turqisë (shih më lart shënimin në fund të faqes 113) paragrafi 87

²³⁹ Kërkesa nr. 30210/96, vendimi i Dhomës së Madhe i datës 26 tetor 2000

²⁴⁰ Shih Brusco kundër Italisë (kërkesa nr. 69789/01), vendim për pranueshmërinë i datës 6 shtator 2001 me referenca të tjera

²⁴¹ Taron kundër Gjermanisë (kërkesa nr. 53126/07) vendim për pranueshmërinë i datës 29 maj 2012

Normalisht, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vlerëson efikasitetin e mjeteve ligjore në nivel kombëtar të cilat ofrojnë një mundësi për të kundërshtuar procedurat e zgjatura e të mbivendosura përmes të ashtu-quajturave vendime pilote. Kërkesit mund të detyrohen që të përdorin mjetet në nivel kombëtar kundër shkeljeve të së drejtës për gjykim, brenda një afati kohor të arsyeshëm dhe para se Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut të ketë përcaktuar, përmes një vendimi pilot apo një procedure tjetër, që zgjidhja e dhënë në nivel kombëtar është efikase. Gjithashtu, Gjykata nuk e ekzaminon mjetin ligjor “*in abstracto*” kur përcakton nëse, futja në përdorim e një mjeti ligjor në nivel kombëtar rrezikon një detyrim për të përdorur këtë mjet në fillim (dhe e bën kështu të papranueshme kërkesën tanimë në pritje të paraqitur në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut). Për shembull, në çështjen *Taron kundër Gjermanisë*²⁴², kërkuesi ishte përfshirë në një çështje gjyqësore të zgjatur në Gjermani. Ai paraqiti një kërkesë në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut në vitin 2007, në të cilën ai debatonte që ishte shkelur e drejta e tij për gjykim brenda një afati kohor të arsyeshëm. Në dhjetor të vitit 2011, në Gjermani hyri në fuqi një mjet i ri ligjor në nivel kombëtar i cili ofronte mundësinë e kundërshtimit të kohëzgjatjes së procedimeve. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut e ftoi kërkuenin që të përfitonte nga ky mjet, por kërkuesi refuzoi. Si pasojë, Gjykata vendosi që të mos e pranonte kërkesën. Ajo nuk u bind nga argumentimi se kërkesa kishte qenë në pritje për katër vjet. Gjykata gjithashtu, hodhi poshtë argumentimin e kërkuetit se mjeti i ri i ofruar në nivel kombëtar nuk ishte efikas. Ajo theksoi se mjeti në nivel kombëtar ishte në përputhje me kriteret e përcaktuara nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe se nuk është detyrë e Gjykatës që të ekzaminojë secilën dispozitë të mjetit të ri *in abstracto*. Prandaj ajo mbajti qëndrimin që kërkuesi duhet të kishte përfituar nga mjeti i ofruar në nivel kombëtar.

Sidoqoftë, mund të bëhet ndonjë përjashtim nga rregulli që kërkuesi duhet të përfitojë nga mjetet ligjore lidhur me kohëzgjatjen e procedimeve, nëse këto janë bërë të disponueshme pas paraqitjes së kërkesës. Në çështjen *Boucke kundër Malit të Zi*, kërkuesi kishte paraqitur një kërkesë para se të miratohej një mjet në nivel kombëtar përmes së cilës palët ndërgjyqëse të mund të kundërshtonin procedimet tejet të zgjatura. Gjykata e hodhi poshtë argumentimin e qeverisë së Malit të Zi që kërkuetit duhet të shfrytëzojnë këtë mjet në nivel kombëtar mbi bazën që ajo ishte bërë e disponueshme pas paraqitjes së kërkesave²⁴³. Prandaj është e këshillueshme nga këndvështrimi i një avokati, që kur paraqitet një kërkesë jo vetëm të shqyrtohen hollësisht të gjitha mjetet ekzistuese, por

²⁴² Kërkesa nr. 53126/07, vendim për pranueshmërinë i datës 29 maj 2012

²⁴³ Shih gjithashtu *Mijanovic kundër Malit të Zi*

gjithashtu të shqyrtohet fakti nëse kanë hyrë në fuqi mjete të reja, në mënyrë që klienti të këshillohet sesi të procedojë me kërkesën ende në pritje.

9.2.3.3.2. Përrjashtim: Mjetet në nivel kombëtar lidhur me shkeljen e të drejtave mbi pronën

Gjithashtu, në procedimet lidhur me shkeljen e të drejtave mbi pronën, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka mbajtur qëndrimin që kërkuessit duhet gjithsesi të shfrytëzojnë mjetet ligjore në nivel kombëtar të cilat kanë hyrë në fuqi pas paraqitjes së kërkesës. Në çështjen *Icyer kundër Turqisë*²⁴⁴, kërkuessi u ankua për mospasjen akses në shtëpinë e tij, e cila kishte qenë vendi i një operacioni kundër terroristëve. Pasi ai paraqiti kërkesën e tij, Turqia prezantoi një mjet në nivel kombëtar, i cili trajtonte çështje të këtij lloji dhe përcaktonte një skemë dëmshpërblimi. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut u shpreh se, pavarësisht faktit që mjeti ligjor në nivel kombëtar ishte prezantuar pas paraqitjes së kërkesës, kërkuessi duhet të shteronte së pari këtë mjet në nivel kombëtar. Ajo deklaroi se mjeti ishte hartuar posaçërisht për raste si ky dhe një shqyrtim *prima facie* i mjetit, dukej se tregonte se ai ishte efektiv. Meqë Gjykata kishte vetëm funksion subsidiar, mjeti në nivel kombëtar duhet të kishte përparësi. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka ndjekur të njëjtën vijë arsyetimi në çështjen e fundit *Demopoulos kundër Turqisë*²⁴⁵, e cila kishte të bënte me humbjen e aksesit në prona në Qipro, pas pushtimit nga Turqia.

9.2.3.4. Barra e provës

Nëse shteti i paditur kundërshton duke u shprehur se nuk janë shteruar mjetet në nivel kombëtar, ai ka edhe barrën e provës që të provojë se në kohën që bëhet fjale ka ekzistuar një mjet efikas dhe praktikisht i disponueshëm në nivel kombëtar²⁴⁶. Shteti i paditur duhet të provojë se ky mjet ka qenë i realizueshëm dhe se mund të ofronte zgjidhje për shkeljen (e supozuar) të të drejtave të Konventës duke ofruar me këtë rast edhe shpresa të arsyeshme për sukses²⁴⁷.

Sapo shteti i paditur ta ketë vërtetuar këtë, kërkuessi ka barrën e provës që të provojë se ai e ka shteruar zgjidhjen e ofruar nga shteti i paditur dhe se ajo nuk ishte efikase për shkak të rrethanave specifike të çështjes, ose në rastin konkret kishin ekzistuar rrethana të tilla të cilat justifikonin një përrjashtim nga parakushti për shterimin e zgjidhjeve në nivel kombëtar²⁴⁸.

²⁴⁴ Kërkesa nr. 18888/02, vendim për pranueshmërinë i datës 12 janar 2006

²⁴⁵ Shih më lart (shënim në fund të faqes 113)

²⁴⁶ Kozacioglu kundër Turqisë (Dhoma e Madhe), paragrafi 39

²⁴⁷ V kundër Mbretërisë së Bashkuar (Dhoma e Madhe), paragrafi 73

²⁴⁸ Akdivar kundër Turqisë (Dhoma e Madhe) paragrafi 68

9.2.3.5. Përfshirja nga parakushti për të shteruar zgjidhjet ligjore në nivel kombëtar

Kërkuesit përjashtohen nga parakushti për të shteruar zgjidhjet ligjore në nivel kombëtar, nëse ekziston një përjashtim i njohur nga rregullat e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare apo një praktikë shkeljesh të përsëritura. Ky përjashtim është në përputhje me idenë e përgjithshme që kërkuesit nuk janë të detyruar që t'u drejtohen zgjidhjeve ligjore të cilat nuk japin shpresë për sukses. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka përpunuar tiparet e një praktike shkeljesh të përsëritura në çështjen *Caraber kundër Mbretërisë së Bashkuar*²⁴⁹. Ajo u shpreh se praktika administrative e shkeljeve përbëhet nga dy elemente:

- *vepra të përsëritura*, d.m.th. një numër i konsiderueshëm veprash të lidhura në një mënyrë apo në një tjetër nga rrethanat e tyre (p.sh. vendi, koha, qëndrimi i personave të përfshirë)
- *toleranca zyrtare*, d.m.th. eprorët e personave përgjegjës, edhe pse në dijeni të veprave të paligjshme, nuk ndërmarrin veprime për të dënuar ata që janë përgjegjës apo që një autoritet më i lartë, pavarësisht supozimeve të shumta, manifeston një qëndrim indiferent dhe refuzon që të kryejë një hetim efikas.

9.2.4. Periudha kohore

9.2.4.1. Tablo e përgjithshme

Neni 35 i KEDNj-së përcakton një periudhë kohore, brenda të cilës duhet të paraqiten kërkesat në mënyrë që këto të mos jenë të papranueshme. Në kohën e përgatitjes së kësaj përmbledhjeje, afati kohor i përcaktuar në Konventë ishte gjashtë muaj. Kjo ka gjasa që të ndryshojë së shpejti. Protokollin 15 i KEDNj-së parashihet që ky afat të shkurtohet në katër muaj. Protokollin do të hyjë në fuqi sapo ai të ratifikohet nga të gjitha shtetet anëtare në Konventën Evropiane; tanimë protokollin është e hapur për nënshkrim. Prandaj avokatët që mendojnë të paraqesin një kërkesë në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut duhet të kontrollojnë me kujdes se cili afat kohor është në fuqi. Ndonëse teksti në vijim i referohet periudhës gjashtë mujore, parimet e përcjella (lidhur me përlogaritjen e periudhës, etj.) në të do të zbatohen (*mutatis mutandis*) edhe kur kohëzgjatja e afatit kohor të ketë ndryshuar.

Periudha kohore prej gjashtë muajsh, ka disa objektiva: Ajo synon krijimin e sigurisë juridike; Shtetet anëtare të Konventës duhet të dinë nëse do t'iu duhet që të përgjigjen për një sjellje të caktuar para Gjykatës Evropiane të të Drejtave

²⁴⁹ Kërkesa nr. 24520/94, vendim për pranueshmërinë i datës 11 janar 2000

të Njeriut dhe të sigurohet që vendimet, gjykimet apo aktet ligjore në nivel kombëtar të mos vihen në pikëpyetje për një periudhë kohore të pakufizuar²⁵⁰. Në të njëjtën kohë, kërkuesve do t'u jepet kohë e mjaftueshme për të shqyrtuar në hollësi vendimin në nivel kombëtar, për të marrë këshilla nëse lind nevoja dhe për të vlerësuar faktin nëse duhet ta çojnë një çështje në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut apo jo. Përpos kësaj, afati kohor vlen për të siguruar nëse faktet janë relativisht ende të freskëta në kohën kur çështja i adresohet Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe që provat janë ende të disponueshme.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut mund të verifikojë *ex-officio* nëse është respektuar afati kohor²⁵¹. Edhe nëse shteti i paditur nuk ngre kundërshtime lidhur me tejkalimin e periudhës prej gjashtë muajsh, Gjykata do ta refuzojë kërkesën si të papranueshme në rast se nuk është respektuar afati kohor²⁵².

Nëse një shtet i paditur është i mendimit se kërkesa nuk është paraqitur në kohë, ai mund të ankohet që kërkesa është e papranueshme për shkak të vonesës së saj. Në përgjithësi, shteteve të paditura iu kërkohet në një fazë të herët që të paraqesin argumente lidhur me pranueshmërinë e kërkesave. Neni 55 i Rregullores së Gjykatës thotë shprehimisht: *“Në përgjithësi, shtetet e paditura duhet që të paraqesin argumente lidhur me pranueshmërinë e kërkesës, që në një fazë të hershme”*. Po neni 55 i Rregullores së Gjykatës thotë: *“Çdo deklaram papranueshmërie duhet, përse kohë ia lejonë karakteri dhe rrethanat e saj, të ngrihet nga Pala Kontraktuese e paditur në vëzhgimet e saj me shkrim dhe me gojë mbi pranueshmërinë e kërkesës së paraqitur në përputhje me nenin 51 apo 54, sipas rastit.”* Sidoqoftë, Gjykata ka deklaruar në çështjen *Sabri Günes kundër Turqisë*²⁵³, që afati kohor është një rregull i politikave publike dhe që Rregullat e Gjykatës duhet të interpretohen në mënyrë të tillë që ta respektojnë atë. Prandaj, Qeveria nuk e ka të ndaluar që ta paraqesë këtë argument në një fazë të mëvonshme, nëse nuk e ka paraqitur në deklaratat e saj mbi pranueshmërinë. Ajo madje mund ta ngrejë atë (me sukses) për herë të parë, para Dhomës së Madhe²⁵⁴.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut i interpreton termat e përdorur në Konventë në mënyrë autonome. Për shembull, rregullat që zbatohen për përlllogaritjen e periudhave kohore në shtetet anëtare lidhur me ndërprerjet e periudhës kohore apo shtyrjen e tyre, nuk zbatohen (shih më poshtë përlllogaritjen në rast se dita e fundit e afatit kohor është ditë e diel). Sidoqoftë, Gjykata merr

²⁵⁰ Idalov kundër Rusisë (Dhoma e Madhe)

²⁵¹ Assanidze kundër Gjeorgjisë (Dhoma e Madhe), paragrafi 160

²⁵² Walker kundër Mbretërisë së Bashkuar, vendim për pranueshmërinë; Sabri Günes kundër Turqisë (vendim i Dhomës së Madhe)

²⁵³ Kërkesa nr. 27396/06, vendim i Dhomës së Madhe për pranueshmërinë i datës 29 qershor 2012

²⁵⁴ Sabri Günes kundër Turqisë, shih më sipër

deri diku në konsideratë specifikat e sistemeve kombëtare kur bëhet fjalë për pikën fillestare të periudhës kohore.

9.2.4.2. Fillimi i afatit kohor

Afati kohor për paraqitjen e një kërkesë është gjashtë muaj duke nisur nga vendimi i formës së prerë për zgjidhjen ligjore efektive të përdorur nga kërkuesi. Prandaj, afati kohor është i lidhur ngushtë me çështjen e mjetit efektiv në nivel kombëtar.

- Gjykimet

Afati kohor është, *inter alia*, për t'i dhënë kërkuetit kohë të mjaftueshme për të shqyrtuar hollësisht vendimin në nivel kombëtar dhe për të vlerësuar nëse dëshiron që të paraqesë një kërkesë në Gjykatën Evropiane të Drejtave të Njeriut. Prandaj, periudha gjashtë-mujore nis atëherë kur kërkuesi vihet në dijeni të vendimit përfundimtar mbi mjetin e fundit efektiv në nivel kombëtar. Në këtë kontekst, duhet bërë dallimi mes këtyre dy situatave:

- Legjislacioni kombëtar parasheh dorëzimin e një kopjeje me shkrim të vendimit të gjykimet
- Legjislacioni kombëtar nuk parasheh dorëzimin e një kopjeje me shkrim.

Nëse legjislacioni kombëtar parashikon dorëzimin tek kërkuesi të një kopjeje të vendimit të gjykimet, periudha gjashtë-mujore nis nga data e dorëzimit të këtij vendimi. Ky rregull zbatohet edhe nëse vendimi i gjykimet lidhur me zgjidhjen e fundit ligjore, shpallet në prani të kërkuetit dhe avokatit të tij. Në çështjen *Worm kundër Austrisë*²⁵⁵, kërkuesi ishte një gazetar i dënuar për ushtrim të një ndikimi të tepruar në procedimet penale. Gjykata e Apelit, si instanca e fundit, e dha gjykimin e saj në datën 19 tetor. Ajo prezantoi jo vetëm dispozitivin e vendimit, por edhe pjesët kryesore të arsytimit. Një kopje me shkrim iu dorëzua kërkuetit në datën 25 mars të vitit pasardhës. Kërkuesi e paraqiti kërkesën e tij në Gjykatën Evropiane të Drejtave të Njeriut në datën 28 korrik. Gjykata e refuzoi argumentin e palës kundërshtarë që kërkesa ishte paraqitur pas periudhës gjashtë-mujore. Ajo vuri në dukje që periudha kohore kishte nisur në kohën që kërkuesi i ishte dorëzuar vendimi i gjykimet me shkrim dhe jo koha kur ishte shpallur vendimi i gjykimet. Një nga arsyet e periudhës kohore ishte që t'i jepet kërkuetit kohë e mjaftueshme për të shqyrtuar hollësisht gjykimin përse i takon përputhshmërisë me Konventën dhe për të shtjelluar argumentet që do të paraqesë. Ky objektiv, sipas Gjykatës, përmbushej më mirë kur përlloragitej

²⁵⁵ Kërkesa nr. 83/1996/702/894,

afati kohor duke nisur nga momenti në kohë në të cilin kërkuesit i ishte dorëzuar vendimi i gjykimit.

Nëse legjislacioni kombëtar nuk parashikon dorëzimin e një kopjeje me shkrim të vendimit tek kërkuesi, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka pasur qasje të ndryshme lidhur me përlogaritjen e momentit fillestar të periudhës kohore, duke marrë në konsideratë specifikat e legjislacionit kombëtar. Në çështjen *Papachelas kundër Greqisë*²⁵⁶, një gjykatë greke kishte shpallur vendimin e saj në një çështje prone. Legjislacioni grek parashikonte bërjen përfundimtar të tij. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut konsideroi se “bërja përfundimtar” e vendimit ishte pika fillestare për përlogaritjen e afatit kohor. Kërkuesi duhet të bëjë përpjekje të mjaftueshme për t’u familjarizuar me përmbajtjen e gjykimit të fundit në nivel kombëtar sapo ai është i disponueshëm. Në çështjen *Haralambidis dhe të tjerët kundër Greqisë*²⁵⁷, vendimi ishte bërë përfundimtar pas bërjes publike të tij, siç parashihet legjislacion grek. Kërkuesit deklaruan se ata ishin kishin mësuar për vendimin disa muaj më vonë. Gjykata ishte e mendimit se ky ishte rezultat i neglizhencës së kërkuesve dhe e refuzoi kërkesën si të papranueshme.

- Paraburgimi

Procedimet lidhur me urdhrin për paraburgim dhe apelimi i këtij urdhri, duhet të trajtohet veçmas nga procedimet penale të themelit. Përlogaritja e periudhës gjashtë-mujore nis nga dita kur mbaron paraburgimi. Kjo mund të jetë ose dita kur lirohet kërkuesi²⁵⁸, ose nëse ai është ende në paraburgim për shkak se akuza është provuar në gjykim, të paktën në shkallën e parë²⁵⁹ (sipas përkufizimit të Konventës paraburgimi mbaron kur përfundon akuza në shkallën e parë).

Nëse kërkuesi çohet në paraburgim, pastaj lirohet dhe pastaj çohet sërish në paraburgim, periudhat e paraburgimit duhet të konsiderohen veç e veç. Data e përfundimit të periudhës së parë përcakton periudhën kohore për kërkesë në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut lidhur me këtë periudhë në lëvizje. Për disa kohë, praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut nuk ka qenë e qëndrueshme në këtë aspekt. Në çështjen *Idalov kundër Rusisë*²⁶⁰, Dhoma e Madhe ka sqaruar që periudhat e ndryshme të paraburgimit të ndërprera nga një fazë në të cilën kërkuesi ishte i lirë, nuk mund të konsiderohen si një fazë paraburgimi. Kërkuesi ishte në paraburgim nga qershori i vitit 1999

²⁵⁶ Kërkesa nr.31423/96, vendim i Dhomës së Madhe i datës 25 March 1999; shih gjithashtu Seher Karatas kundër Turqisë (kërkesa nr. 33179/96), vendim i datës 9 korrik 2002

²⁵⁷ Kërkesa nr. 36706/97, vendim i datës 29 mars 2001

²⁵⁸ Jecius kundër Lituanisë, paragrafi 44

²⁵⁹ Idalov kundër Rusisë (Dhoma e Madhe) paragrafi 112

²⁶⁰ Kërkesa nr. 5826/03, vendim i Dhomës së Madhe i datës 22 maj 2012

deri në korrik të vitit 2001; më pas atë e liruan dhe e paraburgosën sërish nga tetori i vitit 2002 deri në nëntor të vitit 2003. Ai paraqiti një kërkesë duke u ankuar për aspekte të ndryshme të dy periudhave të paraburgimit në shkurt të vitit 2003. Dhoma e Madhe e Gjykatës konsideroi se kërkesës i kishte kaluar koha përsa i takonte periudhës së parë të paraburgimit; ajo deklaroi, sidoqoftë, se periudha mund të merrej ende në konsideratë kur të përcaktohej nëse periudha e paraburgimit ishte e arsyeshme.

- **Deportimi**

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut nuk e trajton të drejtën për azil apo për marrjen e një lejeje qëndrimi në një shtet anëtar të Konventës. Megjithatë Gjykata mund të mos e lejojë një shtet që të dëbojë një të huaj, në raste të veçanta kur ka gjasa që i huaji të persekutohet apo të bëhet objekt i torturave nëse deportohet në vendin e tij. Ky rrezik duhet vlerësuar vazhdimisht; nga ky këndvështrim, një deportim i pashmangshëm i ngjan një situatë të vazhdueshme. Prandaj, afati kohor nuk vihet në lëvizje me vendimin mbi apelimin e fundit në nivel kombëtar. Në çështjen *P.Z. kundër Suedisë*²⁶¹, kërkuësja ishte shtetase afgane. Ajo aplikoi për leje qëndrimi, por kërkesa iu refuzua. Meqë ajo kishte frikë se do ta persekutojnë në rast deportimi në Afganistan, paraqiti një mocion për ta pezulluar përkohësisht zbatimin e urdhrin për deportimin e saj. Mocioni u refuzua dhe ajo paraqiti një kërkesë në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Gjykata vuri në dukje se pika fillestare për afatin kohor prej gjashtë muajsh nuk ishte as vendimi mbi kërkesën e saj për leje qëndrimi, as vendimi mbi mocionin për pezullimin e përkohshëm të zbatimit të urdhrin. Ajo u shpreh se duheshin shqyrtuar në mënyrë të përhershme arsyet për të mos e deportuar atë sipas nenit 3, pra që afati kohor prej gjashtë muajsh, nuk kishte nisur ende.

- **Mungesa e një zgjidhjeje efikase**

Aty ku është e qartë që në fillim se nuk ka asnjë zgjidhje efikase për kërkuësin, përllogaritja e afatit nis që nga data e masës së marrë²⁶². Në çështjen *Dennis dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*²⁶³, djali i kërkuësit kishte vdekur në një përplasje anijesh në lumin Tamiz. Mjeku ligjor dha leje që trupave t'iu priteshin duart për të mundësuar identifikimin e tyre. Kërkuësit dëshironin që të shihnin trupin e djalit të tyre, por kjo iu mohua. Dy vjet pas mohimit ata paraqitën një kërkesë në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Gjykata e refuzoi kërkesën si të papranueshme. Ajo deklaroi se kishte qenë e qartë që në fillim se, nuk kishte

²⁶¹ Kërkesa nr. 68194/10, vendim i datës 29 maj 2012

²⁶² Walker kundër Mbretërisë së Bashkuar (kërkesa nr. 34979/97), vendim për pranueshmërinë i datës 25 janar 2011

²⁶³ Kërkesa nr. 76563/01, vendim për pranueshmërinë i datës 2 korrik 2002

zgjidhje ligjore kundër mohimit të kërkesës për të parë trupin. Prandaj periudha ligjore kishte nisur nga çasti kur prindërit kishin mësuar për këtë vendim. Nëse kërkuesi supozon se ekziston një zgjidhje ligjore në fuqi dhe më vonë mëson se zgjidhja tek e cila ai do të mbështetej, në fakt nuk është në fuqi, periudha kohore nis që nga dita kur ai mëson për mos qenien e saj në fuqi. Në çështjen *Paul dhe Aubrey Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*,²⁶⁴ djali i kërkuessve kishte vdekur në burg. Kërkuessin e kishin informuar se procedimet civile nuk do të ishin ekonomike. Ata pritën për rezultatin e një hetimi zyrtar mbi vdekjen e djalit të tyre, duke shpresuar që të gjenin një bazë për të kërkuar zgjidhje. Pasi hetimi nuk kishte çuar në ndonjë rezultat, ata paraqitën një kërkesë në Gjykatën Evropiane të Drejtave të Njeriut. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut deklaroi se periudha gjashtë-mujore kishte nisur me botimin e raportit, kur kërkuessit mësuan se ajo nuk përbënte bazë për ndonjë lloj procedimi në gjykatat e vendit.

- Shkeljet e vazhdueshme

Në rast të shkeljeve të vazhdueshme, afati kohor prej gjashtë muajsh nuk aplikohet, pasi afati kohor nis çdo ditë nga fillimi. Për shembull, në çështjen *Tarverdiyev kundër Azerbajxhanit*, kërkuesi kishte marrë një vendim gjyqor ku urdhërohej se ai duhej të vendosej në pozicionin e tij të mëparshëm. Qeveria kundërshtoi lidhur me mosrespektimin e afatit kohor. Gjykata u shpreh se gjykimi mbeti i pa ekzekutuar, ndaj nuk u ngrit asnjë çështje lidhur me afatin kohor.²⁶⁵

- Zhdukjet

Ndërsa zhdukjet (gjatë luftërave civile, trazirave publike, konflikteve, etj.) të personave ngjasojnë me situatat e vazhdueshme në shumë mënyra, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, deri në njëfarë shkalle, i trajton ndryshe ato. Në çështjen *Varnava kundër Turqisë*²⁶⁶, Gjykata ka deklaruar se në rast të zhdukjes “kërkuessit nuk mund të presin pafundësisht derisa të vijin në Strasburg. Ata duhet të japin prova se kanë vullnetin dhe iniciativën që të paraqesin ankesat e tyre pa vonesa të tepërta.”²⁶⁷. Gjykata vlerëson sipas rastit se çfarë hapash kanë ndërmarrë të afërmit dhe cilat masa mund të presin në mënyrë të arsyeshme, para se të paraqesin një kërkesë.

²⁶⁴ Kërkesa nr. 46477/99, vendim për pranueshmërinë i datës 4 qershor 2001

²⁶⁵ Kërkesa nr. 33343/03, vendimi i datës 26 korrik 2007

²⁶⁶ Kërkesa nr. 16064/90, vendimi i Dhomës së Madhe i datës 18 shtator 2009

²⁶⁷ Paragrafi 161

9.2.4.3. Përlllogaritja e afatit kohor

Afati kohor për paraqitjen e kërkesës është gjashtë muaj. Ai nis të llogaritet duke filluar nga dita vijuese e ditës që vë në lëvizje afatin kohor. Për shembull, nëse vendimi final i jepet kërkuarit në datën 4 shkurt, dita e parë e periudhës gjashtë mujore është data 5 shkurt. Afati kohor skadon në datën 5 gusht në mesnatë. Kjo vlen pavarësisht se sa të gjatë janë muajt që mbulon kjo periudhë kohore.

Nëse dita e fundit e periudhës kohore është **ditë e shtunë, e diel, apo ditë pushimi zyrtar, afati kohor nuk zgjatet** deri ditën vijuese të punës. Në çështjen *Sabri Günes kundër Turqisë*, vendimi përfundimtar i Gjykatës administrative ishte dhënë në datën 28 nëntor 2005. Data 28 maj 2006 ishte ditë e diel; kërkuari e paraqet kërkesën në datën 29 maj 2006. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut deklaroi që përputhshmëria me afatin kohor prej gjashtë muajsh duhet të përmbushë kriteret e Konventës, jo të kriterëve të parashtruara në kuadrot ligjore të shteteve anëtare. Ajo gjithashtu theksoi se aplikimi i rregullave të vetë Gjykatës kontribuon në një siguri juridike dhe i kursen Gjykatës përpjekjen për të hartuar një axhendë të plotë të të gjitha pushimeve zyrtare kombëtare në shtetet anëtare të Konventës. Për pasojë, ajo u shpreh se afati kohor kishte kaluar në datën 28 maj 2006, në mesnatë, dhe e refuzoi kërkesën mbi bazën se i kishte kaluar koha.

Nëse një kërkesë dërgohet me postë, data në vulën postare është vendimtare, jo data në të cilën letra ka mbërritur në Gjykatë²⁶⁸.

9.2.4.4. Informacionet që duhet të jepen brenda afatit

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka vendosur në dispozicion një formular aplikimi i cili duhet të plotësohet nga kërkuarit. Formulari mund të gjendet në faqen e internetit të Gjykatës dhe në aktet bashkëlidhur këtij manuali. Duke filluar nga 1 janar 2014, Gjykatës duhet t'i dërgohet brenda afatit kohor formulari i aplikimi i plotësuar në përputhje me udhëzimet e Gjykatës si dhe çdo dokument tjetër në të cilin mbështesni pretendimet tuaja. Në rast se nuk depozitoni një formular aplikimi të plotë, kërkesa juaj nuk do të shqyrtohet nga Gjykata. Neni 47 i Rregullores së Gjykatës përcakton më në detaje përmbajtjen e një aplikimi individual.

Përpara se të ndryshohet neni 47 i Rregullores, përlllogaritja e afatit mund të pezullohet duke dërguar një “letër të parë”, i.e. një përmbledhje e shkurtër e fakteve në të cilën bazohet aplikimi dhe e të drejtave që pretendohet që ishin

²⁶⁸ Kipritki kundër Turqisë (kërkesa nr. 14294/04), vendimi i datës 3 qershor 2008

cenuar. Pas kësaj procedure, Gjykata i dërgonte kërkuetit një formular aplikimi dhe i përcaktonte një afat brenda të cilit duhej ta plotësonte. Kjo procedurë tashmë ka ndryshuar. Gjykata ka publikuar një video²⁶⁹ se si mund të plotësohet një formular aplikimi. Përveç saj, Gjykata ka publikuar edhe një udhëzues për mënyrën se si plotësohet formulari i aplikimit. Ky udhëzues mund të gjendet në faqen zyrtare të Gjykatës si dhe në materialet bashkëlidhur këtij manuali.

9.2.5. Disavantazhe të konsiderueshme

9.2.5.1. Përmbledhje/Tablo e përgjithshme

Neni 35 paragrafi 3 (b) i Konventës përcakton parimin se kërkesat individuale deklarohen të papranueshme, nëse kërkueti nuk ka vuajtur nga ndonjë disavantazh i konsiderueshëm. Kjo dispozitë ka për qëllim që të respektojë parimin që Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut duhet të fokusohet në çështjet e rëndësishme që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të njeriut në nivel evropian. Formulimi aktual i këtij neni, parashikon edhe dy përjashtime nga ky parim. Këto raste përjashtimore që duhet të merren parasysh, janë:

- nëse e kërkon respektimi i të drejtave të njeriut
- nëse rasti nuk është marrë siç duhet në konsideratë, në vendin nga vjen

Përsa i përket këtyre dy përjashtimeve, ky nen ka mundësi të ndryshohet së shpejti. Protokoli 15 i KEDNJ-së do të fshijë fjalët “... dhe më kusht që asnjë çështje që nuk është marrë në konsideratë siç duhet nga një gjykatë vendase, të mos mund të refuzohet mbi këto baza”, në mënyrë që përjashtimi i dytë të bëhet nul. Atëherë, çështjet ku kërkueti nuk ka qenë objekt i një disavantazhi të konsiderueshëm nuk do të pranohen edhe nëse nuk janë konsideruar siç duhet në vendin e tyre. Protokoli 15 është i hapur për t’u firmosur dhe do të hyjë në fuqi sapo të nënshkruhet nga të gjitha shtetet anëtare. Për këtë arsye, sa i përket afatit të dorëzimit të kërkesës (shih më sipër), këshillohet që avokatët të shohin nëse është ndryshuar Konventa para se ta këshillojnë klientin që të dorëzojë kërkesën në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

²⁶⁹ Video mund të gjendet në adresën: http://www.youtube.com/watch?v=mA_iGhvxYFM&feature=youtu.be

9.2.5.2. Kuptimi i disavantazhit

Koncepti “disavantazh i konsiderueshëm” nuk mund të përkufizohet në mënyrë shteruese²⁷⁰. Ideja që qëndron pas këtij kriteri është ajo që shkelja e një të drejte duhet të arrijë një nivel minimal ashpërsie për të garantuar marrjen parasysh të saj nga një gjykatë ndërkombëtare. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vendos nëse është arritur masa e kërkuar e ashpërsisë, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes, si dhe duke e konsideruar shkeljen si perceptimin subjektiv të personit të prekur nga shkelja, ashtu edhe atë çka rrezikohet objektivisht, në rastin në fjalë²⁷¹.

9.2.5.2.1. Dëmi financiar

Nëse kërkuesi ka pësuar një **dëm financiar**, rëndësia e dëmit vlerësohet mbi bazën e shumës së humbur nga kërkuesi²⁷². Në përgjithësi, nuk ka ndonjë masë minimale që të shërbejë si pikë referimi për të vendosur nëse dëmi është apo jo i rëndësishëm. Gjykata e vendos këtë rast pas rasti. Në këtë vlerësim, Gjykata nuk e konsideron shumën në fjalë në terma abstraktë, por në dritën e situatës ekonomike specifike të kërkuetit dhe merr parasysh edhe faktorë si situata e përgjithshme financiare²⁷³. Për shembull, në çështjen *Bock kundër Gjermanisë*, kërkuesi ishte një nëpunës civil me një pagë mujore prej rreth 4.500 eurosh. Ai u ankua ndaj kohëzgjatjes së procedurave administrative për një pagesë prej 7.99 eurosh. Gjykata vendosi se kërkuesi nuk kishte qenë objekt i një disavantazhi të konsiderueshëm, duke iu referuar, ndër të tjera, të ardhurave mujore të kërkuetit. Po kështu, në çështjen *Fernandez kundër Francës*, një çështje në lidhje me pagesën e një gjobe prej 135 eurosh, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut i dha një lloj rëndësie faktit se kërkuesi ishte gjyqtar i Gjykatës së Apelit, i cili kishte një nivel të caktuar të ardhurash.

Disa shembuj nga jurisprudenca e Gjykatës mund të na japin një ide të asaj çka Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut e konsideron si një disavantazh të konsiderueshëm. Në çështjen *Cecchetti kundër San Marinos* kërkuesi ishte urdhëruar të paguante 13.91 euro taksa të papaguara plus një gjobë prej 3.48 Euro. Gjykata vendosi se kjo nuk përbënte një disavantazh të konsiderueshëm. Në çështjen *Korolev kundër Rusisë*²⁷⁴, autoritetet ruse nuk i kishin paguar kërkuetit një shumë

²⁷⁰ Cecchetti kundër San Marinos, paragrafi 28

²⁷¹ Korolev kundër Rusisë

²⁷² Ionescu kundër Rumanisë, vendimi i pranueshmërisë, datë 1 qershor 2010

²⁷³ Cecchetti kundër San Marinos (aplikimi nr. 40174/08), vendimi i pranueshmërisë, datë 9 prill 2013

²⁷⁴ Kërkesa nr. 25551/05, vendimi i pranueshmërisë, datë 1 korrik 2010

ekuivalente me më pak se një euro. Gjykata nuk e pranoi kërkesën, meqenëse kërkuesi nuk kishte qenë objekt i ndonjë disavantazhi të konsiderueshëm. Në çështjen *Ionescu kundër Rumanisë*²⁷⁵, kërkuesi kishte hapur gjyq për një shumë prej rreth 90 eurosh. Gjykata vendosi se ai nuk kishte qenë objekt i një disavantazhi të konsiderueshëm. Në çështjen *Bock kundër Gjermanisë*²⁷⁶, kërkuesi, i cili kishte një pagë mujore prej rreth 4.500 eurosh, u ankua rreth kohëzgjatjes së procedurave administrative për një pagesë prej 7.99 eurosh. Gjykata vendosi se kërkuesi nuk kishte qenë objekt i një disavantazhi të konsiderueshëm.

9.2.5.2.2. Dëmet jo financiare

Kriteri i “disavantazhit të konsiderueshëm” aplikohet edhe në rastet kur kërkuesi nuk ka qenë objekt i ndonjë paragjykimi financiar. Në këto raste, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vlerëson faktin se sa ka ndikuar masa e marrë mbi kërkuenin, deri në çfarë mase është ndikuar ai negativisht prej saj. Në çështjen *Zwinkels kundër Holandës*²⁷⁷, kërkuesi kishte punësuar persona që nuk kishin leje pune në Holandë. Inspektorët e punës i panë ata duke punuar në shtëpinë e kërkuetit dhe i morën në pyetje punëtorët në garazhin e kërkuetit, i cili nuk ishte i lidhur me shtëpinë. Kërkuetit iu vu një gjobë. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut nuk e pranoi kërkesën e tij pasi kërkuesi nuk kishte qenë objekt i një disavantazhi të konsiderueshëm. Ajo theksoi se ai as që e kishte vënë re se punëtorët ishin marrë në pyetje në garazhin e tij dhe se gjoba që i ishte vënë nuk kishte lidhje me rrethanat e marrjes së tyre në pyetje.

9.2.5.3. Të drejtat e njeriut kërkojnë gjykim në themel

Neni 35, paragrafi 3 bën një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm. Sipas tij, kërkesat që konsistojnë në një ankesë rreth një disavantazhi të konsiderueshëm duhet të pranohen, edhe pse kërkuesi nuk ka qenë objekt i një disavantazhi të konsiderueshëm, nëse shqyrtimi i çështjes në themel diktohet nga zbatimi i të drejtave të njeriut. Ky përjashtim është përfshirë për t’u siguruar që çështjet, “të cilat pavarësisht natyrës së tyre të parëndësishme, ngrenë pikëpyetje serioze që prekin kërkesën ose interpretimin e Konventës apo pikëpyetje në lidhje me legjislacionin vendas”, të mos refuzohen²⁷⁸.

Ashtu sikurse nënkuptohet nga ky shpjegim, kërkesa nuk duhet të refuzohet

²⁷⁵ Kërkesa nr. 36659/04, vendimi i pranueshmërisë, datë 1 qershor 2010

²⁷⁶ Kërkesa nr. 22051/07, vendimi i pranueshmërisë, datë 19 janar 2010

²⁷⁷ Kërkesa nr. 16593/10, vendimi i pranueshmërisë, datë 9 tetor 2012

²⁷⁸ Raporti Shpjegues i Protokollit Nr. 14, paragrafi 39

nëse ajo ngre çështje të një rëndësie të përgjithshme për sistemin ligjor vendas, për interpretimin apo zbatimin e KEDNJ-së. Për shembull, në çështjen *Nicoleta Gheorge kundër Rumanisë*²⁷⁹, kërkuesi ishte dënuar nga policia me një gjobë prej 17 eurosh për prishjen e rendit publik. Pavarësisht shumës së vogël në fjalë, e cila nuk rezultoi në një disavantazh të konsiderueshëm, Gjykata vlerësoi se çështja duhej gjykuar në themel, në interes të të drejtave të njeriut. Ajo theksoi se ky rast kishte të bënte me çështjen e përgjithshme të zbatueshmërisë së nenit 6, në lidhje me gjokat administrative. Është e rëndësishme të theksohet fakti se ky rast ishte i pari që vinte në Gjykatë pas ndryshimit të praktikave të brendshme në Rumani si rezultat i vlerësimit të procedurave të mëparshme jo në përputhje me Konventën. Në çështjen *Jubas Duric kundër Serbisë*²⁸⁰, kërkuesi i ishte caktuar një avokat për ta këshilluar, ndërkohë që ai merrej në pyetje nga policia. Atij i ishte faturuar një shumë e barabartë me 105 euro për ndihmën ligjore që i ishte dhënë. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut e deklaroi kërkesën të pranueshme pavarësisht se dëmi financiar kishte qenë krahasimisht modest. Ajo u shpreh se avokati i caktuar nga policia kishte një rëndësi vendimtare për sistemin serb të drejtësisë penale, kështu që çështjet që lidheshin me pagesën e këtyre avokatëve nuk mund të konsideroheshin të parëndësishme.

9.2.5.4. Mos vlerësimi siç duhet në nivelin vendas

Një kërkesë nuk duhet të refuzohet si e papranueshme nëse nuk është vlerësuar siç duhet nga një gjykatë vendase. Qëllimi i kësaj dispozitë është që të mos lejojë që kërkuesi t'i mohohet drejtësia dhe të garantojë që çdo rast të gjykohet, në mos në nivel vendas, të paktën në planin ndërkombëtar.

9.2.6. Mos abuzimi me të drejtën e paraqitjes së një kërkesë

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut duhet t'i refuzojë kërkesat nëse ato përbëjnë një abuzim me të drejtën për të paraqitur një kërkesë (Neni 35 paragrafi 3). Rëndësia praktike e kësaj dispozite është e kufizuar.

Gjykata e ka përshkruar “abuzimin” si ‘*ushtrim të dëmshëm të një të drejte për qëllime të ndryshme nga ato për të cilat ajo është parashikuar*’²⁸¹. Çdo sjellje e një kërkuesi që bie në ndesh me mundësinë e së drejtës për të paraqitur një kërkesë dhe që pengon funksionimin e duhur të Gjykatës dhe zhvillimin e duhur të procesit, përbën abuzim të së drejtës për paraqitjen e një kërkesë²⁸².

²⁷⁹ Kërkesa nr. 23470/05, gjykimi i datës 3 prill 2012

²⁸⁰ Kërkesa nr. 48155/06, gjykimi i datës 7 qershor 2011

²⁸¹ Petrovic kundër Serbisë, f. 9

²⁸² Mirolubovs dhe të tjerë kundër Letonisë, paragrafi 62 dhe 65

Prandaj, kërkesat mund të refuzohen si kërkesa që abuzojnë me të drejtën e paraqitjes së një të tillë, nëse dihet se kërkuesi nuk i paraqet faktet siç duhet ose e bazon kërkesën në fakte të pavërteta²⁸³. Kjo nuk do të thotë se faktet mund të mos jenë të diskutueshme midis kërkuetit dhe shtetit të paditur, apo që interpretimet e ngjarjeve që kanë çuar deri tek kërkesa mund të jenë ndryshme, por do të thotë se kërkuesi (dhe përfaqësuesi i tij ligjor) nuk duhet ta gënjejë Gjykatën. Gabime të bëra pa dashje në lidhje me detaje të vogla apo interpretime të ndryshme të fakteve apo dispozitave ligjore, nuk çojnë në abuzim me të drejtën e paraqitjes së një kërkesë. Në çështjen *Marini kundër Shqipërisë*²⁸⁴, kërkuesi u ankua për moszbatimin e vendimeve të gjykatës që ai kishte marrë, nga ana e autoriteteve shqiptare. Qeveria e ftoi Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut që të mos e pranonte kërkesën, duke e konsideruar atë abuzim me të drejtën e paraqitjes së një kërkesë. Gjykata theksoi se kërkesa mund të refuzohet si abuzive, vetëm nëse dihet se ajo bazohet në fakte të pavërteta. Ajo theksoi se kërkuesi nuk kishte paraqitur fakte të pavërteta, por të ndryshme nga qeveria, në interpretimin e vendimeve të marra nga gjykata shqiptare. Prandaj, ajo nuk e shpalli kërkesën të papranueshme.

Abuzim me të drejtën për të paraqitur një kërkesë mund të konsiderohet edhe mos informimi i Gjykatës nga ana e kërkuetit rreth zhvillimeve që lidhen me çështjen e tij apo mos ofrimi i informacionit të kërkuar nga Gjykata brenda afateve të caktuara. Në çështjen *Bekauri kundër Gjeorgjisë*²⁸⁵, kërkuesi u ankua se dënimi i tij me burgim të përjetshëm ishte në shkelje të nenit 3 të KEDNj-së (ndalimi i torturës). Pas dorëzimit të kërkesës nga përfaqësuesi i tij ligjor, dënimi me burgim u ul në gjashtëmbëdhjetë vjet. Megjithatë, kërkuesi nuk e informoi Gjykatën për këtë vendim. Përveç kësaj, avokatja e kërkuetit nuk iu përgjigj kërkesave të Gjykatës për informacione të caktuara dhe i kërkoi Gjykatës dy herë që t'i jepte një kopje të dosjes, duke pretenduar se i kishte humbur të gjitha dokumentet. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vlerësoi se kjo sjellje përbënte abuzim me të drejtën për të paraqitur një kërkesë.

Edhe mbingarkimi i Gjykatës me kërkesa të ndërlikuara dhe të pabazuara qartë, gjë që nuk e lejon Gjykatën të përqendrohet në detyrat e saj reale, është abuzim i të drejtës për të paraqitur një kërkesë. Në çështjen *Petrovic kundër Serbisë*²⁸⁶, një avokat kishte depozituar më shumë se 500 kërkesa në Gjykatë, shumë prej të cilave kishin të bënin me mosmarrëveshje në marrëdhënie pune

²⁸³ Varbonov kundër Bullgarisë, paragrafi 36

²⁸⁴ Kërkesa nr. 3738/02, gjykimi i datës 18 dhjetor 2007

²⁸⁵ Kërkesa nr. 14102/02, gjykimi i datës 10 prill 2012

²⁸⁶ Kërkesa nr. 565551/11, vendimi i pranueshmërisë i datës 18 tetor 2011

dhe padi civile që ende ishin duke u gjykuar nga gjykatat serbe. Në shumë raste, kishte pasur dyshime në lidhje me autenticitetin e prokurave të paraqitura prej tij. Gjykata vendosi t'i bashkonte kërkesat dhe të mos i pranonte për shkak të abuzimit me të drejtën e paraqitjes së një kërke.

Në çdo fazë të procedimit para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, palët mund të angazhohen në diskutime përsa i përket gjetjes së një zgjidhjeje me mirëkuptim (neni 39). Neni 39, paragrafi 2 parashikon që këto negociata të jenë konfidenciale. Ky parim ritheksohet edhe nga neni 62, paragrafi 2 i Rregullores së Gjykatës, i cili thotë: “*Në përputhje me Nenin 39 § 2 të Konventës, negociatat për gjetjen e një zgjidhjeje me mirëkuptim, duhet të jenë konfidenciale dhe pa paragjykim për argumentet e palëve në proces. Në procese konfliktuale, nuk mund të përmendet dhe nuk mund të përdoret asnjë komunikim me shkrim apo me gojë bërë në kuadrin e përpyekjeve për të siguruar një zgjidhje me mirëkuptim*”. Shkeljet e këtij rregulli mund ta bëjnë kërkesën abuzive. Për shembull, në çështjen *Mandil kundër Francës*²⁸⁷, kërkuesi u ankua rreth një dënimi penal, pas mospranimit të tij për ruajtjen e të dhënave të tij biologjike në një bazë publike të dhënash. Kërkuesi dhe qeveria e paditur u angazhuan në negociata për të gjetur një zgjidhje me mirëkuptim. Në kuadrin e këtyre negociatave, qeveria ofroi një kompensim në masën prej 1.500 eurosh. Kërkuesi dhe avokati i tij e nxorën këtë informacion në shtyp dhe një gazetë raportoi në lidhje me ofertën. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vendosi që shkelja e rregullit të konfidencialitetit çoi në abuzimin me të drejtën për të paraqitur një kërkesë dhe e deklaroi kërkesën të papranueshme.

Konfidencialiteti i negociatave në lidhje me gjetjen e një zgjidhjeje me mirëkuptim përbën një rregull të rëndësishëm, që është në interes të procedimit të duhur dhe sigurisë juridike. Ndonëse rregulli është absolut dhe nuk përmban një vlerësim të informacioneve që mund të bëhen të njohura në raste individuale, shkelja e konfidencialitetit nuk çon domosdoshmërisht në mospranimin e kërkesës si abuzive. Në çështjen *Lesnina Veletrgovina kundër Maqedonisë*²⁸⁸, kërkuesi kishte paraqitur një kërkesë bazuar në shkeljen e supozuar të së drejtës së tij për gjykim në një kohë të arsyeshme. Në median e shkruar u publikua një artikull rreth kësaj çështjeje, ku thuhej se kërkuesi “pothuajse e kishte fituar” çështjen dhe se po zhvilloheshin bisedime për gjetjen e një zgjidhjeje me mirëkuptim. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ritheksoi rëndësinë e konfidencialitetit të negociatave. Megjithatë, ajo nuk e refuzoi kërkesën si abuzive, pasi nuk ishte provuar se nxjerrja e informacionit kishte qenë faji i kërkuetit apo i përfaqësuesit të tij ligjor dhe se sasia e informacionit të nxjerrë ishte shumë e kufizuar. Gjithsesi,

²⁸⁷ Kërkesa nr. 67037/09, vendim i pranueshmërisë i datës 13 dhjetor 2011

²⁸⁸ Kërkesa nr. 37619/04, vendim i pranueshmërisë i datës 18 korrik 2013

avokatët këshillohen të frenohen e të mos japin informacione rreth diskutimeve për gjetjen e një zgjidhjeje e t'i udhëzojnë klientët e tyre të bëjnë të njëjtën gjë.

9.2.7. Mospranimi i kërkesave anonime

Kërkesat nuk duhet të jenë anonime pasi një e tillë nuk regjistrohet²⁸⁹. Si rregull, kërkesat bëhen duke përdorur një formular-kërkese, i ofruar nga Gjykata. Në këtë formular, kërkuesit duhet të plotësojnë emrin e tyre, datëlindjen, adresën ose kur kërkuesi është një ent ligjor, emrin e plotë, datën e regjistrimit ose themelimit, numrin zyrtar të regjistrimit (nëse ka) dhe adresën e plotë.

Në rast se këta kërkues nuk duan që identiteti i tyre të bëhet publik, ata duhet ta bëjnë këtë gjë të ditur dhe të paraqesin një deklaratë ku të japin edhe arsyet pse duan që identiteti i tyre të trajtohet si konfidencial. Kjo nuk është e detyrueshme për Gjykatën, por ajo mund të japë të drejtën e anonimatit (shih nenin 47 (4) të Rregullores së Gjykatës). Megjithatë, identiteti i kërkuesit duhet të mos i bëhet i ditur qeverisë. Për këtë rregull, mund të bëhen përjashtime në rrethana shumë të veçanta, ku kërkuesi mund të provojë se bërja e identitetit publik do ta ekspozonte atë ndaj një rreziku të pashmangshëm fizik.

9.3. Çështje procedurale

Pas trajtimit të pranueshmërisë së kërkesave në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, po renditim më poshtë disa komente shumë të shkurtra mbi procedurën e paraqitjes saj në Gjykatë.

9.3.1. Komente të përgjithshme

Kur depozitohet një kërkesë, është e rëndësishme që të kemi parasysh se çfarë është dhe çfarë nuk është Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, si dhe se çfarë e drejte mund të fitohet atje. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut është një gjykatë ndërkombëtare e mandatar për të garantuar përmbushjen e angazhimeve të ndërmarra nga shtetet ratifikuese të Konventës dhe protokolleve (neni 19 i GjEDNj). Ajo merret ekskluzivisht me KEDNj-në dhe me protokollat e saj.

Përsa më sipër ajo nuk është një Gjykatë e “shkallës së katërt” e cila thjesht ofron një tjetër rrugë rekursi, për të mbikëqyrur nëse gjykatat vendase kanë pasur të drejtë. Kjo do të thotë se Gjykata, si rregull, nuk angazhohet në interpretimin e ligjit vendas. Në këtë kuptim, ajo i rishikon vendimet e marra nga gjykatat

²⁸⁹ Harris/o'Boyle et al., Ligji për Konventën e të Drejtave të Njeriut, botimi i 2të, f. 781

vendase dhe interpretimin nga ana e tyre të ligjit vendas nga këndvështrimi i përputhshmërisë së tyre me kërkesat që rrjedhin nga Konventa. Gjithashtu, ajo nuk shqyrton faktet e vendosura nga gjykatat vendase. Ajo shqyrton vetëm nëse vendimi i marrë nga gjykata e një vendi të caktuar dhe procedura e ndjekur për arritjen e atij vendimi, janë në përputhje me KEDNJ-në.

9.3.2. Rezultatet

9.3.2.1. Konstatimi i një shkeljeje

Siç u theksua, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut është e mandatuara për të garantuar respektimin e KEDNJ-së nga shtetet anëtare. Procedura që kryhet përpara Gjykatës ka për qëllim të përcaktojë nëse një veprim apo mosveprim që i atribuohet një shteti anëtar, është në përputhje me Konventën. Nëse Gjykata arrin në përfundimin se veprim apo mosveprim konkret nuk është në përputhje me Konventën, ajo gjykon se ka pasur **shkelje**.

Ky konstatim nuk ndikon domosdoshmërisht në situatën e kërkuarit. Është detyrë e palëve kontraktuese që të garantojnë respektimin e Konventës dhe të ndreqin mangësitë në këtë aspekt. Nëse Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut konstaton një shkelje, është në diskrecionin e shteteve anëtare që të vendosin se si ta korrigjojnë këtë situatë. Nëse, për shembull, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut konstaton se një gjyq penal nuk i ka përmbushur kriteret e nenit 6, kjo nuk do të thotë domosdoshmërisht se kërkuari duhet të çlirohet nga përgjegjësia apo se ai ka të drejtën për t'u rigjykuar. U takon shteteve anëtare që të ndryshojnë dispozitat e tyre në sistemin e tyre ligjor vendas për këtë qëllim.

9.3.2.2. Shpërblimi i drejtë

Gjykata mund t'i japë kërkuarit një shpërblim të drejtë (Neni 41 i KEDNJ-së). Shpërblimi i drejtë mund të përfshijë dëmet pasurore dhe dëme jopasurore. Dëmet pasurore u referohen humbjeve financiare, që kërkuari ka vuajtur si pasojë e shkeljes së të drejtave të tij. Kjo luan kryesisht një rol në procedim në lidhje me shkeljen e së drejtës së gëzimit paqësor të pasurisë (neni 1 i Protokollit 1 të KEDNJ-së). Dëmet jopasurore u referohen shqetësimit ose vuajtjes së pësuar nga kërkuari. Nëse Gjykata vendos se ka pasur një dëm të tillë, përmasat e dëmit varen pastaj nga shkalla e shkeljes. Një kërkuar që kërkon një shpërblim të drejtë duhet të bëjë një kërkesë të posaçme për këtë qëllim dhe të paraqesë të dhëna të detajuara për të mbështetur kërkesën e tij (shih nenin 60 të Rregullores së Gjykatës).

9.3.2.3. Masat e ndërmjetme

Në rrethana të caktuara, Gjykata mund të urdhërojë marrjen e masave të ndërmjetme. Masat e ndërmjetme nuk parashikohen qartë në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut; ato parashikohen në nenin 39 të Rregullores së Gjykatës. Neni 39 i Rregullores së Gjykatës parashikon se “*Dhoma ose, sipas rastit, Kryetari i saj mund t’u japë palëve çfarëdo lloj mase të ndërmjetme që mendon se duhet marrë në interes të palëve ose të procedimit të dubur para saj*”.

Masat e ndërmjetme mund të jepen kryesisht në rastet kur është krijuar një fakt i pakthyeshem ose kur një të drejtë të rëndësishme i është shkaktuar një dëm i riparueshem, para se Gjykata të marrë vendim. Fushat kryesore të zbatimit janë e drejta e jetës sipas nenit 2 të Konventës dhe ndalimi i torturës sipas nenit 3 të KEDNj-së. Në çështjen *Mamatkulov dhe Askarov kundër Turqisë*, Gjykata vendosi se masat e ndërmjetme janë të detyrueshme për palët dhe se mosrespektimi i masave të ndërmjetme përbën shkelje të nenit 34 të KEDNj-së.

9.3.2.4. Procedura e gjykimit pilot


Procedura e gjykimit pilot është krijuar nga Gjykata për t’u marrë me një numër të madh kërkesash që vijnë si pasojë e një problemi themelor. Nëse Gjykata merr një numër të madh padish ndaj një shteti të caktuar në lidhje me një çështje apo temë specifike (për shembull kohëzgjatja e gjykimit), ajo mund të zgjedhë një ose më shumë çështje për t’i trajtuar me prioritet. Në vendimin e marrë, Gjykata duhet të shpjegojë se si duhen adresuar mangësitë sistemike që kanë çuar në një numër të madh kërkesash. Nëse Gjykata angazhohet në një procedurë të gjykimit pilot, kërkesat e tjera që lidhen me të njëjtin problem mund të lihen në pritje deri në finalizimin e procedurës pilote të gjykimit.

9.3.2.5. Zgjidhja me pajtim

Me pranimin e kërkesës, Gjykata u kërkon palëve të angazhohen në negociata për arritjen e një zgjidhjeje me pajtim (neni 62 i Rregullores së Gjykatës). Është e rëndësishme të theksohet se këto diskutime duhen trajtuar në mënyrë konfidenciale.

Nëse palët nuk bien dakord për gjetjen e një zgjidhjeje me pajtim, shteti i paditur mund të depozitojë një deklaratë të njëanshme, duke pranuar shkeljen si dhe të paraqesë një kërkesë për ta hequr çështjen nga lista (neni 62 A i Rregullores së Gjykatës).

“Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) punon për stabilitet, begati dhe demokracinë në 57 shtete përmes dialogut politik rreth vlerave të përbashkëta dhe përmes punës praktike që sjell një ndryshim jetëgjatë”



Përmban CD me aktet e procesit civil

osce Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri
www.osce.org/albania

ISBN 978-92-9235-258-5

